7-8
1974
monumentet

monumentet



DO NOT COPY

7-8, 1974

Çmimi 10 Lekë

IMK
05
MON

DO NOT COPY

Kopertina e parë: **Lis — «Porta e brendshëme» pas restaurimit**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

7-8, 1974

INST. QEN. KULTURËS
BIBLIOTEKA
Nr. INV. 8663

REDAKSIA:

Gani Strazimiri (Kryeredaktor)
Aleksandër Meksi, Apollon Baçe, Emin Riza, Gjerak Karaiskaj, Neritan Ceka (Sekretar),
Selim Islami (Zëvendëskryeredaktor), Stilian Adhami.

DO NOT COPY

Redaktor: Nikolla Mullisi

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
pranë Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës

Adresa e redaksisë: Rruga Alqi Kondi nr. 7, Tiranë.

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

Koço ZHEKU
— Restaurimi i Portës së Brendshme në qytetin ilir të Lisit. 7

Apollon BAÇE
— Qyteti i fortifikuar i Kaninës. 25

Burhan DAUTAJ
— Një rrugë kryesore në Apolloni. 55

Neritan ÇEKA
— Fortifikime të vona antike pranë rrugës Egnatia. 71

Gjerak KARAISKAJ
Petrika LERA
— Fortifikimet e vona antike në rrethin e Korçës. 91

Hasan NALLBANI
— Mozaiku i kishës së amfiteatrit të Durrësit. 111

Valter SHTYLLA
— Banjat e mesjetës së vonë në Shqipëri. 119

Aleksandër MEKSI
Emin RIZA
— Ndërtimet në fshatin rrënojë të Kamenicës. 139

Lazër PAPAJANI
— Kalaja e Prezës. 167

Burhan STRAZIMIRI
— Banesa në Malësinë e Krujës. 183

Emin RIZA
— Banesa me gjysmëkat-perpendikular. 203

MATERIALE DHE KUMTESA

Dhimosten BUDINA
Spiro KOÇO
— Punimet restauruese në disa mozaikë në qytetin e lashtë të Apollonisë. 217

Aleksandër MEKSI
— Dy ndërtime të tipit trekonkësh. 229

Halil MYRTO
— Mbi disa qendra arkeologjike midis Kavajës dhe Durrësit. 247

Maksi VELO
— Banesa popullore në zonën e Ndroqit. 259

Aleksandër MEKSI
— Restaurimi i kishës së manastirit të Shën-Thanasit në Poliçan. 277

KRONIKË

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

Page

ARTICLES

Koço ZHEKU
– Restauration de la porte de la cité illyrienne de Lis. 22

Apollon BAÇE
– La ville fortifiée de Kanine. 51

Burhan DAUTAJ
– Une rue principale à Apollonie. 67

Neritan ÇEKA
– Fortifications de la basse antiquité à proximité de la via Egnatia. 87

Gjerak KARAISKAJ
Petrika LERA
– Fortifications de la basse antiquité dans le district de Korçe. 108

Hasan NALLBANI
– Les mosaïques de l'église de l'amphithéâtre de Durrës. 117

Valter SHTYLLA
– Hammams du bas moyen âge en Albanie. 135

Aleksandër MEKSI
Emin RIZA
– Constructions du village en ruine de Kamenice. 161

Lazer PAPAJANI
– La forteresse de Preze 180

Burhan STRAZIMIRI
– L'habitation de la Malësi de Kruja. 200

Emin RIZA
– L'habitation à demi-étage perpendiculaire. 214

COMMUNICATIONS ET MATERIAUX

Dhimosten BUDINA
Spiro KOÇO
– Restauration de mosaïques découvertes dans la ville ancienne d'Apollonie. 227

Aleksandër MEKSI
– Deux constructions du type à trois conques. 244

Halil MYRTO
– A propos de certains centres archéologiques situés entre Kavaja et Durrës. 257

Maksi VELO
– L'habitation type de la zone de Ndroq. 274

Aleksandër MEKSI
– Restauration de l'église du monastère de Saint-Athanase de Poliçan 286

CHRONIQUE

DO NOT COPY

DO NOT COPY

KOÇO ZHEKU

RESTAURIMI I PORTËS SË BRENDSHME NË QYTETIN ILIR TË LISIT*)

DO NOT COPY

Punimet kërkimore dhe ato restauruese dhe konservuese që janë kryer për disa vjet me radhë në qytetin e Lisit e kanë kthyer atë në një qendër të rëndësishme studimore dhe turistike.

Rezultat i këtyre punimeve është zbulimi, në pjesën më të madhe i mureve të rrethimit, kullave mbrojtëse, portave dhe të disa monumenteve të tjerë të qytetit të lashtë.[1]) Në një pjesë të mirë të këtyre monumenteve janë kryer edhe punime me karakter konservimi dhe restaurimi. Një nga monumentet e Lisit, që u restaurue plotësisht, ka qenë dhe Porta e Brendshme, punën e kryer dhe rezultatet e arrijtura në restaurimin dhe rikonstruksionin e së cilës do ti paraqesim shkurtimisht në këtë punim.

Porta e Brëndshme është quajtur një nga të dhjetë portat e qytetit që janë zbuluar deri më sot. Ky emërtim lidhet me pozicionin topografik dhe funksionin e saj. Ajo është e vendosur gati në mes të gjatësisë së murit të brendshëm, dhe në skajin veriperëndimor të taracës së madhe të shpatit jugor të kodrës, ku shtrihej pjesa më e rëndësishme e qytetit të lashtë (fig. 1). Kjo portë i shërbente kryesisht qytetit të sipërm, për të komunikuar brëndapërbrënda me qytetin e poshtëm. Megjithëkëtë ajo ka qenë, sikurse edhe portat e tjera, e mbrojtur me një kullë drejtkëndore ndërtuar në krahun e majtë të hyrjes së saj.

Porta e Brendshme lidhet konstruktivisht me murin e brendshëm të tij, si rrjedhim ajo është më e vonë se portat e tjera të qytetit dhe koha e ndërtimit të saj lidhet gjithashtu me murin e brendshëm, i cili është ndërtuar që nga themelet rreth mesit të shek. I p.e. sonë. Ky mur, që ndante qytetin në dy zona, bën pjesë në punimet e mëdha që bëhen në këtë kohë për rindërtimin e tërë sistemit fortifikues të qytetit simbas konditave dhe kërkesave të reja ekonomike, politike dhe ushtarake.[2])

ZBULIMI DHE GJENDJA E MONUMENTIT

Porta e Brendshme e Lisit, në krahasim me portat e tjera të këtij qyteti, u gjet shumë e dëmtuar dhe pothuajse në pjesën më të madhe e rrëzuar. Ruajtja e saj në gjendjen sikurse doli nga gërmimet arkeologjike ishte krejtësisht e pa mundur, për arsye se mbeturinat e mureve të saj ishin gjithnjë në rrezik të shembeshin fare gjatë punimeve të gërmimit. Për më tepër, kjo portë nuk mund të zbulohej tërësisht pa larguar blloqet e gurëve të rrëzuar, gjë kjo që do të vështirësonte së tepërmi restaurimin e saj. Për këtë arsye ne ishim të detyruar që krahas gërmimit të fi-

*) Në këtë artikull paraqiten punimet restauruese të kryera vetëm në Portën e Brendshme, kurse materiali arkeologjik dhe të dhënat lidhur me gërmimet arkeologjike do të trajtohen me hollësi në monografinë «Qyteti ilir i Lisit» që është duke u pregatitur nga F. Prendi dhe K. Zheku.
Rilevimet dhe vizatimet e dokumentacionit grafik janë bërë nën drejtimin e autorit nga F. Guralumi dhe A. Drazhi. Dokumentacioni fotografik është bërë nga autori dhe fotografet R. Veseli dhe H. Çollaku.

1) F. Prendi – K. Zheku, **Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike,** «Monumentet». 2, 1971, 7-21.

2) F. Prendi – K. Zheku, **po aty.**

llonim menjëherë edhe restaurimin e pjesëve të ambienteve të zbuluar.

Gjurmët e para të kësaj porte u diktuan që në verën e vitit 1969, gjatë punimeve që u kryen për nxjerrjen në dritë të trakteve të mureve rrethues të qytetit.

Nga Porta e Brendshme u gjetën mbi sipërfaqe të tokës një numër blloqe gurësh të gdhëndur, dy prej të cilëve me qoshe. Vëndi që zinin dy blloqet me qoshe dhe rreshtimi i blloqeve të tjerë të rrëzuar, tregonin qartë për një ndërprerje dhe një thyerje të drejtimit të murit të brëndshëm. Të gjitha këto gjurmë që në pamjen e parë na dhanë konturet kryesore të një porte, me përmasa të përafërta me portat kryesore të Lisit.

Në vazhdim të punimeve të vitit 1969 u zbuluan pjesërisht muret në të dy anët e koridorit, pragu i portës, muret perimetralë të kullës si dhe gjurmë të vazhdimit të trasesë së murit të brendshëm në drejtimin verior dhe atë jugor. Në anën e brendshme të këtij muri dolën në dritë edhe gjurmë të ambienteve ushtarake, që i bashkangjiten atij si në veri ashtu edhe në jugë.

Në përfundim të këtyre punimeve doli e qartë se mbeturinat e kësaj porte ishin të rrëzuara, për shkak të rënies dhe rrëshqitjes së terrenit. Nga sa mund të vërehet nga rrëzimi i mureve dhe çvendosja e blloqeve në muraturë del se rrëshqitja e tokës ka ndjekur pjerrësinë e terrenit në dy drejtime: në drejtimin jugor gjetëm pjesë muresh të çvendosur në mënyrë progresive deri në 2.00 m. larg vendit fillestar, kurse në drejtimin perëndimor çvendosja më e madhe arrinte deri 1.50 m.

Punimet paraprake në sektorin e Portës së Brendshme për vitin 1969 u lanë me kaq, me qëllim që ato të kryheshin krahas punimeve të ardhëshme restauruese.

Kjo fazë e punimeve u dokumentua nëpërmjet fotografimit dhe rilevimit të gjurmëve të zbuluara (fig. 2). Njëkohësisht u bë një studim i hollësishëm i gjendjes konstruktive dhe elementeve artitektonikë që u gjetën në gjithë kompleksin e Portës. Si rezultat i këtij studimi paraprak, ne patëm mundësinë të konkretizojmë masën e ndërhyrjes sonë në këtë monument, metodën e restaurimit dhe njëkohësisht të përcaktojmë pikënisjen e sigurtë për fillimin e punimeve restauruese.

Nga studimi i gjëndjes dhe shkaqeve të rrëzimit të mureve doli se në tre pika të ndryshme të këtij kompleksi, blloqet e gurëve dukeshin në pamjen e parë sikur nuk kishin lëvizur fare nga vendosja fillestare e tyre në muraturë. Duke paramenduar se këto tre pika do shërbenin si reperë të sigurtë për rivendosjen e gjithë sistemit konstruktiv të portës, u bënë sondazhe në secilën pikë, për të parë gjendjen e muraturës deri në themelin e saj.

Në pikën e parë dhe, konkretisht në qoshen ku bashkohet muri «A» me murin F, që ndodhet brënda koridorit të portës fig. 3 u diktua se kjo qoshe muri, në të vërtetë kishte rrëshqitur si bllok e tërë mbi gurin e themelit deri 45 cm., në drejtimin jugor dhe -25 cm në atë perëndimor (fig. 4-5). Këto përmasa u fiksuan mirë, me qenë se blloku i themelit, i cili u gjet i palëvizur nga vëndi, ishte i gdhendur me dhembezim në dy anët e dukëshme dhe vëndi që zinte blloku i parë i qoshes së murit ishte shumë mirë i përkufizuar nga këto dhëmbëzime. Të dhënat që nxorëm nga ky sondazh dhe, sidomos gjetja e bllokut të themelit të qoshes së murit të palëvizur nga vendi i tij fillestar, na dhanë mundësinë që të përcaktojmë pikën e parë si pikënisje për rivendosjen e blloqeve të gurëve që i përkisnin faqes «A» dhe faqes «F» të murit jugor.

Nga sondazhi që u bë në pikën e dytë, gjithashtu u diktua se qoshja e murit, që ndodhej në anën e kundërt të pikës së parë, kishte rrëshqitje vetëm në blloqet e gurëve të rreshtave të sipërme. Sikurse vërehet qartë në foto. 6, nga faqia «G» blloqet e rreshtit të parë u gjetën të çvendosur vetëm në drejtimin perëndimor, kurse nga faqja «L» zhvendosja kishte ndodhur vetëm në disa nga blloqet e tre rreshtave të sipërme, të cilët kishin shkarë në drejtimin jugor, pjesa tjetër e këtij muri u gjet në vendin fillestar.

Pika e tretë, që përfaqëson qoshen verilindore të kullës mbrojtëse, që ndodhet edhe kjo në koridorin e brendshëm të portës, doli se kishte lëvizje të mëdha në të dy drejtimet. Blloqet e gurëve të rreshtit të parë të faqes «L» dhe faqes «J» u gjetën të rrëshqitur së bashku me gurët e themelit në drejtimin jugor, ashtu edhe në atë perëndimor (fig. 7). Vëndi fillestar i kësaj qoshe mund të përcaktohej në mënyrë indirekte, duke fiksuar drejtimin gjatësor të murit «B» paralel me atë të faqes «A» dhe baraslargësinë ndërmjet tyre të njëllojtë me gjatësin e pragut të portës që ruhej tërësisht.

Të gjitha këto të dhëna që u përfituan nga zbulimi deri në themel i tri pikave të përshkruara më sipër, sigurisht që këto të dhëna s'janë të mjaftueshme për të filluar rivendosjen e blloqeve të gurëve të rrëzuar pa njohur mirë, sistemin konstruktiv, materialet dhe teknikën e përdorur për ndërtimin e këtij objekti.

MATERIALET DHE TEKNIKA E NDËRTIMIT

Muret e konstruksioneve të Portës së Brendshme, sikurse rezulton nga pjesët e tyre që ruhen deri në ditët tona, kanë qenë të ndërtuara me gurë gëlqerorë të nxjerrë nga formacione shkëmbore që gjënden në vënd. Në shumicën e blloqeve të rrëzuar dhe të atyre

DOKTORATURË

DO NOT COPY



Fig. 1.



PLANIMETRIA E PORTES BRENDESHME
GJENDJA PARA FILLIMIT TE PUNIMEVE RESTAURUESE

Fig. 2.



Fig. 3.

FAZAT E PUNIMEVE TE RESTAURIMIT



Fig. 4



Fig. 5

që u gjetën në muraturë, ruhen gjurmë të gropëzimeve në formë xhepi, të cilat na njohin me mënyrën e copëtimit të shkëmbinjve në blloqe me madhësi të ndryshme. Përmasat e mëdha të këtyre gjurmëve, që në disa raste arrijnë deri në 0,60 x 0.20 x 0.25 m. (gjatësi, gjerësi, thellësi), tregojnë qartë përdorimin e pykave prej druri për çarjen e tyre.

Gurët kanë vëllime të ndryshme dhe janë prerë në përgjithësi, me faqen e jashtme, në forma trapezoidale të çrregullt. Forma të përafërta drejtkëndore janë përdorur në qoshet dhe në muret e kullës.

Përpunimi i blloqeve të gurëve, të cilët kalonin në një sërë proçesesh teknike, mendojmë se është bërë në tri faza pune. Faza e parë, bëhej në gurore, ku gurët e copëtuar nga shkëmbinjtë pregatiteshin me vare dhe çekan në blloqe me forma të përafërta prizmatike. Faza e dytë, në afërsi të vendit të ndërtimit dhe, faza e tretë, para dhe mbas vendosjes së tyre në muraturë.

Ndarja e punës në këtë mënyrë është bërë për të arritur një shfrytëzim racional të fuqisë punëtore të specialiteteve të ndryshme dhe në shtimin e rendimentit të tyre. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar më shumë në këtë drejtim, mendojmë se kanë qenë këta: përpunimi komplet i blloqeve në gurore nuk mund të arrihej për arsye se ata mund të dëmtoheshin gjat transportit të tyre për në objekt. Në vëndin e ndërtimit blloqet mund të gdhendeshin vetëm në anën e dukëshme, në faqen anësore të krahut të djathtë dhe, në bazamentin e tyre. Kurse faqja e majtë e secilit bllok mund të gdhëndej vetëm mbasi të ishte bërë e njohur lartësia e bllokut të vendosur në muraturë përpara tij. Faqja e sipërme e çdo blloku gdhëndej në mënyrë përfundimtare vetëm mbas vendosjes në muraturë dhe pasi dihej gjatësia e bazamenteve të gurëve që do të mbështeteshin sipër tyre.

Në përpunimin e gurëve duket qartë se gurgdhëndësit kishin parasysh që sipërfaqen më të madhe të secilit bllok ta paracaktonin si faqe ballore dhe e punonin atë, afërsisht të rrafshët. Vihet re, gjithashtu, se bazamenti dhe pjesa e sipërme janë të gdhendura më imët dhe në gjithë sipërfaqen e tyre për të patur një mbështetje sa më të mirë në muraturë. Dy faqet anësore janë gdhendur për aq sa ishte e nevojshme për puthitjen e plotë të gurëve në fugaturat anësore.

Teknika e ndërtimit, siç do të shohim më poshtë, është e bazuar në koncepte konstruktivë, që lidhen direkt me terenin e thyer, materialin dhe stilin e ndërtimit.

Muret ngrihen mbi themele të vendosur mbi tokë të fortë, të ndërtuar me nga një rresht gurësh që kanë sipërfaqe mbështetëse të madhe dhe trashësi (20--30 cm), relativisht të vogël në krahasim me blloqet e muraturës. Gurët e themelit janë të vendosur bri njëri-tjetrit dhe kanë të gdhëndur vetëm pjesën e sipërme të tyre me sipërfaqe gjithëmonë horizontale. Në rastet kur terreni ka pjerrësi të theksuar themeli është ndërtuar me shkallëzime, që kanë zakonisht lartësinë e blloqeve të rreshtit të parë të muraturës. Gjatësia lineare e shkallëzimeve të themelit varet gjithënjë nga pjerrësia e terrenit. Dhëmbëzime apo disnivele shumë të vogëla (0.5-2 cm) vërehen edhe mbi sipërfaqet e punuara të gurëve të themelit. Këto dhëmbëzime tregojnë, se në rreshtin e parë të muraturës janë përdorur blloqe me lartësi të ndryshme.

DO NOT COPY

Gurët e themelit janë të gdhendur me një profil të dhëmbëzuar në gjithë gjatësinë ballore të tyre, me qëllim që të parandalohet rrëshqitja eventuale e murit (fig. 8a).

Themeli nuk ndërtohet në të gjithë gjerësin e murit, por vetëm në pjesën ku mbështeten faqet e murit, kurse bërthama e tij nuk ka fare themel. Duhet të theksojmë këtu, se pjerrësia e terrenit ka ndikuar që në disa raste faqja e jashtme e murit të ketë themel me nivel më të ulët kundrejt faqes së brendshme.

Në muraturë gurët janë vendosur për së gjati në të thatë pa ndonjë material lidhës dhe, në përgjithësi, mbizotëron vendosja e blloqeve në rreshta deridiku horizontale. Dhëmbëzimet e vogla (2-6 cm) në disa raste kanë ndikuar duke u dhënë fugaturave gjatësore drejtim të valëzuar. Muratura mbështetet 10-20 cm. më brënda faqes së jashtme të themelit. Faqet e murit (e jashtmja dhe e brendshmja) lidhen me bërthamën, nëpërmjet blloqeve të gjata të vendosur në drejtim të tërthortë me gjatësinë e murit. Kjo lidhje bëhet në çdo rresht dhe përsëritet mbas tre ose katër blloqeve. Blloqet lidhës dallohen qartë në faqet ballore të mureve nga sipërfaqja e tyre e vogël dhe nga brinjët anësore, të cilat janë zakonisht më të gjata nga brinjët horizontale. Muri i brendshëm, i cili ka funksion mbrojtës, ka një trashësi prej 1.80 m., kurse muret perimetralë dhe ato ndarës të ambienteve ushtarake janë 0.90 m. Lartësia e pjesëve të mureve që ruhen deri në ditët tona është e ndryshme dhe luhat nga 1.00 m. deri 3.50 m.

KONSTRUKSIONI I PORTËS DHE I AMBIENTEVE PËRBRI SAJ.

Porta e Brendshme, megjithëse ka elemente të përbashkët me portat kryesore të qytetit të Lisit, përsa i takon zgjidhjes planimetrike, në kompleks paraqet një variant më të zhvilluar (fig. 2). Porta është vendosur afërsisht në mesin e një koridori të gjatë dhe fill mbas tij gjëndet një ambient i gjërë, i cili shërben si parahyrje e qytetit të sipërm. Në hyrje porta ka një gjërësi prej 3.00 m, që përcaktohet mirë nga pragu i saj, i cili ruhet i plotë. Pragu është i shkallëzuar dhe në ekstremet e tij gjenden dy blloqe gurësh, mbi të cilët mbështetej kasa dhe trarët rrotulluese të kanatave të portës. Në mesin e pragut ruhet një gur i ngulur vertikalisht në tokë, që shërbente për fiksimin e dyerve, të cilat mbylleshin nga brënda me anën e një llozi të vendosur horizontalisht në gjysmë lartësinë e portës, siç dëshmohet nga një bllok i gropëzuar që u gjet në murin e koridorit, në anën e djathtë të hyrjes. Sistemi lëvizës i kanatave të portës bëhej nëpërmjet çernierave, pjesërisht sferike prej bronxi; pjesët e poshtme të kë-



Fig. 6



Fig. 7

DO NOT COPY

tyre çerniereve u gjetën të fiksuar me plumb në dy blloqet anësore të pragut[3]).

Hapësira e madhe e portës tregon se ajo mbulohej me një konstruksion prej druri.

Hyrja në qytetin e sipërm është e vendosur në drejtim të tërthortë me atë të vetë portës me qëllim që kalimi, nëpërmjet koridorit të brendshëm të jetë dyfish i kontrolluar në rast rreziku. Në krahun e majtë të hyrjes së portës ndodhet kulla mbrojtëse, e cila ka formë drejtkëndore me përmasa 9.60x6.40 m. Muret perimetralë të saj në gjendjen që ruhen janë ndërtuar me një faqe muri, gjë që tregon se kulla deri në një farë lartësie ka qenë e mbushur me dhe.

Në anën e djathtë të hyrjes së qytetit, në kthesën



Fig. 8

3) F. Prendi – K. Zheku, **po aty.**

e murit «F», dolën në dritë gjurmët e shkallëve, të cilat shërbenin për tu ngjitur në pjesën e sipërme të murit të brendshëm. Ngjitur shkallëve u gjetën muret perimetralë të dy ambienteve, që kishin formë drejtkëndore me përmasa 4.80 x 7.20 m. Secili ambient kishte një hyrje të vogël me gjërësi 1.10 m. Ambienti i dytë përshkohej në gjithë gjërësinë e tij nga një kanal i mbuluar me seksion katror, i cili duke përshkruar edhe gjërësinë e murit të rrethimit të brendshëm derdhte jashtë ujrat e shirave. Dy ambiente të tilla u gjetën edhe në krahun e majt të hyrjes së qytetit. Gjurmë të mureve që duken në sipërfaqe, tregojnë se ato vazhdojnë, si në drejtimin verior, ashtu edhe në atë jugor. Vendosja e këtyre ambienteve në radhë, ngjitur me murin e brendshëm të qytetit, me përmasa thuajse të përafërta dhe me nga një hyrje, tregojnë se ata ishin ambiente ushtarake dhe i shërbenin direkt mbrojtjes së qytetit të sipërm. Mbeturinat e mureve perimetralë, të ambienteve ushtarake, që u zbuluan në afërsi të portës së brendshme, ruhen në tre rradhë gurësh, përfshirë edhe gurët e themelit të tyre.

GJURMË TË NDËRTIMEVE TË MËVONËSHME

Gjatë gërmimeve që u kryen për nxjerrjen në dritë të konstruksioneve të portës dhe ambienteve ushtarake, u zbuluan edhe disa gjurmë ndërtimesh të tjera, të cilat sipas materialit dhe teknikës së ndërtimit, tregojnë për ripërdorimin e mbeturinave të materialeve dhe ambienteve të vetë portës në një kohë më të vonë.

Nga këto gjurmë me interes janë ato që përfaqsojnë trasenë e një muri mesjetar, ndërtuar pjesërisht mbi mbeturinat e konstruksionit të mbrendshëm dhe pjesërisht përmes ambienteve ushtarake. Trakti më i ruajtur i këtij muri u gjet në hapësirën e hyrjes së qytetit dhe ishte ndërtuar direkt mbi tokë, pa themel, me blloqe të mëdhenj të punuar dhe gurë të vegjël të lidhur me llaç gëlqereje (fig. 9). Vendosja në muraturën me llaç të blloqeve të mbëdhenj, të marrë nga muret e rrëzuar të portës, në mënyrë të çrregullt, duke filluar që në rreshtat e parë si edhe në lartësi të alternuar me gurë të vegjël, tregon për një ndërtim të kryer me ngutje. Në murin me llaç janë përdorur, si material mbushës edhe copa tullash e tjegullash, si edhe fragmente amforash.

Po të kemi parasysh trashesinë e murit me llaç (1.50 m.) dhe lidhjen e mbeturinave të trasesë së tij me gjurmët e kullës katrore, që u zbuluan mbi konstruksionet ushtarake të portës së vogël, që gjëndet rreth 75 m. në jugë të Portës së Brendshme, duhet të mendojmë se muri me llaç ka pasur për qëllim të rikrijojë në gjurmët e murit të brendshëm një rrethim për mbrojtjen e zonës kodrinore të qytetit në kohën e herëshme mesjetare.

Poiotcopy

PUNIMET E RESTAURIMIT.

Punimet restauruese që u kryen në këtë monument kishin për qëllim, rivendosjen e bllogeve të gurëve, elementeve konstruktivë dhe arkitektonikë, që u gjetën të rrëzuar ose të lëvizur nga vendi, si edhe konsolidimin e bazamentit, mbi të cilin do të mbështetej i gjithë konstruksioni i rindërtuar.

Këto punime vazhduan për katër vjet me radhë (1970-1973) në fushata 3-4 mujore. Fazat e restaurimit të Portës së Brendshme, të ndarë për secilin vit më vehte, janë paraqitur në një planimetri të veçantë (fig. 3).

Si pikënisje të punimeve restauruese u muarën për bazë pikat e sondazhit I, II dhe III. Sondazhi I u muar si bazë për të mbështetur restaurimin e murit të brendshëm, pjesën jugore (faqen e jashtme «A» faqen e brendëshme «B») dhe ambientet ushtarake të ndërtuar në anën e brendshme të tij; sondazhin II, për rindërtimin e pjesës veriore të murit të brëndshëm dhe ambientet ushtarake të anës veriore; Sondazhi III, për rindërtimin e kullës mbrojtëse të portës dhe pragut të saj.

Në vazhdim po japim përshkrimin e punimeve restauruese, duke dhënë shkurtimisht gjendjen para punimeve dhe rindërtimin e secilit objekt më vete.[4])

Muri Jugor Faqja e jashtme «A» dhe faqja e brendshme «E». Faqia e jashtme e këtij muri u gjet në një gjendje shumë të dëmtuar. Në pjesën më të madhe të gjatësisë, ishte inklinuar deri në 65°, në drejtimin perëndimor. Në largësinë 15 m. nga qoshja e këtij muri dhe, pikërisht tek kanali i derdhjes së ujrave, terreni kishte pësuar një ulje të madhe dhe gurët e themelit u gjetën 2.50 m. më thellë nga niveli i tyre fillestar.

Si detyrë kryesore përpara fillimit të rindërtimit të këtij muri ishte ndërtimi i një bazamenti të sigurtë, mbi të cilin do të mbështetej themeli. Ky bazament u ndërtue me shtresa butobetoni në të gjithë gjatësinë e murit, duke rikrijuar në këtë mënyrë profilin e terrenit të rrëshqitur, simbas pjerrësis dhe shkallëzimeve të themelit fillestar. Mbas krijimit të bazamentit dhe fiksimit të gurëve të themelit, u rindërtua së pari, muri i faqes



Fig. 9

4) Emërtimi i faqeve të mureve është bërë me gërmat e alfabetit që kanë marë ato në dokumentacionin grafik të tyre. (shih planimetrinë në fig. 3).

DO NOT COPY



Fig. 10

së jashtme, duke rivendosur në vendet e tyre me radhë të gjithë blloqet e gurëve, që u gjetë në muraturë ose të rrëzuar (fig. 10). Proçesi i ndërtimit të bazamentit me shtresë butobetoni, që përmendëm më sipër, është përdorur në të gjithë rastet ku dilte nevoja e zëvendësimit të terrenit të rrëshqitur, kurse rindërtimi i mureve, duke filluar që nga themeli, është bërë simbas teknikës origjinale pa përdorimin e materialeve lidhës, llaç gëlqere ose llaç balte.

Faqja «E», faqja e brendshme e këtij muri, u gjet gjithashtu e dëmtuar dhe e zhvendosur që nga themeli dhe, për rindërtimin e saj u veprue sikurse edhe për faqen e jashtme. Në përfundim të këtyre punimeve u arrit të rindërtohet muri jugor në gjithë gjatësinë prej 35 m. që ruhej, dhe në një lartësi që luhat nga 2.20 m. deri afro 3.20 m. e përbërë nga 3 deri në 5 rreshta gurësh.

KULLA MBROJTËSE

Kulla mbrojtëse e portës e vendosur në krahun e majtë të hyrjes së saj u gjet në një gjëndje mjaft të dëmtuar. Në qoshen jugperëndimore, mezi dallohesin gjurmët e saj. Rrëshqitja e terrenit në drejtimin perëndimor dhe atë jugor, kishte shkakëtuar rrëzimin e mureve dhe zhvendosjen e tyre, shumë larg vëndndërtimit fillestar. Muret perimetralë të kullës ruanin vetëm faqen e jashtme të tyre. Ne ata i kemi emërtuar: muri «B», muri lindor i kullës, i cili është njëkohësisht edhe muri i koridorit të portës; muri C-muri jugor, muri «N»-muri perëndimor dhe muri J-muri verior i kullës.

Muri «B», mbas zbulimit të tij deri në themel doli se në gjysmën e gjatësisë, nga qoshja veriore deri tek pragu i portës, u gjet i rrëzuar dhe i zhvendosur në drejtimin perëndimor, kurse pjesa tjetër e muraturës kishte rrëshqitur e tëra si bllok në drejtimin jugor, me një lëvizje të vogël të gjendjes vertikale dhe një rënie të theksuar, në afërsi të qoshes juglindore të kullës. Në pjesën më të madhe blloqet e gurëve të këtij muri nuk u gjetën në vendin e rrëzimit dhe, ka mundësi që ato mund të jenë përdorur për ndërtimin e murit mesjetar ose kanë rrëshqitur në fund të kodrës.

Në qoshen juglindore të kullës, muri B ruan lartësinë më të madhe rreth 2 m. me katër rreshta gurësh. Themeli i këtij muri për shkak të terrenit të pjerrët, është shkallëzuar në tre vënde nga një rradhë gurësh me disnivel që luhatet nga 0.55-0.60 m.

Punimet për rindërtimin e murit B., filluan në qoshen veriore, pika e sondazhit III, duke konsoliduar së pari,

DO NOT COPY

gurët e themelit mbi një shtresë betoni dhe, në vazhdim, duke rivendosur blloqet e gurëve të secilit rresht me radhë.

Muri «C» përfaqëson faqen ballore të kullës. Nga zbulimi i tij doli se qoshja lindore, megjithëse kishte rrëshqitur ruhej deridiku në këmbë, kurse pjesa tjetër e këtij muri u gjet e rrëzuar dhe e zhvendosur nga 0.50 deri 2.00 m. larg nga vëndi fillestar. Si pikënisje për rindërtimin e murit C u muar qoshja lindore, e cila e lidh këtë mur me murin «B», tanimë të restauruar. Nga rivendosja e blloqeve të rreshtit të parë, të cilët u gjetën të gjithë në vëndin e rrëzimit, u arrit të përcaktohej edhe gjatësia fillestare e murit «C», që doli 6.40 m, gjë që, na dha mundësin të kalonim në rindërtimin e murit perëndimor të kullës të emërtuar me gërmën «N».

Muri «N» u gjet i gjithë i rrëzuar përmbys dhe i rrëshqitur në gjithë gjatësinë e tij. Për rivendosjen e të gjithë blloqeve të murit të rrëzuar na u desht që, edhe në këtë rast, të ndërtojmë një bazament të ri, për stabilizimin e terrenit, i cili për shkak të pjerësisë së madhe ishte gjithënjë në rrezik shembjeje.

Në përfundim të punimeve në murin «N» (fig. 11), u arritën të rivendosen tre rreshta gurësh me një lartësi prej 2.60 m. Rreshti i parë u rivendos në gjithë gjatësinë e tij, qoshe më qoshe gjithësej 9.60 m; nga rreshti i dytë shtatë blloqe, duke filluar nga qoshja veriore dhe nga rreshti i tretë, vetëm pesë blloqe që zunë vend në mes të gjatësisë së murit. Shtojmë këtu, se në vëndin e rrëzimit, u gjetën edhe tre blloqe, të cilët nuk lidhen njeri me tjetrin, pra, ishte vështirë të caktohej edhe vëndi fillestar i tyre, megjithëkëtë ne ata, sikurse shifet në fig. 11 i ngritëm mbi mur, me qëllim që të evitonim rrukullisjen e tyre tatëpjetë kodrës.

Muri «J» është nga ana veriore e kullës dhe lidhet konstruktivisht me murin verior, që ngjitet përpjetë kodrës. Ky mur ishte i ndarë në dy pjesë: pjesa e sipërme në qoshen veriore lidhet me murin «B» dhe, nga ana tjetër, lidhej me faqen e brëndshme «D» të murit verior. Pjesa e poshtme e murit «J» që për arsye të terrenit të pjerrët ishte ndërtuar me një disnivel rreth 3.00 m. nga pjesa e sipërme e tij, u gjet shumë e zhvendosur në drejtimin perëndimor. Kjo pjesë e këtij muri, në qoshen perëndimore, lidhet me murin «N» dhe, në anën tjetër me faqen e jashtme të murit verior «R».

Rindërtimi i murit «J» u arrit duke filluar paralelisht nga të dy qoshet e restauruara të murit «B» dhe murit «N», me të cilat, siç thamë, muri «J» lidhej konstruktivisht. Në qoshen veriore u rivendosën tre blloqet e gurëve të rreshtit të parë dhe nga një bllok për rreshtin e II dhe të III, që u gjetën në vënd. Kurse në qoshen perëndimore, mbas ndërtimit të bazamentit, u rivendosën gurët me qoshe të rreshtit të parë dhe të dytë, tre të të tretit, dy të katërtit dhe një të rreshtit të pestë.

Pragu i portës, u gjet i rrëshqitur në drejtimin jugor dhe i përkulur për arsye të uljes së terrenit në afërsi të takimit të tij me murin «A» (fig. 12). Rivendosja e të gjithë gureve që i takonin pragut dhe shkallës që kishte përpara, u bë mbi një shtresë betoni për plotësimin e terrenit të rrëshqitur. Ruajtja e pragut në gjithë gjatësinë e tij fillestare, gjithsej 3.00 m, na dha mundësinë e përcaktimit të gjërësisë së koridorit të portës dhe respektivisht të vendosjes së kullës mbrojtëse të saj dhe murit jugor.



Fig. 11



Fig. 12

DO NOT COPY



Fig. 13

Në përfundim të punimeve restauruese që përshkruam më sipër u arritën të rindërtohen, deri në masën që na lejoi materiali që u gjet në vënd, muri jugor, kulla mbrojtëse e portës, pragu i portës së saj dhe u krijua mundësia e vazhdimit të punimeve për rindërtimin e murit verior, ambienteve ushtarake në anën veriore dhe ato jugore, të cilat lidhen konstruktivisht me objektet e restauruara.

Muri verior. Faqja e jashtme «R» dhe faqja e brendshme «D» (fig. 13). Ky mur që i ngjitet përpjetë kodrës, në anën veriore të portës, u zbulue deri në themel në një gjatësi rreth 25 m. dhe u gjet i rrëzuar i tëri dhe, vende-vende thuajse përmbys mbi faqen e jashtme të tij. Për arsye të rrëshqitjes së terrenit ky mur kishte pësuar ulje dhe zhvendosje, duke filluar që nga themeli i tij, i cili doli i spostuar nga vendi fillestar në drejtimin gjatësor e tërthor, nga 0.60 m deri 1.20 m. Gjëndja në të cilën u gjet ky mur na detyroi që rindërtimin e tij ta filojmë nga faqja e brendshme «D», e cila ishte dy deri tre radhë gurësh, të shkallëzuar simbas terrenit në gjithë gjatësinë lineare të zbuluar nga ky mur. Mbas mbarimit të rindërtimit të faqes së brendshme u rindërtua edhe faqja e jashtme «R».

AMBIENTET USHTARAKE VERIORE

Restaurimi i ambienteve ushtarake në anën veriore të portës, të cilat nuk lidhen konstruktivisht me murin verior, por i mbështeten atij, filloi me rindërtimin e murit «G», i cili është muri i faqes ballore të ambienteve dhe, konkretisht në pikën e sondazhit II (shih planimetrinë, fig. 3). Ky mur u gjet në krahun perëndimor pjesërisht i rrëshqitur dhe i pjerrur në gjithë gjatësinë ballore të tij. Në pjesën më të madhe blloqet e rreshtit të parë u gjetën thuajse të palëvizur nga vendi. Ky fakt na dha mundësinë që t'a mbështesim rindërtimin e tij në një bazament të shkurtër. Nga rreshti i dytë i murit «G» ruheshin, gjithashtu, të gjithë blloqet e gurëve, kurse nga i treti, katër blloqe dhe nga i katërti vetëm dy blloqe, Të gjithë rreshtat që u gjetën jo të plotë zënë fill nga qoshja veriore e këtij muri dhe, blloqet e gurëve që u mungonin atyre, ne menduam se ishin të murosur në murin me llaç gelqereje, që siç kemi thënë, zinte të gjithë hapësirën e hyrjes së qytetit.

Duke patur parasysh faktin se blloqet e gurëve të punuar, që ndodheshin të murosur në murin mesjetar ishin të shumtë, gjithsejt 18 copë; ne vendosëm ta prishnim atë dhe blloqeve të gurëve tu gjenim vëndin që zinin në konstruksionet prej guri të Portës së Brëndshme. Nga blloqet që nxorëm nga muri mesjetar, 16 prej tyre i përkisnin pikërisht murit «G», i cili me rivendosjen e këtyre blloqeve në vendin e tyre u arrit të rindërtohet, pothuajse tërësisht, duke arritur në qoshen veriore lartësinë origjinale të tij rreth 3.50 m. (fig. 14).

Krahas rindërtimit të murit «G» u bë njëkohësisht edhe rindërtimi i murit «L», i cili është muri ballor i ambienteve ushtarake veriore dhe lidhet konstruktivisht me murin «G», në një qoshe të përbashkët.

Ambientet ushtarake jugore. Për restaurimin e këtyre ambienteve, të cilët u zbuluan në anën e brendshme të murit jugor në një gjendje jo shumë të dëmtuar, na u desh që, së pari, të rindërtonim faqen e murit «F» dhe vëndin e shkallëve, që ndodhej në anën e brendshme të këtij muri. Në këtë mënyrë u arrit të bëhej lidhja dhe të përcaktohej drejtimi i murit ballor të ambienteve jugorë, si edhe të mureve ndarës të tyre (fig. 15). Nga këto ambiente u restauruan tërësisht dy prej tyre, si edhe kanali shkarkues i ujrave të shirave, i cili kalonte nën dyshemenë e ambientit të dytë.

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15

RIKONSTRUKSIONI ARKITEKTONIK

Mbas përfundimit të punimeve restauruese, në Portën e Brendshme doli i qartë konfiguracioni planimetrik i saj dhe i gjithë ambienteve të tjera, kurse pamja konstruktive dhe arkitektonike origjinale është e vështirë të konceptohet në të gjithë unitetin figurativ të kompleksit ku bën pjesë kjo portë. Jemi të mendimit se një rikostruksion arkitektonik, i bazuar në të dhënat që kemi vjelur gjat punës restauruese do të ishte me interes për njohjen sa më të plotë të këtij monumenti.

Me rivendosjen e të gjithë materialeve që u gjetën në vënd u arrit një ngritje vertikale, e cila në pjesën më të madhe, tregon se muratura prej guri nuk vazhdonte më në lartësi. Në këtë përfundim ne arritëm nga vetë fakti, se muri jugor, për arsye të pjerrësisë së terrenit përfundon me një shkallëzim, i cili përkon respektivisht me shkallëzimin e mureve perimetrale të ambienteve ushtarake jugore, që ndodhen në anën e brëndshme të tij. (fig. 15). Për më tepër, të gjithë bllogët e rreshtave të fundit nuk janë të gdhëndur me sipërfaqe të rrafshët në pjesën e sipërme të tyre, gjë që tregon qartë se përsipër këtyre blloqeve nuk mund të vendoseshin gurë të tjerë pa një mbështetje të parapregatitur.

Rrjedhimisht duhet të pranojmë, se muret e ruajtura deri në ditët tona në kompleksin e Portës së Brendshme, përfaqësojnë vetëm zokolaturën e mureve, mbi të cilët ngrihej muratura prej tulle.

Muratura prej guri është gjithashtu e shkallëzuar në lartësi, simbas pjerrësis së terrenit. Shkallëzimet e zokolaturës kanë lartësin e një rreshti gurësh dhe përkojnë, afërsisht, me shkallëzimet e themelit të murit.

Elemente të tjerë që na ndihmojnë të pranojmë përdorimin e teknikës së përzier, pjesërisht mur guri dhe pjesërisht mur tulle, janë edhe fragmentet e shumta



Fig. 16

DO NOT COPY

INST. MON. KULTURES
BIBLIOTEKA
Nr. INV. 8663



DO NOT COPY

Fig. 17

të tullave, që u gjetën gjat punimeve restauruese, si edhe të gjurmëve të mureve prej tulle, që janë gjetur in situ në ambientet ushtarake, tek Porta e Burimit dhe në pjesën jugore të murit të brendshëm (fig. 16). Fragmentet e mureve të zbuluara ruhen në tre-katër rreshta tullash mbi zokolaturën prej guri. Tullat e përdorura në këto raste kanë forma katrore me përmasa 0.48x x 0.48 x 0.08; 0.444 x 0.444 x 0.08 m dhe drejtkëndëshe me përmasa 0.48 x 0.24 x 0.08; 0.444 x 0.22 x 0.08 m. Shtojmë këtu se edhe në fragmentet e tullave të gjetura në Portën e Brendshme kemi të njëjtat përmasa (fig. 8 c). Muri me tulla kishte një trashësi prej 1.75 dhe, mbi zokolaturën prej guri, fillonte me kornizë të hollë të ndërtuar në anën e jashtme me një radhë tullash të profiluara nga njera anë. Fragmente të këtyre tullave u gjetën në vend gjat zbulimit të Portës së Brendshme. Korniza prej tulle kishte për qëllim që të bënte një shkëputje të dallueshme të muraturës prej tulle nga ajo prej guri dhe, të krijonte një mbështetje të sigurtë për murin me tulla, që ngrihej në lartësi (fig. 8 a-b).

Tullat janë të punuara me argjil të brumosura dhe të pjekura shumë mirë. Kanë një ngjyrë që anon nga e kuqja. Në muraturën tullat janë të vendosura mbi shtresa të holla llaçi prej balte dhe me rreshta horizontale në të gjithë gjërësinë e murit.

Përdorimi i llaçit prej balte, si material lidhës, ka bërë që pjesët e mureve prej tullash të prishen me lehtësi, atëhere kur sistemi i fortifikimit nuk i shërbente më mbrojtjes së qytetit. Këto tulla u ripërdorën me leverdi të madhe në ndërtimet e mëvonëshme, sikurse e vërtetojnë fragmentet e mureve të zbuluara kohët e fundit, në afërsi dhe brenda ambienteve ushtarake.

Në ndërtimin e murit të brendshëm të qytetit të Lisit, si edhe të ambienteve të ndërtuara në shpinë të tij, vërejmë një trashëgimi të traditave vëndase, të ndërtimit, që pasqyrohen si në materialet, ashtu edhe në teknikën e përpunimit dhe vendosjes së tyre në muraturë. Në zokolaturën prej guri ne gjejmë koncepte konstruktive dhe arkitektonike të njëllojta me ato të mureve rrethues të qytetit të Lisit. Dallohen gjithashtu edhe elementet, që tregojnë për një zhvillim të mëtejshëm të teknikës së ndërtimit, siç është përpunimi i blloqeve me sipërfaqe të rrafshët në faqen ballore të tyre.

Përdorimi i murit me tulla të pjekura të lidhura me llaç balte të ngritur mbi një zokolaturë prej guri, është gjithashtu një teknikë e njohur në vendin tonë që në kohën e lashtë. Ndërtime të tilla, janë zbuluar në muret e rrethimit të qytetit të Apollonisë, të cilët mendohet se i takojnë shek. IV-III p. e. sonë.[5])



Fig. 18

5) C. Praschniker, **Muzakhia und Malakastra, archäologische Forsshungen in Mittelalbanien,** Wien 1920, 32.
H. Ceka, **Muri rrethues i Apollonisë,** B.SH.SH. 3, 1963, 117.

BOTIMET



DO NOT COPY

Fig. 19

Përsa i takon lartësisë origjinale që kishin muret në të gjithë këtë kompleks arkitektonik nuk kemi as edhe një të dhënë konkrete. Megjithëkëtë një lartësi të përafërt mund të arrijmë t'a përcaktojmë, nëpërmjet gjurmëve të shkallës, që i kemi gjetur, përbrenda portës, në të djathtë të hyrjes për në qytet. Nga kjo shkallë ruhen vetëm dy këmbë shkallët e para, të cilat janë prej guri dhe bëjnë pjesë gjithashtu në zokolaturën e murit prej guri. Kjo gjë na lejon të mendojmë edhe në këtë rast, se pjesa tjetër e shkallës ka qenë ndërtuar me tulla ose edhe prej druri. Vendi ku gjendet kjo shkallë e përcaktuar mirë, si dhe drejtimi i saj, tregojnë qartë se ajo shërbente për tu ngjitur në trapin e luftimit të murit rrethues. Nga kjo shkallë kemi të njohur, gjatësinë e vendit të rampës së saj 6 m., gjërësinë 2 m dhe gjerësinë e lartësinë e dy këmbëshkallëve të para (0.40 m dhe 0.23 m). Nëpërmjet këtyre të dhënave dhe, konkretisht, duke marrë gjërësinë dhe lartësinë (0.40 m dhe 0.23 m) e dy këmbëshkallëve që u gjetën të plota nxorëm së pari, se në gjatësinë e vendit të shkallëve mund të ndërtoheshin gjithësejt 15 këmbëshkallë (6.00 m: 0.40 m = 15) dhe, duke shumëzuar numurin e shkallëve me lartësin e njohur të tyre, që është 0.23 m., arrijmë në lartësinë prej 3.45 m. Kjo lartësi do të ishte kuota e dyshemesë së trapit të luftimit të murit të brendshëm. Mbi këtë kuotë ne vendosëm edhe 2.00 m, lartësinë e nevojshme për mbrojtjen e luftëtarëve dhe në të cakëtuam lartësinë e bedenave të murit.

Të vendosura këto lartësi mbi zokolaturën prej guri të restauruar, del se muri nga ana e jashtme duhet të

kishte një lartësi të përgjithshme rreth 8.50 – 9.00 m, që luhat simbas pjerrësisë së terrenit.

Mbi këto të dhëna ne e kemi mbështetur edhe rikonstruksionin grafik që paraqesim në këtë punim (fig. 17-18).

* * *

Ndërhyrja e jonë në këtë monument, ishte e domosdoshme dhe, nëpërmjet punimeve të restaurimit që u kryen në të, ne mendojmë se kemi arritur të shpëtojmë dhe të vemë në kondita normale gjithëçka kemi si trashëgim nga e kaluara e këtij monumenti.

Me ringritjen në këmbë të gjithë konstruksioneve që i përkisnin kompleksit arkitektonik të Portës së Brendshme, të mbështetur në një bazament të ri dhe të sigurtë për kohën e ardhëshme, mendojmë se kemi arritur në stabilitetin konstruktiv dhe arkitektonik të këtij monumenti në masën sa na lejoi materiali i ruajtur (fig. 19).

Gjat punimeve të restaurimit ne kemi patur parasysh që të ruajmë të pa cënuara dhe të qarta të gjitha gjurmët që koha mijëvjeçare ka lënë në pjesë të ndryshme të këtij monumenti. Në këtë mënyrë, mendojmë se kemi arritur ti japim monumentit të restauruar pamjen e tij origjinale, që ka pasur në një kohë të caktuar, mbas prishjes së murit me tulla dhe para dëmtimit nga rrëshqitja e terrenit.

Në përfundim të punimeve restauruese i gjithë kompleksi i Portës së Brendshme paraqitet në një gjendje mjaft të përceptueshme për vizitorët dhe me interes për studjuesit (fig. 19).

DO NOT COPY

Koço ZHEKU

RESTAURATION DE LA PORTE INTERIEURE DE LA CITE ILLYRIENNE DE LIS

RESUME

La Porte intérieure se rattache comme construction au mur intérieur, donc elle est plus récente que les autres portes de la cité. Sa période de construction se rattache également à celle du mur intérieur, qui a été mis en place vers la moitié du Ier siècle av.n.è.

La Porte intérieure de Lis a été trouvée dans un état très détérioré, la plupart de ses éléments étant en ruine.

De l'écroulement des murs et du déplacement des blocs de la muraille, il ressort que le glissement du terrain a suivi le pendage de celui-ci en deux directions. En direction sud ont été repérées des restes de mur à une distance de 2 m. de leur emplacement initial, tandis qu'en direction ouest le déplacement maximal atteint 1.50 m.

L'analyse de l'état actuel des murs et des motifs qui ont provoqué leur écroulement ont montré, qu'en trois points différentes de ce complexe, les blocs de pierre semblent à première vue n'avoir subi aucun déplacement.

Au premier point (Fig. 3), il a été relevé que l'angle du mur avait vraiment glissé en masse sur le bloc en pierre de la fondation. Les données obtenues par ce sondage, et particulièrement le fait que le bloc de la fondation sur lequel reposait l'angle du mur ne s'était aucunement déplacé de sa position première, nous ont permis de préciser un premier point de départ pour remettre en place les blocs de pierre appartenant à la face «A» et à la face «F» du mur méridional.

Le sondage effectué au deuxième point a montré également que l'angle du mur, situé de front au premier point, ne s'était pas en général déplacé et que seulement les blocs de pierre de ses premières rangées avaient glissé.

Le sondage effectué au troisième point, soit l'angle Ne de la tour d'angle, a montré des déplacements prononcés dans les deux directions. Les blocs de pierre de la première rangée des faces «B» et « » avaient glissé, conjointement avec les pierres de la fondation, aussi bien en direction S que O.

Les murs de la Porte intérieure sont construits avec des pierres calcaires extraites des formations locales. La plupart des blocs de pierre écroulés et ceux en place dans le mur conservant des traces de cavité en forme de poche, ce qui nous a permis de déterminer le mode dont ont été taillés les blocs de dimensions diverses.

En ce qui concerne les pierres elles sont de forme trapézoidale irrégulière. Les pierres utilisées dans les angles et les murs de la tour ont une forme proche des précédentes et sont à angle droit.

Les murs reposent sur des fondations creusées dans un terrain solide et comportent une rangée de pierres ayant une surface d'appui grande et une épaisseur relativement petite (20-30 cm) en regard aux blocs de la maçonnerie.

Les pierres des fondations sont taillées à dents dans toute leur partie frontale, de manière à éviter l'éventuel glissement du mur (Fig. 8a).

DO NOT COPY

DO NOT COPY

En ce qui concerne la maçonnerie, les pierres sont rangées en longuer à sec sans aucun liant et l'on relève, en général, une disposition des blocs en rangs presque horizontaux. Les parements du mur sont liés à son noyau par des blocs longs disposés transversalement à la longueur du mur. Cette liaison caractérise chaque rangée de blocs et se répète après trois ou quatre blocs.

La porte intérieure comporte des éléments communs avec les autres portes principales de la ville de Lis quant à sa composition planimétrique, malgré cela elle présente dans son ensemble une variante plus évoluée (Fig. 2). Elle est aménagée presque au milieu d'un couloir long, qui est suivi par une pièce large servant d'accès à la ville haute. L'entrée de cette porte est large de 3 m., mesure que l'on peut facilement préciser grâce à la présence du seuil qui est entièrement conservé. Le seuil est à degrés et comporte à ses extrémités deux blocs de pierres, sur lesquels s'appuyaient la baie et les poutres mobiles des battants de la porte. Au milieu du seuil se trouve une pierre enfoncée verticalement au sol de manière à fixer les battants, que l'on fermait de l'intérieur au moyen d'un loquet disposé horizontalement à la mi-hauteur de la porte. Le mouvement des battants était assuré par un système de charnières, en partie sphériques et de bronze, dont les parties inférieures étaient fixées avec du plomb aux deux blocs latéraux du seuil.

L'entrée à la ville haute est aménagée transversalement à l'entrée de la porte même, de façon à ce que le passage à travers le couloir intérieur soit soumis à un double contrôle en cas de danger. Le côté gauche de l'entrée de cette porte est flanqué d'une tour rectangulaire dont les dimensions sont 9.60 x 6.40 m.

Sur le côté droit de l'entrée à la ville, au tournant du mur «P», ont été mis au jour les vestiges de escaliers menant à la partie supérieure du mur intérieur. A côté de ces escaliers ont été trouvés des murs contournant deux pièce rectangulaires de dimensions 4.80 x 7.20 m., dont chacune était pourvue d'une petite entrée large de 1.10 m. La disposition en file de ces pièces de monière contigue au mur intérieur de la ville, ainsi que le fait qu'elles ont des dimensions presque égales et sont pourvues chacune d'une entrée particulière, montre que nous avons affaire à des logements de caractère militaire destinés exclusivement à la défense de la ville haute.

Le but des travaux de restauration effectués étaient celui de remettre en place les blocs de pierre, les éléments de construction et architectoniques écroulés ou déplacés, ainsi que de consolider le basement sur lequel allait reposer le monument reconstruit.

Les sondages I, II et III ont été pris comme point de départ de ces travaux de restauration. Le mur intérieur, sa partie méridionale (sa face extérieure A et sa face intérieure B) et les pièces à caractère militaire ont été restaurés à partir des résultats du sondage I, En ce qui concerne la restauration de la partie septentrionale du mur intérieur et des pièces à caractère militaire situés dans la partie nord, nous nous sommes fondés sur les résultats du sondage II. Le sondage III nous a servi comme point de départ pour la restauration de la tour, qui défendait la porte, de son seuil.

A l'issue des travaux de restauration, la configuration planimétrique de la Porte intérieure et des pièces à destination militaire est apparue clairement alors qu'il est difficile de concevoir l'unité figurative de cette porte dans sa complexité du point de vue de sa construction et de son architecture originale.

La maçonnerie en pierres est également construite par degrés en hauteur, conformément à l'inclination du terrain; les degrés du socle ont une hauteur équivalente à celle d'une rangée de pierres et correspondant approximativement à celle des degrés des fondations du mur.

D'autres éléments qui s'expriment en faveur d'une technique de construction mixte comprenant des murs de pierres et des murs de briques, sont les nombraux fragments de briques mis au jour pendant les travaux de restauration ainsi que les vestiges des murs en briques trouvés in situ dans les pièces à destination militaire, dans le complexe de la Porte de la Source et dans la partie méridionale du mur intérieur (Fig. 16).

La construction du mur intérieur de la ville de Lis et des autres pièces édifiées derrière

elle dénote, quant à leur technique, un renouement aux traditions locales comme le témoignent les matériaux ainsi que la technique de leur élaboration et de leur disposition dans la maçonnerie. Le soubassement en pierres se caractérise par des concepts architectoniques de construction analogues à ceux des murs d'enceinte de la ville de Lis.

Nous ne dispozons d'aucunes données concrètes quant à la hauteur originale des murs de ce complexe architectonique. Malgré cela nous pouvons fixer une hauteur approximative à partir des vestiges de l'escalier mis au jour, à l'intérieur de la porte. Nous connaissons de cet escalier la longueur et la largeur de sa rampe, qui sont respectivement de 6 m. et de 2 m., ainsi que la largeur et la hauteur de ses deux premiers gradins (0.40 m. et 0.23 m.).

Partant de ces données, soit de la largeur et de la hauteur des deux gradins (0.40 m. et 0.23 m.) qui ont été trouvés intacts, il nous a été possible de constater que la longueur de l'escalier ne pouvait contenir que 15 marches en tout (6.00 m: 0.40 m = 15) et, qu'en multipliant leur nombre par leur hauteur connue (0.23 m.), nous avons obtenu une hauteur de 3.45 m. Cette hauteur doit avoir été la côte du plancher de la bretèche du mur intérieur, Puis nous avons ajouté à cette cote encore 2 m. de hauteur pour la protection des combattants, ce qui nous a permis de préciser la hauteur des bastions du mur.

Si l'on ajoute au socle en pierres restauré ces hauteurs, il ressort que du dehors le mur doit avoir eu une hauteur totale variant de 8.50 m. à 9.00 m. suivant l'inclination du terrain.

* * *

La mise au jour de ce monument dans un état très endommagé a rendu nécessaire notre intervention et les travaux de restauration effectués à cette fin ont permis, à notre avis, de sauvegarder cet héritage si important du passé et de lui créer des conditions normales d'existence.

Pendant les travaux de restauration un soin particulier a été consacré à ce que les diverses parties de ce monument millénaire ne soient pas affectées et ressortent plus en évidence. Nous pensons avoir donné au monument sa physionomie originale, à une époque établie, à la suite de la destruction du mur en briques et avant son endommagement provoqué par le glissement du terrain.

A l'issue des travaux de restauration, l'ensemble de la Porte intérieure revêt maintenant un aspect facilement perceptible par le visiteur et suscite l'intérêt des hommes d'étude (Fig. 19)

DO NOT COPY

Apollon BAÇE

DO NOT COPY

QYTETI I FORTIFIKUAR I KANINËS

Në mesin e gjirit të Vlorës, male të lartë i afrohen së tepërmi bregut duke e ndarë atë në dy pjesë. Në këtë zonë, paksa e tërhequr në thellësi, ngrihet një kodër 379 m. e lartë, në të cilën gjenden rrënojat e një qyteti të vjetër, atij të Kaninës. Po këtu lugina e Lumit të Vlorës shtyhet deri në rrëzë të kodrës (fig. 1). duke e lehtësuar tepër lidhjen e zonës bregdetare me hinterlandin. Faktor me rëndësi ky, pasi më në jug malet fitojnë lartësi të madhe, ndërsa më në veri largësia midis bregdetit me luginën e Lumit të Vlorës rritet mjaft shpejt. Këto janë dhe kushtet që përcaktojnë rëndësinë strategjike të Kaninës, si ndaj kalimit nga pjesa jugore në atë veriore (dhe në të kundërt), po ashtu dhe ndaj lidhjes së trevës së Lumit të Vlorës me Gjirin e Vlorës.

Kodra (fig. 2) prej formacioni flyshor përshkohet në mjaft pika prej shisteve të fuqishëm të bërthamës prej shkëmbinjsh konglomeratë dhe ranorë. Në jug dhe veri, me përjashtim të dy qafave nga ana perëndimore që e lidhin me vargun, kodra ngrihet me mjaft pjerrësi, në lindje bie relativisht butë në luginën e Kallafatit, ndërsa në drejtim të perëndimit pjerrësija e saj është mjaft e theksuar. Nga maja e saj, shikimit i hapet një horizont i gjërë. Në drejtim të perëndimit dhe veriut shihet Karaburuni, Sazani, Treporti dhe Myzeqeja, nga lindja rrjedhja e sipërme e Lumit të Vlorës dhe vetëm jugu mbetet i mbyllur nga vazhdimi i vargut të Shushicës. Nga ana tjetër kodrat përreth saj krijojnë kushte të mira për zhvillimin e blegtorisë, ndërsa në lindje gjenden troje mjaft të gjëra dhe të përshtatshme për bujqësi, Krahas pozitës ekonomike dhe strategjike vendi i plotëson dhe kërkesat e tjera të nevojshme për ngritjen e një qendre të fortifikuar: mundësinë e komunikimit, praninë e ujit të pijshëm, nxjerrjen e gurit për ndërtim, si dhe një mbrojtje të mjaftueshme natyrale. Megjithëkëtë, më afër detit dhe në një lartësi më optimale, gjenden kodra të tjera, të cilat i plotësojnë tërë kushtet e mësipërme, janë më të mbrojtura dhe rruga për në to është më e përshtatshme. Kodra të tilla gjenden me shumicë dhe në luginën e Lumit të Vlorës, por prej tyre nuk plotësohet lidhja ndërmjet bregut të detit dhe luginës së Lumit të Vlorës, e cila siç e pamë mund të arrihej vetëm në Kaninë.

Kushtet e mësipërme ndikuan që në këtë vend, qysh në periudhën antike, të lindë një qendër e fortifikuar, jeta e së cilës zgjat thuajse pa ndërprerje deri në shekullin e kaluar. Natyrisht, roli i kësaj qendre nuk ka qënë kurdoherë i njëjtë, kështu ajo ka pasur rol të dorës së parë ose ka qënë në vartësi të qendrave të tjera në funksion të kushteve ekonomiko-shoqërore të periudhave përkatëse.

Artikulli në fjalë synon që të japë pikërisht një vështrim mbi arkitekturën e kësaj qendre, si funksion të këtyre kushteve. Ai bazohet mbi studimin për projektin e restaurimit dhe në rezultatet e punimeve restauruese të ndërmarra nga Instituti i Monumenteve të Kulturës në vitet 1972-1974. Në fillim do të synojmë të japim përshkrimin e fortifikimit, duke e ndarë atë në faza, dhe të punimeve restauruese, ndërsa më tej, datimin e këtyre fazave në përputhje me rolin e Kaninës në kohë.

*) Fotografitë janë të autorit, rilevimi i Kaninës i P. Maracit.



Fig. 1

PERIUDHA ANTIKE

Faza e I. Gjurmët antike[1]) i hasim në formë traktesh «in situ» në pikat C, 2, G-D, K, 6, 12 dhe blloqesh të ripërdorur në kurtinat D-E, 1-G, G-4, 7-8, M-N, N-14, (tab. I, fig. 3)*). Siç shihet nga planimetria këto gjurmë mbyllin tërë konturin e rrethimit dhe, tregojnë qartë, se muri mesjetar ka ndjekur me besnikëri konturin e rrethimit antik.

Muret e tij përsërisin vijat rrushkulluese të pjesës së sipërme të kodrës, duke fituar në plan trajtën e një ylli trecepësh dhe një sipërfaqe prej 3,6 hektarësh (tab. I). Në brendi të mureve terreni jo i rrafshët lartësohet në drejtim të jugut dhe perëndimit (tab. I), ku në mesjetë gjendej kështjella (citadela). Por, ndonse në murin që e ndan këtë prej pjesës tjetër të qytetit shihet një numër i madh blloqesh antike të ripërdorur, prania e akropolit është pak e mundshme.[2])

Muri 2,10 m i gjerë, përbëhet prej paretit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Nga fragmenti i ruajtur në pikën 8 (fig. 3) kuptojmë se pareti i jashtëm mbështetej mbi një themel me thellësi rreth 1 m. të gërmuar në truallin shtufor dhe të mbushur me gurë të mëdhenj të papunuar (fig. 5, 6). Por në pjesën e sipërme, gurët janë punuar për krijimin e një platforme të sheshtë, mbi të cilën ngrihet muri me blloqe të gdhendur. Pareti i brëndshëm ngrihet, gjithashtu, mbi një themel të gërmuar në tabanin shtufor (fig. 7). Pjesa e blloqeve që gjenden mbi themel, mbi sipërfaqen e tabanit ka faqe të gdhendura, ndërsa ajo nën të,

1) M.W. Leake, **Travels in Northern Greece,** London, 1835, I, 2, ve në dukje praninë e një fortifikimi antik në Kaninë. Pak më vonë I.G. Hahn. **Albanesische Studien,** Wien 1853, 72, arrin të gjejë blloqe të ripërdorur por jo trakte «in situ». Po kështu dhe R.L. Beaumont, **Corinth, Ambracia, Apollonia,** «Journal of Hellenic Studies» 1952, 66 sheh vetëm blloqe të ripërdorur. Ekzistenca e mureve «in situ» vihet në dukje vetëm nga H. Ceka, **Probleme të numizmatikës Ilire,** Tiranë 1965, 92.

*) Për lehtësi orientimi, në planimetri kullat i kemi shënuar me shifra, kurse kthesat e murit me gërma; kurtinat shënohen me shenjat e dy pikave kufizuese, qofshin këto kulla ose kthesa muri.

2) Në një kanal 2 m. të gjërë, tërthor me murin e kështjellës, që arrin në shtresat sterile nuk shihen gjurmë muri antik.

DO NOT COPY

është lënë e papunuar. Blloqet e murit kanë formë drejtkëndëshe, që rrallëherë shmanget lehtë ndaj trapezit të rregullt, me gjërësi 30-50 cm., gjatësi 40-120 cm. dhe lartësi 35-60 cm. Faqja e tyre e jashtme është gdhendur rrafshët, në mënyrë të ashpër me daltë me majë, e cila ka lënë gjurmët e saj, ndërsa anët janë skuadruar me kujdes. Për evitimin e thyerjes së buzëve të tyre, ato janë gdhendur me daltë të imët me pjerrësi 45º për 2-4 cm. gjerësi (fig. 7 tab. II, 1). Gdhendja e kujdesshme e faqeve të bashkimit siguron një përputhje të përsosur dhe fuga mjaft të mira. Gdhendja nuk është kryer në tërë gjërësinë e bllokut, por vetëm 10-15 cm. në thellësi nga faqja ballore, aq sa të sigurohet bashkimi me bllokun fqinjë (fig. 8). Kjo dukuri, si dhe punimi pjesor i blloqeve të bazës së paretit të brendshëm, tregon se gdhendja e faqeve të tyre, si ballore ashtu dhe anësore, është kryer në vend.

Të tërë blloqet janë punuar prej ranori të miocenit, i cili ka qendrueshmëri të mirë dhe i nënshtrohet lehtë gdhendjes. Në të kundërt, me gjithë praninë e shkëmbinjve konglomeratë nuk kemi parë asnjë bllok të punuar prej këtij formacioni, gjë që tregon për preferencën e formacionit ranor ndaj atij konglomerat.

Traktet «in situ» të mureve ruhen në lartësi të vogël dhe në pak rreshta[3]). Prej këtyre trakteve, si pasojë e gërryerjes dhe shkarjes së terrenit, i cili gjatë rrëzimit ka marrë me vete dhe blloqet e paretit të jashtëm, me përjashtim të pikave 8 dhe 12, trashëgojmë vetëm paretin e brendshëm. Siç kuptohet nga fragmenti i ruajtur në pikën 8, në anën e jashtme, mbi themel, gjendej një rresht gurësh 45 cm. i lartë që formonte xokolin, mbi të cilin i tërhequr 10 cm. më brenda, ngrihej muri i lirë (fig. 8).

Nga sa mund të gjykojmë prej fragmenteve të ruajtura, blloqet ishin vendosur në rreshta horizontale, thuajse pa shkallëzime. Kemi të bëjmë me një muraturë me blloqe kuadratikë, me faqen e jashtme të rrafshët. Por lartësia e pakët e fragmenteve «in situ» dhe mungesa, thuajse e plotë e paretit të jashtëm, nuk na lejon të përcaktojmë me saktësi nëse muratura ka qenë pseudoizodomike ose izodomike. Megjithëkëtë, lartësija, thuajse e njëjtë e blloqeve të ripërdorur (rreth 45 cm.), na shtyn të mendojmë për një muraturë izodomike. Në pikën 8 dallohet se paretet e këtyre mureve lidhen me diatonë dhe, hapësirat midis tyre, janë mbushur me mbeturinat e përpunimit të gurëve.



Fig. 2

3) Në pikën C, 3 rreshta (34, 60, 50 cm.) në pikën D, 3 rreshta (43, 51, 40 cm.), në pikën B, 3 rreshta (?, 36, 44 cm.).

BOOT COPY

Prej kullave të kësaj periudhe trashëgojmë vetëm gjurmë të dobëta të një kulle drejtkëndëshe, në pikën 12 të kurtinës (fig. 9). Së fundi, gjetja e një blloku të gdhendur për futjen e traut të kasës së portës, afër pikës G, tregon se në këtë vend gjendej një nga hyrjet.

Një teknikë të ndryshme nga ajo që shqyrtuam, vërejmë tek kulla 1 (fig. 10, 11) ku është ripërdorur një numër blloqesh antike. Blloqet, po prej guri ranor, janë gdhendur mjaft mirë në tërë gjerësinë; lartësia është e njëllojtë (29 cm.) dhe faqja e dukshme qarkohet prej një kornize 1,5-2 cm. të thellë. Siç shihet kemi të bëjmë me një muraturë izodomike, blloqet e së cilës kanë gjatësi 35-120 cm., gjerësi rreth 45 cm. dhe formë drejtkëndore, që rrallë shmanget lehtë ndaj trapezit të rregullt. Korniza që qarkon blloqet është 4 cm. e gjërë në brinjët horizontale, ndërsa në brinjët vertikale lëviz nga 3-7 cm. Punimi i saj mjaft i kujdesshëm, krijon një kontrast estetik me pjesën e mesit, ku duken gjurmët e daltës. Vemë në dukje se blloqet kanë një lakim shumë të lehtë dhe se në faqet horizontale duken kanalet e kllapave të bashkimit bllok me bllok. Ky fakt, si dhe pranija e tyre vetëm tek kulla 1, na shtyn të mendojmë se blloqet i përkisnin ndonjë ndërtese monumentale dhe se nuk kemi të bëjmë me një fazë të dytë fortifikimi.

Qeramika që shoqëron këtë fazë, e grumbulluar gjatë hapjes së një kanali 40 m. të gjatë që arriti në tabanin steril në rradhë të parë përfaqësohet prej tullave me trashësi 7-8 cm., me brumë të kuq, me fije kashte dhe solenëve të sheshtë me buzë të shtrirë. Përveç saj në truallin e kalasë u gjet dhe një sasi e konsiderueshme qeramike tjetër. Ndër enët mbajtëse predominojnë amforat me qafë të gjatë cilindrike, fund të prerë konik dhe shpatulla të ngritura. Amforat, brumi i të cilave është okër në të verdhë, nganjëherë i lyer me një shtresë lymi ose rozë, ndahen në dy tipe, I pari, me buzë të trasha konike (III, 1,2), ndërsa i dyti, me trashje cilindrike (III, 3).

Enët e guzhinës kanë brumë të ashpër, me kokrriza silici në ngjyrë të kuqe. Dhe këto paraqiten në dy tipa: tek i pari, trupi sferik kalon menjëherë në grykën në formë hinke me buzë të drejta (tab. III, 4,5), ndërsa tipi i dytë ka qafë konike dhe buzë të profiluar në pjesën e brendshme për kapakun (tab. III, 6).

Në enët e tryezës në sasi më të madhe gjenden pjatat dhe kupat, të punuara me brumë të pastër ngjyrë rozë të hapur ose rozë okër, që nuk është karakteristike për Apolloninë, por ndoshta për Amantian. Kupat i gjejmë në katër tipa: dy tipat e parë, me këmbë të lartë konike (tab. III, 7, 11) dhe të ulët cilindrike (tab. III, 8, 12), janë lyer brenda dhe pjesërisht jashtë me vernik të zi të dobët. Tipi i tretë, në formë kantaroide, është lyer me vernik kafe, (tab. III 13). Tipin e katërt e përfaqësojnë kupat e «Megarës», me zbukurime në trajtë luspash (tab. IV, 5, 7) fletësh dafine (tab. IV, 3), vijash oblike (tab. IV, 4), palmetash (tab. IV, 5, 7) dhe rrathësh koncentrikë (tab. IV, 6). Ornamenti në trajtë luspe haset dhe në një kallëp të gjetur në Amantia[4]).



Fig. 3

Pjatat ndahen në katër tipa. Tipi i parë, me buzë të përkulur jashtë (tab. V, 2,3,4), i dyti, me buzë të trashur në formë unaze (tab. V, 5), ndërsa tipi tretë, me buzë vertikale (tab. VI, 1). Tipi i katërt, ndryshon prej tyre nga thellësia më e madhe dhe verniku në ngjyrë kafe të kuqe (tab. V, 6).

Nga amforiskat në gjendje relativisht të mirë, ruhet njëra e zbukuruar në anën e shpatullës, ku kapet dhe vegja, me vija dhe breza në ngjyrë kafe në manushaqe (tab. V, 7). Vegjet e amforave dhe amforiskave janë me kanelyra (tab. V, 9), me 2-3 kurrize,

4) S. Anamali, **Amantia** «Iliria», II, 1972, tab. XXVIII.

NOT COPY

si dhe në formë gërshete: njëshe (tab. V, 8), dyshe, ose me volutë (tab. V, 10).

Përsa i përket fazës së I (tab. II, 1), Bomo i mbështetur vetëm në përmasat, sipas tij të vogla të bllo-qeve, e veçon artificialisht muraturën e kësaj faze prej asaj që haset në teritorin ilir dhe epirot. Por më tej ai e fut në një grup me murin e tarracimit në Apolloni dhe një trakt në Butrint,[5]) grupim që nuk qëndron, pasi siç shihet nga fotografitë e prura prej tij, muri i Apollonisë ka bllloqe me fashatura, ndërsa ai i Butrintit është me faqe të bymyer, kavoje. Në territorin tonë muraturën e mësipërme e vëmë re në Apolloni, Dorëz, Irmaj, Jermë, Melan, Lekël dhe krejt identike në Cerje, ndërtime këto të fillimit të shek. III ose e shumta fundit të shek. IV[6]). Datimi mbështetet dhe prej materialit qeramik, i cili njëkohësisht na tregon dhe vazhdimësinë e jetës për periudhën antike. Ky material në qendrat e tjera qytetare datohet në diapazonin shek. III-I p. e. sonë. Kështu enët e guzhinës, kupat e Megarës dhe amforeta (III, 4, 5, IV, 1-7, V.7); i përkasin shtresës së shek. III-II në Dimal, kupat e Megarës gjenden dhe në Amantie po në këtë diapazon. Pjatat dhe kupat (tab. III, 7, 8, 11, 12; V, 1, 2, 3, 5) gjenden në shtresën e shek. III-II, në Antigone dhe të II-I në Dimal. Nga ana tjetër amforat (tab. IV, 2, 3), në Dimal i përkasin shek. I e. sonë[7]).

Përsa i përket bllogeve të ripërdorur tek kulla 1 (tab. II. 2) i shohim tipollogjikisht të njëjtë me ata të mureve të tarracimit në Apolloni[8]).

Faza e II. Në dy pika të murit rrethues të Kaninës, në anën jugore dhe veriore (fig. 3) dolën në dritë dy trakte të ruajtur mirë, të ndërtuar me teknikën «opus mixtum», Murat 2 m. të gjërë, përbëhen prej dy paretesh anësore dhe mbushjes së mesit. Paretet janë ndërtuar prej gurësh lumi me madhësi mesatare, të vendosur horizontalisht, por pa arritur të krijojnë rreshta, të lidhur me llaç të hirtë me shumë gëlqere dhe mbushës të imtë. Midis pareteve është derdhur mbushja e përbërë po prej një shumice llaçi të tillë dhe gurësh me përmasa të ndryshme.

Në një distancë 1,10 m. nga tabani muratura prej



Fig. 4

guri shkëmbehet prej brezit të tuilës (tab. II, 2) i cili në pikën 8 ruhet vetëm në një lartësi prej 4 tullash, ndërsa në pikën 4 në lartësinë e tij të plotë 6 tulla, duke arritur një gjërësi 61-63 cm. Tullat janë vendosur në rreshta të rregullt horizontalë, që e përshkojnë tejpërtej gjërësinë e murit. Në brendësi ato lidhen me llaç të njëjtë me atë që bashkon gurët, kurse në sipërfaqe fugat e tyre janë stukuar dhe lëmuar me ndonjë vegël druri, rreth 1 cm. brenda buzës së tullës. Fugat vertikale janë mjaft të vogla, ndërsa fugat horizontale e kalojnë trashësinë e tullës (6,5 6, 7, 8, cm. ndaj 4,5-5 cm.).

Tullat kanë një brumë uniform në ngjyrë të kuqe të përzier me grimca tulle të shtypur dhe fije kashte, të pjekur mirë. Përmasat e faqes së tyre të sipërme, për shkak të formës trung-piramidale, janë paksa më të mëdha se ato të faqes së poshtme (33,5 x 37 ndaj 32 x 35). Po kështu dhe trashësia e tyre nuk është uniforme (në mes 4-4,5 në anët 5,5 cm.). Në mesin e njerës prej tullave të brezit, gjendet i stampuar në reliev një kryq simetrik me krahë 5 dhe 6,8 cm., ndërsa

5) R.L. Beaumont, **vep. cit.,** 73.

6) H. Ceka, **Muri rrethues i Apollonisë,** B.SH.SH. 1963, 3, 131, fig. 4, Dorzi tek H. Ceka, **Zbulimi i një qyteti antik në rrethin e Tiranës** B.I.SH. 1951, 1; F. Prendi – Dh. Budina, **Kalaja e Irmajt,** B.SH.SH. 1963, 4, fig. 5. Dh. Budina **Antigonée,** «Iliria», II, 1972, 344, Melani dhe Lekli tek H. Ceka, **Ekspedita arkeologjike në rrethin e Tepelenës,** B.SH.SH. 1952, 34-42, dhe A. Baçe, **Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos,** «Monumentet» 4, 104, 106. Cerja sipas vrojtimeve në vend të autorit.

7) B. Dauti, **Qeramika e Dimalit** (dorëshkrim); S. Anamali, **vep. cit.,** 118, Dh. Budina, **Antigonée,** «Iliria» II. 333, tab. XXVI.

8) H. Ceka, **Mbi historikun e kërkimeve dhe gërmimeve arkeologjike në Apolloni,** B.SH.SH. 1958, 4, 213.

DOKTORATË

në një fragment tulle është vizatuar në mënyrë skematike një degë ulliri 10,5 cm. e gjatë (fig. 12).

Qeramika e ndërtimit, veç tullave, përfaqësohet dhe nga një sasi e madhe solenësh me fund të sheshtë dhe anë të përkulura, buza e jashtme e të cilëve ka trajtën e sqepit të zogut (tab. V, 13).

Fragmentet e enëve mbajtëse të kësaj kohe kanë brumë në ngjyrë okër të hapur ose të kuqe. Zbukurimet e tyre të kryera me inçizime janë tre llojesh: i pari, që haset dhe më shpesh, paraqet një sërë kanelyrash të ngushta horizontale me profil dhëmbësharre (tab. V, 14). Zbukurimet, siç kuptohet nga fragmentet, vazhdonin deri në pak centimetra poshtë qafës së enëve. I dyti (tab. V, 12), po kështu ka për zbukurim kanelyra horizontale, veçse profili i tyre është oval dhe gjërësia ndryshon, duke u shpeshtuar dhe ngushtuar në pjesën e sipërme të enës. Zbukurimi i tretë konsiston në tufa vijash horizontale, pak centimetra larg njera tjetrës, të ndërlidhura me vija të lakuara oblike (tab. V, 11). Vegjet e enëve me kanelyra dhëmbësharre kanë seksion rrethor, ndërsa vegjet e një amfore me qafë cilindrike dhe buzë paksa të shpërvjelur kanë seksion kurrizor.

Faza e II (tab. II, 2), duke u mbështetur në veçoritë teknike të muraturës: numrin e rreshtave, stukimin dhe trashësinë e fugës më të madhe se ajo e tullës, datoi në shek. IV[9]), gjë që mbështetet dhe nga qeramika. Kështu motivet e zbukurimit të saj janë dominuese dhe në qeramikën e shek. VI të gjetur në Elbasan, Bradashesh dhe Belsh[10]). Po kështu, tulla me vulë me kryq janë gjetur në shtresat e shek. V-VI të kalasë së Elbasanit dhe krejt identike në muret e shek. VI të kalasë së Durrësit. Me këto të fundit tullat e Kaninës përkojnë dhe nga gjatësija e trashësia e tyre[11]). Një «terminus ante quem» për këtë datim na e jep një folis prerë në Nikomedi i vitit të XVII të mbretërimit Justinianit (544).

IDENTIFIKIMI

Përsa i përket periudhës antike, pas identifikimit të imagjinuar të Pukëvilit me Oeneusin e Livit[12]), kemi përpjekjen e Bomosë. Duke u mbështetur në një fragment qeramike, sipas tij të shek. VII-VI p.e.sonë, dhe në pasazhin e Pausanias, Bomo e rreshton dhe Kaninën ndërmjet tre qendrave antike, ku ai supozon të



Fig. 5

DOCTOR COPY

9) A. Schneider – N. Carnapp, **Byzanc,** Berlin, 1936, 13, S. Bobçev, **Smesanata Zidarija v rimskite i ranovizantiskite strojezhi,** Sofija, 1952, 12-23, Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Elbasanit,** «Monumentet», 1, 1971, 69.

10) Gj. Karaiskaj, **Të dhëna të reja për datimin e kalasë së Elbasanit** «Monumentet», 3, 1972, 149, N. Ceka, L. Papajani, **Raport mbi gërmimet në Bradashesh dhe Belsh** (Arkivi i Institutit të Monumenteve të Kulturës.

11) Gj. Karaiskaj, **Të dhëna..,** 147, K. Zheku, **Zbulime epigrafike në muret rrethuese të kalasë së Durrësit,** «Monumentet», 3, 1972, 37, fig. 9, 42.

12) F. Pouqueville, **Voyage dans la Grèce,** Paris, 1820, I, 284; Liv. XI.III 12,2. e 4,7.

ketë qenë Throni[13]). Në shikimin e parë identifikimi është më se i pranueshëm[14]), kështu që ai është përkrahur dhe nga mjaft studjues të tjerë, ndërmjet të cilëve N.G.Hamond, S.Anamali dhe së fundi nga D.Komata[15]). Por në kundërshtim me këtë identifikim, pozita dhe të dhënat arkeologjike e arkitektonike të vetë Kaninës, e rrëzojnë këtë lokalizim. Së pari, apolloniatët para Kaninës, e cila konkuronte kryesisht Orikun kishin fare afër qytetin në Cakran, faza e parë e të cilit tregon një teknikë më primitive ndërtimi[16]), ose të paktën Treportin. Së dyti, materiali më i hershëm arkeologjik, pas të cilit vjen shtresa sterile, nuk shkon më tej fillimit të shek. III, e shumta fundit shek. IV, datim ky që përkon dhe me teknikën e ndërtimit të mureve.

Lind pyetja, në se Kanina qytet bregdetar, në një zonë me jetë intensive, i ka shpëtuar vemendjes së historianëve dhe gjeografëve antikë. Në gjirin e Vlorës Ptolemeu rreshton Orikun, Amantien, Byllisin dhe Aulonën (qytet dhe skelë), ndërsa më tej, ai jep dhe një Amantie të brendshme[17]). Duke marrë parasysh të dhënat e Ptolemeut, Amantia bregdetare del 15 njësi larg Orikut (15') dhe 40 njësi larg Apollonisë (40'), pra, diku afër Ujit të Ftohtë. Siç e pamë më sipër, në këtë zonë përmendet vetëm një qytet me emrin Amantie, me koordinata që përkojnë saktësisht me ato të Kaninës. Pozita e tij e kushtëzuar nga lidhja e njëkohëshme me detin, në një zonë të përshtatëshme për qëndrimin e anijeve, dhe hinterlandin amantin (luginën e Lumit të Vlorës), në një vend që kontrollon kalimin nga pjesa jugore e gjirit, e zënë prej Orikut, në atë veriore të zënë prej amantëve, dëshmon mjaft mirë se këtu kemi të bëjmë me një qytet amant.

Zhvillimi i Amanties në shek. IV-III dhe kthimi i saj «në një nga qendrat më me rëndësi të bregdetit të poshtëm të Adriatikut»[18]), sigurisht që kërkonte një qendër buzë detit për kryerjen e tregtisë detare, qendër që, sipas nesh, ishte pikërisht Kanina.

Identifikimi i Kaninës në periudhën e vonë antike, mendojmë se mund të arrihet nëpërmjet listave të Prokopit. Ndërmjet fortifikimeve të ndërtuara në Epirin e Vjetër, ai përmënd dhe njerin më emrin Kionin[19]). Qënia e Kaninës në kufirin midis dy Epireve, na lejon të supozojmë se ajo mund të jetë vënë gabimisht në Epirin e Vjetër, me emrin që ajo vazhdon të mbajë deri në ditët tona.



Fig. 6

BOOT COPY

13) Sipas Bomosë, **vep, cit.,** 66, Throni duhet të ketë qënë në Kaninë, Klos ose Ploçë. Për Kaninën, ndonse pranon se traktet antikë i përkasin periudhës helenistike, ai mendon se ajo ka qenë banuar që në helladikun e vonë. Për këtë Bomo mbështetet vetëm në një fragment qeramike të dekoruar me breza ngjyrë portokalli, të alternuar me breza ngjyrë kafe. Përveç faktit se një fragment i tillë nuk mund të ruhej në sipërfaqe të territorit të kalasë, të banuar për mijravjet me rradhë, qeramika e zbuluar gjatë gërmimeve nuk shkon tej shek. IV. Ndoshta në këtë rast Bomo ka marrë për qeramikë prehistorike ndonjë fragment të mesjetës së vonë, kohë në të cilën është mjaft karakteristik dekori i përshkruar prej Bomosë.

14) Pausania, e përcakton Thronin si qytet të ndërtuar nga lundërtarë Eubeas, në afërsi të maleve Keraune, por të shkatërruar prej apolloniatëve (Paus. V. 22, 3 e 4). Gjetja e mbishkrimit votiv apolloniat në Olimp, për të cilin bën fjalë Pausania, që daton në gjysmën e I të shek. V (E. Kunze, **Berichte uber die Ausgrabungen in Olympia**, 1956, 149), e bën mjaft të besueshëm identifikimin, në shikim të parë, të Kaninës me Thronin.

15) N. G. Hammond, **Epirus,** Oxford, 1967; S. Anamali, **vep. cit.,** 72; D. Komata, **Kështjellat e mesjetës së hershme në Shqipëri,** kumtesë në Kuvendin e I të Studimeve Ilire.

16) Cakrani, është vizituar prej Prashnikerit, por si pasojë e qëndrimit të shkurtër dhe pyllit të dendur, ai dalloi vetëm akropolin. Gjatë një ekspedite informative në vitin 1972, gjetëm rrënojat e një qyteti me sipërfaqe rreth 12 ha, në muret e të cilit shihen 3 faza ndërtimi, prej tyre më e hershmja me blloqe të mëdhenj paksa të punuar.

17) Ptolem., III, 12.

18) H. Ceka, **Probleme...,** 75.

19) Proc. **De aedif.** IV.



Fig. 7

PERIUDHA MESJETARE

Ndonëse muret rrethuese të qytetit të fortifikuar të Kaninës ndjekin trasenë e periudhës antike, formën dhe pamjen në gjendjen që trashëgojmë sot, ai e mori përgjatë mesjetës (fig. 13).

Kullat, që forcojnë muret e fortifikimit të jashtëm, 986 m. të gjatë, kanë formë rrethore, poligonale, drejtkëndore dhe trekëndëshe, me përmasa nga më të ndryshmet (tab. I). Prej tyre trashëgojmë vetëm 7. Por në planimetrinë e Koronelit[20]), e cila është mjaft e saktë, shihet se kurtinat përforcoheshin prej 14 kullash (fig. 14). Zhdukjen e tyre, në rradhë të parë, duhet t'ua atribuojmë hedhjes së fortifikimit në erë nga venecianët në vitin 1690[21]) dhe meremetimit të ngutshëm prej turqve, të cilët i mbyllën zbrazëtirat e hapura nga shpërthimi. Kjo kuptohet fare mirë prej blloqeve të mëdhenj të kullave të flakur deri 20-30 m. larg kurtinave.

Vrojtimet në vend treguan se pikërisht në vëndet e shënuara në planimetri, gjenden dhe 7 kulla të tjera (tab. I): në pikën 4, në vendin e rrëzimit të kurtinës gjetëm shpatullën e djathtë të kullës, e cila në planimetrinë e Koronelit ka formë pesëkëndëshe. Në pikën 5, ku gjithashtu ndërpritet kurtina, në anën e majtë, shihen gjurmë trarësh të brezave përforcuese, të vendosur me një kënd 45º ndaj trasesë së kurtinës. Pikërisht këtu, sipas planimetrisë së Koronelit, gjendej një kullë me bazë trekëndëshe. Në pikën 11 shihet mbushja e boshllëkut të krijuar në kurtinë nga rrëzimi i kullës, ndërsa 25-30 m. poshtë tij, gjenden shpatulla nga balli i kullës me planimetri drejtkëndëshe. Në pikën 12 ruhet shpatulla e djathtë e një kulle, sipas Koronelit me planimetri 5 këndëshe, ndërsa në pikat 14,15 duken fare mirë bazamentet e të tjerave. Prej kullave të shënuara në planimetrinë e Koronelit, nuk mundëm të gjejmë kullën 13, por mungesa e gjurmëve të saj është e kuptueshme, pasi në këtë vend terreni është rrëzuar.

Shpërndarja e kullave nuk është e njëtrajtëshme. Dëndësia e tyre më e madhe, vërehet në anën lindore dhe gjysmën perëndimore të anës jugore (F-K) (tab. I), në të kundërt ato mungojnë tërësisht në anën veriperëndimore (A-F). Kjo shpërndarje shpjegohet me natyrën e relievit më të përshtatshëm për sulm nga lindja, ku pjerrësija është relativisht e vogël, dhe jugperëndimi, ku një qafë e lidh me pjesën tjetër të vargut. Në të kundërt, në anën veriperëndimore terreni i thepisur e vështirëson sulmin dhe në një pjesë të mirë nuk lejon ndërtimin e kullave. Për më tepër, në këtë zonë, prej thyerjes së kurtinës (A-E) krijohet një farë gjiri i flankuar prej dy pjesëve anësore. Megjithëkëtë, për mendimin tonë, në këtë anë ndjehet nevoja të paktën e një kulle. Prania e kullave në perëndim, në një terren të thikët, do lidhur me kontrollin e rrugëve për në Vlorë dhe asaj për në Ujin e Ftohtë.

Sipas Hanit, fortifikimi ndahej prej muresh tërthorë në tre pjesë, që i mbiviheshin njëra-tjetrës[22]). Sot prej tyre ruhet vetëm kështjella, ndërsa gjurmët e ndarjes tjetër nuk shihen më. Ndarja nuk shihet në planimetrinë e Koronelit, por në një skicë të tijën, ku tregohet bombardimi i fortifikimit, vërejmë gjurmët e një muri që kalonte tërthorazi, ndërmjet pikave 10 dhe C, ku dhe ngushtohet gjerësia e truallit të rrethuar. Mosshënimi në planimetri, ndoshta do shpjeguar me lënien e tij pasdore në shek. XVI.

Kështjella me sipërfaqe 0.48 ha, që gjendet në anën perëndimore të fortifikimit, lartësohet mbi pjesën tjetër të rrethimit, e ndarë nga një mur (tab. I). Muri në anën veriore ruhet në gjëndjen e tij të parë,

20) C. Coronelli, **Città, fortezze ed altri luoghi principali dell'Albania, Epiro e Livadia.** Venetia, 1688.
21) C. Contarini, **Istoria della guerra di Leopoldo primo imperatore,** Venezia, 1710, 300. (Kalaja hidhet në erë nga 200 xhenjerë në drejtimin e një inxhinjeri me 16 shkurt).
22) J. G. Hahn, **vep. cit.,** 72.

DO NOT COPY

ndërsa në pjesën tjetër ka ndryshuar së tepërmi nga ndërtimet e shek. XVIII-XIX dhe, veçanërisht, nga punimet xheniere të trupave italiane të pushtimit në vitin 1918. Kështu, ndërsa sot ruhet vetëm një kullë, në një skicë anonime të periudhës së vonë të pushtimit turk[23]) (fig. 16) shihen dy kulla, kurse në planimetrinë e Koronelit vërejmë 2 kulla drejtkëndëshe dhe një rrethore (fig. 14). Sipas planimetrisë së Koronelit në skajin verior të kështjellës gjendej një mur i tërthortë, i cili e ndante këtë pjesë duke krijuar një bastion të fuqishëm, ndarje që i përgjigjet gjëndjes së sotme. Në ndryshim prej saj, në skicën anonime vërejmë një mur tjetër të pajisur me portë, i cili e përgjysmonte sipërfaqen e kështjellës, ndarje kjo që me sa duket i përket periudhës pas vitit 1690.

Hyrjet, sipas përshkrimit të Çelebiut ishin katër. Prej tyre: «njera sheh jugun dhe e lidh kalanë me varoshin e asaj ane, një tjetër është në veri dhe lidhet me rrugën e Vlorës, e treta të çon në Varoshin e Vogël që ndodhet në jug. Pranë kësaj porte, ndodhet kalaja e brendshme (kështjella), një portë e së cilës shikon kundrejt lindjes dhe hapet në drejtim të kalasë... Mbi portën, nga ana e veriut, në një pllakë katër këndëshe prej mermeri, lexohet mbishkrimi: Sulltan Sulejmani e meremetoi këtë kala»[24]).

Prej hyrjeve të mësipërme ruhet, deri në një farë mase, jugorja pranë kështjellës (tab. I, «I», fig. 17). Hyrja e mbrojtur prej një kulle të fuqishme gjashtëkëndëshe është 2.85 m. e gjërë, 3.40 m e lartë dhe mbulohet prej një harku sektorial. Para saj ruhen gjurmët e rampës, e cila të çonte tek pragu.

Hyrja tjetër e mbrojtur prej një kulle gjashtëkëndëshe, ndodhej në lindje të anës jugore (II) e mbuluar nga dheu, kështu që planimetrinë e saj mundëm t'a sqarojmë nëpërmjet pastrimit. Gjërësia e tregon atë si hyrje sekondare për kalimin e njerëzve dhe jo të karrove. Hyrja në anën e djathtë mbështetet në faqen e kullës, ku dhe shihen gjurmët e kanalit për rrëshqitjen e katarahut që e siguronte nga brenda.

Prej hyrjes së tretë, asaj veriore (III) nuk ruhet ndo-

Fig. 8



Fig. 9



23) Origjinali gjendet në bibliotekën e qytetit të Vlorës.
24) E. Çelebi, **Seyahatnamesi,** Istanbul, 1898, VIII, 703.

DO NOT COPY

një gjurmë. Por prania e saj, përveç skicës, kuptohet nga muri mbajtës i rrugës dhe vetë rruga, e cila në pikën C (tab. I) i afrohet me dy bërryla murit rrethues.

Nuk ruhet gjithashtu as hyrja e kështjellës, e cila, siç e vumë në dukje, u shkatërrua nga italianët së bashku me pjesën jugore të citadelës. Sipas skicës anonime, në truallin e kështjellës të mbushur me dhe kalohej me anë shkallësh. Prej tyre në skicë shënohet si hyrja e re, në anën jugore, ashtu dhe e vjetra në anën veriore (fig. 16). Ndërtimi i hyrjes së re, që të shpie në ndarjen e parë të kështjellës është i kuptueshëm, pasi hyrja e vjetër të çonte në ndarjen e dytë të brendshme, duke e bërë të pakuptueshme vetë ndarjen. Nga ana tjetër në planimetrinë e Koronelit (fig. 14), para murit të kështjellës, vihet re një platformë, ngjitja për tek e cila kryhej nga anët.

Ndërtimet në brendi të rrethimit sipas Çelebiut përfaqësoheshin prej 300 shtëpish të gurta, shifër si zakonisht e zmadhuar, prej pallatit të Gazi Sinan Pashës dhe xhamisë së Sulltan Mehmetit të ndërtuar afër tij. Konturet e pallatit që jepen dhe në planimetrinë e Koronelit (fig. 14), shihen dhe sot, por krejt të rrënuara, në mes të anës jugore në një bregore që lartësohet mbi terrenin (tab. I). Komunikimi në brendi të territorit të kalasë kryhej me anë rrugësh që i përshtateshin terrenit të pjerrët, shpesh me shkallëzime fig. 18).

Çelebiu na bën gjithashtu të ditur se në kështjellë gjendeshin dhe 10 shtëpi të tjera, me sa duket të garnizonit, si dhe depo ushqimi e municioni[25]).

Furnizimi me ujë i qytetit të fortifikuar bëhej kryesisht nëpërmjet sterave, prania e të cilave dëshmohet që në shek. e XIII[26]). Më tej ato përmënden prej Çelebiut[27]) dhe shihen në planimetrinë e Koronelit (fig. 14). Në këtë të fundit, në anën veriore, veç sterës me planimetri kuadratike, shënohet dhe një pus me planimetri rrethore. Domosdoshmëria e ndërtimit të puseve shihet në urdhëresat e Karlit të I Anzhu, si dhe në kohën e pushtimit të kalasë prej venecianëve[28]). Prej sterave të shënuara në planimetrinë e Koronelit kemi gjetur vetëm atë të anës jugore, ndërsa pusi dhe stera e anës veriore, me sa duket janë mbuluar prej dherave. Përveç tyre, në perëndim të sterës jugore, gjendet një sterë tjetër. Po kështu, në anën veriore të kështjellës gjetëm dhe sterën e përmëndur prej Çelebiut.

Stera «IV» (tab. I), ka formën e një cilindri me diametër 4,5 m. 12 m. të lartë të mbuluar me kupol. Stera që gjendet nën nivelin e truallit e gërmuar në shkëmb, ka kapacitet për 50.000 l. ujë. Muret dhe kupola e saj janë ndërtuar me gurë të lidhur me llaç shumë të fortë gëlqeror, ndërsa hidroizolimi bëhet me llaç të përzier me pluhur tulle. Furnizimi i saj kryhej me ujin e pullazeve, me sa duket të pallatit, me anë tubash qeramike me diametër 10 cm., njëri prej të cilëve shihet në pjesën e fillimit të kupolës. Uji nxirrej prej sterës nëpërmjet një gryke kuadratike 0,55 x 0,5 m. në mesin e kupolës së saj.

Stera VI», e kështjellës, ka planimetri drejtkëndëshe dhe mbulohet me qemer cilindrik. Stera ka përmasa 6 x 4 x 5 m. dhe kapacitet për 120.000 l. ujë. Ashtu si dhe stera IV, ajo hidroizolohet me llaç me pluhur tulle, gjëndet nën nivelin e truallit të kështjellës dhe ka një grykë kuadratike 0,50 x 0,50 m. Sterat janë punuar me gurë të përmasave të vogla dhe copa tjegullash, lidhja e të cilave kryhet me llaç të bardhë, shumë të fortë.

Punimi dhe forma mjaft e rregullt na shtyn që sterat e mësipërme ti shohim të ndërtuara rreth shek. XIII, kur ato përmënden në privilegjet e Andronikut II. Një sterë tjetër me planimetri të çrregullt katërkëndëshe, që gjëndet mbi tokë, afër rrënojave të pallatit (tab. I), është mjaft e ngjashme me sterat e kalasë së Gjirokastrës. Datimi i këtyre në periudhën e vonë të pushtimit turk[29]), si dhe rindërtimi i pallatit në këtë periudhë e daton dhe sterën e mësipërme në mesjetën e vonë.

Varoshi, sipas Çelebiut dhe skicave të Koronelit (fig. 15) gjëndej në jug, atje ku është dhe sot, dhe përbëhej prej 300 shtëpish prej guri (fig. 2, 13). Mungesa e tregut, hamamit dhe haneve brenda kalasë, për të cilën na bën të ditur Çelebiu, tregon për daljen e tyre prej kohësh jashtë mureve rrethuese.

Fazat e ndërtimit për periudhën antike mundëm ti përcaktojmë në një kronologji, deridiku të kënaqëshme, por për periudhën mesjetare problemi, deri më sot i pamarë në shqyrtim, paraqitet veçanërisht i ndërlikuar. Moria e fazave në shumicën e rasteve të ndërtuara vetëm me gurë dhe llaç gëlqereje, pa ndonjë ndryshim thelbësor e vështirëson së tepërmi kronolo-

25) E. Çelebi, **vep. vit.**, 702-3.
26) Në privilegjet që Andronikу II i akordon peshkopit të Kaninës i njeh dhe pronësinë ndaj sterave të fortifikimit. K. Alexander, **Byzantion,** 15, 179.
27) E. Çelebi, **vep. cit.,** 703.
28) **Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia.** Vindobonae 1903, I. 385, 408, 415, 417, Dokumentat janë urdhëresa të Karlit I për dërgimin e mjeshtrave për hapjen e puseve në kastrën e Aulonës. Për faktin se me këtë emërtim nënkuptohet Kanina shih A. Baçe, **Kalaja e Vlorës,** «Monumentet», 5. Për kohën e venecianëve P. Garzoni, **Istoria della republica di Venezia in tempo della sacra lega,** Venezia, 1712, 324.
29) Th. Kamberi, **Furnizimi me ujë i Gjirokastrës,** (material në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës).

DO NOT COPY



Fig. 10 11

DO NOT COPY

gjinë relative dhe akoma më tepër atë absolute. Në këtë të fundit influencon negativisht studimi i pamjaftueshëm i teknikës së ndërtimit të fortifikimeve mesjetare dhe mungesa e teknikave të datuara rigorozisht. Sidoqoftë, duke u mbështetur në ato pak tipare dalluese, do mundohemi të diferencojmë dhe datojmë fazat kryesore të ndërtimit, por sigurisht pa e absolutizuar vendosjen e tyre në kohë.

Në këtë drejtim analiza e imtë e teknikës së ndërtimit të fazave të veçanta dhe argumentimi i hollësishëm për vendosjen në kohë, veç qëllimeve të drejtpërdrejta të artikullit, synon dhe për krijimin e disa pikave repere (sigurisht pa i absolutizuar ato) për studimin e fortifikimeve të tjera mesjetare.

Faza e III, e cila, sipas nesh, vjen pas fazave të periudhës antike, gjendet në kurtinat 1-3, K-8, I(?), dhe në kullën kontrafort 2 (tab. I, fig. 19). Muret e saj janë ndërtuar me blloqe të ripërdorur antikë dhe gurë të papunuar me madhësi mesatare ose të vogël, midis të cilëve janë vendosur rrallë, horizontalisht, vertikalisht, ose me një kënd 45° tjegulla të periudhës antike. Lidhja kryhet me llaç gëlqereje me ranë, i cili dikur gjëndej me shumicë në anën e jashtme të gurëve (tab. II, 3). Muret përforcohen prej rrjetit të trarëve gjatësorë me seksion 13x17 cm., të lidhur me traversa tërthore me diametër 9 cm., që gjënden 1.5 m. larg njera tjetrës[30]). Për flankimin e kurtinës 1-3 dhe krijimin e një nyje rigjide, që eviton rrëzimin e saj të menjëherëshëm, në mes të saj është ndërtuar një kullë kontrafort me planimetri trekëndëshe (2) me brinjët anësore 1.90 m. dhe bazën 2.60 m. (fig. 20). Lidhja e kullës me kurtinën është organike dhe arrihet me anën e blloqeve të profiluar me kënd të gjërë. Përveç kësaj lidhja dhe përforcimi ndihmohet prej rrjetit të trarëve të vendosur gjatë perimetrit dhe mesores së trekëndëshit. Vemë në dukje se këto mure ngrihen drejt mbi muret e fazës së I (shek. III para e.sonë), pa ndonjë fazë ndërmjetëse.

30) Përmasat e trarëve dhe distancat, sigurisht nuk janë rigoroze, por kjo është vlera e tyre mesatare.



Fig. 12

Faza e IV, përfaqësohet prej kullës 10 dhe kurtinës C (tab. I fig. 19). Muratura e saj përbëhet prej gurësh të vegjël të gdhendur në mënyrë të vrazhdë, të vendosur horizontalisht, por pa arritur një rreshtim të rregullt (tab. II, 4). Më mirë gurët janë latuar në anët e kullës 10 (fig. 17). Lidhja kryhet me llaç të fortë me zhur, i cili dikur gjëndej me shumicë në sipërfaqe. Muri përforcohet prej trarëve gjatësorë dhe traversave tërthore 10 x 10 ose me diametër 10 cm.

Kulla 10, që gjëndet në anën e djathtë të hyrjes, ka planimetri gjashtëkëndëshe me brinjët anësore 2,5 m. dhe lartësi të ruajtur 7 m. (fig. 17). Në një lartësi 5,5 m. nga tabani, në dy faqet ballore, gjënden dy frëngji për armë të rënda, jo zjarri, me përmasa 0,9 x x 0,9 m në anën e brendshme dhe 0,5 x 0,7 m. në anën e jashtme. Faqja që flankon kurtinën e djathtë përshkohet në mes prej një hapësire, që duket se ka shërbyer për vendosjen e një erkeri, ndërsa anash tij gjënden frëngji të gjata shigjete. Niveli i lartë i terrenit, në anën e brendshme të kullës, tregon se pjesa e saj e poshtme ka qënë e mbushur dhe se hyrja në të kryhej nga niveli i brendshëm i fortifikimit. Muret e saj mjaft të gjërë, 1.80 m. nën nivelin e frengjive na shtynë të mendojmë se ajo ka pasur edhe një kat tjetër.

Faza e V a, haset në kurtinat F-1, K-8, E, në anën veriore të murit të kështjellës 16-A dhe në kullat 15 e 16 (tab. I, fig. 19). Kjo fazë karakterizohet nga një muraturë e çrregullt prej gurësh të vegjël të papunuar, midis të cilëve janë vendosur copa tjegullash, që të japin përshtypjen e një kluasonazhi të shpërbërë. Lidhja e tyre kryhet me llaç gëlqere, që gjëndet me shumicë si brenda ashtu dhe në anën e jashtme ku i mbulon gurët, duke krijuar një farë kornize të prerë diagonalisht. Në çdo 1.8-2 m. lartësi muret përforcohen prej trarëve tërthorë, me seksion 12x10 ose 10 x x 10 cm. të lidhur me kllapa dhe gozhdë me trarët gjatësorë 16-10 cm. të vendosur thuajse buzë murit. Karakteristikë e tyre është vendosja e trarëve sheshazi si dhe izolimi i trarëve gjatësorë prej ambientit të jashtëm me një rresht pllakash guri, të cilat njëkohësisht nivelojnë muraturën (tab. II, 5).

Kulla 16 që ka planimetri kuadratike me përmasa 4.8 x 4.9 m. dhe faqe vertikale, shërbente për flankimin e murit të akropolit. Kulla 15 e anës perëndimore të kështjellës ruhet vetëm në pjesën e poshtme. Ajo paraqet një bastion masiv 4 x 3,9 m., me tre shkallëzime. Muri që vijonte në të majtë të kullës nuk lakohej, si ai që ruhet sot, por vazhdonte 3-4 m më tej, duke u kthyer me kënd të mprehtë (tab. I). Në faqet e kullës që janë mbrojtur më mirë nga gërryerja se ndërtimet e tjera shihet vizimi i fugave me mistri, si në kalanë e Gjirokastrës (fazën e parë) dhe atë të Kardhiqit[31]).



Fig. 13

31) A. Baçe, **Vështrim...**, 120 e vazhdim.

DO NOT COPY

Një variant të fazës në shqyrtim, paraqesin muret e kurtinat D-E, L-9 (tab. I fig. 19) të ndërtuara me gurë të vegjël punuar vrazhdët në formë paralelopipedi, por që s'arrinë të krijojnë rreshta të rregullt. Muret veçanërisht në kurtinën D-E, të tërheqin vëmëndjen me gjërësinë e pakët 0.85 m. Në çdo 1 m. lartësi ata përforcohen prej 3 traversave gjatësore 10 x 6 cm. të vendosura sheshazi, që lidhen në çdo 1-5,5 m. me traversat tërthore me seksion 10 x 10 cm. Traversat gjatësore izolohen gjithashtu prej një rreshti pllakash, të cilat nivelojnë muraturën. Në kurtinën D-E shihen dhe gjurmët e një sërë frengji-shigjete 12 cm. nga brenda, 4 nga jashtë, 1-1,5 m. larg njera-tjetrës.

Faza V b. Shihet tek kurtinat 6-7, 14-15 dhe kullat 6 e 8 (tab. I fig. 19). Muret e kurtinave janë ndërtuar me gurë të vegjël dhe copa tjegullash të vendosura pa kriter, të lidhur me llaç gëlqereje jo dhe aq të fortë, me mbushës të imtë shtufor. Llaçi që në anën e jashtme gjëndej me shumicë, duke mbuluar sipërfaqen e gurëve, sot është gërryer nga agjentët atmosferikë. Po kështu dhe në brendësi të murit gurët janë zhytur brenda një sasia të madhe llaçi. Struktura e murit përforcohet nga rrjeti i trarëve, prej të cilëve gjatësorët kanë seksion 14 x 14 cm., ndërsa tërthorët të vendosur 1.5 m. larg njeri-tjetrit kanë diametër 7-10 cm. Në kullën «6» trarët janë vendosur në formë perimetrale dhe tufë rrezesh.

Kurtinat e kësaj faze kanë lartësi 5 m. dhe gjerësi 1,80 m., që ndahet në shtegun e kalimit 1m. të gjërë dhe parapetin me bedenë 0,80 m. të vendosur 0,8 m. larg njeri-tjetrit. Duket se kësaj kohe i takojnë dhe disa kontraforte 4 m. të lartë, në mes të anës perëndimore të akropolit.

Kulla 6, në formë patkoi, ka përmasa 3,5 x 3 m. Ndonse e njëkohshme me kurtinën ajo i vishet kësaj të fundit, në mënyrë që rrëzimi i kullës të mos sjellë si pasojë dhe rrëzimin e kurtinës. Muret e kullës ngrihen me faqe vertikale mbi një bazament të çrregullt; i cili ndoshta ka dalë në dukje nga gërryerja e terrenit. Ajo paraqitet masive, vetëm me një platformë në pjesën e sipërme, në nivelin e shtegut të kalimit. Mbi të nuk ka patur ndonjë kat tjetër, pasi trashësija e parapetit të saj mjaft e vogël nuk mund të mbante ngarkesën e katit.

Kulla 8 (fig. 5) ruhet vetëm në bërthamë, por pastri-



Fig. 14

POOR COPY



Fig. 15

mi lejoi të përcaktojmë se forma e saj planimetrike ka qenë në trajtë patkoi me përmasa 3,5 x 3, mjaft e ngjashme me kullën 6. Kulla i mbështetet pa lidhje pjesës së poshtme të kurtinës K-8 së fazës së III, por lidhet organikisht me pjesën e saj të sipërme, që i përket fazës së Vc. Kjo kuptohet fare mirë prej dy blloqesh, që dalin në pjesën e sipërme në një plan me konturin e poshtëm të kullës (fig. 5). Mundësia më e madhe është që kulla të jetë e fazës së Vb, ndërsa pjesa e sipërme e saj të jetë rindërtuar në fazën e Vc.

Faza e Vc, gjendet në kurtinat K-8, 11-M, 4-H, disa blloqe të rrëzuar, si dhe kullat 1,9 (tab. I fig. 21, 22, 23). Muret janë ndërtuar me gurë të vegjël të qarkuar në anën e jashtme prej një kornize tjegullash të periudhës mesjetare, që të japin përshtypjen e një kluasonazhi të shpërbërë (tab. II, 6). Një farë rregullsie vihet re dhe në vendosjen e gurëve në brendi të murit. Lidhja e tyre kryhet me llaç të fortë gëlqeror me zhur, i cili mbulonte tjegullat dhe një pjesë të sipërfaqes së gurit. Muret përforcohen në brendi prej rrjetit të trarëve, të cilët kanë seksion kuadratik 14-17 cm. (tek kulla 1, 17-25 cm). Nga gjurmët kuptohet se trarët e tërthorë, që gjëndeshin 1.2-1.6 m. larg njeri-tjetrit, ndërlidheshin me kllapa me trarë gjatësorë.

Kurtinat 1.75 m. të gjera, ndahen në shtegun e kalimit 1.20 m. dhe parapetin 0,55 m. Kulla 1 e ndërtuar me këtë teknikë ka në plan formën e një trapezi këndrejtë 5 x 3 m. me dy brinjët anësore paralele (fig. 11, 23). Prej saj ruhen faqja perëndimore, gjysma e faqes veriore dhe një pjesë e bazamentit të faqes lindore. Muret e kullës, 1.70 m. të gjerë, ngrihen vertikalisht mbi një themel të çrregullt, i cili ka dalë në pah nga gërryerja e terrenit. Në lartësi 2 m. ata ngushtohen, dhe krijojnë një dhëmbëzim për vendosjen e dyshemesë, duke shmangur mbushjen me dhe që do të riste presionin ndaj faqeve, 1,2 m. mbi nivelin e dyshemesë. Në skajin veriperëndimor shihen gjurmët e dy frengjive; anësorja me ngushtimin nga jashtë, ndërsa ballorja me ngushtimin nga brenda[32]).

Faza e VI, haset në kurtinat F-1, 3-G dhe kullën kontrafort 3 (tab. I fig. 21). Muret e kësaj faze janë ndërtuar me gurë të një madhësie mesatare, gjysëm të përpunuar në kurtinat dhe të latuar në kullën 3,



Fig. 16

32) Praninë e njëkohëshme të frengjive me zgjerim seksioni brenda dhe jashtë e kemi vënë re dhe në Berat. Këtë dukuri e shpjegojmë me faktin se zgjerimi i seksionit jashtë, lejon jo vetëm një fushëshikim më të gjërë dhe manovrueshmëri, më të mirë të armëve, por ekspozon më tepër armët dhe efektivin ndaj goditjeve. Si pasojë frengjitë me zgjerim jashtë, përdoren atje ku mundësia e afrimit të sulmuesve është e pakët, ndërsa ato me zgjerim brenda në të kundërt. Kjo dëshmohet në rastin konkret ku sulmuesi mund të afrohet nga perëndimi, por jo nga veriu ku terreni është shumë i pjerrët.

DO NOT COPY

madje, në këtë të fundit, qoshet e saj janë skuadruar dhe thadruar në mënyrë të përsosur (tab. III, 7). Tendenca për rreshtim, që vihet re dhe në muret, theksohet më tepër tek kulla. Gurët bashkohen me llaç shumë të fortë me zhur dhe mjaft gëlqere, aq sa kjo e kalçinon tërë sipërfaqen e murit, veçanërisht të kullës. Muret përforcohen prej rrjetit të traversave me përmasa 10 x 10 cm. Kurtinat e ndërtuara me këtë teknikë kanë një pjerrësi rreth 10°, gjerësia e tyre 1,75 m., në pjesën e sipërme, ndahet në parapetin 0,55 m, të dhëmbëzuar në bedenë dhe shtegun e kalimit 1,2 m. Kulla – kontrafort ka gjatësi 8 m. lartësi të njëjtë me kurtinën dhe gjerësi mjaft të vogël (fig. 24). Në anën e djathtë balli gjendet 0,3 m para kurtinës G-4 të fazës së II më të hershme, gjë që kuptohet qartë nga fuga e bashkimit. Në anën e majt, në nivelin e tokës, balli i kullës gjendet në të njëjtën vijë me kurtinën e njëfazëshme 3-G, ndërsa në lartësi ajo del 1,2 m. para, si pasojë e pjerrjes së kurtinës nga brenda. Në faqen ballore të kullës, në një lartësi 4,5 nga bazamenti i saj, gjendet një frengji topi e mbuluar me qemer konik (fig. 25). Mbi të muri i kullës, ashtu si muri i kurtinës, që gjendet në të njejtin nivel me të, ndahet në parapetin me bedenë dhe shtegun e kalimit. Po kësaj faze i përket dhe një pjesë e mbuluar me hark rrethor në kurtinën F-1. Përveç ngjashmërisë teknike muri i saj përforcohej me traversa të punuara mirë me përmasa po 10 x 10 cm.



Fig. 17

Faza e VII, gjendet në kurtinat G-4, K-8, 11-M, 12-13, (tab. I fig. 21). Muratura është e çregullt me gurë të papunuar, lidhur me llaç të dobët me mbushës të imtë, shtuf të nxjerrë në vend (tab. II, 8). Llaçi gjendet me shumicë si në anën e brendshme, ashtu dhe të jashtme. Struktura e murit përforcohet prej dy trarësh gjatësorë me seksion 10-15 cm. të vendosur në çdo 1 m. lartësi dhe traversave tërthore me diametër 8 cm., 1,6 m. larg njera-tjetrës. Kurtina K-8, që ruhet më mirë se të tjerat, ndahet në një lartësi 5 m. nga tabani, në shtegun e kalimit 0.9 m. dhe parapetin e dhëmbëzuar në bedenë 0,6 m. të gjërë. Këto ndërtime meremetojnë dëmtimet që pësoi rrethimi nga hedhja në erë prej venecianëve në vitin 1690, duke u ngritur pjesërisht dhe mbi blloqet e rrëzuara.

Së fundi, shihen disa meremetime mjaft të dobëta si ato në pikën K dhe F, shpesh me gurë të lidhur me baltë, të cilat nuk përbëjnë një fazë më vete.

RESTAURIMET

Siç e vumë në dukje, kalaja e Kaninës e lënë pas dore si fortifikim që nga viti 1832, iu nënshtrua shkatërrimeve të herëpasherëshme. Një dëm të konsiderueshëm ajo pësoi prej bombardimit italian me artileri të rëndë gjatë Luftës së Vlorës, si dhe shembjes së një pjese të saj nga trupat xheniere. Si pasojë, kalaja arriti në ditët tona mjaft e dëmtuar dhe me struktura në degradim e sipër. Për ta parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të këtij objekti me mjaft rëndësi për historinë dhe historinë e arkitekturës së vendit tonë, sektori i monumenteve të arkitekturës mesjetare të Institutit të Monumenteve të Kulturës i hyri studimit të monumentit, lidhur me punimet konservuese e vlerësuese të domosdoshme për të kryer në të. Studimi e bëri të qartë nevojën e ndërhyrjes së menjëhershme për të evituar degradimin e mëtejshëm të monumentit. Projekti i restaurimit i pregatitur në këtë rast, pati si pikësynim pikërisht konsolidimin e strukturave murale, dhe nxjerrjen në dukje të tyre, por pa cënuar vlerat e monumentit. Në këtë mënyrë u mbushën me muraturë vetëm ato vende që paraqesnin rrezik shembjeje (fig.

PHOTOCOPY



Fig. 18

26). Punime të tilla u kryen në traktet F-N-G-H, 1-6, M--N, A dhe kullat 3,6,7 (tab. I). Muret e rinj të lidhur me llaç gëlqereje, ndoqën karakteristikat teknike të mureve të rrëzuar. Për dallimin e tyre nga muret e vjetër, në to, u vendosën pllaka të vogla ku u shënua viti dhe enti restaurues. Më problematike paraqitej gjendja tek kulla 1 dhe traktet afër kullave 8 dhe 9. Në kullën 1 gërryerja e tabanit solli për pasojë rrëzimin e gjysmës lindore, mbetjen pezull të faqes veriore (fig. 10) dhe çarjen e faqes perëndimore. Së pari, për të evituar plasjen nga ngricat në çarjen, pas një pastrimi të kujdesshëm, u injektua lëng çimentoje. Më tej për mbështetjen e faqes veriore u ndërtua një bazament piramidal, i cili dallohet prej ndërtimit të vjetër (fig. II, 23). Kjo formë u zgjodh si për arsye konstruktive, ashtu dhe estetike. Gjatë ndërtimit u pat parasysh mbulimi sa më i paktë i blloqeve antikë, që gjendeshin në pjesën e poshtme të kullës.

Në traktin K-8, ku ishte gërryer bazamenti dhe nga rrëzimi ishte hapur një zgavër në mur (fig. 4), u ngritën dy kontraforte në trajtë pilastrash të pjerrët, 1-1,20 m. të gjërë. Kontrafortet, që lidhen organikisht me pjesën e dobësuar të murit dhe që nuk lejojnë rënien e tij, mbështeten mbi një bazament të zgjeruar (fig. 5). Afërsisht po kjo procedurë u ndoq dhe në traktin e rrëzuar afër kullës 9 (fig. 22). Mënyra e mësipërme e përforcimit, sipas nesh, ka një sërë avantazhesh ndaj mbushjes së plotë, pasi e përforcoi monumentin pa ndërhyrë në vlerat e tij dhe nga ana tjetër paraqitet reversibël.

Përveç punimeve të mësipërme u ndërmorën dhe disa punime pastrimi në traktin 4-K të mureve të jashtëm (tab. I), si dhe hapja e një rrugine rreth e qark kalasë.

DATIMI

Prania e fragmenteve të qeramikës së mesjetës së hershme, tregon për një vazhdimësi jete përgjatë kësaj periudhe. Nga ana tjetër mungesa e saj në qendrat e tjera të gjirit, tregon se shkaqet e kësaj vazhdimësie duhet ti kërkojmë në pozitën e mbrojtur. Kështu që lind mendimi se, ndoshta fortifikimi e vazhdon funksionin e tij dhe gjatë kësaj periudhe. Për më tepër ajo përmendet si qendër peshkopate, ndonëse sufragane e Gllavenicës në dipllomën e Vasilit të II, i cili njeh të drejtat e peshkopatës së Ohrit të fituara që



Fig. 19

DO NOT COPY



Fig. 20

në kohën e Samuilit[33]). Kjo dëshmon qënien e saj si qytet që në shekullin e X. Nga ana tjetër, roli aq i rëndësishëm që lot ajo në luftimet Normano-Bizantine në shek. XI[34]), mund të shihet i lidhur vetëm me një qytet të fortifikuar. Me këtë periudhë (mesjetën e hershme dhe fillimet e mesjetës së mesme) shohim të lidhur fazën e III (tab. II, 3). Për këtë datim, ndonse të rezervuar, na shtyn ngritja e kësaj faze drejt e mbi muret antike (të shek. III p.e. sonë në pikën 2 dhe të shek. VI në pikën 8), pa ndonjë fazë tjetër ndërmjetëse; si dhe përdorimi në mure i materialit qeramik të periudhës antike dhe mungesa e atij mesjetar (midis tjegullave shihet dhe një vegje ene e periudhës helenistike). Kjo nuk kundërshtohet as nga teknika e ndërtimit të mureve, e cila nuk ka ndonjë tipar specifik të mesjetës së mesme dhe që, deri në një farë mase, na kujton muret e fazës së II të Petrelës, të cilat i kemi parë si të kësaj periudhe[35]).

Pas ngjarjeve të shek. XI dhe një periudhe qetësije relative në shek. XII, Kanina kthehet përsëri në një qendër ushtarake të dorës së parë, duke shërbyer si placdarm për shtyrjen anzhuine drejt hinterlandit shqiptar. Mendojmë se me këtë periudhë, duhet të lidhet faza e IV (tab. II, 4). Tiparet e saj dëshmojnë për një punë disi më të kujdesshme se fazat e tjera pasardhëse, por nga ana tjetër dhe mungesën e artilerisë (frengjitë për balista e jo topa, ballkonet, frengjitë e harkut). Fakti se prania e artilerisë dëshmohet në fillim të shek. XV ose fundit të shek. XIV[36]), na jep një «terminus ante quem» për këtë fazë. Nga ana tjetër kjo teknikë e ndërtimit të mureve nuk është specifike për bizantinët, të cilët në këto shekuj përdorin gjërësisht në mure materialin qeramik. Mungesa e teknikës me përdorim tjegullash të vendosura horizontalisht (karakteristike për shek. XII-XIII), qënia e fortifikimit për një kohë të gjatë në duart e anzhuinëve, si dhe dërgimi i inxhinjerëve ushtarakë për meremetimin e fortifikimit[37]) na anon nga mendimi se kjo fazë i përket periudhës së pushtimit anzhuin.

Faza e V (tab. II, 7-8) karakterizohet nga përdorimi i tjegullave të ndërfutura midis gurëve në mënyrë të çrregullt ose në trajtë kluasonazhi të shpërbërë. Por në fazën e V a trarët e brezave janë vendosur sheshazi dhe muratura nivelohet në çdo 1.8-2 m. lartësi (Kjo karakteristikë vërehet dhe në një sërë muresh ku nuk janë përdorur tjegullat, të cilat ndoshta i përkasin së njëjtës kohë). Në fazën e V b tjegullat janë vendosur në mënyrë të çrregullt dhe traversat tërthore kanë seksion rrethor, ndërsa në fazën e V c, tek e cila ashtu si në fazën e V a, tjegullat vendosen në trajtë kluasonazhi, në ndryshim prej saj trarët ven-

33) I. Ivanov, **Bëllgarske starini iz Makedonii,** Sofija, 1931, 554.

34) A. Comn, **Alex.** I, 14, III, 12, VI, 5, X, 8; XII, 9, XIII, 5.

35) A. Baçe – Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Petrelës,** «Monumentet» 5.

36) Tek defteri i vitit 1431-32 (H. Inalçik, **Hiçri 835 Sureti Defter'-i sançak-i Arvanid,** Ankara, 1954, T. 29). përmëndet topçiu Janko, të cilin emri e dëshmon si pjestar të garnizonit paraturk.

37) **Acta Albaniae I,** 255, 258, 261, 295, 299, 322, 323, 326, 330, 352, 355, 356, 366, 385, 403, 407, 415, 425, 441, 443, 454, 463, 464, 480, 491.

DO NOT COPY



Fig. 21

dosen këllëç. Veç kësaj ato diferencohen dhe nga cilësia e llaçit dhe lloji i mbushësit.

Teknikën e sipërme me përdorim të gjërë tjegullash e hasim në kishat e Beratit dhe muret mbrojtëse të Beratit, Elbasanit, Petrelës[38]) dhe Shkodrës, në ato faza që lidhen me ndërtimet pas mesit të shek. XIII, dhe para shek. XIV. Para shek. XIII vërehet vendosja e tjegullave në shtresa horizontale mbi njera tjetrën, ndërsa më vonë në linja të gjata horizontale[39]). Këtë diapazon e mbështesin mjaft mirë tiparet e kullave, të cilat e marrin parasysh praninë e artilerisë (mbushja e pjesës së poshtme tek kullat 6,8, frengjitë e topave tek kulla 1), por në një kohë kur fuqia e saj është ende e vogël, gjë që kuptohet nga faqet vertikale të kullave dhe mospërdorimi i formave poligonale. Fazat e mësipërme, që paraqesin një vazhdimësi në konceptimin dhe zbatimin teknik, i shohim pikërisht si ndërtime të shek. XIV-XV, (të periudhës së vonë bizantine ose pushtimit Serb, të periudhës së principatave feudale dhe ndoshta të fillimeve të pushtimit turk).

Fazën e Va e shohim si më të hershme, pasi e gjejmë në kështjellë në një zonë që nuk i është nënshtruar bombardimeve dhe dëmtimeve, në trakte relativisht të gjatë, të cilat nisin që në bazament. Veç kësaj veçantitë e saj, vendosjen e sheshtë të trarëve dhe vizimin e fugave e gjejmë dhe në kështjellën e Kardhiqit të ndërtuar rreth shek. XIV.[40]).

Faza e V b, diferencohet kronologjikisht nga faza V c, në kullën «8», që gjendet sipër saj. Nga ana tjetër kullat e saj të vogla paraqiten më pak të përshtatura për artileri se ato të fazës së Vc.

Kullën kontrafort 3, të fazës së VI (tab. II, 7) e gjejmë në planimetrinë e Koronelit, pra, ajo është më e hershme se viti 1690. Pajisja e saj me frengji tipike për artileri, të një kohe kur ajo tashmë e ka gjetur vendin e saj, e dëshmon kullën «3» dhe fazën VI C si një ndërtim të shek. XVI-XVII. Nga ana tjetër Çelebiu na bën të ditur se fortifikimi u rindërtua prej sulltan Sulejmanit në një kohë me kalanë e Vlorës, pra, rreth vitit 1530. Me këto rindërtime mendojmë se lidhet dhe faza në shqyrtim, kulla kontrafort e së cilës është mjaft



Fig. 22

38) A. Meksi, **Tri kisha bizantine në Berat,** «Monumentet», 4, 82. A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Beratit»,** «Monumentet», 2 47-51; Gj. Karaiskaj **Kalaja e Elbasanit,** 66-67; A. Baçe, Gj. Karaiskaj, **vep. cit.**

39) Për ndërtimet e shek. XIII shih A. Meksi, **vep. cit.** 82, A. Baçe, **Qyteti.** 47-51; Për ato pas shek. XV. A. Baçe – Gj. Karaiskaj, **vep. cit.**

40) A. Baçe, **Vështrim...,** 122:

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 23



Fig. 24

e ngjashme si nga forma, ashtu dhe përmasat me kullat kontraforte të kalasë së Vlorës[41]).

Ndërtimet e fazës së VII i gjejmë në boshllëqet e shkaktuara nga hedhja në erë e mureve prej venecianëve, kështu ato i shohim në një sërë vendesh ku planimetria e Koronelit shënon kulla. Ky fakt, si dhe teknika e dobët dhe me ngut i daton këto ndërtime në vitet e fundit të shek. XVII, në një kohë kur fortifikimi vazhdon jetën e tij.

Së fundi, rindërtimet e ngushtme i përkasin përpjekjeve të Ibrahim Pashës në shek. e XIX për një ripërdorim të fortifikimit.

PËRFUNDIME

E vetmja qendër qytetare në gjirin e Vlorës deri në shek. IV-III p.e. sonë ishte Oriku[42]). Kjo pamje ndryshon nga fundi i shek. IV, fillimi i shek. III p.e.sonë, kur zhvillimi ekonomiko-shoqëror i Amanties solli si pasojë domosdoshmërinë e tregtisë së rregullt detare[43]). Mendojmë, se pikërisht me këtë nevojë, lidhet dhe themelimi i qytetit në Kaninë. Ky themelim, mjaft i dëmshëm për Orikun nuk do tolerohej në se pas tij nuk do qëndronte njesia e fuqishme amante. Kështu Orikut, thuajse të patokë, i shkëputet hinterlandi (lugina e Lumit të Vlorës), ndoshta duke u bërë shkas për kthimin e tij në një qendër ndërtimi anijesh[44]). Kemi të bëjmë, pra, me një veprimtari të tillë të qyteteve dhe fiseve Ilire, e cila u bie ndeshas interesave të kolonive helene, pa e përfillur reagimin e tyre.

Pushtimi i Ilirisë nga Roma, siç kuptohet tërthorazi nga burimet e shkruara[45]) dhe gjetjet arkeologjike nuk pati për pasojë shkatërrimin e dhunshëm të Kaninës. Për më tepër në shekujt e parë të këtij pushtimi qeramika e zbuluar, tregon për një farë gjallërimi të jetës, me sa duket, si pasojë e lulëzimit ekonomik të Amanties[46]).

41) A. Baçe, **Kalaja e Vlorës.**
42) Scyl. 26 Herod, IX, 93, Scymn, V 44; Scyl 22, 27.
43) S. Anamali ve në dukje fillimin e tregtisë me Apulien që në shek. III, **vep. cit.,** 117.
44) Këtë e argumenton në mënyrë bindëse H. Ceka **(Probleme...** 87, 88), por mendojmë se në fillim ndërtimi i anijeve ka pasur një rol të dorës së dytë, krahas tregëtisë.
45) Liv. XLIV 30, 10. Plin. **N. H.** IV, 10.
46) H. Ceka, **Probleme...** 78, V. 82, S. Anamali, **vep. cit.,** 119.

DO NOT COPY



Fig. 25

Me vendosjen e pushtetit të plotë romak në shekullin e parë Kanina, për hir të qetësisë relative dhe pozicionit të saj të lartë e të lodhshëm për komunikim, e humbet rolin ekonomik, kështu që jeta në të shuhet gradualisht. Rol ushtarak përgjatë kësaj kohe vazhdon të luajë vetëm Orikumi. Veçanërisht kjo kuptohet nga operacionet e Cezarit, ndërsa Kanina nuk përmëndet.

Siç kuptohet, nga lista e qyteteve dhe peshkopatave në periudhën e vonë antike, rajoni i Vlorës kishte një shtrirje në gjirin e Vlorës dhe luginën e Lumit të Vlorës[47]). Pikën qëndrore të këtij territori e ze Kanina, e cila siç e pamë, ishte pika e vetme ku zona e Lumit të Vlorës lidhej me atë bregdetare. Nga ana tjetër, në këtë periudhë hiqet dorë nga qytetet e mëdhenj (kategoria e Apollonisë, Jermës etj.), pasi rrethimi i tyre do kërkonte mund dhe kohë të gjatë në një periudhë kur kjo e fundit ishte mjaft e kufizuar, dhe më kryesorja, se ato nuk mund ti mbronte kush, pasi popullata qytetare ishte reduktuar së tepërmi[48]). Si pasojë kapen qytetet me mbrojtje të favorshme natyrale. Kështu Kanina 3,6 hektarëshe, e destinuar për një rol ndihmës në antikitet, në këtë kohë del në plan të parë, pasi si nga pozita qëndrore, ashtu dhe nga madhësia dhe mbrojtja natyrale, ajo i përgjigjej mjaft mirë kërkesave të kësaj periudhe. Mungesa thuajse



Fig. 26

47) Hierocl, 651-653, Rav. IV 5, V 13 **Not. Episc.** III 615-697, V 458, 519-583.

48) Mjaft karakteristik në këtë drejtim është rasti i Bylisit, ku fortifikimi i ri kap vetëm 1/3 e fortifikimit të vjetër. Përjashtim bën vetëm Durrësi dhe qyteti në Grazhdan.

e plotë e qeramikës së shek. I-VI, tregon se këtu kemi të bëjmë me një themelim të ri, ndonëse mbi një truallI të vjetër dhe jo me fortifikimin e një qendre me vazhdimësi jetike. Rëndësinë e kësaj qendre e kuptojmë dhe nga punimi i mureve të saj me muraturë të rregullt, me teknikën «opus mixtum», një çfaqje që s'e kemi hasur në fortifikimet e tjerë malorë.

Me sa duket në këtë kohë lind dhe simbioza, e cila shfaqet më qartë në mesjetën e mesme, ndërmjet Kaninës, qendër administrativo-ushtarake, dhe Aulonës, qendër tregtare, e cila në shek. VI del si qytet e skelë[49]).

Siç kuptohet nga dokumentat e shumtë, në mesjetën e mesme qendra administrative dhe ushtarake e gjirit të Vlorës mbetet në Kaninë, ndërsa qendra tregtare në Aulonë. Ky dualizëm shpjegohet me faktin se asnjera prej tyre nuk i përmbushte kërkesat për të qenë qendër unike (si p.sh. Durrësi). Kështu Aulona në një nyje rrugore buzës së detit, ka kushte më të mira për tregti, e cila shoqërohet me zhvillimin e zejtarisë. Kanina, qytet tipik mesjetar, ka mbrojtje të mirë natyrale dhe mundësi më të mirë për kontrollin ushtarak dhe administrativ. Vemë në dukje se Kanina në rregjistrin e vitit 1431-2 del si qytet më i madh i Shqipërisë, me 237 shtëpi dhe me një treg të zhvilluar[50]).

Rolin ekonomik Kanina e humbet nga shek. XVI--XVII, që kuptohet nga e dhëna e Çelebiut se varoshi kishte 300 shtëpi[51]) shifër që mbetet shumë mbrapa qyteteve të tjerë të Shqipërisë, më të vegjël se ajo në vitin 1431-2. Në këta shekuj ajo filloi të humbasë dhe një pjesë të rëndësisë ushtarake, duke shërbyer vetëm si një dublim për mbrojtjen e Vlorës, tashmë të pajisur me kalanë e saj.[52])

DO NOT COPY

49) Proc., **Bell. Goth.** I, 12, 24.
50) H. Inalçik, **vep. cit.**, H. 75.
51) E. Çelebi, **vep. cit.**, 703.
52) A. Baçe, **Kalaja e Vlorës.**

TAB. I



DO NOT COPY

TAB II

















DO NOT COPY



1



2



3



4



5



6



7



8



9



10



11



12



13



14



15



DO NOT COPY

















DO NOT COPY



DO NOT COPY

Apollon BAÇE

LA VILLE FORTIFIEE DE KANINË

RESUME

Kaninë, grâce à sa position favorable, facilitait la communication entre le bassin du fleuve de Vlorë et le littoral. La cité fortifiée se dresse sur une colline flyscheuse haute de 379 m, au centre même d'une zone propice à l'agriculture et à l'élevage, d'une position économique et stratégique favorable (fig. 1, 2).

Les murs de la cité fortifiée, qui se dresse conformément aux courbes de profondeur de la partie supérieure de la colline, ceignent une surface de 3,6 ha (tab. 1). Les traces «in situ» des murs antiques montrent clairement que le mur moyenageux a fidèlement suivi le contour du rempart antique (fig. 3). Les blocs de pierre du mur sont à angle droit et s'écartent rarement très peu de la forme d'un trapèze régulier (tab. II, 1, fig. 5-9). Nous avons donc affaire à un mur en blocs quadratiques, dont le parement est aplani. La hauteur de presque tous les blocs réutilisés (45 cm environ), laisse supposer que nous sommes en présence d'un mur isodimique. En témoignent les murs d'enceinte d'Apollonie, Dorez, Irmaj, Melan, Cerje et de Lekel, constructions attribuées au début de IIIe siècle ou à la fin du IVe.

Une technique différente de celle examinée jusqu'ici concerne la tour 1, qui a été reconstruite avec les blocs anciens (fig. 11). Les blocs de forme quadratique régulière sont de hauteur égale (29 cm) et leur face extérieure est entourée d'une bordure gravée. Ces blocs appartenaient à quelque édifice monumental et nous n'avons pas affaire à une deuxième phase de construction. Typologiquement ces murs sont identiques aux murs de terrassement rencontrés à Apollonie.

En ce qui concerne la céramique découverte à Kaninë, les amphores, les plats, les gobelets, les tuiles et les solènes, elles est attribuée à une période allant du IIIe siècle avant notre ère au Ier siècle de notre ère (tab. III, IV, V 1-10). En ce qui concerne la localisation de Kaninë, Beaumont et d'autres rangent Kaninë parmi les trois centres antiques comprenant entre autres Thronion. Cette affirmation est rejetée par la position même de Kaninë et par les données concrètes. Le matérial le plus ancien archéologique mis au jour ne va pas au-delà du début du IIIe siècle ou tout au plus de la fin du IVe siècle. Cette datation répond à la technique de construction des murs.

Ptolémée mentionne dans le golfe de Vlorë, Orik, Amantie, Byllis et Aulone et plus loin une Amantie interne. Les coordonées de l'Amantie côtière coïncident on ne peut mieux avec celles de Kaninë. Sa position, conditionnée par sa liaison à la fois avec la mer, dans une zone propice à l'accostage des navires et avec l'hinterland d'Amantie (le bassin du fleuve de Vlorë) indique que nous avons affaire à la cité d'Amantie littorale. L'essor de l'Amantie interne aux IVe-IIIe siècles et sa transformation en un des centres les plus importants du bas Adriatique exigeait la présence d'un centre à proximité de la mer pour faciliter les opérations commerciales maritimes. Et ce centre, à notre avis, n'est autre que Kaninë.

A la suite des sondages effectués dans les murs d'enceinte de Kaninë, nous avons mis au jour deux tronçons de mur larges de 2 m. et construits selon la technique de l'«opus mixtum» (tab. II, 3)

DO NOT COPY

DO NOT COPY

La bande de pierres, à une distance de 1,10 m. de la base, est alternée par une bande de 6 rangées de briques ayant une largeur de 61 – 63 cm. avec des joints qui sont plus épais que les briques elles-mêmes (6,5 contre, 4,5 cm). Les briques bien cuites sont légèrement en tronc de pyramide (33,5 x 37 x 4,5, 32 x 35 x 4,5). Leur épaisseur également n'est pas uniforme (4 – 4,5 cm, au milieu et 5,5 cm. sur les côtés (fig. 12).

Les fragments de la céramique datent le VIe siècle (tab. V 11-15) ce qui est également appuyé par la muraille à «opus mixtum» caractérisée par des joints épais. Un «terminus ante quem» nous est également fourni par le folis frappé à Nicomédie, à la XVIIe année du règne de Justinien.

L'identification de la cité de Kaninë, à notre sens, peut-être faite sur la base des listes de Procope. Parmi les diverses fortifications construites en Epire il mentionne, entre autres, une s'appelant Kionin.

LA PERIODE MOYENAGEUSE

Bien que les murs d'enceinte de la cité fortifiée de Kaninë suivent le tracé de la période antique, la forme et l'aspect que nous lui connaissons aujourd'hui, elle les a empruntées au moyen âge (tab. 1, fig. 13). Des tours construites en vue de renforcer les murs extérieurs de fortifications, longs de 986 m., nous en avons hérité seulement 7. Selon la planimétrie dressée par Coronelli (fig. 14), qui, à notre avis, est assez exacte, il apparait que les courtines étaient renforcées par 14 tours. Leur disparition doit être attribuée tout d'abord aux Vénitiens qui les ont fait sauter en l'an 1690 et aux réparations pressantes effectuées par les Turcs, qui se sont bornés à remédier les dégâts causés par l'explosion. Les observations faites sur place ont montré que précisément dans les points marqués sur la planimétrie se trouvent 7 autres tours.

La disposition des tours n'est pas uniforme. Une telle chose s'explique par le fait que la configuration du terrain favorise de plus l'attaque éventuelle de l'ennemi du côté E et SO.

Des murs transversaux, selon I.G. Hahn, séparent la fortification en trois parties. Aujourd'hui la seule citadelle est conservée, quant aux traces de l'autre division elles ne sont plus visibles. La citadelle s'étend sur une surface de 0,48 ha dans la partie occidentale de la fortification, qui s'élève au-dessus de l'autre partie de l'enceinte. Un autre mur doté d'une porte, que l'ont peut observer dans un croquis turc anonyme (fig. 16), coupait en deux la surface de la forteresse. Cette séparation est, à ce qu'il semble, postérieure à l'an 1690.

Les entrées étaient, d'après Celebi, au nombre de quatre. Une seule d'entre elles, celle méridionale, à proximité de la forteresse, a été conservée jusqu'à nos jours (fig. 17). Une autre entrée, aménagée à l'E du côté méridional, a été mis au jour après le nettoyage de la terre, qui la couvrait. En ce qui concerne l'entrée septentrionale, son existence est témoignée, en dehors de l'esquisse, par la présence de la route qui s'approche du mur d'enceinte.

Les constructions édifiées à l'intérieur de l'enceinte sont représentées, selon Celebi, par 300 maisons en pierre, chiffre exagéré comme d'habitude, par le palais du Gazi Sinan Pacha et par la mosquée du sultan Mehmet.

L'approvisionnement en eau de la ville fortifiée était principalement assuré par des citernes. Parmi ces citernes la citerne «IV» (tab. I) est de forme cylindrique et recouverte par une coupole. Son diamètre et sa hauteur sont respectivement de 4,5 m et de 12 m. Ses murs et sa coupole sont en pierres liées avec mortier très résistant de chaux; les travaux d'isolation ont été de même réalisés avec du mortier mélangé à de la poussière de briques. Quant à la citerne «VI» de la forteresse, elle se caractérise par une planimétrie à angle droit et est recouverte par une voûte cylindrique. Du point de vue de la construction elle est identique à celle de la citerne «IV». Leur maçonnerie et leur forme relativement

DO NOT COPY

régulières indiquent qu'elles ont été probablement construites pendant le XIIIe siècle, date à laquelle elles sont mentionnées dans les privilèges d'Andronic II.

Le diplôme conféré par Vasil II à l'épiscopat d'Ohri témoigne de l'existence de Kaninë en tant que cité dès le Xe siècle. Par ailleurs l'important rôle qu'elle a joué lors des batailles qui ont opposé Normands et Byzantins au XIe siècle ne peut être expliqué que par la présence d'une cité fortifiée. C'est à cette période (le haut moyen âge et le début du moyen âge proprement dit que se rattachent, à notre avis, les travaux de construction de la IIIe phase (tab. II, 3). Nous avons opté sous toute réserve pour cette datation, en raison du fait que les travaux effectués pendant cette phase ont été directement réalisés, sans aucune phase intermédiaire, sur les anciens murs en employant la céramique ancienne. Par ailleurs, la technique de construction également s'exprime en faveur de notre thèse.

Au XIIIe siècle Kaninë redevient une place forte des féodaux angevins, qui s'en servent pour porter à terme leurs efforts tendant à s'infiltrer dans l'hinterland albanais. Les murs de la IVe phase (tab. II, 4) traduisent un travail quelque peu plus soigné par rapport à celui des phases successives, cela étant dû aussi à l'absence de l'artillerie. L'absence de la technique des tuiles disposées horizontalement, qui caractérise le XII-XIIIe siècle, la possession de cette fortification pendant longtemps par les Angevins ainsi que l'envoi d'ingénieurs militaires pour sa réparation sont autant d'éléments qui nous poussent à penser que la IVe phase correspond à la période de l'occupation angevine.

Les phases Va, Vb, Vc (tab. II, 5, 6) ont comme caractéristique commune l'introduction irrégulière de tuiles parmi les pierres ou le cloisonnage déformé. Mais ces diverses phases se différencient l'une de l'autre. Ainsi pendant la phase Va les poutres des bandes sont disposées à plat et la maçonnerie est nivelée à chaque 1,8-2 m de hauteur. Pendant la phase Vb les tuiles sont disposées irrégulièrement et les poutres transversales ont une section ronde, tandis que pendant la phase V, identique à celle Va quant à la disposition des tuiles en cloisonnage, on relève une différence en ce qui concerne la disposition oblique des poutres. Ces trois phases se différencient également les unes des autres quant à la qualité du mortier et au choix du liant utilisé. Cette technique consistant à employer une grande quantité de tuiles, se retrouve dans les églises de Berat et dans les murs d'enceinte de Berat, d'Elbasan, de Petrelë et de Shkodër et se rattache aux phases de construction réalisées pendant la seconde moitié du XIIIe siècle et antérieurement au XVIe. En effet, le XIIIe siècle se caractérise par la disposition des tuiles en couches horizontales superposées, technique qui plus tard est substituée par celle des tuiles disposées en longues rangées horizontales. En témoignent les traits des tours, qui prennent en considération l'existence de l'artillerie (le remplissage de la partie inférieure dans les tours 6 et 8, les meurtrières à canon dans la tour 1 (fig. 10) en un temps où sa puissance est encore réduite, ce qui est confirmé par l'absence des formes polygonales. Les phases susmentionnées, qui représentent une continuité aussi bien dans leur conception, que dans leur mise en oeuvre, sont, à notre avis, des constructions appartenant aux XIVe—XVe siècles.

La tour 3 à contrefort de la VIe phase de construction figure dans la planimétrie de Coronelli, donc elle est antérieure à l'an 1690 (tab. II, 7). Le fait qu'elle soit garnie de meurtrières typiques à l'artillerie, témoigne que la tour «3» et la phase VIe sont des constructions relevant des XVIe—XVIIe siècles. Celebi nous informe par ailleurs que cette fortification a été reconstruite par le sultan Soliman en même temps que la forteresse de Vlorë, soit en l'an 1530. C'est à ces travaux de reconstruction que se rattache aussi, à notre avis, la phase en examen, dont la tour à contrefort ressemble beaucoup quant à ses dimensions aux tours-contreforts de la forteresse détruite de Vlorë.

Les constructions de la phase VII concernent les espaces vides créées par l'explosion des Vénitiens, qui avaient fait sauter les murs de la forteresse, aussi les retrouvons-nous en plusieurs points de la planimétrie de Coronelli, où figuraient auparavant des tours.

Enfin la phase VIII se rattache aux efforts déployés par Ibrahim Pacha au XIXe siècle pour terminer cette fortification.

* * *

A nous en tenir aux nombreuses sources écrites, il ressort que Kaninë continue d'être le centre administratif et militaire du Golfe de Vlore, tandis qu'Aulone son centre commercial. Ce dualisme s'explique par le fait qu'aucune d'elles n'était en mesure de satisfaire les exigences requises pour devenir un centre unique (comme c'est le cas par exemple de Durrës). Ainsi Aulone, située à un embranchement de routes à proximité de la côte, présente de meilleures conditions pour le commerce, ce qui entraîne l'essor de l'artisanat; quant à Kaninë, cité typique moyenâgeuse, elle est mieux protégée par la nature et offre de plus grandes possibilités en ce qui concerne le contrôle militaire et administratif. Notons qu'à l'occasion du recensement de l'an 1431-2 Kaninë résulte être la plus grande ville d'Albanie, avec 237 maisons et un marché en plein essor.

Kanine perd de son importance économique pendant les XVIe–XVIIe siècles, ce qui ressort des données fournies par Celebi selon lesquelles Varosh n'avait que 300 maisons, chiffre qui est cependant de beaucoup inférieur à celui des plus petites villes d'Albanie par rapport au recensement de l'an 1431-2. C'est au cours de cette période qu'elle perd en partie son rôle militaire aussi, car Vlorë possède désormais sa propre forteresse.

DO NOT COPY

Burhan DAUTAJ

NJË RRUGË KRYESORE NË APOLLONI

DO NOT COPY

Zbulimi në Apolloni i një tok monumentesh të karakterit shoqëror: portiku me nikje, odeoni, buleterioni apo i ashtuquajturi monument i Agonotetëve[1]), nimfeu etj.[2]), dëshmon për aplikimin në këto vepra të një arti dhe stili arkitektural mjaft të përparuar. Kërkimet dhe gërmimet e pasçlirimit në Apolloni hedhin dritë edhe mbi aspekte të ndryshme të urbanistikës së qytetit, të cilat më parë kanë qënë të panjohura për arkeologjinë tonë. Si rezultat i këtyre gërmimeve janë përfituar një sërë të dhënash mbi urbanistikën apolloniate, që ndihmojnë të njihemi sadopak me sistemin e rrjetit rrugor dhe të blloqeve të banesave për rajone të ndryshme të qytetit. Gërmimet e viteve 1958-1960 në Apolloni të ndërmarra në anën veriperëndimore të qytetit[3] mbi një tarracë të sheshtë e të gjërë (sektorët D, D_1 e D_2) që ndodhet në krah të majtë të rrugës automobilistike Pojan—Muze Arkeologjik, nxuarën në pah trakte të dy rrugëve paralele dhe konstruksionet e një godine romake të përfshirë midis këtyre dy trakteve (tab. I). Rrugët ndodhen rreth 60 m. larg njëra-tjetrës. Gjërësia për të dy rrugët lëviz nga 5.95-6,30 m. Për së gjati, nga të dy anët e rrugëve, kalonin kuneta të shtruara me rrasa të mëdha guri gëlqeror. Traseja e mbushur me zhavor të imtë lumi ka gjërësi të njëllojtë (4.20-4.40 m) për të dy rrugët.

Dy trakte të tjerë rrugorë janë ndeshur gjatë gërmimeve për zbulimin e qendrës së qytetit. Trakti i parë,[4] fillon në sheshin përpara odeonit, përbri murit lindor të buleterionit dhe ndjek drejtimin për nga godinat e Muzeut-Arkeologjik. Nga kjo rrugë origjinale është ruajtur vetëm traseja[5]). Trakti i dytë, i zbuluar në vitet 1959-1960, kryqëzohet me të parin në sheshin përpara monumentit të Agonotetëve[6]). Gjërësia e rrugës së bashku me kunetat në të dy krahët e traktit të zbuluar nuk është kudo e njëllojtë dhe lëviz nga 7.40-8.30 m[7]).

Gërmimet në një tarracë tjetër të madhe që shtri-

1) Për rezultatet e gërmimeve të paraçlirimit shih L. Rey, «Albania», II, Paris 1927, «Albania», III (1928); «Albania», V (1935) dhe «Albania», VI (1939).
2) H. Ceka, **Fontana e Apollonisë,** Konferenca II e studimeve Albanologjike, II, Tiranë 1969, 219-243.
3) Raporte të gërmimeve në Apolloni 1958-1960 (Sektorët D, D_1 e D_2), material i pabotuar që ruhet në arshivën e sektorit të Arkeologjisë pranë Institutit të Historisë.
4) Ky trakt rrugor i zbuluar së bashku me monumentin e Agonotetëve dhe me krahun jugor të portikut me nike nuk përmendet në botimet nga L. Rei. Për këtë shih H. Ceka, **Mbi historikun e kërkimeve dhe gërmimeve arkeologjike në Apolloni.** BSHSH, 4, 1958, 213-257.
5) Trotuaret e gurta në të dy anët e trases nuk kanë të bëjnë me fazën fillestare të ndërtimit të kësaj rruge, por me një periudhë më të vonë të përdorimit të saj. Këtë e vërteton më së miri materiali dhe teknika e punimit të rrasave të gurta, që është i njëjtë me atë të përdorur në kunetat e rrugëve të tjera. Rrasat e gurta të përdorura për së dyti në ngritjen e trotuareve, me sa duket, janë po ato që dikur vishnin kunetat e kësaj rruge. Me kalimin e kohës këto të fundit kanë dalë jashtë përdorimit dhe gurët e nxjerrë janë përdorur për shtruarjen e dy trotuareve në funksion të monumentit të Agonotetëve si dhe të ambienteve (dyqaneve) në anën tjetër të rrugës të datuara në shek. II-III-të e.sonë.
6) Raport mbi rezultatet e gërmimeve në Apolloni 1959-1960 (sektorët J e M).
7) Vetëm traseja ruan pothuajse gjërësi të njëllojtë dhe të barabartë me atë të traseve në rrugët e zbuluara në sektorët D, D_1 e D_2. —



Fig. 1

DO NOT COPY

het në krah të djathtë të rrugës Pojan—Muze Arkeologjik, në perëndim të sektorëve D, D_1 e D_2 (sektorët H e D_3) (fig. 1)[8], nxuarën në dritë trakte të dy rrugëve, të cilat, me sa duket, ndërpresin në kënd të drejtë njëra-tjetrën. Tarraca formohej nga një platformë e gjërë, që zbret në anën veriperëndimore të saj me faqe disi të pjerrëta. Gërmimet u shtrinë në sipërfaqe 1100 m^2 [9]). Gërmimi në sektorin H, vetëm pjesërisht, (në qoshen veriore të tij) shkoi deri në tabanin prej dheu subargjilor, të verdhë në gri, përzier me një sasi të konsiderueshme zhavorri. Mbi këtë të fundit ngrihet rruga me të gjitha mbeturinat e tjera antike.

Rruga e përbërë nga traseja dhe dy kuneta që shtrihen për së gjati, në të dy anët e saj, zinte pjesën më të madhe të sipërfaqes së gërmuar (tab. II a). Nga arteriet kryesore të qytetit të zbuluara deri sot në Apolloni ajo formon dhe traktin më të plotë me gjatësi 88 m. Gjërësia e rrugës, së bashku me të dy

8) Fotografia është bërë gjatë proçesit të punës, kur gërmimet ende s'kishin përfunduar. Plotësimet me vija të bardha janë bërë duke u mbështetur në të dhënat e përfituara mbas mbarimit të gërmimeve.

9) Këtu përfshihet edhe një sondazh gërmimi (sektori H2) me sipërfaqe 75 m^2, që shtrihet me në perëndim të sektorit H (tab. II). Largësia midis dy sektorëve në sheshin e pagërmuar është 31.5 m. Nga gërmimi rezultoi se rruga, edhe në këtë pjesë të saj, ruante po atë pendencë e drejtim që kishte dhe trakti rrugor në sektorin H, kështu që dyshimet tona për një shkallëzim të rrugës nuk u vërtetuan. Thepisja për nënbuzën e tarracës nuk kishte lidhje me rrugën, por ka qenë formuar në kohë më të reja, si rezultat i punimeve të ndryshme bujqësore.

vijat e ujit nuk është kudo e njëllojtë dhe lëviz nga 6 m. pranë skajit lindor të gërmimit në 6.20 m. në anën tjetër të tij.

Monumenti, me pak përjashtim, ishte ruajtur në gjendje deri-diku të mirë. Kruga ruante në përgjithësi pamjen që ka patur në antikitet. Dëmtimet në disa pika të traktit rrugor (fig. 2) vijnë si rezultat i ndërtimeve dhe punimeve të ndërmarra në periudha kohe të ndryshme. I tillë ka qënë ndërtimi i një kanali me tulla romake, që ka shkaterruar një pjesë të konsiderueshme të kunetës në anën veriore të rrugës. Ngritja e një godine mesjetare mbi sipërfaqe të rrugës, në pjesën perëndimore të gërmimit, ka shkatërruar disa pjesë të trasesë dhe të kunetave. Dhe, së fundi, çelja e disa transheve, gjurmë nga lufta e fundit botërore, ka prekur kryq e tërthor pjesë të tëra të sipërtaqes së rrugës.

Në gjendje shumë të keqe paraqitej trakti i shkurtër i kësaj rruge me gjatësi 10 m. i zbuluar në sektorin H2, nga i cili ruhesnin vetëm shtroja me njerën nga faqet anësore të kunetës veriore.

Kruga, së bashku me një tok godinash të ngritura pranë saj, formonte në antikitet një ansambël të bukur urbanistik. Pjesën kryesore të rrugës e zë traseja e ngritur direkt mbi tabanin subargjilor. Traseja është e mbushur nga një shtresë e ngjeshur zhavorri, me zaje të vegjël lumi dhe përzier me mbeturina qeramike, kryesisht copa tulle dhe tjegullash helenistike. Nga disa sondazhe të kryera në pika të ndryshme të rrugës, rezultoi se trashësia e trasesë ishte pothuajse kudo e njëllojtë (0.60 m.), kurse gjërësia e saj, (pa përfshirë kunetat) lëviz nga 3.20--3.55 m.

Pranë skajit perëndimor të gërmimit traseja i ka qenë nënshtruar një meremetimi në një sipërfaqe 4,50 m², duke e plotësuar me një shtresë të përbërë nga copa tulla e tjegullash helenistike të vendosura horizontalisht në një nivel me sipërfaqen tjetër të rrugës (fig. 3).

Traseja në të gjithë gjatësin e traktit të zbuluar, përshkohej për së gjëri nga një sërë pritash, që kanë patur si qëllim të pengonin gërryerjen e trases dhe shpëlarjen e zhavorit nga reshjet. Gjithësejt u zbuluan 24 prita, nga të cilat vetëm dhjetë ishin të ruajtura plotësisht. Çdo pritë formohej nga një rresht gurësh (4-6 blloqe) gëlqerore në madhësi mesatare, paksa të punuar nga faqja e dukshme e tyre dhe të puthitur njeri pranë tjetrit. Blloqet, për të qenë sa më të qëndrueshëm, janë futur thellë në tokë, duke dalë mbi sipërfaqe të rrugës vetëm me faqet e sheshta të tyre (tab. II a prerja 1-1). Nga pjesa e dukshme e gurëve faqja lindore e tyre ruante një disnivel paksa të theksuar me sipërfaqen e rrugës, duke formuar kështu një pritëz që ngadalësonte rrjedhjen me rrëmbim të ujrave dhe pengonte shpëlarjen e zhavorrit.

Pritat janë vendosur në largësi të ndryshme nga njëra-tjetra. Largësia midis tyre ndryshon në mënyrë graduale dhe rritet duke shkuar nga lindja në perëndim, në përputhje me zvogëlimin e këndit të pjerrësisë së rrugës.[10]) Me një shkallëzim të tillë të pritave mjeshtërit apolloniatë ja kanë arritur më së miri qëllimit për të evituar, deridiku, pjerrësinë natyrale të terrenit dhe të krijojnë një sipërtaqe sa më të sheshtë të rrugës.

Në përbërjen e rrugës përfshihen dhe kunetat, Qëllimi i ndërtimit të tyre ka qenë mbledhja e ujit të shiut që rridhte nga strehët e godinave, apo që grumbullohej mbi siperfaqe të rrugës dhe përcjellja e tyre jashtë mureve rrethuese të qytetit. Të dy kunetat kanë formën e govatës me prerje të një trapezi të rregullt me bazë brinjën më të vogël të tij. Kunetat janë ndërtuar me rrasa të mëdha guri gëlqeror, aty--këtu dhe shtufi, të punuara në formë katërkëndëshi ose trapezoidale. Rrasat anësore janë shumë më të mëdha nga ato të përdorura për shtroje. Ato janë puthitur mirë me njëra-tjetrën, me buzë paksa të ngritura mbi sipërfaqe të trasesë. Gjërësia nga buza në buzë, për të dy kunetat është e njëllojtë 1.45 m., kurse e fundit 0.35 m. Thellësia e kunetave nuk i kalon 0.20 m. Në të dy kunetat vihen re disa meremetime e ndërtime, të cilat ashtu si edhe tek traseja lidhen me periudha të ndryshme kohe.

Kuneta në krahun jugor të rrugës i ishte nënshtruar në gjatësi 2.45 m. një meremetimi me material të ripërdorur. Trakti i restauruar nga forma dhe përmasat ndryshonte në të gjithë pjesën tjetër të kunetave të zbuluara në sektorin H (fig. 4); prerja trapezoidale i ka lëshuar tani vendin asaj të një trekëndëshi barabrinjës me kulm poshtë. Si materjal ndërtimi janë ripërdorur rrasat e shpateve anësore. Blloqet e shtrojës janë hequr dhe, në të njëjtën kohë, është kryer afrimi dhe puthitja e plotë nga fundi i rrasave të shpateve anësore të kunetës. Në këtë mënyrë gjerësia në traktin e restauruar u ngushtua në 1 m., kurse thellësia në 0.11 m. Një konstruksion të tillë ndërtimi, formë dhe përmasa të njëllojta kanë të gjitha kunetat në traktet e rrugëve të zbuluara në sektorët D, D_1 e D_2.

10) Sa më i pjerrët vinte terreni aq më e afërt bëhej distanca midis pritave dhe, anasjelltas, kur sipërfaqja e rrugës paraqitet e sheshtë edhe largësia midis pritave është më e madhe. Kështu largësia midis pritave (duke filluar nga lindja) 2 dhe 3 është 2.63 m, 7 dhe 8 është 2.83 m., 11-12 = 3.05 m; 16 dhe 17 = 3.30 m, 23 – 24 = 3.55 m, etj.

DOKTORI

Pranë qoshes perëndimore të gërmimit, mbi kunetën jugore të rrugës, u zbulua ureza prej guri (fig. 5) me gjatësi 1.15 m ane lartësi 0,50 m.

Për ngritjen e urës janë përdorur 12 blloqe guri gëlqeror[11]) në madhësi mesatare. Ata janë vendosur për së gjati vijës jugore në katër rreshta (me gjërësi 2.85 m). Secili rresnt përbëhet prej tre blloqesh të vendosur në formë qemeri mbi kunetë. Hapësira cilindrike ka diametër 0.30 m. Blloqet e mesit, që përbëjnë kyçin e qemerit kanë përmasa më të vogla se ata anësorë. Për një mbajtje të sigurtë të tyre në blloqet anësore janë gdhendur shkallëzime. Nga ura më me kujdes është punuar faqja ballore që i është ekspozuar qendrës së qytetit. Përbri urës, mbi traktin e restauruar të trasesë, u zbulua «in situ» një bllok i madh guri, i cili shërbente si shkallë për të lentësuar kalimin mbi urë dhe, nëpërmjet saj, për në ambientet në anë të rrugës. Këto konstatime lënë shkas të mendosh, se ura së bashku me traktin e restauruar të trasesë janë të njëkohëshëm dhe i përkasin një periudhe ndërtimi, që lidhet me ambientet përballë tyre në krahun jugor të rrugës.

Krejt ndryshe paraqitet gjendja në kunetën veriore ku ndërtimet kanë shkatërruar plotësisht një pjesë të konsiderueshme të saj. Duke filluar nga qoshja lindore e gërmimit për nga perëndimi, në gjatësi 33 m., rrasat e gurta të kunetës janë hequr nga ndërtimi i kanalit me tulla të plota romake (fig. 6). Pjesa më e madhe e rrasave të hequr nga kuneta janë përdorur për së dyti si material ndërtimi në banesat romake të ngritura përbri në anën veriore të rrugës, kurse një pjesë e vogël e tyre u gjet e shpërndarë gjatë buzës së kanalit. Sigurisht që ndërtimi i kanalit së bashku me ambientet në krahun verior të rrugës lidhen me një periudhë më të vonë, kur kunetat kishin dalë jashtë përdorimit. Në këtë vështrim studimi i traktit të zbuluar të kanalit me tulla të plota romake paraqet interes për datimin e rrugës sonë.

Kanali me tulla ndiqte pak a shumë drejtimin e kunetës veriore. Përjashtim bënte në këtë drejtim skaji perëndimor i kanalit, i cili duke marë një kthesë në kënd të drejtë nga veriu, futej thellë nën mbeturinat e konstruksioneve të vona romake (fig. 7). Një pjesë e konsiderueshme e kanalit me tulla kishte përfund rrasat e shtrojës të kunetës veriore.[12]) Pjesa tjetër e



Fig. 2

fundit të kanalit, duke qenë se shkonte shumë thellë nën sipërfaqen e rrugës[13]) ishte shtruar me copa tulle e tjegulle helenistike e romake të lidhura me llaç gëlqere. Po me këtë material të rëndomtë ishin ngritur edhe faqet anësore të kanalit.

Gjerësia e kanalit me tulla ishte e barabartë me atë të shtrojës së kunetave, kurse thellësia nga fundi nuk i kalonte 0.30 m. (tab. II a, prerja 2-2). Për mbulesë të kanalit kishin përdorur tulla të plota romake (0.39 x 0.24 x 0,06; 0.41 x 0.28 x 0.06, 0.44 x x 0.06 m.) të puthitura mirë me njëra-tjetrën. Vetëm skaji lindor i kanalit, pikërisht aty ku mendohet për një kryqëzim të rrugës sonë me atë të zbuluar në sektorin D_3, ishte mbuluar jo me tulla, por me rrasa të mëdha guri. Ato ishin të vendosura horizontalisht për së gjëri kanalit dhe ngriheshin rreth 0.25 m. nga sipërfaqja e rrugës në fazën fillestare të ndërtimit të saj. Një disnivel pak a shumë të tillë ruante edhe pjesa më e madhe e mbulesës së kanalit. Rrasa guri qenë përdorur si mbulesë kanali edhe në pragjet e hyrjeve në banesat e ngritura për anë rrugës nga ana veriore e saj. Ndërtimi i kanalit me tulla sigurisht që ka të bëjë me ngritjen e këtij të fundit në një kohë kur të dy vijat ujore kishin pushuar së funksionuari dhe sipërfaqja e rrugës mbulohej nga një shtresë re-

11) Një nga gurët e rreshtit të mesit mungonte dhe si rrjedhim në qendër të urës, nga sipër, ishte çelur një boshllëk.

12) Gjatë çeljes së tij ndërtuesit kanë ndeshur, me sa duket, në konstruksionet e kunetës, nga e cila mbasi kanë hequr rrasat e shpateve anësore kanë ruajtur gurët e shtrojës, për t'i përdorur si fund për kanalin.

13) Kjo pjesë e kanalit zbriste rreth 0.75 m. nën sipërfaqen e rrugës. Ky fakt, si dhe mungesa e lidhjeve të drejtpërdrejta të kanalit me rrugën, presupozon ndërtimin e tij në funksion të ndonjë godine ende të pazbuluar dhe që duhet kërkuar më në lindje, në sheshin e pagërmuar.

lativisht e hollë kulturale. Si përfundim ndërtimi i kanalit me tulla mund të shërbejë tare mirë dhe si **«terminus ante quem»** i ngritjes së rrugës.

Nga përshkrimi rezulton se rruga (me ose pa kuneta) ka vazhduar së funksionuari për disa shekuj me radhë. Përcaktimi i kohës së ngritjes së rrugës, në përgjithësi, paraqitet një çështje mjaft e vështirë. Para se gjitnash vështirësia qenaron në atë që të dhënat stratigrafike, per vete natyrën e përzier të shtresave kulturale, janë të tilla që e bëjnë të vështirë vendosjen e një kronologjie sa më të saktë për rrugën dhe monumentet e tjera përbri saj. Kjo bëhet me e theksuar sidomos për periudhat më të hershme të ndërtimeve antike në këtë pjesë të qytetit. Përzierja e shtresave kulturale në gërmimin tonë ka ardhur si pasojë e veprimit të shumë faktorëve. Ngritja e rrugës drejtpërdrejt mbi tabanin subargjilor ka prekur tërësisht shtresat kulturale më të hershme. Gjithashtu spastrimet dhe shplarjet e herëshme të bëra me kalimin e kohës, sigurisht që kanë eliminuar depozitimet kulturale të porsa formuara mbi sipërfaqe të rrugës. Një tregues kuptimplotë është fakti se gjatë spastrimit të sipërfaqes së rrugës, së bashku me tragmente të qeramikës korintike, u gjetën monedha apolloniate të shek. III-II p.e. sonë, objekte e monedha perandorake etj. Më së fundi, zbulimi i një tog rrënojave antike të ngritura në të dy anët e rrugës përfshinin vetëm një pjesë të godinave, fasadat e tyre, kurse zona brënda kthinave u la pothuajse pa u gërmuar. Kështu që mbetën akoma të panjohura të dhënat stratigrafike, që do të përfitoheshin nga gërmimi deri në taban të sipërfaqeve brenda dhe jashtë mureve të kthinave.

Të gjitha godinat e zbuluara në sektorin H, duke filluar nga ato helenistike deri tek banesat e vona romake, ruajnë me rigorozitet drejtimin paralel ose përpendikular me rrugën pa cënuar kështu traditat helenistike të planizimit. Si rezultat i varfërisë me gurë të zonave përreth Apollonisë, në konstruksionet e banesave vihet re një ripërdorim i shpeshtë i materialeve të gurta. Për më tepër mungesa e ndijshme për gurë ka sjellë si pasojë zëvëndësimin e këtij të fundit me tullën. Në këtë mënyrë ajo që përsëritet me gurin në një masë të konsiderueshme shfaqet edhe në konstruksionet me tulla të këtyre banesave. Dhe kjo mund të shpjegohet me nevojën e madhe dhe përdorimin e gjithanshëm të tullave në ndërtim, deri edhe në sistemin e fortifikimit të qytetit. Përdorimi për së dyti i materialeve të gurta dhe i tullave ka shkaktuar jo vetëm dëmtimin, por në një farë shkalle dhe zhdukjen e banesave të njëkohëshme me rrugën. Kjo gjendje krijon një tok vështirësish në studimin kompleks të jetës dhe vazhdimësisë së saj në këtë rajon të qytetit. Megjithatë është e nevojshme



Fig. 3

që disa nga mbeturinat e këtyre banesave t'i trajtojmë për aq sa ato na ndihmojnë për datimin e rrugës pa i vënë vehtes si detyrë studimin me hollësi të tyre.

Paraqesin interes në këtë drejtim mbeturinat e një godine të madhe helenistike (A), që shtrihet përbri rrugës nga ana jugore e saj. Nga godina u zbulua vetëm fasada e saj nga rruga e gjatë 27.94 m. (tab. II, b). Fasada, në një pjesë të konsiderueshme të saj, formohet nga zokolatura me rrasa të mëdha shtufi (1.20 x 0,65 x 0,22 m; 0.80 x 0.70 x 0,30 m). të vendosura në lidhje të thatë mbi një rresht gurësh në madhësi mesatare, pothuajse të papunuar. Rrasat prej shtufi me forma katërkëndëshe dalloheshin për punimin e bukur me rustika, që sillen rrethepërqark faqes së dukshme të tyre. Lartësia e zokolit mbi buzën e vijës ujore jugore nuk ishte kudo e njëllojtë dhe zvogëlohej gradualisht nga lindja në perëndim në përshtatje me pjerrësin natyrale të terrenit. Mbi rrasat prej shtufi, pranë qoshes lindore të godinës, ngrihej një konstruksion muri me tulla të plota helenistike (0,46 x 0.46 x 0.08 m.) të lidhura me shtresë të hollë balte. I ngjashëm me këtë u zbulua edhe një mur tjetër, po me tulla të tilla helenistike, i cili në gërshetim me të parin formonte qoshen e godinës A. Një prag i formuar nga dy rrasa të mëdha guri (fig. 6) ka shërbyer si e vetmja hyrje nga rruga për në godinën helenistike.

Teknika e ndërtimit të mureve me tulla të plota helenistike, punimi dhe vendosja me kujdes e rrasave prej shtufi dhe e pragut buzë kunetës ujore jugore, duke ruajtur me rigorozitet drejtimin paralel me të dhe në përshtatshmëri të plotë me pjerrësin natyrale të terrenit, të lënë të mendosh për këto

FOTOCOPY



DO NOT COPY

Fig. 4

konstruksione si të njëkohshme me rrugën. Shënojmë se po me tulla të plota helenistike dhe me përmasa të njëllojta me ato të përdorura në godinën A., janë ngritur në Apolloni edhe disa trakte të murit rrethues të qytetit të datuara në shek. III-II p.e.sonë.[14])

Në ndërtimet e periudhave më të vona të tërheq vëmendjen një rresht me blloqe gurësh gëlqerorë të bardhë, të punuar bukur, me forma paralelopipedi (fig. 8), i ngritur mbi gjurmët e godinës helenistike. Mbi sipërfaqe të gurëve ruheshin gjurmë rrethore, me sa duket kolonash, të cilat dëshmojnë për një përdorim të dytë të materialit të ndërtimit në këtë konstruksion. Rreshti me blloqe shtrihej jo drejtpërsëdrejti mbi zokolaturën, por mbi një shtresë të hollë dheu dhe fragmente tjegullash helenistike, që mbulonte krejt rrasat prej shtufi. Nga kjo duket qartë se ndërtimi është bërë në një kohë kur godina helenistike, në një pjesë të konsiderueshme të saj, kishte pushuar së funksionuari. Në këtë kohë rrasat prej shtufi dhe kunetat mbuloheshin nga një shtresë relativisht e hollë depozitimesh kulturale dhe sipërfaqja e rrugës ka qenë ngritur rreth 0.20 m. nga niveli filles-

14) H. Ceka, **Muri rrethues i Apollonisë,** B.SH.SH., 3, 1963, 117-156.

tar. Ngritja e traktit të murit me blloqe në formë paralelopipedi është kryer disi pa kujdes, duke lënë mbas dore traditat helenistike të ndërtimit, sidomos në të paraqiturit bukur të fasadave kryesore. Në përgjithësi një rënie e artit arkitektural në Apolloni vihet re aty nga shek. III e.sonë.[15]

Këto ishin disa nga mbeturinat e godinave të cilat për nga teknika e ndërtimit, materialit të përdorur dhe paraqitjes së fasadave, ndihmojnë përcaktimin me afërsi të moshës së rrugës. Për shfrytëzimin e rrugës në kohën e vonë antike hedhin dritë mbeturinat e konstruksioneve të banesave të zbuluara pranë qoshes jugore të gërmimit. Këto konstruksione lidhen me kohën kur niveli i sipërfaqes së rrugës, si rezultat i depozitimeve shumëshekullore, ka qënë ngritur në mënyrë të konsiderueshme (0.50-1 m. lartësi) nga niveli i saj në periudhën helenistike. Megjithatë duhet thënë se drejtimi i përgjithshëm i rrugës, është ruajtur dhe ndërtesat më të vona janë ngritur mbi gjurmë të godinave më të herëshme, pa cënuar kështu traditën helenistike të planizimit të qytetit. E tillë është fasada nga rruga e një godine (D) e ngritur mbi gjurmë të godinës helenistike (fig. 9). Në muraturë përfshiheshin copa tulle e tjegullash përzier me fragmente arkitektonike dhe gurë të rëndomtë. Për ngritjen e fasadës të kësaj godine është punuar shpejt dhe krejt pakujdes, gjë që vihet re edhe në përdorimin e dobët të llaçit. Gjetja në një nga kthinat e godinës D të monedhave të Arkadit (394-408 e.sonë) shënon dhe fillimet e kësaj periudhe ndërtimi, të fundit në gërmimin tonë. Mbeturinat e konstruksioneve, në qoshen jugore të gërmimit (fig. 4), përcaktojnë qartë kohën kur ka pushuar së funksionuari rruga. Për fasadë të kthinës nga rruga shërbente një mur i ngritur i tëri mbi rrasë të bardhë guri të profiluar (fig. 10). Muret e kthinës të ngritur me material të rëndomtë e fragmente të ndryshme arkitektonike, dalloheshin nga ato të godinës D për përdorimin e bollshëm të llaçit. Të dhënat stratigrafike, të cilat në se nuk dhanë qartë fillimet e rrugës, datojnë shumë mirë periudhën e fundit të përdorimit të saj dhe, në përgjithësi, të ekzistencës së jetës qytetare në këtë rajon të Apollonisë. Në bazë të gjetjeve brenda kthinës të materialeve të vona antike me dy monedha të Justinianit (527-565) kjo kohë është mesi i shek. VI e.sonë.

Duke përmbledhur të dhënat e gërmimeve arkeologjike mund të përcaktojmë këto periudha të funksionimit të rrugës në sektorin H.

Periudha e parë (shek. III-I p.e. sonë) ka të bëjë me ngritjen e rrugës dhe të godinës A, që ka pasur



Fig. 5

për fasadë rrasat prej shtufi dhe murin me tulla të plota helenistike. Fillimet e kësaj periudhe lidhen fare mirë me kohën e përdorimit të tullave të plota (0.46 x 0,46 x 0,08) në traktet e murit rrethues të qytetit të datuar në shek. III p.e.sonë. Kjo periudhë ka vazhduar deri në shkatërrimin e skajit lindor të kunetës jugore me prerje trapezoide dhe restaurimit të saj, me atë të një trekëndëshi dybrinjinjishëm me kulm poshtë, i ngjashëm plotësisht nga forma dhe mënyra e vendosjes të materialit me kunetat në traktet rrugore të zbuluara në sektorët D, D_1 e D_2 dhe të datuara në shek. I, e.sonë.

Periudha e dytë (shek. I—II e.sonë) fillon me ndërtimin e godinave të tjera në krahun jugor të rrugës, të urës me konstruksion guri, dhe kalldrëmit të shtruar me tulla mbi trase, pranë qoshes perëndimore të gërmimit.

Shkatërrimi i kunetës veriore nga ndërtimi i kanalit me tulla të plota romake dhe, ngritja e sipërfaqes së rrugës rreth 0.20 m. nga niveli i saj në periudhën helenistike, shënon cakun e fundit të kësaj periudhe.

Periudha e tretë (shek. III—IV e.sonë) lidhet me ndërtimin e kanalit me tulla të plota romake, adoptimeve dhe rindërtimeve në godinën helenistike, si dhe ngritjen e një tok banesave në anën veriore të rrugës. Në këtë kohë vijat ujore kishin dalë përfundimisht jashtë përdorimit dhe sipërfaqja e rrugës mbu-

15) H. Ceka, **Apollonia,** Tiranë, 1958, 12.



Fig. 6



Fig. 7

lohej nga një shtresë relativisht e trashë (0.20-50 m. trashësi) depozitimesh kulturale. Për këtë periudhë është karakteristike ripërdorimi i materialeve të gurta.

Periudha e katërt (shek. V–VI e.sonë) dhe e fundit për kohën antike në sektorin H përfaqësohet nga mbeturinat e godinës D dhe të dy kthinave pranë qoshes jugore të gërmimit. Ndërtimi i këtyre banesave është bërë në një kohë kur godinat më të herëshme kishin dalë jasht përdorimit dhe rruga në krahasim me nivelin e saj, në periudhën helenistike, mbulohej nga një shtresë e trashë (0.50-1 m.) depozitimesh kulturale. Gjetja në këto kthina të monedhave të Justinianit përcakton dhe fundin e kësaj periudhe.

* * *

Rezultatet e gërmimeve të deritanishme në Apolloni ndihmojnë të njihemi sadopak me shtrirjen, drejtimet dhe shpërndarjen e arterjeve kryesore dhe të blloqeve të banesave në Apolloni.

Trakti rrugor në sektorin H nuk ka dyshim se i përket një rruge kryesore të qytetit. Boshti horizontal i këtij trakti me drejtim nga qendra e qytetit përputhet plotësisht me atë të traktit rrugor të zbuluar përpara monumentit të Agonotetëve (sektorët J e M). Rrjedhimisht, të dy këto trakte janë pjesë të një rruge të vetme, e cila në antikitet ndërpriste qëndrën e qytetit dhe me drejtim nga perëndimi (rreth 200 m. poshtë) kalonte para teatrit[16]), në krahun e djathtë të tij, duke përshkuar pak më tej kompleksin e ndërtimeve në sektorin H. Vazhdimi i mëtejshëm i kësaj rruge në sektorin H2; të bën të mendosh për një lidhje të saj me ndonjë nga portat kryesore në murin rrethues të qytetit.

Për shtrirjen nga lindja të rrugës sonë, dëshmon një trakt tjetër i kësaj rruge e dalë në dritë gjatë gërmimeve për zbulimin e qendrës së qytetit, në vazhdim (nga lindja) të kryqëzimit të rrugës sonë me rrugën që shtrihet në krahun jugor të portikut me nike (shih tab. I). Nga ky trakt është ruajtur vetëm traseja me gjërësi 3.30-3.40 m, që i përgjigjet plotësisht gjërësisë së trasesë në sektorin H; kurse konstruksionet e tjera të rrugës (kunetat e pritat) ngjajnë të jenë shkatërruar nga ndërtimet e vona romake.

Të tërheq vemendjen fakti që trakti rrugor i zbuluar në sektorin J e M ndryshon për nga gjërësia me të gjithë pjesën tjetër të rrugës.

Rruga e jonë paraqitet me elementë më të shumtë dhe më të qartë dhe, si pasojë ndryshon disi nga rrugët e tjera të qytetit. Traseja, ndonse ka po të

16) Gërmimet për zbulimin e këtij monumenti sapo kanë filluar nën drejtimin e arkeologes A. Mano.

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9

DO NOT COPY

njëjtën mbushje si dhe trasetë në rrugët e tjera, ndryshon prej tyre nga kalimi për së gjëri të saj i pritave mbrojtëse. Edhe gjërësia në trasenë e rrugës sonë nuk i përgjigjet asaj të traseve të tjera, që në këto të fundit është më e madhe. Megjithatë duhet thënë se ky ndryshim nuk bie në sy kur rrugët merren në kompleks dhe krahasohen me njëra-tjetrën. Dhe kjo shpjegohet me faktin se kunetat në rruaën tonë janë shumë më të gjëra nga kunetat në rrugët e tjera. Si përfundim të gjitha rrugët kryesore të zbuluara në Apolloni kanë gjërësi të njëllojtë 6-6,20 m. të barabartë me 20-21 këmbë apolloniate.

Kunetat me prerje trapezoide përveç se në rrugën tonë nuk janë ndeshur në asnjë trakt të ndonjë rruge tjetër të zbuluar deri sot në Apolloni. Në rrugët e tjera ato janë plotësisht të ngjashme me kunetën e traktit të restauruar në sektorin H. Rrjedhimisht traktet rrugore me kunetat me prerje trekëndëshi janë më të vona se rruga kryesore në Apolloni. Datimi i rrugëve me kuneta me prerje trekëndëshi në shek. I e.sonë presupozon për ngritjen e rrugës sonë në një kohë më të herëshme shek. II—I p.e.sonë të dokumentuar dhe nga lënda arkeologjike e vjelë në gërmime.

Përsa i takon përdorimit të rrugës sonë koha e shfrytëzimit të saj kalon nëpër dy etapa kryesore. Etapa e parë lidhet me përdorimin e rrugës dhe të kunetave deri në shkatërrimin e kunetës jugore nga ndërtimi i shkallëve të portikut në monumentin e Agonotetëve të datuar në shek. II e.sonë si dhe të kunetës veriore nga hapja e kanalit me tulla të plota romake në sektorin H. Etapa e dytë ka të bëjë me shfrytëzimin e rrugës (pa kuneta) aty nga shek. III deri në gjysëm e parë të shek. VI e.sonë. Gjatë kësaj kohe sipërfaqja e rrugës, si rezultat i depozitimeve kulturale, ka qenë ngritur deri 1 m. lartësi nga niveli i saj në periudhën helenistike.

Rruga e jonë në planin urbanistik të rregullimit të qytetit, sot për sot është e vetmja rrugë e zbuluar në Apolloni, që përshkon nga lindja në perëndim qytetin. Perpendikularisht me rrugën tonë, më saktë me skajin lindor të traktit në sektorin H, ndjek drejtimin rruga zbuluar në sektorin D3 (shih fig. 2). Largësia tepër e vogël (10 m), midis dy trakteve në sheshin e pazbuluar të bën të mendosh për një kryqëzim të këtyre rrugëve. Po me kryqëzimin e rrugëve duhet të lidhet edhe mbulesa me rrasa guri e kanalit me tulla të plota romake pranë qoshes lindore të gërmimit. Një mbulesë e tillë duket se ka shërbyer për të mbrojtur kanalin nga dëmtimi si dhe për të lehtësuar kalimin mbi rrugë të udhëtarëve e mjeteve të transportit. Me pranin e kryqëzimit mund të shpjegohet edhe restaurimi i kunetës, pranë qoshes jugore të gërmimit. Kuneta jugore me prerje trapezoide duke u ndodhur në kryqëzim të rrugëve është konsumuar më tepër se sa në pjesët e tjera dhe, si përfundim, aty është bërë restaurimi i saj me traktin me prerje të një trekëndëshi dybrinjinjishëm.

Rruga në sektorin D3 me shtrirje nga veriu në jug duket ka përshkuar tërë pjesën veriperëndimore të qytetit. Boshti horizontal i saj me drejtim nga veriu ndërpret në kënd të drejtë të dy rrugët e zbuluara në sektorët D, D_1 e D_2, dhe del në sheshin e pagërmuar para nimfeut.

Në dy rrugët në sektorin D, D_1 e D_2, për shkak të terrenit tepër të aksidentuar, në anën lindore kanë patur një shtrirje të kufizuar me karakter rajonal,



Fig. 10

Nga kjo anë kodra e qytetit bie me shpatë të pjerrëta, vende-vende edhe të thepisur, rrëzë të cilave ndjek drejtimin rruga në sektorin D_3. Si përfundim e vetmja mundësi për shtrirjen e këtyre dy rrugëve ka qenë nga veriperëndimi deri në murin rrethues, kurse nga juglindja ato përfundojnë, me sa duket, deri në kryqëzimin me rrugën e zbuluar në sektorin D_3.

Të gjitha rrugët e Apollonisë ndjekin një farë pendence ose nga juglindja në veriperëndim ose nga verilindja në jugperëndim në përshtatje të plotë me pjerrësinë natyrale të terrenit. Për traktin e zbuluar në sektorin H pjerrësia e rrugës arrin 1.5%. Për të patur ide më të plotë të asaj që u tha lart, po ndalemi shkurtimisht mbi disa veçori të konfiguracionit dhe natyrës së terrenit apolloniat. Qyteti i Apollonisë shtrihet mbi një terren kodrinor që zbret nga perëndimi, veriperëndimi dhe jugu në një sërë tarracash, të cilat diku vijnë më të pjerrta e të ngushta, diku më të sheshta e të gjëra. Këtë shkallëzim, që fillon prej kreshtës së akropolit dhe vazhdon me një zbritje herë të menjëhershme dhe herë graduale deri në unifikimin e pjesëve të buta të kodrës me fushat përreth, terreni apolloniat mendohet t'a ketë patur qysh në kohën antike. Për këtë flasin dhe depozitimet kulturale, të cilat në përgjithësi nuk e kalojnë trashësin 1 m. në Apolloni, me përjashtim të rasteve kur për shkak të lëkundjeve të forta të tërmetit janë krijuar mbishtresa si rezultat i shëmbjeve të mëdha të masës së dheut (në nimfe dhe teatër). Natyra e shkallëzuar e terrenit ka bërë që mjeshtrat apolloniat në zgjidhjen e shumë çështjeve konstruktive të planizimit dhe rregullimit të qytetit ti shmangen deridiku kopjimit shabllon të rregullave rigoroze të ashtuquajturit sistem të Hipodamit. Zbatimi me rigorozitet i këtij sistemi në Apolloni detyrimisht ka ndeshur në mjaft vështirësi praktike të diktuara nga vetë konfiguracioni i terrenit. Ishtin këto kushte që imponuan Apolloninë, për shpërndarjen e rrjetit rrugor në përshtatje me pjesët e ulta e të larta të qytetit dhe vendosjen e blloqeve të banesave mbi bazë tarracash të ngjashme me mjaft qytete të tjera të botës antike si Prienë, Pergam etj. Përdorimi i zhavorrit për shtruarjen e rrugëve të qytetit në kushtet e terrenit apolloniat jo vetëm që ka qenë i papërshtatshëm për kullimin, por edhe i paqëndrueshëm ndaj reshjeve. Megjithatë vendosja e pritave mbrojtëse, gjatë trasesë dhe ndërtimi i kunetave, në të dy anët e rrugës, ka bërë që të mënjanohet rreziku i dëmtimit të rrugës nga veprimi shkatërrues i reshjeve. Dhe, në qoftë se rruga e jonë ruan pamjen që ka pasur dikur në antikitet, kjo vjen nga që ndërtuesit kanë ditur të zgjidhin mirë problemin e mungesës së ndjishme për gurë dhe të zbutjes së pjerrësisë së terrenit. Këtu mendojmë se duhet parë dhe arsyeja që në kompozicionin urbanistik të rrugëve të Apollonisë ndeshen të tillë elementë, si pritat mbrojtëse dhe kunetat me prerje trapezoidale, të cilat, nga sa dimë, nuk ndeshen të gërshetuara kaq ngushtë në rrugët e qyteteve të tjera antike.

DO NOT COPY



DO NOT COPY

TAB. II

DO NOT COPY

Burhan DAUTAJ

UNE RUE PRINCIPALE A APOLLONIE

RESUME

Les fouilles effectuées dans la partie NO de la ville out mis au jour les tronçons de deux rues paralèles disposées à 60 m. l'une de l'autre. La largeur de ces rues est respectivement de 5.95 et 6.30 m. Chacune d'elles longe un cassis revêtu de grandes plaques en pierre. Deux autres tronçons ont été découverts au centre de la cité. Le premier conserve encore le tracé à trottoirs pavés de dalles extraites des cassis après leur mise hors d'usage. Elle est percée perpendiculairement par une deuxième rue longeant le monument des Agonothètes. La largeur de cette rue y compris les deux cassis varie de 7.40 à 8.30 m. dans les secteurs J et M.

Les fouilles entreprises dans une terrasse d'étendant à l'O, sur le côté droit de la route Pojan-Musée archéologique ont mis au jour des tronçons de deux rues s'entrecroisant à angle droit.

C'est la rue découverte dans le secteur H qui sera l'objet d'une étude plus approfondie dans ce travail.

Elle comprend son tracé et deux voies d'eau la longeant des deux côtés. Elle a été mise au jour sur une longeur de 88 m. et représente le tronçon le plus long des rues de la cité d'Apollonie. Sa largeur avec les deux cossis n'est pas partout la même, elle varie de 6 m. à l'extrémité est des terrassements jusqu'à 6.20 m. de l'autre côté.

Les constructions de la rue: le tracé avec une série de barrages de protection et les deux cassis se rattachent étroitement sur le plan fonctional et se complètent on ne peut mieux. Elles la rendent résistante et facilitent l'écoulement des eaux.

Le tracé a été aménagé sur un sol subargileux caillouté d'une couche de galets fins mélangés à des restes de céramique antique. Sa largeur d'une bordure à l'autre des rigoles est de 3.40 m. environ. A proximité de l'extrémité ouest des terrassements, le tracé a été réfectionné avec des morceaux de briques et de tuiles hellénistiques. Cette couche constituait un pavé, à la saison des pluies, facilitait le passage sur le tracé et communiquait à travers un pont de pierre traversant le cassis avec les bâtiments situés sur le côté sud de la rue.

Le tracé en question est traversé par maints barrages protecteurs, afin d'empêcher son érosion et le transport des galets sous l'effet dévastateur des précipitations atmosphériques. Les barrages sont distanciés différemment les uns des autres. Cette distance varie graduellement et s'accroît en direction est-ouest à mesure que se retrécit l'angle d'inclination de la rue.

La section de deux cassis se présente sous la forme d'un trapèze dont les côtés sont égaux et la base est constituée par le côté le plus petit.

Le cassis O, à proximité de l'angle est du terrassement, a été réfectionné. La forme trapézoïdale a été substituée par celle à triangle équilatéral, ce qui a retréci la largeur de la rigole jusqu'à 1 m. Les tronçons de rues découverts dans les secteurs D, D_1 et D_2 ont une construction analogue à celle du tronçon du cassis O de la rue mise au jour dans le secteur H.

La détermination exacte de la période de construction de cette rue présente un problème assez compliqué. La difficulté consiste avant tout dans le fait que la partie découverte dans le secteur H ne représente qu'un tronçon limité et incomplet. Par

DO NOT COPY

DO NOT COPY

ailleurs, les données stratigraphiques comportent différentes couches culturelles non bien distinctes ce qui ne facilite pas l'évaluation d'une chronologie absolue pour la rue et ses monuments. Enfin, les vestiges antiques mis au jour se rapportent seulement à une partie des bâtiments, à leur facade, et nous ne connaissons pas encore les données stratigraphiques que peuvent seulement fournir les fouilles qui seront effectuées jusqu'à la base des surfaces situées à l'intérieur et hors des murs de ces bâtiments. Malgré cela, ce n'est qu'en nous fondant sur la technique de construction des éléments des divers bâtiments que nous pouvons porter un jugement plus ou moins valable sur l'âge de cette rue et la période de son usage.

A ce propos, les restes d'un bâtiment hellénistique (A) situé sur le côté S de la rue offrent un certain intérêt. La technique de construction du mur en briques, le soin accordé à l'appareillage des dalles tufacées et la disposition du palier à proximité du cassis S, en conservant rigoureusement la direction parallèle et en suivant l'inclination naturelle du terrain, sont autant de faits que nous induisent à penser que ces constructions sont comtemporaines à celle de la rue. Les commencements de cette période peuvent fort bien coincider avec la période d'emploi des briques pleines hellénitiques (0.46 x 0.46 x 0.8) dans le mur d'enceinte de la cité, voir les IIIe–IIe siècles avant notre ère.

Les autres constructions situées dans la partie S de la rue, les bâtiments B et C se rattachent aux travaux d'aménagement du tracé et à la construction du pont de pierre sur le cassis S. La forme, les dimensions et le mode de disposition du cassis sont entièrement identiques à ceux des cassis correspondant aux tronçons découverts dans les secteurs D, D_1 et D_2 et qui datent le Ier siècle avant notre ère.

A des périodes plus récentes d'usage de cette rue se rattachent les nombreuses restaurations et adaptations effectuées dans le bâtiment hellénique. Ces travaux nous permettent de fixer d'une manière plus précise la période de construction de ces monuments. En effet, on y relève un abandon des traditions helléniques notamment en ce qui concerne la présentation réussie des façades. D'ailleurs le IIIe siècle marque un déclin de l'architecture dans la cité d'Apollonie. A cette période les cassis étaient recouverts d'une couche relativement fine de dépôts culturels et la surface du tracé se trouvait à 0.20 m. au-dessus du niveau correspondant à la période hellénistique.

Les données stratigraphiques, même si elles ne représentent pas un terminus post quem de la construction de la rue, servent tout de même à dater on ne peut mieux la dernière période de son usage et l'existence en général d'une vie citadine dans cette partie de la cité. Les trouvailles effectuées à l'intérieur des pièces d'habitation, voir les monnaies d'Arcadius (394-408) et de Justinien (527-565) indiquent approximativement les limites du commencement et la fin de la quatrième et dernière période de construction dans le secteur H.

* * *

Le tronçon situé dans le secteur H appartient à une rue principale, qui commençait dans l'antiquité au centre se dirigeant vers l'ouest (200 m. environ plus loin), passait devant le théâtre en traversant un peu plus loin le complexe des édifices du secteur H.

A remarquer que notre rue présente un plus grand nombre d'éléments plus évidents et qu'elle se différencie quelque peu des autres rues de la cité. Bien que son tracé a un remplissage analogue à celui des autres rues, il se différencie quand même par la disposition des barrages protecteurs qui le traversent en largeur.

Les caniveaux à section trapézoïdale de notre rue sont les seuls découverts à Apollonie jusqu'à ce jour. Les autres rues de la cité sont dotées de caniveaux dont la construction, la forme et les dimensions sont entièrement identiques au tracé restauré ayant

un caniveau à section de triangle équilatéral. En conséquence, les tronçons de rue à caniveaux dont la section est triangulaire sont plus récents et se rattachent à une deuxième période de construction des rues principales d'Apollonie.

A Apollonie, toutes les rues ont une même inclination, du SE au NO ou du NE au SO, conformément à la pente naturelle du terrain. Pour s'en faire une idée plus claire, il suffit de rappeller que la cité d'Apollonie s'étend sur un terrain mamelonné qui descend en direction O, NO et S à travers une série de terrasses plates et larges. Ce sont ces conditions qui ont imposées à Apollonie la distribution du réseau de rues conformément aux parties élevées et basses de la cité et à la disposition des pâtés de logements sur des terrasses, ce que l'on relève aussi dans d'autres cités antiques, comme Priene, Pergame, Panticapée etc.

Le mérite des maitres apolloniates réside précisément dans le fait qu'ils ont su approprier les principes de l'urbanisme hellène aux conditions spécifiques de leur cité. C'est ce qui explique aussi la présence dans la composition urbaniste de notre rue d'éléments tels que les barrages protecteurs et les caniveaux à section trapézoïdale, que l'on ne rencontre pas si étroitement enchevêtrés, à ce que nous sachions, dans les rues des autres villes de l'Antiquité.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Neritan CEKA

DO NOT COPY

FORTIFIKIME TË VONA ANTIKE PRANË RRUGËS EGNATIA

Në kushtet e krizës së rendit skllavopronar dhe të rrezikut të dyndjeve barbare, që u bënë të vazhdueshme pas mesit të shek. IV të e.sonë, një rëndësi të veçantë mori fortifikimi i arterieve rrugore më të rëndësishme. Rrugës Egnatia, dhe veçanërisht pjesës perëndimore të saj që të nxirrte në bregun Adriatik, përballë Italisë, nuk mund të mos i kushtohej një vëmëndje e veçantë në këtë veprimtari ndërtuese. Rrethimi i qytetit Skampin[1]) me një kuadrat muresh në gjysmën e dytë të shek.IV të e.sonë përbënte vetëm fillimin e krijimit të një sistemi fortifikimesh, që do të ngrihej në rrugën kryesore dhe krahinat përqark (fig. 1). Në këtë proçes, që zgjati rreth dy shekuj, krijimi i një fizionomije të re urbane dhe arkitektonike është pasqyrimi i rrethanave të reja ekonomiko-shoqërore dhe historike. Për këtë arsye, duke u ndalur kryesisht në anën e parë, do të përpiqemi ta shoqërojmë atë me të dhëna të karakterit arkeologjik. Materiali kryesor për këtë është mbledhur nga vrojtimet në terren dhe vetëm për gradishtën e Belshit ai vjen nga gërmimet sistematike. Nga kjo rrjedhin një radhë vështirësishë në detajimin e monumenteve, datimin e saktë apo në përcaktimin e fizionomisë së tyre. Sidoqoftë mendojmë se botimi i tyre në grup do të plotësojë deri diku boshllëqet e veçanta dhe mund të jetë një kontribut për studimin e një periudhe mjaft interesante të historisë sonë.

Mbrojtja e pjesës perëndimore të rrugës Egnatia fillonte me një grup fortifikimesh të ngritura pranë trasesë kryesore dhe degzimeve të saj, në fushën e Domosdovës dhe luginën e sipërme të Shkumbinit[2]). Rolin kryesor e luanin aty «Sofra e Skënderbeut» në Pishkash, qyteza e Selcës së Poshtme[3]) dhe ajo e Manastirecit[4]), si dhe qyteza e Xhyres[5]). Kishte edhe një numër qytezash të vogla, si qyteza e Sllabinjës, qyteza e Shpellave, qyteza e Zemçës, të cilat qenë të tërhequra nga rrugët kryesore të komunikacionit dhe shërbenin për kontrollin e krahinave malore.

Për të gjitha këto fortifikime janë tipike planimetritë e thjeshta, pothuaj gjithkund pa kulla, të cilat i

1) Përshkrimin dhe datimin e kalasë nga Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Elbasanit,** «Monumentet», 1, 1971, 61-77 e konsiderojmë të plotë në gjendjen e sotme të të dhënave dhe për këtë arsye nuk e kemi përfshirë në trajtimin tonë.

2) N. Ceka – L. Papajani, **Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike»,** «Monumentet», 1, 1971, 53; N. Ceka, – A. Baçe, **Vrojtime arkeologjike në rrethin e Pogradecit, luginën e Devollit dhe Shkumbinit,** «Monumentet» 3, 1972, 206-207.

3) N. Ceka, **La ville illyrienne de la Basse–Selcë,** «Iliria», 2 1972, 170, 174.

4) Qyteza e Manastirecit ndodhet në bregun e majtë të Shkumbinit, pranë fshatit me të njejtin emër të rrethit të Librazhdit. Fortifikimi i vonë antik zinte një sipërfaqe elliptike 100 x 50 m., të kufizuar në tre anë nga rëniet shkëmbore. Pjesa e pambrojtur mbyllej nga një mur me llaç të dobët, që është rrafshuar krejt. Qeramika është karakteristike për shek. IV-VI të e.sonë.

5) Qyteza e Xhyrës gjendet në vendin ku rruga Egnatia arrin lartësinë më të madhe dhe kontrollonte një kalim të detyruar, që krijohej nga përroi i rrëmbyer i Gurrave të Zeza. Forma e fortifikimit ndiqet me vështirësi për shkak të ruajtjes së keqe të mureve, por gjetjet e qeramikës kanë një shtrirje rreth 1 ha. Fortifikimi kontrollonte njëkohësisht edhe një rrugë sekondare nëpër lugjet e maleve, e cila fiton rëndësi në kohën e vonë antike. Shih N. Ceka, L. Papajani, **vep. cit., 53.**



Fig. 1

përshtaten në linjat e mureve formës së kodrave ku ndërtohen. Gjithashtu është e përbashkët teknika e dobët e ndërtimit. Muret janë të ngushtë, gurët kanë dimensione të vogla dhe lidhen me llaç të dobët, i cili shkriftohet lehtë. Gërmimet arkeologjike në Selcën e Poshtme treguan se ndërtimi i këtij grupi fortifikimesh mund të lidhet me çerekun e fundit të shek. IV, me shumë të ngjarë me kohën e sundimit të Valentinianit I.

Që nga Xhyra, ku rruga Egnatia ngjitet në lartësinë më të madhe e deri sa zbret për të kaluar Shkumbinin, ndeshet vetëm një fortifikim i vonë antik, Guri i Skënderbeut në Dardhë[6]). Tek ura e Haxhi Beqarit Shkumbini e zgjeron shtratin, për tu futur përsëri në një grykë të ngushtë pranë fshatit Xibrakë. Këtu, në bregun e djathtë të lumit, mbi kodrën që shënon fillimin e grykës, ruhen gjurmët e një fortifikimi të vonë antik. Nga pikpamja strategjike ai përbënte postin më të avancuar të një grupi të dytë fortifikimesh mbi rrugën Egnatia, qendër e të cilit ishte Skampini.

Fortifikimi zinte pjesën më të lartë të kodrës, që njihet nga vendasit me emrin **«Shkambi Mbret».** Kreshta gëlqerore e kodrës, që thyhet në një lartësi prej disa dhjetra metrash gjatë anës lindore (fig. 2), ndërpritet me një rënie të thikët nga jugu dhe nga veriu, ku lidhet me një qafë të lartë me kodrën fqinjë. Vetëm nga perëndimi kreshtën e pasojnë lugje të përshtatëshme për banim me një sipërfaqe rreth 0.5. ha., të cilat kalojnë në faqen e pjerrët të kodrës që zbret deri në bregun e lumit. Një shteg në anën veriperëndimore përbën rrugën më të përshtatëshme për tu ngjitur në rafshet e kodrës. Në këtë vend ndeshen shënjat e para të murit, që kapet buzë rënies shkëmbore dhe pas 20 m. kthen në kënd të gjërë nga veriperëndimi. Gjatë faqes perëndimore ruhen vetëm pjesë të shkëputura të murit, por prej tyre mund të ndiqet traseja gjatë vijës rushkulluese deri në rënien shkëmbore nga ana e veriut. Muri është ndërtuar me gurë të vegjël e mesatarë dhe llaç gëlqere të dobët që shkrifërohet lehtë (fig. 3). Në gjërësinë prej 2 m. të murit dallohet faqja e jashtme dhe e brendshme si dhe mbushja prej gurësh më të vegjël.

Në lugjet dhe në faqen perëndimore të qytezës dallohen rrënoiat e një numri godinash të ndërtuara me gurë dhe llaç baltë. Njëra prej tyre ka planimetri katërkëndëshe me katër ambiente dhe gjërësi muri 0.60 m. (dy faqe dhe mbushje). Një periudhe më të vonë ndërtimi i takon edhe një godinë njëkthinëshe katërkëndëshe, pranë murit perëndimor të qytezës, që është ndërtuar me gurë mesatarë e të vegjël, të niveluar rregullisht. Lidhja është bërë me llaç gëlqere të përzier me thërmija tullash, që është më i fortë se ai i përdorur në murin e rrethimit. Hyrja, që sheh nga perëndimi, është hapur në mes të anës së ngushtë dhe është përforcuar me dy pilastra. Pjesa e prapme e

6) Qyteza e Dardhës që njihet me emrin Guri i Skënderbeut është një piramidë shkëmbore mbi rrugën Egnatia. I vetmi shteg që të çon mbi shkëmb është përforcuar me një mur të ndërtuar me gurë dhe llaç mjaft të fortë. Në faqen e murit duken vrimat e drurëve të skelës në çdo 1 m. lartësi. Një kthesë kundrejt murit duket në anën V. dhe shërbente më tepër për krijimin e një tarrace për banesë. Në sipërfaqen mjaft të kufizuar gjendet edhe një sterë uji cilindrike me diametër 3 m. Qeramika është tepër e rallë dhe i takon kohës së vonë antike.

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3



Fig. 4

godinës është mbuluar nga dheu, gjë që na pengoi të përcaktonim tek ajo një kishë. Sidoqoftë kemi të bëjmë këtu me një ndërtim me të vonë se muri rrethues.

Gjetjet në qytezë janë të ralla, kryesisht tjegulla të tipeve të vona antike dhe fragmente enësh po të kësaj periudhe.

Pasi kalon grykën, Shkumbini le nga e djathta fushën e ngushtë të Labinotit. Rruga e kalonte këtë pjesë në një vijë të drejtë dhe futej midis Krastës dhe kodrës së Menglit në fushën e Elbasanit. Kjo ngushticë e fundit përpara qytetit të Skampinit kontrollohej nga kalaja e Menglit. Vetë kodra ku është ngritur kalaja ka formë piramide me bazë trekëndëshe dhe shkëputet nga një qafë e ulët prej malit të Godoleshit. Fortifikimi përfshin një sipërfaqe relativisht të sheshtë prej 1.5 ha, që kurorëzon majën e kodrës. Muri i kalasë me gjatësi rreth 500 m. kalon në vendet ku kjo sipërfaqe thyhet drejt faqeve që bien me pjerrësi 40º-50º nga të gjitha anët (fig. 4) dhe formon një planimetri trekëndëshe. Ruhet më mirë brinja veriore, ku dallohet një kullë katërkëndëshe në mes dhe një kullë tjetër në këndin verilindor, ku janë gjurmët e një hyrje. Në anët e tjera ndiqet pa ndërprerje linja e murit.

Muri është ndërtuar me gurë mesatarë dhe të vegjël, të lidhur me llaç të dobët gëlqereje që shkrifto-het lehtë. Kjo ka bërë që pjesa më e madhe e murit të rrafshohet me tokën dhe vetëm në pak raste ai arrin lartësinë 1 m. Në gjërësinë prej 1.70 të murit, gurët janë vendosur në dy faqe të dalluara qartë dhe në mbushjen me gurë më të vegjël. Në fasadë vihet re se janë bërë nivelime të herpasherëshme të murit gjatë ndërtimit. (fig. 5).

Në sipërfaqen e kalasë vihen re gjurmë banesash me mure të ndërtuara prej gurësh dhe balte, të cilat në përgjithësi janë vendosur gjatë murit rrethues. Gjetjet më të shpeshta janë tjegullat e tipeve të vona romake.

Sipërfaqja e kufizuar e banimit tregon se kalaja e Menglit ka qenë një qendër me karakter ushtarak në funksion të kalasë së Skampinit, si një pararojë e saj. Në Kozmografinë e Anonimit të Ravenës (IV, 9) të tërheq vëmëndjen fakti se në radhitjen e qyteteve është ndjekur itinerari i rrugës. Që nga Lyhnidi (Licinum) ne ndeshim qëndrat e njohura nga itinerarët romake: Ponservili dhe Candavia si dhe një qendër të panjohur Duriana.[7]) Mungesa e stacioneve të njohura Tres Ta-

7) Qendrat janë rreshtuar sipas itinerarit të rrugës Egnatia nga Lyhnidi deri në Skampin, duke lënë jashtë këtë të fundit.

DO NOT COPY

bernas, Ad Dianam dhe Treiecte shpjegohet me faktin se këtu bëhet fjalë për qytete, pra për qëndra të fortifikuara. Kështu ne kemi mundësi të lokalizojmë Ponservilin në «Sofrën e Skënderbeut» dhe Candavian në qytezën e Xhyrës. Për Durianën vijnë në konsideratë kalaja e «Shkambit Mbret» dhe ajo e Menglit. Sigurisht që lista e Anonimit ka përfshirë kalatë kryesore. Për këtë arsye mund të mendojmë se Duriana ishte kalaja e Menglit, e lidhur më ngushtë me rrugën dhe me një rëndësi më të madhe për mbrojtjen e saj.

Elbasani paraqiste në periudhën e vonë antike një nyje të rëndësishme strategjike. Që aty rrugët ishin të hapura drejt perëndimit, veriut apo jugut. Për këtë arsye qyteti i Skampinit u rrethua me një kuadrat muresh që përbën fortifikimin e parë të kësaj periudhe në këtë zonë. Është për tu shënuar se gjatë gjithë rrugës Egnatia nga Skampini në Durrës nuk ndeshet më asnjë fortifikim tjetër. Ndërkohë, në degëzimet e rrugës drejt fushës së Tiranës, ka dy kështjella antike të vona: Kulla e Gracenit dhe Kalaja e Bodinit, pranë fshatrave homonime.

Kulla e Gracenit përbën majën më të lartë të vargut të Krrabës. Kreshta e saj gëlqerore zgjatet nga jugu në veri me një syprinë të ngushtë që nuk i kalon 25 m., të kufizuara anash me rënie të thikta. Që aty kontrollohet së afërmi rruga në shpatin perëndimor të vargmalit të Krrabës (fig. 6), e cila ka funksionuar që në kohën antike. Traseja e saj, siç dëshmohet nga prania e fortifikimeve qytetare ilire përputhej, afërsisht, me rrugën e sotme automobilistike deri në qafën e Krrabës, të cilën nuk e kalonte traseja e sotme, sepse vazhdonte gjatë shpatit perëndimor deri në kalanë e Petrelës. Kulla e Gracenit ka patur funksionin e një poste kontrolli gjatë kësaj rruge që në periudhën qytetare ilire. Kësaj kohe i takojnë disa trakte muresh në pjesën veriore të qytezës dhe disa fragmente me vernik të zi të gjetura rastësisht. Ndërtimet e fortifikimit të vonë antik e kanë shfrytëzuar pjesërisht murin e hershëm si substruksion. Gjithashtu planimetria e këtij fortifikimi është përcaktuar nga forma e kreshtës dhe na paraqitet si një katërkëndësh i zgjatur me gjërësi mesatare 20 m. (fig. 7). Sipërfaqja prej rreth 0.25 ha. zihet në pjesën më të madhe nga shkëmbinjtë, ndërmjet të cilëve ka sheshe të kufizuara, që janë përdorur për banesa. Një zonë rreth 200 m², më e përshtatëshme për banim, por më e ulët se pjesa tjetër, është veçuar me një mur ndarës, duke krijuar një farë oborri të fortifikuar nga ana jugore. Nga kjo anë duhet të ketë qënë hyrja kryesore për në kështjellë, por prej saj nuk ruhen më gjurmë.

E vetmja hyrje dallohet si një hapësirë e thjeshtë në këndin veriperëndimor të qytezës. Që këtu muri perëndimor ndiqet pa ndërprerje mbi thyerjen shkëmbore, ku ndjek vija të drejta. Kthesat e murit në anën jugore janë bërë me kënde të drejta ose me kalim të harkuar. Krahu tjetër i murit, që shkon nga hyrja drejt verilindjes, kthen me kënd të drejtë nga jugperëndimi për të takuar pjerrësinë e kreshtës. Që aty dallohen vetëm shënja të dobëta të murit. Në tërë gjatësinë e mureve nuk vihen re gjurmë kullash.

Në pjesët më të ruajtura, që gjënden në anën jugore (fig. 8), dallohet qartë ndërtimi i murit. Gurët me madhësi mesatare dhe të vegjël janë vendosur në një gjërësi 1.40 m. në dy faqe dhe mbushjen. Si lidhës është përdorur llaçi me shumë gëlqere dhe rërë përrenjsh. Lidhja paraqitet shumë e dobët, ndoshta për



Fig. 5



Fig. 6

PHOTOCOPY

DO NOT COPY



SKICE PLANIMETRIKE Fig. 7

shkak të staxhionimit të pamjaftueshëm të gëlqeres, dhe gurët bien me lehtësi nga muri.

Në një sondazh të vogël, krahas tjegullave solenë dhe kalyptere me vija të valëzuara mbi kurriz, tipike për shek. VI të e.sonë, me rëndësi ishte gjetja e një monedhe bronzi të Valentinianit. Kjo na jep një «terminus ante quem», çerekun e fundit të shek.IV të e.sonë. Gjetja e monedhave të Valentinianit në kalatë e vona antike është një fenomen i njohur edhe në pika të tjera.[8]).

Që nga vargmali i Krrabës, në drejtim të perëndimit, ndërmjet Shkumbinit dhe luginës së Zhullimës, shtrihet një zonë e gjërë kodrinore, që mban emrin Malësia e Krrabës. Afluentët e Shkumbinit e përshkojnë këtë zonë nga veriu në jug, duke krijuar rrugë të përshtatëshme natyrore për të kaluar në drejtim të Petrelës apo Pezës për në luginën e Erzenit. E gjithë kjo zonë, si dhe rruga që e përshkon në mes nëpër përroin e Pajunit, zotërohet nga një kodër shkëmbore, që mban emrin kalaja e Bodinit. Syprina që zbret butë



Fig. 8

nga jugu dhe perëndimi ndërpritet në veri dhe në lindje nga rënie të pakalueshme shkëmbore. Dy rradhë muresh të kohëve të ndryshme kalojnë në formë harqesh nga një buzë tek tjetra, duke përfshirë një sipërfaqe rreth 1 ha. (fig. 9). Më i gjëri prej tyre i takon periudhës së parë të hekurit, ndërsa i dyti, që përmbledh vetëm gjysmën e sipërfaqes së vendbanimit të parë, është ndërtuar në periudhën e vonë antike. Ndryshe nga muri i periudhës së parë, ai kalon edhe në anët lindore dhe veriore, duke qenë i tërhequr rreth 5-6 m. nga gremina, por në të gjithë gjatësinë e tij nuk vihet re asnji kullë.

Duket se në atë kohë ruhej në gjendje të mirë edhe fortifikimi i vjetër. Duke dashur të shfrytëzojnë edhe sipërfaqen e mbrojtur prej tij, ndërtuesit e fortifikimit të ri kanë zgjatur muret lindore dhe veriore, deri në ekstremet e murit të vjetër. Me sa duket, kjo është realizuar në një kohë më të vonë, siç mund të kuptohet nga ndryshimi në qëndrueshmërinë e mureve. Ndërsa fortifikimi kryesor dallohet për llaç të një cilësie më të mirë, në muret shtesë llaçi është krejt i dobët dhe muri paraqet një ndërtim të nxituar. Megjithëse i dallueshëm, ndryshimi në teknikën e ndërtimit nuk është aq i madh sa të mendojmë për dy periudha të largëta ndërtimi. Për të dy pjesët është tipike mungesa e kullave, ndërsa hyrjet nuk dallohen për shkak të gjendjes së keqe në të cilën ruhen muret. Qeramika në sipërfaqen e kalasë është e rrallë, kryesisht tjegulla solenë të tipeve të vona antike dhe fragmente pitosi të zbukuruara me breza vijash të valëzuara, karakteristike për këtë periudhë.

Pasi Shkumbini del nga grykat, disa degëzime të rrugës Egnatia ktheheshin drejt jugut për në luginën e Devollit. Njëlloj si në krahun e djathtë, edhe nga kjo

8) Monedha të Valentinianit I janë gjetur në shtresën që lidhet me fortifikimin e vonë antik në Selcën e Poshtëme dhe në Rosujë (Tropojë). Shih B. Jubani, N. Ceka, **Gërmimet në qytezën ilire të Rosujës,** «Iliria», I, tab. VIII.



SKICE PLANIMETRIKE Fig. 9



SKICE PLANIMETRIKE Fig. 10

anë nuk ndeshim fortifikime të vona antike pranë degëzimit kryesor, që shkonte rrëzë kodrave, për ta kaluar Devollin në Gostimë. Përkundrazi ato gjënden në brendësi të krahinës së Shpatit, që shtrihet midis Shkumbinit e Devollit, duke patur si kufi juglindor lumin e Holtës.

Midis kodrave me formacion shtufi të Shpatit të Sipërm, pranë fshatit Valësh, ngrihet kurrizi gëlqeror i Krastës. Pjesa më veriore e tij, që veçohet nga Qafa e Qytezës, quhet nga vendasit «Qyteti i Kaurrit». Aty ndeshen gjurmët e një vendbanimi të rrethuar me mure që përshkojnë faqet veriperëndimore, perëndimore dhe juglindore të kodrës, duke u kapur në dy ekstremet e tyre tek gremina që kufizon anët e tjera të kodrës. Gjetjet e rastit dhe gjurmët e një muri me gurë të papunuar, që është përdorur si substruksion i një muri me llaç, tregojnë se vendbanimi ka ekzistuar gjatë periudhës qytetare ilire. Planimetria e plotë e mureve vjen që nga koha e vonë antike. Forma e saj është katërkëndëshe e zgjatur, me një brinjë të formuar nga rënia shkëmbore (fig. 10). Linjat e murit janë të drejta për distanca të gjata, ndërsa kthesat bëhen në kënd të drejtë. Dy kthesa në kënd të gjërë në anën perëndimore lidhen me drejtimin që ka pasur muri më i hershëm. Vetëm në anën verilindore muri kalon në hark për të takuar buzën e greminës.

Hyrja e vetme që dallohet, gjëndet në këndin e qytezës me një vendosje pranë kthesës së murit, që të kujton hyrjen në kullën e Gracenit. Për shkak të rrënimit të murit nuk mund të përcaktohej gjërësia e hyrjes, si dhe forma e një kulle në krahun e djathtë. Muri juglindor i qytezës, që mbron anën më të afrueshme, në një periudhë të dytë është përforcuar edhe me një kullë rrethore me diametër 7.50 m. Trakti i murit që pason kullën dhe që i takon periudhës së parë është ruajtur relativisht mirë në një gjatësi rreth 20 m. Ndërtimi është bërë me gurë të vegjël dhe mesatarë, me dallim të qartë të faqes së jashtme dhe të brendshme. Llaçi, i pregatitur me gëlqere dhe rërë të ashpër përrenjsh, është përdorur me pakicë dhe shkrifëtohet lehtë. Në fasadë dallohen nivelimet e bëra herëpashere gjatë ndërtimit. Muri i kullës është i pjerrët, gjë që shpjegohet me lartësinë më të madhe që ka pasur kundrejt kurtinave që kanë qenë vertikale. Gjerësia e murit, në këtë vend, është 1.50 m., ndërsa në anën perëndimore arrin deri 1.70 m. Brenda mureve përfshihet një sipërfaqe prej 0.6 ha, por vetëm pjesa jugore dhe veriore e saj janë të përshtatëshme për banim. Duken shenjat e rreth 100 godinave, në pjesën më të madhe njëdhomëshe, të larguara nga muri rrethues. Ndër gjetjet mbizotërojnë tjegullat solene dhe kalypter, pitosa me breza vijash të valëzuara dhe fragmente enësh guzhine. Gjetja më e vonë është një monedhë bronzi. e perandorit Jan Zimices.

DO NOT COPY

Forma e planimetrisë me vija të drejta, kthesa këndore të paforcuara me kulla dhe vendosjen e hyrjes pranë njerit prej këndeve si dhe muret me llaç të dobët të kujtojnë Kullën e Gracenit.

Tërheqja nga rruga kryesore dhe kontrolli mbi një rrugë kryesisht krahinore, është karakteristikë edhe e kalasë tjetër në krahinën e Shpatit, që ngrihet në Llixhat e Elbasanit (fig. 11). Në perëndim të burimeve të Llixhave zgjatet një kodër me formacion gëlqeror që njihet me toponimin Kalaja e Brajës. Kurrizi i kodrës është përfshirë brenda një elipsi muresh, që krijon një kështjellë me sipërfaqe rreth 1,5 ha. (fig. 12). Muret kalojnë në faqet e pjerrëta të kodrës, duke krijuar pas tyre tarraca të ngushta, në të cilat kanë qenë vendosur në një radhë të pandërprerë banesa. Linja e mureve është e thjeshtë, pa asnjë kullë, megjithëse këto do të ishin të domosdoshme në anën juglindore dhe veriperëndimore të kodrës, ku qenë pikat më të mundshme të sulmit. Sistemit të fortifikimit i është shtuar nga juglindja një zonë katërkëndëshe e fortifikuar, të cilën e ndeshim edhe në kullën e Gracenit. Duket se kemi të bëjmë me një oborr të fortifikuar në anën e hyrjes kryesore për në kështjellë.

Në gjithë gjatësinë e tyre muret pothuaj janë rrafshuar dhe vetëm pak trakte na japin mundësi të vërejmë mënyrën e ndërtimit. Në gjërësinë prej 1,80 m. të murit dallohen faqja e jashtme dhe e brendshme e punuar me kujdes prej gurësh gëlqerorë të gjithë madhësive, të lidhur me llaç gëlqereje mjaft të dobët, dhe mbushja me gurë të përzier me llaç. Në fasadë duken shënjat e një nivelimi të herëpashershëm të rradhëve të gurëve gjatë ndërtimit. Muri i «oborrit» ka një trashësi më të vogël 0.80 m., por është ndërtuar me një lidhje më të mirë të gurëve me llaç gëlqereje të përzier me zhavorr mali, mjaft i qëndrueshëm. Një dorë e tretë ndërtimi në muret rrethues vihet re në një trakt të vogël në anën perëndimore. Ruhet vetëm thelbi i murit me derdhje gurësh të vegjël e llaçi të pregatitur me gëlqere të përzier me zhavor e rërë të ashpër. Në këtë derdhje janë hedhur mjaft copa tjegullash. Derdhja përshkohet tërthor nga kanale të rrumbullakta me diametër 0.06 m. çdo 1.50 m. horizontalisht, që i takojnë skeleve të drunjta. Është një merametim i pjeshëm i sistemit të fortifikimit në një nga anët ku ai ka qenë prekur më lehtë nga sulmet e jashtme.

Sipërfaqja e banueshme brenda mureve është kufizuar nga kreshta shkëmbore, që përshkon kurrizin e kodrës. Banesat janë vendosur të gjitha në terracat e krijuara buzë murit rrethues, gjatë tërë gjatësisë së tij. Muret e banesave kanë gjërësi 0.60 — 0.80 m. dhe janë ndërtuar me gurë të lidhur me llaç të qëndrueshëm. Gjerësia e dhomave arrin 5-6 m. Për mbulimin e tyre janë përdorur tjegulla të tipeve romake që mbajnë kanelyrat karakteristike me gishta (fig. 13). Numri i madh i banesave dhe shtresa e trashë e depozituar pranë murit, tregojnë për një jetë intensive të zhvilluar në këtë qendër banimi të fortifikuar. Megjithatë qeramika është mjaft e varfër me forma karakteristike të shek. IV-VI të e.sonë, ku dallohet një grykë amfore e njohur si tip nga shtresa e shek. IV në termet e Bradasheshit.

Nga teknika e ndërtimit të mureve rrethues, karakteristikat e sistemit të fortifikimit dhe qeramika, kalaja e Llixhës qëndron më afër kullës së Gracenit dhe kalasë së Menglit dhe mund të rreshtohet në sistemin e fortifikimeve të ngritura rreth luginës së Shkumbinit në shek. IV-VI. Në këtë kuadër kjo kala e shkëputur nga rruga në bregun e majtë të Shkumbinit kishte për funksion kryesor kontrollin e pjesës veriore të Shpatit të ulët. Mënyra e vendosjes së banesave tek muri rrethues dhe gjetja e pakët e keramikës flasin për një karakter ushtarak-fshatar të vendbanimit.

Me këtë vendbanim lidhet një kishë paleokristiane e dëmtuar gjatë punimeve për krijimin e një lulishte në stacionin e Llixhave. Në pjesën jugore të krahinës së Shpatit, atje ku ajo kufizohet nga Vërça me lumin e Holtës, gjendet një tjetër fortifikim i vonë antik. Kalaja e Galigatit, që njihet nga vendasit me toponimin Bregu i Shëmlliut. Ajo vrojton një territor të gjërë që përfshin gjithë luginën e Holtës dhe zotëron pjesën jugore të Shpatit të Poshtëm. Muret ruhen mjaft dobët, pothuaj rrafsh me tokën, por ndiqet pa ndërprerje linja e tyre. Planimetria e kalasë është një elips me gjatësi 100 m. dhe gjërësi më të madhe 37 m. (fig. 14). Muri kalon gjatë vijës rushkulluese dhe nuk është përforcuar me kulla. Për shkak të rrënimit nuk është e mundur të dallohet hyrja. Në trashësinë e murit prej 1.25 m. dallohen qartë dy faqet dhe mbushja me gurë mesatarë e të vegjël. Lidhja me llaç gëlqereje me mbushës rëre të trashë është mjaft e dobët. Sipërfaqja e vogël që përfshihet brenda mureve është e përshtatëshme për banim. Vihen re shënja banesash dhe gjendet qeramikë e vonë antike: tjegulla solene me buzë sinusoidale, kalypter me inçizime valëzimesh në kurriz dhe pitosa me breza valëzimesh në buzë dhe shpatull.

Pozita strategjike dhe jeta e kufizuar dëshmojnë se kalaja e Galigatit ishte një qendër ushtarake, që bashkë me kalanë e Valshit dhe të Llixhave kishte si funksion kontrollin e një zone malore.

Kontrolli i degëve jugore të rrugës Egnatia si dhe i pjesës kodrinore dhe fushore që shtrihet në jug të Shkumbinit ushtrohej nga kalaja e Qafës dhe Gradishta e Belshit. E para, gjendet mbi vargun gëlqeror të Malit të Mollasit, që zgjatet nga jugu në veri, duke hyrë thellë në kthesën që bën Devolli, drejt jugut. Një qafë që ndërpret vargun në mesin e tij përbën rrugën më të shkurtër për tu futur nga perëndimi në luginën e mesme të Devollit. Në veri të qafës ngrihet

Pa fotokopje

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 13



SKICE PLANIMETRIKE

Fig. 12



SKICE PLANIMETRIKE

Fig. 14

një shkëmb gëlqeror i quajtur Kalaja e Qafës (fig. 15). Sipërfaqja relativisht e sheshtë që shtrihet sipër shkëmbit, zbret butë nga veriu dhe lindja. Në anët e tjera konturi i sheshit përcaktohet nga një rënie e pangjitëshme shkëmbore. Një hark muresh, duke u kapur në ekstremet e veta buzë greminës, e përfshin këtë sipërfaqe prej rreth 1 ha. në territorin e një kështjelle (fig. 16). Muri rrethues ndjek vija të drejta, duke bërë në tërë gjatësinë dy kthesa në kënd të gjerë. Në murin lindor, jo shumë larg fillimit të tij nga shkëmbi, është vendosur një kullë katërkëndëshe me ballë 9 m dhe dalje 7.90 m. Në murin verilindor ruhen tri kulla të vendosura 32 m. larg njera tjetrës, të cilat kanë formë trapezi të regullt me anë 7 m. dhe ballë 1.70 m. Në këtë mënyrë ato i ngjajnë një trekëndëshi me kulm të prerë (fig. 17). Ambienti i brendshëm ka formë pesëkëndshe dhe komunikon nëpërmjet një hyrje me gjërësi 1.15 m. Në fasadën e njerës prej kullave, që ruhet në lartësi 5 m, dalin rregullisht vrimat katërkëndëshe të skeleve, 2.30 m. larg njëra-tjetrës në vija horizontale çdo 1 m. lartësi.

Pas kullës së katërt, muri bën kthesën e fundit dhe pas 40 m gjenden gjurmët e një kulle të pestë, me formë rrethore. Ajo është ngritur me gurë e llaç balte mbi një kullë më të vjetër që është mbuluar nën rrënojat e saj. Po kësaj periudhe të dytë ndërtimi i takon një mur me të njëjtën teknikë, i vendosur reth 20 m. para saj.

Nga ana jugore, mbrojtja është mbështetur në faqen e prerë të shkëmbit, me përjashtim të një shtegu që të nxirrte në kala. Ky është mbyllur me një mur që lidhet në dy faqet e shkëmbit (fig. 18). Formimi i një tarrace pas murit i ka detyruar ndërtuesit të përdorin kanale për shkarkimin e ujrave, të cilat dallohen në fasadë krahas vrimave të skelave.

Kurtinat e murit rrethues të kalasë kanë trashësi 2.30-2.50 m. dhe janë ndërtuar me gurë katërkëndësh të vegjël, siç dalin nga shtresat e shkëmbit. Vendosja e gurëve në mur është bërë pa rreguil të caktuar. Llaçi i pregatitur me gëlqere, rërë të trashë dhe grimca tjegullash është përdorur me fuga deri në 3 cm. dhe paraqitet mjaft i qendrueshëm. Mbushja përbën një derdhje llaçi me përzierje gurësh të vegjël.

Sipërfaqja e kështjellës është mbushur me një mori themelesh të godinave të banimit, që janë vendosur larg murit rrethues. Në kundërshtim me këtë vjen një mungesë e theksuar e gjetjeve të qeramikës, që shpjegohet edhe nga përdorimi i rrasave të gurit për mbulimin e çative. Ndër gjetjet e tjera janë disa vegla pune bujqësore të gjetura në një shtresë të djegur gjatë pastrimit të një banese[9]). Këto na shtyjnë të zgjerojmë përfytyrimin mbi karakterin e kështjellës jo ve-



Fig. 15

9) Ruhen në muzeun e Elbasanit. Disa prej tyre janë botuar në artikullin tonë **Vështrim arkeologjik mbi rrethin e Elbasanit.** «Monumentet» 3, 1972, tab. XIV, 1, 2.

PHOTOCOPY



Fig. 16





Fig. 17

tëm si një fortifikim për sigurimin e rrugës që shkëputej nga Egnatia drejt jugut, apo të rrugës perëndimore për në luginën e Devollit, por edhe si një vendbanim me karakter bujqësor.

Planimetria e kështjellës dallohet menjëherë nga fortifikimet e vona antike të zonës së Elbasanit. Ajo përbën një punë të studjuar, me përdorim të gjërë të kullave të vendosura në distanca të caktuara. Kulla trapezoidale, që siç e vumë në dukje është një kullë trekëndëshe me majë të prerë, është një element i panjohur në fortifikimet e vona antike të vendit tonë. Paralelizmin më të afërt e gjejmë në kalanë e Durrësit ku kullat kanë formën e zakonshme pesëkëndëshe[10]). Edhe teknika e ndërtimit të mureve përkon me planimetrinë me të përpunuar. Gjërësia e madhe e mureve, llaçi i qëndrueshëm me përzierje shamoti i përdorur me shumicë, ngritja e skelerive me futje në mur gjatë ndërtimit, i takon një faze të dytë në ndërtimin e fortifikimeve të periudhës së vonë antike në zonën e Elbasanit.

Dega e rrugës Egnatia, që kalonte Shkumbinin tek ura e Topçiasit, ka pasur si drejtim kryesor kalimin nëpër Dumre, diku pranë Gradishtës së Belshit, ku bashkohej me të rruga që vinte nga lugina e Devollit. Që aty mund të vazhdohet nga jugu për të arritur në urën antike mbi Aps pranë Kuçit. Dy rrugë të tjera të nxirrnin drejt perëndimit për në fushën e Myzeqesë dhe drejt veriut, në vaun e Shkumbinit, pranë Bishqemit, prej nga kalohej më tej në fushën e Tiranës. Vetë Gradishta është një masiv shkëmbor gipsi në formë paralelopipedi, që ngrihet nga fundi i gropave karstike (fig. 19). Pjerrësia e kodrës nga jugu është pothuaj e pangjitëshme, ndërsa faqja veriore ndërpritet nga rrëzime shkëmbore. Një shteg në anën lindore dhe një ngjitje relativisht e lehtë nga ana e perëndimit të çojnë në syprinën e sheshtë të kodrës, e cila ndahet në dy pjesë nga një qafë e cekët në mes të saj.

Pozita strategjike në krahinën e Dumresë dhe kontrolli i rrugëve mjaft të rrahura në lashtësi, favorizoi krijimin e një vendbanimi në Gradishtë gjatë periudhës qytetare ilire. Në ndryshim, nga qytezat e tjera ilire të zonës, ky vendbanim jetoi pa ndërprerje deri në shek. I-II të e.sonë, duke kaluar në këtë kohë edhe një periudhë tjetër lulëzimi. Në shek. IV-VI veçohet një periudhë e tretë në jetën e qytezës, gjatë së cilës ndryshon edhe karakteri i vendbanimit. Sondazhet dhe vrojtimi në sipërfaqe dëshmojnë se vendbanimi ruajti po të njejtën shtrirje. Gjurmët e banesave të kësaj periudhe ndeshen në të gjithë sipërfaqen e qytezës. Gjithashtu

10) Gj. Karaiskaj na tërhoqi vëmëndjen në faktin se pjesa e sipërme e kullave të Durrësit është prerë për të krijuar një vend të përshtatëshëm për luftim. Duket se kjo ka shërbyer si model më pas për kullat e Qafës.

DO NOT COPY

për herë të parë territori i saj rrethohet me mure mbrojtëse.

Sondazhet, në pjesën më lindore të qytezës, treguan se shtresa e shek. IV të e.sonë ishte vendosur mbi një depozitim të shekujve të parë të erës sonë. Niveli më i poshtëm i saj (thellësia 1.55 m) përfaqësohet nga mbeturina të djegjes së një kasolleje me thurje thuprash dhe veshje balte. Qeramika përbëhet pothuaj krejtësisht nga enë guzhine të punuar me një baltë kafe me përzierje të shumtë silici. Vorbat trajtohen me trup të fryrë sferik dhe buzë të profiluara nga brënda për vendosje kapaku ose me buzë të trashuara (fig. 20,5-11). Si ornamente përdoren kanelyrat e gjera horizontale dhe brezat me vija të inçizuara sinusoidale (fig. 20,13-14). Kapakët (fig. 20,12) kanë karakteristikë një strehë në mesin e trupit që shërbente për ti kapur. Më të kufizuara janë format e pitosave dhe amforave (fig. 20, 1-4), këto të fundit me baltë të pastër ngjyrë okër në të verdhë. Shtresa prej 0.55 m që mbulonte horizontin e djegjes ishte një depozitim që përmbante materiale të së njëjtës kohë, ku gjendeshin ndër të tjera në numër të madh kokrra gruri dhe qiqrash të karbonizuara. Mbi këtë shtresë kishte vazhduar një depozitim i ngadalshëm, që datohet nga gjetja e një monedhe të Justinianit në shek. VI të e.sonë. Gjatë kësaj kohe kjo pjesë e qytezës nuk është përdorur për banim. Aty janë bërë varrime me konstruksion tjegullash në formë çatie.

Një varr gruaje kishte gjatësi 1.80 dhe gjerësi 0.60 m. Tjegullat solene me përmasa 0.73 x 0.43 (0.39) m. mbanin një ornament në formë tete të deformuar, të bërë me gishtërinj kur balta ishte e butë. Mbi kalypteret e vendosur në kulmin e konstruksionit ishin inçizuar me gishta vija të valëzuara. Trupi qe vendosur i shtrirë në shpinë me duar të kryqëzuara në gjoks. Tjegullat e një varri fëmije kishin profilin e zakonshëm të shek. VI në formë kokë zogu (fig. 20,15).

Gërmimi i zhvilluar në lugun, që përbën qafën e qytezës, nxorri në dritë një kompleks ndërtimesh të shek. IV-VI të përbërë nga muri i rrethimit, një mur tarracimi 0.80 m. i lartë (fig. 21) dhe ambientet e një punishteje tjegullash. Muri i tarracimit është vendosur në një shtresë të shek. I-II të e.sonë. Ndërtimi është bërë me gurë konglomerati gëlqeror të lidhur me një llaç të bardhë, që ka si mbushës zhavor të imët të marrë nga brigjet e liqenjve. Në gjerësinë prej 1 m. dallohen dy taqet dhe mbushja me gurë të vegjël.

Në tarracën e krijuar është vendosur një punishte tjegullash me katër ambiente katërkëndëshe. Ambienti



Fig. 18

i parë është një cisternë 3.90 x 3.60 m. Muri jugor i saj ngrihet me trashësinë 0.70 m. mbi murin e tarracimit. Bazamenti i cisternës përbëhet nga një shtrojë 0,10 m. me copa tjegullash të vëna pjerrtas mbi dheun e ngjeshur. Mbi to është hedhur një shtresë llaçi e njëjtë me atë të murit të tarracimit. Më në fund është vendosur shtresa izoluese prej llaçi me pluhur tjegullash, e cila kalon edhe si suvatim në muret[11]).

Uji i cisternës shkarkohej nëpërmjet një lëfyti me diametër 0.10 m. që mbushte një enë të madhe balte në formë kazani, e cila u gjet **in situ** (fig. 22).

Mbushja e cisternës me ujë bëhej nga ambientet që vazhdonin në veri të saj. Ambienti i parë ka përmasë 2.50 x 2.50 m. dhe është ndërtuar me gurë të lidhur me llaç. Vazhdon një ambient më të njëjtën gjërësi, i pagërmuar plotësisht, që lidhet nga 1. me një ambient të tretë me gjërësi 4 m. Një mur i ruajtur dobët nga I tregon se, ndërmjet tij dhe ambienteve të përshkruara kufizohej një oborr 4x4.50 m. me dalje nga muri i tarracimit.

Cisterna është përdorur për një kohë të gjatë, siç e dëshmojnë pesë shtresa të reja izoluese dhe një mur që zvogëlonte vëllimin e saj, të shtuara gjatë mere metimeve. Vetëm në periudhën e parë që lidhet me shtresën e shek. IV është përdorur ena e madhe. Në buzën karakteristike me prerje katërkëndëshe ajo është zbukuruar me një brez vijash të valëzuara, që përsëritet edhe në qafën e enës. Qypi ka qenë thyer dhe, duke qenë i vendosur në oborr, është mbuluar nga

11) Pregatitja e bazamentit të kujton deri-diku shtrojen e vaskave të ujit në termet e Bradasheshit: N. Ceka, — L. Papajani, **Termet dhe nymfeu i stacionit Ad Quintum,** «Monumentet», 4, 1972.

DOKUMENT



Fig. 19

DO NOT COPY

mbeturinat e punishtes, të cilat përbëhen nga një shtresë e trashë hiri dhe copa tjegullash. Në pjesën më të sipërme të kësaj shtrese u gjetën, in situ, një rradhë tjegullash kalyptere me valëzime gishtrinjsh në kurriz të mbështetura tek njera-tjetra (fig. 23) dhe një bel hekuri[12]). Gjetjet e qeramikës në këtë horizont, që datohet nga monedhat e Justinianit, në gjysmën e parë të shek. VI të e.sonë, janë të ralla. Përveç tjegullave të çatisë së rrëzuar, që kanë profilin karakteristik, u gjetën enë guzhine: vorba me buzë të profiluara ose me buzë të trashuara dhe tasa (fig. 20,16-19). Takohen edhe amfora që dallohen për kanelyrat e thella që përshkojnë barkun e tyre sipas vijave të çarkut. Për zbukurimin e pitosave përdoret ende brezi me vija sinusoidale (fig. 20,20) zakonisht me amplitude me të madhe dhe kënde të mprehta, si dhe një rrjetë kuadratesh me breza vijash të ndërthurura.

Horizonti i shek. VI të e. sonë shtrihet në gjithë pjesën perëndimore të qytezës dhe lidhet me një mur rrethues të ndërtuar në këtë kohë. Muri është ruajtur shumë dobët dhe ndiqet nga trakte të shkëputur në buzët perëndimore dhe jugore të syprinës së qytezës, por nuk dallohet asnjë shenjë kulle apo hyrje. Trashësia e murit nuk e kalon 1 m. dhe duket të ketë pasur një lartësi të vogël. Është ndërtuar me gurë konglomerati ose gurë gipsi me madhësi mesatare ose të vogël, të lidhur me llaç të dobët allçie me pak përzierje rëre.

Objektet metalike janë mjaft të ralla dhe përfaqësohen nga një sopatë hekuri me dy teha të barabartë e gjetur në sektorin C dhe një zile bronzi nga horizonti i sipërm i punishtes (fig. 24).

Nekropoli i qytezës gjatë shek. IV të e.sonë ka qenë në faqen e një kodrine të vogël që ngrihet rreth 100 m. në perëndim të shkëmbit të Gradishtës. Varret janë ndërtuar me çati prej tjegullash solene dhe nuk përmbajnë inventar, përveç fibulave të tipit kryq që mbërthenin pjesët e veshjes. Ky vend ka vazhduar të përdoret edhe në shek. VI, kur siç e pamë, janë bërë varrime edhe në pjesën lindore të qytezës.

Gradishta e Belshit është i vetmi fortifikim i vonë antik në zonën e Dumresë dhe duket qartë se ka qenë qendra administrative e saj. Ajo kryente njëkohësisht funksionin e kontrollit të rrugëve të rëndësishme tregtare dhe strategjike. Vazhdimësia e punishtes së tjegullave dhe gjetja e monedhave, dëshmon gjithashtu, se aty zhvillohej edhe një aktivitet i kufizuar ekonomik.

12) Shih N. Ceka, **Vështrim...**, tab. XIV, 3.



DO NOT COPY

Fig. 20

* * *

Në një vështrim të përgjithshëm të fortifikimeve të vona antike në zonën e Elbasanit mund të dallojmë dy grupe në bazë të kriterit kronologjik. Sipas të dhënave arkeologjike dhe paralelizmave në teknikën e ndërtimit, i takojnë çerekut të fundit të shek. IV të e.sonë ndërtimi i fortifikimeve në Xhyrë, Shkëmbin Mbret, Mengël, Gracen, Bodin, Valësh, Llixhë dhe Galigat. Në shek. VI kemi ndërtime të mirfillta kështjellash në Dardhë, Qafë dhe Belsh dhe rindërtim në Llixhë, Valsh dhe Skampin[13]). Fortifikimet e periudhës së parë karakterizohet nga planimetri të thjeshta që i përshtaten formës së koorave ku ngrihen. Në vendet e fortifikimeve të vjetra ilire Valsh, Gracen, Bodin, muret e tyre përdoren si substraksione ose shfrytëzohen në sistemin e ri të fortifikimit. Për kështjellat e ndërtuara nga fillimi (Llixhë, Galigat) është tipike planimetria e zgjatur eliptike, e cila përbën një formë të preferuar edhe për kala të kësaj kohe në zona të tjera të vendit tonë[14]). Veçori të tjera të kësaj periudhe në formën planimetrike janë «oborret» e fortifikuara (Llixhë, Gracen) dhe vendosja e hyrjeve pranë kthesave këndore të mureve (Gracen, Valsh).

Teknika e ndërtimit përbën gjithashtu një veçori për fortifikimet e këtij grupi. Muratura karakterizohet nga gjërësia e vogël, ndërtimi me faqe e mbushje të dalluar qartë, nivelimi i herpashershëm i gurëve në fasadë dhe ç'është më tipike, cilësia e dobët e llaçit. Ai ka një përmbajtje të shumtë gëlqereje, mbushës të trashë dhe përdoret me pakicë. Llaçi i kësaj periudhe shkriftohet lehtë dhe kjo ka bërë që muret e fortifikimeve të ruhen shumë keq.

Fortifikimet e periudhës së parë i ndeshim gjatë rrugës Egnatia, si dhe në zonën kodrinore e malore rreth Skampinit. Pjesa dërmuese e tyre ka sipërfaqe të vogël, që nuk i kalon 0.5 ha., gjë që flet për një karakter thjesht ushtarak. Kështu qyteza e Xhyrës dhe Shkëmbi Mbret qëndrojnë në lartësi të madhe mbi rrugë, duke e kontrolluar plotësisht atë, por njëkohësisht humbin kontaktin ekonomik me rrugën. Fortifikimet e ngritura në krahinat kodrinore apo malore në përgjithësi kontrollojnë rrugë sekondare dhe nuk kishin kondita për zhvillimin e një veprimtarie ekonomike. Karakteri jo ekonomik i këtyre fortifikimeve del në pah edhe nga pamja e brëndshme e tyre. Banesat që ndeshen përgjatë murit rrethues janë njëdhomëshe[15]), gjë që flet për ambiente të përdorura nga garnizone ushtarake. Me këtë përputhen edhe gjetjet e kufizuara dhe me cilësi të dobët të qeramikës.

Fortifikimet e ndërtuara në shek. VI janë në një numër shumë më të kufizuar se ato të periudhës së parë. Kalaja e Qafës është më tipikja prej tyre, me përdorim kullash të formave të ndryshme në distanca rreth 40 m. nga njera-tjetra. Kulla si element mbrojtës shtohet edhe në kalanë e Valëshit.

Përsa i përket teknikës së ndërtimit ka gjithashtu një ndryshim të dukshëm në krahasim me periudhën paraardhëse. Gjërësia e mureve është më e madhe dhe llaçi ka një cilësi mjaft të mirë[16]). Kjo i ka dhënë qëndrueshmëri mureve të kësaj kohe, të cilat në kalanë e Qafës ruhen deri në lartësinë 5 m.[17]). Ndoshta për këtë arsye vemë re, për herë të parë, vrimat e trarëve të skelave (Dardhë, Llixha dhe Qafë).

Nuk kemi ndonjë ndryshim në vendosjen dhe karakterin e fortifikimeve të periudhës së dytë. Të gjithë fortifikimet e periudhës së parë vazhdojnë të përdoren edhe në të dytën. Po ashtu kemi të njëjtën pamje me ambiente të vogla, zakonisht të vendosura larg murit, pranë vendeve të sulmit. Qeramika është tepër e rrallë ose përfaqësohet kryesisht nga enë guzhine dhe tjegulla. Veprimtaria ekonomike që përfaqësohet nga punishtja e tjegullave në Belsh apo gjetja e veglave bujqësore në Qafë, nuk e ndryshon tiparin kryesor të këtyre fortifikimeve, karakterin ushtarak. Për këtë flet edhe gjetja e kufizuara e monedhave, pjesa më e madhe e të cilave vjen nga rrënojat e punishtes së Belshit.

Ndarja e qartë në dy grupe e fortifikimeve të vona antike dhe vazhdimësia e grupit të parë gjatë tërë periudhës, dëshmon se ato u ndërtuan në rrethana të caktuara historike. Për grupin e parë kemi si mbështetje kronologjike gjetjen e monedhës së Valentinianit I në kullën e Gracenit. Që kjo nuk është diçka e rastit, dëshmohet nga prezenca e monedhave të të njëjtit perandor në shtresat që lidhen me fortifikimet e

13) Gj. Karaiskaj, **Të dhëna të reja për datimin e kalasë së Elbasanit,** «Monumentet», 3, 1972; 152.
14) Gj. Karaiskaj, P. Lera, **Fortifikimet e vona antike në rrethin e Korçës** (në këtë numër).
15) Kjo është një veçori që ndeshet edhe në fortifikime të tjera të kësaj periudhe. Shih B. Jubani, – N. Ceka, **Gërmime**..., 55-56.
16) Kjo është një veçori që e ndeshim në kalatë e tjera të kësaj kohe si në Dajt, Dorës, Rosujë etj.
17) Bën përjashtim vetëm Gradishta e Belshit, ku cilësia e dobët e llaçit shpjegohet me faktin se në vend të gëlqeres është përdorur aty gipsi.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 21



Fig. 22

vona antike në Selcën e Poshtëme dhe në Rosujë. Edhe tek këto fortifikime vëmë re të njëjtat veçori në planimetri dhe teknikën e ndërtimit: mungesën e kullave, linjën e thjeshtë të murit dhe llaçin e dobët, që e ka bërë murin të paqëndrueshëm. Të njëjtat veçori kanë edhe fortifikimet e periudhës së vonë antike në rrethin e Korçës[18]). Duket qartë se kemi të bëjmë me kështjella që u ngritën si rezultat i një veprim-



Fig. 23



Fig. 24

18) Gj. Karaiskaj – P. Lera, **Fortifikimet e vona.....**, kësaj periudhe i takon faza e parë e fortifikimit antik në kalanë e Trajanit dhe më shumë të ngjarë kalaja e Symizës, të cilën autori e vendos në shek. VI të e. sonë, megjithë prezencën e shtresës aktive të shek. IV të krijuar pas braktisjes disa shekullore të vendbanimit.

tarije të planifikuar ndërtuese. Që në kohën e Julianit II[19]) flitet për rindërtimin e mureve të qyteteve në Iliri dhe Maqedoni (Panegyrici latini, XI, 9), kur duket se u ndërtuan kështjellat e qyteteve kryesore, në rastin tonë Skampini. Thyerja e rëndë e ushtrisë romake nga gotët pranë Adrianopolit më 378, i hapi rrugën dyndjeve të njëpasnjëshme të tyre në Ballkan. Në kohën e Valentinianit I gotët e shkatruan Ilirikun (Amm. Marcellinus, XXX, 7) dhe ky u bë pre e sulmeve të tyre, veçanërisht në çerekun e fundit të shek. IV. Me këtë periudhë mund të lidhet ndërtimi i kështjellave të vogla. Gjatë Theodhosit ka patur gjithashtu një periudhë ndërtimi kështjellash siç del nga Codex Theodhosianus (XI, 17, 4), ku përcaktohet për Ilirinë puna e detyruar për këtë qëllim.

Vendosja e kështjellave në zonën e Elbasanit dhe vetë madhësia e tyre dëshmon se jo të gjitha ato ishin llogaritur për t'i bërë ballë invazionit të jashtëm. Duket qartë se kalaja e Valshit, e Galigatit, e Llixhave apo e Bodinit synonin më tepër të mbanin nën kontroll popullsinë vendase në kushtet e vështira të shthurjes ekonomiko-shoqërore dhe politike të perandorisë romake. Është shumë kuptimplotë pasazhi i Prokopit të Cezaresë (De bello vandalico, III, 2, 8), prej të cilit mësojmë se barbarët që plaçkisnin tokat e taulantëve, mund të kenë qënë ftuar nga vetë perandori Honor për të shtypur kryengritjen e popullsisë vendase. Gjatë këtij sulmi, sipas Prokopit, u shkatërrua një numër i madh qytetesh dhe kjo përputhet me shënjat e djegjeve në Selcë, Belsh apo Rosujë.

Shekulli V kalon pa lënë gjurmë të dukshme në fortifikimet e vona antike të zonës së Elbasanit dhe vetëm në shek. VI fillon një periudhë e dytë ndërtimesh[20]). Gjetja e monedhave të Anastasit apo Justinit në Belsh dhe Selcë dëshmojnë se Justiniani plotësoi një sistem fortifikimesh të menduar nga paraardhësit e tij dhe me të vërtetë lista e Prokopit është mjaft e kufizuar në krahasim me numrin e madh të kështjellave që njohim nga kjo kohë.

Shtresa e djegur që mbyll periudhën e gjatë të jetës në Belsh dëshmon për një fund të dhunshëm të këtij vendbanimi. Monedhat e datojnë këtë ngjarje në vitet e sundimit të Justinianit. Ndërprerja e jetës vihet re edhe në fortifikimet e tjera antike të zonës së Elbasanit, ku nuk ndeshim objekte dhe ndërtime më të vona se kjo kohë. E njëjta gjë është konstatuar nga gërmimet arkeologjike në Skampin, Selcën e Poshtëme, kalanë e Symizës, apo në Rosujë[21]). Kuptohet nga kjo se kemi të bëjmë me një ngjarje të zhvilluar në shkallë të gjërë, me një dyndje që u shtri në disa krahina të vendit. Në rastin tonë vijnë në konsideratë dyndjet sllave të mesit të shek. VI. Është për tu shënuar fakti se ato patën një karakter thellësisht shkatërrimtar, por njëkohësisht nuk lanë asnjë gjurmë tjetër në fortifikimet e shkatërruara. Por, ndryshe nga sulmet gote, pas të cilave kështjellat u rindërtuan, pas dyndjes sllave fortifikimet nuk u përtritën më edhe për disa shekuj. Duket se administrata bizantine nuk qe më në gjëndje të rivendosej në shkallë të gjërë dhe u kufizua në qytetet kryesore. Pas zhdukjes së Skampinit një qytet i tillë nuk u krijua në këtë zonë deri në themelimin e Elbasanit dhe vetëm nga studimi i vendbanimeve të hapura mund të ndiqet historia e kësaj periudhe.

DOWNTOPY

19) Veprimtaria ndërtuese e këtij perandori në vëndin tonë provohet nga një mbishkrim i vendosur në traktin jugor të rrugës Egnatia, H. Ceka, **Dega jugore e rrugës Egnatia** «Monumentet» 2, 1971, 17.

20) Edhe kjo periudhë ndërtimesh ka lënë gjurmë në tërë vendin tonë. Në rrethin e Korçës sipas kritereve të përcaktuara në fortifikimet e Elbasanit dhe të datimit që jep Gj. Karaiskaj, i takojnë kësaj periudhe kalaja e Zvezdës, Zaradishta, Menkulasi, dhe Trajani III. Të njejtat veçori në teknikën e ndërtimit i vëmë re në kalanë e Dajtit dhe atë të Dorëzit në rrethin e Tiranës, ku janë gjetur monedha të Justinianit, në Margëlliç (rrethi i Fierit) Amantia (S. Anamali, «Iliria» 2, 1972, Tab. III), Zharrëz (D. Komata, **Kalaja e Zharzës»,** Buletini Arkeologjik», Tiranë, 1971, 133. 140, të cilën autori megjith gjetjen e qeramikës tipike të shek. VI të e.sonë, e daton në shek. III-IV).

21) Shih respektivisht Gj Karaiskaj, **Të dhëna të reja...,** 152; N. Ceka; **La ville illyrienne,** 174; Gj. Karaiskaj — P. Lera, **fortifikimet e vona antike....** B. Jubani — N. Ceka, **Qyteza ilire e Rosujës,** 59.

Neritan CEKA

FORTIFICATIONS DE LA BASSE ANTIQUITE A PROXIMITE DE LA VIA EGNATIA

RESUME

La défense de la partie occidentale de la via Egnatia commençait par un groupe de fortifications élevées à proximité du principal tracé et de ses embranchements, dans la plaine de Domosdove et dans la vallée supérieure du Shkumbin. Un rôle de tout premier plan était rempli par Sofra e Skenderbeut à Pishkash, par les citadelles de la Basse Selce, de Manastirec et de Xhyre. Il y avait aussi un bon nombre d'autres citadelles, cependant plus petites et se trouvant à l'écart des principales voies de communication.

Toutes ces fortifications ont en commun la planimétrie qui est des plus simples; presque partout elles ne sont pas munies de tours et la ligne de leurs murs épouse les mouvements du terrain sur lequel elles sont construites. Elles ont également en commun la technique de construction. Leurs murs sont étroits, les pierres de petites dimensions et liées avec du mortier de chaux friable. Des fouilles archéologiques effectuées dans la Basse Selce, il ressort que ce groupe de fortifications appartient à la fin du IVe siècle.

Dans les gorges du Shkumbin, à proximité de Xibrake, sont conservées les traces d'une fortification de la basse antiquité. Du point de vue stratégique, elle représentait le poste le plus avancé du deuxième groupe de fortifications de la via Egnatia, dont le centre était l'ancienne Scampa.

Les fortifications de la basse antiquité situées dans la zone d'Elbasan peuvent être réparties, du point de vue chronologique, en deux groupes. Les fortifications de Xhyre, Skëmbi Mbret, Mengel, Gracen, Bodin, Valësh, Llixhe et Galigat, selon les données archéologiques et les analogies quant à la technique de construction, appartiennent au dernier quart du IVe s. de notre ère. En ce qui concerne les forteresses de Dardhe, Qafe et Belshe et la reconstruction des forteresses de Llixhe, Valësh et Scampa, ce sont des ouvrages qui ont été mis en place pour la première fois au VIe siècle. Les fortifications de la première période se caractérisent par une planimétrie simple, qui s'adapte à la forme des collines qu'elles surmontent. Dans les emplacements des anciennes fortifications illyriennes de Valësh, Gracen et Bodin, les murs de celles-ci ont été utilisés comme fondement par le nouveau système de fortifications. En ce qui concerne les forteresses construites au commencement (les forteresses de Llixhe, Galigat), elles se caractérisent par une planimétrie allongée elliptique, qui représente une forme préférée même pour les forteresses de cette période construites dans d'autres zones de notre pays. Un autre trait relatif à cette période, quant à la forme de la planimétrie, sont les «cours» fortifiés («Llixhe, Gracen) et l'aménagement d'entrées à proximité des détours angulaires des murs (Gracen, Valësh)

La technique de construction représente également un trait caractéristique des fortifications de ce groupe. Les murs sont généralement peu épais, leurs parements et leur remplissage se distinguent clairement, les pierres des façades sont parfois nivellées et le mortier est de mauvaise qualité, parce qu'il renferme trop de chaux, des liants grossiers et est employé avec parcimonie. Le mortier de cette période étant friable, les murs des fortifications en question sont très mal conservés.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Les fortifications de la première période longent la voie Egnatia ou s'élèvent sur les hauteurs des collines et des montagnes situées aux alentours d'Elbasan. Elles couvrent en général une surface relativement petite non supérieure à 1.5 ha et exercent une fonction exclusivement militaire. En ce qui concerne les fortifications construites dans les régions collineuses ou montagneuses, elles surveillaient en général des voies de communication d'une importance secondaire et ne remplissaient pas les conditions pour le développement d'une activité économique, ce qui est attesté par l'aspect de leur intérieur. Les habitations construites le long du mur d'enceinte sont à une seule pièce, ce qui témoigne que celle-ci était destinée exclusivement au séjour de la garnison militaire. Le nombre réduit de trouvailles mises au jour dans leur enceinte et la mauvaise qualité de la céramique sont une autre preuve en ce sens.

Le nombre des fortifications du VIe siècle est inférieur de beaucoup à celui de la première période. La forteresse de Qafe, la plus typique parmi elles, comporte des tours des formes les plus diverses disposées à 35 m. environ l'une de l'autre. La forteresse de Valesh a été également munie de tours et cela pour les raisons de caractère exclusivement militaire.

La technique de construction aussi se différencie beaucoup de celle de la période précédente. Les murs sont plus épais et le mortier d'une qualité meilleure. C'est pourquoi les murs sont plus solides et actuellement conservés, dans la forteresse de Qafe, jusqu'à une hauteur de 5 m. C'est pour la même raison que l'on relève, pour la première fois, les ouvertures aménagées pour les travées des échafauds (Dardhe, Llixhe et Qafe).

On ne relève aucune différence quant à la disposition et le caractère des fortifications de la deuxième période. Toutes les fortifications de la première période ont été utilisées pendant la deuxième période aussi. Les habitations de même comportent des pièces peu spacieuses, disposées généralement loin du rempart et à proximité des lieux d'attaque. La céramique est très rare, principalement représentée par de la vaisselle et des tuiles. L'activité économique attestée par la présence d'un atelier de tuiles à Belsh ou la trouvaille d'outils agricoles à Qafe ne modifie en aucune manière le trait principal de ces fortications, leur caractère militaire. En témoigne également le nombre restreint de monnaies mises au jour, dont la majorité ont été découvertes parmi les ruines de l'atelier de Belsh.

La répartition des fortifications de la basse antiquité en deux groupes bien distincts et la continuité du premier groupe pendant toute la période indiquée témoignent qu'elles ont été construites dans des circonstances historiques déterminées. En ce qui concerne le premier groupe, un important élément d'ordre chronologique est la trouvaille de la monnaie de Valentinien Ier dans la forteresse de Gracen. A l'époque de Valentinien, les Goths ont dévasté l'Illyricum (Amien Marcellini, XXX, 7) qui a été l'objet de leurs attaques particulièrement vers la fin du IVe siècle. C'est à cette période que se rattache vraisemblablement la construction des forteresses plus petites. Le règne de Théodose également a été marqué par une période de construction de forteresses, comme l'atteste le Code Théodosien XI, 17, 4, qui prévoit le travail obligatoire pour l'Illyrie à cette intention.

L'édification de ces forteresses dans la zone d'Elbasan et leurs dimensions même montrent qu'elles n'étaient pas exclusivement destinées à faire face à l'invasion étrangère, mais qu'une bonne part d'entre elles visaient surtout à tenir sous leur contrôle la population locale dans les difficiles conditions de décomposition économique, sociale et politique de l'empire romain. Une signification particulière revêt en ce sens le passage de Procope de Césarée (De bello vandalico, III, 2, 8), selon lequel les barbares qui pillaient le territoire des Taulantins peuvent avoir été invités par l'empereur Honorius en personne pour écraser la révolte de la population locale. Pendant cette attaque, selon Procope, un bon nombre de cités ont été détruites et cette affirmation est confirmée par les traces d'incendies à Selce, Belsh ou Rosunje.

Le VIe siècle est marqué par une deuxième période de constructions. La mise au jour des monnaies d'Anastase ou de Justin à Belsh et Selce montre que Justinien n'a fait que compléter le système de fortifications envisagé par ses prédécesseurs et que la liste de Procope est véritablement plutôt limitée par rapport au grand nombre de forteresses que nous connaissons pour cette époque.

La couche incendiée qui clôture la longue période de vie à Belsh témoigne en faveur d'une fin violente pour cette agglomération. Les monnaies trouvées attribuent cet événement aux dernières années du règne de Justinien. L'interruption de la vie s'observe également dans les autres forteresses anciennes de la zone d'Elbasan, où on n'a pas rencontré des objets et des constructions appartenant à une période de temps plus récente. Les fouilles archéologiques effectuées à Scampa, dans la Basse Selce, dans la forteresse de Symize ou de Rosuje ont démontré la même chose. Il va de soi que nous avons affaire à l'invasion de certaines régions de notre pays et précisément aux invasions slaves de la moitié du VIe siècle. Par la suite les fortifications de la zone d'Elbasan n'ont été plus remises en place pendant un long temps. La faiblesse caractérisant l'administration byzantine ne permettait pas à celle-ci d'entreprendre une action de grande envergure tendant à rétablir son autorité à travers tout le pays, aussi s'est-elle limitée aux villes les plus importantes.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ – Petrika LERA

DO NOT COPY

FORTIFIKIMET E VONA ANTIKE NË RRETHIN E KORÇËS

Ndërmjet ndërtimeve të shumta mbrojtëse, të zbuluara në rrethin e Korçës, një vend me rëndësi zenë ato të periudhës së vonë antike. Ato janë ndërtuar mbi lartësitë që rrethojnë fushën, si dhe gjatë rrjedhës së Devollit, duke zënë gjithnjë pika të rëndësishme strategjike (tab. VI). Në ditët tona këto fortifikime kanë arritur tepër të rrënuara; shpesh trasetë e mureve ndeshen të rrafshuara me tokën, por megjithatë, në tërësi ato ruajnë tiparet e epokës në të cilën u ndërtuan.

Qëllimi i këtij shkrimi është të japë përshkrimin dhe skicat planimetrike, si dhe disa nga karakteristikat më të përgjithëshme të këtyre fortifikimeve, deri tani të pa studiuara dhe në të shumtën e rasteve të panjohura.

Kalaja e Zvezdës (tab. V), ndodhet rreth 16 km. në verilindje të Korçës, rrëzë Malit të Thatë dhe pranë fshatit me të njëjtin emër.

Për Zvezdën kemi vetëm disa njoftime të shkurtra. Ajo përmendet nga Liku[1]), i cili nuk sheh aty gjurmë antike dhe e identifikon atë me Selasforin, si rrjedhim me qytetin mesjetar të Devollit. Kodra mbi të cilën ndodhet kalaja është krejtësisht shkëmbore dhe thirret nga vendasit «Maja e Shkëmbit» ose «Mbizvezdë». Nga ana e fshatit ajo bie në një faqe të pjerrët, ndërsa nga anët e tjera lidhet butë me vargun e Malit të Thatë. Pozicioni i përshtatshëm dhe dominues i Shkëmbit bën të mundur jo vetëm vrojtimin e qafës së Zvezdës, por gati të gjithë fushës së Korçës dhe të një pjese të mirë të fushës së Devollit.

Maja e Shkëmbit përfundon me një sipërfaqe të sheshtë, e cila zbret në formë tarracash dhe, njëkohësisht, zgjerohet në drejtim të veriperëndimit. Një mur, rreth 400 m i gjatë, rrethon vetëm anën verilindore dhe veriperëndimore, duke lënë të pa fortifikuara pjesët e tjera, të cilat nuk kanë pasur nevojë për mbrojtje artificiale, për shkak të pjerrësisë së madhe të terrenit.

Përveç murit të jashtëm në kala vihen re edhe disa mure tërthore, të cilët e ndajnë atë në disa pjesë. Pjesa më e lartë e kodrës ndahet nga një mur tërthor 42 m i gjatë, i cili krijon një akropol që ka formën e një katërkëndëshi 25 x 42 m. Në skajin lindor të akropolit vihen re gjurmët e një kulle të brendshme, konturet e së cilës nuk dallohen qartë. Kulla është vendosur në një pozicon, nga ku mund të vrojtohet më mirë qafa e Zvezdës. Paralel me murin ndarës të akropolit, në largësi 8 m prej tij, ruhen gjurmët e një rruge të shtruar me kalldrëm 2,5 m të gjerë. Përveç murit ndarës të akropolit në kala vihet re edhe një mur tjetër me funksion të ngjashëm. Ai veçon një sipërfaqe të vogël, e cila bije me një disnivel prej 10-15 m, në skajin verior të kalasë. Gjurmët e këtij muri shumë të rrënuar dallohen aty-këtu rrafsh me tokën.

Përveç mureve mbrojtës, në kala vërehet edhe një mur tarracimi, që shkon paralel me murin ndarës të akropolit 48 m, në veriperëndim të tij dhe që ka një gjatësi prej 57 m. Menjëherë pas këtij muri, sipërfaqja e kalasë fillon të zgjerohet në mënyrë të dukshme. Në këtë kala vumë re dy hyrje, që të dyja në murin verilindor, njera prej tyre me gjërësi 3 m, pothuajse në skajin veriperëndimor të këtij muri, ndërsa tjetra jo aq e sigurtë, rreth 150 m në juglindje të së parës.

1) W.M.Leake, **Travels in Northern Greece,** London 1835, I, 339.

DO NOT COPY



Fig. 1

Muret pothuajse kudo janë të rrafshuara me tokën, dhe vetëm në disa vende arrijnë lartësinë pak më tepër se 1 m. Trashësia e tyre lëviz nga 1,40-2,20 m. Bërthama e murit përbëhet prej gurësh kave me përmasa të vogla të lidhura me llaç të bollshëm prej gëlqereje të përzier me xhavorr. Gurët e faqeve janë vendosur në mënyrë të çrregullt dhe rrethohen nga fuga të trasha llaçi. Gjurmë brezash druri nuk shihen. Në ndërtimin e mureve të bije menjëherë në sy një punë e nxituar.

Jeta në këtë vendbanim fillon qysh në periudhën e parë të hekurit. Fragmente të qeramikës së pikturuar të kësaj periudhe ndeshen shpesh në «Majën e Shkëmbit», si dhe në një kodër rreth 500 m në verilindje. Por vend të rëndësishëm zë qeramika e periudhës së vonë antike dhe e mesjetës së hershme. Gjithashtu, janë gjetur prej fshatarëve disa monedha të Justinianit I, të cilat sot ruhen në muzeun e Korçës. Qeramika e periudhës së vonë antike përfaqësohet nga një shumicë enësh të përdorimeve të ndryshme. Enët me parete të holla, shpesh janë zbukuruar me inçizim ose me pikturim. Inçizime të bëra para pjekjes, hasen në formën e brezave të valëzuar ose paralelë, si dhe të kanaleve horizontalë, që mbushin barkun e enës (tab. II, 9). Këto motive i gjejmë edhe në qeramikën e periudhës së vonë antike të zbuluar në Symizë, si dhe në qendra të tjera të kësaj periudhe.

Fragmentet e zbukuruara me pikturim, të gjetura më me pakicë në Symizë, përfaqësohen nga parete enësh të lyera me breza ngjyrë kafe në gështenjë, të cilat vendosen në mënyrë të çrregullt vertikalisht me barkun e enës. Këto motive janë karakteristike për qeramikën e shek. IV të gjetur në Bradashesh, Belsh dhe Elbasan[2]). Por fragmentet e gjetura në Zvezdë ndryshojnë prej atyre të Elbasanit, Bradasheshit, Belshit dhe Symizës, nga që faqja e brendshme e enës është lyer me zmalto jeshile. Nga kjo pikëpamje kjo qeramikë ka ngjashmëri me atë të gjetur në Rosujë, në shtresën kulturale të shek. IV-V të e.sonë.[3])

Kalaja e Zaradishtës (fig. 1), ndodhet rreth 8 km në perëndim të qytetit të Korçës, pranë fshatit me të njëjtin emër.

Ajo është ndërtuar mbi një kodër që nuk i kalon të 50 m, prej së cilës kontrollohet një pjesë e mirë e anës perëndimore të fushës së Korçës. Nga lindja kodra zbret butë në një faqe që ka formën e një trekëndëshi dybrinjënjishëm, ndërsa nga perëndimi lidhet me anën e një qafe të lartë me vargun e kodrave në vazhdim.

Muret rrethonin konturin natyral të kodrës dhe kishin një perimetër prej rreth 1 km. Në pjesën më të lartë të kodrës, ruhen gjurmët e një kulle të rrumbullakët me diametër të jashtëm 7 m. Ajo ka qenë ndërtuar për ta mbrojtur kalanë nga ana perëndimore, që megjithëse është pjesa më e lartë, njëkohësisht është një nga pikat që mund të sulmohet më lehtë, për shkak të disnivelit të pakët me kodrën fqinjë. Kulla nuk është vendosur në kulmin e trekëndëshit që krijon planimetria e kalasë, por është spostuar pak nga veriu, pas një bryli të krijuar nga muri rrethues. Nuk dihet në se ka patur nga një kullë edhe në dy këndet e tjera të trekëndëshit, pasi këtu gjurmët humbasin.

Një mur tjetër, rreth 170 m në lindje të kullës,

2) Gj Karaiskaj. **Disa të dhëna të reja për datimin e kalasë së Elbasanit.** Buletin Arkeologjik. Tiranë 1971, 166.
N. Ceka, **Qeramikë romake nga rrethi i Elbasanit.** (artikull i pabotuar. Me këtë rast falenderojmë autorin që na vuri në dispozicjon këtë materjal.
3) B. Jubani–N.Ceka, **Qyteza ilire e Rosujës (rrethi i Tropojës),** «Iliria» I, Tiranë 1971, 59.

veçonte kulmin e trekëndëshit nga pjesa tjetër e kalasë.

Muret janë rrënuar pothuajse krejtësisht para shumë kohësh, për shkak të përdorimit të gurëve të tyre për ndërtimin e banesave, por janë ruajtur kanalet e hapur për të shfrytëzuar materjalin deri në themel. Nepërmjet tyre mund të nxirret lehtë forma e fortifikimit. Tek-tuk ruhen trakte të shkëputur muresh, prej nga mund të gjykohet mbi teknikën e ndërtimit. Ato kanë pasur një trashësi prej 2,2 m, duke ruajtur të njëjtën masë edhe në themel. Muret janë ndërtuar me gurë lumi të madhësisë mesatare, pa u përpunuar me dorë. Llaçi i përdorur si lidhës ka ngjyrë të bardhë dhe është i përzier me zhavor dhe copra të rralla tullash. Nga ndërtimet e brendshme të kalasë nuk ruhet asgjë. Në sipërfaqen që përshihet brenda mureve, vihen re mjaft fragmente qeramike, kryesisht enësh të përdorimit të përditshëm. Nxjerr me karakteristikat janë vorbat me qafë të shkurtër dhe buzë të profiluara nga jashtë, me trup sferik e fund të sheshtë. Ngjyra e brumit të këtyre eneve është zakonisht kafe në të zezë. Mjaft prej tyre janë zbukuruar me motivin e brezave të valzuar ose paralele të ngjashme me qeramikën e vonë antike të Symizes dhe Zvezdës. Qeramika e ndërtimit përfaqësohet nga fragmente të shumta tullash dhe tjegullash me profile karakteristike për periudhën e vonë antike.

Në pjesën perëndimore të kalasë, në faqen e një kodre, që ndodhet jashtë mureve mbrojtës, u zbuluan gjurmët e një nekropoli. Varret ishin dëmtuar dhe nuk dhanë ndonjë inventar. Ato ishin ndërtuar me tjegulla solene të periudhës së vonë antike. Brenda territorit të kalasë, gjatë punës për hapjen e themeleve për banesa, u zbulua kanet e funait një kolonë shtufi, që nga forma dhe kryqi i gdhendur në të është i zakonshëm për kolonat e dritareve të kishave paleokristiane (fig. 2). Në vendin e gjetjes së kolonës u vunë re dhe gjurmë mozaiku, shumë të dëmtuar. Mbeturina të tjera antike në fshat nuk vunë re. Por vetëm 15' në jugperëndim të Zaradishtës, në fshatin Polenë, ruhen gjurmët e një vend-banimi të hapur të periudhës së vonë antike. Nga gjetjet më të rëndësishme janë: një mozaik paleokristian, bazamente kolonash, një gur varri me mbishkrim grekisht, si dhe objekte të tjera që ruhen në muzeun e këtij fshati.

Kalaja e Menkulasit, ndodhet në rrjedhën e sipërme të lumit Devoll, në jug të fshatit me të njëjtin emër. Kodra mbi të cilën ajo është ndërtuar ka formën e një trungu koni (fig. 4), e cila nga veriu bije me një faqe të pjerrët mbi Devoll, ndërsa nga lindja dhe perëndimi ndahet nga vargu i kodrave në vazhdim prej dy përrenjve të thellë: përroit të Mysliut



Fig. 2

dhe të Shkallës, të cilët e bëjnë të vështirë afrimin në kala.

Kodra përfundon me një platformë 150 m. të gjatë dhe 40 m. të gjerë, të orjentuar me anët më të ngushta në drejtimin lindje-perëndim.

Pjesa jugore e platformës është më pak e mbrojtur; në këtë anë dallohen dhe gjurmët e një muri, me gjatësi rreth 300 m. (fig. 3).

Muri është tepër i rrënuar. Ai është ndërtuar me gurë lumi dhe kave të përmasave të vogla të lidhura me llaç. Llaçi është më shumë gëlqere, i përzierë me rërë të ashpër. Gjerësia e tij nuk mund të matet në asnjë vend, për shkak të rrënimit të tepërt.

Brenda territorit të kalasë, takohen vetëm pak fragmente qeramike, kryesisht vegje enësh me një kanelyrë të theksuar në pjesën e sipërme, të cilat ndeshen më shpesh në antikitetin e vonë.

Kalaja e Trajanit (tab. IV), ndodhet mbi një kodër të lartë shkëmbore, e cila ngrihet mbi liqenin e Prespës së Vogël, në veriperëndim të fshatit Tren. Pjesa më e lartë e kodrës përfundon me nji platformë të gjerë, mjaft të përshtatshme për banim, e cila ka formë ovale dhe bije me një pjerrësi të lehtë nga veriperëndimi në juglindje. Gjatësia e platformës është rreth 400 m, ndërsa gjerësia mesatare 150 m.

Muret ndjekin formën natyrale të terrenit, duke ju shmangur asaj vetëm në anën juglindore, ku muri ndjek një linjë të drejtë. Ato janë ndërtuar mbi mure

DO NOT COPY



Fig. 3

më të vjetër, që i përkasin periudhës së parë të hekurit[4]). Vetëm pjesa veriperëndimore, krejtësisht shkëmbore dhe e thepisur, është lënë pa u fortifikuar, megjithëse aty-këtu midis shkëmbinjve është ndërtuar ndonjë mur i shkurtër që i lidh ato, por këto mure më shumë shërbenin si parapetë për të shmangur aksidentet se sa për t'u mbrojtur.

Përveç mureve rrethuese një mur tërthor 116 m i gjatë veçon një sipërfaqe të vogël, në pjesën më të lartë të platformës, prej të cilit ruhen vetëm gjurmë të pakta. Kulla nuk vihen re në asnjë vend, vetëm në mesin e murit verilindor del një dhëmbëzim këndrejtë 2,2 m, që luan deri diku rolin e një kulle.

Në këtë fortifikim mundëm të vemë re katër hyrje. Njera ndodhet në mesin e murit jugperëndimor (a), gjerësia e së cilës nuk mund të matet, pasi nuk ruhet njera nga paturat. Në hyrje 2,2 m e gjërë, vihet re në murin juglindor (b), gjithashtu akropoli lidhet me pjesën tjetër të kalasë me një hyrje 2 m. të gjërë (c), e cila ndodhet afërsisht në mesin e murit ndarës. Hyrja e fundit ndodhet në murin verilindor, (d). Kjo është vetëm 0,90 m. e gjerë e mbrojtur nga pjerrësia e madhe e shpatit dhe e fshehur prej syrit të armikut, i cili nuk mund ta sulmonte kalanë nga kjo anë. Ajo shërbente, me sa duket, si dalje e fshehtë në raste rrethimi.

Nga ndërtimet e brendshme ruhet vetëm një ambient katërkëndësh, i cili i mbështetet nga ana e brendshme e murit të kalasë, në qoshen lindore. Nga ky ambient mund të matet vetëm gjerësia prej 5 m, ndërsa gjatësia e tij nuk mund të kapet, pasi gjurmët humbasin në drejtim të veriperëndimit. Këtij ambienti i përkasin dy kamare me përmasa 0,60 x 0,40 m. dhe thellësi 0,60 m. të ndërtuara në faqen e brendshme të murit të kalasë.

Muret e kalasë kanë një trashësi prej 1,8-2 m. Ata ruhen në lartësi 1 m, vetëm në pjesën verilindore dhe juglindore, ndërsa në anët e tjera janë të rrafshuara me tokën. Muret janë ndërtuar me gurë kave të lidhura me llaç pa përdorur breza druri. Nga teknika dallohen qartë dy periudha ndërtimi. Në pjesën jugore muret ndjekin një linjë të drejtë dhe bashkohen në qoshe, gjithashtu në kënde të drejta. Gurët e faqeve janë më të mëdhenj se në pjesën tjetër të kalasë dhe janë vendosur deri diku në rreshta. Llaçi është i dobët dhe i imët. Nëpër fuga, nga koha, ai është gërryer duke marrë ngjyrën e dheut. Kjo teknikë vihet re vetëm në qoshen lindore të kalasë dhe përfshin një mur 16,3 të gjatë në verilindje. Faza tjetër përfshin pjesët e mureve që mbetet. Ajo është ndërtuar në një periudhë më të vonë, gjë që kuptohet lehtë po të vëresh me kujdes vendin e takimit të dy periudhave në anën verilindore, ku muri i ri mbështetet mbi të vjetrin. Në periudhën e dytë të ndërtimit janë përdorur gurë kave më të vegjël, llaçi është më i fortë dhe më i ashpër, i përzierë me copra të vogla çakëlli, ndërsa fugat janë të mbushura. Kjo teknikë ka ngjashmëri me atë të përdorur në kalanë e Zvezdës.

Qeramika në sipërfaqen e rrethuar është e pakët dhe i përket periudhës së vonë antike dhe mesjetare. Në kala janë gjetur gjithashtu monedha të shek. V-VI të e.sonë.

Kalaja e Kakaçit (fig. 5), ndodhet në njerën prej kodrave që shtrihen në të majtë të rrugës automobilistike Korçë-Pogradec, rreth 8 km në veri të qytetit të Maliqit. Ajo thirret nga vendasit «Qytet» ose «kalaja e Kakaçit». Kodra përfundon me një platformë që ka formën e një elipsi me gjatësi 120 m dhe gjerësi 50 m. Muret e kalasë janë tepër të rrënuar dhe ndjekin konturin e terrenit. Në këto mure mundëm të dallojmë dy periudha të ndryshme ndërtimi, të cilat ngriheshin mbi të njejtën planimetri. Më e herëshmja përfaqësohet nga mure të ndërtuara me blloqe gurësh të papunuar me përmasa relativisht të mëdha të vendosura në të thatë, dhe i takon periudhës së parë të hekurit[5]).

Periudha e dytë e ndërtimit, përbëhet nga një mur guri i lidhur me llaç dhe i vendosur mbi ndërtimin e vjetër. Ky mur është tepër i rrënuar. Ai është ndërtuar prej gurësh me përmasa më të vogla, por vende-vende janë shfrytëzuar dhe blloqe gurësh të fortifikimit më të vjetër. Llaçi është i bardhë, i përzier me zhavorr të imët, në të gjejmë të futura edhe fragmente qeramike.

4) Shih Gj.Karaiskaj – P. Lera, **Fortifikimet e periudhës së parë të hekurit në pellgun e Korçës,** «Studime historike», 1, 1973, 116-117.
5) Gj. Karaiskaj – P. Lera, **vep. cit.,** 114.

DO NOT COPY



Fig. 4

Gjurmët e këtij fortifikimi ruhen në të gjithë planimetrinë. Muri ka një gjerësi prej 1, 8– 2 m. d.m.th. më se 1 m. më i ngushtë nga ai i periudhës së parë të hekurit. Kjo është realizuar duke prishur faqen e brendshme të murit të vjetër dhe duke shfrytëzuar faqen e jashtme të tij. Në pjesën veriore të kalasë ruhen gjurmët e një kulle katërkëndëshe të rrënuar. Ajo del 7 m nga muri rrethues dhe ka një gjërësi prej 8 m. Gjërësia e plotë e mureve të saj nuk ruhen. Bazamenti i kullës është ndërtuar me gurë të vegjël të lidhur me llaç dhe i përket krejtësisht periudhës së dytë të ndërtimit. Ashtu si në kalanë e Zaradishtës kulla është ndërtuar në pikën më të dobët të fortifikimit, atje ku kodra e kalasë lidhet me anën e një qafe të lartë me një kodër fqinjë.

Rreth 25-30 m në jug të kullës katërkëndshe, kalon një mur me drejtimin lindje-perëndim, i cili ndan veças një pjesë të territorit të kalasë dhe përshkon kuotën më të lartë të kodrës. Ai ruhet në trajtën e një rrënoje. Gurët janë të vegjël dhe ndërmjet tyre dallohen mbeturina llaçi. Në mesin e murit ndodhet një grumbull i madh gurësh me lartësi 3-4 m. Pozicioni dhe vetë grumbulli i gurëve të lënë të kuptosh, se këtu ka patur një kullë, prej së cilës mund të sigurohej vrojtimi më mirë nga çdo pikë tjetër dhe, njëkohësisht, të shërbente për të mbrojtur pjesën veriore të kalasë si vendstrehim i fundit, Nga qeramika e ndeshur mbi sipërfaqe, vend të rëndësishëm zinte ajo e periudhës së vonë antike.

Gradishta e Symizës (fig. 6,7), ndodhet 10' në veri të qytetit të Maliqit, mbi një kodër të lartë. e të pjerrët nga tëra anët në formë konike. Në perëndim, veri dhe jugë të saj shtrihet një terren i gjerë kodrinor, nga lindja syri të kap një horizont që shtrihet



Fig. 5

DO NOT COPY



Fig. 6



Skicë planimetrike

Fig. 7

nga skaji më verior i fushës së Korçës, deri tek Qafa e Zvezdës dhe Mali Ivan, ndërsa nga perëndimi kontrollohet lugina e Devollit. Në majë, kodra përfundon me një platformë eliptike të përshtatshme për banim, që zgjatet në drejtimin veri-jugë 220 m dhe lindje-perëndim 70 m.

Gërmimet arkeologjike të kryera gjat muajit Gusht 1973 zbuluan një mur me lloç shumë të rrënuar, që ndiqte anën perëndimore të platformës. Muri vazhdonte drejtimin e një fortifikimi më të vjetër të ndërtuar me blloqe gurësh këndrejtë me faqe të rafshtë të periudhës helenistike. Ashtu si i pari, ai rrethonte gjithë platformën, duke përfshirë një sipërfaqe prej rreth 1 ha dhe kishte një gjatësi të përgjithëshme prej 530 m. Gërmimet vërtetuan gjithashtu, se vetëm pjesa e sipërme e kodrës ka qenë e banuar, ndërsa tarracat e gjëra që zbresin në taqen lindore nuk kanë qenë të banuara në asnjë periudhë. Muri është ndërtuar me gurë të vegjël të thyer të lidhur me një llaç të bardhë me mbushës të trashë. Gjatë gërmimit shtresat kulturale dolën të përziera.

Qeramika më e vonë i përkiste periudhës së vonë antike. Disa fragmente qeramike me pikturim (shirita ngjyrë kafe të kuqëremtë), të ngjashme me ato të gjetura në Elbasan i përkasin shek. IV të e.sonë.[6]) Po kësaj periudhe i përkasin edhe disa tasa, si dhe vorba me buzë të kaneluar për vendosjen e kapakut[7]) (tab. II,5, tab.I,6,8). Por shumica e fragmenteve të qeramikës së antikitetit të vonë i përkasin shek. VI. Të tilla janë barqet e enëve të zbukuruara me kanelyra të gjëra dhe kanelyra të ngushta të punuara ashpër, të zbuluara edhe në Elbasan[8]) në formë brezash të valzuar që shpesh herë bashkohen me maje të mprehtë etj.

Bashkë me këto fragmente janë gjetur monedha të Anastasit I dhe Justinianit I. Një teknikë tjetër zbukurimi është ajo me ngulitje. Motivet paraqiten në formën e gropzave në trajta e përmasa të ndryshme të vendosura në rreshta horizontalë. Ky motiv vendoset në shpatull të enës dhe rrallë në buzën e saj. Në enët me grykë të gjërë takojmë nga një herë zbukurime me gërvishje para pjekjes, në formë valëzimesh të shkëputura dhe të çrregullta, të cilat ndërpresin njëra tjetrën, ndërsa barku i enës zbukurohet me kanale horizontale (tab.II,1).

Nga ndërtimet e kësaj periudhe paraqet interes dhe zbulimi i një stere që ndodhet në skajin jugperëndimor të platformës së kalasë.

Stera, (tab. III), ka në plan formën e germës T. Pjesa tërthore ka një gjatësi prej 4,80 m, kurse gjatësorja 4,40 m. Gjërësia e sterës është 1,20 m., ndërsa thellësia 2,48 m. Ajo është e mbuluar me një qemer cilindrik, me trashësi 35 cm. të ndërtuar me gurë çmërsi. Nga ana e brendshme muret e sterës janë suvatuar me një shtresë llaçi të bardhë, mbi të cilën ndodhet një shtresë llaçi shamot, me trashësi 3 cm, që shërbente si hidroizolues. Të gjitha këndet e bashkimit të mureve, nga ana e brendshme, janë të rrumbullakosura për të qenë me rezistente, si dhe për të lehtësuar pastrimin. Stera lidhet me një grykë pusi, i cili

6) Gj. Karaiskaj, **Disa të dhëna të reja.... art.cit,** 116.
7) Kjo keramikë është datuar në shek. IV nga gërmimet e bëra në termat e Bradasheshit prej N. Cekës, **art. cit.**
8) Gj. Karaiskaj, **art. cit.,** 166-67.

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9

ndodhet në fundin e pjesës gjatsore. Pusi ka një diametër prej 0,50 m. është ndërtuar me muraturë guri, dhe është veshur gjithashtu nga ana e brendshme me një shtresë llaçi të bardhë dhe, mbi të, me një shtresë 3 cm. të trashë llaçi shamot. Për shkarkimin e ujrave të tepërta është ndërtuar një kanal me prerje katërkëndëshe, 0,25 x 0,17 m, i cili lidhet me pjesën tërthore të sterës dhe i shkarkon ujrat në drejtim të murit të kështjellës.

«Mali i Dishnicës» quhet njëra nga majat e vargut kodrinor që ndodhet në lindje të qytetit të Korçës, e cila gjendet në jugperëndim të fshatit me të njëjtin emër. Në një ekspeditë informative të mëparshme[9]) është zbuluar këtu një kala e tipit të periudhës së parë të hekurit, që rrethonte një sipërfaqe prej 3000 m². Mbi fortifikimin e vjetër u vunë re gjurmë muresh të lidhura me llaç të një kohe më të vonë, romake apo mesjetare. Qeramika e gjetur në sipërfaqe i përkiste periudhës helenistike dhe kohës së vonë romake[10]). «Mali i Dishnicës» vjen duke u ngritur në drejtim të qytetit të Korçës, Në majën më të lartë të tij dallohen gjurmë të një ndërtimi, të cilat nuk janë vënë re nga vrojtuesit e mëparshëm. Mbi këtë majë krijohet një shesh shumë i vogël (rreth 50 x 15 m). ku ruhen dy grumbuj gurësh me gjurmë llaçi dhe konturet e një ndërtimi katërkëndësh. Ky i fundit, ka një gjërësi prej 2 m nga ana e brendshme, gjatësia nuk ruhet e plotë (1.35m), ndërsa muret kanë një trashësi prej 3m. Ato janë ndërtuar me gurë të thyer të madhësive mesatare të lidhur me llaç të përzierë me pluhur të imët tullash, teknikë e përdorur kryesisht në kohën e vonë antike. Gjërësia e mureve është e madhe për një banesë, ndërsa hapësira e brëndëshme tepër e vogël. Gjithashtu, vendosja e saj në majën më të lartë nga ku dominohet një zonë mjaft e gjërë e fushës së Korçës, të le të kuptosh se kemi të bëjmë me një kullë vrojtimi. Teknika e ndërtimit dhe qeramika e datojnë atë në kohën e vonë antike. Ne mendojmë se kjo kullë lidhet dhe me një vendbanim të hapur, po të kësaj periudhe, që ndodhet jo më larg se 1 km, në fshatin Neviçisht.

Kalaja e Gopeshtit[11]) është një fortifikim tjetër, ku është përdorur e njëjta teknikë ndërtimi (mure guri lidhur me llaç përzier me pluhur tullash). Ajo ndodhet në krahun e djathtë të rrjedhës së Devollit, mbi një kodër flishore në veriperëndim të lokalitetit të Mogliçës. Muret e saj 2 m. të gjërë, sot në gjendje shumë të dëmtuar, rrethonin një sipërfaqe të vogël, ndërsa qeramikë nuk vihet re.

Kalaja e Bllacës[12]) ngrihet mbi dy kodra shkëmbore me një bazë të përbashkët, në perëndim të fshatit

9) Zh. Andrea, **Rezultatet e kërkimeve informative në rrethin e Korçës.** «Materjale të sesionit arkeologjik», Tiranë 1968, 127.

10) **Po aty,** 127.

11) P. Lera, **Gjurmë të reja të lashtësisë në rrethin e Korçës,** «Monumentet», 1, 1971, 178.

12) Për kalanë e Bllacës shih. N. Ceka — A. Baçe, **Vrojtime arkeologjike në rrethin e Pogradecit, luginën e Devollit dhe Shkumbinit,** «Monumentet» 3, 1972.

DO NOT COPY

Bllace, në juglindje të Pogradecit dhe të rrugës natyrale që lidh Liqenin e Ohrit me fushën e Korçës.

Tre fortifikime të tjera ndodhen në anën perëndimore të fushës së Korçës.

Kalaja e Klocës, ndodhet rreth 2 km. në jug të qytetit të Maliqit. Ajo ngrihet mbi një kodër të lartë e cila thirret «Hija e Korbit» (fig. 8). Nga veriperëndimi kodra zgjatet në drejtim të qytetit dhe ndahet prej «Gradishtës së Symizës» nga lugina e Devollit. Shpatet e kodrës të çarë nga përrenj të shumtë bijen me pjerrësi të dukshme mbi fushën, por mbi majën e saj krijohet një platformë e gjërë, që ka formën e një elipsi të çrregullt. Nga juglindja «Hija e Korbit» lidhet me anën e një qafe të lartë me një kodër të vogël, e cila ka formën e një kupole.

Platforma e madhe është e pasur me fragmente qeramike të periudhës helenistike dhe romake. Në kohën e vonë antike ky vendbanim i madh ka qenë i fortifikuar. Nga muret mbrojtës sot ruhen vetëm dy trakte të shkëputur shumë të dëmtuar, njëri 100 m i gjatë, ndodhet në anën jugperëndimore të platformës, ndërsa tjetri i gjatë 150 m., në anën verilindore. Këto gjurmë tregojnë se dikur muret rrethonin gjithë sipërfaqen e platformës, duke ndjekur konturin natyral të saj.

Gjurmë fortifikimi u vunë re edhe në kodrën fqinje nga ana juglindore. Mbi majën e saj ndodhej një grumbull gurësh me gjurmë llaçi (fig. 9). Një sondazh i vogël vërtetoi se kemi të bëjmë me nji kullë katërkëndëshe, konturet e së cilës janë akoma të padallueshëm. Në mes të rrënojave u gjetën edhe fragmente tjegullash dhe tullash romake.

Kjo kullë, me sa duket, shërbente për të vrojtuar në drejtim të juglindjes, mbasi një pjesë e horizontit që shtrihet në këtë anë, i parë nga vendbanimi, fshihet prej vetë kodrës mbi të cilën ndodhet kulla.

Kalaja e Bellovodës (fig. 10,11), ndodhet mbi një kodër shkëmbore në verilindje të fshatit me të njëjtin emër, në skajin jugor të fushës së Korçës. Prej saj hapet një horizont shumë i gjërë, që përfshin gjithë fushën e Korçës, zonën kodrinore të Qafës së Qarrit dhe fushën e Kamenicës. Njëkohësisht ajo bllokon dy dalje natyrale që lidhin fushën e Korçës me zonat malore të Ersekës dhe Vithkuqit. Kodra ka qenë rrethuar me mure qysh në periudhën e parë të hekurit me një akropol në pjesën më të lartë[13]). Ndërsa në kohën e vonë antike qe ndërtuar një mur me gurë të vegjël lidhur me llaç, që ndiqte pjesërisht linjën e murit të periudhës së parë të hekurit, kurse akropoli dhe një pjesë e mureve që dalin prej tij, janë ruajtur deri në ditët tona me teknikën e vjetër. Tani muri me llaç, është i rrafshuar me tokën dhe ka një gjërësi prej 1.90-2 m. Llaçi është i bardhë, i përzier me copra gurësh të thyer të madhësive të ndryshme që arrijnë deri në 3-4 cm. diametër. Muri ka një gjatësi të përgjithëshme prej 360 m dhe, së bashku me muret e periudhës së parë të hekurit, rrethonin një sipërfaqe prej rreth 2 ha. Kulla nuk vihen re në asnjë vënd.

Gradishta e Gjonomadhit (fig. 12,13), ndodhet mbi një kodër shkëmbore, në të djathtë të rrugës automobilistike, që të çon nga Korça në Voskopojë, pranë fshatit me të njëjtin emër. Ajo zë një pozitë të rëndësishme strategjike, duke bllokuar grykën e njerës prej luginave që lidhin fushën e Korçës me zonën malore të Voskopojës. Kodra është shumë e thepisur dhe më e lartë nga perëndimi dhe jugperëndimi, ndërsa nga veriu lidhet me një qafë të lartë me kodrën fqinje, që ndodhet nga ana e fshatit, duke krijuar të vetmen pikë me mbrojtje natyrale të dobët nga ku kalon edhe rruga që të çon në kala.

Pjesa e sipërme e kodrës përfundon me një platformë të ngushtë dhe të zgjatur, e cila ka formën e gërmës L. Konturet e kësaj platforme rrethoheshin me mure të thatë të periudhës së parë të hekurit[14]). Më vonë mbi to u ndërtuan mure me llaç, të cilët ndiqnin të njëjtën linjë. Atje ku ruheshin muret e vjetër u çfryetëzuan bazamentet, duke e zvogëluar trashësinë nga ana e brendshme e fortifikimit, kështu që trashësia e mureve me llaç është 1,50 m. Një trakt i tillë ruhet në anën jugperëndimore të platformës në një gjatësi prej 25 m. Në vende të tjera, ku muri i vjetër nuk është ruajtur, muret me llaç janë ndërtuar direkt mbi tokë. Të tilla janë dy trakte nga 15 m. gjatësi, në anën veriperëndimore të platformës. Trashësia e tyre është gjithashtu 1,50m. Muret janë ndërtuar me gurë kave të vegjël e mesatarë, të lidhur me llaç gëlqerje të bardhë me mbushës të trashë (zhavor). Gjatë gjithë linjës së murit rrethues nuk konstatuam asnjë kullë, por në skajin verior të platformës, që është edhe vendi më pak i mbrojtur nga natyra, ndodhet një grumbull i madh gurësh që ka një diametër prej 12 m. Gurët janë të vegjël, midis tyre dallohen gjurmë llaçi. Ka mundësi që ato ti përkasin një kulle të brendshme të rrënuar, e cila bllokonte të vetmen hyrje në kala. Disa metra në veri të grumbullimit të gurëve dallohen gjurmët e një ndërtimi katërkëndësh 6 x 7 m. të një periudhe më të vonë, trashësia e mureve e të cilit është 1,2 m.

Qeramika e gjetur në sipërfaqe që përbëhet nga fragmente pitosash, tasash, kupash, tjegullash etj. përket periudhës së vonë antike, me përjashtim të pak fragmenteve prehistorike.

13) Gj. Karaiskaj – P. Lera, art. cit., 115.
14) Po aty, 114.

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11

PËRFUNDIME

Format planimetrike të fortifikimeve të kësaj periudhe në rrethin e Korçës varen shumë nga kushtet e terrenit. Ato rrethojnë konturet natyrale të kodrave, mbi të cilat janë ngritur dhe kanë në përgjithësi forma ovale, trekëndëshe ose të çrregullta, por në të gjitha rastet planimetritë kanë forma të përzgjatura. Buzët shkëmbore të pangjitëshme të kodrës nga një herë lihen pa u fortifikuar, ose mbrohen me mure më të hollë.

Kullat janë të rralla, ose mungojnë fare, si në kalanë e Trajanit. Nganjëherë janë ndërtuar kulla të brendëshme në pikat dominuese të terrenit si në Zvezdë dhe Kakaç, ose kulla sinjalizimi jashtë mureve rrethuese, siç është rasti i «Hijes së Korbit». Ato kanë forma rrethore ose katërkëndëshe me predominim të këtyre të fundit. Në shumicën e rasteve pjesa më e lartë e fortifikimit ndahet nga një mur tërthor, duke krijuar një farë akropoli, që shërbente edhe si pikë e rezistencës së fundit. Sipërfaqet e këtyre ndarjeve ndryshojnë sipas madhësisë së vendbanimit ose destinacionit të tyre. P.sh. në kalanë e Trajanit, akropoli rrethon një sipërfaqe shumë të vogël, ndërsa në Zaradishtë ai ze pothuaj se 1/3 e sipërfaqes të krejt vëndbanimit. Hyrjet janë të thjeshta, të pambrojtura nga kulla anësore.

Në planimetritë e fortifikimeve të lartpërmendura të tërheq vëmëndjen ajo e kalasë së Zaradishtës, e cila ka formën e një trekëndëshi me një kullë të rrumbullakët, të spostuar nga kulmi i saj në drejtim të veriut, pas një bërryli të krijuar nga muri rrethues. Një vendosje të tillë të kullave e takojmë edhe në kalanë e Dajtit të datuar në kohën e vonë antike, me mundësi më të madhe për të qenë një nga ndërtimet mbrojtëse të Perandorit Justinian. Dalje të ngjashme të kurtinave pranë kullave të rrumbullakta konstatojmë edhe në një kështjellë me planimetri trekëndëshe të «Limesit Danubian» në Dzanjevo[15]). Forma planimetrike trekëndëshe ndeshet në vendin tonë në «Gradishtën e Sllabinjës»[16]) si dhe në një fortifikim tjetër, me shumë të ngjarë, të së njëjtës periudhë në rrethin e Mirditës[17]). Ashtu si Zaradishta, Gradishta e Sllabinjës është ndërtuar në faqen e një kodre me mure që mbyllen në kulm të saj; trashësia e tyre është e njëjtë me ato të Zaradishtës (2,5 m.), ndërsa kulla nuk konstatohen.[18]).

Muret e fortifikimeve që përshkruam më sipër kanë një trashësi prej 1,7-2,5 m. Ato janë ndërtuar sipas rastit me gurë të vegjël kave ose lumi të lidhur

15) F. Kanitz, **Römische Studien in Serbien**, Wien 1892, 55.
16) N. Ceka – A. Baçe, **art. cit.**
17) M. Tirtja, **Gjurmët e lashtësisë në Mirditë**, «Materjale të sesionit arkeologjik, Tiranë. 1968, 91.
18) N. Ceka – A. Baçe, **art. cit.**

DO NOT COPY

me llaç. Breza druri për forcimin e mureve nuk përdoren. Llaçi ka si mbushës zhavorin, rërën me copa guri ose tulle të thyer dhe, nga një herë, pluhur tullash. Bërthama e murit përbëhet prej gurësh të vegjël, të thyer e të zhytur në mënyrë të çrregullt në llaç të bollshëm si në Zvezdë, ose me gurë të thyer të madhësisë mesatare të vendosur në shtresa të rregullta, duke përdorur për lidhje sasira më të pakta llaçi (Trajan), teknikë që e hasim kryesisht në ndërtimet mesjetare. Fugat e llaçit në paretet e mureve janë zakonisht të trasha.

Fortifikimet, me përjashtim të Zaradishtës dhe Kakaçit, janë vendosur në pika të rëndësishme strategjike për të siguruar një mbrojtje për të gjithë pellgun e Korçës dhe Devollit. Nga ana tjetër mbrohej kalimi më i rëndësishëm që përshkonte këta dy pellgje, lugina e Devollit.

Në grupin e parë hyjnë Zvezda, Bellovoda, Gjonomadhi, Symiza, Bllaca. Ato mbyllin vendkalimet e mundëshme, që lidhin fushën e Korçës me zonën malore përreth, duke u vendosur në grykat e lumenjve ose qafat.

Rruga natyrale që kalonte nëpër luginën e Devollit mbrohej nga kalaja e Menkulasit në skajin juglindor, nga Zvezda në grykën e Cangonjit. Kulla e Dishnicës dhe, më në fund, nga Symiza dhe kalaja e Gopeshtit. Ndërsa jashtë territorit të rrethit të Korçës lugina vrojtohej nga gradishta e Zerecit, e cila është në fakt një vendbanim i mbrojtur nga natyra, i ngritur mbi një kodër të lartë në bregun e majtë të Devollit, në juglindje të fshatit Zerec[19]). Disa nga fortifikimet e përmendura zinin një pozitë veçanërisht të rëndësishme strategjike. Prej kalasë së Zvezdës, jo vetëm që hapet një horizont i gjerë dhe dominohet pothuajse krejt fusha e Korçës dhe një pjesë e asaj të Devollit, por kontrollohet edhe një nyje e rëndësishme rrugësh dhe vendbanimesh. Në radhë të parë bllokohet rruga nëpër qafën e Zvezdës e cila ka qenë e rrahur qysh në kohët prehistorike. Kontrollohet gjithashtu gryka e Cangonjit që lidh pellgun e Korçës me atë të Devollit si dhe kalimi në rrëzën perëndimore të Malit të Thatë, ku mund të shkëputej ndonjë degë e rrugës Egnatia, që kalonte fare pranë në Lyhnid. Jo më pak e rëndësishme ishte edhe pozita strategjike e kalasë së Symizës, në skajin tjetër të fushës së Korçës. Ajo, përveç kontrollit të fushës dhe rrugës që kalon bri kodrave në jug të saj, bllokon edhe luginën e Devollit, në grykën ndërmjet kodrës së «Hijes së Korbit» dhe të Symizës. Në pika të tilla të rëndësishme mund të mendohet se ka patur edhe garnizone ushtarake. Për këtë flet vetë sipërfaqja e vogël që rrethon kalaja e Symizës, si dhe ndarja katërkëndëshe në pjesën më të lartë të kalasë së Zvezdës. Në këtë grup mund të futet edhe kalaja e Gopeshtit, për të cilën është karakteristik jo vetëm rrethimi i një sipërfaqeje të vogël, por edhe mungesa e qeramikës. Ajo kontrollonte një pjesë të mirë të luginës së Devollit si dhe rrugën Moglicë-Zerec-Guri i Prerë-Berat.

Pjesa tjetër e fortifikimeve, me përjashtim të «Kullës së Dëshnicës» e cila ka nji karakter thjesht strategjik, kanë qenë njëkohësisht edhe vendbanime. Një pjesë e tyre janë ngritur atje ku ka pasur vendbanime ose fortifikime më të vjetra, kryesisht të periudhës së parë të hekurit. Në ndonjë rast sipërfaqja e madhe e rrethuar me mure mbrojtëse është reduktuar, si në kalanë e Trajanit ose kanë vazhduar të përdoren pjesërisht muret e vjetër, si në Bellovodë.



Fig. 12



Fig. 13

19) N. Ceka – A. Baçe, art.cit.

KOPJE

Përputhja e fortifikimeve të dy epokave kaq të ndryshme diku mund të spjegohet me vazhdimësinë e banimit si në Bellovodë, por më tepër me ekzistencën e një situate kërcënuese të ngjashme për të dy epokat, kështu që u shfrytëzuan të njëjtat pika strategjike. Në këtë mënyrë mund të spjegohet mungesa e qeramikës helenistike në shumë nga këto fortifikime, ose gjetja e saj në sasira të pakta. Këto ndërtime mbrojtëse, duke rrethuar sipërfaqe të mëdha, që mund të krahësohen me ato të një qyteti të fortifikuar, shërbenin për të strehuar në rast rreziku edhe popullsinë fshatare të fushës. Vetëm kalaja e Zaradishtës, e cila zë një pozitë qëndrore në raport me të tjerat e ndërtuar pothuajse në vend të sheshtë (mbi një kodër që lartësohet fare pak mbi fushë), duhet ti përkiste një qëndre urbane. Këtë mendim e përforcojnë elementet arkitektonikë, mozaikët, si dhe mbishkrimi i gjetur në afërsi. Brenda mure të saj të fuqishëm, me një perimetër prej 1 km. mund të strehohej edhe një pjesë e popullsisë fshatare të zonës. Banorët e kësaj qëndre nuk ja besojnë mbrojtjen terrenit të aksidentuar, por mureve të fuqishëm, ashtu siç ndodh edhe për qytete të tjera të fortifikuara të kësaj periudhe si Skampini dhe Dyrrahi. Është e vështirë të përcaktohet nëse që të gjitha këto fortifikime janë ngritur sipas një plani të studjuar për gjithë zonën, apo një pjesë e tyre janë ndërtuar me vetë inisiativën e popullatës në ato çaste rreziku. Kjo e fundit mund të mendohet edhe nga mënyra primitive e ndërtimit.

Për datimin e këtyre fortifikimeve na shërben teknika e ndërtimit, qeramika, monedhat, si dhe karakteristikat e përbashkëta të tyre. Mungesa e brezave të drurit në mure dhe përdorimi i llaçit me pluhur ose copa tullash nuk janë karakteristike për periudhën mesjetare.

Një tregues me rëndësi janë gjithashtu toponimet sllave si Gradishtë, Zaradishte, Zagradec (fshat në lindje të malit të Trajanit) etj., të cilat nuk i hasim në kështjellat mesjetare dhe tregojnë se këto ndërtime mbrojtëse u gjetën prej sllavëve.

Një veprimtari e madhe ndërtuese në drejtim të fortifikimeve u vu re në Perandorinë Romake qysh në shek. III të e.sonë, sidomos gjatë gjysmës së dytë të këtij shekulli. Shumë qytete fortifikohen në këtë periudhë në brëndësi të perandorisë dhe, për pasojë, edhe në Iliri. Në rastin tonë nuk kemi të bëjmë me qytete të mëdha të fortifikuara, por me rrethime të thjeshta vendbanimesh, pozicioni malor i të cilave është karakteristik për një periudhë më të vonë, që fillon nga shek. IV e.sonë. Dihet gjithashtu se shumë nga fortesat u rindërtuan nga Justiniani në shek. VI, ose u ngritën kështjella të reja. Emrat e vjetër të këtyre kështjellave janë zhdukur me kohë, kështu që identifikimi i kështjellave tona me ato të përmendura në listën e Prokopit bëhet i pamundur. Për këtë arsye do të pranojmë si periudhën më të mundëshme të ndërtimit të tyre, atë që përfshin shek.IV – VI të e.sonë.

PHOTOCOPY



DO NOT COPY

TAB. II



DO NOT COPY

TAB. III

STERA



PLANIMETRIA SHK 1:50





PREMJE A-A

DO NOT COPY

KALAJA E Krajanit





LEGJENDA

1, 2, 3 - MURE TE PERIUDHES SE PARE TE HEKURIT

4, 5 - MURE TE PERIUDHES SE VONE ANTIKE



DO NOT COPY

TAB. V





KALAJA E ZVEZDES

Skicë planimetrike



DO NOT COPY

DO NOT COPY


RRETHI I KORÇES
BLLACA
KAKAÇI
SYMIZA
MOGLICA
KLOCA
ZVEZDA
TRAJANI
GJONOMADHI
KORÇA
DISHNICA
BILISHTI
ZARADISHTA
BELLOVODA
MËNKULAS
FORTIFIKIM I PERIUDHES VONE ANTIKE
0 4 8 12 16KM.

Gjerak KARAISKAJ – Petrika LERA

FORTIFICATIONS DE LA BASSE ANTIQUITE DANS LE DISTRICT DE KORÇE

RESUME

Du nombre des ouvrages défensifs découverts dans le district de Korçe, une place importante revient à ceux de la basse antiquité.

Ils se dressent sur des éminences entourant la plaine du Devoll et le long du cours du fleuve du même nom (Tab. VI). Dans le présent travail sont traités les ouvrages suivants: la forteresse de Zvezde, la forteresse de Zaradishte, la forteresse de Menkulas, la forteresse de Trajan, la fortersse de Kakaç, la forteresse de Symize, la tour de Dishnice, la forteresse de Kloce, la forteresse de Bellovode et celle de Gjonomadh.

Les formes planimétriques des fortifications susmentionnées sont en fonction, dans une grande mesure, des conditions du terrain. Elles s'adaptent aux contours des collines qu'elles surmontent et sont généralement de forme ovale, triangulaire ou irrégulière, mais en tout cas ces fortifications ont une forme allongée. Parfois les bords rocheux inaccessibles des collines ne sont pas fortifiés ou sont dotés de murs moins épais.

Les tours sont plutôt rares et se dressent aux points les plus délicats de l'ouvrage, où elles manquent tout à fait comme par exemple dans la forteresse de Tragjas. On relève parfois des tours internes construites sur les points dominants du terrain comme à Zvezde et à Kakaç ou encore des tours de guet en dehors des murs d'enceinte, comme dans la forteresse de Kloce. Elles ont une forme circulaire ou quadrangulaire, avec une nette prévalence de ces dernières. La partie la plus élevée de la fortification, dans la plupart des cas, est séparée par un mur transversal qui crée de la sorte une espèce d'acropole, qui servait de point d'ultime résistance La surface de ces milieux diffère en fonction des dimensions de l'agglomération ou de leur destination. Dans la forteresse de Tragjas, par exemple, l'acropole entoure une surface très petite, tandis qu'à Zaradishte elle occupe presque le tiers de toute la surface sur laquelle s'étend l'agglomération. Les entrées sont simples et ne sont pas flanquées de tours latérales.

Parmi les planimétries de ces fortifications, une attention particulière mérite celle de la forteresse de Zaradishte de forme triangulaire et flanquée d'une tour ronde, dont le faîte regarde en direction nord. Une telle disposition des tours concerne également la forteresse du Dajti, attribuée à la basse antiquité et qui fait part très probablement du nombre des ouvrages défensifs construits par Justinien. De pareilles courtines saillantes, à proximité des tours rondes, ont été également relevées dans une forteresse à planimétrie triangulaire du kimes danubien, à Dzanjevo. La planimétrie de forme triangulaire concerne également notre pays, particulièrement la forteresse de Slabinje ainsi qu'une autre fortification, probablement de la même période, située dans le district de Mirdite.

Les murs de ces ouvrages ont une épaisseur variant de 1,7 à 2,5 m. Ils sont construits, selon le cas, de petites pierres de carrière ou fluviatiles liées avec du mortier. Le mortier est un mélange de cailloux, de sable renfermant ds morceaux de pierres ou de briques

DO NOT COPY

DO NOT COPY

et parfois même de la poussière de briques. Le noyau du mur est constitué par de petites pierres équarries et empilées irrégulièrement dans une quantité abondante de mortier comme à Zvezde ou par des pierres équarries de grosseur moyenne et disposées en couches régulières, ayant comme liant des quantités réduites de mortier (Trajan), technique celle-ci caractérisant surtout les constructions moyenâgeuses. Les joints en mortier de la face extérieure du mur sont généralement épais.

Ces fortifications, à l'exception de celles de Kakaç et de Zaradishte, se dressent en des points stratégiques et servent à défendre tout le bassin de Korçe et du Devoll. Elles assurent aussi la défense du plus important passage qui traverse ces deux bassins, soit la plaine de Devoll.

Du premier groupe font part les forteresses de Zvezde, Bellovode, Gjonomadh, Symizë et Bllace. Elles ferment les éventuels passages reliant la plaine de Korçe à la zone montagneuse avoisinante et se dressent dans les embouchures des cours d'eau ou dans les cols de montagne.

La voie naturelle parcourant la vallée du Devoll était défendue, à son extrémité S.–E., par la forteresse de Menkulas, au col de Cangonie par la forteresse de Zvezde et de Dishnice et, en dernier lieu, par les forteresses de Symize et de Gopesht. En dehors du territoire de Korçe, cette vallée est protégée par la citadelle de Zerec, qui de fait est une agglomération urbaine protégée par la nature même. Elle dresse sur le sommet d'une colline élevée, le long de la rive gauche du fleuve Devoll, au S.–E. du village de Zerec. Quelques-unes de ces fortifications s'élevaient en des points stratégiques très importants. La forteresse de Zvezde embrasse non seulement un immense horizon et domine presque toute la vallée de Korçe et en partie celle du Devoll, mais elle contrôle aussi un important noeud routier et une multitude d'agglomérations urbaines. Non moins importante est la position stratégique de la forteresse de Symize, située à l'autre extrémité de la vallée de Korçe. Cette forteresse domine non seulement la vallée de Korçe et la route longeant les collines situées dans sa partie méridionale, mais elle bloque aussi la vallée du Devoll au couloir constitué par la colline de Hije e Korbit et par celle de Symize. Il n'est pas à exclure que dans ces points importants du point de vue stratégique ont séjourné des garnisons militaires. En témoignent la surface restreinte entourant la forteresse de Symize, ainsi que la disposition quadrangulaire de la partie la plus élevée de la forteresse de Zvezde. Dans ce groupe de fortifications, on peut également inclure la forteresse de Gopesht qui se caractérise non seulement par le fait qu'elle s'étend sur une surface relativement petite, mais encore par l'absence de céramique. Cette forteresse dominant une bonne part de la vallée du Devoll, ainsi que la route reliant Moglice à Zerec, Guri i Prere et Berat.

Quant aux autres fortifications, à l'exception de la «Tour de Dishnice» qui a un caractère simplement stratégique, elles ont servi dans le même temps comme agglomérations urbaines. Elles se dressent en partie sur les emplacements des agglomérations ou des fortifications antérieures, se rattachant surtout à la première période du fer. Parfois la grande surface ceinte de murs défensifs est réduite (forteresse de Trajan) ou les anciens murs sont en partie utilisés (forteresse de Bellovode).

La similitude des fortifications appartenant à deux époques si différentes peut être expliquée en partie par le fait qu'elles ont continué à servir comme lieu d'habitation (Bellovode), mais surtout par la permanence de la même situation menaçante pendant iles deux époques, ce qui a induit les gens à utiliser les mêmes points stratégiques. Ces ouvrages défensifs, s'étendant sur une surface relativement grande comparable à celle d'une cité fortifiée, servaient en même temps d'abri à la population paysanne de la vallée en cas de danger. La seule forteresse de Zaradishte, qui occupe une position plus centrale que les autres forteresses et se dresse sur un emplacement presque plat (une colline surplombant, à piene la plaine), doit avoir appartenue à un centre urbain. Cette opinion est confirmée par la découverte d'éléments architectoni-

ques, de mosaïques et d'une inscription dans la zone avoisinante. Mais à l'intérieur de ces murs puissants, s'étendant sur un périmètre de 1 Km., pouvait trouver refuge une partie de la population paysanne de la zone.

En ce qui concerne la datation de ces fortifications, nous nous sommes fondés sur la technique de construction, la céramique, les monnaies ainsi que sur leurs traits communs. L'absence de bandes en bois dans les murs et l'emploi d'un mortier mélangé a de la poussière ou a des morceaux de briques ne sont pas un trait caractérisant la période moyenâgeuse.

Une autre indication de relief sont également les toponymes slaves tels que Gradishte, Zaradishte, Zagradec (village situé à l'est du mont Trojan), etc., que l'on ne retrouve pas dans les fortifications moyenâgeuses et qui montre que les Slaves ont trouvé ces ouvrages défensifs.

Une intense activité de construction de fortifications a marqué l'empire romain dès le IIIe siècle de l'ère nouvelle, surtout pendant la deuxième moitié de ce siècle. Pendant cette période nombre de cités ont été munies d'ouvrages de défense à l'intérieur de l'empire et, par conséquent, en Illyrie aussi. En l'occurence il ne s'agit pas de grandes cités fortifiées, mais plutôt d'ouvrages destinés à défendre des agglomérations urbaines se dressant dans des zones montagneuses. C'est là une caractéristique de la période commençant au IVe siècle de notre ère. On sait de même que la plupart de ces forteresses ont été réaménagées ou construites ex novo par Justinien au VIe siècle. Leur ancien nom ayant disparu depuis longtemps, il est impossible d'identifier nos forteresses avec celles mentionnées dans la liste de Procope. Aussi comme période probable de leur construction allons-nous considérer celle s'étendant du IVe au VIe siècle de notre ère.

DO NOT COPY

Hasan NALLBANI

DO NOT COPY

MOZAIKU I KISHËS SË AMFITEATRIT NË DURRËS

Gjatë muajve tetor-nëntor të vitit 1971 në mozaikët e kishës bizantine në amfiteatrin antik të Durrësit u kryen disa punime konservimi, që synonin në konsolidimin e gjëndjes së mozaikut dhe vlerësimin estetik të tij. Gjatë punimeve u trajtua kryesisht skena e faqes perëndimore, e cila paraqiste më tepër nevoja për ndërhyrje të këtij karakteri, për shkak të shkallës së madhe të dëmtimeve që ajo kish pësuar.

Mozaikët e kishës, përbëhen nga dy panela vertikale të vendosura në njerën nga kamaret e galerisë nënshkallare të amfiteatrit antik, që është pjesa e naosit. (fig. 1). Skena e faqes perëndimore ka formën e katërkëndëshit të rregullt me dimensione 2,25 m. x x 1.06. m., ndërsa ajo e faqes jugore ndjek konturin e faqes së kamares, duke krijuar një trapez të parregullt me dimensione 2 m. x 1.5 m. në brinjën më të lartë. Të dy skenat janë konservuar në gjëndje të ndryshme, ajo e faqes jugore ruhet përgjithësisht në gjendje të mirë, ndërsa skena tjetër është mjaft e dëmtuar. Prej kësaj skene ruhet një portret i dëmtuar i figurës së Shën-Irenës, në anën e djathtë të skenës dhe figura më e plotë e Shën-Sofis, në krahun e majt (fig. 2). Gjithashtu ruhet një figurë e dëmtuar e Kryeengjëllit në të majtë dhe, pjesërisht, pjesa e poshtme e figurës qëndrore. Dy figurat në minjaturë, në anë të figurës qëndrore, janë më pak të dëmtuara. Skena e faqes jugore është e dëmtuar vetëm në disa zona të vogla që nuk e prishin tërësinë organike të saj.

Për shkak të lagështirës në të cilën për një kohë shumë të gjatë kanë qëndruar mozaikët dhe mungesës së masave konservuese në çastin e zbulimit, gurët e tyre janë dëmtuar pjesërisht dhe kanë humbur mjaft nga nuancat e tyre origjinale. (fig. 3).

Shtresa bazë e mozaikëve e trashë 3-5 cm. është e përbërë nga një sasi e madhe gëlqere e përzier me tulla të shtypura. Shtresa e bazës së mozaikut të faqes perëndimore ka krijuar një lidhje të dobët me shtresën e afreskut, e cila ka qënë ekzekutuar në një periudhë më të hershme dhe që gjatë ndërtimit të mozaikëve është çfrytëzuar si bazament i tyre. Gjurmë të ngjyrave të afreskeve të vjetra ruhen në disa vënde, ku shtresa e mozaikëve është shkëputur. Gjithashtu zona të shkëputura të afreskut gjenden edhe në faqet tjera të ambientit të kishës dhe kamares, ku janë vendosur mozaikët. Nga këta afreska tani nuk ruhet ndonjë skenë apo fragment i lexueshëm.

Mbi sipërfaqen e mozaikëve gjenden gozhdë kovaçi, të një tipi mjaft të vjetër, të shpërndara në zona ku nuk ka figurë ose element figurativ të rëndësishëm. Këto gozhdë janë përdorur, ndoshta për të ruajtur nivelin e shtresës së gurëve të mozaikut gjatë ndërtimit.

Gurët e përdorur janë të shumëllojtë dhe me origjinë të ndryshme. Kryesisht predominon guri i bardhë i thyer në formën kubike me madhësi nga 0,5 cm. në 2-3 cm. Gurët e bardhë janë kryesisht me origjinë gëlqerore dhe janë dekompozuar në shtresën e tyre të sipërme. Gurë të tjerë, të përdorur edhe këta me madhësi të ndryshme, janë në ngjyrë gri, blu, jeshil, të verdhë, të zez dhe gurë xhami të lyer me shtresë ari. Ka gjithashtu një përdorim të gjërë të gurëve në ngjyrë rozë dhe të kuqe. Në fushat e brenoreve të dy figurave qendrore të skenave, si dhe në brenoren, këmbët dhe duart e figurës së Shën-Stefanit, që është vendosur në të djathtë të skenës jugore e ndarë me një bordur me gurë të kuq, janë përdorur gurë xhami që kanë qënë lyer me ar, i cili me kohë është hequr dhe tani gjejmë vetëm disa mbeturina të vogla të tij.

Përbërja e gurëve me ngjyra është e ndryshme. E verdha, jeshilja dhe bluja në tonalitete nga e hapta



Fig. 1



Fig. 2

tek bluja e erët janë paste xhami. Gurët e kuq janë tullë e pjekur, ndërsa ata me ngjyrë gri janë gurë lumi të thyer në forma kubike të madhësisë gati të njëjtë.

Mbas punimeve të zbulimit dhe pastrimit të kryera nga muzeu i Durrësit, janë bërë në zonën e mozaikëve edhe disa përforcime të nevojshme për të konsoliduar gjendjen. Këto përforcime janë kryer me allçi dhe jo në të gjithë zonën e skenës perëndimore. Duke u nisur nga nevoja për konsolidimin e mëtejshëm të gjëndjes, nga ana e Institutit të Monumenteve të Kulturës u kryen përforcime të reja në skenën e faqes perëndimore, si dhe u hoqën përforcimet e vjetra të kryera me allçi, për shkak të shkëputjeve që kishin pësuar këto lidhje, dhe të nevojës që të përdorej një material më i afërt me natyrën e materialeve origjinale të përdorur fillimisht. Gjithashtu gjatë këtyre masave u bë edhe një integrim i pjesëve që mungonin, duke përdorur për këtë qëllim një llaç të përbërë nga gëlqere dhe pluhur shamoti të spërkatur me një përqindje të vogël acetat polivinili. Zonat e mbushura u lanë disa milimetra nën nivelin e sipërfaqes së gurëve të mozaikut, ndërsa në pjesët e mëdha, ku ekzistonte vetëm shtresa e afreskut të vjetër, niveli i mbushjeve u bë i barabartë me atë të afreskut, për të ruajtur kështu një trajtim të ndryshëm, simbas karakterit të zonave dhe interesit për të venë në dukje edhe gjurmët e afreskut.

*

* *

Duke marrë shkas nga kontakti me monumentin gjatë punimeve konservuese, si dhe nga materialet e botuara për këta mozaikë nga V.Toçi[1]) dhe Th.Popa[2]) në të cilat bëhet përshkrimi, datimi dhe interpretimi i tyre ne po përpiqemi të argumentojmë një pikpamje dhe interpretim të ndryshëm për të dy skenat me mozaik të kishës në amfiteatrin e Durrësit.

Në paragrafin që i kushtohet përshkrimit dhe datimit të mozaikut të amfiteatrit V.Toçi, e cilëson figurën qëndrore në skemën e faqes jugore si paraqitjen e imperatorit bizantin të dinastisë maqedonase, Aleksandrit (viti 912-1913). Edhe Th.Popa e mbështet këtë interpretim dhe shkruan, se sipas mbishkrimit ajo i dedikohet perandorit «plangprishës», bizantin Aleksandër, paraqitur në pamje djaloshare. Sipas tij, mozaiku është i porositur nga perandori për të diktuar zotërimin e tij në një krahinë që rezikohej nga pushtimet bullgare[3]). Gjithashtu ai jep shpiegime edhe për dy figurat anësore në minjaturë, që qëndrojnë në të dy anët e figurës qëndrore, të cilat i quan dy oborrtarë. Ky version gjëndet edhe tek V.Toçi, në paragrafin kushtuar mozaikut, ku skena e faqes perëndimore cilësohet si e dedikuar perandoreshës.

Sipas argumentave që do të parashtrojmë rezulton që skenat me mozaik të vendosura në njerën nga

1) V. Toçi, **Amfiteatri i Durrësit,** «Monumentet» 2/71, 40.
2) Th. Popa, **Elementë laikë në pikturën tonë mesjetare»,** Studime Historike» 1 — 1972, 132.
3) V. Toçi, **art. cit.,** 39

DO NOT COPY

kamaret e galerisë, që bënë pjesë në naosin e kishës, ndërtuar në amfiteatrin e Durrësit gjatë mesjetës, lidhen me përdorimin e këtij ambienti si vënd varrimi, pikpamje të cilën e gjejmë të shprehur edhe nga V. Toçi[4]). Këto dy skena kanë lidhje me personat e varosur në këtë ambient, në kohë relativisht të afërta me njëra-tjetrën. Gjithashtu mbishkrimi sipër, në të djathtë të skenës së faqes jugore nuk ka lidhje me figurën qëndrore, por me atë në minjaturë, që gjëndet në të djathtë të saj. Sipas mendimit tonë, këto skena i kushtohen figurave me rëndësi nga paria e Durrësit të varrosur në ambientin e kishës.

Të dy autorët, që shfaqin pikpamjen se skena e faqes jugore paraqet në qendër figurën e perandorit Aleksandër, nisen nga ekzistenca e mbishkrimit dhe paraqitja e kësaj figure me glob në dorën e majtë (simbol i pushtetit shtetëror).

Sipas pikpamjes sonë, mbishkrimi thotë vetëm lutjen «ndihmoje Aleksandrin». Ai nuk e cilëson Aleksandrin perandor dhe as ka ndonjë cilësi tjetër, që zakonisht gjënden në skena të tilla kushtuar figurave historike.

Për perandorin Aleksandër të dinastis maqedonase ekziston në kishën e Shën-Sofis në Kostantinopol një portret muziv. Perandori paraqitet në këmbë, në të dy anët e figurës janë vendosur medalione, që përmbajnë emrin e tij dhe tre monograme, në të cilat deshifrohet lutja «Zot ndihmoje shërbëtorin tënd imperatorin ortodoks dhe shumë besnik». Paraqitja e figurës së Aleksandrit në mozaikun e Shën-Sofisë, është krejt e ndryshme nga ajo e figurës qëndrore të mozaikut të amfiteatrit në Durrës. Në mozaikun e Shën-Sofisë imperatori është paraqitur në pozë të ngurtësisht frontale. Koka është zbukuruar me një kurorë imperiale jo të lartë tipit camelaucum[5]) stolisur me perle që i bijen në të dy anët. Figura mban në dorën e majt një glob. Portreti është paraqitur me mjekër dhe mustaqe. Veshja e gjatë arrin deri afër këmbëve. Figura e mozaikut të amfiteatrit është paraqitur gjithashtu në këmbë frontalisht dhe mban në dorën e majt një glob. (fig. 4). Figura është veshur me një robë të gjatë, që kalon masën e gjatësisë së robave të figurave të tjera që i bijen deri në fund të këmbëve, duke lënë të duken vetëm majat e çizmeve të kuqe. Në kokë ajo mban një kurorë të lartë të zbukuruar me perle në të dy anët. Portreti është paraqitur pa mjekër, pa mustaqe me pamje femërore. Në të dy veshët figura ka dy vathë që kornizohen me të kuq, nga të cilët ruhet vetëm ay i veshit të majt. Karakteri plastik e linear i trajtimit të portretit, shpatullave dhe duarve është disi i ndryshëm nga ai i figurave të tjera, p.sh. po t'a krahasojmë atë me figurën rinore të Shën-Stefanit, paraqitur në të djathtë të skenës, e cila edhe pse djaloshare ruan tipare të qarta burrërore. Karakteri linear i ndërtimit të kësaj figure është më i ashpër, më i thyer dhe më pak i butë se ai i figurës qëndrore.

Një rëndësi të veçantë në argumentat tanë kanë edhe stolitë që zbukurojnë figurën qëndrore. Një kurorë me kënde të lartë, të ndërtuar sipas konfiguracionit të figurës qëndrore të mozaikut të Durrësit, e gjejmë në formën e kurorës së një skulpture, që pa-



Fig. 3



Fig. 4

4) Th. Popa, **art. cit.**
5) V. Lazariev, «**Storia della pittura bizantine**» Torino 1967 146 fig. 155-156.

NON-COPY

raqet një perandoreshë bizantine[6]). Ndërsa vathë, si element zbukurimi, në figurat e perandorëve nuk gjënden. Edhe stolitë e tjera që zbukurojnë veshjen e gjatë përpara, të vendosura dy sipër në formë katrore e dy poshtë në formë elipsi, janë identike në formë dhe ngjyra me stolitë e përdorura për zbukurimin e pjesës së sipërme të veshjes së perandoreshës Teodora, paraqitur në mozaikun e Shën-Vitalit në Ravenë. Po ashtu, në drejtimin stilistik e figurativ, gjejmë analogji midis figurës qëndrore të skenës dhe figurës së gruas në minjaturë, vendosur në të majt të saj. Figura e gruas në minjaturë ka një veshje, që arrin po atë gjatësi që ka ajo e figurës qëndrore, deri tek majat e çizmeve të kuqe. Silueti i saj i poshtëm ruan po atë ndërtim linear. Analogji stilistike shohim edhe në portretet e këtyre dy figurave, si dhe stolitë që zbukurojnë kokën dhe veshjen e figurës së gruas në minjaturë. Edhe këtu gjejmë katër elementë dekorativë zbukurues, që ruajnë gati atë formë dhe po atë shpërdarje; dy sipër veshjes e dy poshtë.

Në ndihmë të argumentave tona duam të sjellim edhe shqyrtimin e skenës së faqes perëndimore. Kjo skenë është e përbërë nga shtatë figura, dy më tepër se skena e faqes jugore. Megjithëse ruan një karakter kompozicional të njëjtë ndryshon nga skena tjetër, si në aspektin teknik, ashtu dhe n'atë stilistik të ndërtimit të figurave. Gurët e kësaj skene janë më të mëdhenj, arrijnë deri në 3 cm. në sipërfaqet e lira, kanë një renditje më të parregulltë. (fig. 5). Bordura që kufizon skenën nga poshtë është më e gjërë dhe përbëhet nga 3 rreshta gurësh të kuq, ndërsa ajo e faqes jugore ka vetëm një rresht. Poshtë bordures prej gurësh, skena perëndimore kufizohet me një tjetër bordur në teknikën e afreskut të zbukuruar me motive dekorative të gërryera në llaç. Gama e gurëve të kësaj skene është më e varfër. Ndërsa në drejtimin stilistik ajo ndryshon nga skena tjetër, mjafton që të krahasohet figura e kryeengjellit, që ruhet më mirë në këtë skenë (fig. 6), me ato të skenës jugore. Qëndrimi i kësaj figure është më i lirë, jo plotësisht frontal, disi në lëvizje dhe veshja është krejt e ndryshme. Ndërtimi linear është tepër spontan dhe ekspresiv. Gjithashtu edhe në këtë skenë janë paraqitur dy figura në minjaturë, si ato të skenës tjetër, të vendosura në anë të figurës qëndrore me duar të mbuluara në formë të tillë, siç paraqiten ato në figurat e magëve dhuratëprurës. Figura e gruas në minjaturë e kësaj skene, përsërit, po ashtu, ndërtimin linear dhe karakterin e veshjes së figurës qëndrore. Rezulton, pra, që kjo skenë të jetë jo vetëm vepër e një autori tjetër, por edhe ekzekutuar në kohë relativisht të ndryshme nga mozaiku i faqes jugore. Edhe shkalla krejt e ndryshme e gjëndjes së konservimit të skenës perëndimore, që ka qëndruar pothuajse në të njëjtat kondita me skenën tjetër, është një argument që duhet marrë në konsideratë.



Fig. 5

Mozaikë të tillë, që lidhen me kultin e të vdekurve, ku figurat e porositësve janë paraqitur në minjaturë, si tek mozaiku i Durrësit, gjënden në narteksin e Karie Xhamisë[7]), ku dy figurat në anë, ajo e Maria Paleologut dhe Isak Komnenit janë varosur poshtë kësaj skene. Gjithashtu, sipas mendimit tonë, versioni i shprehur nga autorët që kanë shkruar për mozaikun e amfiteatrit të Durrësit se të dy figurat në minjaturë, në anë të figurës qëndrore, paraqesin dy oborrtarë nuk qëndron, për faktin se paraqitje të kësaj natyre ku figurat e oborrtarëve vihen në një shkallë të tillë mvartësie e diferencim formal nuk gjinden në asnjë rast të pikturës monumentale bizantine. Ky version është në kundërshtim edhe me rolin tepër të madh që ushtronte oligarqia në sistemin perandorak bizantin. Ishte, pikërisht kjo klasë nga e cila dilnin oborrtarët, që lozte një rol vendimtar mbi gjithë kursin e zhvillimit të artit bizantin. Kjo shoqëri që jetonte në mënyrë luksoze ishte përbërë nga aristokracia e tokave, oborrit dhe klerit; ajo kishte një pasuri të pamasë, zotëronte situatën, kurorëzonte dhe çkurorëzonte sovranët. Që nga shek. X, kjo oligarqi ishte bërë aq e fortë, sa të monopolizonte gjithë postet kyçe administrative të shtetit dhe të oborrit, duke eleminuar pamëshirë edhe sovranët që cënonin interesat e saj. Kështu që nuk mund të pranohej një ekspozim i tillë, i cili nuk qëndron edhe për faktin, se skena paraqet vetëm një figurë burri dhe një grua. Veç këtyre argumentave

6) «Enciklopedia dell'arte», f. 62 fig. 1.
7) V. Lazariev, vep. cit.

DOKTORSKY



Fig. 6



Fig. 7

duam ta mbështesim pikpamjen tonë edhe në disa argumenta të tjera, që kanë të bëjnë me nevojën e ndërtimit të këtyre mozaikëve në një ambient të tillë. Normalisht faqja më e preferuar për pikën e shikimit dhe dimensionet, duhet të ishte ajo perëndimore ose njëra nga faqet e lira të naosit, po të pranojmë versionin se këtu kemi të bëjmë me figurën e perandorit bizantin, ku, siç dihet, skena të tilla ndërtoheshin proporcionalisht më të mëdha[8]) dhe në vendet më kryesore. Pra, nuk kish arësye përse kjo skenë kaq me rëndësi të ndërtohej në një vend gati të padukshëm të kishës në proporcione aq të reduktuara. Mbishkrimi që është vendosur në një sfond të bardhë ndaj sfondi i figurës qëndrore, në rastin e figurës së perandorit, duhej të lidhej formalisht me figurën dhe të kishte cilësimin e Aleksandrit si perandor për t'a bërë të kuptueshme skenën edhe për arësye të mungesës së plotë të individualizimit, karakterit të portretit. Ndërsa, në fakt, ai është jo vetëm i ndarë nga sfondi që inkuadron figurën qëndrore, por edhe emri Aleksandër është ndarë në rrokje për të mos kaluar në sfondin e figurës qëndrore.

Fakti historik i qëndrimit të Aleksandrit ne më pak se një vit në fronin e imperatorit, përjashton mundësinë e paraqitjes së tij në moshë djaloshare që mund të ishte e pranushme për një perandor, p.sh. si Justiniani, që ka sunduar një periudhë të gjatë. Pra, mungesa e çdo tipari individual dhe elementet e tjera që parashtruam, çojnë në konkluzionin se figura qëndrore e skenës së mozaikut të amfiteatrit nuk paraqet figurën e Aleksandrit, por figurën e njerës nga perandoreshat që kanë sunduar në bizant.

Në këtë paraqitje kjo figurë është, ndoshta, konvencionale dhe pushteti shtetnor e fetar që ajo si-

8) David Talbot Rice, **«Arte bizantina»,**

DO NOT COPY

mbolizon renditet përkrah forcave qiellore në proçesionin fetar lidhur me personat e varrosur në këtë ambient.

Cila është kjo figurë dhe kujt epoke i përkasin këta mozaikë është një problem i diskutueshëm.

Duke i bërë një analizë stilistike këtyre mozaikëve, vëmë re, se megjithë ndryshimet përkatëse kanë një karakter të njëjtë në konceptimin e të dy skenave. Ato kanë mungesë të theksuar të formës dhe trajtimit plastik. Format janë të sheshta, figurat të ngurta e statike, me përjashtim të figurës së Shën-Stefanit, që bën një përjashtim në lëvizjen dhe karakterin ekspresiv të paraqitjes. (fig. 7). Vihet re, një farë peshe dhe rëndimi i formës, një predominim i sfumaturave të bardha e gri. Duke u mbështetur në elementet e theksuar të linearizmit, që predominojnë në këta mozaikë, ata duhet t'i përkasin në kohë atij evolucioni artistik, që lidhet me përpjekjet për krijimin e një stili klasik bizantin që manifestohet gjatë shek. X dhe XI. Mjeshtërit që i kanë ekzekutuar ata, padyshim kanë njohur mirë ikonografinë dhe teknikën e mozaikëve të kësaj periudhe, gjë që del e qartë në elementet figurativë që analizuam dhe, ka të ngjarë, që të kenë qënë edhe vendas pasi, siç dihet, në këtë periudhë qëndra të ndryshme jashtë metropolit u krijuan dhe drejtuan shkollat e tjera lokale të pikturës monumentale[9]). Një qendër e tillë ishte edhe Selaniku, ku mozaikët e tij kanë analogji me ato të amfiteatrit të Durrësit.

DO NOT COPY

9) V. Toçi, po aty, f. 40.

Hasan NALLBANI

LES MOSAIQUES DE L'EGLISE DE L'AMPHITHEATRE DE DURRES

RESUME

Les mosaïques de l'église de l'amphithéâtre de Durres sont représentées par deux panneaux verticaux, disposés dans l'une des niches de la galerie aménagée au dessous de l'escalier de l'antique amphithéâtre faisant partie du naos. La scène reproduite sur la face occidentale a la forme d'un rectangle régulier, tandis que celle de la face méridionale suit le contour de la surface de la niche et crée de la sorte un trapèze irrégulier. En ce qui concerne cette dernière, sont conservés à l'heure actuelle sur son côté droit le portrait endommagé de la figure de Sainte-Irène et, sur son côté gauche, la figure complète de Sainte-Sophie. On peut également observer la figure endommagée de l'Archangel, sur le côté gauche de cette scène, et, en partie, la partie inférieure de la figure centrale.

Les pierres utilisées dans les mosaïques sont d'espèce et d'origine diverses. On relève une nette prédominance de pierres blanches taillées en cubiques, dont la dimension varie de 0,5 cm. à 2-3 cm. Celles-ci sont surtout d'origine calcaire et présentent des signes de décomposition dans leur couche supérieure. Quant aux autres pierres, de dimensions également diverses, elles sont de teinte grise, bleue, verte et jaune, ou représentées par des structures vitreuses recouvertes d'une couche dorée. Les pierres de coloration rose et rouge sont aussi largement utilisées.

La composition des pierres colorées est différente. Le jaune, le vert et le bleu, dont la tonalité varie du clair au bleu foncé, sont en pâte de verre. En ce qui concerne les pierres rouges, elles sont en brique cuite; les pierres grises sont représentées par du gravier fluviatil, cassé en forme de cubiques de dimensions presque identiques.

Des données obtenues pendant les travaux de restauration de ce monument et des matériaux publiés à propos de ces mosaïques, il ressort que les scènes en mosaïques revêtant l'une des niches de la galerie, faisant partie du naos de l'église construite dans l'amphithéâtre de Durres au moyen âge, se rattachent à un lieu de sépulture. Ces deux scènes se relient à des personnes ensevelies en ce milieu, dans des périodes de temps relativement proches l'une de l'autre. De même l'inscription figurant sur la partie supérieure, à droite de la scène du côté méridional, n'a aucun lien avec la figure centrale mais se rapporte à la miniature disposée à sa droite. Ces scènes sont consacrées à des personnalités éminentes de la ville de Durres ensevelies dans l'enceinte même de l'église.

En ce qui concerne l'empereur Alexandre de la dynastie macédonienne, dans l'église de Sainte-Sophie de Constantinople un portrait mural lui est consacré. La figure d'Alexandre, dans le mosaïque de Sainte-Sophie, est tout à fait différente de celle reproduite sur la figure centrale de la mosaïque de l'amphithéâtre de Durres. L'empereur y est présenté dans une attitude extrêmement frontale: sa tête est ornée d'une couronne impériale non haute de type camelaucum, agrémentée de perles des deux côtés. Il porte une barbe et des moustaches et tient dans sa main un globe. Il a une robe longue qui lui descend jusqu'aux pieds. La figure de la mosaïque de l'amphithéâtre de Durres est également un portrait en pied de l'empereur, dans une attitude frontale et tenant dans la main gauche un globe. Il a une robe longue, plus longue que celle des autres

DO NOT COPY

personnages l'entourant, qui lui descend jusqu'aux pieds et ne laisse voir que la pointe de ses bottes rouges. Il a sur sa tête une couronne haute agrémentée de perles des deux côtés. L'empereur cependant ne porte ni barbe, ni moustache, il a un aspect féminin. Il a, en plus, à chacune de ses oreilles, une boucle encadrée de rouge, dont celle de l'oreille gauche seulement y est conservée.

Une importance toute particulière revêtent également les ornements qui agrémentent la figure centrale. De même, on relève des analogies stylistiques et figuratives entre la figure centrale de la scène et celle de la femme en miniature, qui est placée à sa gauche. Des analogies stylistiques s'observent aussi dans les portraits de ces deux figures, ainsi que dans les ornements agrémentant la tête et l'habillement de la femme en miniature.

De telles mosaïques se reliant au culte des morts, où les figures des clients sont présentées en miniature, comme dans le mosaïque de Durres, s'observent dans le narthex de Karie Cami où les deux figures latérales, celle de Marie Paléologue et d'Isaac Comnène, sont ensevelies au-dessous de cette scène.

De l'analyse stylistique de ces mosaïques il ressort que, malgré les différences relatives, ces deux scènes se caractérisent par une conception analogue. En nous fondant sur leur caractère linéaire prononcé, il apparaît que ces mosaïques se rattachent dans le temps à l'évolution artististique qui s'est manifestée, à la suite des efforts accomplis en vue de créer un art byzantin classique, pendant les IXe-Xe et XIe siècles. Les maîtres qui les ont exécutées connaissaient sans doute fort bien l'iconographie et la technique des mosaïques de l'époque, ce qui ressort clairement des éléments figuratifs que nous venons d'examiner. Il se peut même que ces maîtres soient des indigènes, et cela du fait qu'au cours de cette période ont vu le jour en province divers centres qui dirigeaient les autres écoles de la peinture monumentale. Un tel centre fut aussi Salonique, dont les mosaïques présentent plus d'une analogie avec celles de l'église de l'amphithéâtre de Durres.

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

BANJAT E MESJETËS SË VONË NË SHQIPËRI

Në këtë artikull kemi marrë si objekt studimi banjat e ndërtuara në vendin tonë gjatë shek. XV-XIX. Banjat (hamamet)[1]) zinin një vënd të dukshëm në ndërtimet shoqërore të qyteteve tona mesjetare. Koha dhe transformimet e mëdha e të vazhdueshme të qëndrave të banuara kanë bërë që sot të ruhet një numër i kufizuar i tyre, bile dhe këto të transformuara. Banjat e ruajtura deri më sot i hasim në qytetet Elbasan, Durrës, Shkodër, Delvinë, Krujë, Gjirokastër, Çorovodë (Sllatinjë), Lezhë dhe Tiranë. Udhëtari turk Evlia Çelebiu në vitin 1672 përmënd dy banjat e Elbasanit, që ekzistojnë edhe sot, dy banjo në Berat, sot të zhdukura, banjën në lagjen Meçite të Gjirokastrës, si dhe shumë banja private në Berat, Kavajë dhe Elbasan.[2])

Për nga përdorimi, vendi ku ndërtoheshin dhe madhësia, banjat ndahen në private, (shtëpijake) dhe në publike.

BANJAT PRIVATE

Me sa kemi vënë re, banjat private ndërtoheshin në banesat e mëdha të qyteteve. Në banesën shkodrane me çardak, banja (hamamxhiku) i bashkëngjitet anash ose nga prapa asaj, duke qëndruar si volum më vete. Një rast zgjidhjeje të tillë takojmë dhe në Gjirokastër, në banesën e Zekatëve. Këto banja përbëhen prej vetëm një ambienti me përmasa të vogla, zakonisht 1,5 x 1,5 m. Funksionojnë në mënyrë primitive, pa impiant ngrohjeje apo furnizimi me ujë, veç asaj të Zekatëve, e cila ngrohet me hipokaust, që shfrytëzon oxhakun e dhomës pranë. Në përgjithësi, të ndodhura në aneksin ngjitur me banesën, ato hasen në unitet me nyjën sanitare dhe sqollin. Në disa banesa të mëdha të shtresave të larta shoqërore, takojmë variantin e banjës familjare në formën e saj më të zhvilluar, qoftë të përfshirë në konturin planimetrik të banesës apo si aneks ngjitur asaj. Në këtë variant banja familjare është me skemë funksionale më të plotë, me përmasa më të mëdha e me sistem ngrohje, furnizimi me ujë e zgjidhje sferike të mbulesës, që të kujtojnë banjën publike në miniaturë.

Në një banesë të tillë në Berat (sot muzeu i qytetit) hasim banjën familjare të zhvilluar, të ruajtur në gjendje mjaft të mirë. Përfshihet brënda konturit planimetrik të banesës, në katin e sipërm të saj (tab. I,4). Volumi i banjës, i përbërë prej disa ambientesh, është vendosur prapa, në qoshen e djathtë të banesës (tab. I,5). Prej koridorit të banesës kalohet në ambientin e hyrjes së banjës (1), që lidh katër ambientet përbërëse të saj. Përballë hyrjes ndodhet ambienti i zhveshjes(2), prej nga kalohet në ambientin e larjes(3). Këtu ndodhet vaska e ujit, një gur i vetëm, i trajtuar me motive bimore në qoshet. Dyshemeja është shtruar me pllaka guri. Ndriçimi i ambientit të larjes realizohet nëpërmjet vrimave mbyllur me xham, të hapura në mbulesën sferike.

Ngrohja e ujit kryhej në ambientin e zjarrit(4), që ndodhej ngjitur me atë të banjës, në shpinë të faqes së murit ku ndodhej vaska.

Uji pasi ngrohej mbi vatrën e këtij ambienti, me tubacion në mur, del në rubinetën e vaskës. Mbulesa e ambienteve të banjës është realizuar me qemere. Ambientet e larjes e të ngrohjes mbulohen me kupol sferike, ato të hyrjes e nyjes sanitare me qemer cilindrik, ndërsa ambienti i zhveshjes mbulohet me qe-

1) Hamam – Nga arabishtja Hamme = banjë
2) E. Çelebi, **Shqipëria para dy shekujsh,** Tiranë 1930, 8, 10, 34, 64, 94, 105.

mer pasqyrë, ku ndodhet një hapje qëndrore për ndriçim.

Një tjetër banjë familjare gjejmë dhe në një banesë krutane në lagjen Kala të qytetit (sot muzeu etnografik). Në ndryshim me rastin e Beratit, kjo banjë (tab. I,1,3), përbëhet nga ambienti i zhveshjes(1) dhe ai i larjes(2); këtu shohim vaskën në shpinë të murit tërthor të banesës, Ngrohja e ujit bëhet prej oxhakut të «shtëpisë së zjarrit»(3), që ndodhet ngjitur me banjën (tab.I,2). Zjarri i oxhakut ngroh ujin e kazanit, vendosur në një nike mbi vaskë, si dhe hipokaustin (kanalet) nën dyshemenë e ambientit të larjes. Banjë e vjetër familjare e këtij tipi (sot e transformuar) ruhet dhe në Tiranë, në banesën ku sot ndodhet Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Këta ishin ekzemplarë të ruajtur të banjës private të ndërtuara në banesat e vjetra të qyteteve. Transformimet e banesave kanë bërë që sot të arrijnë një numër i kufizuar i këtyre elementeve përbërës të tyre.

BANJAT PUBLIKE

Banjat publike janë ndërtime shoqërore të rëndësishme të qytetit mesjetar të vonë. Sipas rastit këto ndërtoheshin në qendër të qyteteve ose në lagjet e tyre. Për shkak të frekuentimit më të dendur, banjat e qendrës përbëjnë ndërtime më të mëdha se ato të lagjeve.

Përgjithësisht banjat publike i gjejmë të ndërtuara afër xhamive duke formuar në unitet me to një kompleks arkitektonik tipik. Skema bazë e kompozimit planimetrik të banjove, që takohet më shpesh, përsëritet me ndryshime të vogla në të gjithë objektet e këtij lloji, që ruhen ende në disa nga qytetet tona. Ajo përbëhet nga këto ambiente: 1 — Ambienti i zhveshjes, 2 — Ambienti ndërmjetës ose izolues, me një temperaturë ndërmjetëse. Zakonisht me këtë ambient lidhen nga ana funksionale ambienti i pastrimit të imët dhe nyje sanitare. 3 — «Odat» e larjes me temperaturë të lartë. Përgjithësisht, menjëherë pas ambientit ndërmjetës, kalohet në ambientin kryesor të djersitjes, zakonisht me gjerësi sa ajo e vetë objektit, ku kryhej masazhi e ku ndodhen dhe vaska për larje. Pas këtij ambienti renditen frontalisht dy ose tre ambiente (qeli) të veçanta për banjë, në çdo njerën prej të cilave ka një ose dy vaska. 4. — Ambienti i fundit i banjës është depua e ujit, gjithmonë me gjatësi sa gjërësia e objektit. Në mjaft banja këto ambiente janë simetrike njera me tjetrën ndaj një aksi gjatësor.

Për nga përdorimi i tyre, banjat publike ndahen në «tek» — hamamet e në «çift — hamamet. Tek—hamamet janë ndërtuar për një seks dhe përdoreshin vetëm për burrat ose vetëm për gratë apo dhe për të dy sekset, në ditë të ndryshme ose në kohë të ndryshme të ditës (para-dite për burrat e pas-dite për gratë). Vetëm njera nga banjot që ruhet sot ka funksjonuar si çift-hamam, ajo e kalasë në Elbasan, e cila edhe kjo në fillim ka qenë tek, por më pas, në një fazë të dytë, është shtuar dhe adaptuar në dy seksione të veçanta.

Duke u nisur nga ambientet që përbëjnë banjën publike, këto ndërtime shoqërore të ndërtuara tek ne, mund ti klasifikojmë në dy grupe:

1. — Banja publike me skemë të plotë funksionale, ku përfshihen dy banjat e Elbasanit, ajo e Shkodrës e ndoshta dhe e Tiranës.

2. — Banja publike me skemë jo të plotë funksionale, ku mungon ambienti ndërmjetës. Këtu mund të grupojmë banjat e Krujës, Gjirokastrës, Durrësit, Çorovodës, Lezhës dhe Delvinës.

Banja e Pazarit në Elbasan — Ndodhet në qendër të qytetit, afër Xhamisë së Agait dhe ruhet në gjëndje të mirë, pasi ka funksionuar deri në vitet 40 të shekullit tonë (fig. 1). Kjo banjë, e cila përmendet që në vitin 1672 prej Çelebiut,[3]) ka funksionuar si tek-hamam. Një ditë e javës, e enjtja, ishte caktuar vetëm për gratë. Ambientet që e përbëjnë banjën janë ai i zhveshjes (1), ndërmjetësi (2) me nyjen sanitare (3) dhe atë të pastrimit (4), ambienti kryesor i djersitjes (5), dy ambientet e veçanta për banjë (6) dhe rezervuari i ujit (8) me furrën pas tij.

Ambienti i zhveshjes, më i madhi, ka pësuar transformime. Sipas thënieve të vëndasve, që kanë shërbyer në këtë banjë, vite më parë ky ambient ka qënë me dy kate. Nga sondazhet dolën gjurmë të ambientit të vjetër të zhveshjes, që dallohen në lidhjet e mureve të tij me pjesën tjetër më të vjetër të banjës. Ambienti i zhveshjes sot mbulohet me çati me konstruksion druri (Fig. 3). Përsa i takon tipit të mbulesës së vjetër nuk kemi asnjë gjurmë apo të dhënë, pra, mbetet vetëm të supozohet nëse ka qenë mbulesë me kupola masive, siç ndodh shpesh me ambientet e tilla të banjove të mëdha.

Hyrja e sotme e banjës është nga ana e xhamisë, ndërsa hyrja e vjetër ka qenë në mesin e murit jugor të ambientit të zhveshjes (nga ana e hotelit). Në qendër të ambientit ndodhet një shatrivan me formë oktagonale i punuar me pllaka guri, lidhur në krye me ganxha e plumb. Në qendër të tij ngrihet një kollonë gurësh me seksion rrethor, të çpuar në mes për kalimin e ujit. Veç efektit dekorativ, shatrivani shërbente dhe si vend për larjen e peshqirëve. Në ambient, perimetralisht gjatë mureve, është ndërtuar një sofat guri i ngritur 60 cm. nga dyshemeja e me gjerësi 1,5 m. Ky shërbente për uljen e klienteve dhe për vendosjen

3) E. Çelebi, vep. cit., 108.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1



Planimetria

Fig. 2



Fig. 3

e plaçkave para larjes. Poshtë, në ballin e sofasë janë hapur kamare për lënien e nallaneve.

Në murin jugor, ngjitur me murin e pjesës së vjetër, është hapur një derë, prej nga sillej prushi i furrës për tharjen e peshqirëve, proçes që kryhet në një vatër të improvizuar ngjitur me derën. Në qoshen e djathtë, karshi hyrjes së vjetër është ndërtuar një llozhë prej druri, qoshk për pushimin e personave të veçantë pas banjës. Ambienti merr dritë nëpërmjet shtatë dritareve të hapura në lartësi nën nivelin e tavanit. Muret janë ndërtuar me gurë plloçakë të lidhur me llaç balte, ndërsa konstruksioni i drunjtë i çatisë mbështetet në qendër mbi katër kollona druri, të cilat janë ngritur në pjesën e poshtme mbi kollona guri rrethore. Dyshemeja dhe sofati janë shtruar me pllaka guri të rregullta.

Prej ambientit të zhveshjes kalohet në ambientin ndërmjetës, (fig. 4) që siguronte adaptimin gradual të trupit ndaj temperaturës së lartë të ambienteve të larjes. Majtas hyrjes, në ambient ndodhet një nike dhe, karshi saj ngrihet një sofat, që ze një pjesë të mirë të sipërfaqes së ambientit, e shtruar edhe kjo me pllaka guri të rregullta. Herë-herë ky ambient përdorej edhe për zhveshje, sidomos në stinën e dimrit. Mbulesa e këtij ambienti është realizuar me qemer pasqyre, ku janë hapur 23 vrima për ndriçim natyral, disa në formën e yllit me gjashtë cepa e disa në formën e gjashtëkëndëshit.

Lidhur me ambientin ndërmjetës ndodhet nyja sanitare dhe ambienti i pastrimit. Në ambientin e pastrimit ndodhet vetëm një vaskë guri me niken mbi të, ku vendosej kandili me vaj për ndriçim natën. Ambienti ndërmjetës, që lidhej me katër ambiente të tjera, izolohej prej tyre me anën e dyerve të rënda prej druri, që me sa shihet nga gjurmët, mbylleshin vetëm nga një peshë lavjerës varur prapa tyre. Në këtë mënyrë sigurohej mbyllja e vazhdueshme e dyerve për të mos lejuar ftohjen e ambienteve kryesore të banjës.

Pas këtij ambienti kalohet në ambientin kryesor të djersitjes me përmasa të mëdha. Në këtë ambient kryhej proçesi i djersitjes dhe i masazhit të klientave, pra, pregatitja e tyre për larje. Për këtë qëllim shërbenin tre nike në muret anësore dhe sofaja në skajin karshi hyrjes. Këtu ndodhen dhe dy vaska guri, ku laheshin nga dy klientë ulur mbi stola. Në qendër të mbulesës së ambientit ngrihen dy kupola sferike, koncentrike njëra mbi tjetrën. Prej këtej kalohet në dy ambientet e veçantë të larjes, të mbuluar secili me kupol sferike dhe të paisura me nga dy vaska, mbi të cilat ka vetëm nga një rubinetë. Në ambientin e djathtë ndodhet një dritare komunikuese me depon e ujit, pra ky është dhe ambienti më i ngrohtë, pasi këtu hynte avulli i nxehtë i ujit të depos.

Ambienti i fundit përbërës i banjës së Pazarit është depua e ujit me gjërësi pothuej sa ajo e vetë objektit. Depozita e ujit mbulohet me qemer cilindrik, ku janë hapur tri dritare. Mbi nivelin e tabanit të depos, nga ana e ambienteve, ndodhet filtri i daljes së ujit të nxehtë, i cili qarkullon pastaj nëpër tuba qeramike. Në qendër të depos ndodhet një kazan bakri me

DO NOT COPY

diametër 120 cm. dhe thellësi 70 cm., vendosur mbi qemerin e furrës. Ajri i nxehtë i furrës ngroh ambientet me përjashtim të atij të zhveshjes, duke kaluar nëpër boshllëqe të bëra nën dyshemet e ambienteve. Konstruksioni i dyshemesë së këtyre ambienteve mbështetet mbi kollona guri 40 x 40 cm., që krijojnë boshllëqet (kanalet) midis tyre. Sipas thënieve të shërbyesit të banjës, furnizimi me ujë i banjës bëhej nga depozita e shpërndarjes së qytetit, afër kullës së kalasë. Uji vinte deri tek hyrja e vonë e ambientit të zhveshjes dhe aty ndahej në dy degë: njëra furnizonte direkt shatrivanin, ndërsa tjetra furnizonte kanalin e ndërtuar në kreun e pragut të gurtë ngjitur murit verior nga jashtë, që çonte ujin në depo, në nivelin e mesit të saj. Veç kësaj depua grumbullonte dhe ujët e shiut, që mblidhej në ulluqet, ndërmjet kupolave të çatisë. Ky ujë hynte në sterë me anë tubash qeramike të maskuara nën tjegullat e mbulesës së sterës, që përfundonin tek dritaret e hapura në qemerin cilindrik të depos. Në fazën fillestare, vaskat e ambienteve furnizoheshin me ujë nga dy tuba qeramike, uji ftohtë sipër dhe i nxehti poshtë. Në gjendjen e sotme mbi vaskat ka vetëm nji rubinetë me ujë të nxehtë, që furnizohej nga depua me anën e një tubi metalik.

Banja në Kalanë e Elbasanit. Edhe kjo përmendet prej Çelebiut që në shek. XVII[4]). Ka funksionuar si çift-hamam (tab. II,1) dhe është e vetmja e këtij llooji nga banjat që ruhet deri më sot në vendin tonë. Në gjendjen e sotme objekti ka arritur me shumë transformime, të cilat e kanë ndryshuar mjaft kompozicionin planimetrik të saj. Transformimet e tij kanë ardhur si pasojë e tri fazave të ndërtimit, që janë kryer në këtë banjë (tab.II,2,3).

Nga faza më e hershme ruhen sot, ambienti i zhveshjes (1), ambienti kryesor i djersitjes (2), dy ambientet e veçanta për larje (3 e 4) dhe depua e ujit (5). Në fazën e dytë objektit i shtohen dhe dy ambiente anësore për gratë (6 e 7), duke u zgjeruar gjithashtu sipërfaqja e depos së ujit dhe e njerit nga ambientet e veçanta të burrave. Gjithë këto ambiente mbulohen me qemere.

Në fazën e tretë objektit i shtohet përpara një ndërtesë me lartësi 6 m., mbuluar me çati me konstruksion druri e me disa dritare për ndriçim. Kjo shtesë me mur guri lidhur me llaç balte, që zen pothuaj gjithë gjërësinë e objektit, është ndarë për së gjati në dy pjesë. Në të majtë u adaptua ambienti i zhveshjes për gratë (8), që përbënte një volum pa ndonjë trajtim të veçantë, ndërsa ambienti i zhveshjes i burrave (9), mbeti në pjesën e djathtë. Proçesi i zhveshjes kryhej në sofatin përdhes si dhe në lloxhën që shërbente për këtë qellim në dy nga tre muret kufizues të



Fig. 4

ambientit, e cila ngrihej mbi kollona druri. Me ndërtimin e këtij lokali shtesë, ambienti i parë i pjesës së vjetër vetiu duhet të ketë funksionuar si ambient ndërmjetës. Ky ambient ku në një krah ndodhej vetëm një sofat i ulët, nga e majta e tij, lidhet me nyjen sanitare. Në ambientin në vijim të djersitjes, në anët më të ngushta, karshi njëra tjetrës, duken gjurmët e dy rubinetave. Më tej kalohet në dy ambientet e larjes, djathtas të cilave ndodhet nyja e pastrimit. Njëri nga këto ambiente, i djathti, komunikon me depon e ujit me anën e një dritareje. Në qendër të depos së ujit ndodhet kazani i bakrit për nxehjen e ujit, i vendosur me fundin nga sipër. Në ndryshim nga rastet e tjera, këtu mbulesa e depos së ujit është realizuar me llaç

4) E. Çelebi, **vep. cit.**, 108

DO NOT COPY



Fig. 5

shamot shtruar mbi qemerin cilindrik konstruktiv.

Banja e Vogël e Shkodrës – Kjo banjë, që ndodhet në lagjen Parucë (fig. 5), sipas H. Bushatit del se është ndërtuar në janar 1739.[5]) Edhe në këtë objekt shohim skemën e plotë të banjës publike. Kompozicioni planimetrik i saj është trajtuar duke ruajtur pothuaj një vendosje të ambienteve përbërëse sipas një aksi gjatësor simetrik. (fig. 6,7). Në ballin e banjës shohim një ndërtesë dykatëshe, me nga dy ambiente në çdo kat, të ndara me koridor në mes, që ka funksionuar si administratë e banjës dhe, ndoshta, «odat» e sipërme dhe si ambient pushimi.

Pjesa e poshtme është ndërtuar me mur guri, që duket i një teknike me murin e ambientit të zhveshjes, ndërsa kati i sipërm është ndërtuar me mur tulle dhe mbulohet me çati me konstruksion druri. Nëpërmjet koridorit të katit të poshtëm kalohet në ambientin përdhes të zhveshjes (2), ndërtuar me mure masivë guri, që ndriçohet prej katër dritaresh, nga dy në çdo faqe gjatësore, dhe mbulohet me konstruksion druri. Në një qoshe të ambientit që caktuar vendi i pregatitjes së çajit.

Në anën e një dere të ulët kalohet në ambientin ndërmjetës (3), i cili ka vetëm një sofat majtas hyrjes. Nga e djathta e hyrjes, ambienti ndërmjetës lidhet me nyjen e pastrimit (4) dhe atë sanitares, që del si shtesë e murit të banjës. Pastaj kalohet në ambientin kryesor të djersitjes, (6) që shërbente edhe për larje kolektive. Për këtë qëllim rreth mureve të tij ndodhen gjashtë vaska. Pas këtij ambienti renditen tërthorazi tre ambiente të veçanta për larje (7) të pajisura me nga dy vaska. Këto ambiente të fundit mbulohen të gjitha me kupola sferike, ku janë hapur vrima për ndriçim.

Depua e ujit (8), e cila ka disa vrima në mure për furnizimin me ujë, përbëhet nga tre ndarje, dy kapërderdhës anash për veçimin e ujit të ftohtë dhe nga volumi qëndror ku ngrohej uji. Rezervat e ujit të ftohtë me anën e tubave prej qeramike, sot të dëmtuar, furnizonin rubinetën e ujit të ftohtë tek vaskat.

Në grupin e banjave publike të mëdha përfshihen dhe dy banjat e Tiranës, njera sot e shkatërruar dhe tjetra e ruajtur pjesërisht. Këtu bëhet fjalë për banjën e vjetër prapa Komitetit Ekzekutiv (fig. 8, 9), që ruhet

5) H. Bushati, **Lagjet e Shkodrës, toponomistika, etnografia dhe historiku i tyre,** Dorëshkrim i ruajtur në muzeun e Shkodrës.
Autori përmend se kjo banjë administrohej nga drejtoria e arsimit e Turqisë. Në vitet 1892-93 u riparua furra dhe njëra nga kupolat. Më 1919 bashkia e qytetit bëri shumë riparime në brëndësi. Pas riparimit banja u dha në sipërmarrje, por pas disa vjetësh ajo u mbyll, pasi nuk përballonte shpenzimet.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Planimetria



Prerje Aksionometrike

Fig. 6

Fig. 7

e pjesshme, dhe për banjën tjetër afër tyrbes së Kapllan Pashës e ndërtuar në vitin 1614 (ose 1607)[6]) prej Sulejman Pashës, bashkë me xhaminë. Sipas një fotografie të vjetër, ambienti i hyrjes (zhveshjes) i kësaj të fundit ishte masiv dhe mbulohej me dy kupola të mëdha, ndërsa për ambientet e tjera nuk mund të shprehim ndonjë mendim. Po këtë formë ka dhe ambienti i hyrjes i banjës tek komiteti. Ambientet e tjera të kësaj janë shkatërruar prej kohësh.

Rastet e përshkruara më sipër ishin ekzemplarët e banjave publike të mëdha të ruajtura ende në vendin tonë. Një grup tjetër përbëjnë banjat e vogla me

6) Kristo Frashëri, Doreshkrimi mbi historikun e Tiranës, f. 18

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9



Fig. 10

skemë funksionale jo të plotë, ku mungon ambienti ndërmjetës. Këtu përfshihen banja e Kalasë në Krujë, e Gjirokastrës, e Durrësit, e Sllatinjës (Çorovodë), e Lezhës dhe e Delvinës.

Banja në Kalanë e Krujës. Ndodhet në skajin perëndimor të kalasë, afër teqes së Dollmës (fig. 11). Ambienti i zhveshjes sot është pa çati. Brënda tij, anës mureve, ruhen gjurmë sofatesh. Dy-tre këmbëshkallë të zbresin në ambientin e djersitjes (2), në të djathtë të të cilit shihen gjurmë të një vaske (fig. 12). Majtas tij, ngjitur ndërtesës, ndodhet nyja sanitare (3). Më tej vazhdojnë dy ambientet e veçantë të larjes (4 e 5). Ambienti i djathtë ka një dritare komunikuese me depon e ujit. Kjo furnizohet me ujë nëpërmjet një dritareje të vogël hapur djathtas saj. Në qendër të depos është vendi i kazanit të ujit, ndërsa në skajin e

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

majtë një kapërderdhës ngrihet për të veçuar rezervën e ujit të ftohtë. Në siluetën e çatisë së banjës dominojnë tri kupola sferike. Ky objekt ka qënë mjaft i dëmtuar. Në vitin 1966 në të u kryen punime restaurimi që e vlerësuan mjaft monumentin.

Banja në lagjen Meçite — Gjirokastër (fig. 13), është ndërtuar në qëndër të lagjes afër xhamisë që përmëndet nga Çelebiu[7]). Për ngritjen e saj është zgjedhur një zonë me ujë, pasi edhe sot këtu ruhen disa kroje të vjetra. Në hyrje të objektit (fig. 14) shohim ambientin e zhveshjes, sot i dëmtuar, që është më i vonë se ambientet e tjera. Pjesa më e vjetër përbëhet gjithësej nga tre ambiente me volume pothuaj të njëjta. Para dy ambienteve të veçantë të larjes (3 e 4) ndodhet ambienti i tretë 2, që mund të konsiderohet qoftë si ambient djersitje, qoftë si ndërmjetës, qoftë si vend për zhveshje në periudhën kur nuk ishte shtuar akoma ambienti i zhveshjes, prej të cilit sot ruhen vetëm muret. Si në këtë ambient ashtu edhe në dy të tjerët, të destinuar për larje, ka pasur vetëm nga një vaskë. Uji rridhte në to me anën e dy tubacioneve prej qeramike, që nisen nga depua e ujit. Depua e ujit 5 është e formës së zakonshme, mbulohet me qemer cilindrik dhe furnizohet nga e majta. Ambientet mbulohen me kupola sferike, që nuk lartësohen shumë mbi çati. Kjo banjë, është braktisur prej vitesh e prandaj ndodhet në gjendje mjaft të dëmtuar.

Banja e Vjetër në Durrës. Ndodhet afër gjimnazit të vjetër të qytetit dhe përfshihet brënda mureve të kalasë mesjetare. Përbëhet prej vetëm katër ambientesh (fig. 15). Në qendër të kompozimit planimetrik të saj ndodhet ambienti i zhveshjes, që është dhe më i madhi. Mbulohet prej një kupole masive në majën e së cilës ngrihet një tjetër më e vogël koncentrike me të. Në të djathtë të saj janë vendosur dy ambiente të vogla për larje, njeri pas tjetrit. Ai i pasmi lidhet me dritare me depon e ujit, që zë gjithë gjërësinë e objektit.

Jashtë, nga prapa sterës (4), duken gjurmët e qemerit të furrës. Në ambientet e saj nuk ruhet tashmë asnjë pajisje e veçantë e banjës, si vaska, sofa, etj. Në një fazë të dytë, para hyrjes së banjës së vjetër, është ngritur një ndërtesë dykatëshe, që duhet të ketë funksionuar si aneks zhveshjeje, duke lehtësuar kështu ambientet e pjesës së vjetër. Në qytetin e Durrësit deri kohët e fundit ekzistonte një banjë tjetër, e cila megjithëse ishte mjaft e re, qe ndërtuar me një skemë funksionale identike me banjën e vjetër, veçse në ditët tona furnizimi me ujë i saj ishte përshtatur sipas teknikës së kohës (fig. 16).

7) E. Çelebi, **vep. cit.**, 34.



Fig. 13



Fig. 14

Banja e Sllatinjës. Ndodhet në qendër të fshatit, ngjitur me xhaminë dhe ruhet në gjendje të rrënuar. Përdorej prej banorëve të fshatit e, ndoshta, dhe prej efektivit të garnizonit turk të Kalasë së Çorovodës, që ndodhet aty afër. Përbëhej prej katër ambientesh që formojnë një kompozicion planimetrik simetrik ndaj aksit gjatësor (tab. II, 6). Ambienti i zhveshjes (1) me gjërësi sa vetë ndërtesa mbulohej me qemer cilindrik dhe ishte suvatuar i tëri nga brenda me llaç shamot. Brenda tij, nga e djathta ishin përshtatur dy nyje sanitare. Dy volume të njëjta, njeri bri tjetrit, përbëjnë ambientet e banjës (2 e 3), që mbulohen me kupola sferike të realizuara me tulla. Ambienti i majtë komunikon me sterën e ujit, që, si zakonisht, mbulohet me qemer cilindrik. Në këtë banjë të rrënuar nuk ruhet asnjë pajisje e veçantë e saj. Me sa kemi mundur të gjurmojmë, kjo banjë është e vetmja e këtij lloji në vëndin tonë e ndërtuar në fshat, që ruhet ende.

Banja e Lezhës. Është më e vogla që ruhet në vendin tonë. Ndodhet në afërsi të kalasë antike të Lezhës. Përbëhet prej tre ambienteve (tab. II, 5). Lokali i zhveshjes me lartësi 3.30 m. nga të dy anët e hyrjes ka sofa 20 cm. nga dyshemeja për vendosjen e rrobave. Mbulohet me qemer cilindrik. Ambienti i banjës (2) ka formë kuadratike dhe mbulohet me kupol sferike. Stera (3) mbulohet me qemer cilindrik të realizuar me gurë çmërsi. Edhe kjo banjë ndoshta është përdorur nga garnizoni turk i kalasë së Lezhës. Sot është transformuar në banesë, prandaj nuk ruan asnjë pajisje të veçantë të banjës.

Banja e Delvinës. Ndodhet në lagjen e vjetër Xhermëhallë (sot Lejla Malo), jashtë qytetit, ngjitur kalasë mesjetare. Bën pjesë në një kompleks interesant arkitektonik, që formohet prej xhamisë, tyrbeve, imaretit, krojeve dhe vetë banjës. Ky objekt hyn në kategorinë e banjave të vogla dhe përbëhet prej katër ambientesh (tab. II, 4). Ambienti i zhveshjes (1), zë tërë gjërësinë e ndërtesës dhe majtas hyrjes ka pasur dhe vaskë. Djathtas hyrjes ndodhet një derë, e cila, me sa duket, të lidhte me nyjen sanitare. Më tej vijojnë dy ambientet e banjës (2 e 3) njeri përbri tjetrit, ku ka pasur nga një vaskë. Në këto ambiente duken gjurmët e tubacioneve të qeramikës me diametër 10 cm. e gjatësi 27 cm. Ambienti i fundit i banjës është stera (4), sot e dëmtuar. Nën sterë duken gjurmët e hipokaustit. Ambientet mbulohen me kupola sferike, realizuar me tulla. Në çati duken gjurmë tjegullash të mëdha dhe të kanaleve (oxhaqeve) të daljes së tymit. Interesant është fakti se në ndërtimin e muraturës së banjës është përdorur brezi i drurit, gjë që nuk haset në banjat e tjera.

Analiza teknike. Merita e mjeshtrit popullor në ndërtimin e hamameve qëndron në zgjidhjen e problemeve teknike që paraqet ky ndërtim shoqëror, problemeve të cilat nuk takohen njëherësh në kompleks në gjinitë e tjera të objektevet shoqërore. Aftësia e ndërtuesit në këto objekte duket që në fillimin e ndërtimit të hamamit, në zgjidhjen teknike të hipokaustit. Kjo ka të bëjë jo vetëm me zgjedhjen e materialeve për ndërtimin e tij, por dhe me caktimin e seksionit të kanaleve, nga i cili varet direkt ngrohja e mjaftueshme e ambienteve të ndryshme.

Kollonat e hipokaustit ndërtoheshin me seksion rrethor me diametër 25 cm. (Shkodër) dhe, në shumi-

DO NOT COPY

cën e rasteve, me seksion kuadratik me brinjë 30-40 cm. (Krujë, Gjirokastër, Elbasan). Boshllëqet (kanalet) ndërmjet tyre kanë gjërësinë 30-35 cm. Lartësia e kanaleve të hipokaustit varet nga volumi i ambienteve që ngrohen. Në banjat e mëdha (Shkodër, Elbasan) kjo lartësi arrin deri në 80 cm., ndërsa në banjat e vogla (Gjirokastër, Krujë) arrin jo më shumë se 50 cm. Kollonat janë ndërtuar me gurë lidhur me llaç gëlqere. Për sigurimin e një mbështetje të mirë të pllakave të dyshemesë, në banjat e mëdha, ku kanalet e hipokausit janë më të gjëra, krerët e kollonave lidhen midis tyre me vetë pllakat e dyshemesë (Elbasan) ose me rripa metalikë (Shkodër). Mbi këtë konstruksion është vendosur shtresa e parë mbajtëse e pllakave prej guri me trashësi 4 cm., mbi të cilën shtrihet 3 cm. llaç me pluhur tjegullash dhe sipër vendosen pllakat që formojnë dyshemenë e ambienteve. Kjo teknikë haset në banjat e mëdha të Shkodrës dhe Elbasanit. Në këto banja, pllakat e dyshemesë së ambienteve kanë forma të rregullta gjeometrike. Në banjat e vogla, ku hipokausti është i vogël, mbi kollonat e tij vendoset vetëm një rrjesht me rrasa guri 5 cm. me formë pak a shumë të rregullt (Gjirokastër, Krujë).

Dyshemetë e ambienteve kanë një pendencë që fillon të bjerë nga ambienti i fundit i larjes, në drejtim të nyjes sanitare, ku shkarkohen ujrat e banjës. Për këtë shërben në ndonjë rast, si në Elbasan, dhe një kanal i vogël i hapur rrëzë mureve perimetralë.

Gazi i nxehtë i furrës, pasi qarkullon nën dyshemeja i ngroh ambientet dhe del në hapësirë nëpërmjet disa kanaleve vertikalë hapur në muret e banjës, direkt nën paretin e suvasë. Këto kanale rrethore me diametrin e poshtëm rreth 30 cm, ngushtohen në pjesën e daljes në çati ku ato përfundojnë me tuba qeramikë, të nxjerrë 20-30 cm. mbi çati, për heqjen e tymit. Në çatinë e banjës shihen mjaft «oxhaqe» të tillë p.sh. në banjën e Pazarit të Elbasanit numërohen 26 copë. Gjithë ambientet e banjave, që janë në kontakt me lagështinë dhe me avujt e ujit, janë suvatuar me llaç shamot, ku si mbushës shërben pluhuri i tjegullës së shtypur, e si lidhës gëlqere e shuar mirë. Kjo zgjidhje e suvatimit të ambienteve është karakteristike për banjat, ku lagështia dhe avulli dëmtojnë veshjet e mureve. Vërehet se nën veprimet e këtyre faktorëve, me kalimin e kohës ngjyra e kuqe e hapur e finos me tjegull nxihet. Ky lloj suvatimi në banja të ndryshme



Fig. 15



Fig. 16

DO NOT COPY

është realizuar me teknikë të ndryshme. Në banjën e Shkodrës deri në nivelin 1,1 m. mbi dysheme është realizuar kjo teknikë: 10 mm. dorë e parë me kokrriza tjegulle të mëdha, (5 mm. dorë e dytë e varfër me tjegull dhe finua 4 mm. e pasur me pluhur të shtypur imët. Pjesa mbi këtë nivel ka duar të ndryshme. Në banjën e Pazarit të Elbasanit ambientet janë suvatuar me një shtresë të trashë 3 cm. prej llaçi me tjegull. Muret në interierin e banjës së Krujës në suvatim si dorë e parë kanë një shtresë të trashë llaçi me përzjerje rane dhe kokriza gëlqereje, dora e dytë është vetëm brumë i papastër gëlqereje dhe 2 mm. fino me tjegull të imët. Suvatimi i brendshëm në banjën e Gjirokastrës përbëhet nga 6 shtresa: dora e parë është një shtresë 5 mm. brumë i pastër gëlqereje, pastaj vijojnë — 5 mm. llaç me përqindje të madhe tjegulle; 10 mm. llaç gëlqere e pasur me ranë 0-5 mm. me ngjyrën jeshile të ranës; 6 mm. brumë gëlqere me kokrriza, 2-3 mm. brumë gëlqere e staxhionuar dhe në syprinë, në vend të sherbetit, është hequr një shtresë shumë e imët me pluhur tjegulle. Boja e bardhë e sherbetit të gëlqeres nuk i reziston lagështisë së banjave, prandaj në shumicën e banjave ajo është e dëmtuar. Nuk dimë në se ambientet kanë qenë gjithmonë të sherbetuara, apo vetëm me suvatim shamot. Faktet kanë treguar se ky lloj suvatimi i ka qëndruar mjaft mirë kohës. Bile ai ka rezistuar dhe në veshjen e sterave të ujit tek hamamet, ku ka qënë në kontakt direkt me ujin dhe avujt e tij. Si mbushës në këto llaçe është përdorur pluhuri i tjegullës e jo i tullës, sepse tjegulla duke qënë më e hollë, piqet më mirë, kështu që pas shtypjes argjili i saj i pjekur mirë lidhet më mirë me gëlqeren e shuar. Me llaç të tillë janë suvatuar edhe kamaret e nallanave në ambientin e çveshjes të banjës së Pazarit të Elbasanit.

Vaskat e ujit (kurmat — nga turqishtja mbledhës uji) nëpër ambientet vendoseshin direkt mbi dysheme. Ndërtoheshin prej një guri të vetëm, qoftë ky gëlqeror (Elbasan), apo dhe mermer (Shkodër), i cili punohej në formë kubike nga jashtë ose dhe afërsisht në formën e një gjysmë sfere. Për mbajtjen e ujit ato thelloheshin nga brënda në trajtën e gjysmës së sferës. Veç këtij punimi, vaskat e banjave ishin objekte të dekoruara me skalitje të ndryshme. Ato trajtoheshin me motive të ndryshme si dhe me korniza. Vaskat e banjës së Pazarit të Elbasanit kanë formën e kubit të rregullt të prerë në skajet e jashtme, me brinjë 50 cm., brenda të cilit hapet e thelluara sferike e ujit me diametër 36 cm.

Vaskat e hamamit të Shkodrës kanë formën e një vazoje gjysëmsferike të mbështetur mbi një këmbë. Në këtë rast gdhëndësi i ka dhënë vaskës jo vetëm zgjidhjen funksionale, por dhe trajtimin dekorativ. Në asnjë nga banjat tona nuk ruhet ndonjë ekzemplar i rubinetave prej tunxhi mbi vaskat.

Nga gjurmët shihet se mbi çdo vaskë ka pasur dy dalje uji, njera për ujin e nxehtë dhe tjetra për ujin e ftohtë (Elbasan, Shkodër, Gjirokastër, Krujë). Uji në vaskat vinte me anën e dy tubacioneve prej qeramike lidhur mashkull-femër në fugat e tyre. Në Shkodër, Krujë dhe Gjirokastër tubat e qeramikës kanë diametrin e punës 100 mm. dhe trashësinë e pareteve 10 mm. Në lidhje ato futen rreth 15 cm. tek njeri tjetri duke u forcuar dhe me brumë gëlqere të pastër në rolin e llaçit.

Në banjën e Elbasanit tubi i poshtëm (i nxehtë) ka diametrin e punës 12 mm., ndërsa i sipërmi 11 mm. dhe midis tyre i ndan një shtresë llaçi 1 cm. Tubacioni i ujit të nxehtë në gjithë banjat nis paksa mbi nivelin e tabanit të sterës, ku për këtë qëllim është vendosur një filtër llamarine. Përsa i takon furnizimit me ujë të ftohtë ndiqen rrugë të ndryshme. Në rastin e banjave të Krujës dhe Shkodrës uji i ftohtë vjen nga ndarjet e veçanta të realizuara brënda volumit të sterës, ndërsa në banjat e tjera furnizimi me ujë të ftohtë bëhet direkt nga tubacioni i jashtëm (në Pazarin e Elbasanit e Delvinës). Për furnizimin me ujë të banjave publike, veç asaj të Pazarit të Elbasanit, që furnizohej direkt nga ujësjellësi i jashtëm nuk kemi ndonjë të dhënë tjetër. Në të gjitha banjat për ngrohjen e ujit në depo përdoren kazana bakri, të vendosura në qendër të depos, direkt mbi furrë. Kazanet, diku i gjejmë të vendosur normalisht (e Pazarit të Elbasanit) dhe, diku me fundin nga sipër (e Kalasë së Elbasanit).

Për ruajtjen e nxehtësisë së ambientit, për mos depërtimin e të ftohtit të jashtëm, si dhe për të qenë sa më solidë ndaj ngarkesave të mëdha të konstruksionit të mbulesave, muret e banjave ndërtoheshin gjithmonë të trasha. Në asnjë rast nuk i gjejmë më të holla se 70 cm. Dhe konkretisht në Skrapar e Delvinë i hasim 70 cm., në Lezhë 80 cm., në Elbasan 100 cm. dhe bile në Tiranë hasen mure masive me trashësi 131 cm. Ka raste që muret e pasme të sterave për t'i rezistuar presionit të ujit bëhen mjaft të trasha, si ai i Pazarit të Elbasanit, ku trashësia arrin 130 cm. Karakteristikë e përbashkët e mureve të banjave është se në muraturën e tyre mungon brezi lidhës i drurit (veç Delvinës). Breza hasen në ambientet e vona të zhveshjes, që mbulohen me konstruksion druri (dy të Elbasanit).

Ndoshta vështirësinë më të madhe teknike banjat e kanë në zgjidhjen konstruktive të mbulesës, në zgjidhjen sa më të lehtë të tipit të mbulesës, të atij tipi që shkon për një ambient të dhënë, si dhe në sigurimin e ekuilibrit të nevojshëm statik ndërmjet gjithë sistemit konstruktiv që mbulon banjën. Zgjidhja e këtyre problemeve e vlerëson mjaft mjeshtrin popullor, i cili me praktikën e tij ka bërë që banjat e vjetra publike të njihen si ekzemplarë me vlerë tekniko-konstruktive në gjininë e ndërtimeve të vjetra shoqërore.

Dorëshkrim

Në banjat publike takon tipe qemeresh nga më të ndryshmet.

Elementët dominues në banjat janë harku dhe kupola. Harku rrethor takohet në nike e dyer të brëndshme të ambientevet. Një lloj tjetër harku, që haset shpesh në banjat, është harku i thyer (me majë të mprehtë), që shihet si konstruksion mbajtës nën kupolat apo si formulim dekorativ në kamaret e ambienteve të ndryshme. Kupola gjysëmsferike mbulon ambientet e ndryshme të banjave.

Kalimi nga plani kuadratik i ambienteve drejt unazës rrethore të mbështetjes të kupolës realizohet me anën e velave ose trompave. Këto zgjidhje konstruktive këndore i gjejmë në të gjitha banjat. Mbështetja e kupolave në mure, realizohet me anën e harqeve të verbër. Në mbulimin e ambienteve të vogla janë përdorur qemere pasqyrë. Të tilla hasen në banjat e Elbasanit, në Krujë dhe Gjirokastër.

Në banjën e kalasë në Elbasan këto lloj qemeresh mbështeten në muret me anën e konsolave dhe trompave me formë stalaktitesh. Kupolat koncentrike i takojmë në dy raste, në banjën e pazarit të Elbasanit dhe në Durrës. Këtu në qendër të kupolës masive sferike ngrihet një kupol tjetër e vogël, që evidentohet mbi çati. Siç pamë më sipër, në konstruksionin e mbulesave të banjave, për ndriçim janë hapur vrima mbi të cilat vendoseshin globe xhami. Çdo banjë ka shumë vrima të tilla, p.sh. në atë të Pazarit të Elbasanit janë 111 të tilla, në Shkodër 112, etj. Në asnjë banjë nuk ruhet qoftë edhe një glob si gjurmë. Sipas thënieve gojore këto globe kanë pasur formën e këmbanës me një kapse sipër. Zakonisht vrimat e ndriçimit kanë seksion gjashtëkëndësh (Elbasan, Shkodër, etj.), por i gjejmë dhe në formën e yllit me 6 cepa (pazari i Elbasanit) ose dhe rrethore (Gjirokastër).

Pothuaj në të gjithë banjat tona mbulimi i kupolave është realizuar me tjegulla. Kupola e vogël koncentrike në Elbasan mbulohet me llaç shamot, po kështu duken dhe gjurmat e mbulesës së sterës të banjës së kalasë së Elbasanit.

Në banjën e vjetër të Durrësit që ka arritur e transformuar, dy kupolat koncentrike i gjejmë të lyera me bitum. Pendenca e madhe e tyre të shtyn të mendosh se dhe ato do të kenë qenë mbuluar me llaç shamot ose me plumb. Llaç i tillë është përdorur dhe në suvatimin nga jashtë të tambureve të kupolave në banjën e Elbasanit si dhe në Shkodër, siç shihet nga gjurmët.

Furrat për ngrohjen e ujit i gjejmë gjithmonë në murin e pasmë të banjës, pra pas sterës. Ndërtoheshin në qendër të këtij muri dhe konstruksioni i tyre realizohej me qemer cilindrik prej tullash. Në mes të qemerit lihej një boshllëk, mbi të cilin ngrihej oxhaku për daljen e tymit (Elbasan, Shkodër).

Në muret e jashtëm të banjave nuk përdorej suvatimi. Materialet për ndërtimin e banjave siguroheshin të gjitha në vend. Ne unitet me ndërtimet e tjera të qytetit, banja e Gjirokastrës mbulonet me rrasa guri. Me sa kemi vënë re në ndërtimin e banjave rendesi e veçantë i kushtohej kualitetit të brumit te gelqeres. Të gjithë muret lidhen me llaç gelqere. Në muraturë janë perdorur edhe gurë lumi (Krujë, Elbasan), edhe gurë pllocakë shkëmborë (Gjirokaster). Një përdorim më të kurizuar në banjat ka patur tulla. Me tullë ndërtoheshin qemerët e mbulesave (Elbasan, Shkodër, Krujë, Skrapar, furrat, harqet e dyerve dhe kornizat dekorative të çative (në Kalanë e Elbasanit, Shkodër).

ANALIZA ARKITEKTONIKE

Kompozimi arkitektonik i banjave publike ka një karakter specifik në krahasim me ndërtimet e tjera sociale të kohës të mbuluara me kupolë, si xhamitë, tyrbet, depot, etj. Ndërsa në volumin e këtyre spikat vetëm një kupolë masive, në mbulesën e banjës shihen disa kupola. Këto kupola, që karakterizonen nga lartësi të vogla e bëjnë të larmishme siluetën horizontale arkitektonike të banjës dhe thyejnë monotoninë, që japin sipërfaqet e mbyllura masive të mureve. Hapje dritaresh në muret e banjave shihen vetëm tek ambientet e zhveshjes (Elbasan, Shkodër). Variacioni i disa lloj kupolave në harmoni njëra me tjetrën është tipike për banjën publike. Në disa banja (e Kalasë së Elbasanit, Shkodër) linja e sipërme horizontale e murit nënvizohet me kornizë dekorative prej tullash. Shumica e banjave tek ne nuk kanë lartësi të mëdha. Përjashtim bënin banjat publike të Tiranës, ku ambienti i zhveshjes ishte voluminoz dhe mbulesa e saj qe realizuar me dy kupola masive sferike. Banjat e këtij lloji janë më monumentale se të tjerat dhe, në këtë rast, ato spikasin mjaft në zgjidhjen urbanistike të qendrës së banuar.

Përsa i takon vlerave arkitektonike në interier, banjat janë të varfra. Tek-tuk vemë re elementë me vlerë dekorative. Përmendim këtu shatrivanin e banjës së Pazarit të Elbasanit i realizuar me estetikë, tavanin dhe kapitelet e kollonave, si dhe llozhën e kompozuar me finesë, gjithmonë në banjën e sipërpërmendur. Veç zgjidhjeve të drejta funksionale, vaskat përbëjnë elemente të përpunuar artistikisht me motive të ndryshme (Elbasan, Shkodër).

Edhe në aspektin tektonik, në interierin e banjave vemë re realizime interesante. Disa zgjidhje konstruktive në banjat e Elbasanit si trompat në mbështetjen e kupolave apo konsolet e mbështetjes së qemerave pasqyrë (banja e Kalasë), janë realizuar me forma stalaktitesh që e dekorojnë mjaft konstruksionin.

DO NOT COPY

Në përgjithësi mund të themi, se kompozimi arkitektonik i banjës publike është i tillë që e dallon atë menjëherë nga ndërtimet e tjera dhe kjo lidhet kryesisht me ekzistencën e kupolave të shumta mbi çati dhe me mungesën e dritareve në muret e saj. Veç këtyre, element tipik dallues është dhe konstruksioni «qemer – oxhak» i furrës, që spikat në fasadën e prapme.

KONKLUZIONE

Pamë se banjat publike të ruajtura tek ne arrinë gjithsejt 10. Evlia Çelebiu më 1672 përmend shumë banja të ndërtuara si në qytet, ashtu dhe në fshat, si dhe një numër të konsiderueshëm banjash private në banesat qytetare. Nga banjat e fshatit sot ruhet vetëm ajo e Sllatinjës (Skrapar). Megjithëse është objekt arkitektonik i ndërtuar gjatë periudhës turke dhe i njohur me terminologjinë arkitektonike të pushtuesit (hamam), rasti i banjës publike ndryshon në një tarë mase nga ndërtimet e tjera të kësaj periudhe, si pasojë e ndikimit të arkitekturës turke si objektet e kultit, xhami, tyrbe, teqe etj. Këtu nuk e kemi fjalën për banjat e vogla të lagjeve, që janë kudo të thjeshta e të njejta. Në banjat e mëdha turke takohen zgjidhje planimetrike të tilla, që nuk i gjejmë në banjat tona të mëdha. Në shumicën e tyre ambienti kryesor i djersitjes ka formën e një poligoni tetëkëndësh, nga brinjët e të cilit shkëputen qeli të veçanta me vaska. Në qendër të ambientit ndodhet një sofat i madh me po këtë planimetri. Këtë gjë e vemë re në shumë banja turke si në hamamet Jeni Kapliçia, Bit-Basar, Inxhille, etj. të Bursës, në hamamin Jeni-Xhuma; Ismid, etj.[8]). Veç kësaj zgjidhje funksionale shihet dhe varianti tjetër, i cili gjithashtu nuk haset tek ne, ku rreth ambientit kuadratik të djersitjes janë vendosur perimetralisht gjatë mureve një shumicë qelish (odash) të veçanta për banjë siç vemë re në Hamamin afër Ulu-Xhamisë në Bursë, në hamamin Jeshil-Bursa, në Girçik-Hamamin e Bursës[9]), etj. Një tipar tjetër që dallon banjat tona me turket është se tek këto të fundit ambienti i zhveshjes mbulohet me kupolë masive sferike, ndërsa në ambientet e tillë të banjave tona të mëdha, të ruajtura plotësisht, është përdorur mbulesë me konstruksion druri. Veç kësaj kupola masive mbulon dhe ambientin e djersitjes, gjë që tek ne nuk haset. Në përgjithësi banjat e qyteteve turke paraqesin ndërtime me luks dhe komoditet të madh në zgjidhjen funksionale dhe formulimin e interierit[10]). Kjo vihet re sidomos në ambientet e zhveshjes, ku ndodhen një numur nikesh të pasura me mindere, qilime, sofa, etj. Si influencë të arkitekturës turke në banjat tona publike shohim përdorimin e harkut të thyer, element konstruktiv i përdorur mjaft në ndërtimet e kësaj periudhe. Me kalimin e kohës ky element u përfshi në traditën popullore të ndërtimeve. Veç kësaj zgjidhje konstruktive në ndërtimet tona të periudhës turke u përdor dhe harku lundër dhe kjo influencë e arkitekturës turke[11]) e që e takojmë kryesisht tek niket e banjave dhe në dritaret e objekteve të kultit.

Banjat publike janë përdorur gjërësisht dhe në vende të tjera të Ballkanit si në Jugosllavi, Bullgari, e Greqi. Midis banjave të këtyre vëndeve dhe tonave ka si ngjasime ashtu dhe dallime. Si dhe banjat tona, ato kanë skema funksionale të thjeshta, ndërsa në ambientet e zhveshjes është përdorur si mbulesë kryesisht kupola masive, e këtu pikërisht qëndron dhe dallimi. Pak a shumë zgjidhje të njëjta funksionale me banjat tona, vemë re në Bash-Hamam (Tërnovo), dhe Berkovica[12]) të Bullgarisë, në hamamet e Karagjozbeut, Poçiteljit, Stokut dhe Gazi Husret Beut në Sarajevo të Jugosllavisë[13]), në hamamin e vjetër të Janinës[14]) etj. Në pamje të përgjithëshme banjat publike të ndërtuara në vendet e Ballkanit kanë skema funksionale pak a shumë të ngjashme midis tyre, më të thjeshta e më pak të komplikuara në krahasim me hamamet e mëdha të ndërtuara në Turqi.

U përpoqëm të japim një punim mbi banjat publike të mesjetës së vonë në Shqipëri, duke u bazuar në një numër të vogël objektesh të tilla të ruajtura, në krahasim me përhapjen e gjërë që ka pasur kjo gjini e ndërtimeve shoqërore në periudhën që studjojmë. Në këtë mënyrë në këtë studim përgjithësues, të bazuar në disa ekzemplarë ekzistues, nuk ka se si të mos kenë kaluar çështje pa u kapur ose në të kundërt mund të jenë shprehur konkluzione jo të plota. Këto realizime teknike me vlerë dëshmojnë për aftësinë e mjeshtrit popullor si dhe për zhvillimin e qytetit tonë mesjetar, ku banjat publike në unitet dhe me disa ndërtime të tjera përbënin bërthamën urbanistike të tij.

8) K. Klinghardt, **Turkische Bader,** Stuttgard, 1927, fig. 66, 69, 75 e 62.
9) K. Klinghardt, **Po aty,** fig. 53,5' e 18.
10) A. Sirkarov, **Banjiot epokata na turskoto vladiçestvo Burgaskija Kraj,** «Izvestija na narodnija Muzej, Burgas», 2, Nauka i Izkustvo; Sofija 1965, 128.
11) D. Çeliç – M. Mujezinoviç, **Stari mostovi u Bosni e Hercegovini,** Sarajevo, 1969, 32.
12) T. Zllatev, **Bllgarskata Nacionalna Arhitektura,** Knjiga 1, Bllgarskijat grad prez epohata na Vzrazhdaneto, Sofija, 1955, fig. 68, 67.
13) H. Kresevljakoviç **Banje u Bosni i Herzegovini,** Sarajevo, 1952, 9 fig 1 e 2, 12, 14,
14) **Ipirotika Hronika,** Etos Proton, 1926, fig. 30.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

1

Muzeu etnografik
Krujë



kati i II

3



4

Muzeu i Beratit



katii II

2

Banja private
KRUJE



Planimetria

5

Banja private
Berat



Planimetria

DO NOT COPY



1

4

Banja e Delvinës



Planimetria

0 1 2 3

2

Banja e kalasë
Elbasan



Planimetria

0 1 2 3

5

Banja e Lezhës



Planimetria

0 1 2 3

3



Prerje tërthore

0 1 2 3 4 5 M.



Banja e Çorovodës

0 1 2 3

6

Valter SHTYLLA

HAMMAMS DU BAS MOYEN AGE EN ALBANIE

RESUME

Cet article traite des établissements de bains (hammam) construits, pendant les XVe-XIXe siècles, en Albanie. Les hammams qui existent actuellement se trouvent dans les villes d'Elbasan, Durrës, Shkodër, Delvinë, Krujë, Gjirokastër, Çorovodë (Sllatinje), Lezhë et Tirana. L'homme d'étude turc Evliya Celebi, qui, en 1672, est venu chez nous, mentionne deux établissements de bains à Elbasan, qui existent encore, deux autres établissement à Berat, qui ont disparu depuis, le hammam du quartier Mecite à Gjirokastër ainsi que nombre d'autres bains privés à Berat, Kavaje et Elbasan.

DO NOT COPY

HAMMAMS PRIVES

Les bains privés constituaient des annexes dans les grandes maisons des villes albanaises. Dans la maison shkodrane, le hammam (hamamxhiku) est une annexe latérale ou postérieure de son contour planimétrique et constitue un volume à soi. Une solution semblable on la retrouve également dans la maison des Zekat à Gjirokastër. Ces bains comportent une seule pièce de petite dimension. Ils se caractérient par un fonctionnement primitif, étant donné qu'ils manquent du système d'installation d'eau chaude ou d'alimentation en eau.

Dans une habitation de Berat, il y a une salles de bains conservée en bon état et se rattachant à une variante plus évoluée; elle est comprise dans le contour planimétrique de l'habitation, située à son étage supérieur (Tab. VI,4). Le volume de cette salle comporte l'entrée 1, la pièce 2 où l'on se déshabille, la salle 3 proprement dite du bain, la pièce du feu 4 et le noeud sanitaire. L'eau, après avoir été réchauffée dans la pièce 4, arrive au robinet de la baignoire. Quant à la toiture de la salle des bains, elle repose sur des voûtes garnies d'ouvertures pour l'illumination du milieu.

Une autre salle de bains de type évolué est celle qui se trouve dans une maison de Kruja, dans le quartier Kala.

ETABLISSEMENTS DE BAINS PUBLICS

Les bains publics représentent d'importantes constructions à caractère social de la ville albanaise au bas moyen âge. Ils sont édifiés suivant les cas au centre de la ville ou dans ses quartiers.

En général les bains publics se situent à proximité des mosquées et s'harmonisent avec elles en un complexe architectonique. Le schéma base de leur composition planimetrique, que l'on rencontre plus souvent, se répète à de petites différences près dans tous les ouvrages de ce genre conservés encore dans nos villes. Ils sont formés par les pièces suivantes: 1 – la salle où les clients se déshabillent; 2 – une salle attenante à la première, d'un caractère intermédiaire et qui est isolée, de manière à maintenir une température intermédiaire. Cette dernière se rattache, du point de vue fonctionnel, à la salle du

DO NOT COPY

nettoyage vrai et propre et au noeud sanitaire; 3 – Puis viennent les «cabines» à haute température où les clients prennent leur bain. En général la pièce intermédiaire conduit directement au sudarium, dont la largeur est identique à celle de l'ouvrage lui-même et où ont lieu les opérations de massage et se trouve la baignoire. De front au sudarium sont aménagées deux ou trois cabines, chacune d'elles munies d'un ou de deux baignoires. 4. La dernière est la salle où se trouve le réservoir d'eau, dont la largeur est égale à celle de l'ouvrage lui-même. Dans plusieurs établissements ces salles sont disposées symétriquement l'une par rapport à l'autre suivant un axe longitudinal. Quant à leur fréquentation, les bains publics sont destinés exclusivement aux hommes ou aux femmes ou aux deux sexes à la fois. Les bains seulement pour hommes ou femmes, ainsi que les bains «mixtes», fonctionnaient selon un horaire diversifié: dans la matinée pour les hommes et dans l'après-midis pour les femmes.

Partant des pièces que comportent les bains publics, ces constructions de caractère social sont classifiées en deux groupes: 1 – Bains publics à schéma fonctionnel complet, comme le sont les deux établissements d'Elbasan, celui de Shkodër et peut-être même celui de Tirana; 2 – Bains publics à schéma fonctionnel incomplet, du fait qu'ils ne sont pas munis de la salle intermédiaire. Cette catégoire de bains comprend les établissements de Kruje, Gjirokastër, Durrës, Çorovode, Lezhe et Delvine.

Bains du marché à Elbasan. – Cet établissement situé en plein centre de la ville, à proximité de la mosquée Agaj, est encore conservé dans un bon état bien que Celebi le mentionne dès 1672. Il a fonctionné seulement pour les hommes, mais une fois par semaine, le jeudi, il était exclusivement fréquenté par les femmes. Il est formé par les pièces suivantes; 1) la salle où les clients se déshabillent; 2) la salle intermédiaire; 3) le noeud sanitaire; 4) la salle du nettoyage; 5) le sudarium; 6) et 7) deux salles particulières destinées aux bains; 8) la sallle du réservoir d'eau et du fourneau dans sa partie postérieure (Fig. 2). La salle servant de vestiaire, la plus large par rapport aux autres, a subi des modifications.

Bains publics de la forteresse d'Elbasan. – Cet établissement aussi est mentionné par Celebi. Il était destiné aux hommes et aux femmes à la fois et rentrait dans la catégoire des bains publics «mixtes». C'est le seul établissement de ce type conservé à ce jour chez nous. A l'état actuel il a subi de profondes modifications, qui ont changé sa composition planimétrique. Ces modifications se rattachent à trois diverses phases de construction (Tab. II, 5,7). De la première phase sont conservés le vestiaire 1, le sudarium 2, deux cabines à baignoire 2 et 4 et la salle 5 du réservoir d'esu.

Les petits bains de Shkodër. Cet établissement public, situé dans le quartier Parruce (fig. 4), a été mis en place en 1739. Il présente également un schéma fonctionnel complet. Sa composition planimétrique se fonde sur une disposition symétrique des diverses salles selon un axe longitudinal (Tab. II,4,6). La partie frontale de cet ouvrage est occuppée par un édifice à deux étages, qui a servi comme siège de l'administration des bains publics.

Le groupe des grands établissements comprend également les deux bains publics de Tirana, dont l'un actuellement en ruine et l'autre en partie conservée. Il s'agit précisément de l'ancien établissement situé derrière le siège du Comité Exécutif (Fig. 5), actuellement en partie conservées, et de l'établissement édifié en 161' (1607) à proximité du mousolée de Kapllan Pacha. L'entrée (le vestiaire) de cette dernière, selon une ancienne photographie, présente un aspect et était couverte par deux coupoles, mais nous ne disposons pas de données quant aux autres salles.

Le deuxième groupe comprend des établissements plus petits à schéma fonctionnel incomplet.

Bains publics de la Forteresse de Kruje. (Fig. 6) Elle comprend un vestiaire, un sudarium, deux salles destinées aux bains ainsi qu'une salle pour le réservoir d'eau et le chaudron placé en son milieu.

Bains publics du quartier Mecite (Gjirokastër). (Tab. III, 3). La partie la plus ancienne de cet établissement comporte trois salles presque analogues. Les deux salles de bains

DO NOT COPY

(3 et 4) sont précédées par une troisième salle (3), qui a du remplir les fonctions de sudarium, ou de salle intermédiaire ou encore de vestiaire, alors que celui-ci n'avait pas encore été mis en place.

Les anciens bains publics de Durrës. – *Il comprend quatre salles (Tab. III, 5). Au milieu de la composition planimétrique figure le vestiaire, qui est aussi la salle la plus grande; il est surmonté d'une coupole massive, sur le sommet, de laquelle repose concentriquement une autre coupole plus petite. A droite viennent de suite deux salles pour les bains, dont celle postérieure communique à travers une fenêtre avec le réservoir d'eau. Dans une deuxième phase de construction, avant l'ancienne entrée on a édifié une maison à deux étages qui a du servir de vestiaire.*

Bains publics de Sllatinje. – *Cet établissement se touve en plein centre du village de même nom, à proximité de la mosquée. Il comprend quatre salles qui constituent une composition planimétrique symétrique suivant l'axe longitudinal (Tab. IV, 2). Le vestiaire 1 est surmonté par un cintre cylindrique.*

Bains publics de Lezhe *(Fig. 7). Il s'agit du plus petit établissement de ce genre conservé chez nous. Situé à proximité de la forteresse, il comprend trois salles disposées successivement (le vestiaire, la salle des bains et celle du réservoir d'eau).*

Bains publics de Delvine *(Fig. 8). Situé, hors du périmètre de la ville de Delvine, cet établissement se dresse tout près de l'ancienne forteresse moyenâgeuse. Il fait part d'un intéressant complexe architectonique comprenant la mosquée, le minaret, des fontaines et les bains publics eux-mêmes.*

En ce qui concerne l'aspect architectonique des bains publics de chez nous, il est difficile d'exprimer un avis définitif à leur égard en raison du nombre restreint d'établissements de ce genre dont nous disposons actuellement. Leur composition architectonique est spécifique par rapport aux autres constructions de caractère social de l'époque, du fait qu'ils sont surmontés par des coupoles semblables à celles des mosquées, des mausolées, des réservoirs d'eau, etc. Dans le volume de ceux-ci fait saillie une seule coupole, tandis que la couverture des bains publics comprend plusieurs coupoles, qui, bien que pas très hautes, confèrent à leur silhouette architectonique horizontale plus de variété et rompent l'uniformité créée par les murs massifs.

Quoique ces bains publics aient été construits pendant l'occupation turque et leur nomination relève de la terminologie architectonique de l'occupant (hammam), *ce genre d'établissements diffère des autres constructions mises en place pendant la même période, et qui sont un produit de l'architecture turque, à savoir des monuments de culte comme mosquées, mausolées, teqe, etc. Ici il n'est pas évidemment question des petits bains publics de quartier, qui, partout, se caractérisent par une composition simple et analogue. Les grands établissements de bains turcs, en revanche, comportent des solutions planimétriques que l'on ne rencontre pas chez nous.*

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI Emin RIZA

NDËRTIMET NË FSHATIN- RRËNOJË TË KAMENICËS*)

DO NOT COPY

Rrënojat e Kamenicës gjënden në rrethin e Sarandës, rrëzë shpatit jugperëndimor të Malit të Gjerë. Ato shtrihen mbi dy kodra të ulta, me pjerrësi të butë të bashkuara me një qafë të ulët prej lindjes në drejtim të perëndimit (fig. 1). Fshati, në të kaluarën zinte dy lartësitë e kodrave, qafën që i bashkon ato, si dhe shpatin e tyre jugor. Terreni rreth tyre paraqitet mjaft i favorshëm për zhvillimin ekonomik: poshtë, nga jugperëndimi shtrihet një fushë e gjërë me toka pjellore, në veri gjënden kullota të mira për bagëti, ndërsa klima e butë favorizon rritjen e ullirit. Nga ana tjetër para Kamenicës kalonte rruga që ndërlidhte Finiqin dhe Delvinën me luginën e Kardhiqit dhe me tej me atë të Drinos.

Rruga që të çonte në fshat kalonte duke ndjekur qafën ndërmjet dy kodrave, në jug të tij. Ajo përfundon në qendër të fshatit, i cili është sheshi më i gjerë, në masën e dëndur të ndërtimeve. Kësaj qendre i përket dhe toponimi: «qafa e Pazarit». Ndërtimet rrethojnë qafën e pazarit, duke u shtrirë kryesisht nga kodra e madhe në perëndim të saj, dhe më pak në kodrën e vogël në lindje. Kodra e madhe ka një rënje më të butë në drejtim jugor, kështu që ndërtimet shtrihen më poshtë se ato të kodrës tjetër. Zona veriperëndimore dhe ajo veriore e të dy lartësive bie thikë. Ndërtimet kanë një dëndësi të madhe, por kjo është veçanërisht e theksuar në zonën rreth qendrës së fshatit. Ato janë të orientuara, përgjithësisht nga jugu dhe më pak nga juglindja e jugperëndimi, duke ndjekur pjerrësinë e terrenit. Nga sa mund të shihet sot, rrugët fillonin nga qendra e fshatit duke u shpërndarë drejt dy grupimeve kryesorë të ndërtimeve. Ato kanë qenë të ngushta dhe gjarpëruese, herë duke ndjekur konturet horizontale të terrenit, herë duke përshkuar atë normal vijave rrushkulluese. Ndërtimet janë vendosur buzë rrugëve, ose në mjaft raste ato rrethohen më mure që krijojnë oborre të vegjël.

Në gjëndjen e sotme, fshati i rrënuar i Kamenicës, ruan deri diku mirë një numër të madh ndërtimesh, ku pjesën dërmuese e zenë banesat, krahas tyre ruhen dhe disa kisha. Numuri më i madh i tyre ndodhet në pjesën jugperëndimore të kodrës së madhe. Muratura e ndërtimeve për shkak të punimit të mirë dhe lidhësit të fortë, ruhet shpesh, thuajse deri në lartësinë origjinale, ndërsa nga elementet e drurit kanë mbetur vetëm gjurmë.

Burimet historike që përmëndin fshatin e Kamenicës janë relativisht të pakta. Në regjistrin e vitit 1431-32[1]), fshati i Kamenicës i përfshirë në vilajetin e Vajonetes, kishte gjithsejt 267 banesa, duke pasur si pronë të fshatit 400 rrënjë ullinj. Të ardhurat nga ky fshat ishin 19.740 akçe. Këto të dhëna e bëjnë Kamenicën, në atë kohë, një nga qendrat e banuara më të mëdha të kësaj zone. Mjafton, të përmendim se Gjirokastra, kryeqendra e sanxhakut të Shqipërisë, në këtë kohë kishte 163 banesa dhe të ardhurat pa taksat e vijaletit dhe tregut ishin 16.938 akçe. Në regjistrin e vitit 1583[2]), fshati kishte rreth 200 banesa. Këto janë dy të dhënat më të sakta që disponojmë deri më sot për Kamenicën.

---

*) Rilevimet janë të autorëve, F. Zarshatit, S. Dashit, E. Harxhit dhe E. Soppit. Vizatimet janë të F. Zarshatit, fotot të autorëve.

1) **Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë,** II, Tiranë 1962, 241.

2) **Arkivi i drejtorisë së tapive dhe kadastrës në Ankara, defter Nr. 91.** Përmëndet Kamenica në defterin e regjistrit të vitit 1583, afërsisht me 200 banesa.



Fig. 1

Çelebiu i cili kaloi në mesin e shekullit XVII, nga Delvina në Kalasë, përbri Kamenicës nuk e përmënd këtë të fundit[3]). Aravantinoi[4]) në listën e hollësishme të fshatrave të Epirit, që i përket gjëndjes së fillimit të shek. XIX nuk e përmënd Kamenicën si fshat por në një pasazh ai flet për vendin e quajtur Kamenicë. Pukëvili[5] përshkruan rrënojat e Palavlisë për të cilat shpreh mendimin se duhen identifikuar me Eleontën e Ptolemeut. Nga përshkrimi i tij mund të mendohet se Pukëvili për mbeturinat «antike» të Palavlisë, të këtë pasur parasysh pikërisht rrënojat e Kamenicës. Ugolini[6] dhe Hamondi[7]) gjithashtu e përmëndin Kamenicën pa prurë ndonjë të re. Së fundi Dh. Budina[8]) mendon se ndoshta rrënojat e Kamenicës duhen identifikuar me ato të qytetit të vjetër Baiake, të përmëndura nga Stefan Bizantini. Duke gjykuar nga gjendja dhe karakteri i ndërtimeve që trashëgojmë në Kamenicë, përjashtohet mundësia e identifikimit të tyre me qendrat e përmëndura nga Pukëvili dhe Budina, sidoqoftë fjalën e saktë do ta japin gërmimet arkeologjike.

Ky artikull i shkurtër, ka si qëllim të bëjë një parashtrim të arkitekturës së ndërtimeve të fshatit-rrënojë të Kamenicës, për aq sa e lejon gjendja e sotme e tij. Pra, ky mund të quhet një botim paraprak. Punimet e pastrimit, dhe gërmimet që do të ndërmerren në të ardhmen do të bëjnë të mundur të sqarohen dhe thellohen shumë çështje në lidhje me karakteristikat e këtyre ndërtimeve, sidomos në planin urbanistik. Kështu do të krijohen kushtet për një botim të plotë, që të pasqyroi në mënyrë të gjërë e sistematike këtë qendër banimi, dikur të lulëzuar, e cila padyshim zë një vënd me rëndësi të posaçme në trashëgiminë arkitektonike të së kaluarës. Nga sa kemi vrojtuar, ndërtimet e Kamenicës mund të përfshihen në grupet e mëposhtëme: banesa me kullë, kulla, banesa dhe kisha.

BANESAT ME KULLA DHE KULLAT

Në rrënojat e Kamenicës ruhen në gjëndje relativisht të mirë dy ndërtime interesante: një banesë me kullë, e cila ngrihet në tre kate, duke qënë një kat më e lartë se banesa së cilës i shërben, dhe një kullë në kuptimin klasik të fjalës. Banesa me kullë për nga kompozimi përbën dëshminë më të vjetër, deri më sot, në vendin tonë. Këto ndërtime dalloj-

3) E. Çelebi, **Shqipnia para dy shekujsh,** Tiranë 1930. Autori V. Baras në librin «To Delvino» Athinai 1966, 192. jep një të dhënë, sipas së cilës le të kuptohet se fshati ekzistonte më 1690, por pa u referuar mbi burimin.
4) Aravantinos, **Hronografia tis Ipiru,** 1856, 119.
5) F.C.H.L. Pouqueville, **Voyage dans la Grece,** Paris 1820, I, 69 358, 359.
6) L.M. Ugolini, **Albania Antica,** V. I. Rome-Milano, 1927, 141.
7) N.G.L. Hammond, **Epirus,** Oxford, 1967. Hamondi mohon me të drejtë të këtë ndërtime antike në Kamenicë, gjë që e bën me të besueshme mendimin se Pukevili me Palavlinë ka parasysh Kamenicën.
8) Dh.Budina, **Disa rezultate të gjurmimeve në vendbanimet e lashta ilire të Kaonisë,** «Konferenca e dytë e Studimeve albanologjike» II, 1969, 327.

DO NOT COPY

në nga banesat jo vetëm për karakterin e tyre, por edhe nga elementë të ndryshëm arkitektonikë e konstruktivë të cilët i gjejmë vetëm në to.

BANESA ME KULLË Nr. 1.

Është një nga ndërtimet më interesante dhe komplekse, që ruhet deri diku në gjëndje të mirë në rrënojat e Kamenicës. Barinjt e kësaj zone e emërtojnë «Kulla e Krahës». Ajo zë pikën më të lartë të kodrës, në perëndim të qafës së Pazarit (fig. 2), duke pasur kështu një pozicion sundues mbi krejt fshatin. Volumi masiv prizmatik i kullës lartësohet deri 6,70 m. nga pika më e ulët e terrenit. Ky ndërtim nuk qëndron më vete, por është pjesa më e rëndësishme e një kompleksi banimi (tab. I-II). Kulla në pjesën veriore zgjerohet në plan, duke përfshirë dhe një ndërtim tjetër, i cili duket qartë se është i njëkohshëm me kullën dhe ka qenë lidhur funksionalisht me të. Për shkak të rrënimeve, është vështirë të përcaktohet në se kjo pjesë e kompleksit ka qenë një apo dykatëshe. Përbri faqes lindore të kullës dhe ambientit mbas tij, përgjatë gjithë gjatësisë së tyre, gjejmë të rrethuar me mure një oborr të vogël. Muri në pikën më të lartë të ruajtur arrin lartësinë 4.4 m. Hyrja nga rruga bëhet nëpërmjet një dere në murin jugor (fig. 3). Simbas shënjave, hapësira e derës mbulohej me arkitra, siç duket prej druri. Duken gjithashtu dhe gjurmët e kanalit të katarahut, që siguronte derën. Në fundin e oborrit, përballë hyrjes, gjëndet një rrafsh, tashti i mbushur me rrënoja, i krijuar prej një muri tarracimi, në të cilin gjenden dy kamare të thella, me të njejtën lartësi të mbuluara me qemer gjysëm cilindrik. Funksioni i këtyre kamareve është i pa qartë. Gjithashtu gjurmët e pakta nuk na lejojnë të shprehemi me siguri nëse rrafshi i përmëndur ishte dyshemeja e ndonjë ambienti, siç praktikohet zakonisht kjo zgjidhje në banesat e kësaj qendre. Të tërheq vëmëndjen një trakt muri, që në plan ka formë këndore, duke e pasur njërin krah të mbështetur në muraturën e ambientit, përngjitur kullës. Qenja e një fragmenti pature të hyrjes për në ambientin mbas kullës, e cila bie diku mbi këtë trakt muri, na shtyn të mendojmë se ndoshta këtu duhen kërkuar shkallët. Nuk përjashtohet mundësia që ky mur të mbronte vendin e marrjes nga jasht të ujit nga stera, ndërtuar në katin përdhes të kullës.

Pra, kulla shtrihet horizontalisht në pjesën veriore me një ndërtim, një apo dykatësh, i cili është i njëkohshëm me vetë kullën. Kulla ka tre kate. Në plan ajo i afrohet katrorit, duke pasur dy brinjë të barabarta, ndërsa dy të tejrat të ndryshme. Kështu, brenda për brenda, brinjët e barabarta janë prej 3,3 m.



Fig. 2



Fig. 3

ndërsa dy të tjerat 3.80 m. dhe 4.10 m. Kati i saj përdhes është i pa ndriçuar. Në lartësi të ndryshme në muraturë gjejmë disa vrima me diametër rreth 7 cm; të cilat siç duket shërbenin për një ajrim minimal të këtij ambienti apo ishin vrima skelash. Lartësia e katit nuk mund të përcaktohet, për shkak të mbushjes së truallit me gurë të rrëzuar nga muratura. Mbështetur në faqet lindore dhe atë veriore, gjendet një sterë e vogël që në plan ka formën drejt këndore. Fundi i mbulesës së saj vjen në një nivel me dyshemenë e katit të parë. Pjesa përbri faqes

DO NOT COPY

lindore mbulohet me qemer çerekrrethor, ndërsa pjesa tjetër me qemer cilindrik. Stera është e suvatuar nga brenda me llaç të papërshkueshëm nga uji. Shembja e një pjese të mbulesës, me seksion çerekrrethor, na shtyn të mendojmë se këtu mund të ketë qënë vendi i marrjes së ujit. Përveç kësaj nuk përjashtohet marrja e ujit me rrjedhje si nga brenda, ashtu dhe nga jashtë. Stera komunikon me ambientin e jashtëm me një vrimë në murin jugor, e cila duke qenë e lartë, mund të ketë kryer dhe funksionin e shkarkimit të ujrave të tepërta. Ambienti i katit të parë, me lartësi rreth 2.0 m., gjithashtu është i pa ndriçuar, lidhja me ambientin e jashtëm bëhet vetëm me anë të vrimave të ajrimit, të cilat janë më të shumta se në katin përdhes. Lartësia, në gjëndjen e sotme, prej 1.30 e murit verior e përjashton mundësinë e komunikimit të këtij ambienti me pjesën tjetër të ndërtimit.

Kati i dytë është me lartësi më të madhe se ajo e katit të parë, ai arrin sot në pikën më të lartë rreth 3.30 m. Muratura e faqes veriore është pothuaj krejt e rrënuar (fig. 4), me përashtim të dy pjesëve të vogla në të dy qoshet e muraturës. Këta fragmente tregojnë qartë se kati i dytë i kullës ngrihej shkëputurazi nga pjesa tjetër, e cila ishte lidhur me kullën deri në mbarimin e katit të parë të saj. Më anë tjetër, shëmbja e plotë e muraturës që përmëndëm të shtyn të mendosh se, pikërisht në këtë kat dhe në këtë faqe muri duhet kërkuar ndërlidhja e kullës me ndërtimin përngjitur saj. Kati i dytë, është i vetmi që ndriçohet nga dy dritare shumë të vogla në formë frengjije (fig. 5). Dritarja në faqen lindore ruhet deri diku e plotë, ndërsa qënjen e një të tille dhe në faqen jugore t'a sugjeron shembja e muraturës. Në faqen perëndimore gjejmë, duke filluar nga e djathta (e majta e vrojtuesit) një kamare të vogël, pranë saj një më të madhe (fig. 6), ndërsa më tej gjejmë një vrimë për shkarkim ujrash, njëlloj sqolli, bazën e të cilit e formojnë dy tjegulla. Ky kat siç tregojnë gjurmët e vrimave ku mbështeteshin trarët duhet të ketë pasur pjesërisht në lartësi 1.20 m. nga dyshemeja, një dysheme të dytë me gjerësi rreth 1,10 m. Ky podium të kujton mafilin. Prej këndej bëhej i mundur vrojtimi përreth kullës nëpërmjet dy dritareve, por ai mund të ketë shërbyer dhe si vendfjetje.



Fig. 4

Ambienti përngjitur kullës shtrihet në drejtim verior, duke u lartësuar deri në mbarim të katit të parë të kullës. Në faqen përballë kullës, gjejmë të ndërtuara dy kamare të vendosura njera mbi tjetrën e të ndara nëpërmjet tyre me një pllakë guri. Ky detal unik, me sa kemi parë në Kamenicë, na kujton vendin e zjarrit në kullat e Goranxisë[9]). Aty, pranë vatrës, ndërtohen dy kamare si këto që përshkruam. Në faqen lindore duken qartë gjurmët e njerës paturë të derës së vetme, që lidhte këtë ambient dhe, nëpërmjet tij dhe kullën me oborrin. Në paturë duken gjurmët e kanalit të katarahut. Siç përmëndëm, gjurmët tregojnë se e vetmja mundësi për të komunikuar me kullën është që hyrja për në të, të ketë qenë në katin e dytë, prandaj i bije që lartësia e saj të përfshihej brenda hapësirës së çatisë, plotësishi apo pjesërisht, ndërsa ndërlidhja ndërmjet kateve të kullës ka qenë bërë, sigurisht, me shkallë të brendshme prej druri.

Kulla është ndërtuar me muraturë prej guri, lidhur me llaç gëlqereje. Veçanti konstruktive në dallim nga ndërtimet e tjera është përdorimi i dy konture ve me breza druri në nivelet e dyshemeve të katit të parë dhe atij të dytë (fig. 3). Brezi formohet nga dy binarë me përmasa rreth 10 x 10 cm, që vendosen rrafsh me të dy faqet e muraturës, të cilët lidhen rreth çdo 60 cm. me binarë tërthorë me përmasa rreth 3 x 8 cm. Në nivelin e dyshemesë së katit të dytë, në mesin e murit jugperëndimor duket qartë vrima ku mbështetej një tra, i cili shkurtonte hapësirën e dritës, për trarët e tjerë, tërthor tij, mbi të cilët shtrohej dyshemeja prej dërrase. Të tre ambientet e kullës kanë gjurmë të qarta që tregojnë se ata kanë qenë të suvatuar. Suvatimi formohej nga dy shtresa: shtresa e parë prej llaç gëlqereje, ndërsa ajo e dyta, shumë

9) E. Riza – Th. Kamberi, **Kullat e Goranxisë**, «Monumentet» 3, 1972.

DOKTORI



Fig. 5



Fig. 6

e hollë, me patinaturë gëlqereje. Dhe në ambientin përngjitur kullës, gjejmë gjurmë suvaje në faqet e brendshme të muraturës. Mbulesa e kullës duhet të ketë qenë me çati katërujshe, mbasi nuk ruhet asnjë gjurmë kallkani në dallim nga pjesa tjetër e ndërtimit, e cila ka qenë mbuluar me çati dyujshe.

Kulla Nr. 1. Kjo kullë ndodhet në jugperëndim të banesës me kullë Nr. 1, në pjesën më periferike të fshatit. Ajo është një kullë klasike e vetmuar, e pa lidhur me asnjë ndërtim tjetër bashkëngjitur. Në plan ajo ka formë katërkëndësh këndrejt (tab. II), dhe është trekatëshe: kati përdhes dhe kati i parë kanë afërsisht lartësi të barabartë rreth 2.0 m. ndërsa kati i dytë është më i lartë rreth 1 m., ashtu si kulla e Rrahës. Hyrja e vetme për në kullë ka qenë në katin përdhes nga balli verior, siç tregon një fragment i njerës paturë, në të cilën gjëndet kanali i katarahut. Në katin përdhes në gjëndjen e sotme nuk dallohen gjurmë dritaresh në formë frengjije. Kati i parë, le të dyshosh se mund të ketë pasur dritare në faqen jugore dhe ndoshta edhe në atë perëndimore. Kati i dytë ruan mirë muraturën në gjysmën lindore, ndërsa pjesa tjetër është e dëmtuar. Faqja lindore ruan shumë mirë disa elementë, deri tashti unikalë në arkitekturën e banesës dhe kullave të Kamenicës. Është fjala për një oxhak (fig. 7). të ndërtuar, afërsisht në mesin e kësaj faqeje. Kanali i tymit të tij fillon me një thellim në muraturë dhe në lartësi mbyllet në formë harku, duke lënë të vazhdojë në masën e muraturës një kanal të ngushtë me seksion rrethor. Nuk ka ndonjë shenjë që të tregojë për ekzistencën e tamburit. Anash oxhakut ndodhen dy kamare dhe, pranë kamares së djathtë, një sqoll. Dëmtimi i madh i qoshes veriperëndimore dhe sidomos asaj jugperëndimore (fig. 8) të le të dyshosh se në këto pjesë mund të kenë qenë ndërtuar dritare dhe, me shumë gjasë, dhe ndonjë qoshk jashtë konturit të muraturës, siç e gjejmë në kullat e Goranxisë[10]). Muratura e gurit është e lidhur me llaç gëlqereje. Në dallim nga të gjitha ndërtimet e tjera të Kamenicës, brezat e drurit që lidhin muraturën e kullës janë të futur brenda trashësisë së saj, ato kanë seksion 12 x 13 m dhe lidhen me binarë tërthorë. Përveç këtyre brezave përforcues të muraturës, mbi nivelin e kamareve anash oxhakut, kanë qenë vendosur dy apo më shumë binarë, që shërbenin si arkitra për kamaret. Për të lidhur më mirë këtë në faqen e jashtme të muraturës është vendosur një binar tjetër. Binari i faqes së jashtme lidhet me të brendshmit me binarë tërthorë. Dyshemetë prej druri, siç tregojnë gjurmët, i kishin të vendosur trarët në drejtim të hapësirës më të shkurtër, mbi brezat e drurit. Në ballin e oxhakut, në katin e dytë, duken qartë gjurmë suvatimi, ndërsa në të dy katet e tjerë nuk dallojmë gjurmë të tilla.

Në se krahasojmë kullën e Rrahut me kullën që përshkruajmë do të konstatojmë ndërmjet tyre një sërë ndryshimesh jo vetëm në kompozimin e tyre, por edhe në elemente të veçantë. Kështu kulla e Rrahut është pjesë e një ndërtimi më të madh, i cili përfshin dhe një apo dy ambiente, një kat më të ulët se vetë kulla. Ajo, pra, është pjesë e një banese, siç

10) E.Riza – Th.Kamberi, **Vep. cit.**

DO NOT COPY

tregon dhe qënja e oborrit dhe e murit të avllisë. Kompozimi i saj është i njëjtë me banesat e zhvilluara të fshatit. Kurse kulla Nr. 1 është e veçuar, ajo qëndron si njësi më vehte e palidhur me ndonjë pjesë tjetër. Ajo është ndërtuar në një zonë periferike, disi e veçuar nga fshati. Oxhaku dhe kamaret, anash tij, janë vendosur dhe realizuar me të njëjtën mënyrë si në shumë banesa të shek. XVIII dhe fillimit të shek. XIX. në qytetet tona, duke qenë elemente unikale në fshatin e Kamenicës. Këto dallime, që në disa drejtime janë mjaft të rëndësishme, lejojnë që kulla Nr. 1 të vendoset kronologjikisht mjaft mbas asaj të Rrahut. Gjendja e saj më e rrënuar, në krahasim me kullën e përmëndur më të vjetër, duhet shpjeguar me një punim më të dobët të muraturës.

Qënja e këtyre kullave në fshatin e Kamenicës dhe, sidomos e kullës së Rrahut më e vjetra e këtij lloji dhe më e lidhura me traditën arkitektonike të fshatit, si dhe e disa banesave më të zhvilluara si ajo Nr. 1, tregojnë për diferencimin klasor të banorëve të fshatit. Volumi i madh i kompleksit që përfshin banesën me kullë Nr. 1 pozita sunduese e saj në lidhje me fshatin, qenja e elementëve të tillë unikalë, si stera e ujit dhe përdorimi gjithashtu unikal (me përjashtim të kishave) i qemereve cilindrike, tregojnë qartë se ky ndërtim, ashtu si dhe kulla Nr. 1 apo ndonjë banesë tjetër, i përkasin të pasurve të fshatit.



Fig. 7

BANESAT

Në fshatin e rrënuar të Kamenicës, ruhen një numër shumë i madh banesash, disa prej të cilave në gjëndje relativisht të mirë. Natyrisht në gjëndjen e sotme nuk ka mbetur asnjë gjurmë e mbulesave dhe e konstruksioneve prej druri. Kompozimi, elementet e veçantë arkitektonikë-konstruktivë, si dhe teknika e ndërtimit, tregojnë qartë se banesat janë të ndërtuara në një periudhë relativisht të afërt me njera -tjetrën. Vetëm një grup banesash të ndërtuara në jugperëndim të «qafës së Pazarit», duket se i përkasin një kohe më të vonë, pasi janë të ndërtuara në një zonë periferike të fshatit dhe, në to, gjejmë të ndërtuara në katin e parë dritare në dallim nga banesat e tjera, që ndriçohen nga të çara në formë frengjije. Më anë tjetër në këto banesa e ndeshim rrallë praktikën e shtesave të mëvonshme. Banesat ndjekin drejtimin e terrenit, duke pasur kështu orientime të ndryshme nga juglindja, jugperëndimi dhe jugu. Ato janë gjithmonë të vendosura me ballin e ngushtë në drejtim të vijave rrushkulluese, duke qënë kështu volumi i tyre normal me to. Kjo vendosje është më racionale në terrenet jo shumë të pjerrët shkëmborë, mbasi nuk e bën të nevojshëm gërmimin për të bërë të përdorshëm katin përdhes me anë tjetër largohet më shumë kontakti eventual me ujrat e reshjeve dhe, së fundi, rritet në mënyrë të ndjeshme aftësia mbrojtëse e banesës. Shumica dërmuese e banesave janë dykatëshe, ndërsa banesat përdhese janë shumë të pakta. Për shkak të pjerrësisë së terrenit, në shumicën e rasteve banesat kompozohen me gjysmëkat, dmth. sipërfaqja e katit të parë shtrihet përtej asaj të katit përdhes. Konfiguracioni i tyre në plan është gjithmonë katërkëndësh këndrejtë, në shumë raste me brinjë jo të barabartë dhe, disa herë, edhe me ndonjë qoshe të harkuar (tab. VI, banesa Nr. 9) apo të thyer për të mos ngushtuar rrugën apo për të bërë më të lehtë kalimin në kthesa. Në përgjithësi banesat kanë nga një ambient në secilin kat. Sipërfaqja, disa herë mjaft e madhe e katit nuk e përjashton mundësinë e ndonjë ndarje të lehtë prej druri tërthor saj. Mjaft të rralla janë banesat me dy ambiente, në katin përdhes dhe po aq në katin e parë. Ngushtësia e truallit, dhe natyra shumë e ashpër shkëmbore e tij ka bërë që edhe në ato raste kur banesa kishte një oborr të rrethuar me mure guri, përbri faqes ku ishin hyrjet, ai ishte shumë i vogël. Por ka dhe shumë raste kur hyrja për në banesa bëhet drejtpërdrejt nga rruga. Për tu vërejtur është dhe një praktikë e përhapur gjërësisht në ndërtimin e banesave, ajo e ndërtimit të një banese të dytë, ngjitur me të parën dhe, disa herë edhe e një banese të tretë. Në shumicën e rasteve shtesa e re përbën një banesë

DOKTORY

më vehte, që për nga kompozimi është e njëjtë me banesën së cilës i përngjitet. Më të rrallë janë rastet kur banesës i shtohen një apo dy ambiente. Kjo dukuri shpjegohet me rritjen e numrit të pjesëtarëve të familjeve, mbasi gjurmët e komunikimit të brendshëm, ndërmjet tyre, tregojnë se ato i shërbenin një familjeje të vetme.

Për të dhënë një vështrim mbi tiparet dalluese kompozicionale dhe të mënyrës së ndërtimit të këtyre banesave, po fillojmë së pari me përshkrimin deri diku të hollësishëm të nji banese të zhvilluar, e cila ruhet në gjëndje relativisht të mirë. Mbas kësaj do të përshkruajmë dhe analizojmë një numër banesash të tjera me interes, në aspektin kompozicional dhe atë teknik.

Banesa Nr. 1, një nga më të zhvilluarat dhe më të ruajturat, është e vendosur në qendër të fshatit (fig. 9), në një rrafsh me pjerrësi të vogël e orientuar afërsisht në drejtim veri-jug. Banesa (tab. III) ka në plan formën e katërkëndëshit këndrejtë të vendosur me brinjët e gjata normal me rënjen e terrenit. Disa trakte muresh, në të majtë të saj, të bëjnë të mendosh se ajo ka pasur një oborr të vogël.

Banesa është dykatëshe dhe përbëhet nga katër ambiente, dy në çdo kat. Dy ambientet e ballit kanë sipërfaqe të barabartë në të dy katet, ndërsa ata të mbrapmit ndryshojnë. Ambienti i mbrapëm përdhes, është me sipërfaqe më të vogël se i sipërmi, i cili zgjerohet mbrapa. Banesës i është bashkëngjitur më vonë një ambient i vogël, përbri faqes veriore, me konfiguracion të çrregullt dhe me hyrjet nga perëndimi. Banesa ka pasur dy hyrje të veçantë, njerën në katin përdhe, siç dëshmon një fragment i paturës, dhe tjetrën në katin e parë, nga e cila nuk ruhen shenja, por qënja e saj vërtetohet nga një trakt murature përngjitur murit perëndimor, mbi të cilin kanë qenë ndërtuar shkallët. Ky mur përfundon pikërisht atje ku fillon hapësira e derës për në ambientin e mbrapëm të katit përdhes.

Siç përmëndëm, kati përdhes përbëhet nga dy ambiente. Ambienti i parë ku të çon hyrja e vetme e këtij kati, kufizohet në drejtim verior nga një mur mbajtës, i cili ngrihet deri në nivelin e dyshemesë së katit të parë. Ky ambient nuk ka asnjë hapësirë ndriçimi. Në komunikim me të, siç tregojnë shenjat e hapësirës së derës, ndodhet ambienti tjetër. Muri që ndan këta dy ambiente, i cili është me të njëjtën trashësi, me muret e tjerë, vazhdon i tillë deri në mbarim të katit të parë. Mungesa e gjurmëve nuk lejon të përcaktohet nëse ai ngrihej në formë kallkani apo përfundonte horizontalisht. Gjithashtu dhe në këtë ambient nuk gjejmë asnjë hapësirë driçimi. I vetmi komunikim me ambientin e jashtëm sigurohet, nëpërmjet disa vrimave me diametër 5-7 cm. si në Kullën e Rrahut të vendosura pa ndonjë kriter të caktuar, sidomos në faqen ballore. Ato sajohen duke futur në muraturë, gjatë ndërtimit të saj copa shkopijsh,



Fig. 8



Fig. 9

FOTO COPY



Fig. 10

të cilët me sa duket pastaj hiqeshin. Në këtë ambient gjejmë të ndërtuara dy kamare të mbuluara me pllaka guri (fig. 10). Kati i parë përbëhet gjithashtu nga dy ambiente. Ambienti i prapëm, në lidhje me hyrje të drejtpërdrejtë me ambientin e jashtëm është me përmasa të mëdha, duke qënë kështu ambienti kryesor i banesës. Ai është pjesërisht përdhes, dhe pjesërisht me dysheme druri. Pjesa përdhese është ajo prej murit mbajtës tërthor të katit përdhes, deri në murin fundor të banesës. Në këtë të fundit, në të djathtë të tij, ruhet një kamare e njëllojtë me ato të përmëndura më sipër. Muri fundor i banesës përfundon në formë kallkani. Nuk ka asnjë shenjë që të tregojë për qënjen e ndonjë hapësire ndriçimi në të dy muret perimetralë, që ruhen në gjëndje të mirë, ndërsa për murin lindor nuk mund të gjykohet, mbasi ai është i rrënuar thuajse deri në nivelin e dyshemesë. Rrënimi i madh, rreth mesit të tij, i murit që e ndan këtë ambient nga ai i ballit, të sugjeron qënjen në këtë pjesë të derës që lidhte të dy ambientet. Ambienti ballor i katit të parë nuk ka asnjë kamare. Rrënimi i një pjese të muraturës jugore, të shtyn të mendosh se aty duhet të ketë qënë dritarja e vetme e këtij ambienti. Përmasat relativisht të vogla të rrënimit, na shtyjnë të mendojmë se dritarja duhet të ketë qënë në formë frengjije, ashtu siç e takojmë dhe në banesa të tjera (fig. 11). Në gjëndjen e sotme nuk ka mbetur asnjë gjurmë që të tregojë në se, ekzistonte komunikimi i brendshëm ndërmjet të dy kateve. Për mendimin tonë kati përdhes ka qenë i pabanuar, ndërsa kati i parë i banuar. Mungesa e ambienteve ndihmës të domosdoshëm për një banesë fshati, që patjetër kishte bagëti dhe kafshë ngarkese, hyrja e veçantë për në katin përdhes, mungesa e plotë e ndriçimit dhe konditat jo të përshtatëshme për jetesë të ambienteve të këtij kati, janë arsyet që na çojnë në mendimin e mësipërm. Përpos kësaj, një ndarje e tillë funksionale, ndërmjet kateve, është e njohur gjerësisht në banesat në të kaluarën. Ambienti i prapëm i katit të parë për vetë përmasat e tij dhe vendin në volumin e banesës, tregon se ka qënë ambienti kryesor ku zhvillohej jeta e përditëshme. Ai ka qenë «shtëpia e zjarrit». Mungesa e gjurmëve të oxhakut tregon se zjarri ndizej në vatër, mbi pjesën përdhese të këtij ambienti. Por mbetet disi i pa qartë funksionimi i dy ambienteve ballorë. Duke u nisur nga analogjia kompozicionale e kësaj me banesën me kullë Nr. 1 nga përmasat relativisht të mëdha të saj dhe faktit që, mesa kemi vërejtur, ky është ekzemplari i vetëm i ndërtuar si i tillë që në krye, mendojmë se pjesa e ballit të banesës ka funksione mbrojtëse, ajo është kulla e banesës. Muri masiv tërthor, që i ndan dy ambientet e ballit nga pjesa tjetër e banesës, krejt i pa nevojshëm, konstruktivisht, gjithashtu është një dëshmi e synimit për t'a bërë sa më të sigurtë këtë pjesë të banesës.

Muratura e banesës, ashtu si e të gjithë ndërtimeve të Kamenicës, është ndërtuar me mur guri e lidhur me llaç të fortë gëlqereje. Brezat e drurit nuk janë përdorur. Muratura, me qoshe të punuara me gurë të latuar trashë, ka një tendencë të theksuar drejt rreshtimit. Ndërsa në mbarim të katit përdhes është bërë rrafshimi i muraturës, me një rresht gurësh të së njëjtës lartësi me ata të qosheve. Terreni i fortë shkëmbor vende-vende, thuajse ka bërë të panevojshme hapjen e themeleve, kështu muratura ngrihet ose drejt mbi shkëmb, ose terrenit i bëhet një përpunim i vogël përpara se të fillojë ndërtimi i murit. Trashësia e mureve fillon që poshtë, rreth 77-80 cm. e pastaj ngushtohet, duke u ngritur lart pa dhëmbëzim, deri në 60-65 cm. Në nivelin e mbarimit të katit përdhes duken qartë nga brenda, vrimat për vendosjen e trarëve të dyshemesë në largësi aks më aks rreth 65-75 cm. Ambienti i mbrapëm i katit të parë i ka pasur trarët e dyshemesë të vendosur paralel me brinjët e shkurtëra të mureve, ndërsa ambienti i ballit normal me to, sepse hapësira ishte më e shkurtër. Kallkani, i ruajtur mirë në ballin e mbrapëm, tregon se çatia ishte dyujshe. Fragmente kallkani dhe në faqen ballore të banesave të tjera e bëjnë të qartë se, kjo lloj mbulese ishte në përdorim të gjërë. Siç përmëndëm dritaret mungojnë krejtësisht, me përjashtim të disa hapësirave të rralla në formë frengjije, që i kemi takuar dhe në ballin e mbrapëm të banesës kur ai është mjaft i lartësuar nga toka. Nuk përjashtohet mundësia e qënjes së baxhave të ndriçimit në mbulesën e banesës. Mbetet gjithashtu e pa

DO NOT COPY

qartë me çfar materiali mbuloheshin banesat. Mungesa e mbeturinave të tjegullave të shtyn të mendosh se do të jenë përdorur rrasat e gurit. Megjithëkëtë kjo çështje mbetet e hapur, përderisa nuk janë bërë pastrime dhe gërmime sistematike. Në faqet e brëndshme nuk gjejmë gjurmë suvatimi, por fugat e muraturës janë fugatuar me llaç, duke i dhënë një rrafshim të mirë këtyre sipërfaqeve.

Me interes është banesa Nr. 2 (tab. IV, fig. 12), e cila ka dy faza ndërtimi. Në fazën e parë, banesa kishte një kompozim të thjeshtë volumor me gjysëm kat me një ambient në pjesën përdhese dhe, të dytin, pjesërisht në kat e pjesërisht përdhes, me sipërfaqe më të madhe. Të dy ambientet kanë hyrje direkte nga jashtë. Banesa, ka në krahun e majtë, pranë, ndërtime të tjera. Ndërmjet saj dhe atyre duken shenjat e një rruge, që, në një pjesë është në formë shkallësh për të hipur, pastaj në një platformë që e formon një masiv murature, prej së cilës hyet në ambientin e banuar. Më vonë, banesës i është shtuar një ndërtim i ri në ballin e saj. Kjo shtesë e ka prurë banesën në një formulim të njëjtë kompozicional me atë të banesës Nr. 1. I vetmi dallim ndërmjet tyre qëndron se, në ambientin përdhes të pjesës së shtuar të banesës Nr. 2 ka hyrje direkte nga jashtë dhe, ai është i pajisur me një vrimë ndriçimi me seksion të njëjtë. Në hapësirën e portës duken shenja të një pature të dhëmbëzuar, rast ky i rrallë. Shtesa ka formë jo të rregullt, për shkak të terrenit të aksidentuar (fig. 13). Banesa origjinale me dy kthina është lloji i përhapur gjerësisht në Kamenicë.

Siç kemi përmëndur në Kamenicë ka qenë mjaft e përhapur praktika e ndërtimit, pranë banesës së parë e një të dyte. Një rast të tillë kemi në kompleksin e dy banesave, që formohet nga banesa e parë, ajo e krahut të majtë, së cilës më vonë i është bashkëngjitur një e dytë, në krahun e djathtë (tab. IV, fig. 14). Në banesën e parë, në krahun e majtë, duken gjurmët e një oborri të vogël. Në të ruhet në gjëndje të mirë faqja ballore ku gjejmë dy hapësira ndriçimi në formë frengjije, si dhe gjurmë të qarta që tregojnë se faqja ballore përfundonte me kallkan. Në këtë banesë nuk dalluam gjurmët e murit të zakonshëm mbajtës, që formon pjesën përdhese të katit të parë. Rrënimet e mëdha që kanë pësuar muret e saj nuk kanë lënë gjurmë të hapësirave të dyerve, kështu që nuk mund të shprehemi nëse ndërlidheshin apo jo këto dy banesa të përngjitura.

Rasti më i skajmë, i ndërtimit të një banese përngjitur një tjetre, është kompleksi i banesave Nr. 4 (tab. IV, fig. 15) që formohet nga tre banesa. Banesa e parë është ajo e krahut të djathtë, më vonë, asaj i janë shtuar dy të tjera. Në këtë kompleks ruhen mirë katojt, ndërsa ambientet e banuar janë mjaft të rrënuara. Të tre katojt ndërlidhen me dyer. Në njerën derë ruhet kanali i katarahut. Në dy banesat e mëvonshme ruhen qartë gjurmët e murit mbajtës. Ndërlidhja e katojve dhe pozicioni i izoluar i banesës së mesit e bën të kuptueshëm se ky kompleks i shërbente një familje të vetme.

Nga banesat, në jug të kodrës perëndimore që, siç thamë, duken më të vona, me interes është ajo Nr. 5 (tab. V, fig. 16). E kompozuar me gjysëm kat, ajo është e variantit të thjeshtë me nga një ambient në secilin kat. Në plan ka formën e një katërkëndëshi të çrregullt. Muri mbajtës në trupin e tij ka tre kamare, rast ky i rrallë. Dera për në katua është relativisht e madhe: 1.50 m. Katoi është pa dritë, por në të nuk mungojnë vrimat e ajrimit, ashtu si dhe në ballin e katit të parë. Banesa ruan gjurmë të kallkaneve në të dy muret e shkurtë. Veçanti e kësaj banese është qënja e një dritareje në ballin e përparmë të ambientit të katit (fig. 17), e cila duket se mbulohej me arkitra guri.

Po në këtë zonë gjëndet një ekzemplar (tab. V, fig. 18), në të cilën në murin ballor, në nivelin e dyshemesë, gjejmë të vendosur një brez druri. Ai formohet nga dy binarë të vendosur rrafsh me të dy faqet e muraturës dhe të lidhur me binarë më të vegjël, njëlloj si brezi i kullës Nr. 1. Ambienti i katit ndriçohet me dritare, si ajo e banesës Nr. 5.

Si rast i veçantë dhe i vetëm është banesa Nr. 7 një nga më të mëdhatë e Kamenicës (tab. V), e cila formohet nga dy banesa të përngjitura, por të ndërtuara të tilla që në krye, siç tregon vazhdimësia e murit ballor (fig. 19). Mungesa e hyrjeve në murin e djathtë anësor, tregon se hyrjet ishin nga krahu i faqe



Fig. 11

DOKTORE



Fig. 12

së majtë. Në katoin e bllokut të djathtë duken gjurmët e një lloj kupole të vogël, funksioni i së cilës nuk njihet akoma.

Përveç banesave pjesërisht me kat, që, siç përmendëm, përbëjnë shumicën shumë rrallë kemi takuar ndonjë banesë përdhese. Shembulli më tipik është banesa Nr. 8 (tab. V, fig. 20). Ajo ka një plan formë të rregullt katërkëndësh këndrejt. Hyrja e vetme me paturë të drejtë, sigurohet me katarah. Banesa njëkthinëshe ndriçohet nga një hapësirë në formë frengjije. Dy kamare të vogla në fundin e të dy mureve gjatësor janë të vetmit elementë që dallojnë në brendësi të banesës. Përveç banesave të zakonshme, në fshatin e rrënuar të Kamenicës takojmë dhe disa banesa, në katojtë e të cilave kanë qenë vendosur instalime mullinjsh vaji. Tre prej këtyre banesave, të vetmet përsa kemi gjurmuar, janë ndërtuar relativisht pranë njera tjetrës, në pjesën qendrore të fshatit. Në dallim nga banesat e tjera, këto janë vendosur me brinjët e gjata paralele me vijat rrushkulluese. Ato janë kompozuar simbas pjerrësisë së terrenit, me gjysëmkat apo me kat. Mulliri vendoset në katin përdhes në njërin krah të ambientit të vetëm me përmasa të mëdha të këtij kati. Volumi i madh i këtyre ndërtimeve, mënyra e vendosjes dhe mungesa e këtyre instalimeve në banesat e tjera, tregon se këta mullinj i shërbenin mbarë fshatit. Gjurmët e qarta të katit të parë, tregojnë se këto ndërtime ishin banesa, katoi i të cilave shërbente si hapësirë për vendosjen e mullirit të vajit, i cili sigurisht, funksiononte në mënyrë sezonale. Bazamenti i mullirit përbëhet nga një bllok i vetëm guri në formë rrethore me diametër 114 cm. e trashësi 25 cm. (siç e kemi gjetur në banesën me mulli Nr. 1). Në qendër të tij është gdhëndur një vrimë (tab. VI). Ky gur mbështetet mbi një platformë, gjithashtu rrethore, të punuar me gurë me diametër 230 cm. Pranë këtij instalimi, gjetëm dy gurë mulliri në formë cilindri, me diametër 76 cm e trashësi 40 cm. me një vrimë, që çponte tejpërtej qendrën e gurit.

Banesa me mulli Nr. 1 (tab. VI), ngrihet mbi një terren shumë të pjerrët. Në ambientin e katit përdhes në të djathtë të tij, është vendosur mulliri i vajit që përshkruam. Ka mundësi që, diku nga mesi i murit ballor, të ketë qënë ndërtuar hyrja për në katin përdhes. Në murin fundor duken qartë gjurmët e vrimave për vendosjen e trarëve të dyshemesë. Në katin e parë ruhet një fragment i hapësirës së derës, ndërtuar në murin e mbrapëm.

Banesa me mulli Nr. 2 (tab. VI, fig. 2), është me përmasa më të mëdha në katin e parë, në krahasim me atë përdhes, mbasi ndërtimi është kompozuar me gjysëmkat. Në katin përdhes në murin ballor, nga brënda duken gjurmët e vrimave të trarëve të dyshemesë, të cilat vazhdonin deri më tej mesit të murit. Në këndin perëndimor të katit përdhes, duken gjurmët e tre kamareve. Rrënimi i murit, rreth mesit të ballit, të sugjeron mundësinë e qënjes të një hyrjeje. Ambienti i katit është mjaft i rrënuar. Banesa me mulli Nr. 3 (tab. IV) ruan fragmente të mulirit dhe hapësirën e derës prej 1,4 m. rreth mesit të murit ballor. Teknika e ndërtimit në këto banesa me mullinj është e njëllojtë me atë të banesave të zakonshme.

KISHAT

Në kërkim të ndërtimeve të kultit, në grumbullin e madh të rrënojave të fshatit, gjetëm rrënoja të shtatë kishave të shpërndara në zona të ndryshme të tij. Tri prej tyre ndodhen në pjesën e lartë të kodrës perëndimore, një në pjesën jugore të saj, dy në «qafën e Pazarit» dhe kisha e fundit në kodrën më të ulët lindore. Nuk mund të shprehemi nëse ky është numri i plotë i kishave të fshatit, por sidoqoftë mendojmë se këto paraqesin më së miri ndërtimet e kësaj kategorije. Një kishë e rrënuar ndodhej larg fshatit, në anën juglindore të tij. Studimi i këtyre kishave paraqet interes sepse ndonjë prej tyre na jep të dhëna me mjaft vlerë për vendosjen në kohë të fshatit dhe ndërtimeve të tij. Le ti vështrojmë radhazi këto kisha.

DO NOT COPY

KISHA NR. 1

Ndodhet në anën perëndimore të fshatit, në majën e kodrës më të lartë. Nga perëndimi terreni bije thikë, ndërsa nga anët e tjera janë banesat e rrënuara të fshatit. Muret e kishës ruhen në një lartësi të madhe, duke patur të rrëzuara vetëm pjesët e sipërme, materiali i të cilave ka mbuluar dyshemenë. Kisha është njënefshe, me naos drejtkëndësh 8,1 x 3,9 M. dhe me një absidë pesëfaqshe, në anën lindore (tab. VII). Në kishë hyet nga perëndimi dhe nga jugu. Porta jugore është e plotë dhe mbulohet me arkitra guri në anën e jashtme, ndërsa në anën e brëndshme ruhen gjurmët e trarëve të drunjtë. Nga porta perëndimore ruhet vetëm shpatulla jugore, sepse ky mur është i rrënuar më tepër se të tjerët. Një dritare, pjesërisht e murosur dhe mbuluar me hark, nga i cili ruhen vetëm tullat përgjatë harkut ndodhet në murin verior. Në ambientin e altarit, përveç bemës së formuar nga absida, kemi dhe dy nikjet, protezis dhe diakonikonit në faqen lindore dhe, një kamare pranë në faqen veriore. Protezis është më i madh dhe më i lartë dhe mbulohet me hark, tullat e të cilit janë marrë.

Ka shumë të ngjarë që kisha të ketë pasur një ikonostas të gurtë, siç tregojnë disa vrima në mur dhe një pllakë guri e thyer. Këtë problem do ta ndriçonte gërmimi brenda kishës dhe pastrimi i materialeve të rrënuara aty. Në brendësi të kishës gjënden mjaft gurë çmërsi në formë pyke, që duket se janë të qemerit të absidës, sepse trashësia e mureve gjatësor përjashton mundësinë e mbulimit të naosit me qemer. Gjithashtu asnjë gjurmë qemeri nuk u gjet në pjesën e sipërme të mureve.

Kisha është ndërtuar me gurë të punuar ndryshe nga ndërtimet e tjera të fshatit. Si lidhës është përdorur llaçi, i gëlqeres me rërë mjaft të trashë. Si material ndërtimi është përdorur dhe tulla, të cilën e gjejmë më tepër në anën lindore me funksion dekorativ. Vende-vende duken vrima të rrumbullakta tërthorë murit, të formuara nga drunjtë të lënë në mur. Një gjë të tillë, siç thamë, e kemi vërejtur dhe në mjaft ndërtime të tjera të Kamenicës[11]).

Absida pesëfaqshe që del në anën lindore, ngrihet mbi një platformë të ulët. Në muret e saj kemi një numër mjaft të madh tullash. Në faqen e mesit të saj është ndërtuar një dritare dyshe me një shtyllë guri çmërsi në mes, që shkon në tërë gjerësinë e murit dhe që është mbuluar me dy harqe të punuar në një gur të vetëm. Nën dritaren, një brez katër tullash kalon në gjithë absidën. Brinjët, që formojnë faqet, në takimin e tyre kanë nga një tullë vertikale që ndërpresin brezin. Më lart, tullat janë përdorur në rreshta horizontalë me një ose dy tulla dhe, më rrallë tullat vendosen vertikalisht, por nuk mund të cilësohen në formë kluasonazhi. Në faqet pranë absidës të murit tullat përdoren më rallë. Akoma më rallë hasen ato në muret e tjerë.

Në anën perëndimore të kishës gjënden gjurmët e disa mureve, në një nivel mjaft të ulët, që të bëjnë të mendosh se janë mbeturina të narteksit të vonë me një hyrje në anën veriore.



Fig. 13



Fig. 14

11) Këto lloj vrimash i kemi takuar edhe në kishën e Marmiroit të datuar në shek. XIII shih A. Meksi, **Restaurimi i kishës Marmiroit,** «Monumentet» 2, 1971, 74.

DO NOT COPY

Për datimin e kësaj kishe, teknika e ndërtimit të mureve flet për periudhën përpara pushtimit turk. Si argument kryesor kemi formën pesëfaqëshe në planimetri të absidës, që në provincat çfaqet jo përpara shek. XIV[12]). Në këtë mënyrë do të mund ta datonim kishën në shekujt XIV-XV.

KISHA NR. 2

Ndodhet pranë kishës së më sipërme, në jug të saj, në një pjesë më të ulët të kodrës. Kisha është ndërtuar mbi një terren jo të rafshët, kështu që absida mbështetet pjesërisht mbi një shkëmb më lart se dyshemeja e kishës. Rreth kishës (tab. VII) si nga ana jugore, ashtu dhe ajo perëndimore ka gjurmë muresh, hajate të mbyllura, të cilat duke qenë të vegjëra nuk lexohen qartë në planimetrin e tyre. Në të hyet nga ana jugore dhe perëndimore. Porta jugore është mbuluar me hark prej gurësh, mbi të cilën kemi breza prej tullash dhe tjegullash, që lakohen mbi portën dhe që zenë një pjesë të fasadës. Në fillim është një brez prej dy shirita tullash, pastaj breza të tjerë me tulla e tjegulla të vendosura pjerrtas dhe në formë kurriz peshku. Gati një metër mbi to, janë shkruajtur me tulla dy fjalë me gërma greke që nuk i deshifrojmë dot. I këtij mendimi është edhe Ugolini, i pari që na kumton për këtë monument[13]).

Me të njëjtin dekoracion me tulla dhe tjegulla është edhe një pjesë mbi portën perëndimore, mbulesa e së cilës është rrëzuar me kohë. Nga porta ruhen vetëm shpatulla në anën e brendshme të saj. Një nikje e vogël ndodhet mbi të. Po me tjegulla e tulla dekorohet absida. Në të kemi një brez tullash në formë kurriz peshku ose vertikalisht dhe që formojnë vizatime të ndryshme. Një dritare e ngushtë si frëngji, ndodhet në mes të absidës rrethore.

Në interier të kishës kemi një grumbull të madh gurësh të mureve dhe tjegullash nga të çatisë. Në faqen lindore kemi bemën, në qemerin e së cilës ruhet një fragment afresku. Dy kamare të mbuluara me hark guri janë në veri të saj. Si në anën lindore, ashtu edhe në atë perëndimore muret përfundojnë me fronton, pra, kisha mbulohej me çati dyujshe.

Të dhëna për datimin e kishës nuk disponojmë, por duke u nisur nga teknika e ndërtimit me gurë të çrregullt dhe, në përgjithësi e një niveli të ulët, si dhe nga dekoracioni primitiv, mendojmë se kjo duhet të jetë kisha më e vjetër e fshatit dhe duhet të datohet e shek. XIII-XIV.

KISHA NR. 3

Është një kapel e vogël, që ndodhet në vendin e quajtur «qafa e Pazarit». Ajo përbëhet nga naosi, me mure të ruajtur në një lartësi 1.5 m dhe hajati i mëvonët, në anët jugore dhe perëndimore, me mure të ruajtura shumë pak dhe jo të qartë (tab. VII). Muret janë ndërtuar me gurë të rregulltë dhe tjegullat përdoren si dekor vetëm në absidën rrethore në tre rradhë të vëna pjerrtas nën dritaren e ngushtë të frëngjisë.



Fig. 15



Fig. 16

12) G. Millet, **L'ecole grecque dans l'architecture byzantine,** Paris 1916, 181.
13) L. Ugolini, **Albania Antica,** Roma, 1927, 141, 198-199, tav. CLL.

PHOTOCOPY

Për datimin e saj, jo të sigurtë, në periudhën e parapushtimit turk të shtyn dekori me tjegulla në absidë, sepse të dhënat e tjera, si planimetria dhe teknika e ndërtimit janë të pavendosëshme në kohë.

KISHA NR. 4

Ngrihet pranë kishës Nr. 1 (tab. VIII), përmasat e saj janë 5 x 2.7 m. Nga perëndimi dhe jugu rrethohet me një hajat të më vonshëm. Sot kisha është mjaft e rrënuar me mure në një lartësi të vogël. Hajati ka hyrjen nga ana jugore, ndërsa kisha në anën perëndimore ruan mjaft të qartë gjurmët e paturave të hyrjes. Një absidë rrethore e vogël del në anën lindore. Muret e kishës janë të ndërtuar me gurë të rregullt. Datimi i saj na duket i papërcaktuar akoma.

KISHA NR. 5

Është me përmasa 5 x 2.77 m, ajo ndodhet në pjesën e poshtme të anës jugore të kodrës më të lartë (tab. VII). Në anën perëndimore të saj është një narteks më i vonë me përmasa 5,30 x 4,40 m, muri verior i të cilit mbështetet direkt mbi shkëmb. Në narteks hyet nga ana perëndimore, nëpërmjet portës që ruhet qartë kurse në naos hyet nga dy porta me paturë, një më e madhe në anën perëndimore dhe një më e vogël në anën jugore. Në faqen lindore është një absidë e vogël rrethore, ndërsa pranë saj në murin verior një kamare drejtkëndëshe. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë të punuar.

KISHA NR. 6

Ndodhet në pjesën veriperëndimore të «qafës së Pazarit» dhe përbëhet nga naosi me përmasa 5,50 x x 2,90 m dhe një oborr pranë tij në anën perëndimore (tab. VII). Në kishë, muret e të cilës ruhen në një lartësi rreth 2 m. hyet nga ana jugore dhe portës i ruhet vetëm shpatulla e majtë. Brënda kishës ka grumbuj gurësh të trazuar. Në anën lindore ruhet tërësisht absida rrethore me një dritare të ngushtë e të lartë, ndërsa pranë saj një nikje rrethore mbuluar me hark si protezis. Në murin verior ndodhet gjithashtu një kamare e vogël. Kisha është ndërtuar vetëm me gurë dhe nuk ofron ndonjë element datimi.

KISHA NR. 7

Ndodhet në majën e kodrës së ulët, në pjesën lindore të saj, atje ku shkëmbi bie thikë. Përbëhet nga naosi me përmasa 4 x 3,70 dhe narteksi i vonë 4,40 x 3,70 m. në anën perëndimore (tab. VII). Muret e tyre ruhen të veçuara dhe vende-vende arrijnë lartësinë 2.5m. Porta e narteksit duket se ka qenë në anën perëndimore atje ku mungon pjesa qendrore e murit, ndërsa porta e naosit ruhet qartë. Në anën lindore kemi vetëm absidën rrethore me një dritare të ngushtë. Muret e kishës janë të ndërtuar me gurë të çrregullt.

* *
*

Arkitektura e ndërtimeve të fshatit të rrënuar të Kamenicës përbën një dëshmi të lashtë në trajtimin arkitektonik-konstruktiv të banesës. Për këtë arsye ajo zë një vënd me rëndësi të veçantë në trashëgiminë arkitektonike të së kaluarës.

Ky vendbanim i ruajtur relativisht mirë, dallohet për një unitet të theksuar të ndërtimeve në planin arkitektonik dhe atë konstruktiv. Tipizimi i ndërtimeve është një dukuri që çfaqet në mënyrë të theksuar. Ky tipizim vjen i natyrshëm, kryesisht për shkak të thjeshtësisë së kompozimit të banesave që përfshijnë një numër relativisht të vogël ambientesh, duke pasqyruar kushte ekonomiko-shoqërore relativisht të qëndrueshme dhe duke ruajtur kështu gjatë traditën, në mënyrën e jetës, pra, dhe në ndërtimin e banesave. Banesa e Kamenicës është një tip i thjeshtë, ajo është e ndarë funksionalisht në dy kate. Kati përdhes zakonisht me sipërfaqe më të vogël se ajo e katit të parë është i pabanuar, ndërsa kati i parë është i banuar. Banesa është mjaft e mbyllur. Muret e fortë prej guri, hapësirat minimale për ndërlidhje me ambientin e jashtëm dhe mungesa, thuajse e plotë e dritareve apo hapësirat e tyre shumë të vogla, i japin banesës një karakter të theksuar mbrojtës. Banesat e Kamenicës dallohen për një primitivizim të theksuar, ku utilitarizmi është realizuar me mjetet më të thjeshta. Megjithëse nuk ruhet thuajse asnjë gjurmë për të gjykuar mbi arkitekturën e brendshme, kuptohet qartë se ajo ka qenë shumë e thjeshtë. Mungojnë krejtësisht oxhaqet, gjë që tregon se zjarri ndizej në vatër, pra, mungonte dhe tavani. Mungesa e dritareve i bënte të errët ambientet, por këtu duhet pasur parasysh edhe fakti se banesa ishte më fort një strehë për fjetje, mbasi të aftët për punë, burra e gra, e kalonin ditën jashtë me punët e shumta të blegtorisë e bujqësisë. Kompozimi volumor i tyre është përcaktuar nga pjerrësia dhe natyra shkëmbore e terrenit. Ekzemplarët e shumtë të banesës me gjysëmkat me një kthinë të banuar, janë një dëshmi bindëse se kjo banesë lindi si një zgjidhje racionale me konditat e një zhvillimi relativisht të ulët të jetës ekonomike të fshatit, që kushtëzonte një minimum prej dy kthinash. Ky numër minimal ambientesh bëri që faktori i terrenit, në rastin tonë jo i rrafshët, të merr-



Fig. 17



Fig. 18

te një rëndësi thuajse vendimtare në kompozimin volumor të banesës me gjysëmkat. Kjo ngritje jo e plotë e banesës në lartësi, pra, qenja e ambientit të banuar pjesërisht në kat e pjesërisht përdhes mund të konsiderohet, ashtu siç ka vërejtur me të drejtë dhe B. Kojiç[14]), si hapi i parë drejt kalimit nga banesa përdhese në atë me kat. Po të jetë kështu banesës së zonave kodrinore e malore, i takon së pari, të tentojë drejt kalimit të banesës me kat, që, padyshim përbën një hap cilësor në rrugën e gjatë të zhvillimit të banesës.

Me shumë interes është ekzemplari i banesës me kullë, i cili për nga kompozimi dhe raporti volumor, ndërmjet kullës dhe banesës të konceptuara si njësi e vetme, përbën një lloj të veçantë në arkitekturën e banesës shqiptare. Bashkërendimi i kullës, në kuptimin e një ndërtimi me tipare të theksuara mbrojtëse me banesën, është një fenomen i njohur në banesën shqiptare. Kështu një lloj «kamerjeja» në banesat gjirokastrite është një kullë me tipare të theksuara të mbrojtjes pasive[15]). Gjithashtu të njohura janë dhe banesat e tipit «kullë», pra, banesat e fortifikuara, në të cilën mund të përfshihet kulla Nr. 1 e Kamenicës. Por ajo që përbën të veçantën në banesën me kullë të Kamenicës është kompozimi i saj dhe raporti sipërfaqësor ndërmjet këtyre dy njësive. Në banesën me kullë, sipërfaqja e dobishme e kullës zë më tepër se gjysmën e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit. Ky tregues, si dhe kompozimi me lidhje organike funksionale, ndërmjet kullës dhe pjesës tjetër të ndërtimit, tregon se vetë kulla bartte dhe funksione banimi dhe nuk ishte një ndërtim që shërbente vetëm për mbrojtje pasive në rast të ndonjë rreziku.

Në gjëndjen e sotme të njohjes dhe studimit të trashëgimisë në lëmin e banesës popullore, banesat e Kamenicës përbëjnë një dëshmi mjaft të lashtë të kësaj kategorie ndërtimesh në vëndin tonë dhe, janë padyshim, më të vjetrat në llojin e banesave me gjysëm kat, aq të përhapura në vëndin tonë si në qytete dhe në fshatra të ngritur në terrene të pjerrët. Kualiteti i mirë i muraturës dhe në përgjithësi niveli i mirë i ndërtimeve, e bëjnë të qartë se Kamenica është ndërtuar nga mjeshtra profesionistë. Teknika e ndërtimit është mjaft e thjeshtë, mungojnë harqet dhe qemeret. Arkitrarë prej një blloku të vetëm mbulonin hapësirat e dyerve, por nuk përjashtohet dhe përdorimi i drurit. Mungesa e brezave të drurit në banesat, shpjegohet me përdorimin e lidhësit të fortë prej llaçi gëlqereje, lartësisë relativisht të ulët të ndërtimeve dhe terrenit të fortë shkëmbor.

Banesat e Kamenicës kanë afërsi në kompozimin e tyre me rrënojat e banesave të Mistrës të përshkruara nga Orlandos[16]). Por banesat e Mistrës, në dallim

14) B. Kojiç, **Sëska arkitektura i rurizëm,** Beograd, 1958.
15) E. Riza, **Banesa e fortifikuar gjirokastrite,** «Monumentet» 1, 1971.
16) A. K. Orlandos, **Arqion ton vizantinon mnimion tis Elladhos,** V. III. 1937, Athinai.

DO NOT COPY



Fig. 19



Fig. 20

nga të Kamenicës janë mjaft të pasura në elementë të veçantë arkitektonike dhe më të mëdha në përmasa. Me interes është gjithashtu të vërejmë se në Mistra takohet dhe ndërtimi i kullave së bashku me banesën; në disa raste me kompozim të njejtë me ato të Kamenicës (banesa me kullë Nr. 1). Autori i lartpërmëndur i daton ato rreth shekujve XIII-XV.

Problem më i vështirë për tu zgjidhur për mungesë të dhënash është ai i datimit të ndërtimeve të Kamenicës dhe ai i kohës rreth së cilës u braktis fshati. Mendimin për një braktisje kolektive të fshatit ta sugjeron gjëndja e rrënimeve, e cila është thuajse e të njejtit nivel në të gjithë ndërtimet e tij. Shkaqet e kësaj braktisje nuk njihen, por kjo nuk duhet konsideruar si diçka e jashtëzakonshme në ato kohra të pasigurta kur raprezaljet masive ishin shfaqje të shpeshta. Për kohën e braktisjes së fshatit merren në konsideratë: përmëndja në tefterin e regjistrimit të vitit 1583, dhe mospërmëndja nga Çelebiu në mesin e shek. XVII, duke mbetur kështu fillimi i shek. XVII koha më e mundëshme gjatë të cilët të jetë kryer braktisja. Ndërtimet e Kamenicës siç kemi përmëndur mund ti ndajmë kronologjikisht në dy grupe. Në grupin e parë, bëjnë pjesë ndërtimet në «qafën e Pazarit» dhe në dy lartësitë pranë tij, ndërsa në grupin e dytë, më të vonë, ndërtimet në jugperëndim të «qafës së Pazarit». Për mendimin tonë ato të grupit të parë mund të datohen rreth shek. XIV-XV, ndërsa të grupit të dytë rreth shek. XV-XVI. Në grupin e parë përfshihet dhe banesa me kullë, ndërsa kulla Nr. 1 duhet ti përkasë shek. XVI-XVII.

Studimi sistematik që pret ti bëhet rrënimeve të kësaj qëndre të banuar në të ardhmen, pa dyshim, do ti japë një përgjigje më të bazuar e më të saktë shumë çështjeve e sidomos vendosjes në kohë të këtyre ndërtimeve.

DO NOT COPY

TAB. I

BANESA ME KULLE
№1









DO NOT COPY

BANESA ME KULLE Nº 1
Prerjia C-C



KULLA Nº 1 Kati II



BANESA ME KULLE Nº 1
Prerjia b b



KULLA Nº 1
Prerjia 0-0



DO NOT COPY

BANESA №1

KATI PERDHE



PAMJE BALLORE



KATI 1re



PAMJA A



PREMJE C-C



PAMJA B



DO NOT COPY


BANESA Nº 2
Kati I re
BANESA Nº 2
Prerja 0-0
BANESA Nº 3 Kati I re
BANESA Nº 4 Kati I re
MULLIRI
BANESA Nº 3
Prerja 0-0
0 1 2 3 M

DO NOT COPY

BANESA Nº 5 Kati I re



BANESA Nº 6 Kati I re



BANESA Nº 7 Kati I re



BANESA Nº 5 Premja 0-0



BANESA Nº 8



BANESA Nº 9 Kati I re



DO NOT COPY

BANESE ME MULLI Nº 1
Kati I re



BANESE ME MULLI Nº 1
Kati përdhe



BANESE ME MULLI Nº 1
Prerjo 0-0



BANESE ME MULLI Nº 2



BANESE ME MULLI Nº 3



DO NOT COPY

DO NOT COPY

KISHA Nº 1



KISHA Nº 2



Pamje nga lindja



Pamje nga jugu



Pamje nga lindja



KISHA Nº 3



KISHA Nº 6



KISHA Nº 7



KISHA Nº 4



KISHA Nº 5



Emin RIZA
Aleksandër MEKSI

CONSTRUCTIONS DU VILLAGE EN RUINE DE KAMENICE

RESUME

Cet article n'est qu'un simple exposé de l'architecture caractérisant les constructions du village en ruine de Kamenice. Des travaux de déblayage et des fouilles systématiques n'ayant pas encore été effectués, cet article ne peut être considéré qu'une publication à caractère introductif.

Les ruines de Kamenice se trouvent dans le district de Sarande et surmontent deux collines reliées entre elles par un col de faible altitude. Le terrain avoisinant se prête à l'essor de l'économie vers le bas, en direction SO s'élendent une vaste plaine et, plus au N, des prairies florissantes. Le climat doux favorise la culture de l'olivier.

Le village en ruine de Kamenice, à l'état actuel, conserve un bon nombre de constructions dont la majeure partie est représentée par des maisons d'habitation surtout et par des églises. Les sources historiques faisant état de Kamenice sont relativement réduites en nombre. Selon le Registre des années 1431-32 le village de Kamenice, relevant du vilayet de Vajonet, comptait en tout et pour tout 267 maisons d'habitation. Il était à l'époque une des agglomérations la plus grande de cette zone. Plus tard, selon le Registre de l'année 1583, il ne compte que 200 maisons d'habitation. Le voyageur turc Evliya Celebi, qui, vers la moitié du XVIIe siècle, s'est rendu de Delvine à Kalas, en passant à proximité de Kamenice, passe nous silence celui-ci. Aravantinoi, dans sa liste détaillée des villages de l'Epire, liste relavive au commencement du XIXe siècle, ne mentionne pas également Kamenice. Les constructions de Kamenice, à l'heure actuelle, peuvent être groupées en habitations à kulla, en kulla, en maisons d'habitations et en églises.

L'HABITATION A KULLA N° 1

Il s'agit là d'une des constructions la plus intéressante et la plus complexe conservée passablement bien parmi les ruines de Kamenice. Elle s'élève sur le point le plus élevé de la colline, à l'ouest du col du marché, occupant ainsi une position dominant le village tout entier. Cette construction est formée de deux unités reliées organiquement entre elles, à savoir la kulla à trois étages et l'habitation vrai et propre qui a un étage en moins. Toute la face orientale de cette construction est longée par une petite cour, entourée de murs, dans la partie méridionale de laquelle est aménagée l'entrée. Au fond de cette cour, face à l'entrée, gisent les ruines d'une construction dont on n'a pas pu établir la fonction. La surface de la kulla est proche de celle d'un carré. Un petit réservoir d'eau s'appuie sur les faces orientale et septentrionale de la construction. L'ambiance du premier étage, dont la hauteur est de 2 m. environ, manque d'illumination. Le rez-de-chaussée également manque d'illumination. Le mur septentrional du premier étage, dont la hauteur actuelle est de 1,3 m., exclue toute possibilité de communication entre cette pièce et le reste de l'habitation. Le deuxième étage est plus élevé: 3.3 m. au maximum actuellement. La maçonnerie de la face septentrionale est presque en décombres. Les deux angles montrent que le deuxième étage de la kulla représentait

DO NOT COPY

une construction indépendante du reste. L'écroulement du mur que nous venons de mentionner, nous invite à penser que c'est précisément dans cet étage que nous devons rechercher la liaison entre la kulla et la construction contiguë. Le deuxième étage est le seul illuminé par deux petites fenêtres en forme de meurtrières. La pièce contiguë à la kulla s'étend en direction septentrionale. Le mur à la kulla porte les traces d'un foyer. Sur le mur oriental on peut voir les restes de l'encadrement de la porte, qui faisait communiquer cette pièce et, à travers elle, la kulla aussi, avec la cour.

La maçonnerie de la kulla est en pierres liées avec du mortier de chaux. En ce qui concerne la technique de construction, elle se caractérise par des bandes de bois entourant les murs au niveau des planchers du premier et du deuxième étage.

LA KULLA Nº 1

Elle est située au SO du centre, dans la périphérie du village de Kamenice. Nous avons affaire à une kulla de type classique, à trois étages et à planimétrie rectangulaire. L'étage au rez-de-chaussée et le premier étage ont presque la même hauteur, environ 2 m., tandis que le troisième étage est de 1 m. environ plus élevé. L'unique entrée se trouvait au rez-de-chaussée, du côté de la face septentrionale. On n'a pas relevé des traces de fenêtres ou de meurtrières au rez-de-chaussée. Il est probable que le premier étage ait eu des fenêtres aménagées dans le mur méridional et peut être même dans celui occidental. Les faces du deuxième étage, regardant en direction est, sont conservées relativement bien. En ce qui concerne la face horizontale, elle conserve le tuyau de la cheminée percée approximativement en son milieu. L'angle NO et particulièrement celui SO ayant été gravement endommagée, il y a lieu de supposer qu'ici se trouvaient des fenêtres. La communication entre les étages a du être assurée par des escaliers intérieurs. La maçonnerie en pierres est liée avec du mortier de chaux. Contrairement à toutes les autres construction de Kamenice, les bandes de bois servant à renforcer la maçonnerie ne sont pas visibles, ayant été placées dans l'épaisseur du mur.

Toute confrontation entre la kulla Nº 1 et l'habitation à kulla Nº 1, nous permet de relever des différences essentielles. Ces différences prouvent que la kulla N0 1 est plus ancienne chronologiquement que l'habitation à kulla Nº 1, qui se renoue à la tradition de construction paysanne aussi bien du point de vue de la composition que de la technique.

LES MAISONS D'HABITATION

Un nombre considérable de maisons d'habitation, dont quelques-unes dans un état satisfaisant, sont conservées à ce jour dans le village en ruine de Kamenice. La composition, les divers éléments architectoniques ainsi que la technique de construction montrent que ces habitations ont été construites dans des périodes de temps relativement proche l'une de l'autre. Seulement un groupe d'habitations situées au SO du centre se rattachent, selon toute vraisemblance, à une période plus récente. Les habitations épousent généralement les mouvements du terrain, ce qui leur donne une orientation des plus diverses. Elles sont toujours disposées avec leur front étroit en direction des courbes de profondeurs, de manière à ce qu'elles présentent un volume normal par rapport à celles-ci. La plupart des habitations sont à deux étages, celles à un seul étage au rez-de-chausée se comptent sur le bout des doigts. Le terrain étant incliné, la grande majorité des maisons ont une composition à demi-étage. Chaque étage comporte généralement une seule pièce, rares sont les habitations ayant deux pièces par étage. L'absence du terrain et son caractère accidenté sont les raisons pourquoi ces maisons manquent généralement d'une cour, qui, même lorsqu'elle existe, est de dimension ré-

DO NOT COPY

DO NOT COPY

duite, et souvent leur entrée donne directement sur la rue. Une pratique largement répandue, et qui mérite d'être relever, est celle de construire une deuxième, parfois même une troisième maison, tout près de la première. Ce phénomène trouve son explication dans l'accroissement de la famille, comme l'attestent les traces de communication intérieure entre l'ancienne maison et la nouvelle.

L'habitation Nº 1, une des plus grandes, se trouve en plein centre du village. Elle est à deux étages et comporte quatre pièces, deux par étage. Elle avait deux entrées, l'une au rez-de-chaussée et l'autre au premier étage. Sa principale pièce doit avoir été celle disposée au fond du premier étage, qui vraisemblablement communiquait avec la pièce de front.

La composition analogue à celle de l'habitation à kulla Nº 1, ses dimensions relativement grandes et le fait que, sur la base de nos actuelles observations, elle résulte être le seul exemplaire construit tel quel dès le commencement, sont autant d'éléments qui nous induisent à penser que la partie frontale de cette maison a du remplir les fonctions d'une kulla.

L'habitation Nº 2, construite en deux phases, présente également de l'intérêt. Sa première phase de construction se caractérise par une composition simple quant à son volume, qui est à demi-étage et comporte une pièce à chaque étage. Une nouvelle construction a été ajoutée à sa partie frontale, pendant la deuxième phase, en reprenant de la sorte la formule de l'habitation Nº 1. Les maisons à un étage au rez-de-chaussée, comme c'est le cas de l'habitation Nº 8, sont rares.

Outre les habitations à compozition ordinaire, on rencontre à Kamenice, des maisons dont le rez-de-chaussée a été aménagé en moulin à huile. Contrairement aux autres habitations, les côtés longs de celles-ci sont disposés parallèlement aux courbes de profondeurs. Exemple les maisons à moulin Nº 1, 2 et 3.

Les murs de ces habitations sont en pierres liées avec du mortier de chaux, sans employer cependant des bandes de bois. L'épaisseur des murs est d'environ 75-80 cm au niveau du sol puis elle se rétrécit jusqu'à 60-65 cm. Là où commence l'étage supérieur, ou voit les ouvertures des travées du plancher à une distance de 65-75 cm environ. Les fragments des frontons montrent que les toits de ces habitations étaient à deux pentes. En ce qui concerne les fenêtres, elles manquent presque complètement à l'exception de quelques ouvertures en forme de meurtrières pratiquées dans le mur.

LES ÉGLISES

A la suite des observations sur place, parmi les ruines du village de Kamenice, on a mis au jour les restes de sept églises.

L'EGLISE Nº 1.

Elle est à une nef et comprend un naos à angle droit et une abside à cinq faces. Dans l'ambiance de l'autel, outre le sanctuaire constituée par l'abside, on relève deux niches, le prothésis et le diaconicon sur la face orientale. Selon toute vraisemblance, comme le montrent les traces, il doit y avoir eu une iconostase de pierre. Outre la pierre en tant que matériau de construction, on a employé aussi des briques pour agrémenter surtout la face orientale de l'église. La technique de construction des murs témoigne une période de temps antérieure à l'occupation turque. L'abside à cinq faces est apparue dans les provinces de l'empire byzantin avant le XIVe siècle. Aussi cette église date, à notre avis, les XIVe–XVe siècles.

L'ÉGLISE Nº 2.

En direction sud et ouest de cette église on été mises au jour des traces de murs et d'atriums fermés que l'on ne peut déterminer clairement. Sa porte méridionale est couverte par un arc de pierres, surmonté par des bandes de tuiles et de briques. Au-dessus

de ces bandes, à 1 m. environ, avec ces briques ont été écrits deux mots en grec que nous n'avons pas pu déchiffrer. La même décoration agrémente en partie la porte occidentale. L'abside également est orné de tuiles. La voûte du sanctuaire conserve encore un fragment de fresque. Sur les côtés est et ouest les murs se terminent en fronton, ce qui montre que cette église était couverte par un toit à deux pentes. Partant de la technique de construction des murs en pierres disposées irrégulièrement et de la décoration primitive, il semble que c'est l'église la plus ancienne du village et qu'elle date les XIIIe–XIVe siècles.

L'ÉGLISE Nº 3.

Il s'agit d'une petite chapelle, ayant sur ses côtés sud et ouest un naos et un atrium de construction plus récente. Ses murs sont en pierre. Seulement son abside circulaire est décoré de tuiles. L'ornamentation de l'abside avec des tuiles nous induit à la dater d'une période antérieure à l'occupation turque.

L'ÉGLISE Nº 4.

Elle est entourée du côté ouest et sud par un atrium de construction plus récente. Son abside est de forme circulaire. En ce qui concerne sa datation, nous ne pouvons formuler aucune opinion exacte.

L'ÉGLISE Nº 5.

Dans sa partie ouest se trouve un narthex de construction plus récente. L'abside est de forme circulaire. Les murs de cette église sont en pierres taillées.

L'ÉGLISE Nº 6.

Elle comporte un naos et une cour dans sa partie ouest. Son abside de forme circulaire est doté d'une fenêtre étroite et haute. Il s'agit d'une construction en pierres qui n'offre pas des éléments de datation.

L'ÉGLISE Nº 7

Elle est formée du naos et du narthex de construction plus récente dans sa partie occidentale. L'abside de forme circulaire est muni d'une fenêtre étroite. Ses murs sont en pierres non travaillées.

* * *

L'architecture des constructions du village en ruine de Kamenice est un ancien témoignage concernant le traitement de la maison d'habitation sur le plan architectonique et de construction. Cette agglomération urbaine relativement bien conservée, se distingue par l'unité profonde caractérisant ses constructions. La maison de Kamenice représente un type d'habitation simple, dont l'étage au rez-de-chaussée n'est pas destiné à l'habitation tandis que l'étage supérieur couvrant une plus grande surface est habitable. La solidité de ses murs en pierre, le minimum d'espace libre destiné à assurer la liaison

DO NOT COPY

avec le milieu extérieur, l'absence de fenêtres et leur substitution par de rares ouvertures en forme de meurtrière confèrent à cette habitation un caractère défensif prononcé. Les maisons de Kamenice se distinguent par leur primitivisme et par leur intérieur qui est des plus simples. L'absence de cheminée montre que le feu était allumé au foyer. La composition de leur volume est déterminée par l'inclination et la nature accidentée du terrain. Les nombreux exemples d'habitations à demi-étage, avec une seule pièce habitable, témoignent que ce type de maison est apparue comme une solution rationnelle dans des conditions de développement relativement peu élevées de la vie économique du village qui exigaient un minimum de deux pièces d'habitation. Un intérêt particulier présente le type d'habitation à kulla, qui, par sa composition et le rapport entre le volume de la kulla et l'habitation vrai et propre, constitue une variante spéciale dans le domaine de l'architecture de la maison albanaise. La bonne qualité de la maçonnerie et des autres éléments constructifs en général nous induisent à penser que Kamenice est l'oeuvre de maîtres professionnels.

Les maisons de Kamenice se rapprochent quant à leur composition avec les habitations en ruine de Mistra, qui ont été décrites par Orlandes.

Le problème le plus difficile à résoudre, et cela en raison de l'absence de données, est celui de la datation des constructions de Kamenice et de la période pendant laquelle le village a été abondonné par ses habitants. L'idée d'un exode massif se fonde sur l'état actuel des ruines, qui sont presque partout de même nature. En ce qui concerne la période de son abandon, il importe de prendre en considération le fait que Kamenice est mentionné dans le Registre de 1583 et qu'il n'est pas mentionné par Celebi à la moitié du XVIIe siècle. Les constructions de Kamenice, comme nous l'avons précisé plus haut, peuvent être chronologiquement réparties en deux groupements. Du premier font part les habitations situées au centre du village et celles édifiées sur les éminences avoisinantes, tandis que les habitations du deuxième groupe, de construction plus récente, sont représentées par celles se trouvant dans la partie SO du village. Les habitations du premier groupe, à notre sens, peuvent être attribuées aux XIVe-XVe siècles et celles du deuxième groupe aux XVe-XVIe siècles. Le premier groupe comprend également l'habitation à kulla N° 1 tandis que la kulla N° 1 appartient vraisemblablement aux XVIe-XVIIe siècles.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Lazër PAPAJANI

KALAJA E PREZËS

DO NOT COPY

Kalaja e Prezës është ndërtuar në pjesën më të lartë të vargut kodrinor, që kufizon fushën e Iiranës në anën veriperëndimore, duke përfshirë krejtësisht sipërfaqen e vogël dhe të thyer të majës së saj. Prej aty zoterohej pjesa veriore e fushës së Iiranes dhe kontrollonej rruga me rendësi ekonomike dhe usntarake, që lidhte Durrësin me Krujën dhe me Shkodrën. Gjithashtu kalaja përbën një pikë komunikimi vizual midis kalave te Durresit, Krujes dhe Petreles.

Kalaja ngrihet në një zonë të pasur ekonomike. Fusha e Iiranes, që shtrihet në lindje të saj, siguronte prodnimet bujqesore, ndërsa kodrat në perendim dhe në veri kanë qenë të veshura pjesërisht me ullishta apo vreshta dhe pjesërisht me kullota për zhvillimin e blegtorisë.

Burimi më i vjetër historik, që bën fjalë për këtë kala është shënimi i Marin Barletit në veprën e tij «Historia e Skënderbeut»[1]). Perveç kësaj ajo përmëndet edhe në një relacion anonim mbi Shqipërinë të vitit 15/0[2]), në relacionin e ambasadorit venedikas Bernardo në vitin 1591[3]) dhe në një koleksion të sixhilateve të sherisë së Elbasanit në vitin 1605[4]).

Ndër studjuesit, i pari që e vizitoi kalanë e Prezës ishte Hani. Mbasi flet për numrin e shtëpive të fshatit, ai përmënd edhe kullën e sahatit, pa bërë fjalë për kalanë[5]). Kalaja përmëndet në studimet e Ipenit[6]) dhe të Shuflait[7]).

Gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, Preza vizitohet kalimthi nga arkeologu austriak Prashniker, i cili jep vetëm disa shënime të shkurtëra. Duke e krahasuar me periudhën e parë të kalasë së Elbasanit, ai presupozon si kohë të ndërtimit të kalasë së Prezës vitet 300-500 të e.sonë[8]).

* *
*

Kodra mbi të cilën është ndërtuar kalaja është një kreshtë shkëmbi shtufore, që zgjatet duke u ulur gradualisht në drejtim veri-jugë. Ndërsa nga lindja zbret në mënyrë të theksuar, ana perëndimore e kreshtës përbën një terren relativisht të sheshtë që është përfshirë nga fortifikimi.

Sipërfaqja e përfshirë brenda mureve ka pasur pjerrësi nga lindja në perëndim, por me kalimin e kohës rrëshqitjet e dheut dhe mbushjet me qëllim, që janë bërë herë pas here e kanë niveluar oborrin e saj deri në një farë mase.

Kalaja ka planimetri katërkëndëshe me brinjë 80 x 50 m (fig. 1). Në përshtatje të thyerjes së terrenit, brinja lindore ka një kthesë me kënd të gjërë.

Kalaja forcohet në qoshe me 4 kulla rrethore, ndërsa në këndin që formohet nga brinja e thyer mbrojtja mjaftohet me ndërtimin e një ballkoni të mbështe-

1) M. Barleti, **Historia e jetës dhe vepravet të Skënderbeut.** Botim i dytë. Tiranë 1967, 249-250.
2) Relacion anonim mbi Shqipërinë. **Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë,** vëll. III, Tiranë 1962, 164.
3) **Po aty,** 171.
4) **Po aty,** 74-75.
5) J. G. von Hahn, **Albanesische Studien,** Jena 1854, f. 31.
6) Th. Ippen, **Alte Kirchen und Kirchen ruinen in Albanien** Wien 1900, 22.
7) M. Sufflay, **Stadte und Burgen Albaniens, hauptsachlich wànrend des mittalalters,** Wien-Leipzig, 1924, 35.
8) C. Praschniker A. Schober. **Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien 1919, 81-82.



Fig. 1

tur në një konsol me harqe tullash. Në murin perendimor, i cili është më i ekspozuar ndaj sulmeve dhe ka një largësi të madhe ndërmjet kullave të qosheve, ka një kullë katërkëndëshe të dalë pak nga muri. Një kullë tjetër katërkëndëshe gjendet edhe në faqen jugore ku ndodhet porta e vetme, e cila forcohet me një oborr të vogël me hyrje drejtuar nga perëndimi.

Nga ndërtimet brenda kalasë përmendim një xhami mbi portë, një sterë të madhe në oborrin e kalasë dhe kullën e sahatit.

Në kala dallojmë katër periudha ndërtimi. Prej tyre periudha e parë përfshin tërë sistemin e fortifikimit. Periudha e dytë ka të bëjë me rindërtime të mureve rrethuese, ndërsa e treta me ndërtimet brenda kalasë. Ndërtimi i kullës së sahatit përbën një periudhë të katërt, që nuk ka të bëjë me sistemin mbrojtës.

Periudha e parë. – Kësaj periudhe i përkasin krejtësisht muret rrethuese të kalasë, që sot ruhen në lartësi të ndryshme. Lartësinë më të madhe e ka muri perëndimor 6,40 m. Për ndërtimin e mureve janë përdorur gurë të nxjerrë nga shkëmbinjtë shtuforë, të vetë kodrës. Themelet e mureve dhe të kullave, që në pjesën më të madhe janë mbështetur në shkëmbin e kodrës, janë ndërtuar me gurë dhe të lidhur me shumë llaç. Edhe në muraturë gurët janë vendosur pa rregull. Llaçi është përdorur në sasi të madhe dhe mbush plotësisht fugaturën ndërmjet gurëve, duke dalë mbi faqen e tij me një trashësi të vogël. Aty ai është fërkuar dhe prerë me mistri, duke kufizuar faqen e gurit me një kornizë në formë vezake ose të rrumbullakët. Një teknikë punimi të njëllojtë me këtë e gjejmë edhe në muraturën e kalasë së Peqinit.

Në gjerësinë e murit dallohen gjurmët e trarëve, që tregojnë se muri ka qenë lidhur me breza druri të përforcuar me breza më të hollë transversalë. Trarët, që kanë pasur seksion kuadratik ose të rrumbullakët me diametër 0,10 – 0,14 m., kanë qenë vendosur 15-20 cm. thellë nga faqja e murit dhe gati 1 m. larg nga njeri-tjetri.

Mbi mur, në trashësinë e tij që lëviz nga 1,30 deri 1,40 m., veçohet një trap me gjerësi 0,65 – 0,85 m. për qëndrimin dhe lëvizjen e luftëtarëve. Parapeti me bedenat kanë një gjerësi konstante prej 0,60 m. Nga disa gjurmë që shohim pranë murit të kullës jugore del se lartësia e bedenit ishte rreth 1.70 m., ndërsa ajo e parapetit rreth 1 m. Po në trashësinë e murit jugor, përfshihen edhe një palë shkallë. Bazamaku i tyre është i gjatë 0.65 m., prej të cilit 0,25 m. dalin nga faqja e murit, për të shtuar gjerësinë e shkallës pa prekur atë të murit. Në murin perëndimor shkallët sot nuk është e mundur të shihen, mbasi muri është i mbuluar me dhe deri në pjesën më të lartë të tij. Në murin lindor dhe atë verior këto mungonin, sepse dalja në trapet e këtyre mureve, kryhej nëpërmjet kullave nr. 1-4.

Kullat e qosheve kanë formë të plotë rrethore me diametër 3,5 – 4,25 m. Tipike është se harku vazhdon edhe brenda oborrit të kalasë (fig. 13 A.D.). Kulla katërkëndëshe në anën perëndimore me përmasat 4,30 x x 0,85 m. nuk krijon ambient të brendshëm. Ai është ndërtuar si muri rrethues, me bedena dhe me trap më të gjerë.

Në qoshen prej gati 135º në murin jugor nuk është ndërtuar kullë. Në lartësinë e trapit janë krijuar tre konsola prej guri dhe, mbi to, janë ndërtuar dy harqe me tulla, mbi të cilët ka qenë një ballkon për të kontrolluar vendin që shtrihet para tij (fig. 2). Një ballkon i tillë duhet të ketë qenë edhe në murin perëndimor, ndërmjet kullës jugore dhe asaj këndrejtë, aty ku sot shohim 8 gurë të dalë nga muri dy nga dy në formë konsoli (fig. 3). Përdorimi i këtyre konsolave nëpër kala është i njohur qoftë si për ndërtimin e ballkoneve mbi to, ashtu edhe për shtimin e sipërfaqeve të kullave.

Muratura e kullave karakterizohet nga e njëjta teknikë si e murit rrethues. Më me kujdes është punuar fasada e kullës nr. 1 me që ajo ndodhet pranë rrugës

DO NOT COPY

dhe hyrjes për në kala. Në pjesën e poshtme të kësaj kulle, së bashku me gurët mesatarë janë përdorur edhe gurë të një mase pak më të madhe. Në disa raste atyre u është dhënë forma kubike dhe anash, janë ndarë prej njeri-tjetrit me nga një tullë. Po kështu janë përdorur edhe copa tullash, ndërmjet gurëve. Në lartësinë 2,40 m. kullën e rrethon një brez prej dy radhë tullash me lartësi 12 cm. Të gjithë gurët e radhës së parë të vendosur mbi brezin e tullave, kanë afërsisht formën kubike dhe ndahen me tulla të vendosura vertikalisht 3,40 m. mbi brezin e parë. Kulla rrethohet nga një brez i dytë prej dy rreshta tullash, por me një gjerësi 0,25 m. Distanca midis rreshtave përshkohet nga një ornament zigzag prej tek tulle (fig. 4).

Kullat kanë pasur lartësi të ndryshme. Gjithashtu ka një diferencë, ndërmjet lartësisë së jashtme dhe asaj të brendshme, për arësye të terrenit të pjerrët. Në krahasim me murin rrethues kullat duhet të kenë qenë edhe 50-70 cm. më të larta dhe të mbuluara me çati.

Në pjesën e kullës, që është nga oborri i kalasë, është krijuar një trap nga ana e jashtme, i cili, lidhet me trapet e mureve pranë, kështu sigurohet lidhja midis trapeve pa qenë nevoja të kalohet nëpër kullë (fig. 19 C. F).

Luftimi nga kullat zhvillohej nëpërmjet frengjive. Ndërmjet brezit të parë të tullave dhe brezit të dytë, në kullën nr. 1, janë vendosur dy frengji të rrumbullakta. Njëra prej tyre është e drejtuar nga jugu dhe kontrollon rrugën që vjen për në kala, ndërsa frengjija e dytë kontrollon zonën para murit perëndimor. Në kullën nr. 2 janë prishur krejtësisht frengjitë me ndërtimin e kullës së sahatit. Në kullën nr. 3 ka tri frengji: njera kontrollon faqen e murit lindor, tjetra muri perëndimor dhe e treta, në mes, territorin para kullës. Edhe në kullën e katërt janë tri frengji: dy kontrollojnë vendin para mureve veriorë dhe perëndimorë dhe e treta zonën para kullës.

Të gjitha frengjitë janë të ndërtuara me të njejtën mënyrë, me ndryshime të vogla. Nga jashtë ato janë punuar në mënyrë dekorative. Rreth një hapësire rrethore 0,18 – 0,32 m. janë vendosur tulla në formë rrezesh të kufizuara nga një kornizë rrethore tullash. Frengjija jugore e kullës nr. 1 kufizohet me 4 rrathë koncentrikë (fig. 5), ajo veriore me dy rrathë, ndërsa në frengjinë jugore të kullës nr. 4 vetëm me një rreth (fig. 6). Edhe nga brenda kullave frengjitë janë të ngjashme me njëra-tjetrën. Ato kanë formë dritaresh katërkëndëshe me gjerësi dhe lartësi që lëviz nga njera tek tjetra (gjerësia 0,76 – 0,98 m. dhe lartësia 1,35 – – 1,40 m). Nga sipër janë të mbuluara me qemer cilindrik prej tullash me lartësi 0,30 m. Tullat janë të lidhura me një shtresë të trashë llaçi gati sa gjerësia e vetë tullës, i cili del jasht faqes së saj dhe kufizohet me anë të një të thelluar të lehtë në formë të një kanali. Në



Fig. 2



Fig. 3

FOR NOT COPY



Fig. 4

ballë, frengjitë vijnë duke u ngushtuar, deri sa kufizohen me një mur të hollë, ku ndodhet hapësira në formë rrethi (fig. 7). Në pjesën e sipërme të kullave ka pasur edhe frengji të tjera më të vogla me anën e të cilave kryhej plotësisht vëzhgimi i zonës rreth kalasë, por prej tyre nuk ruhet sot asnjë.

Secila kullë komunikon me oborrin e kalasë nëpërmjet një porte. Në kullën nr. 1, porta 1,70 m. e lartë dhe 0,90 m. e gjërë, është vendosur në nivelin e dritareve të frengjive. Në faqen e jashtme të kullës, porta është mbuluar me hark të mprehtë tullash, të kufizuar nga sipër me një rresht tullash. Hapësira nën kurbaturën e harkut është mbushur me muraturë guri që përshkohet vertikalisht nga një ornament zigzag prej tullash. Në kundërshtim me sa mund të pritej, mbushja në pjesën e poshtme është e kufizuar me një rresht tullash të vendosura horizontalisht, të cilat vetëm imitojnë piatabandën (fig. 8). Mungesa e kësaj të fundit ka bërë që në kullat e tjera mbushja nën hark të bjerë, duke zbuluar sipërfaqen e çrregullt të muraturës. Përsa i përket mbulimit të portës ka një ndryshim midis kullës Nr. 1, ku harku nuk vazhdon më në thellësi, dhe portave të tjera, të cilat janë mbuluar me qemerë të plotë cilindrikë (fig. 9).

Kullat kanë pasur edhe kat të dytë. Trarët e dyshemesë mbështeteshin në trapet që krijoheshin në pjesën e brendshme të kullave, duke krijuar një shesh të mjaftueshëm pranë parapetit që, edhe në këtë kohë, duhet të ketë qënë me frengji. Në pjesën tjetër të hapësirës, që nuk mbulohej nga dyshemeja, me sa duket kanë qenë shkallë prej druri. Në kullën Nr. 1, shkallët duhet të kenë pasur në nivelin e portës një vendpushim 0,85 m. të gjërë, që e lidhte kullën me trapin e murit perëndimor (fig. 10), ndërsa dyshemeja ndodhet gati 1 m. më lart. Në këtë mënyrë mund të kalohej direkt nga trapi i murit perëndimor në katin e poshtëm ose në katin e dytë të kësaj kulle.

Në kullën Nr. 4 nuk vërehet mundësia për të kaluar nga trapet e mureve brenda në kulië. Në dy ku-



Fig. 5

DO NOT COPY

llat e tjera Nr. 2 dhe 3, kjo pjesë e murit është e dëmtuar.

Kalaja ka funksionuar vetëm me një hyrje, që është vendosur në mes të gjatësisë së faqes së murit jugor, në një kullë katërkëndëshe të nxjerrë nga muri 0,85 m. dhe me ballë të gjerë 1,16 m. Porta e kalasë mbyllet sipër me qemer cilindrik të shtrirë. Në fasadë ajo përfshihet nga një katërkëndësh i dalë 7 cm. Mbi këtë është ndërtuar një hark tjetër i dalë nga muri 22 cm., që përfundon me majë në kulm. Edhe ky përfshihet nga një kuadrat i dytë, që del me reliev nga faqja e murit 7 cm. (fig. 11). Qëllimi ndërtimit të tij është kryesisht dekorativ, mbasi harku nuk kryen asnjë funksion. Harku funksional, i ndërtuar me tulla,[9]) gjendet ndërmjet tyre dhe ka kurbë të plotë cilindrike, që përbën vazhdimin e qemerit me gur të koridorit të hyrjes.



Fig. 6

Porta ka qenë me dy kanata, mbylljen e të cilave e siguronte një tra me seksion kuadratik, që lëvizte në mënyrë horizontale brenda një zgavre në krahun e majtë të shpatullës së hyrjes. Ndërsa në krahun tjetër, përballë saj, është një zgavër më e vogël, që shërbente për vendosjen e traut kur mbyllej porta.

Hyrja në pjesën e brendshme vazhdon me një koridor të gjatë 4,50 m. të mbuluar me qemer guri, që të nxjerrë në oborrin e kalasë (fig. 12 A). Në të dy krahët ai zgjerohet me dy nike të mbuluara me qemer më të ulët dhe tërthor me atë të koridorit. Në krahun e djathtë të koridorit janë dy ambiente të vogla me hyrje nga oborri i kalasë.

Mbi koridor duhet të ketë qenë një ndërtesë për banimin e garnizonit ose me karakter administrativ. Prej kësaj ndërtese sot ruhet vetëm faqja e murit që ngrihet mbi portën me harqet.

Për arsye të territorit të vogël që përfshinte kalaja brenda nuk duhet të ketë pasur banesa familjare. Për strehimin e ushtarëve të garnizonit, përveç kullave përdoreshin, me sa duket, godina me konstruksion të lehtë.

Periudha e dytë. – Ndërtimet e kësaj periudhe zënë një volum mjaft të vogël dhe janë, në më të shumtën e rasteve rindërtime të pjesëve të kalasë. Muratura është e thjeshtë, me përdorim të pakët llaçi, i cili nuk kalohet më në formë kornize mbi sipërfaqen e gurëve. Këtë teknikë e gjejmë në kullën Nr. 1, në murin e ndërtuar mbi brezin e dytë të tullave. Në këtë pjesë muri janë vendosur dy radhë frengjish. Ato të radhës së parë janë pesë dhe gjënden 50-60 cm. mbi trapin ku mbështetet dyshemeja, që i takon periudhës së parë, ndërsa ato të radhës së dytë janë gjashtë të vendosura në lartësi të ndryshme nga dyshemeja, prej 0,80 deri 1,10 m (fig. 13).

Frengjitë janë të thjeshta në fa mën e një drita-reje me gjërësi 0,30-0,55 m. dhe lartësi 0,33-0,55 m. Nga ana e brendshme e kullës ato janë më të gjëra se në pjesën e jashtme. Në dy frengji të radhës së parë vemë re, përkatësisht një dhe dy të çara vertikale.

Mbi trapet e jashtme të kullave Nr. 3 dhe 4, në këtë periudhë është ndërtuar një muraturë me lartësi rreth 0,40 m. e nxjerrë nga faqja e murit rreth 0,10 –

9) Tullat e harqeve të saj janë të një masë me ato të hyrjeve dhe të frengjive në të gjitha kullat, si edhe me tullat që formojnë dy brezat në kullën nr. 1, prandaj mund të mendojmë për ndërtime të një kohe.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

– 0,15 m. në formë kornize. Ndërtimi i saj është bërë për të shtuar sipërfaqen e trapit që përdorej si vend kalimi nga një mur në tjetrin (fig. 14).

Në këtë periudhë korridori që ndodhet pranë hyrjes zgjerohet. Në të dy krahët atij i shtohet nga një galeri 2m e mbuluar me qemerë. Në njerën anë ajo del përsëri në oborrin e kalasë, ndërsa në anën e kundërt ajo ndërtohet me qëllim që të lihet i lirë komunikimi me dy ambientet e vogla të periudhës së parë (fig. 12 B). Zgjerimi i kësaj pjese nuk duhet të jetë bërë për ndonjë qëllim të caktuar për katin e poshtëm, se sa për zgjerimin e sipërfaqes së godinës, në pjesën e sipërme.



Fig. 9

Nga jashtë porta mbrohet me një oborr të rrethuar me tri faqe muri të mbështetura në murin e kullës së portës dhe me hyrje nga perëndimi (fig. 12 B). Në këtë periudhë duhet të jetë ndërtuar edhe stera në oborrin e kalasë, ujë i së cilës grumbullohej me anë tubash balte nga çatia e godinës, pranë portës.

Periudha e tretë. – Në këtë periudhë është ndërtuar xhamia, mbi sipërfaqen që krijohet nga ambientet pranë hyrjes. Ndërtesa e periudhës së parë dhe të dytë, që duhet të ketë qënë këtu, me kalimin e kohës është dëmtuar ose është prishur për t'i lënë vend ndërtimit të xhamisë.

Edhe xhamia vetë, me kalimin e kohës, ka pësuar ndryshime. Ajo është shtuar në drejtim të lindjes, duke e zgjeruar sipërfaqen e saj, afërsisht sa gjysma e pjesës ekzistuese. Po kështu edhe dritaret nga perëndimi janë mbyllur me mur (fig. 15).

Periudha e katërt. I kësaj periudhe është ndërtimi i kullës së sahatit, mbi kullën mbrojtëse të anës lindore të kalasë, në një kohë kur ajo kishte humbur karakterin mbrojtës[10]).

Karakteri dhe koha e ndërtimit të kalasë. – Kalaja ka qenë e vogël dhe e pafuqishme për t'u bërë ballë luftimeve dhe rrethimeve të gjata. Qëllimi i ndërtimit të saj ka qenë vrojtimi mbi rrugët e rëndësishme ekonomike dhe ushtarake, që kalonin poshtë saj, në-

për fushën e Tiranës. Gjithashtu, garnizoni i kalasë mund të siguronte edhe mbledhjen e taksave dhe të detyrimeve të tjera nga popullsia e krahinës.

Në pjesën ku bën fjalë për vendosjen e ushtrisë turke, në rrethimin e Krujës, Barleti[11]) përmënd fushën e Tiranës, që e vendos ndërmjet qytetit të Krujës dhe qytezës së parthinëve. Më poshtë tregon se kjo e fundit në këtë kohë quhej me emrin Prezë dhe është në gjëndje gërmadhe. Kufizimi që i bën fushës së Tiranës dhe përcaktimi i vendit të qytezës së Presës është mjaft i saktë, prandaj nuk mund të mendohet në këtë rast se mund të jetë fjala për ndonjë vend tjetër.

Në një relacion anonim të vitit 1570 përmëndet edhe kalaja e Prezës, për të cilën thuhet se u ndërtua para disa kohësh nga turqit[12]). Prej kësaj duket se është nisur Shuflai, i cili e radhit Prezën krahas kalasë së Elbasanit, që dihet se turqit e ndërtuan mbi bazat e një kalaje më të vjetër.

Prashniker është përpjekur të dallojë dy periudha ndërtimi, sidomos në kullën jugore (Nr. 1) dhe në atë juglindore (Nr. 2). Në kullën jugore ai veçon muraturën deri në rreshtin e parë të tullave, si të periudhës së parë, ndërsa në atë lindore, muraturën në pjesën e poshtme të saj. Në fakt, një vrojtim i kujdesshëm do të shikonte aty një periudhë të vetme dhe gabimi i Prashnikerit mund t'i detyrohet kohës së kufizuar që ai pati në dispozicion[13]). Kjo pjesë e muraturës është punuar me një teknikë dhe, llaçi ka të njëjtën përbërje me atë që ai e quan periudhë të dytë. Edhe tullat e plota që përdoren këtu, kanë të njëjtat përmasa me ato që përdoren në pjesët e sipërme të kullës, si dhe në qemeret e portave dhe frengjive në kullat e tjera të kalasë.

Gjithashtu nuk ka vend për të bërë asnjë paralelizëm me kalanë e Elbasanit, qoftë nga forma planimetrike apo teknika e ndërtimit. Kullat e qosheve në kalanë e Elbasanit nuk kanë formë të rrumbullakët, ato dalin me faqe të drejta nga muret dhe pastaj rrumbullakosen, ndërsa kullat ndërmjetëse kanë formën e germës U. Në ndryshim me kalanë e Prezës, në muraturën e saj, në vend të brezave prej druri përdoren brezat me katër rreshta tullash.[14]) Në Prezë, brezat e tullave përdoren vetëm në një kullë (Nr. 1) dhe aty me qëllim dekorativ. Si rrjedhim, përfundimet e Prashnikerit në lidhje me kohën e ndërtimit të kalasë së Prezës, duke e krahasuar me atë të Elbasanit janë të gabuara.

Megjithatë, problemi i datimit të saktë të kalasë nuk është i thjeshtë. Përmendja e kalasë nga Barleti tregon se ajo duhet të jetë ndërtuar para rrethimeve të Krujës nga turqit, prandaj relacioni anonim i vitit 1570 nuk është i saktë. Në vitin 1466, sipas Barletit, ajo është në gjëndje gërmadhe. Për të arritur në këtë gjëndje, ajo duhet të ketë qenë braktisur me kohë, me sa duket në fillim të luftrave të Skën-



Fig. 10

DO NOT COPY

10) Përveç këtyre punimeve, që i vendosëm në katër periudha, në kala janë bërë punime edhe kohët e fundit, sipas qëllimit që ajo përdorej.

Gjatë Luftës së Parë Botërore dhe më vonë, kalaja është përdorur si kamp përqëndrimi. Gjurmët e telave me gjëmba dhe të disa punimeve me beton shihen edhe sot. Po në këtë kohë bëhet edhe nivelimi i oborrit të kalasë.

Në vitin 1937-1938 në kala u kryen disa punime për ta bërë një vend turistik. Muri perëndimor u ngrit gati në të gjithë gjatësinë e tij 1m. mbi gurët e dalë në formë konsoli, duke ruajtur gjërësinë e parapetit, dhe duke e kaluar lartësinë e tij të vjetër, ndërsa kulla Nr. 3 u përdor si kafe. Dyshemeja dhe shtresa e sipërme e saj u shtruan me beton dhe betonarme. Dy prej frengjive u kthyen në dritare, në murin ndërmjet tyre u ndërtua një oxhak. Në pjesën e sipërme të kullës u ndërtuan bedena, duke përfshirë edhe pjesën nga oborri i kalasë. Në murin verior janë ndërtuar një palë shkallë guri për t'u ngjitur në katin e dytë të kësaj kulle.

Po në këtë kohë u rindërtua dhe kulla e sahatit duke mos ruajtur formën e vjetër.

11) M. Barleti, **vep. cit.,** 249-250.

12) Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë vëll. III, 164.

13) C. Praschniker, **po aty.**

14) Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Elbasanit,** «Monumentet» 1/1971, 61.

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 13

Fig. 14





Fig. 12

derbeut me turqit, si një kala e dobët që nuk ishte në gjëndje ti rezistonte luftimeve dhe rrethimeve të gjata. Prandaj si periudhë më e mundshme për ndërtimin e saj, duhet të jetë fillimi i shek. XV nga Topiasit, zotëruesit e kësaj zone. Kjo mbështetet edhe nga përdorimi i elementeve karakteristike të arkitekturës vendase të shek. XV. Kështu harku dekorativ në formë qepe, mbi portën kryesore të kalasë, përsërit të njejtën formë që e ndeshim në hyrjen tek oborri i brendshëm i kalasë së Shkodrës, ndërtuar midis viteve 1405-1416[15]). Po kështu harku me majë, i përdorur në njerën prej hyrjeve të kullave, ndeshet rëndom në kishat e shek. XIV.[16]).

Nuk dijmë fatin e mëtejshëm të kësaj kalaje, por duket se ajo u braktis në kohën e Gjon Kastriotit dhe vetë i biri i tij Gjergji nuk e rindërtoi më.

Mbas pushtimit të Krujës, kur turqit rivendosën pushtetin e tyre, asaj i bëhen disa rindërtime, ndërmjet të tjerave ndërtohet edhe xhamia mbi portë. Këto punime rindërtimi janë konsideruar në dokumentat dhe autorët e përmëndur si ndërtime të mirëfillta të kalasë. Në fakt kësaj kohe mund t'i takojnë vetëm përforcimi i portës, nëpërmjet të oborrit të vogël të rrethuar me një mur të dobët, si edhe ndërtimi i sterës në oborrin e kalasë, pra, periudha e dytë dhe e tretë e ndërtimeve.



Fig. 15

Kulla e sahatit që është nga ndërtimet e fundit, duhet të jetë ngritur gjatë periudhës 1800-1850, sepse në vitin 1852-3 përmëndet nga Hani[17]), i cili në këtë vit vizitoi fshatin e Prezës. Në faqen e kullës nga oborri i kalasë, shikohen dy gurë të gdhendur me mbishkrime fetare në gjuhën turke dhe arabe. Në fund të mbishkrimit të dytë lexohet data 1275 Hixhri, që i përket vitit 1859[18]). Duke ditur se kulla është parë nga Hani para kësaj date, del se mbishkrimet janë vendosur më vonë, ndoshta në ndonjë rast meremetimi të kullës.

Punimet e restaurimit. — Në vitin 1966 në kala u kryen punime: pastrimi, konservimi dhe restaurimi.

Me kalimin e kohës dherat e kanë mbushur pjesën perëndimore të oborrit të kalasë, deri në pikën më të lartë të murit. Dheu kishte mbushur njëkohësisht edhe dy kullat, që ndodhen në qoshen jugore Nr. 1 dhe atë veriperëndimore Nr. 4.

Gjatë këtij viti u pastruan këto dy kulla, duke dalë plotësisht pjesa e brendshme e frengjive dhe portat, që lidhnin kullën me oborrin e kalasë. Përveç këtyre kalasë iu bë një pastrim i përgjithshëm, brenda dhe jashtë, nga shkurret dhe dherat. Gjithashtu ndërhyrje të domosdoshme kërkonte gjendja e muraturës, sidomos në murin perëndimor.

Duke filluar nga kulla veriperëndimore Nr. 3 deri tek kulla jugore Nr. 4 muri perëndimor ishte anuar nga jashtë. Pika më e theksuar ishte në kullën katërkëndëshe. Për këtë lëvizje ka influencuar mbushja me dhe e oborrit të kalasë, si edhe presioni i ushtruar nga rrënjët e pemëve pranë murit. Pranë themelit të kullës katërkëndëshe ku animi ishte shumë më i theksuar u bë një sondazh për ta parë gjëndjen e tij. Si rezultat i sondazhit doli se themeli i kullës pjesërisht ishte prishur, dhe pjesërisht kishte rrëshqitur, prandaj ishte i domosdoshëm ndërtimi i një themeli me bazament të gjërë për t'u mbështetur muratura e kullës, dhe për të evituar mënjanimin e mëtejshëm të saj.

Gjithashtu një pjesë e murit, ndërmjet kullës katërkëndëshe dhe kullës Nr. 3, duke e patur themelin e dëmtuar ishte shembur. Në këtë mënyrë ishte dëmtuar e gjithë muratura në pjesën e sipërme duke plasur në breza. Fugat ndërmjet brezave ishin hapur në

15) V. Kamsi **Kështjella e Shkodrës dhe restaurimi i saj** «Monumentet» 1, 1971, 166, fig. 3.
16) A. Meksi **Tri kishat bizantine të Beratit «Monumentet» 4, Dy ndërtime trekonkshe në** këtë numër.
17) J. G. Hahn, **vep. cit.,** 91.
18) Falënderojmë A. Zarshatin që pati mirësinë t'i lexojë mbishkrimet dhe të na japë datën e saktë të tyre.

DOKUMENT



Fig. 16



Fig. 17

DO NOT COPY

distanca të mëdha 20-30 cm., gjë që rrezikonin shembjen e plotë të murit (fig. 16), por dheu që e mbushte nga brenda dhe ai i grumbulluar jashtë tij, siguronin në një farë mase qëndrueshmërinë.

Me pastrimin e dheut, u krijua një boshllëk që rrezikonte rënien e blloqeve të muraturës të palidhur me njeri-tjetrin dhe me murin në pjesën e sipërme. Për sigurimin e tyre nga rënia gjatë punimeve u forcuan me shtylla dhe pajanta, duke krijuar në këtë mënyrë mundësinë për të punuar. Për të pasur muri qëndrueshmëri, themeli u ndërtua i gjërë, duke dalë nga faqja e murit rreth 40-50 cm. Mbi të u ndërtua një mur i shkallëzuar deri sa arriti në faqen e murit rrethues. Në këtë mënyrë për këto blloqe u krijua një mbështetje e fortë, që siguroi qëndrueshmërinë e gjithë faqes.

Përveç kësaj, duke qenë i pamundur afrimi i blloqeve me njeri-tjetrin dhe me murin në pjesën e sipërme, boshllëku midis tyre u mbush me llaç dhe në disa raste edhe me gurë.

Punime konservimi u kryen edhe në bazamentin e kullës Nr. 4. Themeli i saj kishte dalë jashtë nga rrëshqitja e dheut, duke krijuar mundësinë e dëmtimit të tij. U pa e nevojshme të ndërtohej një mur paralel me kullën dhe murin perëndimor dhe, hapësira ndërmjet tyre të mbushej me dhe, duke mbuluar në këtë mënyrë gurët e themelit. Punime me karakter konservimi u kryen edhe në pjesë të tjera të murit rrethues, në mënyrë që të pengohet dëmtimi i tyre i mëtejshëm.

Muri në pjesën e sipërme të kullës Nr. 4, pra, muri i periudhës së dytë, ishte dëmtuar në disa vënde së bashku me dy rradhët e frengjive. Duke u nisur nga gjurmët që kishin mbetur dhe nga forma e atyre që ishin të paprekura, u pregatit projekti i restaurimit. Mu-



Fig. 18

ratura u ndërtua, duke iu përshtatur teknikës së murit të periudhës së dytë. U restaurua gjithashtu edhe porta e kullës Nr. 3, që lidhet me oborrin e kalasë. Për ndërtimin e saj u muar si bazë harku i portës në kullën Nr. 1. Kështu që harku u ndërtua me majë në kulm, i kufizuar lart dhe poshtë me tulla. Hapësira e harkut u mbush me mur guri, në ndryshim me atë të kullës Nr. 4 që e ka me gurë dhe tulla të vendosura në mënyrë dekorative. Krahas restaurimit të portës, në kullë u kryen edhe punime me karakter konservimi, duke mbushur disa të çara dhe zgavra të vogla, që ishin hapur në pjesë të ndryshme të murit.

Restaurimi i kullës së sahatit. – Nga punimet e restaurimit në kala, volumin më të madh e zuri kulla e sahatit. Kjo ngrihet mbi kullën mbrojtëse të anës lindore Nr. 2 të kalasë. Muret e saj kanë një trashësi prej 1m. Ato nuk ndjekin formën e rrumbullakët të kullës mbrojtëse, por ngrihen mbi një bazë katrore me gjatësi 4,20 m. kulla është e lartë nga toka rreth 12 m. (në anët e ndryshme s'ka lartësi të barabartë). Në lartësinë 9 m. kulla përshkohet nga një kornizë guri me profil të rrumbullakët.

Për komunikimin në pjesën e brendshme të saj shërben porta e kullës së rrumbullakët. Në pjesën e sipërme hyhej, me sa duket, me shkallë druri, nëpërmjet hapësirës së brendshme, që është në formë katrore me dimensione 2,20 x 2,20 m.

Siç e kemi thënë edhe më sipër, gjatë viteve 1936-37 kulla ishte rindërtuar duke e ndryshuar formën e vjetër. Ky transformim ishte bërë në pjesën mbi kornizën prej guri. Në secilën faqe të saj që vendosur nga një rreth me diametër 1m. me një kornizë të profiluar për vendosjen e fushave të orës. Pjesa sipër saj ishte e ndarë në tri hapësira drite të mbuluara me qemer tullash (fig. 17). Për arësye të ndryshimeve që u



Fig. 19

DO NOT COPY

bënë, kjo pjesë e kullës u ngrit edhe 1,10 m. më lart nga ajo ekzistuese.

Goditjet e herëpasherëshme të rrufeve e kthyen atë në një gjëndje gjysëm të rrënuar. Qoshja jugore e saj ishte krejtësisht e rrëzuar, së bashku me pjesën më të madhe të faqes jugore, të një pjese të qoshes jug lindore, si edhe të çatisë së saj.

Gjurmët e formës së vjetër dalloheshin në disa pjesë, por ishin të pamjaftueshme për pregatitjen e projektit. Nga ana tjetër edhe në banorët e fshatit flitej për rindërtimin dhe ndryshimin e formës së saj, duke mbajtur mend formën e vjetër, që e krahasonin me atë të kullës në kalanë e Krujës. Më në fund u gjet edhe një fotografi[19]), që tregon kullën në gjëndjen e periudhës së parë. Së bashku me kullën e sahatit në fotografi tregohet edhe një pjesë e murit rrethues të kalasë, kështu që indentifikimi i saj me kullën e kalasë së Prezës është i saktë.

Në bazë të fotografisë dhe gjurmëve, që dalloheshin në vetë kullën, pregatitet projekti, në bazë të të cilit u krye restaurimi i plotë.

Puna për restaurimin e kullës paraqiste vështirësi, për arsye të lartësisë, prandaj u ndërtuan dy skela, një në brendësi të kullës dhe tjetra në pjesën e jashtme, pranë dy faqeve ku do të punohej. Qoshja u punua me gur të gdhendur ashtu si dhe pjesët e tjera dhe muratura në përgjithësi u punua me teknikën e mureve ekzistuese.

Kulla u kthye në gjëndjen fillestare. Në bazë të gjurmave u caktua lartësia e kollonave mbi kornizë (2,60 m.), si dhe gjerësia e tyre. U hoq e gjithë murature e ndërtuar në vitin 1936 – 37. Në katër qoshet e saj u ndërtuan katër kollona me gur të gdhëndur, mbi të cilat u mbështet çatia[20]) (fig. 18).

Pas punimeve konservuese dhe restauruese, kalaja e Prezës na paraqitet me vlerat e vërteta arkitektonike si një nga fortifikimet tipike të mesjetës feudale paraturke më të ruajtura të Shqipërisë së Mesme.

DO NOT COPY

19) Gjatë pregatitjes së projektit K. Zheku gjeti një fotografi të gjëndjes fillestare të kësaj kulle në librin e F. Bauchman, **Albanien, Land Zwichen Gestern und Morgen,** 1942.

20) Punimet në kala dhe në kullë janë kryer nga Ateljeja e Monumenteve të Kulturës në Durrës me përgjegjës F. Miraj. Projekti për ndërtimin e çatisë është pregatitur nga Ing. S. Bejko. Rilevimet dhe skicat janë punuar nga A. Drazhi, F. Guralumi dhe P. Katroshi, ndërsa fotografitë nga K. Zheku, R. Veseli dhe A. Baçe.

Me këtë rast falenderojmë L. Cenollarin që na vuri në dispozicion rilevimin e plotë topografik të kalasë së Prezës.

Lazër PAPAJANI

LA FORTERESSE DE PREZE

RESUME

La forteresse de Preze se dresse dans la partie la plus élevée de la chaîne de collines délimitant la plaine de Tirana en direction NO et couvre entièrement la petite surface accidentée constituant le sommet de cette chaîne. Elle domine la partie septentrionale de la plaine de Tirana et contrôle la route reliant Durres à Kruje et à Shkoder.

Cette forteresse s'élève au centre d'une zone économiquement riche.

La plus ancienne source écrite historique faisant état de ce monument est une note de Marin Barleti insérée dans son «Histoire de Skanderbeg». Par ailleurs elle est également mentionnée dans une relation anonyme sur l'Albanie de l'an 1570, dans une relation de l'ambassadeur vénitien Bernardo et dans le sigillaire du Sherryat d'Elbasan de l'an 1609.

Pendant les années de la Première Guerre mondiale, Preza a fait l'objet d'une brève visite de la part de l'archéologue autrichien Praschniker.

* * *

En ce qui concerne la planimétrie cette forteresse, elle est rectangulaire avec des côtés d'une dimension de 80 x 50 m. (Fig.). S'adaptant à la nature accidentée du terrain, le côté oriental fait un détour à angle plus large.

Les quatre angles de la forteresse sont flanqués d'une tour circulaire, tandis que son angle constitué par le côté accidenté est renforcé d'un balcon reposant sur une console à arcs de briques. En ce qui concerne son mur occidental, qui est plus exposé aux éventuelles attaques de l'ennemi de l'extérieur et se trouve plus éloigné des tours angulaires, il est doté d'une tour rectangulaire dépassant légèrement ce mur. Une autre tour rectangulaire se dresse sur la face méridionale de la forteresse, où a été aménagée la seule porte qui est renforcée d'une petite cour dont l'entrée regarde vers l'occident.

Cette forteresse se caractérise par quatre périodes différentes de construction, dont la première comprend tout le système de fortification. La deuxième période de construction se rattache aux travaux effectués dans la partie intérieure de la forteresse. La construction de la tour de l'horloge représente la quatrième période qui n'a aucun avec le système de défense.

La première période. — *C'est à cette période que se rattache entièrement la construction des murs d'enceinte conservés actuellement à différentes hauteurs. Le mur occidental haut de 6,40 m. est le plus élevé. La maçonnerie se caractérise par une disposition irrégulière des pierres et un emploi abondant du mortier qui remplit entièrement le joint entre les pierres et apparaît sur le parement moins épais du mur.*

Au-dessus du mur, d'une épaisseur variant de 1,30 à 1,40 m., se trouve la plateforme de défense dont la largeur varie de 0,65 à 0,85 m.

Les tours disposées aux angles de la forteresse présentent une forme entièrement circulaire et ont un diamètre allant de 3,5 à 4,25 m. Une caractéristique typique de ces tours est la fait que leur arc se prolonge à l'intérieur de la cour de la forteresse.

Un soin particulier a été consacré à l'aménagement de la façade de la tour № 1, et cela du fait qu'elle se trouve à proximité de la route et de l'entrée à la forteresse.

A 2.40 m. de hauteur cette tour est entourée d'une bande de deux rangées de

DO NOT COPY

DO NOT COPY

briques hautes de 18 cm. A une hauter de 3.40 m. de la première bande, la tour est entourée d'une deuxième bande à deux rangées de briques d'une largeur de 0.26 m. La distance séparant les différentes rangées est agrémentée d'un ornement en zigzag à une seule brique.

En comparaison au mur d'enceinte, les tours doivent avoir été 50-70 m. plus hautes et couvertes d'une toiture.

La tour se dressant à proximité de la cour de la forteresse est munie d'une plate-forme extérieure, qui se rattache aux plates-formes des murs avoisinants, de manière à communiquer avec elles et éviter le passage à travers la tour.

Toutes les meurtrières sont construites de la même manière, à quelque différence près. Elles sont ornées à l'extérieur par des cercles limités par une corniche circulaire de briques. A l'intérieur même de la tour les meurtrières sont semblables les unes aux autres, elles ont la forme d'une fenêtre rectangulaire dont la largeur et la hauteur varient d'une meurtrière à l'autre (elles sont larges de 0,76-0,98 m. et hautes de 2,35-1,40 m.) et couvertes d'une voûte cylindrique de briques.

Chanune des tours communique avec la cour de la forteresse à travers une porte. En ce qui concerne la tour N° 1, sa porte haute de 1,70 m. et large de 0,90 m. est aménagée au niveau des fenêtres des meurtrières. Sur la face extérieure de la tour, cette porte est couverte par un arc en ogive de briques. Contrairement à ce que l'on pouvait s'attendre, le remplissage dans la partie inférieure se borne à une seule rangée de briques disposées horizontalement et imitant seulement la plate-bande.

Les tours étaient munies d'un étage supérieur. Les travées du plancher reposaient sur les plates-formes situées dans la partie intérieure des tours, qui créaient de la sorte un espace suffisant à proximité du parapet doté de meurtrières. Dans le reste de l'espace non recouvert par le plancher, on avait aménagé des escaliers en bois.

En ce qui concerne la tour N° 4, elle n'offre pas la possibilité de passage des plates-formes à proximité des murs, que ce soit septentrional ou occidental, à l'intérieur de la tour. Dans les deux autres tours, celles NN°° 2 et 3, une partie du mur est endommagée.

La forteresse de Preze avait une seule entrée. A l'intérieur cette entrée se prolonge par un couloir, couvert d'une voûte de pierres et menant à la cour de la forteresse. Des deux côtés elle s'élargit de deux niches recouvertes par une voûte plus basse et disposée tranversalement à celle du couloir. Du côté droit du couloir se trouvent deux petites pièces donnant sur cour de la forteresse.

Au-dessus du couloir avait été jadis aménagée un habitation servant de séjour à la garnison ou de locaux aux bureaux de l'administration. Actuellement on ne voit que le parement du mur surmontant la porte à arcs.

La deuxième période. — Les constructions se rapportant à cette période occupent un volume relativement petit et représentent dans leur plus grande partie des travaux de reconstruction des éléments endommagés de la forteresse. La maçonnerie y est simple et se caractérise par un usage réduit du mortier. Cette technique se retrouve dans la tour N° 1, et précisément dans le mur construit au-dessus de la deuxième rangée de briques. Cette partie du mur comporte deux rangées de meurtrières.

Les plates-bandes extérieures des tours NN°° 3 et 4 ont été surmontées, au cours de cette période, par un mur haut de 0,40 m. environ et dépassant le parement du mur environ de 0,10-0,19 m. en forme de corniche. Cette construction a dû servir pour augmenter la surface de la plate-bande employée comme point de passage d'un mur à l'autre (Fig.).

C'est au cours de cette période qu'on a élargi le couloir se trouvant à proximité de l'entrée, en lui ajoutant deux galeries de 2 m. recouvertes par des voûtes. D'un côté ce couloir aboutissait de nouveau dans la cour de la forterresse et de l'autre il n'empêchait pas la communication avec les deux petites pièces de la période précédente.

De l'extérieur la porte est renforcée par une cour entourée par trois parements de murs reposant sur le mur de la tour d'entrée qui regarde vers l'occident.

La troisième période. — C'est au cours de cette période qu'a été construite la mosquée sur la surface créée par les pièces se trouvant près de l'entrée. L'habitation de la première et deuxième période, qui doit avoir été ici, a dû éventuellement subir des endommagements avec le temps ou s'est écroulée pour céder la place à la mosquée.

La quatrième période. — C'est à cette période que se rattache la construction de la tour de l'horloge au-dessus de la tour de défense, située dans la partie orientale de la forteresse, et cela en un temps que celle-ci avait perdu son caractère défensif.

Le caractère et le temps de construction de la forteresse. — Nous sommes en présence d'une forteresse de dimension réduite et incapable à faire face à des combats et des sièges prolongés. Elle avait été érigée pour contrôler les importantes routes économiques et militaires sillonnant la plaine de Tirana.

Dans un passage où il est question de la disposition de l'armée turque, pendant le siège de Kruje, Barletius mentionne la plaine de Tirana qui se trouvait entre la ville de Kruje et la citadelle des Parthins. Plus bas, il affirme qu'à l'époque cette citadelle portait le nom de Preze et se trouvait en ruines.

La délimitation faite par Barletius à la plaine de Tirana et la détermination de l'emplacement de la citadelle de Preze sont assez exactes, aussi sommes-nous tenus d'écarter toute supposition qu'il y est question d'un autre endroit.

Dans une relation anonyme de l'an 1570, entre autres descriptions l'auteur mentionne également Preze en tant que forteresse construite quelque temps avant par les Turcs.

Šufflay aussi est du même avis. Il mentionne de pair au nom de Preze celui de la forteresse d'Elbasan, qui, comme on le sait, a été construite par les Turcs sur les fondations d'une forteresse plus ancienne.

Praschniker s'est employé à distinguer deux périodes de construction, et cela particulièrement dans la tour S N° 1 et celle SE N° 2. En vérité un oeil attentif ne distingue qu'une seule période de construction et l'erreur de Praschniker est due vraisemblablement au fait que sa visite à Preze a été de très brève durée.

Malgré cela la datation de cette forteresse n'est pas un problème facile à résoudre. Le fait que cette forteresse est mentionnée par Barletius montre qu'elle a été construite après les sièges successifs de Kruje par les Turcs, ce qui prouve que les affirmations contenues dans la relation anonyme de l'an 1570 ne sont pas exactes. En 1466, selon Barletius, la forteresse de Preze était déjà en ruines. Pour en arriver là, elle doit avoir été abandonnée depuis longtemps, vraisemblablement au début des guerres entreprises par Skanderbeg contre les Turcs, du fait qu'il s'agissait d'un ouvrage défensif n'offrant pas des garanties de résistance aux attaques et aux sièges prolongés de l'ennemi. En ce qui concerne sa période de construction le plus possible, elle se situe à notre avis vers le commencement du XVe siècle par les Thopias, les seigneurs de cette contrée.

Certains éléments architectoniques de la porte d'une tour et de l'entrée principale, entre autres des arcs en ogive ou épaulés sont des éléments que l'on retrouve chez nous dans les constructions des XIVe et XVe siècles.

A la suite de l'occupation de Kruje par les Turcs et le rétablissement de leur pouvoir sur cette contrée, la forteresse de Preze subit maintes reconstructions, entre autres la mosquée érigée au-dessus de la porte. Ces travaux sont considérés par les documents écrits et par les auteurs mentionnés plus haut comme des travaux se rattachant à la période initiale de la forteresse. A cette période se rapportent de fait seulement les travaux consistant à renforcer la porte entourant la cour intérieure d'un mur léger, alors que les autres travaux doivent être attribués à la deuxième et troisième période de construction.

En ce qui concerne la tour de l'horloge, elle appartient aux travaux effectués pendant la dernière période de construction (1808-1890), du fait qu'elle est mentionnée en 1852-3 par Hahn. La façade de la tour de l'horloge comporte des inscriptions religieuses en turc et arabe écrites évidemment plus tard à l'occasion de la réparation de la forteresse.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Burhan STRAZIMIRI

BANESA NË MALËSINË E KRUJËS[1]

Vitet e fundit, si rezultat i gjurmimeve të kryera në Malësinë e Krujës për njohjen, zbulimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve me vlerë të arkitekturës fshatare është mbledhur një material, studimi i së cilës, paraqet interes për arkitekturën popullore të vendit tonë. Mbi bazën e këtij materiali jemi munduar të japim këtë punim, i cili ka për qëllim të paraqesë në kohë tipat e banesave që kanë mbizotëruar. Gjithashtu, duke filluar nga banesa më e thjeshtë do të japim rrugën që ka ndjekur zhvillimi i saj, si dhe karakteristikat themelore.

Malësi të Krujës kemi quajtur të gjithë pjesën malore që përfshihet brenda kufijve të sotëm administrativ të rrethit të Krujës. Është një zonë që kufizohet nga lindja me malin e Skënderbeut, nga jugu me Malësinë e Tiranës, nga perëndimi me fushën e Krujës dhe nga veriu me lumin e Matit[2]). Relievi i krahinës është mjaft i thyer. Ajo karakterizohet nga vende të ashpra, herë të zhveshura dhe herë me pyje të dendura. Toka e bukës ka qenë relativisht e pakët. Në të kaluarën Malësia e Krujës komunikonte me krahinat fqinje të Matit, Mirditës e Tiranës vetëm me rrugë këmbësorie. Në të kaluarën kjo krahinë karakterizohej nga një ekonomi e vogël bujqësore e blegtorale, e cila ishte e prapambetur.

Edhe në Malësinë e Krujës, ashtu si në shumë krahina malore të Shqipërisë së Veriut nuk u stabilizue pushteti shtetëror turk.

Malësinë e Krujës nuk mundi t'a fusë nën vartësinë e tij ekonomike as pushteti feudal. Në këto kushte, këtu nuk u zhvilluan historikisht diferencime të mëdha e të thella ekonomike-shoqërore. Familjet e mëdha ose fiset kishin pronat e veta, mbi të cilat ushtronin të drejtat sipas kanunit.

Njësitë etnografike formuese të Malësisë së Krujës, si Kurbini[3]) e Benda[4]) kanë qenë më vete, brenda të cilave vepronte e drejta zakonore e vet bajrakut.

Për këtë punim jemi mbështetur, kryesisht në materialin që kemi mbledhur në fshatrat Skuraj, Gallatë, Vinjollë, Mafsheq, Shkretë, Noj, Kamt, Selitë, Daul, Shemri, Zgërdhesh i Vjetër (tab. I).

Banesa e Krujës është bërë objekt i një studimi të veçantë[5]), ndërsa për banesën e Malësisë, me sa dimë, deri më sot nuk është shkruar asgjë, qoftë dhe kalimthi.

Përgjithësisht banesat brenda fshatit janë shumë të shpërndara. Në mjaft raste duhen orë të tëra për të kaluar nga njera banesë në një tjetër. Kjo shpërndarje është e kushtëzuar, kryesisht me sigurimin e tokës së bukës. Në disa fshatra banesat janë të grupuara,

1) Fotografitë janë të autorit. Skicat të autorit, F. Zarshatit dhe B. Penxhës.
2) Është bërë e zakonëshme në këta 30 vjetët e fundit të ndiehet shpesh «Malësia e Krujës». Në fakt, Malësi e Krujës nuk përbën një unitet etnografik. Brenda saj bëjnë pjesë disa fshatara malorë të Kurbinit, Bendës e Rranxës. Nga të gjithë fshatrat malore kemi lënë pa shkelur fshatrat Bruz Bruz-Zall dhe Rranxë të krahinës së Bendës.
3) Frano Iliaj, **Zakoni i Kurbinit** — Dorëshkrim. Arkivi i Sektorit Etnografisë, Instituti i Historisë Tiranë.
4) Haxhi Goci, **E drejta zakonore e Bendës.** Dorëshkrim. Arkivi i Sektorit Etnografis, Instituti i Historisë, Tiranë.
5) Koço Zheku, **Kulla Krutane,** «Konferenca II e Studimeve Albanologjike» Vol. II Tiranë 1968, 205.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

DO NOT COPY

duke formuar lagje më vete, të cilat shpesh thërriten me emrin e fisit që jeton në të.

Banesat në Malësinë e Krujës janë të disa tipave e varieteteve, që ndryshojnë njeri nga tjetri si nga kompozicioni planimetriko-volumor, ashtu dhe nga teknika dhe materialet e përdorura.

Ne, duke u nisur nga kompozimi planimetriko-volumor, banesat e Malësisë së Krujës do t'i tratojmë duke i ndarë në dy grupe: në grupin e banesave përdhese dhe, në grupin e banesave jopërdhese.

Banesat përdhese

Në këtë grup kemi përfshirë si banesat njëkatshe prej guri që vendasit e thërresin mëdheska, ashtu dhe kasollet.

Sipas emërtimit që përdorin vendasit, me kasolle përfshihen të gjitha kategoritë e ndërtimeve që bëhen me lënde druri. Në fakt, ky term nuk i përgjigjet në të gjitha rastet këtij emërtimi, pasi ato na paraqiten në dy variante, që ndryshojnë thellësisht nga konstruksioni dhe teknika e ndërtimit.

Në variantin e parë, kemi të bëjmë thjesht me kasollen e mirfilltë, e cila deri në vitet e para të çlirimit është përdorur për banesë vetëm nga një numër i kufizuar familjesh nga shtresat më të varfëra të fshatarësisë. Në të gjithë krahinën kemi gjetur vetëm katër ekzemplarë të braktisur, të cilat kishin të njejtën formë dhe zgjidhje funksionale. Këto kasolle dallohen njera prej tjetrës vetëm nga përmasat. Njerën prej tyre po e paraqesim në (fig. 1). Ndodhet në fshatin Shkretë, një nga fshatrat me kuotë më të lartë të Malësisë. Banorët e saj, që tani jetojnë në një shtëpi të re, na treguan se paraardhësit e tyre kanë jetuar përkërisht në atë kasolle. Ajo është mbështetur pas tabanit në një terren të shkallëzuar, duke eliminuar kështu ndërtimin e njerës nga faqet anësore të saj. Faqja tjetër dhe dy ballet e ngushtë ishin ndërtuar prej drunjsh të ngulur në tokë e të veshura pjesërisht me dërrasa (anie), e pjesërisht të thurura me degë dushku. Ajo është e mbuluar me kashtë gruri e gjethe dushku. Në kasolle hyet nga balli i ngushtë, nëpërmjet një porte prej dërrase. Në fillim kasollja përbëhej prej një ambienti të vetëm, që më vonë është ndarë në dy kthina me anë të një gardhi prej thuprash me lartësi afërsisht 1 m.

Kthina e parë, e përfituar nga kjo ndarje, përdorej për gatim, ndejtje e fjetje. Vendi i zjarrit gjendej pranë faqes së tokës. Ndriçimi bëhej nga dritarja e vetme e hapur në ballin e ngushtë, në të cilin gjendej dhe porta. Kthina e dytë, ka shërbyer për të strehuar bagëtinë. Në të hyej, duke kaluar nëpërmjet kthinës së banimit.

Edhe tre kasollet e tjera, që pamë në Malësinë e Krujës, ishin po të kësaj forme, por të ndërtuara mbi tokë me faqet të ndërtuara me drunj, të thurura anash me thupra e të mbuluara me kashtë gruri ose me gjethe dushku. Njerën nga këto po e paraqesim në (fig. 2). Në të gjitha rastet, kemi vënë re, se edhe këto kanë të njëjtat karakteristika ndërtimi si kasollja e përshkruar më sipër. Me rëndësi është të vemë në dukje, se pranë të gjithë këtyre kasolleve ka pasur furra për pjekjen e bukës. Kasollet gjenden të parrethuara. Ndërtimi dhe përdorimi i tyre si banesë nga vendasit është një tregues i një prapambetje të thellë, gjithnjë për kohën kur u ndërtuan. Fshatarët i ndërtonin kasollet vetë dhe këtë ata e bënin lehtësisht, pasi një gjë e tillë atyre nuk u kërkonte mjete dhe njohuri teknike. Përdorimi, në disa raste, i kasolles si banesë, deri në

vitet e para të çlirimit, ekzistenca e tyre dhe në vënde të thella malore, si dhe prania e furrës tregojnë për një karakter të përhershëm të saj. Për mendimin tonë, në përdorimin e kasolles si banesë ka determinuar kryesisht gjendja e tyre ekonomike.

Varianti tjetër, gjithashtu i quajtur nga vendasit kasolle, por që nuk duhet t'i identifikojmë me kasollet e përshkruara më sipër, është banesa përdhese e ndërtuar me lëndë druri e punuar me sopatë.

Ndërmjet këtyre dy llojeve ekziston një ndryshim i madh si nga teknika e materiali i përdorur, ashtu dhe nga zgjidhja planimetriko-funksionale. Duke u nisur nga këto faktorë do të ishte më i saktë cilësimi, «banesë me lëndë druri», emërtim të cilin do ta përdorim më poshtë. Një diferencim i tillë, ndërmjet këtyre kategorive, do të bënte të qartë dhe vendin që zë në këto në ndërtimet e krahinës. Banesat me lëndë druri gjenden gjithmonë mbi sheshe të vogla, shpesh të krijuara vetë. Ato janë të orientuara gjithmonë me kurriz nga veriu, veriperëndimi apo verilindja për t'u mbrojtur nga erërat e ftohta. Struktura mbajtëse e tyre (tab. II) përbëhet nga skeleti i trarëve, që lidhen me një skelet tjetër trarësh horizontalë të kllaposur njeri me tjetrin. Bazamenti i trarëve horizontal për t'u mbrojtur nga lagështia, vendoset gjithmonë mbi një xokolaturë mur guri, paksa të ngritur nga toka. Në disa raste faqet anësore të banesës vishen nga jashtë me mur guri të thatë, afërsisht, 0,50 m. lartësi (tab. II. fig. 2). Kjo veshje bëhet me qëllim që të mbrojë dërrasat anësore nga lagështia. Teknika me të cilën ndërtohen faqet anësore nuk është e njëllojtë në këto banesa. Ne kemi takuar këto teknika ndërtimi:

a) Prej thuprash të thurura ose mbërthyera tek trarët (tab. II/1).

b) Me dërrasa vertikale të vendosura një mbi një (tab. II./2).

c) Me dërrasa horizontale të kllaposura në trarët e strukturës mbajtëse (tab. II./3).

d) Me rripa dërrase të çara dhe të mbërthyera në të dy faqet e trarëve të skeletit mbajtës, boshlleku ndërmjet të cilëve, në disa raste, mbushet me dhe (tab. II./4).

Në rastet a) dhe c), faqja e brendshme gjithmonë suvatohet me llaç balte. Mbulesat e çative, në të shumtën e herës, janë prej dërrase, por gjenden dhe t'atilla me pllaka guri. Përdorimi i tjegullave të lugëta është një fenomen i shfaqur më vonë. Në këto banesa nuk shihet më përdorimi i kashtës ose gjethit të dushkut.

Këto banesa janë me formë planimetrike drejtkëndore. Sipas dëshmive gojore, banesat me lëndë druri kanë qenë të përbëra prej një ambienti të vetëm, që shërbente si për të banuar familja, ashtu dhe për të strehuar bagëtinë. Zakonisht, ne i kemi gjetur të ndara në dy kthina me anë të një perdeje të plotë prej gardhi të thurur me purteka që në disa raste është i suvatuar. Kjo perde ndan kthinën e banimit nga kthina e strehimit të bagëtisë. Të dy këto kthina komunikojnë nga brenda, nëpërmjet një dere. Në kthinën që banon familja ka vatër, e cila gjindet pakëz e larguar nga faqja e ballit më të ngushtë. Në disa raste këtë e kemi gjetur ngjitur me këtë ballë. Kur vatra është e ngjitur me ballin më të ngushtë; atëherë, anash saj; gjënden kamare për vendosjen e pajisjeve të kafes. Këto kthina janë pa tavan dhe të shtruara me dhe. Rreth faqeve të ambientit shpesh gjenden shtrethë[6]). Këto banesa, zakonisht edhe pas ndarjes së ambientit në dy kthina, kanë qenë me një hyrje të vetme që shërbente si për njerëzit, ashtu dhe për bagëtinë. Në shumicën dërmuese të tyre ne i kemi gjetur me dy dyer ku, njera shërbente për njerzit e tjetra për bagëtinë. Dyert gjënden gjithmonë në qendër të ballit kryesor të banesës. Dritaret për ndriçim janë të kufizuar në numër dhe me përmasa shumë të vogla. Furra shoqëron gjithmonë banesën. Atë thuajse kurdoherë e gjejmë të veçantë nga banesa. Atëhere kur furra është ngjitur me ambientin, ajo shfrytëzohet nga brenda kthinës. Nyja sanitare gjendet, diku, pranë ose në kurriz të banesës. Ajo gjithashtu është ndërtuar me të njëjtën teknikë si dhe vetë banesa.

Populli i krahinës vazhdon ti quajë kasolle dhe kjo, sepse materiali i ndërtimit është krejtësisht drusor. Tipari dallues i banesave me lëndë druri qëndron në faktin se janë më të qëndrueshme, më të ngrohta dhe i përgjigjet më mirë karakterit dhe nevojave të një banese. Kujdesi dhe sigurimi i bagëtisë si një nga burimet kryesore për të ardhurat e jetesës, ka bërë që fshatari t'a mbajë atë në të njëjtën strehë. Tek nevoja e sigurimit të bagëtisë e ka shpjegimin dhe hyrja e vetme që shërbente si për bagëtinë, ashtu dhe për njerëzit.

6) Shtrethe — Dërrasa horizontale me gjërësi, afërsisht 25 cm., të vendosura në faqet anësore, 1.5 m. lartësi, dhe shërbejnë për mbajtjen e enëve. Në Shkodër i thërresin «sergjen», në Berat «polise».

Shënim:
Në asnjë rast neve nuk kemi takuar që bagëtia të mbahej brenda banesës. Të dhënat për funksionet e ambienteve janë gojore dhe i takojnë së kaluarës. Ambientet e banesës përdhese prej guri dhe asaj me lëndë druri shërbenin për nevojat e familjes.

POROTOPY



Fig. 3



Fig. 4

Banesa përdhese prej guri.

Banesa përdhese prej guri mund të konsiderohet si tipi primar dhe mbizotërues i banesës në Malësinë e Krujës. Ajo është përdorur, pothuaj, nga të gjitha kategoritë e shtresave fshatare. Këto banesa, që njihen në popull me emrin «mëdheskë», gjenden ose si ndërtime të veçuara, ose të ngitura me banesat e tjera me kat.

Kur ajo është e veçuar, zakonisht gjendet e ndërtuar në rrafshe të vogla, të krijuara nëpër shpate jo shumë të rrëpinjta (fig. 3). Përdhesja na paraqitet si ndërtim njëvolumor, ku masën e faqeve të murit, të gurit e thyejnë vetëm portat e vendosur në qendër dhe dy dritare të vogla anash. Në formën e saj më primitive (tab. III/1), ajo është një ndërtim i thjeshtë me bazë drejtkëndore, me përmasa që lëvizin 4-6 m. dhe 6-8 m. e përbërë nga një ambient i vetëm që shërben për gatim, ndejtje, fjetje dhe strehimin e bagëtisë.

Vatra është e larguar nga muri ballor dhe kufizohet nga një varg rrasash guri, që lartësohen paksa nga rrafshi i tokës. Në disa vende vatrën e kemi gjetur të ngjitur me murin ballor. Në këtë rast, atje ku bashkohet vatra, muri thellohet në gjysmën e trashësisë së tij me seksion këndrejt ose gjysmërrethor. Këtu mbi vatër ne kemi parë kibe oxhaku[7]). Në përgjithësi në murin pranë ose ngjitur me vatrën, janë vendosur dollape në mur, që shërbejnë për mbajtjen e pajisjeve të kafes. Brenda ambientit, pranë portës së hyrjes gjendet lasi[8]), i cili mund të jetë i thelluar në mur ose i ndërtuar mbi një bazament të ngritur nga toka dhe ngjitur me murin. Po kështu, gjithmonë brënda ose jashtë përdheskës, gjëndet furra e pjekjes së bukës. Në faqet e mureve anësore shpesh vendosen shtrethe. Banesa përdhese ndriçohet nga dritare të vogla, që hapen e mbyllen me kapak dërrase. Hyrja për në mëdheskë është në qendër ose e spostuar në faqen më të gjatë të murit. Shpesh, përdhesja është e ndarë në dy kthina, me anë të një gardhi të suvatuar me llaç balte (tab. III/2). Kur përdhesja është ndarë në dy kthina, shpesh hapet dhe një portë tjetër, pranë se parës, duke bërë kështu që, dhe bagtia të kenë hyrje me vehte (tab. III/3). Këto dy kthina komunikojnë nga brenda me derë, që gjendet ngjitur me murin, pranë hyrjes. Nyja sanitare e shoqëron gjithmonë përdhesen. Atë shpesh e takojmë si aneks të banesës dhe, rrallë, të veçuar. Përgjithësisht përdheset janë pa tavan, të pasuvatuar dhe të shtuara me dhe të ngjeshur. Tavanin e zëvëndësojnë patavrat e çatisë, të cilat janë të vendosura në formë shtrese me dërrasa ngjitur njera me tjetrën. Çatia zakonisht mbulohet me rrasa guri. Strehet janë të dalura jashtë mureve perimetral rreth 50 cm. Përdheset ndërtohen me mur guri, lidhen me llaç balte e breza druri. Zakonisht, këto gjenden të parrethuara. Në raste shumë të rralla oborri i saj është i rrethuar me gardh. Në oborrin rreth përdheses, përveç ndonjë koshere misri për ruajtjen e produkteve bujqësore,

7) Kibe oxhaku — në Mat quhet shkorse. Hinkë druri mbi vatër.
8) Las — Vend ku lahen duart.

DO NOT COPY

nuk sheh gjë tjetër. Është për të shënuar se një numër i kufizuar përdhesesh, rezultojnë që të jenë ndërtuar nga fillimi i shek. XX, teknika e ndërtimit në to është më e avancuar, duke e bërë kështu një banesë më të qëndrueshme. Kjo vihet re, në përdorimin e llaçit-gëlqere dhe eliminimin nga faqet e jashtme të brezave të drurit, në zëvëndësimin e strehëve me bishta druri dhe me korniza guri. Po kështu porta e hyrjes është e harkuar, gurët në shpatullat e dyerve e të dritareve gdhënden me kujdes. Një banesë të tillë kemi paraqitur në (fig. 4).

Përveç ndryshimeve që shihen në teknikën e ndërtimit, në muret anësore lihen frengji (tab. III/4).

Këto ndryshime, që koincidojnë me kohën kur kulla[9]) kishte filluar të përhapej në krahinë, shpjegohen me ndikimet që ushtroi kjo e fundit mbi përdhesen dhe jo me nevojën për t'i dhënë kësaj karakter mbrojtës.

Është për t'u vënë në dukje, se në një përdhese të paraqitur në (tab. III/5) të lagjes Shkretë të fshatit Zgërdhesh i Vjetër, kemi takuar shtrat për fjetje. Ky zinte një kënd të mirë të përdheses dhe ishte i ndërtuar prej dheu. Shtrati lartësohej nga toka rreth 35 cm., duke u kufizuar nga një xokolaturë guri, mbi të cilën ishte vendosur një brez druri i përbërë prej një çift trarësh. Shtrati i fjetjes, të cilin ne e takuam në Malësinë e Krujës, vetëm te kjo përdhese, e gjen të ndërtuar prej lënde druri ose dheu edhe në Tiranë[10]) e përgjithësisht, në Shqipërinë e Mesme.

Përdhesja prej guri, si banesë, është njohur dhe përdorur dhe në krahina të tjera të vendit, Në Zadrimë[11]) dhe në fushën e Mbishkodrës[12]) ajo njihet me emrin «jerevi». Ajo është përdorur dhe në Mirditë[13]). Në përgjithësi të gjitha këto janë të njëjta nga ana funksionale ose kompozicionale me përdhesen e Malësisë së Krujës. Po kështu zgjidhja funksionale dhe kompozimi i përdhesës nuk ka asnjë ndryshim nga zgjidhja funksionale e kompozicionale të ndërtimeve njëkatshe prej druri. Kjo na shtyn të mendojmë se të dy këto banesa, që duhet të jenë me origjinë të njëkohëshme, kanë jetuar paralelisht dhe se ndërtimi i tyre është i kushtëzuar kryesisht nga materialet rrethanore. Nga ana tjetër edhe emërtimi nga vendasit «kasolle» apo «mëdheskë», është lidhur me ndryshimin që ekziston në materialin e ndërtimit ku në njerën është druri, ndërsa në tjetrën guri.

Banesat me kat.

Në Malësinë e Krujës, banesat me kat janë ndërtime prej guri. Këto i shohim si evolucion të mëdheskës në drejtim vertikal, duke na dhënë banesën me kat, dhe, madje, dhe banesën me gjysmëkat.

Banesa me kat, zakonisht vendoset në terrene të shkallëzuar. Ajo përbëhet gjithmonë prej dy kthinash të vendosura njeri mbi tjetrin që janë: poshtë «burgu», dhe sipër[14]) «shpia e burrave» ose «kulla». Vendasit, ashtu si të gjitha banesat me kate prej guri edhe këtë banesë, që vetëm në disa raste e gjejmë të pajisur me frëngji, e quajnë kullë. Shpesh ata kullë thërresin vetëm katin e sipërm të banesës. Përgjithësisht të dy ambientet kanë hyrje të veçantë. Në mjaft raste ato kanë, gjithashtu, komunikim të brendshëm me shkallë prej druri, të cilat mbyllen në rrafshin e dyshemesë me kapanxhë. Në kthinën e banimit, zakonisht hyet nga mbrapa me 2-3 këmbëshkallë, nëpërmjet një nënstrehe të mbuluar, të cilën vendasit e quajnë «çati». Kjo nënstrehë shpesh mbulon të gjithë murin e mbrapmë të banesës. Në ekstremin e saj, në takim ose në kthesën që bën nga muri i ballit më të ngushtë është vendosur nyja sanitare. Nënstreha herë është e hapur dhe herë e mbyllur me dërrasa (tab. IV 1, 2). Koridori i krijuar nga mbyllja e nënstrehës me dërrasa, bëhet me qëllim që të mbrojë familjen nga era dhe shiu, si dhe të mos lejojë vrojtimin nga jashtë të lëvizjeve të familjarëve nëpër të.

Ambienti i banimit, d.m.th. «shpi e burrave« ose «kulla» shërben për gatim, fjetje dhe për pritjen e miqve dhe ka formë drejtkëndore. Përgjithësisht ngjitur me murin e ballit më të ngushtë është vatra, e cila lartësohet jo më shumë se 10 cm. nga rrafshi i dyshemesë. Edhe këtu, kemi vënë re, që mbi vatër të ketë «kibe oxhaku».

Pjesa e murit ngjitur me vatrën thellohet në formë tymari me seksion gjysmërrethor. Mbi ambientet e disa banesave, në faqet anësore, gjënden shtrethe. Porta e hyrjes vendoset në mesin e murit të ballit më të gjërë. Dritaret për ndriçim janë të pakta dhe të vogla. Ato rrallëherë janë më shumë se dy dhe hapen e mbyllen me kapak dërrase. Ky ambient është pa tavan dhe i pasuvatuar. Një element arkitektonik, që takohet në këto banesa është qoshku, i cili del në katin e sipërm në formë konsoli, në mesin e murit të ballit

9) Për kullën në Malësin e Krujës shih vijimin e artikullit.
10) E. Riza – K. Zheku, **Banesa tiranese,** «Monumentet» 2, 1971, 115
11) E. Zarshati. **Të dhëna mbi banesën e fushës Zadrimës,** «Monumentet», 3 1972, 189.
12) V. Shtylla, **Banesa të vjetra të fushës së Mbishkodrës,** «Monumentet», 5-6/1973, 179.
13) P. Thomo,**Banesa popullore e tipit kullë në Mat dhe në Mirditë** «Studime historike», 1, 1970, 136.
14) Kthina e sipërme thiret edhe çardak, për shkak të shtresës me dërrasa të dyshemesë. Këtu kemi dëgjuar të identifikohet shtresa e dyshemesë me emërtimin çardak të kthinës.

POMOTOR

më të gjatë, dhe mbështetet mbi zgjatimin e trarëve të dyshemesë. Ky qoshk, që formohet nga ndërprerje për një gjatësi të caktuar të murit mbi të cilin del, shërben për ndriçim dhe për të ndenjtur në kohë të nxehtë. Faqet e mureve anësore të qoshkut, zakonisht janë prej çatmaje të suvatuar me llaç balte si nga brenda, ashtu dhe nga jashtë. Qoshku, gjithashtu, nuk ka tavan. Në ballin e tij gjenden dritare të vogla për ndriçimin e soditje. Në muret e banesave me kat, shpesh herë janë lënë frengji.

Ambienti tjetër «burgu i gjasë» është i errët pa asnjë dritare. Ndriçimi bëhet vetëm nga porta e hyrjes, që vendoset nga ana e kundërt e hyrjes për në ambient, ose nga balli më i ngushtë. Këto banese janë ndërtuar me materiale rrethanore, dhe si lidhës është përdorur llaçi i baltës. Muret ndërpriten në intervale të caktuar me breza druri. Çatitë janë të mbuluara me rrasa guri. Patavrat e çatisë janë të puthitura mirë njera me tjetrën, duke zëvëndësuar kështu, deri diku, mungesën e tavanit. Strehët e çatisë nuk dalin më shumë se 50 cm. jasht kontureve të mureve.

Në (tab. IV/1) kemi paraqitur një banesë në fshatin Shkretë, që përfaqëson në përgjithësi tiparet karakteristike të banesës me kat si në trajtimin e brendshëm, ashtu dhe në atë të jashtëm. Në fillim ajo përbëhej prej dy kthinash të vendosura njëra mbi tjetrën: burgu dhe ambienti banimit, që shërben njëkohësisht dhe për pritjen e miqve. Kjo banesë është vendosur në drejtim paralel me vijat rrushkulluese. Ndarja e këtij ambienti me perde gardhi të suvatuar me llaç balte është i mëvonshëm. Kthina e re e përfituar nga kjo ndarje shërben vetëm si vend fjetje. Në (tab. IV/3) kemi paraqitur një banesë tjetër me kat, që ndodhet në fshatin Cudhi në lagjen «Kroi i Madh». Kjo banesë përbëhet prej burgut, të vendosur poshtë dhe atij të banimit, sipër. Ka formë drejtkëndore me dimensione të përafërta 7 x 5 me lartësi 2.20 m. të katit të sipërm. Është e vendosur në terren pak të shkallëzuar, duke bërë të mundur hyrjen për në ambient nga prapa, nëpërmjet shkallëve prej guri që të çojnë pastaj në nënstrehë, e prej andej, nëpërmjet derës hyrjes, në ambientin e banimit. Poshtë është vendosur burgu i gjësë, ndërsa në ekstremin e nënshtresës në takim me murin tërthor është vendosur nyja sanitare. Kjo banesë ka të njëjtën zgjidhje funksionale si në banesat e tjera me kat të Malësisë së Krujës ku dhoma e miqve është trajtuar me mjaft përkujdesje. Në dhomën e miqve ka pasur dy «sheshene» me frengji, nga të cilat, njeri ka qenë i vendosur në mes të faqes së përparme (që sot është adoptuar në dritare) dhe tjetri është i vendosur në qoshen e krahut të djathtë, aty ku takohet muri tërthor me atë ballor. Frengji shihen dhe në dy faqet e tjera të mureve. Njera prej tyre kontrollon hyrjen nga nënstreha, ndërsa tjetra është vendosur anash. Në këtë ambient ne gjejmë gjithashtu dhe vatrën me kamaret anash saj, lasin (avdeshanen), ancakë druri të vendosur rreth mureve dhe kiben e oxhakut. Trajtimi dhe pajisja e këtij ambienti me elemente arkitektonikë mbrojtës nuk dallohen nga trajtimi i dhomës të miqve të kullës së Matit.

Në (tab. V/1) ne kemi paraqitur një banesë me kat me përmasa mjaft të zgjeruara, në drejtim paralel me vijat rrushkulluese. Këtë banesë ne e kemi gjetur në fshatin Skuraj. Në përgjithësi kjo banesë ka po atë zgjidhje si dhe banesat e tjera. Fillimisht ka qënë e përbërë prej dy kthinash të vendosura njera mbi tjetrën që janë, burgu dhe ai i banimit, të cilën vendasit e thërresin «çardak». Këto dy kthina, përveç që janë me hyrje të veçanta, kanë dhe komunikim të brendshëm me shkallë druri. Kthina e banimit është me dy vatra të ngjitura me muret ballorë, në njërën prej të cilave mblidheshin burrat. Po kështu një nga dy hyrjet ka shërbyer vetëm për burrat. Në katër muret e kthinës banimit, si dhe në dy nga muret janë lënë frengji. Dy palë shkallë që ndërlidhin të dy katet të vendosura në faqen përpara dhe përkundruall njera-tjetrës, të çojnë në një ballkon të mbuluar e të rrethuar me parmake, i cili përshkon pothuaj të tre anët e banesës. Këtë ballkon në Skuraj e thërresin «serxhi». Të dy shkallët e drurit mbyllen në rrafshin e dyshemesë së ballkonit me çapanxhë (kapanxhë) dhe sigurohen nga sipër me çengel. Një palë shkallë të tjera, të përbëra prej 3-4 shkelje ngjitur me murin ballor, të ndërlidhin gjithashtu me ballkonin. Këto shkallë që të çojnë në ballkon janë vendosur nga balli i ngushtë, në krahun e djathtë, në një vend që kontrollohet nga dy frengji.

Në këtë banesë përmasat e mëdhaja në gjatësi kanë lejuar që kthina e banimit të ndahet në dysheme dhe me perde dërrase, veprim ky i vonshëm se ndërtimi i vet banesës. Kjo ndarje krijoj mundësinë që tani banesa të shërbejë njëkohësisht për dy familje.

Shtimi i banesës me kat, si pasojë e shtimit të numrit të familjeve, është bërë duke çfrytëzuar relievin e vendit. Shtesat bëhen duke u vendosur gjithmonë në vende të shkallëzuara paralel me vijat rrushkulluese në varg dhe ngjitur njera me tjetrën.

Në (tab. V/2) ne kemi paraqitur një banesë tjetër të ndërtuar qysh në fillim për dy familje dhe që ndodhet në fshatin Cudhi. Ajo përbëhet prej dy banesash me kat, të ngjitura në vazhdim të njera-tjetrës dhe të vendosura paralel me vijat rrushkulluese. Ato në përgjithësi ruajnë po atë kompozim dhe trajtim të brendshëm, si gjithë banesat me kat të Malësisë së Krujës. Në këtë banesë të bie në sy një ballkon i dalë konsol mbi zgjatimin e trarëve të dyshemesë, që vendasit e quajnë «çati». Ky ballkon, siç shihet në tabelë, përshkon të gjithë ballin e dy banesave të paraqitura; si dhe pjesërisht muret anësore. Në pjesën qëndrore, ky

DO NOT COPY

thatë dhe pa breza druri, ndërsa nga përpara mbyllet me një gardh prej rripash dërrase të çara me sopatë. Kati i sipërm është ndërtuar me lëndë druri të punuar me sopatë. Edhe mbulesa e çatisë është prej të njejtit material. Druri si material ndërtimi i përdorur në katin e dytë, lidhet mirë me muraturën e katit të parë.

Në përgjithësi këto ishin tipat e banesave fshatare të Malësisë së Krujës, që historikisht kanë prejardhje më të lashtë dhe kanë dominuar në këtë krahinë. Por, përveç këtyre, ne kemi konstatuar se në Malësinë e Krujës, aty nga fundi i shek. XIX ka zënë vënd dhe kulla (tab. VIII) me tipare e karakteristika të njëjta me kullën e ndërtuar në Mat dhe Mirditë.[20]) Përveç kësaj, në mjaft raste, kjo na rezulton të jetë e ndërtuar nga banorë të ardhur prej krahinave fqinjë, ose nga familje që kanë pasur marrëdhënie me këtë krahinë. Kulla që takuam në Malësi të Krujës është me dy dhe tri kate. Ajo përbëhej me nga një ambient në secilin kat. Ndërlidhja në mes kateve realizohet me shkallë të brendshme druri. Ajo nuk ndryshonte nga kulla e krahinave fqinje edhe nga funksioni, destinacioni, si dhe vendosja e ambienteve, tipar ky i përbashkët me banesat me kat të krahinës. Ajo përgjithësisht është e zhveshur nga ndërtimet ndihmëse. Ashtu si gjithë banesat e tjera kulla në Malësinë e Krujës, gjendet e parrethuar me mure avllie. Një tipar që e dallon kullën në Malësi të Krujës nga ajo e krahinave fqinjë të Matit dhe Mirditës është se atë nuk e gjen të veçuar, por të ngjitur me përdhesen. Në pjesën dërmuese përdheset e ngjitura me kullat i kemi gjetur të rrënuara. Edhe kohët e ndërtimit të këtyre dy njësive nuk janë të njëjta. Është për të theksuar se si kulla ashtu dhe përdhesja, qëndrojnë njera ngjitur me tjetrën si dy njesi me funksione të veçanta pa komunikim të brendshëm dhe me hyrje nga oborri. Mëdheska gjithmonë shërben për gatim, ngrohje dhe shpesh për fjetje. Në kullat dykatshe, kati i sipërm mbetet vetëm për miqt, ndërsa kur ajo është trekatshe, kati i dytë shërben vetëm për fjetje. Kulla në Malësinë e Krujës është me dy kate dhe, në mjaft raste, mbi portën e hyrjes dhe mbi zgjatimin e trarëve të dyshemesë së ambientit të pritjes miqve të bije në sy një qoshk (fig. 5)[21]), i cili ka karakteristika të njëjta me banesën me kat. Një qoshk i tillë gjendet dhe në kullën krutane. Faqet anësore të qoshkut janë prej skeleti trarësh të mbushura me gurë ose prej skeleti trarësh të thurura me thupra dhe të suvatuara me llaç balte. Në faqen përballë tij, gjen një ose dy dritare. Kur qoshku ka dalje të madhe, atëhere mund të ketë dritare dhe anash. Frengji në këto qoshke nuk kemi parë, por edhe konstruksioni i tij nuk është i përshtatshëm për lënjen e tyre.

Nga materiali i përshkruar ne mund të nxjerrim disa përfundime:

1) Banesa paraardhëse e ndërtimeve me kat, në Malësinë e Krujës është përdhesja. Ajo është përdorur gjërësisht nga shtresat fshatare dhe ka jetuar njëkohësisht me ndërtimet me lëndë druri.

2) Banesa me kat shënon evolucionin e banesës përdhese në drejtim vertikal. Shtimi dhe zgjerimi i saj është bërë në pershtatje me relievin.

Si banesë me kat, ashtu dhe ajo me gjysmëkat nuk na transmetohen gjatë gjithë kohes së ekzistencës së tyre me të njëjtat tipare e karakteristika. Banesat më të herëshme bartin, deri nga fundi i shek. XIX, pothuaj të gjitha tiparet e karakteristikat fillestare të ndërtimit. Këto banesa, duke i qendruar besnike idesë kompozicionale, pajisjen me elementë të tillë arkitektonikë e ndërtimore që u jepnin këtyre tonin e banesave me karakter mbrojtës. Në të vërtetë, pozicioni i disfavorshëm i vendosjes, zgjidhja planimetriko-funksionale në përshtatshmëri me terrenin dhe lartësia relativisht e vogël si e banesave me kat, ashtu edhe e banesës me gjysmëkat, nuk jep mundësi për të dominuar e kontrolluar gjithë zonën përreth e, rjedhimisht nuk mund të siguronet një mbrojtje e sigurtë. Duke u nisur nga këto veti këto banesa nuk mund t'i identifikojmë me kullën për qëllime mbrojtëse, por nga ana tjetër as mund t'a zhveshim atë krejtësisht nga karakteri i saj mbrojtës.

3) Banesa e tipit kulle e variantit të Matit apo Mirditës u ndërtua në kushte të tilla ku pasiguria shoqërore dhe hakmarrja ishin bërë fenomene të ditës. Fakti që kjo banesë nuk arriti të bëhet mbizotëruese e krahinës, si dhe, ashtu siç kemi përmendur më sipër, ndërtimi i saj me shumë tipare e karakteristika të përbashkëta me kullën e Matit apo Mirditës, tregon që kulla e këtij varianti është një fenomen i shfaqur vonë dhe më shumë të ngjarë të jetë huazuar nga fqinjët e saj, ku kjo banesë ka qenë mbizotëruese.

Sot në Malësinë e Krujës, ashtu si në të gjithë vendin tonë, banesat e reja që po ndërtohen ndryshojnë nga banesat që përshkruam edhe pse ato ruajnë, në mjaft raste, po atë kompozicion planimetriko-volumor (fig. 6). Ato sot janë plot dritë e komoditet dhe në përshtatje të plotë me nevojat që u dikton jeta dhe kushtet e reja historiko-shoqërore.

20) Hollësira mbi tiparet e kullës Matit e Mirditës shif në Artikullin e P. Thomos, **Banesa populore e tipit kullë në Mat dhe në Mirditë,** «Studime Historike», 1, 1970.
21) K. Zheku, art. cit., 207.

POROSOR

TAB. I



DO NOT COPY













DO NOT COPY

















DO NOT COPY













DO NOT COPY

DO NOT COPY















DO NOT COPY

















TAB. VII



















DO NOT COPY













DO NOT COPY

Burhan STRAZIMIRI

L'HABITATION DE LA MALESI DE KRUJA

RESUME

A la suite des recherches effectuées, pendant ces dernières années, en vue de connaître, d'identifier et de prendre sous protection les habitations situées dans la Malesi de Kruja et présentant le plus d'intérêt pour l'architecture rurale, on a réussi à recueillir des données de valeur dans ce domaine d'étude. Se fondant sur le matériel rassemblé, l'auteur s'est assigné la tâche d'étudier les types d'habitation qui ont prévalu dans le temps dans cette zone, de suivre leur voie de développement et d'exposer leurs principales caractéristiques.

La région de Kruje se caractérise par un relief variable et par une insuffisance de terres destinées aux cultures vivrières.

Ces caractéristiques locales, conjointement aux conditions économiques et sociales, ont souvent influé sur la disposition parsemée des maisons à l'intérieur même du village.

Les habitations de la Malesi de Kruje sont de types et variantes diffèrent les uns des autres tant pour ce qui concerne leur composition planimétrique et volumétrique que leur technique de construction et les matériaux employés.

Partant de la composition planimétrique et volumétrique, l'habitation de la Malesi de Kruja se répartit en deux groupes, la maison à rez-de-chaussée et la maison à un étage.

Les maisons à rez-de-chaussée. — *De ce groupe font part les chaumières entièrement en bois de construction et les habitations à rez-dechaussée en pierres que le habitants du pays appellent «mëdheskë».*

Partant de l'appellation locale kasolle *(=chaumière), il apparaît que ce terme ne répond pas toujours à la véritable chaumière, du fait qu'elle est édifiée en deux variantes diffèrent l'une de l'autre surtout quant à la technique de construction.*

Dans la première variante nous sommes tout simplement en présence de la véritable chaumière, dont on n'a trouvé que quatre exemplaires dans un état abandonné. Elle est constituée de peaux fichés en terre et garnis de tiges en treillis; son toit est représenté d'une couverture de chaume ou de branchages. L'intérieur est séparé en deux pièces, par une haie à mi hauteur, dont l'une destinée à l'habitation et l'autre aux animaux.

Quant à l'autre variante, bien q'uelle soit appelée kasolle, *ce n'est pas une chaumière dans le sens propre du terme mais une habitation à un étage, de bois équarri à la hache, dont les faces latérales sont revêtues de planches ou de pans en bois. Son toit est couvert de planches ou de dalles de pierre. Ce type d'habitation en bois de construction correspond mieux au caractère d'une maison. Une spécifique de la chaumière est le fait qu'elle est toujours dotée d'un four et des installations sanitaires construites à son voisinage. L'habitation la plus répandue et prévalente de cette région est la maison à rez-de-chaussée (mëdheskë) en pierre. Il s'agit d'une construction à un seul volume, dont la masse sévère des parements du mur en pierres est interrompue seulement par la porte d'entrée et les petites fenêtres aménagées tout près d'elle. La technique de construction est en général simple. De même, la composition architectonique et fonctionnelle de la maison à rez-de-chaussée ne diffère pas de celle des habitations à un étage en bois. Ces deux types d'habitation ont une forme planimétrique identique et un nombre égal de pièces. L'intérieur aussi y est traité de la même manière. Dans ces deux habitantions on retrouve le foyer, aménagé loin des murs latéraux ou attenant au front le moins large. Les faces latérales des murs sont garnies*

DO NOT COPY

DO NOT COPY

d'étagères, où l'on met les récipients. Chacun de ses types d'habitations est également doté d'un four pour cuir le pain et du noeud sanitaire. Le seul élément distinctif est représenté par les matériaux de construction: le bois dans le premier cas et la pierre dans le deuxième. Toutes ces spécifiques montrent qu'aussi bien la maison en bois que celle en pierres à rez-de-chaussée ont mené une existence parallèle et que la construction de l'une ou de l'autre a été conditionnée par les matériaux disponibles. Par ailleurs l'appellation locale de kasolle ou de medheskë se rattache principalement à la différence des matériaux employés pour la construction de l'une ou de l'autre.

Au commencement du XXe siècle, la medheskë de la Malesi de Kruja enregistre certaines modifications qui concernent surtout sa technique de construction: elle est garnie de meurtrières; les culées des portes et des fenêtres, les linteaux et les saillies en pierre sont travaillés plus soigneusement; on se sert de mortier de chaux comme liant dans les travaux de maçonnerie et on n'emploit plus les bandes en bois sur les faces extérieures des murs. Toutes ces modifications sont un résultat de l'influence exercé par la kulla sur le type d'habitation à rez-de-chaussée. Dans la forteresse de Kruje, les habitations à un étage sont des constructions où la pierre est l'élément essentiel. Elles constituent une évolution de la medheskë dans le sens vertical et c'est ainsi que voit le jour l'habitation à un étage et voir même celle à demi-étage.

Dans la maison à un étage les deux pièces, celle des animaux et celle de l'habitation, sont disposées l'une au-dessus de l'autre. Chacune d'elles à une porte particulière, mais elles communiquent entre elles par un escalier en bois. Ces maisons sont généralement construites sur un terrain en terrasses. Un important élément architectonique y est représenté par le qoshk, à l'intérieur de l'habitation même, ainsi que par l'auvent à proximité de l'entrée, souvent fermé par des planches et que les habitants du pays appellent çati (= toit).

Le développement des maisons à un étage, dans la Malesi de Kruja, reflète également leur disposition en série parallèle, sur un terrain accidenté, contigues les unes aux autres. Elles servent en l'occurence d'habitation à deux familles et conservent entièrement la composition des maisons à un étage soit pour ce qui concerne le nombre de leur pièces que leur fonction. L'élargisement de la maison à un étage a lieu en direction normale aux lignes de profondeurs. Une telle disposition de l'habitation, par suite de son contact avec le terrain, donne naissance à un volume échelonné, tandis que son extension sur le même plan horizontal dans la partie supérieure permet d'obtenir deux pièces. Ce type d'habitation, largement diffusé dans d'autres régions du pays aussi, est connu par le nom de maison à demi-étage et à continué d'être construite jusqu'à la première moitié du présent siècle. Les différentes pièces de cette habitation: le refuge des animaux, la chambre des amis ou des «hommes» et la chambre des travaux de ménage, ont toujours conservé intactes leur disposition et leur fonction. La chambre des amis et celle des travaux ménages se trouvent sur le même plan et, quoique chacune d'elles à une porte particulière, sont en communication entre elles. L'ultérieure extension de cette habitation et direction normales aux courbes de profondeurs a entraîné la disposition partielle de la chambre de ménage au-dessous du niveau du sol. Le refuge des animaux est resté toujours au-dessous de la chambre des amis.

Les maisons à un étage comme celles à demi-étage, qui ne sont que les variantes d'un même type, se caractérisent souvent par des traits défensifs, traits que l'on peut observer soit dans leur technique de construction que dans leurs éléments architectoniques ajoutés à cette fin.

Voilà donc quels sont les types d'habitation rurales de la Malesie de Kruje, qui, du point de vue historique, ont une origine plus ancienne. Bien qu'elle aient connu une nette prévalence dans cette région, à la fin du XIXe et au commencement du XXe siècles a fait son apparition la maison type kulle selon la variante de Mat ou de Mirdite. Celle-ci est construite selon des traits et des caractéristiques analogues à ceux de la kulle des régions voisines de Mat et de Mirdite, voir même par des gens venus de ces contrées ou qui ont eu des contacts avec elles. Un trait marquant de cette kulle est

le fait que dans la Malesie de Kruje elle est toujours construite contiguë à la maison à rez-de-chaussée. Souvent l'auteur n'a trouvé que les ruines des maisons à rez-de-chaussée édifiées tout près de la kulle.

* * *

Les maisons à un étage comme celles à demi-étage n'ont pas conservé, au cours de leur existence, les mêmes traits et caractérisques. Les plus enciennes d'entre elles ont maintenu jusqu'à la fin du XIXe siècle tous les traits et caractéristiques initiaux, soit elles sont demeurées fidèles à l'idée compositionnelle et fonctionnelle de l'époque alors qu'elles furent dotées d'éléments architectoniques et de construction leur conférant un carcatère défensif. En vérité leur disposition peu favorable, leur composition planimétrique et fonctionnelle conformément au relief du terrain et le fait qu'elles sont peu élevées furent autant de facteurs qui ne leur permirent pas de dominer la zone avoisinante et, partant, d'assurer à ses habitants la protection nécessaire. Se fondant sur ces données, l'auteur aboutit à la conclusion que ces habitations dénommées kulle *ne peuvent être identifiées à la véritable* kulle *construite à des fins défensifs, mais, par ailleurs, vu les éléments défensifs dont elles sont pourvus, ont tout de même servi, à protéger la famille rurale.*

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Emin RIZA

BANESA ME GJYSMËKAT – PERPENDIKULARE

Në arkitekturën e banesës popullore shqiptare qytetare dhe fshatare banesa me gjysmëkat perpendikulare zë një vënd të posaçëm, sepse ajo ka gjetur një përhapje të gjerë në qytetet e ndërtuar në terrene të pjerrët, të cilët janë nga më të zakonshmit gjatë mesjetës, si dhe në shumë fshatra të zonave kodrinore dhe malore.

Koncepti i gjysmëkatit ka lidhje me kompozimin volumor të ndërtimit. Ai shprehet në zhvillimin e pabarabartë sipërfaqësor dhe volumor të kateve, duke u shtrirë ndërtimi i atij të sipërmit, më tej katit të poshtëm. Kështu në pjesën e prapme krijohet një shkallëzim karakteristik dhe ndërtimi ndjek pjerrësinë e terrenit me thyerje volumore sipas kateve. Ky koncept i thyerjes së volumeve, që diktohet nga terreni jo i rrafshët dhe shkëmbor është racional, sepse mënjanon gërmimin në terrenet e fortë dhe shfrytëzon mirë truallin e pakët të ndërtimit. Prandaj kompozimi volumor me gjysmëkat është një koncept ndërtimor, i cili lidhet ngushtësisht me pjerrësinë e truallit të ndërtimit dhe, si i tillë, nuk lidhet vetëm me një tip të caktuar banese. Kështu këtë kompozim volumor e gjejmë të përhapur gjerësisht në variantet e ndryshëm të banesës gjirokastrite[1]) dhe në disa banesa me çardak të ndërtuara në Berat[2]). Në grumbullin e madh të banesave me gjysmëkat, shquan për përhapjen e gjerë, programin dhe veçantitë arkitektoniko-konstruktive, thuajse të njejta, banesa me gjysmëkat perpendikulare, të cilën rezervohemi t'a cilësojmë një tip më vete në kuadrin e banesës popullore shqiptare. Së pari, kjo banesë ka tërhequr vëmëndjen e G. Strazimirit[3]), i cili e konsideron një nga tipet bazë në evolucionin e banesës qytetare.

Banesa me gjysmëkat perpendikulare ka një program të thjeshtë, i cili përmbledh katoin përdhes, një ambient të vetëm banimi, pjesërisht përdhes dhe pjesërisht në kat, ose dy të tillë, njeri prej të cilëve është «shtëpia e zjarrit»[4]) dhe tjetri, «oda e miqve». «Shtëpia e zjarrit» është gjithmonë në pjesën përdhese në banesat me dy kthina banimi, ndërsa vatra e zjarrit në ato me një kthinë të banuar, përgjithësisht ndërtohet në pjesën përdhese.

Banesa me gjysmëkat perpendikulare ka qënë mjaft e përhapur në qytetin dhe fshatin shqiptar. Kështu atë e gjejmë të ndërtuar gjerësisht në Gjirokastër, Berat dhe Krujë[5]), ndërsa në Shkodër ruhen pak shembuj në lagjet kodrinore të Shkodrës[6]) së vjetër. Në fshat, së pari, duhen përmëndur banesat e këtij lloji në Kamenicë[7]), të cilat hedhin dritë mbi lashtësinë dhe zhvillimin e kësaj banese në truallin tonë. Nga sa

1) E. Riza, **Banesa e fortifikuar gjirokastrite,** «Monumentet», 1, 1971, 128.
2) Banesa tipike me gjysmëkat me çardak janë: banesa në rr. Kostandin Leka nr. 4, banesa në rr. Gaqi Karakashi, nr. 15 etj.
3) G. Strazimiri, **Rreth evolucionit të banesës qytetare shqiptare gjatë mesjetës në qytetet ekzistuese qysh para pushtimit otoman,** «Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike». II, Tiranë, 1969, 200-201.
4) Ky ambient në banesën me gjysmëkat perpendikulare ka emërtime të ndryshme, sipas qyteteve dhe krahinave. Kështu në Gjirokastër quhet «dimërore», në Berat «shtëpi zjarri», në Krujë dhe Malësinë e saj «mëdhaçkë», në Kurvelesh «magjërri».
5) K. Zheku, **Kulla Kruetane** «Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike». II, Tiranë 1969, 223, 225.
6) E. Riza, **Banesa popullore në Shkodër, gjatë shek. XVIII-XIX** «Monumentet» 4, 1972, 158,
7) A. Meksi, E. Riza, **Ndërtimet në fshatin rrënojë të Kamenicës,** në këtë numër.

njohim deri më sot, kur gjurmimi dhe studimi i ndërtimeve fshatare ende nuk ka përfshirë mbarë vendin, këtë banesë e gjejmë të ndërtuar në Malësinë e Krujës[8]), në fshatrat e Dropullit të Sipërm, në Kurveleshin e Sipërm[9]) dhe në fshatin Borsh[10]) të rrethit të Sarandës. Në këtë artikull do të trajtojmë vetëm shembujt e ndërtuar në qytet, pa u ndalur në ato të ndërtuar në fshat, të cilët janë bërë objekt i artikujve të veçantë.

Banesa me gjysmëkat perpendikulare ka një ndarje të qartë funksionale, ndërmjet pjesës së poshtme përdhese dhe asaj të sipërme, pjesërisht përdhese e pjesërisht me kat. Pjesa e poshtme është gjithmonë e pabanuar dhe formohet nga ambienti i vetëm i katoit, i cili shërbente për depozitimin e lëndëve djegëse dhe, në shumë raste, për strehimin e kafshëve. Pjesa e sipërme e banuar është kompozuar me një ambient të vetëm apo dy të tillë, të vendosur përbri njeri-tjetrit ose të ndarë me një lloj parahyrje, në variantin më të zhvilluar. Në variantin e thjeshtë, në këtë ambient banimi, zhvillohet jeta e familjes në të gjitha aspektet e saj. Në variantin me dy ambiente, njeri është shtëpia e zjarrit kurse tjetri dhoma e miqve. Shtëpia e zjarrit ndërtohet gjithmonë në pjesën përdhese të katit të banuar. Ambienti tjetër është dhoma e miqve. Trajtimi i brendshëm i këtyre ambienteve është i ndryshëm. Shtëpia e zjarrit ndërtohet përdhese e pa tavan, me ndriçim të dobët që e merr kryesisht nga baxhatë. Dritaret janë të pakta, me hapësira të vogëla, dhe në mjaft raste ato mungojnë. Oxhaku ndërtohet në ballin që i mbështetet terrenit. Dollapet e murit dhe musandrat zenë një pjesë të mirë të brendësisë së këtij ambienti. Në dallim nga ky ambient, dhoma e miqve, me sipërfaqe më të madhe, ka ndriçim të bollshëm nga dritaret e ballit. Shpesh numri i tyre rritet, duke ndërtuar dy të tilla në secilën faqe anësore. Dhomat kanë tavan, dhe shtrohen me dysheme dërrase. Oxhaku ndërtohet në njerën nga faqet anësore. Banesa zakonisht i ka ambientet sanitare të ndërtuar jashtë konturit katërkëndësh këndrejtë të planimetrisë të mbuluar me zgjatimin e njerës flegër të çatisë. Krahas këtyre veçantive të përbashkëta këto banesa kanë dhe ato lokale, prandaj ajo që duhet theksuar më tepër, është se dhe banesa me gjysmëkat perpendikulare, e ndërtuar në një diapazon kohor relativisht të gjatë, ka pësuar zhvillimin e saj, sidomos në trajtimin e elementeve të veçantë arkitektonikë. Kështu dhe kjo banesë ndjek influencat e ndryshimeve që filloi të pësojë banesa qytetare shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shekullit 19, duke rikonstruktuar kryesisht ballin e katit të banuar, ku vendin e dritareve të vogla të mbuluara me hark e zenë dritaret e mëdha në konstruksion me skelet druri. Në Berat shpesh u rrit sipërfaqja e banuar, duke dalë balli në formë erkeri. Banesat e këtij lloji, të ndërtuar gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, si në trajtimin e brendshëm, ashtu dhe atë të jashtëm mbajnë vulën e kohës, duke ruajtur kompozimin karakteristik volumor. Për të krijuar një kuadër të kësaj banese, në zgjidhjet e saj të ndryshme po japim një përshkrim të shkurtër të disa ekzemplarëve tipikë, duke filluar nga ata më të thjeshtët. Ekzemplarët që do të paraqiten janë ndërtuar në qytetet e Gjirokastrës, Beratit dhe Krujës, ku kjo banesë ka gjetur një përhapje të gjerë në të kaluarën.

Një ekzemplar i thjeshtë dhe interesant është banesa Nr. 1 (fig. 1) e ndërtuar në lagjen Mangalem të Beratit. Kjo banesë është dykatshe, katin e posntëm e zë katoi, kurse në të sipërmin me sipërfaqe më të madhe, pjesërisht përdhes, është vendosur ambienti i vetëm i banimit. Në anën e përparme dyshemeja e këtij ambienti është më e ngritur, duke u diferencuar kështu nga pjesa tjetër. Në ballin e kësaj ane, që paraqet një lloj qoshku, janë vendosur dritaret. Në pjesën fundore të ambientit, është vendosur nyja sanitare dhe musandra. Oxhaku është ndërtuar karshi hyrjes së vetme, në të cilin të çojnë shkallë prej guri. Ky variant dykthinësh, prej të cilëve vetëm njeri i banuar, sot takohet mjaft rrallë. Atë e gjejmë më fort në «oda jashtat» e banesës gjirokastrite, duke qënë kështu përpara fenomenit të njohur të përdorimit të formave të lashta të banesave si ambiente me funksione të dorës së dytë të banesave të mëvonëshme më të zhvilluara.

Varianti tjetër i banesës më gjysmëkat perpendikulare me dy kthina banimi është më i përhapur se i mësipërmi. Një shembull tipik është banesa Nr. 2 (tab. I, fig. 2), në lagjen Goricë të Beratit. Katoi me hyrje të veçantë ka zgjidhjen e zakonshme. Kati i banuar përbëhet nga dy ambiente: shtëpia e zjarrit dhe dhoma e miqve me hyrje të veçantë, pranë njera-tjetrës. Të dy ambientet i ndan musandra dhe sipër saj mafili. Anash musandrës krijohen dy parahyrje njera i shërben shtëpisë së zjarrit, ndërsa tjetra ndërlidh të dy ambientet ndërmjet tyre, si dhe ata me nyjen sanitare, që i ngjitet anash banesës. Shtëpia e zjarrit është përdhese, pa tavan dhe ndriçohet nga një dritare. Oxhaku është ndërtuar si zakonisht në faqen që i mbështetet terrenit. Dhoma e mirë ka ndriçim të bollshëm. Banesa ka pësuar një rikonstruksion nga çe-

8) B. Strazimiri, **Banesa popullore në Malësinë e Krujës,** në këtë numër.
9) E. Riza, **Banesa popullore në Kurveleshin e Sipërm.** Ruhet në Arkivin e I.M.K.
10) Informacion nga A. Baçe.

PROTOCOPY



Fig. 1

reku i tretë i shek. XIX, siç duket nga trajtimi i faqes fundore të dhomës së mirë.

Trajtim interesant të këtij varianti gjejmë në Krujë. Siç do të shohim më poshtë, banesat krutane me gjysmëkat perpendikulare kanë veçori dalluese nga banesat e këtij lloji të Beratit e Gjirokastrës, në disa zgjidhje funksionale dhe në elemente të veçantë arkitektonikë, por për nga kompozimi volumor ato mund të grupohen së bashku. Banesa Nr. 3 (tab. 2, fig. 3) ndërtuar në Krujë paraqet interes. Ambienti i katit përdhes «burgu», ka të njëjtat funksione si në banesat e përshkruara më lart. Por në dallim nga to, prej burgut me shkallë druri kalohet në rruginën ndërmjet dy ambienteve të katit të banuar. Këtë rruginë e formon një ndarje me dërrasa, në të cilën është vendosur një musandër dhe disa etazhere që i shërbejnë dhomës së miqve. Kjo nyje ndërlidh të dy ambientet e banuar të katit dhe dhomën e miqve me nyjen sanitare. Në dallim nga dhoma e miqve me hyrje nëpërmjet «burgut», shtëpia e zjarrit, e cila thirret «mëdheckë» ka hyrje drejtpërdrejt nga jashtë. Trajtimi arkitektonik i mëdheskës nuk ka ndonjë dallim nga ajo e të njejtit ambient në qytetet e tjerë, gjithashtu dhe oda e miqve në kompozimin e saj nuk dallohet për ndonjë veçanti të rëndësishme. Banesa Nr. 4 (tab. 3), gjithashtu e ndërtuar në Krujë, përfqëson më mirë tiparet e veçanta të kësaj banese. Hyrja kryesore e banesës ndërtohet dhe këtu në burg, por ajo është në faqen ballore, ndërsa shkallët janë ndërtuar përbri njerës faqe anësore. Hapësira e tyre në katin e banuar ndahet me perde dërrasash, ku janë vendosur të njejtët etazherë si dhe musandra, e cila nuk shërbehet drejtpërdrejt nga oda e miqve. Veçanti e kësaj banese është gjerësia më e madhe e odës së miqve në krahasim me mëdheskën për shkak të vendosjes së shkallëve, të cilat zenë një pjesë të sipërfaqes. Në këtë banesë gjejmë dhe qoshkun karakteristik të banesës krutane, i cili del jashtë konturit të planimetrisë. Ambientet sanitare këtu janë të veçantë për të dy kthinat dhe janë vendosur brenda konturit të planimetrisë.

DO NOT COPY

Një zhvillim më të madh merr kati i banimit kur ndërmjet dy ambienteve krijohet një parahyrje, e cila bën që hyrjet për në ta të mos jenë më drejtpërdrejt nga jashtë. Ky variant ka përhapje të gjerë. Shembull të tij mund të marrim banesën Nr. 5 (fig. 4, 5) në lagjen Goricë të Beratit, e cila ruan mirë mjaft elementë në gjëndjen origjinale. Kështu dritaret e dhomës së miqve, ashtu si dhe dyert e jashtme, janë mbuluar me hark gjysmërrethor, ndërsa katoi ndriçohet me dy hapësira në formë frengjije. Ambientet e banimit ndahen nga një parahyrje, e cila ndriçohet me një dritare të lartë. Shtëpia e zjarrit ndriçohet vetëm nga baxhaja. Një shembull me interes me të njejtën zgjidhje paraqet banesa Nr. 6 (tab. 3) në lagjen Palorto të Gjirokastrës. Veçanti karakteristike e saj është se një pjesë të hapësirës së ambientit, ku përgjithësisht vendoset katoi, e ze stera me marrje uji nga jashtë. Me një planimetri dhe brendësi më të përparuar paraqitet një banesë e këtij lloji (fig. 6), në lagjen Mangalem të Beratit[11]). Së fundi, me interes është një shembull i zhvilluar i banesës me gjysmëkat ndërtuar në lagjen «Kala» të Beratit më 1866. (Banesa Nr. 7, tab. IV). Në katin e banuar të saj janë vendosur radhazi tre ambiente dhe, anash tyre, një galeri e hapur ndërlidhëse. Siç përmëndëm, banesa me gjysmëkat perpendikulare takohet dhe në Shkodër në terrenin e pjerrët të lagjeve të vjetra, pranë kalasë. Në përgjithësi planimetritë e tyre kanë pësuar transformime, por ato dallohen qartë janë kompozuar me të njejtin koncept si banesat që po trajtojmë.

Nëse krahasojmë banesat me gjysmëkat perpendikulare të Gjirokastrës, Beratit dhe Krujës do të vërejmë se, ndërmjet tyre ka dallime. Përsa i përket zgjidhjes funksionale me rëndësi është dallimi, ndërmjet banesave të Gjirokastrës e Beratit me ato të Krujës. Ndërsa në të dy qytetet e parë, hyrja për në katin e banuar bëhet gjithmonë drejtpërdrejt nga jashtë, në Krujë hyrja për në dhomën e miqve bëhet nëpërmjet «burgut», duke qënë kjo hyrja kryesore, siç del nga përmasat dhe trajtimi i saj. Veçanti e banesës krutane me gjysmëkat perpendikulare duhet konsideruar dhe qoshku karakteristik, në formë konsoli, i cili shpesh i shtohet dhomës së miqve. Banesat e këtij lloji, në Gjirokastër e Berat, kanë tipare thuajse të njëllojta në planin kompozicional. Në to, hyrja për në katin e banuar, në dallim nga banesat e Krujës, bëhet gjithmonë nga jashtë, por në mjaft raste kemi konstatuar qenjen e një shkalle të thjeshtë shërbimi, që lidh katoin me katin e banuar. Trajtimi i ballit të banesës, gjithashtu ka paralele të qarta, ndërmjet



Fig. 2



Fig. 3

Beratit dhe Gjirokastrës në dallim nga Kruja. Kështu në dy qytetet e parë banesa me gjysmëkat perpendikulare ndahet zakonisht në ballë, në nivelin e dyshemeve të katit të banuar nga një kornizë karakteristike guri të dhëmbëzuar apo me forma të tiera. Në Krujë, nga shembujt që ruhen, ka një trajtim tje-

11) Shih. G. Strazimiri, **Disa tipare të arkitekturës së qytetit të Beratit** «Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike», Tiranë, 1965, tab. VI.

PHOTO COPY





Fig. 4

tër, ku spikat qoshku apo dritaret e shumta në çatma, të cilat i gjejmë të tilla dhe në shembujt e vonë, apo te rikonstruktuar të Beratit dhe Gjirokastrës. Ndërsa në Krujë këto banesa, ashtu si gjithë të tjerat, i gjejmë të mbrojtura me mure rrethues, në Berat, në disa raste, takojmë shembuj të lidhur drejtpërdrejt me rrugën. Përsa i përket elementeve të veçantë arkitektonikë dhe teknikës së ndërtimit, gjithashtu kemi ngjasime shumë të theksuara, ndërmjet Beratit dhe Gjirokastrës e disa veçanti në Krujë.

Këto banesa janë ndërtuar gjithmonë me mur guri, material rrethanor i bollshëm në zonat ku është përhapur kjo banesë. Muratura përforcohet me breza druri të maskuar nga jashtë, apo të vendosur në faqen e jashtme. Muratura lidhet me llaç balte ose me llaç gëlqereje. Duke vrojtuar banesat më të lashta të patransformuara më vonë, mund të themi se, në Gjirokastër dhe Berat dyert dhe dritaret mbuloheshin me hark gjysmërrethor, i cili për efekte dekorative thellohet pak karshi sipërfaqes së muraturës, ndërsa në Krujë me këtë lloj harku mbulohen zakonisht dyert e, shumë rrallë, dritaret. Çatia ndërtohet me sistem stropil, ajo në Gjirokastër mbulohet me rrasa guri, ndërsa në Berat dhe Krujë me tjegulla në formë lugu. Strehët janë të hapura dhe shpesh dyfishe sidomos në Berat. Në Gjirokastër dhe Berat ruhen disa ekzemplarë në të cilat katoi mbulohet me qemer cilindrik çfaqje kjo që nuk takohet në Krujë. Banesa është e suvatuar brenda, ndërsa jasht muratura është e zhveshur, me përjashtim të ballit të odës së miqve, kur ai ndërtohet me skelet druri. Në Berat dhe Gjirokastër shkallët e jashtme, që të çojnë në hyrjen apo hyrjet e katit të banuar ndërtohen prej guri, në disa raste mbi qemere cilindrik, ndërsa në Krujë shkallët e brendshme janë gjithmonë prej druri.

Arkitektura e jashtme e banesës është e thjeshtë dhe e ashpër, muratura e pasuvatuar thyhet vetëm nga dritaret dhe dyert. Në Gjirokastër dhe Berat, shpesh, një kornizë karakteristike guri (fig. 5) në nivelin e dyshemesë, ndan pamjen kryesore në dy pjesë,

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

ajo punohet në forma të ndryshme dhe, siç duket, ka funksion dekorativ. Volumi i ndërtimit lidhet shumë mirë me terrenin për vetë formën e kompozimit volumor.

Me interes është të shikojmë rrugën e zhvillimit të kësaj banese në qytetet e Gjirokastrës, Beratit dhe Krujës, të cilat kanë pasur dallime të shënuara në natyrën e tyre ekonomike. Gjirokastra, deri nga mesi shek. XIX, qe më fort një qendër administrative dhe shkëmbimi, një pjesë e mirë e popullsisë merrej me blegtori e bujqësi. Banesa me gjysmëkat, duke gjykuar nga përhapja e saj në lagjet periferike dhe nga ndërtimi i saj si «oda jashtë», në banesat e mëdha gjirokastrite duket se ka pasur përhapje të gjerë ajatë shek. XV-XVI. Fuqizimi i shtresave të pronarëve të tokave bëri që kjo banesë të marrë një zhvillim të shpejtë, duke kaluar gradualisht në skema kompozicionale më të përparuara, deri sa aty rreth mesit të shek. XVIII, duke gjykuar nga të dhënat e derisotme, u arrit në variantet e zhvilluara të banesës gjirokastrite. Berati kishte një natyrë tjetër ekonomike, ai që prej shek. XVII ishte kryesisht një qendër zejtaro-tregëtare. Deri aty nga mesi i shek. XIX, zejtarët dhe tregtarët beratas ndërtuan banesa të thjeshta me gjysmëkat perpendikulare në tre lagjet me terren më të vështirë ndërtimi: Kala, Mangelem dhe Goricë. Krahas kësaj banese, në dy lagjet e fundit, gjejmë mjaft të përhapur ndërtimin e banesave me shtrirje gjatësore të kompozuara me gjysmëkat, si dhe improvizime të shumta për t'ju përshtatur terrenit. Gjatë shek. XIX fuqizimi ekonomik i shtresave zejtaro-tregëtare gjeti pasqyrim dhe në rritjen e kërkesave për një banesë më komode. Kjo u shoqërua me uljen e aftësive mbrojtëse të saj. Prishja e ndërtimeve ekzistuese ishte një barrë e rëndë dhe, aq më tepër, dëndësia e ndërtimeve dhe terreni i vështirë nuk lejonte zgjidhje të lira, prandaj u preferua rikonstruksioni i katit të banuar, e sidomos i pamjes kryesore, duke i dhënë kështu lagjeve të përmëndura trajtimin arkitektonik që ruajnë ende sot.

Kruja ishte një qendër e vogël që kishte si bazë ekonomike olivikulturën, blegtorinë dhe zejtarinë. Këto shtresa me fuqi ekonomike të kufizuar banesës me gjysmëkat perpendikulare i dhanë një trajtim më të përparuar, kryesisht, përsa i përket brendësisë së odës së miqve e, veçanërisht, ballit të saj, në krahasim me banesën e të njejtit lloj në Malësinë e Krujës.

Banesa që trajtojmë është lloji më i përhapur në banesën popullore shqiptare. Ajo gjatë shek. XVI-XIX është ndërtuar gjerësisht në tre qendrat qytetare të përmëndura. Siç e tregojnë disa ekzemplarë, ajo ka qenë ndërtuar edhe në Shkodrën e vjetër. Në anën tjetër, kjo banesë njihet dhe në shumë fshatra të zonave kodrinore dhe malore. Kjo të tërheq vëmëndjen për faktin se këtu jemi përpara një fenomeni uniteti, ndërmjet banesës qytetare dhe asaj fshatare. Bashkë-

DO NOT COPY

jetesa e kësaj banese, për një kohë relativisht të gjatë në fshat dhe në qytet, gjithashtu është me interes, për të treguar lidhjet fshat-qytet, dhe nivelin e këtij të fundit në periudha të ndryshme. Mosnjohja e banesës në qytetin shqiptar gjatë mesjetës së mesme (shek. XI-XIV) e bën të vështirë zgjidhjen e problemit se, cili është dhënës në binomin fshat-qytet, madje, është krejtësisht e mundshme që, në këtë rast, të kemi të bëjmë me zhvillime të pavarura duke qënë se banesa në fjalë, ka një kompozim të thjeshtë. Në favor të këtij mendimi janë dhe shembujt e të njejtit koncept kompozicional në Maqedoni[12]), Mal të Zi dhe Herzegovinë[13]). Kjo banesë, siç e pamë, pati zhvillim të pabarabartë në qendra të ndryshme. Aty ku gjeti kushte të përshtatëshme ajo u zhvillua, ndërsa në disa qendra ajo ruajti gjatë tiparet themelore, duke pësuar një far zhvillimi vetëm në elemente të veçantë arkitektonikë dhe, në përgjithësi, në trajtimin e brendshëm. Programi i saj i thjeshtë pasqyron shkallën e zhvillimit të shtresave zejtare të qytetit, si dhe të një pjese të popullsisë që nuk u shkëput nga ekonomia bujqësore e blegtorale.

Banesa me gjysmëkat perpendikulare njihet në truallin tonë që në shek. XIV-XV, siç e dëshmojnë rrënojat e Kamenicës. Ndërtimi i saj në qytet ka shumë mundësi të ketë filluar që me krijimin e «Varosheve», pra, gjatë shek. XIII-XIV, të cilët, siç dihet, ndërtoheshin si lagje të banuara, pranë kalave në terrene të pjerrët. Ndërtimi i saj vazhdoi me ritëm të ndryshëm për një kohë relativisht të gjatë, deri aty nga mesi i shekullit të kaluar, duke qënë kështu një nga banesat më të lashta të vendit.

Banesa me gjysmëkat perpendikulare, ka një karakter të mbyllur, ndërtuar me material të fortë, ajo deri aty nga mesi i shekullit të kaluar kishte hapësira të vogla ndriçimi vetëm në dhomën e miqve, ndërsa shtëpia e zjarrit, zakonisht ndriçohej nga baxhatë a ndonjë dritare e vogël. Ky karakter tepër i mbyllur i jep kësaj banese tipare mbrojtëse, në kuptimin se ajo nuk mund të dhunohet lehtë. Por vendosja e saj në terren e dobëson mjaft këtë tipar, duke qënë se pjesa e mbrapme e saj është shumë e ulët nga trualli. Ekzistenca në Kamenicë e ekzemplarit të banesës me kullë[14]), tregon qartë se aftësia mbrojtëse e kësaj banese ishte larg kërkesave për një sigurim të mjaftueshëm. Zhvillimi i kësaj banese shihet qartë se ka kaluar nga banesa përdhese, duke marrë kati i banuar një zhvillim më të shtrirë për shkak të terrenit. Shembujt me një kthinë të banuar, veçanërisht ata me të hershmit në Kamenicë, e bëjnë të qartë se kjo banesë (varianti me dy kthina) nuk mund të shikohet si e lindur nga kryqëzimi i banesës fshatare-malore prej guri, dhe të kullës shqiptare[15]). Gjithashtu ne e konsiderojmë variantin me gjysmëkat te «kulla krutane», siç parashtruam më sipër, të të njëjtit lloj me banesat me gjysmëkat perpendikulare të Gjirokastrës dhe Beratit dhe nuk jemi të mendimit se ajo ka lindur nga «bashkimi i mbëdheskës me kullën shqiptare»[16]).

Banesa që trajtojmë ka një zhvillim të natyrshëm nga varianti me një kthinë të banuar, në atë: me dy kthina, i cili nuk rezulton të jetë një bashkim mekanik i dy banesave me karakteristika të ndryshme, por zhvilim i diktuar nga nevoja për një ambient të veçantë nga shtëpia e zjarrit. Shembujt e disa banesave në Krujë, ku mëdheska ndërtohet anash banesës me kat, duke përbërë këto dy njësi një banesë të vetme, nuk mund të shërbejë si argument për të mbështetur mendimin se këtu kemi thjeshtë një bashkim, përderisa ekzistojnë banesa me kat me një ambient poshtë dhe një sipër, duke qënë ky i fundit «shtëpia e zjarrit». Nga pikpamja e programit banesa me gjysmëkat është e njëjtë me këto, por ato kanë ndryshime të dallueshme në kompozim. Nga ana tjetër banesa me gjysmëkat nuk ka lidhje me kullën shqiptare, banesë e fortifikuar e përdorur nga shtresat e gjera të popullsisë fshatare në shumë zona të Shqipërisë së Veriut, për vetë faktin se kulla si banesë fshatare është një fenomen i vonë, që nuk e kalon shek. e XIX, siç kanë treguar dhe studimet e fundit[17]). Si përfundim, mund të themi, se banesave me gjysmëkat është një lloj i lashtë i banesës popullore shqiptare, që ndërtohej prej shek. XIV në zonat kodrinore e malore, popullsia e të cilave merrej kryesisht me blegtori. Kjo banesë pati një përhapje të gjerë dhe në qytetet shqiptare, që patën si bërthamë fillestare kalatë. Ndërtimi i saj vazhdoi përgjatë shekujve të mëvonshëm, deri aty nga mesi i shekullit të kaluar.

12) Tomoski. S., **Makedonska narodna arhitektura,** Skopje, 1960.
13) B. Kojiç. **Sëska arhitektura i rurizëm,** Beograd, 1958, 38-39.
14) A. Meksi, E. Riza, **art. cit.**
15) G. Strazimiri, **art. cit.,** 200.
16) K. Zheku, **art. cit., 209.**
17) P. Thomo, **Banesa popullore e tipit kullë në Mat dhe në Mirditë.** «Studime Historike», 1, 1970, 129.

TAB. I



DO NOT COPY

BANESA Nr. 3



PAMJE KRYESORE



PAMJE ANESORE



KATI PERDHES

0 2 4 6M



KATI I PARE

DO NOT COPY

DO NOT COPY

BANESA Nr. 4



PAMJE KRYESORE



KATI I PARE



PREMJA A-A

0 2 4 6 M

BANESA Nr 6



PAMJE KRYESORE



KATI PERDHE



KATI I PARE

0 2 4M

BANESA Nr. 7



PAMJE KRYESORE



PREMJE A-A

0 2 4 6 M



KATI I PARE



KATI PERDHE

DO NOT COPY

Emin RIZÀ

L'HABITATION A DEMI-ETAGE PERPENDICULAIRE

RESUME

L'habitation à demi-étage perpendiculaire occupe une place particulière dans l'architecture de la maison albanaise type, urbaine et rurale, du fait qu'elle est largement répandue dans les villes bâties sur des terrains escarpés; notamment pendant le moyen âge, ainsi que dans nombre de villages édifiés dans des zones de collines et de montagnes.

Le concept de demi-étage se rattache à la composition volumétrique de la construction elle-même. Il s'exprime par le développement inégal de la surface et du volume des étages, l'étage supérieur étant plus large que celui inférieur. Ainsi, dans la partie arrière se crée un échelonnement caractéristique et la construction suit l'inclinaison du terrain en engendrant des changements de volume selon les étages. La composition volumétrique à demi-étage se reliant étroitement à la déclivité du terrain, cette solution ne se rattache pas à un seul type d'habitation donné. Ainsi, cette composition volumétrique concerne les différentes variantes de la maison type de Gjirokastra et certaines autres maisons à tchardak *de Berat.*

Dans la foule d'habitations à demi-étage, la maison à demi-étage perpendiculaire occupe une place toute particulière du fait qu'elle est largement répandue et se distingue par son programme et ses propriétés architectoniques et de construction presque analogues. C'est pourquoi, à notre sens, nous sommes en présence d'un type de maison à soi dans le cadre de l'habitation type albanaise.

La maison à demi-étage perpendiculaire se caractérise par un programme simple, comportant la pièce à rez-de-chaussée destinée aux animaux, une seule chambre d'habitation, en partie au rez-de-chaussée et en partie en étage, ou deux chambres pareilles, dont l'une sert de «maison du feu» et l'autre de «chambre des amis». Ces maisons étaient largement répandues dans les centres urbains et ruraux albanais. Nous en trouvons un bon nombre à Gjirokaster, Berat et Kruje. Quant à Shkoder, elle n'en conserve qu'un nombre restreint d'exemplaires dans les quartiers surmontant des collines dans l'ancienne ville. En ce qui concerne les campagnes, mentionnons en premier lieu les maisons à demi-étage du village de Kamenice, dans le district de Sarande, ce qui prouve l'existence lointaine de cette habitation sur notre territoire. Partout des connaissances actuelles, la recherche et l'étude des habitations paysannes n'ayant pas encore embrassé le pays tout entier, ce type de maison concerne également la Malesi de Kruje, les villages du Dropull Siperm, Kurvelesh Siperm et autres contrées du pays.

La maison à demi-étage perpendiculaire se caractérise par une nette séparation fonctionnelle entre l'étage inférieur au rez-de-chausée et l'étage supérieur destiné à l'habitation. L'étage habitable comporte deux pièces ou une seule. Dans les variantes simples, ces pièces sont contiguës et, dans celles plus développées, elles sont séparées par un antichambre.

De la confrontation des maisons à demi-étage perpendiculaires de Gjirokaster, Berat et Kruje, il ressort qu'elles ne sont pas tout à fait analogues. Plus proches entre elles sont, soit pour ce qui concerne la composition de l'étage habitable que les différents éléments architectoniques et de construction, les maisons de même type de Gjirokaster et

DO NOT COPY

de Berat, quant à celles de Kruje elles se caractérisent par des propriétés particulières.

L'habitation objet de notre étude est celle qui a connu la plus grande extension dans le cadre de la maison type albanaise. Pendant le XVIe–XIXe siècles, elle a été largement construite dans les trois centres urbains susmentionnés. Par ailleurs, on la retrouve aussi dans maints villages situés dans des zones de collines et de montagnes. Ce fait même montre que nous sommes en présence d'un phénomène généralisé, unique, rattachant l'habitation urbaine à celle rurale. Ce type d'habitation s'est développé précisément là où il a trouvé des conditions favorables, alors qu'ailleurs il a conservé pendant un long temps ses traits fondamentaux, subissant seulement un certain développement en ce qui concerne ses différents éléments architectoniques et, en général, le traitement de son intérieur.

L'habitation à demi-étage perpendiculaire date chez nous dès le XIVe–XVe siècle, comme l'attestent les constructions en ruines du village de Kamenice. Son extension aux centres urbains se rattache vraisemblablement à la fondation des Varosh, donc aux XIIIe–XIVe siècles, qui furent alors édifiés en tant que qartiers à soi, à proximité des forteresses, sur des terrains escarpés. La construction de la maison à demi-étage perpendiculaire s'est poursuivie, à des cadences différentes, pour une période de temps relativement longue, jusqu'à la moitité du siècle dernier.

Ce type d'habitation se distingue par son caractère fermé, qui lui confère des traits défensifs, assertion qui pourtant est gravement compromise par le fait que la partie arrière de cette maison est très peu élevée du niveau du sol.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Dhimosten BUDINA
Spiro KOÇO

DO NOT COPY

PUNIMET RESTAURUESE NË DISA MOZAIKË NË QYTETIN E LASHTË TË APOLONISË.

Gjatë fushatave të gërmimeve të viteve 1958–1960, në shpatin perëndimor të pjesës veriore të qytetit të Apollonisë, në anën e majtë të rrugës, e cila lidh fshatin e sotëm të Pojanit me muzeun e qytetit u zbuluan mbeturinat e një shtëpie banimi të shek. I të e. sonë.[1]) e cila zë një sipërfaqe të madhe prej reth 2500 m². Godina ka pasur dy oborre me peristil: I pari, i vendosur në pjesën verilindore të shtëpisë dhe i dyti, që është pak më i vogël, në pjesën jugperendimore. Rreth e përqark këtyre oborreve ngriheshin dhoma të shumta me destinacione të ndryshme: dhoma banimi dhe pritje, dhoma me sistem ngrohje (hipokaust) dhe t'atilla për qëllime ekonomike.

Një sasi dhomash të vogla dhe të mëdha kishin dysheme të shtruara me mozaikë polikrom, motivet e të cilave riprodhojnë figura të thjeshta dhe të ndërlikuara gjeometrike, si edhe skena figurative me subjekte të nxjerra nga mitologjia ose nga cikli i Luftës së Trojës.

Zbulimi i mozaikëve të tjerë në qendrat e ndryshme të vëndit, shtron në mënyrë urgjente problemin e konservimit dhe restaurimit të tyre. Prandaj eksperienca e fituar gjatë punimeve të këtij karakteri të ndërmarra në monumentin e lartpërmëndur, mund të vlejë për perfeksionimin e mëtejshëm të kësaj pune.

*
* *

Ndërmjet dyshemeve me mozaikë të zbuluara në këtë shtëpi, të tërheq vëmendjen dhoma e Nereides (tab. I, 1), e cila ndodhet në pjesën jugore të banesës. Dyshemeja e saj në formë katërkëndësh këndrejtë është zbukuruar me një mozaik polikrom, i cili dallohet për një ekzekutim të lartë artistik dhe për një larmi të madhe të ngjyrave në të. Vizatimi i mozaikut përbëhet nga dy pjesë kryesore: nga emblema, që është kuadri qëndror me kompozime figurale, dhe nga fusha e formuar prej brezash të ngushtë dhe të gjërë motivesh ornamentale.

Emblema ka formën e një kuadrati; sipërfaqja e saj është e ndarë në disa figura gjeometrike (tetëkëndësh, rreth, gjysmërrethi, çerekrrethi, brenda të cilave janë paraqitur figura të ndryshme të qenieve mitologjike, si peshq dhe të tjera. Tek fusha tetëkëndëshe është paraqitur Nereida, duke notuar mbi delfin, e cila formon subjektin qendror në këtë emblemë.

Dyshemeja e dhomës së Nereidës ka arritur tek ne në gjendje mjaft të dëmtuar. Nga koha ka humbur qëndrueshmërinë e tij dhe shtrati i mozaikut. Ai është bërë shumë i dobët dhe në shumë raste, duke u bashkuar me dheun e depërtuar nëpërmjet plasave, nuk ka mundur t'i mbajë me kubiket prej guri. Dyshemeja ka ruajtur gjurmat e meremetimit të herëpashershëm. Kështu në pjesën juglindore të ornamentit gjeometrik, ndodhet një arne e vogël vezake e përbërë nga kubikë ngjyrë kremi.

Tek dhoma e aktorëve, që ndodhet në pjesën veriperëndimore të shtëpisë, dyshemeja në formë katërkëndësh këndrejtë ka qenë shtruar gjithashtu me mozaikë shumëngjyrësh (tab. I 2). Në vizatimin e tij dallohen dy lloje figurash gjeometrike: një figurë e madhe me konture të rrumbullakuara në formë kryqi dhe një kuadër qendror, që ka gjithashtu formën e figurës së kryqit, por me përmasa më të mëdha, në të cilën paraqitet skena teatrale dhe disa portrete njerëzish.

1) Gërmimet u drejtuan nga S. Islami (shih **Gërmimet në Apolloni dhe Orik në vitin 1958,** B.U.SH.T., seria Shk. Shoq. 1, 1960, 1).
Në zbulimin e kësaj shtëpie mori pjesë dhe Dh. Budina bashkëautori i këtij artikulli.

Mozaiku i dyshemesë ka qënë i prishur që në kohët e lashta. Në sipërfaqen e tij janë ruajtur gjurmë zjarri. Për këtë dëshmojnë gjithë njollat e mëdha të dyshemesë së djegur, si rezultat i sëcilës disa kubikë kanë marrë dhe nuanca të veçanta. Mirëpo shkatërrimet më të mëdha në shtrojën e mozaikut janë shkaktuar nga lëvrimi i vazhdueshëm i tokës në vendin e gërmimit.

Në anën lindore të oborrit të dytë shtrihet një koridor, dyshemeja e sëcilës në formë katërkënde këndrejtë ka qenë shtruar me mozaikë polikrom[2]). Vizatimi i tij ka një kompozim relativisht i thjeshtë. Ai përbëhet nga dy pjesët: pjesa e parë, është një qilim i math me një ornament të dendur gjeometrik. Është i ndërtuar me metodën e rrathëve që ndërpriten.

Dyshemeja tjetër që tërheq vemendjen për mozaikun e saj të mrekullueshëm është ajo e dhomës B, e cila shtrihet në lindje të shtëpisë së banimit (tab. II, 1).

Pjesën më të madhe të mozaikut e ze emblema qendrore e ekzekutuar me teknikën opus vernikulatum. Emblema paraqitet me një kompozim shumë figurash polikrome, në të cilën janë paraqitur katër skena nga subjektet e amazonave. Emblema rrethohet nga një kornizë katërkëndëshe e përbërë nga katër motive ornamentale. Mozaiku ka arritur deri tek ne shumë i dëmtuar, megjithatë të katër skenat mund të riprodhohen komplet.

Me shumë interes është dhe mozaiku i dhomës që ndodhet në anën lindore të Amazonamahisë (tab. II, 2). Fusha qendrore paraqitet në formën e një katrori ku në qendër është vizatuar një rozetë e madhe. Përreth rozetës janë vizatuar katërkëndëshe këndrejtë të mbushura me figura të ndryshme gjeometrike. Vizatimet e bordurave janë të mbushura me figura të ndryshme si meandra ose katrorë të vegjël.

Përsa i përket përbërjes dhe veçorive të dheut që është përdorur në truallin e mozaikëve nuk ndryshon nga dherat e shtëpive të tjera të Apollonisë. Shtrojet e mozaikëve të shtëpisë së zbuluar nuk kanë bazë të fortë të pregatitur posaçërisht, siç kanë sikurse dihet, shumica e dyshemeve të kateve të poshtme të shtëpive antike të banimit. Mozaikët e zbuluara këtu ndodhen mbi një truall prej rëre dhe zall lumi. Shtrati i mozaikëve përbëhet prej llaçi gëlqeror të përzier me grimca tullash, me trashësi 7 cm. Llaçi ka ngjyrë rozë, është i shkrifët i paqëndrueshëm dhe me kokrriza. Qendrueshmëri të veçantë i jepte kësaj shtrese përzierja me grimca tulle. Shtresa e dytë, në të cilën janë vendosur direkt kubiket e mozaikëve është shumë e hollë, mesatarisht 3-4 mm. Ky është një komponim homogjen shumë i qëndrueshëm në ngjyrë të bardhë, që pregatitet pothuajse vetëm nga gëlqereja duke shtuar lëndë fibroze.

Zakonisht në mozaikët e Apollonisë është përdorur gjërësisht guri gëlqeror mikrokokrizor shumëngjyrësh. Kubiket, zakonisht kanë një madhësi prej 7 mm² deri në 1 cm². Formati i tyre nuk është i njëliojtë. Midis tyre hasen shpesherë gurë të vegjël në formë katërkëndëshi këndrejtë, trekëndëshi dhe në formë të çrregullt. Gurët e vegjël trekëndësh janë të përdorur zakonisht për mbushjen e hapësirave këndore të sfondit dhe të motiveve të veçanta. Për figurat e ndryshme të njerëzve apo të kafshëve, si dhe detajet e imta janë përdorur kubikë të vegjël nga 3 mm² deri në 6 mm². Përveç gurit gëlqeror në mozaikët e Apollonisë janë përdorur dhe kubikë të pregatitur nga copa tullash, qelqi dhe gurë të tjerë.

Gjatë radhitjes së motiveve të mozaikëve të Apollonisë piktorët kanë përdorur teknikën e kombinuar. Në paraqitjen e motiveve më të thjeshta (ornamentet gjeometrike) është përdorur teknika opus tesselatum ndërsa në paraqitjen e vizatimeve figurale të emblemave qendrore që janë më të imta për nga vizatimi dhe ngjyra kanë përdorur opus verniculatum.

PUNIMET RESTAURUESE

Në vitin e parë dhe të dytë të zbulimit të mozaikëve u morën masat e para për përforcimin e shtresave që u zbuluan me mozaik, u thurën bordura dhe u mbushën gropat me një përzierje çimentoje me allçi që të mos lëviznin vëndit kubikët që formojnë figurat (fig. 1). Pas këtij operacioni të vogël u bë fotografimi dhe skicimi i mozaikëve. Më vonë filloi dhe kopjimi dhe restaurimi i tyre[3]. Për këtë qëllim në vitet 1960

1) Dh. Budina, **Rezultatet e gërmimeve në sektorin D.** Doreshkrimi ruhet në arkivin e sektorit Arkeologjik viti 1959, 12.

3) Kopjimi dhe restaurimi i disa pjesëve të vogla të mozaikëve të zbuluara në shtëpinë e banimit filluan që në vitin 1959, të cilat shërbyen si bazë e punës restauruese në stil të gjërë gjatë viteve 1960-1961 dhe 1965-1966. Kopjimi i mozaikëve u krye nga nxënësit e Liceut Artistik «J. Misja» të udhëhequr nga N. Kodheli, piktor i sektorit arkeologjik. Ndërsa restaurimi dhe trajtimi i mozaikëve u bë nga grupi i atelieve pranë sektorit arkeologjik dhe restautori i sektorit S. Koço. Një kontribut të mirë në këtë drejtim, gjatë viteve 1965-1966, ka dhënë S. Kosta skulptor i sektorit arkeologjik. Të gjitha punimet restauruese të para në mozaikët e zbuluara me këtë shtëpi banimi u drejtuan nga arkeologu Dh. Budina antar i këtyre gërmimeve.

POROSOPY



Fig. 1

-1961 dhe 1965-1966 u ndërmorën punime restauruese në stil të gjërë në disa mozaikë të zbuluara në shtëpinë e banimit të shekujve të I-rë të e. sonë. Gjatë kësaj kohe u kopjuan ose u restauruan: dhoma e Nereides, aktorëve, dhoma me figura gjeometrike, koridori dhe dhoma e amazonomahisë.

Fazat kryesore që u përdorën gjatë proçesit të restaurimit të këtyre mozaikëve ishin dy: a) kopjimi dhe b) Shkulja e mozaikëve.

Kopjimi i mozaikëve. Në përgjithësi kopjimi i mozaikëve ishte një punë e vështirë dhe delikate meqënëse kërkonte nga piktori një durim dhe kujdes të madh, veçanërisht në përcaktimin e toneve dhe nuancave të ngjyrave si edhe kohë të mirë dhe me diell. Me proçedurën e mëposhtëme u kopjuan mozaikët e dhomës së Nereides, dhomës me figura gjeometrike, aktorëve, amazonomahisë dhe mozaiku i shtëpisë së banimit që u zbulua në anën jugore të kodrës së qytetit.

Puna e parë që u krye ishte pastrimi i kujdesshëm i sipërfaqes së mozaikut që do të kopjohesh. Mbas kësaj sipërfaqen e lame me ujë e sapun dhe e fërkuam lehtë me furçë të zakonshme. Gjatë kohës së pastrimit treguam kujdes së veçantë që kubikët pak të lëvizshëm të mos luajnë nga vendi i tyre dhe pjesët e dëmtuara të mos shkatërohen më tej.

Pasi u krye në rregull i gjithë proçesi i pastrimit të mozaikut bëmë një kontroll të kujdeshëm në të gjithë sipërfaqen e dyshemesë, duke shikuar nëse ndonjë nga kubikët qëndronte më lart ose më poshtë se të tjerët. Për këtë qëllim në sipërfaqen e dyshemesë bëmë një rrafje të lehtë me anën e një çekani prej druri me formë cilindri, në mënyrë që gurët e mozaikut mundësisht të zinin vendet e tyre fillestare.

Pas dystimit të mozaikut, vendet ku mungonin kubikët u mbushën me një përzierje çimentoje me allçi.

Mozaikun që do të kopjohesh e lame edhe një herë me ujë e sapun, duke e fërkuar lehtë me furçe robash derisa atij ja hoqëm të gjitha papastërtirat që mund të kishte mbledhur gjatë punimeve.



Fig. 2

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

Pregatitëm letër çiklostil ose filetër me format 20 x 30 cm. dhe mbasi e njomëm me ujë të pastër e shtruam me kujdes në dysheme, në mënyrë që letra të mos dëmtohesh dhe gurët të dilnin mirë në relief (fig. 2). Në rast se letra e shtruar grisej gjatë vendosjes, atëhere vendet e dëmtuara u arnuan, përsëri me letër çiklostili. Letrat u ngjitën njera me tjetrën me anë të kollës të pregatitur prej nishesteje. Në këtë mënyrë vazhduam deri sa u mbulua krejt sipërfaqja e mozaikut. Sipër kësaj shtrese vendosëm dhe një tjetër shtresë me letra çiklostili, por kësaj here ngjitjen e bëmë në krejt sipërfaqen e vendosur më parë. Në këtë mënyrë pregatitëm atë që ne e quajtëm papiermashe.

– Mbasi shtruam letrën çiklostil shënuam me anë të penelit ngjyrat origjinale të gurëve. Kjo na ndihmoi më vonë në mbushjen e kubikëve me ngjyrat e veta edhe në një ambient tjetër të mbyllur kur koha ishte e keqe.

– Kur u tha letra e vendosur me krejt fushën e mozaikut, pregatitëm një gomallak të holluar në ngjyrë kafe të erët, me të cilën lyem krejt sfondin. Kjo ngjyrë krijoi vijën, që ndante kubikët e ngjyrosur nga njeri-tjetri.

– Kur kaluan 30 minuta letra u tha mirë dhe filloi të shkolitej nga mozaiku. Atëhere ne filluam t'a zhveshim letrën nga dyshemeja, duke e mbledhur në formë cilindri që të mos deformohej.

Mbas pregatitjes së papiermashesë ne filluam kopjimin e tij. Ngjyrosja e kubikëve u bë duke vështruar nga sipër mozaikun origjinal në mënyrë që të kontrollonin më mirë ngjyrat duke i qëndruar sa më besnik ngjyrave origjinale. Kur koha nuk qe e përshtatëshme për këtë proçes, puna u vazhdua në ambient të mbyllur. Ritokimi i fundit u bë në kohë të mirë sipër mozaikut origjinal.

Kur mbaruam ngjyrosjen e rregullt të krejt mozaikut, pregatitëm merlë (napë) të bardhë që u ngjit me kujdes në pjesën e prapme të papiermashesë.

Shkulja e mozaikut. – Përveç kopjimit në vitin 1960 bëmë përpjekjet e para për restaurimin dhe trajtimin e një pjese shumë të kufizuar të një mozaiku të shtëpisë së banimit. Ne zgjodhëm një nga mozaikët me figura sa më të thjeshta, siç ishte koridori, dhe ai jo i tëri por në një sipërfaqe shumë të kufizuar. Pjesa që do të trajtohesh zuri një sipërfaqe prej 16 m^2 deri në parapetin ndarës, i përbërë nga një rresht blloqe gurësh në forma të rregullta paralelpipede. Në vitin tjetër mbas provës së parë të suksesshme ne filluam restaurimin e plotë të koridorit dhe në vitet e mëpastajme u restauruan dhoma e aktorëve, dhoma me figura gjeometrike dhe dyshemeja e dy ambienteve përbri kësaj dhome. Rruga e ndjekur për trajtimin e tyre qe po ajo që përdorëm në koridorin duke evituar disa gabime të vogla që u konstatuan më parë. Lidhja ndërmjet copave të shkëputura me shtresën e betonit të thjeshtë u realizua përmes një shtrese llaçi bastart shumë të hollë ose u vendosën letra thasë çimentoje, në mënyrë që mozaiku mund të shkëputej me lehtësi në të arthmen. Njëkohësisht para se të shkëputej mozaiku u hodh në letër

DO NOT COPY

dhe u caktuan mirë format e ndarjes së mozaikut, në mënyrë që kur të vendosej përsëri të zinte po atë sipërfaqe që kishte në fillim. Pavarësisht nga këto ndryshime të vogla zhvendosja dhe vendosja e mozaikut u krye si më poshtë: mozaiku në fillim u pastrua mirë me ujë e sapun duke e fërkuar me kujdes me furçë të butë, që të mos ngelte asnjë papastërti në të. Ekzistenca e tyre në kohën e ngjitjes së letrës me tutkall krijon boshllëqe, kështu që në kohën e shkuljes kubikët rrëzohen.

Mbas pastrimit filluam ndarjen e formave që do të shkuleshin, afërsisht me përmasa 1+1 m. Ndarjen e bëmë me një fill spango që e ngjitëm midis gurëve me tutkall. Vija e spangos ndoqi formën e figurës gjeometrike. Gjatë këtij proçesi ne larguam edhe disa nga gurët e formave që do të ndaheshin njera nga tjetra. Por kjo u bë me kujdes që të mos humbisnin pozicionin e tyre që është baza e domosdoshme për montimin e mëvonshëm.

Format e ndara i lyem me tutkall dhe sipër tyre shtruam letër filtër ose çiklostil, të cilën e rrahëm me furçë gjersa kubikët dolën në relievi. (fig. 3). Në këtë mënyrë vepruam deri sa mbuluam të gjithë sipërfaqen e mozaikut që do ta trajtonim. Mbi letrat shtruam merlen e bardhë dhe të pastër të cilën e kishim lyer gjithashtu me tutkall (fig. 4) dhe e rrahëm edhe këtë me furçe, që të merte formën e letrës dhe të kubikëve.

Kur tutkalli me letrën dhe merlen ishin tharë mirë, morëm një daltë të mprehtë dhe me anë të çekanit, duke e goditur ndoqëm vijën e spangos që tregonte rrugën nëpër të cilën do të bëhesh prerja e mozaikut. Kështu vazhduam derisa ndamë të gjitha format që përbënin këtë mozaik. Sipër çdo forme shënuam me bojë numrin rendor që do të na orientonte më vonë për montimin e mozaikut në pozicionin origjinal në shtresën e re të betonit (fig. 4).

— Filluam shkuljen e mozaikut me anë të thikave, duke i shtyrë këto midis bazës së kubikëve dhe harasanit ose llaçit që i ka mbajtur të fiksuar. Me lëvizje anësore të thikave dhe me një dorë ngritëm gradualisht bazën dhe letrën ku ishin ngjitur kubikët. Të gjitha format e shkulura i shtrimë në një fushë që të thaheshin. Format i vendosëm përmbys dhe duke ndjekur numrat rendorë filluam pastrimin me thika të përshtatëshme të të gjitha formave duke larguar dheun ose llaçin që kishte ngelur midis tyre (fig. 5). Pastrimi u bë me shumë kujdes. Para se të bënim derdhjen e çimentos kontrolluam edhe njëherë format se mos kishin pluhur ose papastërtira të tjera midis kubikëve.

Pas pastrimit bëmë pregatitjen e armaturave në formë zgare me hekur 6 ose 8 milimetrash, duke i lidhur mirë këto për të siguruar që mozaiku të mos bënte lëshime ose çarje në fushën e vet. Format e mozaikëve që kishim pregatitur për t'i derdhur i shtri-



Fig. 5



Fig. 6

For not COPY

më përmbys në një platformë të niveluar mirë. Mandej bëmë rrethimin e çdo forme me rripa teneqeje, të cilat qanë jo më tepër se 4 cm. të gjerë. Pregatitëm një përzierje bujake çimentoje jo shumë të trashë dhe e shtrimë sipër kubikëve derisa ta mbulonte këtë. Pastaj shtruam një dorë të dytë me përzierje prej tri pjesësh rërë, një pjesë çimento dhe një sasi gëlqere. Kjo përzierje u shtri mbi të parën gjer në sipërfaqen ku mbaron teneqeja. Pastaj vendosëm armaturën metalike, e cila u mbulua krejtësisht nga çimentoja.

Dymbëdhjetë orë mbas derdhjes së formave, kur çimentoja kishte marë forcimin e vet, larguam fashot prej teneqeje dhe me kujdes, me anë të spatulës larguam çimenton në formë skarpati. Po në këtë kohë shenuam numrat rendorë për çdo formë me anën e gërryerjes.

Kur kaluan 48 orë, format e derdhura i lëvizëm nga vendet e tyre dhe i kthyem për të parë figurën e mozaikut. Pastaj filluam largimin e merles dhe letrës dhe mozaiku u la mirë me ujë që të zhdukej tutkalli dhe figurat të dilnin të pastra.

Në truallin ku u shkul mozaiku bëmë një kontroll të terrenit. Në thellësinë 0.30 m. doli menjëherë shtresa sterile në ngjyrë të verdhë.[4]) Pastaj kryem nivelimin e tij, duke e rrahur tabanin me tokmak që të mos mbante boshllëqe dhe të mos krijonte më vonë deformime me mozaikun.

Për vendosjen definitive të mozaikut të koridorit betoni u pregatit me tri pjesë zhavor të hollë dhe një pjesë çimento dhe u shtrua aty ku filloi montimi i formës së parë. Trashësia e betonit nuk shkoi më tepër se 7 cm. Mbi këtë beton shtruam formën, duke ndjekur një farë pendencë, në mënyrë që ujrat të mos ndaleshin sipër mozaikut (fig. 6). Kështu u veprua sipas numrave duke kontrolluar që figurat të shtriheshin e të lidheshin pa asnjë difekt derisa mozaiku i zhvendosur të zinte vendin e vet në sipërfaqen e dyshemesë. Nga përvoja që fituam nga një provë mendojmë se mozaiku nuk duhet të vihet përgjithmonë, me qenë se zhvendosja e tij e mëtejshme është tepër e vështirë për ta realizuar. Për më tepër në rast të ndonjë gabimi që mund të ndodhë gjatë punës është gjithashtu vështirë për tu korigjuar. Për këtë arsye mozaikët e tjerë u vendosën në mënyrë të lëvizshme. Morëm dy mastarë të drejtë sa gjatësia ose gjerësia e dhomës dhe i vendosëm mbi betonin. Niveluam dyshemen duke pasur kujdes që trashësija e betonit të mos i kalonte 5 cm.; njëkohësisht betonit i dhamë



Fig. 7

4) Gërmimi nën mozaik na dha mundësi të gjurmojmë muret që në themel të tyre. Ato ishin ndërtuar me copa tullash dhe gurë të lidhura me llaç gëlqereje me të njëjtin material sikurse qe ndërtuar e gjithë banesa. Muret gjatë kohës së ekzistencës së vet nuk kishin pësuar ndonjë rindërtim apo merametim, ato i përkisnin të njëjtës periudhë ndërtimi që ka e gjithë banesa.

FOTOCOPY

pendencën e nevojshme të shtrimit për kullimin e ujrave. Nga ana e numrit formën e lyem me vaj lubrifikant dhe pastaj simbas madhësisë së formës shtruam një letër prej thasë çimentoje,[5]) që krijonte impermeabilitet midis formës dhe shtresës duke mos lënë mozaikun që të zhytet në çimento dhe në të njejtën kohë duke e stabilizuar mozaikun që u inkasua në betonin e freskët sipas relievit të vet. Në këtë mënyrë mozaikun mund ta zhvendosim e vendosim në vende të ndryshme. Me këtë metodë u bë vendosja e mozaikut të dhomës me figura gjeometrike.

Kur mbaruam vendosjen e mozaikut sipas mënyrës të përshkruar më lart, filluam qepjen e formave që të nxirrnim kështu figurën e përgjithëshme (fig. 7). Qepjen e bëmë duke plotësuar vendet në të ndarat e figurave me kubikët që kanë lëvizur nga vendi i tyre (fig. 8).

Në mënyrë që të lidhen mirë kubikët ndërmjet tyre derdhëm në të gjithë sipërfaqen çimento fino.

Më në fund mbasi mbaroi i gjithë procesi i trajtimit të mozaikut atë e lamë me ujë të bollshëm dhe e fërkuam me furçë dhe me fshesë deri sa të hiqeshin të gjitha mbeturinat e çimentos nga sipërfaqja e mozaikut. Për t'ju shmangur plasaritjeve që mund të pësonte mozaiku nga thatësira për disa ditë rresht ne i hodhëm ujë në të gjithë sipërfaqen e restauruar. Pastaj e lamë të thahesh mirë.

Gjatë kësaj kohe pregatitëm një sasi parafinë të shkrirë me benzinë të pastër, sipas raportit 1 kg. parafinë me 10 litra benzinë. Me këtë solucion lyem të gjithë sipërfaqen e mozaikut me dy deri në tri duar. Pastaj e lamë të thahet jo më tepër se gjysmë ore dhe mandej e fërkuam me furçë të butë. Këtë punë e bëmë jo vetëm për të mbrojtur sipërfaqen e tij, por njëkohësisht edhe për të gjallëruar ngjyrat e kubikëve.

Për të siguruar më mirë mozaikët muarëm mushama plastmasi transparent dhe e mbuluam të gjithë sipërfaqen e dyshemesë të restauruar. Sipër mushamasë shtruam një shtresë rërë lumi me trashësi deri në 20 cm., të cilën e ngjeshëm mirë.

* * *

Kanë kaluar më tepër se dhjetë vjet nga koha që ne kemi bërë restaurimin e mozaikëve që përshkruam më lart, dhe deri tani ne nuk kemi konstatuar as-



Fig. 8

një gjurmë dëmtimi. Mbi to, sot mund të kryhet çdo lloj pastrimi si larje me ujë të bollshëm, fshirje me furçë ose me fshesë në çdo kohë të vitit.

Metoda që në përdorëm në restaurimin e mozaikëve të Apollonisë përdoret gjerësisht në shumë vende të Evropës.[6]) Në Itali dhe Francë kanë filluar që armaturat prej betoni t'i zëvendësojnë me forma më të lehta, por ato janë akoma në fazën eksperimentale. Po të bëhej e mundur transferimi, në të gjitha rastet i kubikëve mbi një shtresë mbajtëse të lehtë, atëhere format e mozaikëve do të bëheshin

5) Në disa raste format me shtresën e betonit i lidhëm përmes një shtresë të hollë me llaç bastart. Në këtë mënyrë u veprua në eksedrën dhe dhomën me ujë.
6) A. Agazzi, **Il mosaico in Italia,** Milano, 1926, 116-120 shih dhe I. F. Roncuzzi, **Tecnologia del mosaico,** Ravenna, 1964, për kopjimin e mozaikëve shih f. 16. fig. 6, 7 e 10. Për pastrimin shih f. 47 fig. 23 dhe për shkuljen e tij f. 71 fig. 7, 8, 9 dhe 12.

DO NOT COPY

më të përdorëshme dhe do të lëviznin më lehtë nga një vend në një vend tjetër.

Nga të dy mënyrat e përmendura për zhvendosjen dhe vendosjen e mozaikëve më e përshtatshme është ajo e vendosjes jo definitive. Lidhja me çimento e shtresës së betonit me format e mozaikëve, ashtu siç vepruam në mozaikun e koridorit, e vështirëson shkuljen e mëtejshme të tij në rast të transportimit në ndonjë vend tjetër apo të ndonjë veprimi të gabuar. Vendosja definitive mund të bëhet vetëm në raste të veçanta.

Trajtimi i mozaikëve të përshkruar më lart është më i përshtatshëm për dyshemetë e mozaikëve me figura të thjeshta gjeometrike. Përsa i përket dyshemeve të tjera, me figura më të komplikuara siç është p.sh. amazonomahia apo dhoma e Nereides, kërkon metoda edhe më të perfeksionuara se sa kjo që përdorëm në rastet e lartpërmendura. Megjithatë duhet të mos harrojmë se çdo dysheme me mozaik ka veçoritë e saj që të detyron gjatë punimeve të bësh dallime në vënien në veprim të parimeve teorike dhe praktike. Asnjë metodë nuk mund të zbatohet në mënyrë shabllone dhe kjo, natyrisht, është një çështje përvoje dhe eksperience të gjatë.

Në trajtimin e mozaikut të koridorit duke mos pasur përvojën e duhur nuk bëmë që në fillim ndarjen e sipërfaqes në forma të caktuara, por e bëmë pjesë-pjesë kështu që në fund të provës na mbeti një rrip i ngushtë 20 cm. jashtë sipërfaqes së koridorit. Ky gabim u korigjua menjëherë në kohën e trajtimit të mozaikëve të tjerë, të cilët mbas mbarimit të punimeve zunë po atë sipërfaqe që kishin mozaikët para restaurimit. Prandaj është e nevojshme dhe e domosdoshme që ndarja e sipërfaqes të bëhet para trajtimit me spango dhe të hidhet edhe në letër.

Një e metë tjetër, që vumë re gjatë trajtimit të mozaikëve na duket se është edhe mbushja e hapësirave ndërmjet kubikëve me fino çimento. Kjo mënyrë veprimi i jep sipërfaqes së dyshemesë ngjyrën e theksuar gri ashtu sikurse është vetë çimentoja. Ndoshta këtij solucioni duhet shtuar ndonjë lëndë tjetër që ti avitet më tepër lëndës fibroze në të cilën nguliten kubikët.

Këto rezultate të para që ne nxorëm nga këto prova do të na shërbejnë pa dyshim për restaurimet e mëtejshme, që do të bëhen në mozaikët e tjerë të Apollonisë, dhe të mozaikëve të qendrave të tjera të vendit tonë, të cilat do ti paraqesin ato me një gjendje më të mirë dhe, njëkohësisht do të kthehen në këtë mënyrë në një gjendje më të përshtatëshme për kopjimin dhe studimin e tyre.

DO NOT COPY





DO NOT COPY

DO NOT COPY





Dhimosten BUDINA
Spiro KOÇO

RESTAURATION DE MOSAIQUES DECOUVERTES DANS LA VILLE ANCIENNE D'APOLLONIE

RESUME

A la suite des expéditions de recherches et de fouilles effectuées dans la partie septentrionale de la ville d'Apollonie, pendant la période s'étendant de 1958 à 1960, ont été découvertes les ruines d'une maison d'habitation du Ier siècle de notre ère dont le périmètre occupe une surface de 2.500 m.

Parmi les diverses mosaïques mises à jour dans cette maison, une attention toute particulière mérite celle de la chambre de la Néréide. Son plancher rectangulaire est pavé de mosaïques polychromes, dont le dessin comporte deux parties principales: l'emblème et le fond qui est représenté par des bandes étroites et larges de motifs ornementaux,

En ce qui concerne l'emblème, elle est de forme rectangulaire et reproduit différentes figures géométriques, à l'intérieur desquelles sont représentés des personnages mythologiques et des poissons. Dans un octogone est reproduite la figure de la Néréide montée sur un dauphin.

La loge des artistes, de forme rectangulaire et située dans la partie SO de l'habitation, est également ornée d'un pavement de mosaïques polychromes. Le fond du pavement comporte deux sortes de figures géométriques, dont la figure grande est à contours arrondis en forme de croix et le carré central toujours en forme de croix, mais de dimensions plus petites, reproduit des scènes de pièces théâtrales et des portraits de personnes.

Du côté est de la deuxième cour s'étend un couloir, dont le pavement rectangulaire est agrémenté de mosaïques polychromes à dessins géométriques compliqués. Le motif ornemental est représenté par des cercles qui se coupent et constituent de la sorte des rosettes quadrifoliées.

Un autre pavement qui frappe l'attention pour son admirable mosaïque est celui de la chambre B, située dans la partie orientale de la maison et reproduisant une scène d'amazonomachie.

D'un grand intérêt est également la mosaïque de la chambre aménagée du côté est de l'Amazonomachie, où l'on relève une nette prévalence du motif géométrique.

Les mosaïques sont disposées sur un terrain représenté par du sable et des cailloux fluviatiles. Leur lit est constitué par une couche de mortier de chaux mélangé à de la poudre de briques d'une épaisseur de 7 cm. et par une deuxième couche, d'une épaisseur moyenne de 3-4 mm., dans laquelle sont assemblées les cubiques de mosaïques.

Les divers pavements de mosaïques représentent un assemblage de pierres ayant des dimensions différentes, mais surtout de pierres calcaires microgrenues polychromes.

Les peintres d'Apollonie se sont servis de la technique combinée pour l'exécution des motifs ornementaux. En ce qui concerne les motifs simples, ils ont employé la technique opus tesselatum; *quant à la représentation du dessin des emblèmes centrales, qui sont plus délicates, il les ont travaillé en vermicoulure* (opus verniculatum).

Pendant le processus de restauration de ces mosaïques, on s'est servi de deux méthodes principales: du calquage des mosaïques et de leur détachement.

On a commencé tout d'abord par nettoyer soigneusement la surface des mosaïques qui allaient être copiées, en y éloignant la terre et les autres corps qui s'y trouvaient. Ensuite

DO NOT COPY

cette surface a été lavée avec de l'eau au savon et frottée légèrement avec une brosse ordinaire.

Une fois cette opération terminée, on a soigneusement appliqué sur le plancher des feuilles de papier à rotaprint ou de papier-filtre de format 20 x 30 cm., préalablement imprégnées d'eau propre, de manière à ce qu'elles ne s'endommagent pas et reproduisent fidèlement le relief des pierres. Par la suite toute la surface des feuilles de papier a été enduite d'une colle préparée à l'amidon, de façon à créer ce qu'on appelle dans le langage technique un papiermasche. A l'aide d'un pinceau, sur cette surface, ont été reproduites les couleurs originales des pierres afin de les copier plus tard, pendant l'assemblage des cubiques. Après le séchage des feuilles de papier, leur surface a été enduite d'une couche de gomme laque de couleur brun foncé. Au moyen de cette opération, nous avons réussi à créer une ligne séparant les cubiques teints les uns des autres.

Au bout de 30 minutes la surface de papier étant sec, on l'a enlevé du pavement de mosaïques et enroulé sur lui-même. Ensuite il lui a été appliqué une couche de toile fine comme cela se fait avec les cartes géographiques.

Le pavement de mosaïques, à son tour, a été lavé avec de l'eau au savon et frotté avec une brosse a filaments souples de maniere à éliminer toutes les saletés. Ensuite il a été divise en des carreaux de dimension 1+1 m., en se servant à cette intention d'une ficelle qui a été collée entre l'interstice des pierres. Ainsi la ficelle reproduisait la forme des figures géometriques. Au cours de ce processus nous avons également enlevé quelques pierres aux carreaux qui allaient être separés les uns des autres.

Les carreaux separés ont été enduits de colle et recouverts de papier-filtre ou de papier à rotaprint, qui a été tamponné avec une brosse pour reproduire le relief des cubiques. Toute la surface du pavement qui allait être restauree a subi le même traitement. Puis contre la surface de papier a été appliquée une toile fine enduite de colle, qui a été également tamponnée avec une brosse en vue de reproduire la forme du papier et des cubiques.

Une fois terminée l'assemblage des mosaïques, nous avons commencé la couture des différentes formes afin de recomposer la figure générale. Il s'agissait précisément de remettre en place les cubiques précédemment enlevés le long des lignes séparant les figures les unes des autres. A cette intention la surface du pavement a été recouverte d'une couche de ciment liquide, puis les cubiques ont été incrustés à leur place de façon à ce qu'ils se trouvent au même niveau que les autres pierres.

o
o o

Bien que dix ans soient déjà passés depuis la restauration de ces mosaïques, nous n'avons relevé à ce jour aucun signe d'altération. Pour les protéger des effets négatifs du verglas, il importe toutefois de les couvrir avec du matériel plastique puis avec une couche de sable propre.

Le traitement complet des mosaïques est indiqué particulièrement quand leur support est fragile et que leurs cubiques se détachent continuellement, ainsi que quand leur conservation présente de leur intérêt.

La méthode de restauration que nous avont employé convient surtout aux pavements de mosaïques à motifs ornementaux géométriques simples. En ce qui concerne les autres pavements, à figures géométriques plus complexes, tels que celui de l'Amazonomachie ou de la chambre de la Néréide, leur restauration exige l'application de méthodes plus perfectionnées.

Les résultats atteints à ce jour, grâce à ces premiers essais, nous servirons sans doute de point d'appui pour la restauration d'autres pavements de mosaïques d'Apollonie et d'autres centres archéologiques du pays. Ce qui nous permettra évidemment de leur donner non seulement un aspect plus présentable, mais de faciliter aussi les opérations de reproduction et d'étude les concernant.

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DY NDËRTIME TË TIPIT TREKONKËSH

DO NOT COPY

Në këtë shkrim[1] do të trajtojmë arkitekturën e dy ndërtimeve të tipit trekonkësh, Shën-Kollin në fshatin Kurjan dhe trapezarin e manastirit të Shën-Mërisë së Apollonisë në Pojan, të dyja në rrethin e Fierit. Në njerën prej tyre, në atë të Kurjanit, gjatë vitit 1970 kryem punime restaurimi, të cilat do ti paraqesim këtu bashkë me studimin.

* * *

Kisha e Shën-Kollit ndodhet në një kodër pranë fshatit Kurjan të rrethit të Fierit. Si kisha ashtu edhe varrezat pranë saj kanë qënë të braktisura prej kohësh. Kisha deri më sot ka qënë e njohur nga studjuesit për afreskat e Joanit dhe Nikollës së Onufrit që datohen në gjysmën e dytë të shek. XVI[2]).

Në gjëndjen përpara punimeve të restaurimit kisha, në anën jugore, kishte një hajat drejtkëndësh pjesërisht të rrënuar, me mure prej guri dhe llaçi balte. Një këmbanore e ulët ndodhej në kontaktin e hajatit me narteksin (fig. 1). Nga teknika e ndërtimit hajati kuptohej lehtë se ishte një shtesë mjaft e vonë. Vetë kisha si ndërtim më i vjetër përbëhet nga narteksi dhe naosi (fig. 2). Narteksi gjëndet, si zakonisht, në anën perëndimore të kishës. Ai ka një planimetri drejtkëndëshe me brinjën më të gjatë, atë që shtrihet nga veriu në jug. Sot narteksi mbulohet me çati druri, ndërsa forma e vjetër ka qënë një qemer cilindrik në drejtim lindje-perëndim. Nga ky sot ruhen gjurmët e harkuara në muret verior e jugor dhe fillimet e tij në muret lindor dhe perëndimor. Në narteks hyhet nga tre anë. Hyrja kryesore është ajo e perëndimit, që mbulohet me arkitra guri. Dy hyrjet e tjera, nga të cilat ajo nga veriu është e mbyllur, janë mbuluar gjithashtu me arkitra guri.

Narteksi komunikon me naosin, nëpërmjet një dere të vendosur në mes të murit ndarës. Naosi përpara restaurimit ishte në formë bazilike trenefëshe. Nefat ndaheshin ndërmjet tyre me nga një pilastër me mur guri dhe një shtyllë druri. Pilastrat të vendosura ndërmjet naosit dhe ambientit të altarit janë me seksion katror dhe janë ndërtuar, njera prej gurësh të madhësive të ndryshme të lidhur me llaç gëlqereje ndërsa tjetra me tulla të ndërprera në çdo 5-6 rradhë me një pllakë guri. Ata mbarojnë me nga një kapitel të stilit korintik, të pa përfunduar dhe të përmbysur. Përpara këtyre dy pilastrave ndodhet një ikonostas druri, që ndan naosin nga ambienti altarit. Të dy kolonat e drunjta kanë seksion drejtkëndësh dhe përfundojnë me jastekë druri të punuar, të tipit që përdoret në banesat me çardak, mbi të cilat është tavani prej dërrase. Të dyja kolonat mbështeten mbi kapitele dorike të vënë përmbys, direkt mbi dyshemenë me pllaka guri të çrregullta, mesatare nga madhësia. Ky rregullim i tavanit duhet të jetë i vonë, sepse ai zë një pjesë të mbulesës së absidës dhe afreskat shtrihen edhe mbi të. Naosi komunikon me ambientin e jashtëm nëpërmjet një dere të absidës jugore. Një derë të tillë, që sot është murosur, ka edhe absida veriore. Të dy konkat janë vendosur simetrikisht ndaj pilastrave dhe kolonave të drunjta. Lartësia e tyre është më e vogël se e absidës lindore. Absida lindore shkon

1) Rilevimet janë të autorit, S. Dashit, L. Sulit dhe E. Soppit fotografitë të R. Veselit dhe autorit.
2) Th. Popa, **Piktura të tjera të piktor Nikollës zbuluar në Kurjan të Fierit,** B.SH.SH. 4, 1960, 226-228.



Fig. 1

deri në tokë, në muret anash saj janë dy pilastra që shkojnë deri në lartësinë e pilastrave të lira, mbrapa ikonostasit. Protezisi është gjysëm rrethor dhe ndriçohet nga një dritare si frengji, ndërsa diakonikoni është një kamare drejtkëndëshe. Anash këtyre, në muret jugore e veriore, ka nga një kamare tjetër.

Ndërsa dyshmeja e ambientit të altarit është e çrregullt, pjesa ndërmjet pilastrave dhe ajo e mureve gjatësorë është e rregulltë dhe në nivel më të lartë. Kemi të bëjmë me gurë të gdhëndur dhe të vendosur në rregull. Dy bazamente të njëllojtë (me formë trung piramide të përmbysur) janë për secilën nga pilastrat. Në drejtimin tërthorë kishës ata kanë në të dy anët e pilastrit nga një kanal. Boshllëqe të tjera të vendosura në mënyrë të rregullt kanë dhe gurët që janë në dysheme. Këto rregullshmëri na shtyjnë të mendojmë se kemi të bëjmë me gurë në të cilët mbështetej dhe mbërthehej ikonostasi i gurit që kishte dikur kjo kishë. Shënojmë se në qendër të dyshemesë gjëndet një pllakë guri, përmasat e së cilës na shpien në mendimin se ajo shërbente si pllakë e ikonostasit. Në të dallohen bordurat anësore dhe figura shpendësh në reliev.

Muret e kishës janë ndërtuar kryesisht me tulla të lidhura me llaç gëlqereje, ndërsa me gurë janë ndërtuar qoshet dhe shpatullat e dyerve. Mjaft fragmente arkitektonike, skulpturalë, antikë dhe paleokristianë, si dhe një gur varri janë vënë në mënyrë të çrregullt jo vetëm në faqet e jashtëme të mureve të kishës por dhe në ato të brendshmit. Tullat me të cilat është ndërtuar muri janë të trasha, jo karakteristike për kohën e ndërtimit të kishës dhe ka shumë të ngjarë që të jenë sjellë nga Apollonia ose ndonjë vënd tjetër, ashtu si dhe gurët e tjerë.

Muret ngrihen mbi një xokol, duke formuar një shkallëzim, të cilin nuk e kanë vetëm absidat anësore. Nëpër qoshet e mureve, anët janë të ndërtuara në formë pilastrash, me gurë të mëdhenj të skuadruar, të cilët janë të vendosur alternativisht në njerën e në tjetrën faqe. Këto pilastra janë në një plan vertikal me xokolin, kështu që faqet e mureve janë të kuadruar brënda pilastrave në anët vertikale dhe xokolit e kornizave në brinjët horizontale.

Duke vrojtuar muret e kishës do të shohim se ato janë të meremetuara në pjesët e sipërme, ku përfundojnë me një kornizë të çrregullt. Muratura e këtij meremetimi është ndërtuar me tulla të lidhura me llaç balte. Vite më parë, duke qënë se balta e fugave

DO NOT COPY

DO NOT COPY



0 1 2 3

PLANIMETRIA

Fig. 2

ishte shpëlarë, në sipërfaqe të murit fugat u plotësuan me llaç gëlqereje, duke fëlliqur dhe tullat. Kjo ka bërë të dallohen lehtë shtesat por, në të njëjtën kohë, të mos kuptohet mirë teknika e këtij meremetimi. Muri perëndimor (tab. I) është i gjithë i vjetër. Në mes të tij gjëndet porta qëndrore, me shpatulla prej gurësh dhe arkitrarë guri në të cilën është gdhendur një dekor floreal. Shpatullat e derës dalin jasht murit njëlloj me pilastrat e qosheve. Mbi to është një hark gjysmërrethi me tulla, i cili vazhdon në të dyja anët me nga katër harqe lombarde më të vegjël, që mbështeteshin në konsola me tulla të nxjerra nga muri, ndërsa harqet e fundit (anësore) mbështeten në një dhëmb konsol të nxjerrë nga pilastri. Mbi harqet,

në një plan me to, vazhdon muri i plotë, deri tek korniza e re dhe e çrregullt. Në këtë mur, në të dy anët e derës, janë hapur më vonë dy dritare të vogla.

Muret veriore dhe jugore (tab. II), në përgjithësi janë të njëllojtë; absida trefaqëshe në pjesën e naosit me kornizë horizontale, dhe nga një portë në pjesën e narteksit me kornizë të pjerrët. Edhe këtu pilastrat ndodhen në qoshet e mureve dhe në takimin e aksidës me murin. Pjesa që i takon narteksit mbulohet me çati të veçantë njëujëse me rrjedhje nga perëndimi. Ajo është e tëra e vjetër dhe përfundon nën kornizën me katër harqe, që fillon direkt mbi pilastrin në qoshe dhe mbaron në vëndndarjen e narteksit me naosin. Harqet s'kanë as madhësi as nivel të njëjtë. Harku i fundit nga lindja është më i madh dhe përfundon vertikalisht në mënyrë të rregullt. Në mes të narteksit ndodhet porta jugore e tij me shpatulla prej gurësh të mëdhenj dhe arkitrarë guri të rrafshët. Anash portës ndodhet një gur, sot i këputur e i vendosur normal murit, barabar me konsolat e tjera pranë derës veriore të narteksit dhe asaj të absidës jugore. Porta veriore e narteksit sot është e zënë. Ajo ruan të plota të dy kupolat. Përsa i përket arkadës mbi të sot ruhen vetëm 3 harqe, ndër të cilët, i fundit, përfundon mbi portën dhe ka pranë mure të ri me llaç balte.

Absidat trefaqëshe anësore nuk janë të dyja të njëllojta. Absida jugore ka një portë të mbuluar me hark të mprehtë dhe, në njerën anë, ka një gur konsol, ndërsa porta veriore është më arkitra dhe s'ka as konsola, as gjurmë të tyre në mur. Kjo absidë përfundon me një çati të ulët. Absida jugore ka dhe një veçanti tjetër sepse ka dy çati në nivele të ndryshme. Për të shpjeguar këtë vrojtuam muret nën to dhe rezultoi se ata janë të ndërtuara me tulla dhe llaç balte, pra, janë të rindërtimit të shek. XVI. Gjithashtu pamë se në të dy anët e portës ka pasur konsola dhe se muri mbi to, është i meremetuar. Prezenca e konsoleve dhe forma e meremetimit mbi to na shtynë të mendojmë se këtu kemi pasur portikë ashtu si në kishën e manastirit të Apollonisë[3]). Gjatë këtij meremetimi është përfunduar absida me dy çati, mundet, për thjeshtim pune. Edhe pjesët e sipërme të mureve veriore dhe jugore, janë të rinj dhe me tulla e llaç balte.

Tek muri lindor i kishës (tab. III, 1), del një absidë trefaqëshe me një dritare pjesërisht të murosur në faqen e mesit, e cila ka në shpatulla afreske, që presupozon datimin në shek. XVI. Pilastrat janë në qoshe të absidës dhe përfundojnë lart me harqe me tulla. Fusha brënda këtyre harqeve është dekoruar e gjitha me tulla të vendosura në formë zig-zake. Pikërisht në nivelin e thembrave të këtyre harqeve është fuga e takimit të murit të vjetër në murin e ri me llaç balte. Nga jugu ky mur fillon direkt mbi gurin kornizë të pilastrit, ndërsa nga veriu pak më poshtë. Si absida ashtu dhe kallkani i kësaj fasade përfundojnë me një kornizë jo shumë të rregullt. Dritarja në absidë është e rrethuar më brënda faqes nga një radhë tullash dhe mbulohet me hark. Një hark sektorial ndodhet mbi të. Në pjesën që i takon në interier prothezisit, muri është i kurbuar jo në tërë lartësinë dhe ka një dritare të vogël. Për mbështetje të këtij muri shërben një kapitel i stilit dorik me përmasa të konsiderueshme që del pak prej murit (tab. III, 3).

Nga studimi i mësipërm i mureve dhe strukturave të kishës së Shën-Kollit në Kurjan dallojmë dy faza kryesore ndërtimi. Kisha, e parë sot, përfaqësohet me pjesën më të madhe të mureve me përjashtim të pjesës së sipërme të tyre të ndërtuara me llaç balte (tab. VI), që përbën dhe shenjën dalluese ndërmjet këtyre dy fazave. Gjatë kësaj faze të dytë është bërë dhe pikturimi i kishës, sepse muri i ri përfundon në mënyrë të rregullt në pjesën e brëndshme, e cila është pikturuar në tërë frontonin. Një meremetim i mëvonshëm i është bërë çatisë duke shtuar dhe tavanin që zë një pjesë të absidës dhe frontonin mbi të.

Përcaktimi i formave fillestare të kishës përmban në vetvete një sërë vështirësish. Së pari, në pjesën e kontaktit, ndërmjet dy fazave s'kemi të ruajtur asnjë gjurmë që të flasi qartë se si vazhdonin më lart këto mure. Së dyti, influenca romanike më të theksuara, siç janë harqet lombarde, e kufizojnë përdorimin e analogjisë me arkitekturën e manastirit të Apollonisë dhe në format e tjera. Në planimetri kisha i përmbahet në vija të përgjithëshme tipit trekonkësh, vetëm se duhet të përcaktojmë organizimin e brëndshëm të naosit. Prezenca e dy pilastrave tek ikonostasi, përjashton që në fillim formën njënefshe, duke lënë dy mundësi, atë bazilikale dhe atë kryq i brëndshëm mbi kupol në mbështetje të brëndshme. Po të vërejmë në planimetri ambientin e altarit, do të shohim qënien në të njëjtën vijë të pilastrave të lira dhe pilastrave që dalin në murin lindor, pranë absidës. Po qe se do të konsideronim distancën ndërmjet tyre si hap të arkadës ndarëse të nefave, do të shohim se pilastra apo kolona do të binin në mes dy konkeve anësore, gjë që për pasojë bije shkëputjen e tyre nga naosi. Nga ana tjetër, mungojnë në murin perëndimor pilastrat, që zakonisht hasen në bazilikat.

Mbetet për të trajtuar mundësinë e tipit kryq i brendashkruar me kupol. Këtë na e sugjeron edhe

3) A. Meksi, **Arkitektura dhe datimi i kishës së manastirit të Apollonisë** «Monumentet», 1, 1971, tab. I, 1.

Bototon

vendosja, thuajse në këndet e një katrori e dy pilastrave dhe kapiteleve dorikë të përmbysur. Këta të fundit do të kenë shërbyer si bazamente të kolonave, të nevojshme për mbështetjen e harqeve mbajtës të kupolës. Deri përpara restaurimit, siç pamë dhe më lart, këto shërbenin si bazamente për kolonat e drunjta. Për një qëllim të tillë ato mund të vendoseshin drejt mbi dysheme, ndërsa po të kishim ngarkesën e qemereve dhe kupolës, do të duhej të kishim pa tjetër themel. Për këtë sonduam aty dhe na rezultoj se nën kapitel kishte dy gurë të mëdhenj njëri mbi tjetrin në formë themeli të çrregullt (tab. III, 4). Shtojmë se i tillë është dhe themeli që patëm mundësi të shohim në murin perëndimor të narteksit. Sidoqoftë, duhet të pranojmë se këto argumenta nuk janë të mjaftueshme. Sadopak në favor të kësaj hipoteze mund të ishte dhe fakti që konkat anësore janë pikërisht në mes të pilastrave dhe «kolonave», pra, kemi të bëjmë me një ndërtim normal të naosit. Argument tjetër janë dhe pilastrat në murin lindor, që duhet të kishin një vazhdimësi me hark në pilastrat mbrapa ikonostasit, zgjidhje kjo normale për ambientet këndorë të kishave të këtij tipi.

Le të shohim se sa mundësi ka kjo hipotezë sikur të vrojtojmë muret e vjetra të kishës nga jashtë sepse nga brënda afresku nuk na lejon të shohim tullat e murit. Si zakonisht, narteksi, i cili ruhet thuajse tërësisht, ndodhet në nivel më të ulët se mbulesat e naosit. Këtu muret e naosit janë në nivel më të ulët se narteksi, prandaj i vetmi element që mund të sqarojë diçka është pilastri në këndin juglindor, i cili ruhet tërësisht së bashku me gurin kornizë, gjë që do të thotë, po të pranojmë analogjinë me narteksin, se muri përfundonte aty. Duke qënë se kjo kornizë është nën nivelin e çatisë së absidave anësore do të thotë se jo e tërë çatia është në të njëjtin nivel, por pjesët këndore janë në nivel më të ulët se sa pjesa qendrore. Megjithëse pjesa e sipërme e absidës së bashku me pilastrat është e re, struktura e saj (qemeri i konkës) është i vjetër, pra, dhe nuk bije në kundërshtim me konkluzionin e sipërmë (tab. III, 6). Një zgjidhje e tillë, me çatinë qëndrore në nivel më të lartë, të bën të mendosh për një kishë të tipit kryq i brëndashkruar me kupol mbi tambur.

Sidoqoftë, ruajtja e mureve të vjetër në nivel të ulët, pa gjurmë të mbistrukturave, qoftë dhe minimale e bën gjithënjë të vështirë zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi. Ne nga çka parashtruam më sipër, jemi të prirur për variantin e kishës të tipit kryq i brëndashkruar me kupol.

Në verën e vitit 1970, duke konsideruar gjëndjen e strukturave të çatisë jo të mirë, ashtu edhe rrënimin e pjesshëm të hajatit të vonë në anën jugore, u ndërmorën punime restaurimi[4]), Ndërhyrjet patën për qëllim vlerësimin maksimal të monumentit. Si të tilla u konsideruan punimet konsoliduese të pjesëve të sipërme të mureve, duke përfshirë këtu edhe pastrimin e tyre nga llaçrat e hedhura, rigjenerimin e strukturave të drunjta, dhe largimin e hajatit jugor. Kjo ndërhyrje çliruese e fundit na u duk me vënd: së pari, se vlera e saj është minimale, së dyti, se ndodhej pjesërisht e rënuar, dhe së fundi e shëmton së tepërmi monumentin. Rigjenerimi i strukturave të drunjta, punimet konsoliduese dhe ato pastruese të muraturës ishin të domosdoshme sepse diktoheshin nga vetë gjëndja e monumentit dhe nuk preknin vlerën dokumentare dhe shkencore të tij.

Punimet restauruese filluan me çlirimin nga hajati jugor. Mbas kësaj u kalua në prishjen e çatisë dhe tavanit të vjetër. Ky veprim i fundit nxori në dukje, në pjesën mbi çati të frontonit, një skenë të tërë afreskash të ruajtur mjaft mirë dhe që përbën një vazhdim të pikturës, që dekoron murin lindor të kishës dhe absidës. Gjithashtu rezultoi se rreshtat e sipërme të mureve që janë me llaç balte janë të dëmtuara dhe i shmangen vertikalitetit nga veprimi i agjentëve atmosferikë, që kanë kërkuar dhe suvatimin e tyre. Kjo e ka fëlliqur së tepërmi këtë pjesë.

Punimet konservuese konsistuan në shtytjen e murit perëndimor, i cili qe shkëputur nga vertikaliteti rreth 10–12 cm., kryesisht në pjesën jugore dhe në lidhjen me një brez beton arme, në pjesën e sipërme të mureve. Ky i fundit kishte jo vetëm funksion antisizmik por dhe mbronte nga infiltrimet e ujit murin me llaç balte dhe lidhte kornizën e re. Muri i pjerrur u shty me kriko, nëpërmjet një sistemi pajantash (tab. III, 3) dhe, mbas kësaj, u bë lidhja e tij me pjesët e tjera të murit. Brezin beton arme e kaluam si në narteks, ashtu dhe në naos mbi të gjitha muret, duke e lidhur në të tërë kornizën e re që ndërtuam. Këtë të fundit e krijuam me dy rradhë tullash të vendosura normal murit dhe të nxjerra nga ai në mënyrë të shkallëzuar (tab. III, 5). Duke qënë se korniza, në këtë rast, është vetë një element strukturat dhe se nuk kishte asnjë lidhje arkitekturale me pjesën tjetër të kishës atë nuk e riformuam sipas kornizës së zakonëshme bizantine në formë dhëmbësharre.

Me kryerjen e këtyre punimeve ndërtuam çatinë me kapriata dhe pa tavan në mënyrë që të mund të shikohen tërësisht afreskat me vlerë të murit lindor.

4) Punimet restauruese u kryen nga Ateljeja e Tiranës nën drejtimin e autorit dhe F. Topullit.

Do not copy



Fig. 3

Me sistemimin e jashtëm dhe pastrimin e mureve nga llaçrat, përfunduam këtë ndërhyrje konservuese, qëllimi i së cilës, pra, vlerësimi i monumentit, na duket se u arrit (fig. 3).

* * *

Manastiri «Fjetja e Shën-Mërisë» në Apolloni, shquhet, jo vetëm për kishën dhe pikturat e saj por dhe për trapezarinë e cila është një ndërtim i periudhës përpara pushtimit turk. Deri më sot nga kjo kanë qënë objekt studimi pikturat murale që ruhen në interier të saj.

Trapezaria gjëndet në anën perëndimore të manastirit dhe është edhe pjesë anësore e tij. Ajo është e orjentuar me brinjën më të gjatë në drejtimin verijugë. Në anën jugore dhe në ato perëndimore e lindore dalin nga një absidë (fig. 4). Këto dy abside të fundit janë trefaqëshe të zakonshme, ndërsa absida jugore është kuadratike dhe është kompletuar në vitin 1962 gjatë punimeve restauruese. Deri atëhere absida ishte e mbyllur nën anën e brëndshme me një mur të dytë në një plan me murin jugor. Këtij restaurimi i përkasin dhe çatia e drunjtë me kapriata, pjesa më e madhe e kornizave dhe dyshemeja me pllaka mbi një shtresë betoni.

Në trapezari hyet nga një portë në anën lindore dhe interieri (tab. IV, 1) ndriçohet nga një numër i madh dritaresh të vendosura jo në të njejtin nivel dhe të ndërtuara në kohë të ndryshme.

Pjesa më e madhe e mureve të interierit është e mveshur me afreske, me përjashtim të pjesëve më në veri të mureve perëndimore dhe lindore dhe krejt murit verior, i cili sot është i tëri i suvatuar. Ky mur është i ndryshëm nga të tjerët dhe i ndërtuar vetëm me gurë. Dhe, në të vërtetë, po ta shohim nga jashtë, do të vërejmë se muri lindor i trapezarisë shikon me në veri se ky mur, duke qenë dhe pjesë e ambienteve të tjerë të manastirit. Ky mur përfundon me një fugë vertikale. Në faqen e brëndshme të tij dalin gurë që tregojnë qartë se ky mur vazhdonte në drejtim të perëndimit dhe ishte muri verior i trapezarisë.

Po të shqyrtojmë teknikën e ndërtimit të murit lindor (tab. IV, 2, tab. V) do shohim se ai përbëhet nga dy breza: i poshtëmi, që zë pjesën më të madhe të lartësisë së murit është i ndërtuar me gurë të mëdhenj dhe tulla ndërmjet tyre e përgjajshme me teknikën e vërejtur në kishat dhe kalanë e Beratit, ndërsa

DO NOT COPY

pjesa e sipërme me kluasonazh me dy tulla vertikale. Të dy brezat ndahen nga tre rreshta me tulla. Duke qënë se tullat janë marrë nga rrënojat antike të Apollonisë, pra, janë të trasha, kluasonazhi është mjaft i rëndë në pamje dhe jo me proporcione elegante gurë tullë ashtu si e hasim në kishat e tjera bizantine. Po nga rrënojat antike janë marrë dhe gurët, të cilët shpesh janë fragmente arkitektonike të ndërtesave.

Absida trefaqëshe në këtë mur lindor është e ndërtuar si muri i pjesës së poshtëme, ndërsa pjesa e sipërme është kryesisht me tulla. Në këtë pjesë ndodhet një dritare në faqen e mesit dhe nga një nikje në faqet anësore. Dritarja është mbuluar me hark prej tullash të shkallëzuara që zbresin përgjatë shpatullave. Me këtë strukturë janë dhe nikjet, të cilat e kanë fushën të dekoruar me rradhë tullash zig-zake, si në kishën e Shën-Triadhës në Berat. Brinja që formohet nga dy faqet është një kolonet me gurë vertikalë dhe dy tulla ndërmjet tyre. Nga këto ruhet vetëm njëra, ndërsa tjetra është e merremetuar. Mbi dritaren dhe nikjet ka rreshta me tulla dhe, mbi to, korniza me dy rradhë tullash të vendosura në formë dhëmbësharre.

Pesë dritare, pak a shumë të vogla, janë në brezin e sipërm dhe dy në të poshtmin. Dritaret e sipërme, të ngushta e të larta, kanë të gjitha të njëjtën strukturë, dy rreshta të shkallëzuar brënda një shiriti tullash. Nga këta një është nga lindja e absidës, të tjerat më nga veriu dhe të vendosura në largësi pak a shumë të barabartë. Nga këto dy janë të mbyllura dhe të gjymtuara. Njëra, ajo pranë absidës, nga hapja nën të e një dritareje të madhe, tjetra më në veri (tab. IV, 3), nga ndërtimi i murit të ri të ambienteve pranë trapezarisë. Ky mur i ri, përveç dritareve, ka prishur dhe pjesë të sipërme të murit, të trapezarisë dhe kornizës, nga që ngrihet mbi këtë (tab. IV, 4). Dy dritare janë në brezin e poshtëm, në të dy anët e absidës. Ajo nga jugu është me mbulesë harku tullash dhe shpatulla murature me gurë, ndërsa ajo nga veriu me shpatulla dhe me hark guri. Nga vrojtimi i muraturës së saj kuptohet se është një dritare e mëvonëshme. Ka shumë të ngjarë që për analoqji me murin perëndimor edhe këtu të ketë pasur një dritare por që për arsye të panjohura e kanë zmadhuar.

Edhe porta e madhe që ndodhet në këtë anë duket se është e transformuar, jo vetëm në shpatullën që ndodhet më nga veriu, por dhe në murin mbi har-



PLANIMETRIA

Fig. 4

POZITIV COPY

kun rrethor. Shpatulla nga veriu, patura e saj dhe një pjesë prej rreth 70 cm. është e re dhe po ta shohim në rilevim do të na rezultojë se është vazhdimi i murit të ri verior. Madhësinë e dikurshme të portës mund ta gjejmë po të shqyrtojmë atë në anën e brendshme. Ruhet e plotë shpatulla e dikurshme nga jugu me gjurmë suvaje në pjesën e sipërme dhe arkitrau i ngushtë e monolit. Ky i fundit është më i vogël se hapsira e dritës së portës së sotme, çka do të thotë se porta e dikurshme ka qenë më e ngushtë. Me ndërtimin e murit të ri verior, është preferuar kalimi i tij deri jashtë, duke shërbyer edhe si shpatull e portës.

Muri perëndimor (tab. V, fig. 5) ruhet në përgjithësi mirë. Atij i mungon pjesa veriore, e prishur me ndërtimin e ambienteve të reja, fuga e kontaktit të murit të ri me atë të vjetër është mjaft e qartë si rezultat i ndryshimit të teknikave të ndërtimit. Edhe këtu kemi dy breza, të poshtëmin me gurë dhe të sipërmin me kluasonazh. Brezi i poshtëm, për shkak të nivelit më të ulët të dherave, është më i lartë dhe më teknik të lexueshme qartë. Pjesa e absidës dhe muri në jug të saj me gurë të mëdhenj dhe tulla të vendosura horizontalisht, ndërmjet gurëve dhe gati kudo, ndërsa pjesa tjetër është me gurë të mëdhenj dhe shumë pak tulla ndërmjet tyre. Dy dritare të vogla kuadratike janë hapur më vonë; një në absidë dhe një në mur. Në pjesën e sipërme të këtij brezi janë tri dritare mbuluar me hark tullash dhe shpatullat me gurët e mëdhenj të muraturës, të cilat në zonat mbi dritare kanë më tepër tulla se sa gurë. Dy brezat ndahen me dy rreshta tullash, mbi të cilat fillon kluasonazhi i njëjtë me atë të murit lindor. Në këtë mur janë tri dritare me harqe dhe shpatulla prej dy rradhë tullash të shkallëzuara. Duke konsideruar vendosjen e tyre në vënde të njëjta me ato të murit lindor mendojmë se dhe kjo anë do të ketë pasur një numër të njëjtë me t' atij muri. Edhe këtu muri përfundon me një kornizë të dyfishtë dhëmbësharre, e cila në pjesën më të madhe është restauruar.

Përsa i përket murit jugor të trapezarisë ne nuk disponojmë të dhëna sepse ai është i suvatuar. Siç e përmendëm dhe më lart gjatë restaurimit është riformuar absida e dikurshme, duke ruajtur formë gjysëm rrethore në anën e brendshme dhe duke i dhënë formë drejtkëndëshe në anën e poshtme.

Për organizimin e brëndshëm të trapezarisë nuk kemi asnjë të dhënë, dhe nuk jemi në gjëndje të përcaktojmë nivelin e vjetër të dyshemesë së saj.

* * *

Dy ndërtimet e sipërme janë të vetmet ndërtime të tipit trekonkëshe që kemi takuar në vendin tonë. Sigurisht që në shekujt përpara pushtimit turk ky tip do të ketë qënë dhe tek ne i përhapur, si dhe në vëndet fqinjë dhe, mbetet detyrë për kërkimet arkeologjike studimi i tyre.

Studimi i këtyre dy monumenteve duhet bërë i përbashkët, për shkak të lidhjeve të qarta ndërmjet tyre gjë që është e kuptueshme po të kemi parasysh distancën e vogël ndërmjet Kurjanit dhe Apollonisë. Kisha e Shën-Kollit në Kurjan lidhet me manastirin e Apollonisë në disa aspekte themelore. Së pari, me planimetrinë e trapezarisë që janë të dyja të të njëjtit tip. Së dyti, me një sërë elementesh formalë si harqet e mprehtë të dyerve dhe portikët e vegjël të portave. Dhe ishin pikërisht këta elementë të kishës së Kurjanit që na shtyjnë, krahas të dhënave të tjera, të mendonim për formën e saj, kryq të brëndashkruar me kupol.

Është gjithashtu interesante të vërejmë se në të dy rastet kemi përdorim të një forme planimetrike, që shmanget nga funksioni normal i tipit. Në Pojan monumenti shërben për trapezari dhe orientohet me aksin e gjatë veri-jugë, ndërsa në Kurjan në të dy absidat kemi dyer që e bëjnë të pamundur funksionin si të kishave trekonkshe të tipit të Malit Atos.

Kjo lidhje mjaft e qartë ndërmjet monumenteve në shqyrtim na jep mundësi dhe për një vendosje në kohë. Kemi pranuar për kishën e manastirit të Apollonisë gjysmën e parë të shek. XIII[5]), ndërsa për trapezarinë, si elemente datimi kemi teknikën e ndërtimit dhe datimin e pikturës murale. Teknika e ndërtimit, me gurë e tulla ndërmjet tyre në pjesën e poshtëme dhe, kluasonazh në pjesën e sipërme, na datohet në kishat dhe muret rrethuese të Beratit gjatë shek. XIII-XIV[6]) ndërsa pikturat murale Puzanova e Dhamo i daton në shek. XIV[7]). Jemi të mendimit se trapezaria është më e vonë se sa kisha e manastirit dhe do të prireshim për një datim të fundit të shek. XIII dhe fillimit të shek. XIV. Duke parë se kisha e Shën-Kollit në Kurjan përdor elementë që ne i hasim në të dy monumentet e mësipërme, do të ishim për një datim të saj në shek. XIV. Përsa i përket një sërë influencash të arkitekturës perëndimore, që hasim te kjo e fundit, mendojmë se ato vinë jo vetëm nga ndikimi i Pojanit, siç është rasti i harqeve që mbulojnë dyert, por edhe

5) A. Meksi, **vep. cit.,** 110.
6) A. Meksi, **Tri kishat bizantine të Beratit.** «Monumentet» 4, 1972, A. Baçe **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** «Monumentet» 2, 1971.
7) V. Puzanova, Dh. Dhamo, **Disa tipare të pikturës monumentale në Shqipëri gjatë shek. XIII-XIX.** «Studime Historike», 2. 1967, 107.

POZITIVE COPY

DO NOT COPY



Fig. 5

nëpërmjet kontakteve direkte të dy brigjeve të Adriatikut dhe ngulimeve katolike në Shqipërinë bregdetare.

Një konstatim me rëndësi, që duhet vënë në dukje, është se dhe tek ne monumentet e tipit trekonkësh datojnë të shek. XIII-XIV, gjë që dëshmon dhe një herë se kishat trekonkëshe serbe dhe ato rumune janë më të vona se ato të pjesës jugore e qendrore të Ballkanit[8]). Me këtë të fundit, monumentet tona lidhen me ngjasime në një serë elementësh në format e thjeshta të absidave trefaqëshe dhe në formulimin e thjeshtë të mureve[9]). Në këtë të fundit, duhet thënë se ndryshimet që vërehen në Kurjan i detyrohen influencave të arkitekturës mesjetare perëndimore, që këtu vjen edhe me rrugë direkte brënda vendit tonë pikërisht nëpërmjet Pojanit. Gjithashtu në Pojan edhe trajtimi dekorativ i mureve, është i pandarë nga kishat e tjera të kësaj kohe në Shqipëri, pra, pjesë e repertorit lokal. Përsa i përket kishës së Kurjanit, në të vërejmë një koncept më të avancuar në trajtimin e fasadave jo vetëm në aspektin plastik, harqet dhe pilastrat, por dhe në aspektin dekorativ piktoresk tipik bizantin nëpërmjet kombinimit të muraturës me tulla me fragmente skulpturale të marra nga ndërtime më të vjetra dhe të vendosura pa ndonjë rregull në muret e saj.

8) N. Çaneva-Deçevska, **Trikonhalnite cërkvi ot IX-XIV po Bëllgarskite zemi,** «Arheologjija» 4, 1970, 19-20.
9) N. Çaneva-Deçevka, **Po vëprosa za srednovekovnite trikonhalni cërkvi ot manastirski tip na Ballkanite,** «Muzei i pametnici na kulturata» 1, 1971, 11-12.



PAMJE NGA LINDJA





PAMJE NGA PERENDIMI



DO NOT COPY



PAMJE NGA JUGU



PAMJE NGA VERIU

DO NOT COPY


1


4


2


5


3


6

DO NOT COPY

DO NOT COPY









TAB. V



PAMJE NGA PERENDIMI



PAMJE NGA LINDJA

DO NOT COPY





PRERJE TERITORE

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DEUX CONSTRUCTIONS DU TYPE A TROIS CONQUES

RESUME

Dans cet article l'auteur traite de l'architecture de deux constructions à trois conques, et précisément de celle de l'église de Shën-Koll (Saint-Nicolas) de Kurjan et du réfectoire du Monastère de Sainte-Marie d'Apollonie, tous deux situés dans le district de Fier. En 1970, l'église de Shën-Koll a été l'object de travaux de restauration.

* * *

L'église de Shën Koll avait suscité jusqu'à ce jour l'intérêt des hommes d'étude seulement en raison des fresques de Joan et de Nicolas d'Onufre, qui ornementent ses murs et datent la deuxième moitié du XVIe siècle. La partie la plus ancienne de l'église, conservée même après les travaux de restauration, se compose du naos et du narthex aménagés sur son côté ouest. Le narthex actuellement couvert par un toit en bois conserve encore les traces de l'ancienne couverture à voûte. L'accès est assuré par trois entrées, dont la principale aménagée sur le côté ouest. Avant la restauration le naos avait la forme d'une basilique à trois nefs, chacune d'elle étant séparée de l'autre par une colonne en bois de construction plus récente reposant sur un chapiteau dorique renversé et par un pilastre dans l'arrière-partie de l'iconostase. Cette église avait un toit de construction plus récente qui couvrait les fresques surmontant l'abside. La régularité du plancher s'étendant entre les pilastres et les murs contigus, ainsi que les traces des dalles, nous induisent à penser que cette église a du avoir un iconostase en pierres.

Les murs de l'église sont généralement en briques, quant à leurs angles et aux embrasures les portes ils sont en pierres. Nombre de fragments architectoniques, anciens et paléochrétiens, sont disposés régulièrement et il se peut que nous soyons en présence de murs d'Apollonie. Les murs reposent sur un socle disposé sur un même plan que leurs pilastres angulaires. En ce qui concerne leur partie supérieure, elle est enduite de mortier de glaise et a été l'objet de travaux de réparations au XVIe siècle, période pendant laquelle l'église de Shën Koll a été agrémentée de fresques. La réalisation des adjonctions à un niveau qui a fait disparaître toutes les traces précédentes ne nous permet pas de formuler un jugement sur la forme antérieure de l'église en hauteur. Or il suffit de confronter la partie inférieure du pilastre engagé à l'angle SE avec le niveau des conques latérales pour comprendre que le toit de cette église ne pouvait pas se trouver à un même niveau que le naos. La possibilité d'une architecture basilicale est à exclure, parce que les colonnes ne devancent pas les absides latérales et en plus manquent les pilastres du mur ouest sur lesquels devaient s'appuyer l'arcade. D'où l'hypothèse la plus probable, nous semble celle d'une église en forme de croix inscrite à coupole, d'autant plus que les angles des murs sont munis d'un rectangle de pilastres et de colonnes en bois. Des sondages ont été effectués au-dessous du soubassement des colonnes et ils ont mis au jour des fondements identiques à ceux des murs latéraux, ce qui nous invite à penser que nous sommes en présence

DO NOT COPY

des fondements des colonnes antérieures. Bien que l'absence de traces dans les parties supérieures des murs complique la solution définitive du problème, malgré cela nous optons pour la variante d'une église en forme de croix inscrite.

Les travaux de restauration réalisés avaient pour but de regénérer le toit, d'éliminer l'atrium de construction plus récente et partiellement en ruine et de déplacer le mur ouest chancelant. L'exécution de ces travaux a contribué à une meilleure valorisation de ce monument sur le plan scientifique et esthétique.

* * *

Le Réfectoire du Monastère d'Apollonie occupe la partie occidentale de ce monument et en constitue le côté latéral. En ce qui concerne sa forme, il est à angle droit, avec son côté le plus long orienté du nord au sud; il est muni de trois absides, dont une occupe sa partie méridionale et les deux autres, qui sont des absides à trois faces, s'étendent respectivement dans sa partie orientale et occidentale. Des trois absides antérieures, celles méridionale (en direction de son axe le plus long) a été également l'objet de modifications du côté nord, modifications représentées par l'adjonction d'habitations en tant que prolongement du réfectoire. La technique de construction des murs O et E est identique à celle des églises de Berat. Les murs comportent deux bandes, celle inférieure comprenant des blocs de pierre à intercalations de briques et celle supérieure construite en cloisonnage avec deux briques verticales. L'abside à trois faces est munie d'une seule fenêtre, percée dans la face du milieu, et de niches en briques disposées en zig-zag sur les faces latérales.

Le mur N, qui sépare actuellement le réfectoire de ses annexes, est de construction récente et se dresse plus en dedans du mur antérieur, ce qui ressort de l'ancien parement O qui s'engage au delà du nouveau mur et des traces de l'angle se trouvent à l'intérieur du mur.

En ce qui concerne l'ancienne forme de l'abside méridionale, qui, dans son état actuel, est de construction récente, nous ne disposons pas de données. L'absence de données se fait également sentir quant à l'ancienne composition intérieure du Réfectoire et du niveau de son plancher.

* * *

Ces deux constructions sont les seules du type à trois conques rencontrées à ce jour chez nous. Evidemment, dans la période antérieure à l'occupation turque, ce type d'église doit avoir été répandu chez nous comme dans les pays voisins au nôtre. Aussi, nous appartient-il d'intensifier les recherches archéologiques dans cette direction.

L'étude de ces deux monuments ne peut être entreprise que conjointement, en raison des liens évidents qui existent entre eux du fait même que le village de Kurjan se trouve à proximité d'Apollonie. L'église de Shën Koll se rattache au monastère d'Apollonie, sous plusieurs aspects fondamentaux. Premièrement, la planimétrie de leurs réfectoires est du même type. Deuxièmement, une série d'éléments comme les arcs aigus des portes et les petites portes des portails ont une forme analogue dans les deux cas. Ce sont justement ces éléments de l'église de Kurjan qui nous ont induits, de pair à d'autres données, à penser que nous sommes en présence d'une église ayant la forme d'une croix inscrite à coupole.

Il est également intéressant de noter que dans les deux cas la forme de la planimétrie s'éloigne de la fonction normale du type. A Pojan la planimétrie du monument a été mis au service du réfectoire, dont l'axe s'oriente du nord au sud, tandis qu'à Kurjan les deux absides sont munies de portes, ce qui éloigne notre monument de sa fonction normale qui est celle des églises à trois conques du Mont Athos.

Cette liaison relativement évidente entre les deux monuments, que nous sommes

DO NOT COPY

en train d'examiner, nous permet également de déterminer leur existence dans le temps. En ce qui concerne l'église du monastère d'Apollonie, elle est unanimement attribuée à la première moitié du XIIIe siècle; quant à son réfectoire, les éléments de datation sont représentés par sa technique de construction et la date d'exécution des peintures murales. La technique de construction, avec des pierres intercalées à des briques dans la partie inférieure du mur et le cloisonnage dans sa partie supérieure, est analogue à celle des églises et des remparts de Berat; quant à la peinture murale, selon Pusanova et Dhamo, elle se ratache aux XIIIe–XIVe siècles. A notre avis le réfectoire est de construction plus récente que l'église du monastère, raison pour laquelle nous sommes pour une datation s'étendant de la fin du XIIIe siècle jusqu'au commencement du XIVe. Etant donné que l'église de Shën Koll comporte des éléments qui sont communs aux deux monuments précédents, elle doit appartenir à notre sens au XIVe siècle. En ce qui concerne les influences de l'architecture occidentale que l'on relève dans l'église de Kurjan, exemple les arcs surmontant les portes, elles sont non seulement un résultat de la proximité de Pojan mais encore des contacts directs entre les deux rives de l'Adriatique et des établissements catholiques dans l'Albanie côtière.

Une autre constatation importante est le fait que chez nous aussi les monuments du type à trois conques datent les XIIIe–XIVe siècles, ce qui prouve encore une fois que les églises à trois conques serbes et roumaines sont plus récentes que celles situées dans la partie méridionale et centrale des Balkans. Nos monuments se rattachent certes à celles-ci par une série d'éléments comme le sont la forme simple des absides à trois faces et la présentation également simple des murs. Les différences qui caractérisent cependant l'église de Kurjan sont dues à l'influence de l'architecture occidentale moyenâgeuse, qui en l'occurence a pénétré directement chez nous à travers Pojan. Le décor des murs de Pojan se retrouve également dans les autres églises albanaises de l'époque, ce qui montre que ce décor faisait part du répertoire local. En ce qui concerne l'église de Kurjan, nous sommes ici en présence d'une conception plus avancée non seulement sous l'aspect plastique quant au traitement des façades, des arcs et des pilastres, mais encore sous l'aspect décoratif pittoresque, qui nous rappelle le décor byzantin par la combinaison du mur en briques avec des fragments sculpturaux prélevés des anciennes constructions et disposés sans aucun critère.

DO NOT COPY

Halil MYRTO

MBI DISA QENDRA ARKEOLOGJIKE NDËRMJET KAVAJËS DHE DURRËSIT

DO NOT COPY

Historia shumëshekullore e Durrësit, nuk mund të kuptohet e shkëputur nga ajo e hinterlandit të tij, sidomos atij të afërtit. Fondet e pasura arkeologjike të Muzeut të këtij qyteti, që vijnë gjithnjë duke u shtuar edhe me materiale nga rrethi e vërtetojnë këtë më së miri. Durrësi i lashtë apo mesjetar shihet i pasqyruar në hinterlandin e tij dhe anasjelltas.

Muzeu i këtij qyteti vitet e fundit, me anë ekspeditash informative dhe një punë studimore, ka marrë përsipër përpilimin e hartës arkeologjike të rrethit. Në këtë artikull do të paraqesim një pjesë të punës që është bërë deri tani, duke informuar mbi disa qendra arkeologjike, ndërmjet Kavajës dhe Durrësit (tab. I).

1. – ZIG-XHAFAJ.

Më tepër se 100 vjet më parë L. Hezej njoftonte për një fortesë të vogël në katundin Zig-Xhafaj, të cilën e shënonte në termin «akropol helenistik»[1]), pa dhënë hollësira rreth saj.

Zig-Xhafaj ndodhet 4-5 km në verilindje të Kavajës, mbi masivin e kodrave të Menglës. Këto kodra, pak më në veri të këtij fshati, ndërpriten nga një luginë e vogël, për të vazhduar përsëri drejt veriperëndimit, në Golemas, Seferaj, Shkallnur e deri në Shkëmbin e Kavajës.

Shpina e kodrës ku shtrihet lagja e Ballijve (fig. 1), me majën më të lartë 239 m. është e butë, me ndonjë shesh apo tarracë të vogël dhe gjithëkund e mbuluar me ullinj e pemë të tjera frutore. Ajo zbret lehtë në drejtim të juglindjes me rrëpira të buta nga jugu e jugperëndimi, kurse nga ana e lindjes, veriut dhe veriperëndimit zbulon shpate shkëmbore mjaft të pjerrëta prej guri shtuf me ndërfutje konglomeratesh dhe gipsi. Rrëzën e shpatit shkëmbor të anës veriperëndimore e ndjek rruga që vjen nga Kavaja. Këtu kjo kapërcen qafën e Zige dhe pastaj, nëpër Qafë-Shkallë, kalon për në luginën e Erzenit dhe Ndroqit. Përveç këtij kalimi nga kalaja e Zig-Xhafes kontrollohet edhe rruga kryesore që kalon në fushën e Kavajës.

Nga vëzhgimi i mbetjeve në vend dhe i terrenit duket se pjesa më e lartë e kodrës së Zig-Xhafes, nga ana veriperëndimore, perëndimore dhe jugore, ka qenë e rrethuar me mure mbrojtëse. Forma e këtij muri do t'i ngjante një trapezi të çrregullt, me gjatësi mesatare 400 m. e gjerësi 100 m. (shih rilevimin topografik). (tab. II).

Mbeturinat e këtij muri rrethues sot vihen re në anën perëndimore të kodrës, te vendi që mban emrin «Muri i Kalasë» ose «Rrethi i Kalasë» (pika B në rilevimin topografik). Këtu është një trakt muri që ndjek rrëpirën e kodrës në një vijë të harkuar 22 m. të gjatë. Me një pastrim të pjesshëm të tij, u vërejt se s'është veçse radha e fundit e murit, ndonëse aty-këtu kanë mbetur edhe 2-3 blloqe njeri mbi tjetrin, **in situ.** Në këtë mënyrë lartësia e sotme e këtij muri arrin 0,90 m. deri 1,20 m. Në gjendjen që paraqitet, duke qenë nga njera anë i mbuluar pjesërisht nga dherat e kodrës, është vështirë të përcaktohet gjërësia e tij.

Ky trakt muri është ndërtuar me blloqe gurësh konglomerati e shtufi të mëdhenj (fig. 2, 3), që janë lidhur me njeri-tjetrin pa llaç dhe pa ndonjë mjet tjetër ndërlidhës. Një pjesë e tyre janë latuar nga të gjitha anët dhe kanë forma të rregullta paralelpipede, ndërsa të tjerët s'janë latuar me të njëjtin kujdes

1) L. Heuzey, **Operations militaires de Jules César,** Paris, 1866 (shih hartën).



Fig. 1

dhe paraqesin forma të çrregullta. Në përgjithësi faqja e jashtme e tyre duket e sheshtë dhe kuadratike. Përmasat e tyre arrijnë: 1,40x0,40x0.40: 1.30x0,80x0.50; 1,43x1,15x0,60 m. Vihen re shenja të këmishës së brendshme dhe të mbushjes me gurë të vegjël.

Gjurmë të këtij muri rrethues vihen re edhe 50 m. më tej, në drejtim të veriut (pika A në rilevimin topografik), ku terreni i avitet më tepër rrëpirës shkëmbore pranë qafës, si dhe 100 m. më tej në drejtimin tjetër, nga ana e jugperëndimit (C), duke plotësuar rrethin e mureve nga kjo anë.

Rreth 60-70 hapa poshtë majës, nga ana jugore e saj, prej nga është edhe ngjitja më e lehtë për në territorin që përfshihej brenda fortesës, shihen përsëri mbeturina të një muri, që janë pothuaj në nivelin e sipërfaqes (D). Ky është një trakt muri që ka formën e shkronjës «T», dy vijat përbërëse të së cilës janë nga 3 m. të gjata dhe kanë drejtimin e pikave kardinale të horizontit. Edhe këtu blloqet janë kuadratike, të latuar dhe të lidhur me njeri-tjetrin sipas teknikës së thatë, por përmasat e tyre janë pak më të vogla. Muri i këtushëm, pranë të cilit nga punimet bujqësore kanë dalë një sasi e madhe fragmente tjegullash solene e kaliptere, tulla, një terrakote (tab. III, 1), e gozhdë hekuri të tipit këpurdhë, mendojmë se i përket ndonjë godine shoqërore brenda murit rrethues.

Përsa i përket stilit të murit të kalasë së Zig-Xhafes, duke gjykuar nga gjurmët e pakta që shihen, është vështirë të bëhet një përkufizim i plotë. Megjithatë janë të dukshëm elementet që e bashkërendisin me tipe të tilla ndërtimesh të periudhës qytetare ilire, të shek. IV-II p.e. sonë.

Në territorin që përfshihej brenda kalasë dhe sidomos pranë pikave të sipërpërmendura, janë gjetur një sasi e madhe fragmente tullash, tjegullash e enësh qeramike me ngjyrën natyrale të baltës ose të lyera me vernik të zi.

Tjegullat solene janë 2,5-3,5 cm. të trasha. Buzët e tyre, që arrijnë deri 6 cm. trashësi, i kanë të trashuara në mënyrë konkave ose konvekse. Tjegullat kalipteret kanë prerje në formë gjysëm gjashtëkëndëshi. Në disa fragmente solenesh shihen vula në formë drejtkëndëshi (18 x 3 cm) dhe mbishkrime të pjesshme (tab. III, 4-6), ku lexojmë: ΕΠΙ, ΑΡΙΣΤΟΔΑΜΟΥ dhe ΠΑ. ΙΩ . .



Fig. 2



Fig. 3

DO NOT COPY

Duke pasur parasysh thënien e Aristotelit se në Dyrrah skllevërit ishin pronë e qytet-shtetit[2]) (prej nga del që edhe kumitë ishin shtetërore) dhe faktin se parafjala ΕΠΙ shoqëron pothuajse gjithë emrat që janë regjistruar ne vulat e tjegullave solene të këtij qyteti, emra që përputhen me ata të shpinës së monedhave të emetuara këtu, pra, të prytanëve[3]). Këtej del se pjesa më e madhe e tjegullave të Zig-Xhafes janë prodhuar në Durrës në konën e prytanit Αριστοδαμος. Ky emër lexohet (mendojmë) pjesërisht edhe në vulat e soleneve të zbuluara në nekropolin helenistik të Epidamnit[4]). Monedhat e prera në Dyrrah, që mbajnë emrin e këtij prytani, u takojnë viteve 250-200 p. e. sonë[5]).

Ndër objektet pothuaj të plota prej qeramike është një gutus (i gjetur në pikën B), një lakrimore, dy peshore, konike, dhe terrakota që përmendëm më lart. Gutusi (tab. III, 2) në Muzeun e Durrësit qëndron unikal në mes një shumice enësh të këtij lloji të zbuluara në qytet[6]). Lakrimorja (tab. III, 3), që është e lyer me vernik të zi të dobët, nga forma, i afron tipit VI të balsamareve të Gnathias të shek. III p. e. sonë[7]) dhe ka ngjashmëri me shishe balte të gjetura në varret e shek. III-II p. e. sonë në Apolloni[8]).

Nga të dhënat e më sipërme mund të nxjerrim si përfundim se në Zig-Xhafaj gjatë shek. IV-II p. e. sonë ka ekzistuar një qytezë ilire e tipit **castellum,** që shërbente si vendbanimi, qendër administrative, religjioze dhe vendstrehim, në raste luftrash, për banorët e zonës përreth.

Në sistemin e qendrave të fortifikuara ilire të vrojtuar në afërsi të rrugës së lashtë, asaj që dilte prej Dyrrahit e vazhdonte nëpër luginën e Shkumbinit, si dhe atyre fortesave që vërehen në degëzimin e rrugës kryesore,[9]) kalaja e Zig-Xhafes është e para përsa i përket afërsisë me qytetin e madh bregdetar. Ajo është e vetmja kala ilire që kemi parë deri më sot në rrethin e Durrësit.

Kulmin e lulëzimit ekonomik e kultural, me sa duket, kjo qendër e vogël e ka pasur në shek. e III p. e. sonë. Te pika D u vunë re gjurmë të theksuara të një zarri shkatërrimtar. Ky fakt dhe fragmentet e soleneve të zbuluara po në atë pikë, që mbajnë emrin Αριστοδαμος, prytan i viteve 250-200 p. e. sonë të afrojnë mendimin se edhe kjo qytezë e fortifikuar është përfshirë nga luftërat e mbarimit të shek. III p. e. sonë, ndërmjet ilirëve dhe romakëve e maqedonasve në truallin ilir. Dihet se gjatë asaj periudhe pati faza që fiset ilire «kutitare të Dyrrahit, duke shpresuar në ndryshimin e gjëndjes, ishin ngritur[10]). Këto luftëra mund t'i kenë dhënë fund edhe jetës së kësaj qytezë. Kjo gjë vërtetohet edhe nga fakti se askund në sipërfaqe dhe as pranë pikave të sipërpërmendura, që u hetuan më me kujdes, nuk u pa qeramikë ose objekte të tjera që të datohen si të periudhës romake.

2. – SPANJO.

Në afërsi të katundit Spanjo dhe Aganas (tab. I), te kodra e Qenzë, që është një bregore e butë, jo më e lartë se 40-50 m. mbi nivelin e detit dhe që ndodhet në lindje të rrugës Durrës-Kavajë shumë afër lagjes Sallbag të qytetit të dytë, shihen në sipërfaqe fragmente të shumta tullash dhe tjegullash të periudhës helenistike. Këto janë nxjerrë në dritë nga punimi i tokës me mekanizma bujqësore. Midis tyre gjetëm fragmente soleneje, ku brenda kornizës së zakonshme të vulave drejtkëndëshe (me dimensionet 18 x 3 cm), lexohet emri i prytanit Γαιος emër i njohur ndër prytanët e Dyrrahit të gjysmës së dytë të shek. I p.e.sonë.[11])

3. – SEFERAJ.

Mbi një nga brigjet e veshura me ullinj të fshatit Seferaj, që i thonë «Bregu i Qishës», nga punimet me karakter bujqësor (siç na informuan vendasit), janë

2) Aristoteli, Pol. II, 7.
3) H. Ceka, **Probleme të numismatikës ilire,** Tiranë, 1965, 52.
4) S. Anamali, **Nekropoli helenistik i Epidamnit,** B.SH.SH., 1957, I, 57.
5) H. Ceka, **Datimi i drahmeve të Durrahit e Apollonisë,** «Studime Historike», 1966, III, 33; **«Thesari i Jubicës»,** Iliria, I, Tiranë, 1971, 88; **Le trésor numismatique de Bakerr,** «Studia Albanica», 1972, 52.
6) Një gutus, pothuaj identik kemi parë në ekspozitën arkeologjike që u hap në Tiranë në vitin 1972 – Vitrina «Lissus».
7) L. Forti, **La ceramica di Gnatia,** Napoli, 1965 (Shih «Cronologia»).
8) A, Mano, **Nekropoli i Apollonisë – Tuma e I,** «Iliria» I, 1971, 162.
9) N. Ceka – L. Papajani, **Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike».** Monumentet», 1/1971, 48-49.
10) Livi, XXIX, 12, 13.
11) H. Ceka, **vep. cit.,** 39, 42, 50 dhe 151.

Do not copy



Fig. 4



Fig. 5

zbuluar varre të vjetra, ku përveç skeleteve janë parë dhe objekte të ndryshme, si enë balte etj. Pranë këtij vendi, ka qenë edhe altari me mbishkrimin që është botuar nga H. Ceka dhe S. Anamali[12]).

Mbasi iu nënshtrua një pastrimi të plotë, u bë e mundur të dallohet në njerën prej faqeve anësore të altarit përfytyrimi me reliev i një objekti që ngjet më tepër të jetë një çantë me bravë (fig. 4).

Në fillim të rreshtit të katërt tani dallohen edhe tri shkronja të tjera: MAF. dhe pesë shkronja të tjera në rrethin e shtatë NEMER. Me këto ndryshime mbishkrimi duhet të jetë si vijon:

D(iis) M(anibus) S(acrum) / M]unatia [Cl]audia / mariti / Maf(ilia) [et] Cor / [n]eliae m / [at]ri dulcissi [mae] / benemerent) i posuit q(uae) (v(ixit) a(nnos)...

Nga ky lexim do të thoshnim se altarin ia ka ngritur s'ëmës shumë të dashur dhe të denjë për mirënjohje Kornelias, e bija, Munatia Klaudia Maritima. Ky altar mermeri mendojmë se i përkiste një pronareje tokash, nga shtresa e kolonizatorëve romakë, që, siç është provuar dhe nga monumente të tjera sepulkrale, në periudhën perandorake u shtri tej Durrësit, në fushën e Kavajës.[13])

Po te «Bregu i Qishës», në fasadën e shtëpisë së Shaban Dokës, është vendosur një pllakë varri jo e plotë, ku lexohet një pjesë mbishkrimi: NICEPH... Shkronjat janë të mëdha, të bukura dhe të pajisura me apices.

4. — QERRET

Përballë Malit të Robit (kuota 62 m.), në fushë, në një distancë prej 100 m. nga rruga automobilistike dhe 6-700 m. nga buza e detit, mbi një sipërfaqe prej 1-2 ha, kanë dalë (nga shpyllëzimi dhe punimet bujqësore) mjaft materiale qeramike dhe objekte të tjera me vlerë arkeologjike. Vendi njihet nga banorët e fshatit më të afërt, Qerretit, me toponimin «Qisha». (tab. I).

Interesi shtohet për këtë pikë duke pasur parasysh edhe njoftimin e Leon Reit, se më 1901, me rastin e punimeve për ndërtimin e trasesë së rrugës Durrës-Kavajë, ndërmjet Malit të Robit dhe detit, u zbuluan themele muresh, ku u gjet një arkëzë prej mermeri të bardhë[14]). Arka përmbante një unazë prej argjendi të praruar, që nga autori i lartpërmëndur është konsideruar unazë episkopi. Në arkë qe vendosur dhe një kuti, brenda së cilës kishte një monedhë argjendi të

12) H. Ceka – S. Anamali, **Mbishkrime latine të pabotuara të Shqipërisë**, B.SH.SH., 1961, I, 117-118.
13) L. Heuzey – H. Daumet, **vep. cit.**, 392.
14) L. Rey, **Répertoire topo-bibliographique des antiquités de l'Albanie (suit).** Albania, 1932, 4,

DO NOT COPY

perandorit Aleks Komneni (sh. XI), si dhe monedha të tjera argjendi të shek. XII, XIII, XIV[15]).

Duke marrë në këtë vend si pikë referimi shtyllën e tensionit të lartë, gjurmët që vërejtëm aty po i ndajmë në këtë mënyrë:

– Rreth njëqind metra në jug të saj shihen mbeturinat e një themeli 40 m. të gjatë, me drejtimin lindje-perëndim. Afër tij nga ana e jugut, ndiqeshin gjurmët e një themeli që ipte një formë gjashtëkëndëshi, me gjatësinë e brinjëve 5,5 m dhe gjërësinë 0,45-0,50 m. Plani poligonal dhe madhësia e këtij themeli na kujton baptisteret e kishave paleokristiane, ndonëse forma e preferuar për to ka qenë tetëkëndëshi dhe, në lindje, është aplikuar vetëm në ndërtesat e mëdha[16]).

Nga materialet e ndërtimit që vihen re pranë themeleve, del se muri këtu ka qënë ndërtuar me gurë të çrregullt, tulla dhe llaç. Shumica e tullave kanë përmasat: 28 x 25 x 4 cm. Llaçi është gatuar me gëlqere dhe rërë deti që përmban mjaft guacka dhe thërmija qeramike. Ai e ka trashësinë 5 cm.

– Pranë këtyre themeleve, në largësi 30 m. nga veriu dhe 40 m. nga lindja, u gjetën dy kolona të cunguara prej mermeri të bardhë. E para (fig. 5) është 1,20 m. e gjatë dhe diametrin e bazës e ka 0,45 m.

– Rreth 100-200 m. në lindje të shtyllës së tensionit të lartë shihen materiale ndërtimi të antikitetit të vonë. (tab. IV, 1-3). Interes paraqesin dy fragmente tullash prej balte violë në rozë. Ato kanë trashësinë 4 cm. dhe faqen jo të lëmuar. Mbi njerën është paraqitur në reliev një kryq i vogël bizantin, kurse mbi tjetrën shihet një monogram i pjesshëm në reliev (tab. IV, 4).

Këto të dhëna na bëjnë të mendojmë, se muret e këtushme duhet t'i takojnë periudhës së fillimit të mesjetës.

–Rreth shtyllës së tensionit të lartë, duke qëmtuar në materialet e nxjerra në sipërfaqe nga punimi i tokës, kemi mbledhur një sasi fragmentesh qeramike të enëve të përdorimit të përditshëm, si buzë, vegje e parete vorbash, tasash e amforash. Këto janë prej balte jo të pastër dhe me ngjyrat okër, kafe, rozë e errët dhe okër në violë.

Ndër to ka vegje të zakonshme me prerje ovale, elipsoidale e vegje shpatuke me kanelyra (tab. IV, 5-6). Mbi një vegje është inçizuar një X. (tab. IV, 7). Paretet në përgjithësi janë zbukuruar me të njejtin motiv: breza paralele dhe ravijëza, diku më të shpeshta e diku më të rralla (tab. IV, 8-13). Këto fragmente kanë ngjashmëri me qeramikën e shek. IV-VI të njohur në qendra të ndryshme të vendit tonë, si në Selcën e Poshtëme[17]) e Pogradec[18]).

Duke gjykuar nga të gjitha materialet e përshkruara më lart, mund të themi se këtu, brijë **Via Egnatias,** që në shek. I-II dhe më vonë, gjatë periudhës së vonë antike, ka qenë një stacion i banuar. Pastaj, duke mbajtur parasysh mikrotoponimin «Qisha», themelin në formë gjashtëkëndëshi e fragmentet e përmendura arkitektonike pranë tij, mendojmë se këtu ka qenë ngritur një kishë paleokristiane.

Materialet që disponojmë, ende pa kryer gërmime sistematike në këtë vend, nuk na lejojnë të përcaktojmë se deri në ç'kohë kjo kishë ka qenë në këmbë. Por, po ta lidhim me thesarin e vogël të zbuluar këtu, të cilin e përmendëm më lart, mund të themi se kjo ka jetuar së paku deri në shek. XIV. Atëhere, duke pranuar se në këtë vend në shek. XI ishte në këmbë një kishë, pikërisht këtu duhet kërkuar «Kisha e Shën-Todrit», ku u strehua Guiskardi mbas zbarkimit të tij të befasishëm në prapashpinën e perandorit Aleks Komneni dhe jo në Shtodhër të Kavajës[19]), Duke mbajtur parasysh thënien e Ana Komnenës se Guiskardi: «... me gjithë ushtrinë e vet zbriti në det e zuri kishën që ishte ndërtuar që në kohët e vjetra për nder të dëshmorit Teodor.... dhe prej këndej... ai shkoi në ballë të normanëve nga ranishtja e detit»[20]), s'ka përse të shkojmë deri në Shtodhër për të kërkuar këtë vend. Largësia e Shtodhrit nga buza e detit, fusha moçalore e Kavajës dhe po ashtu largësia e konsiderueshme me kampin e kundërshtarit, nuk do ta kishin lejuar Guiskardin të kryente brenda një nate gjithë ato veprime që përshkruan Komnena. Kurse pozicioni i këtushëm, me lartësinë e Malit të Robit, që vëzhgon mirë grykën strategjike të Petras, mbi të cilën ishte kampi i perandorit, qënia njëkohësisht pranë detit dhe rrugës kryesore, janë në favor të supozimit tonë.

15) L. Rey, **po aty.**

16) Ch. Délvoye, **L'art Byzantin,** 1967, 49.

17) H. Ceka, **La ville illyrienne de Basse-Selce.** «Iliria», 1972, II, 174 (Pl. VII).

18) S. Anamali, **Rezultatet e gërmimeve në kalanë e Pogradecit,** «Buletin arkeologjik», 1969, 97.

19) **Historia e Shqipërisë,** botim i U.SH.T., Tiranë, 1957, në faqen 178 këtë vend e identifikon me Shtodhrin e Kavajës.

20) Ana Comnene, **Alexia,** Lib. IV, 6.

Fotokopi



Fig. 6

5. – GJURMË TË RRUGËS EGNATIA

Nga vendi i quajtur «Qisha» e Qerretit, në drejtim të Kavajës deri tek përroi i Fosës, në një distancë prej 4-5 km., mund të ndiqen gjurmët e një rruge të lashtë të shtruar me kalldrëm (shif hartën). Ajo në fillim ecën në vijë të drejtë, në perëndim të rrugës së sotme automobilistike dhe anash katundit Qerret. Pranë shtëpisë së Zef Bokrit, në thellësinë 0,50 m., janë nxjerrë prej trasesë së saj, që ka gjërësi 4 m, rrasa të mëdha me përmasa: 0,50 x 0,30 x x 0,10 m.; 0,70 x 0,40 x 0,15 m. Duke shkuar gjithnjë në drejtim të shkollës së Qerretit, kjo rrugë «e nëndheshme» mund të konstatohet edhe nga një zhvillim i dobët i kulturave bujqësore në një vijë të drejtë me gjërësi 4-5 m.

Pranë shkollës së Qerretit linja e ndjekur nga ne duket se bën një kthesë nga lindja. Këtu, me sa kuptohet, ajo kapërcen rrugën automobilistike dhe hekurudhën. Gjurmët e saj tani ndiqen duke vërejtur kanalet kulluese, të cilët në thellësinë gati 1 m. presin një kalldrëm me rrasa të mëdha.

Kalldrëmi në fjalë mund të studjohet mirë në lagjen Sallbeg të Kavajës, përballë kodrës Qenze, afër shtëpisë së Mahmut Shijakut, jo më tepër se 150-200 m. nga përroi i Fosës. Këtu, në thellësinë 1 m., ne te dy faqet e kanalit, që ka drejtimin lindje-perëndim, verenet mire prerja e trasese. Gjëresia e kalldremit esnte rretn 6,5 m. Ai është shtruar me rrasa te medna guri qe kane trasnesi 15-25 cm. (fig. 6) ndersa siper do të jetë mbuluar me një shtresë zhavorri.

Përsa i përket pjesës së rrugës prej «Qishës» deri prane shkolles se Qerretit, jemi te mendimit se është mbeturine e një rruge mesjetare, që lidhte këtë qenaer me rrugën kryesore. Pjesa tjeter e kesaj linje, që mund të ndiqet në lindje të hekurudhës, deri tek perroi i Foses, mendojmë se është mbeturinë direkte e **via Egnatias.** Karakteristikat e kësaj përputhen me ato të permendura nga Prashnikeri per rrugen prej Durrësit në luginën e Shkumbinit[21] dhe nga N. Ceka e Ll. Papajani në këtë luginë, aty ku ata flasin për një periudhë radikale ndertimi në shekujt e parë të perandorisë[22]).

* * *

Qendrat arkeologjike midis Kavajës dhe Durrësit, që përshkruam më lart[23]), i takojnë një zone të kufizuar, por ato lidhen ngushtë me Dyrrahin, qytetin e madh të bregdetit dhe me kalimin ketu të rrugës kryesore, që degezohej pastaj në drejtim të linajes dhe jugut.

Banorët vendas të Zig-Xhafes, Kanapares, Spanjojt e Qerretit, në periudhën helenistike e romake, sigurisht, kanë qënë ilirët. Por informatat letrare dhe arkeologjike të deritanishme janë të pamjaftueshme për të formuar një ide të plotë mbi jetën e tyre ekonomike, shoqërore e politike. Megjithatë duket qartë shtrirja e kulturës qytetare në këtë zonë në periudhën helenistike. Gjetjet në kalanë e zig-Xhafajt tregojnë ekzistencën e marrëdhënjeve të ngushta ekonomike të banorëve të kësaj zone me Dyrrahin.

Dukja e një pjese të **Via Egnatia** në këtë zonë është një fill që duhet ndjekur më tej. Me këtë rrugë e me atë që shkonte në Apolloni, lidhen stacione të përmendura në burimet, por ende të paidentifikuara. Pranë saj vazhdojnë edhe qendra mesjetare, siç është rasti i Qerretit. Të gjitha kërkojnë një punë të mëtejshme informuese dhe hetuese në terren për të orientuar kërkimet sistematike në të ardhmen.

21) C. Prashniken, **Muzakhia und Malakastra,** Jahreshefte d. Oest, Wien 1920, f. 113.
22) N. Ceka – Ll. Papajani, **Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike,** «Monumentet», 1/1971, 48-49.
23) Nga qendrat arkeologjike të kësaj zone në këtë artikull nuk janë përfshirë varreza pranë shkollës bujqësore Golem, e përmëndur lidhur me një fibul të shek. III-IV (shih. S. Anamali – F. Prendi, **Vazhdimësia e kulturës ilire në kulturën e herëshme mesjetare shqiptare, Konf. I e St. Alb.,** Tiranë 1965, 471; S. Anamali – H. Spahiu, **Varreza e herëshme mesjetare e Krujës,** «Studime Historike» 1963, 3, 3-67 dh Shkëmbi i Kavajës, ku kohët e fundit është bërë një sondazh nga F. Tartari, i cili materialet e përfituara i ka në studim.

DO NOT COPY


TAB I
Kryemedhenj
Tiloj
GJIU I DURRESIT
Seferaj
Golemaj
Qerret
Aganas
Spanjo
Zig Xhafaj
Zikulari
Prroi i Kavajes
Stani Ri
Rrakulli
Helmas
Çeta
Mameli
Shengjergji
KAVAJA
Legjenda
Kala Ilire
Varrezë
Mbishkrim
Rrënoja kishe
Gjurmë të Via Egnatias

DO NOT COPY

TAB. II



DO NOT COPY



1



2



3



0 1 2 3 4 cm







DO NOT COPY



Malli Robit : Fragmente qeramike ndërtimi e poçarie

DO NOT COPY

Halil MYRTO

A PROPOS DE CERTAINS CENTRES ARCHEOLOGIQUES SITUES ENTRE KAVAJA ET DURRËS

RESUME

Le présent travail est un éxposé partiel des travaux accomplis à ce jour pour dresser la carte archeologique du district de Durrës, et plus particulièrement de la zone s'étendant entre cette ville et la localité de Kavaje.

1. – XIG–XHAFAJ

L. Heuzey mentionne la présence, à proximité de Kavaja, d'une petite forteresse. Le lieu Xig-Xhafaj se trouve à 4 – 5 km. de Kavaja, dans sa partie S.E., et surmonte le massif mamelonné de Mengle.

Le dos de la colline, dont le sommet le plus élevé a une hauteur de 239 m. est marqué par un relief arrondi comprenant quelque étendue plate ou de petites terrasses.

La partie le plus élevée de la colline de Zig-Xhafe était entourée, en direction N,-O., O. et S., par des murs défensifs. La forme de ce mur a du ressembler à un trapèze irrégulier, d'une longueur moyenne de 400 m. et d'une largeur de 100 m. (voir l'élevé topographique). Des travaux partiels de déblayage ont montré que nous ne sommes en présence que de la dernière rangée du mur.

Ce trait de mur est construit de blocs de pierres conglomératiques et calcaires, empilés sans mortier. De leur nombre, quelques-uns sont équarris de tous les côtés et ont la forme de parallélépipèdes réguliers. Son parement est généralement plat et quadratique.

Dans la territoire fortifié ont été découverts une foule de fragments de briques, de tuiles et de récipients en céramique, ayant la couleur naturelle de la glaise ou vernissés en noir. Certains fragments de solènnes sont marqués de sceaux à angle droit (18 x 3 cm.) reproduisant les inscriptions partielles (voir le texte albanais). La plupart des tuiles trouvées à Zig-Xhafe ont été produites à Durrës à l'époque du prytane Αριστοδαμος.

Les données précitées nous permettent d'aboutir à la conclusion qu'à Zig-Xhafe existait, au IVe-IIe siècle avant notre ère, une citadelle illyrienne du type castellum, servant en même temps comme centre administratif, religieux et lieu de refuge, en cas de guerre, pour les habitants de la zone avoisinante.

2. – SPANJO

A proximité des villages de Spanjo et d'Aganas on à découvert un fragment de solène, dont la face reproduit, à l'intérieur du cadre habituel des sceaux à angle droit, le nom du prytane Γαιος, *qui s'est distingué parmi ses collègues de Dyrrachium pendant la deuxième moitié du Ier siècle avant notre ère.*

DO NOT COPY

3. SEFERAJ

A proximité de ce village, on a trouvé un autel portant une inscription déjà publiée (H.Ceka, S. Anamali, Inscriptions latines inédites d'Albanie, *Bul.Sciences Soc.,1961,I,117-118). A la suite d'un nettoyage l'inscription en question se présente plus complet.*

Cet autel en marbre appartient, à notre avis, à une propriétaire terrienne de la couche des colonisateurs romains, qui pendant la période impériale étendirent leur pouvoir hors des limites de Durres.

4. QERRET

Les matériaux mis à jour montrent qu'ici, à côté de la Via Egnatia, *dès le Ier-IIe siècle et plus tard, pendant la basse antiquitée, se trouvait une station habitée. Le fait que cette station porte le microtoponyme de «Qisha» (= église), ainsi que la présence de fondaments en forme sexangulaire et de fragments architectoniques (colonnes et autres) dans son voisinage, sont autant de témoignages qui nous induisent à penser qu'une église paléocretienne s'élevait ici pendant le haut moyen âge. Si nous admettons qu'une église s'érigeait ici au XIe siècle, c'est précisément en cet endroit que nous devons rechercher l'Eglise de St.Théodore, où s'est arrêté Guiscard après son débarquement inattendu à l'arrière des forces de l'empereur Alexis Comnène, et non pas à Shtodher de la localité de Kavaja. La distance séparant Shtodher de la mer, la plaine marécageuse de Kavaja, ainsi que la distance considérable du camp de l'ennemi sont autant de faits qui n'auraient pas permis à Guiscard d'effectuer en une seule nuit toutes les notions déscrites par la Comnène. Tandis que la position de Qerret, qui s'avantage de la hauteur de Mali Robit et est en mesure d'observer tranquillement le col stratégique de Patras, qui était surmonté par le camp de l'empereur, ainsi que le fait qu'il se trouvait à proximité de la mer et de la route magistrale, sont autant d'arguments qui s'expriment en faveur de notre hypothèse.*

5. – TRACE DE LA VIA EGNATIA

Du lieu nommé «Qisha» e Qerretit, en direction de Kavaja, sur une distance de 4 – 5 km, on peut suivre les traces d'une ancienne route pavée. Les pierres extraites représentent des dalles ayant les dimensions suivantes: 0,50 x 0,30 x 0,10; 0,70 x 0,40 x 0,15 m.

DO NOT COPY

Maksi VELO

BANESA POPULLORE NË ZONËN E NDROQIT

DO NOT COPY

Ndroqi është qendër e këshillit të bashkuar që përfshin 23 fshatra të kooperativës së bashkuar «Myslim Peza» në zonat e Pezës dhe të Ndroqit. Ndodhet 17 km. në juglindje të Tiranës, në mes të rrugës automobilistike Tiranë-Durrës. Kufizohet me fshatra të Rogozhinës, Kavajës, Durrësit, Shijakut, Vorës, Vaqarrit e Baldushkut.

Kjo trevë, sikurse tregojnë kalaja ilire e Dorzit dhe kalaja e Ndroqit, gjetjet e rastësishme arkeologjike nga fshatarët, rrënojat e 6 kishave që kemi gjetur, (dy në Shesh në lagjet Cep e Sarbalot, një në Pinet, një në Maknor, një midis Pezës e Dorzit në Bërhakje dhe një në Gror), tregojnë për një vazhdimësi të kulturës materiale në këtë territor.

Në defterin e regjistrimit të vitit 1431-32 të sanxhakut të Shqipërisë, jepen të dhëna dhe mbi këto fshatra: Grori ka pasur 14 shtëpi, Maknori 18 shtëpi, Ndroqi 25 (shënohet Andronik' Ier)[1]. Këto fshatra bënin pjesë në krahinën e Misjes, vilajeti i Krujës.

Luginën pjellore të Erzenit, fushat e Pezë-Helmësit e Butacit i shoqërojnë kodra, ku janë ngritur fshatra relativisht të grupuara si Mëniku, Grëbllleshi, Çala-Barzezi, Sauqeti, Pineti, në anën veriore dhe Damjani, Dorzi, Peza e vogël, Ndroqi, Zbarqja, Kërçukja, Matera, në anën jugore.

Konditat e favorshme klimaterike dhe pedologjike kishin favorizuar zhvillimin e një ekonomie bujqësore kryesisht në përpunimin e ullirit, vreshtave, duhanit, frutave dhe, më pak, bereqetit (misrit). Blegtoria në ekonominë fshatare zinte një vënd të kufizuar, kryesisht për plotësimin e nevojave vetjake, më tepër rrisnin lopën, dhinë kurse delen jo dhe aq.

Disa fshatra malore të zonës së Pezës kishin të zhvilluar prodhimin e druve të zjarrit dhe të qymyrit për shitje. Me gjahun e shpendëve dhe kafshëve të egra merreshin më tepër fshatarët e zonave malore, kurse ata të luginës së Erzenit, praktikojnë ende gjahun e peshkut në lumë. Sidoqoftë, këto luanin vetëm një rol ndihmës në ekonominë fshatare.

Karvanët e kafshëve që vinin nga Rogozhina, Kavaja, Durrësi, Shijaku kalonin nëpër Pezë e Ndroq për të shkuar në veri: Krujë, Lezhë, ose në lindje, Tiranë. Ndroqi, në fund të shek. XIX e në fillim të shek. XX, mori zhvillim edhe si qendër tregtare. Ai kishte pazarin e vet me rreth 20 dyqane në sheshin pranë rrapit shekullor. Tregtinë më të madhe Ndroqi e zhvillonte me Tiranën, Shijakun e Kavajën. Shisnin ullinj, vaj, dru, qymyr; blinin drithra buke, bagëti, qerre etj.

Pjesa më e madhe e banesave të Ndroqit janë ndërtime të reja, të ngritura mbas çlirimit të vëndit, por takojmë dhe banesa të vjetra, në përgjithësi të ruajtura mirë, me pak adaptime, të cilat janë dhe objekt i studimit tonë.

Fshatrat e Ndroqit e të Pezës kanë patur kondita të përafërta historiko-ekonomike-sociale dhe banesa të njëjta. Por tani në zonën e Pezës takojmë shumë pak materjal faktik, sepse fshatrat e kësaj zone u dogjën në operacionin e qershorit të vitit 1943. Sot këto fshatra janë ndërtuar krejtësisht të

---

1) H. Inalçik. Hisri 835. Suret-i, Defter-i, Sançak-i Arvanid. Ankara 1954 Tim. 281, 317, 276.

rinj. Nga dëshmitë e mbledhura ndër fshatarë dhe nga ndonjë ekzemplar që ruhet ende[2]), rezulton se zgjidhja planimetrike dhe teknike e ndërtimit është e njëjtë me ato të banesave që do të parashtrojmë. Mbasi kontrolluam gjithë fshatrat, zgjodhëm e rilevuam ato ekzemplarë që na u dukën më tipikë e më të vlefshëm. Kryesisht këtë materjal e mblodhëm në Ndroq-Treg, Kala, Lagje e Re, Varosh, Zbraqje e Kërçukje.[3]).

Ndër banesat e vjetra fshatare më tepër predominon tipi me «shtëpi zjarri». Karakteristika kryesore e saj është se banesa ka si ambient kryesor «shtëpinë e zjarrit» ku zhvillohej tërë aktiviteti jetësor. Këtu grumbullohej gjithë familja, bisedohej, gatuhej dhe qëndrohej në pjesën më të madhe të kohës.

Dhoma e zjarrit thirret dhe «shtëpi e madhe», «shtëpi e bukës» ose thjesht «shpi». Pra, kaq i rëndësishëm është ky ambient, sa që vëndasit e identifikojnë me vetë banesën. Emërtimi fillestar mendoj se është «shpi zjarri», ky përmendet edhe më shpesh. Vetë emërtimi tregon se veprimi më i rëndësishëm që kryhet në këtë ambient është ndezja dhe ruajtja e zjarrit. Zjarri ndizej direkt në tokë në një vënd pak të gërryer. Nuk ka vatër në kuptimin e vërtetë të fjalës, po vetëm dy gurë të ngulur në tokë që quhen «carunj». Tymi shkon direkt lart dhe del ndërmjet trarëve të çatisë e tjegullave. Ky vënd ku digjet zjarri është i spostuar nga qendra e ambientit, afër njërit mur perimetral, por nuk takohet me të.

Carunjtë më tepër fiksonin vëndin ku do të digjej zjarri dhe përcaktonin drejtimin dhe mënyrën e vendosjes së drurëve që digjen.

Nga trarët e shtëpisë varet zinxhiri që quhet «kamostër». Në disa raste, në vënd të zinxhirit prej hekuri, «kamostri» është një shkop i gjatë prej dru frashëri ose shkoze, që varet nga trau i çatisë, kurse poshtë ka një kërrabë të kthyer ku varet kusia. Kamostri prej druri, duhet të jetë më i hershëm se sa kamostri prej hekuri. Ky ambient ndriçohet ditën me dritën që vjen nga baxha në çati. Baxha (një ose dy) kishte në fillim kapakë druri, të cilët më vonë janë zëvëndësuar me xham. Këta kapakë, gjatë ditës, hapeshin me anën e një zinxhiri që tërhiqej nga poshtë. Por kemi takuar dhe «shpi zjarri» pa baxhë, pra, pa ndriçim nga sipër, por që mernin dritë vetëm nga porta e hyrjes.

Në muret përreth dallojmë kamare me një ose dy ndarje të zgavruar më mur, ku mbaheshin orendi me dimensione të vogla. Elementi tjetër i rëndësishëm në këtë ambient është «mafili» ose «nafili», tek i cili ngjitemi me shkallë druri me një rampë. Mafili na lidh me ambientet e katit të dytë të banesës. Në disa banesa të fshatarëve të varfër të para çlirimit kishte një zhvillim volumetrik të kufizuar, kështu që mafili nuk ekzistonte fare dhe kalimi për në katin e dytë bëhej vetëm me tre ose pesë shkallë të thjeshta. Trualli poshtë është vetëm me dhe të ngjeshur, kurse muret janë me gurë të lyer me baltë. Lyerja me sherbet gëlqere është një dukuri e mëvonshme, kurse më parë gëlqeren nuk e njihnin dhe nuk i lyenin veçse me baltë. Në muret ose në trarët e çatisë ngulen kunja e gozhdë ku varen objekte të punës së përditëshme, drapinj, rrjeta peshkimi, sëpata etj.

Në fshatin Kërçukje[4]), gjetëm një rast kur «shpija e zjarrit» me dimensione 7.80 x 5.4 m. e me lartësi 7.3 m. ishte e futur brënda në shkëmb. Shkëmbi qe sharruar 4 m. thellë (faqja jugore e banesës) dhe mbi te ishte ngritur mur guri.

Planimetria më e thjeshtë që takuam (tab. I, banesa 1) është një ambient i vetëm, pothuajse katror 4.2 x 3.97 m., në Ndroq-Treg me lartësi 2.40 m. Këtu banohet, gatuhet, flihet. Më parë ka pasur vetëm një derë, 90 x 175 cm., e cila është mbyllur dhe tani është një derë tjetër e një dritare. Ka vatër e një zgavër në mur gjysmë cilindrike 45 cm. të gjërë, 24 cm. të thellë, e 180 cm. të lartë për drejtimin e tymit (viz. 1). Në mes të saj është vendosur një pllakë guri, e cila shërben për vendosjen e objekteve të ndryshme. Dyshemeja është më dhe të ngjeshur.

Në një variant tjetër (tab. I banesa 2) ambienti kryesor mbetet ay i zjarrit me dimension 3,98 x 5,30 m. me lartësi 2.20 m. është pa dritare vetëm me një hyrje, por këtu janë shtuar dy ambiente ndihmëse, një qur (depo) dhe një hamam që komunikon me ambientin e jashtëm. Kjo është përdhese e pa tavan. Përveç kanalit të tymit 36 x 147 cm. ka edhe një kamare në të djathtë të tij 26 x 36 cm. Këto dy raste që paraqitëm janë me interes si ekzemplarë të banesës një-

2) Banesa e Dem Muçallës – Damjan. Në Damjan ka pasur shtëpi të mëdha ku banonin disa kurorë dhe ku komandonte plaku i shtëpisë, i cili ndante dhe punët. Shtëpia e Uf Tresës, 60 veta, kur u ndanë mbas çlirimit u bënë 14 shtëpi. Shtëpia e Dull Damjanit, 50 veta. Shtëpia e Baft Tafës, 50 veta. (Të dhëna nga Ismail Muçalla).

3) Falenderoj sektorin e qendrave historike, pranë Institutit të monumenteve të Kulturës për ndihmën që më dha, si dhe shokët E. Harxhi, Dh. Shala, e B. Penxha që rilevuan banesat. Fotot dhe vizatimet e lira janë të autorit.

Shënim: Në fshatin Rrethje të Shijakut më treguan se trungun e drurit e fusnin brënda me një ka dhe e linin në mes të votrës që ta digjnin.

4) Banesa e Dull Lilës. Sipas të dhënave gojore kjo banesë është ndërtuar para 150 vjetësh nga mjeshtra korçarë.

BOTIMI

DO NOT COPY



Skica 1



Fig. 1

kthinëshe, ku kryhen gjithë aktivitetet jetësore. Banesa njëkthinëshe (fig. 1), shndrrohet ngadalë në banesë me shumë ambiente banimi. Në fillim kjo shtrirje është horizontale dhe pastaj zhvillimi volumentrik bëhet vertikal.

Në lagjen Varosh, tek banesa e Sul Tores (tab. II banesa 3), dhoma e zjarrit 5,24 x 6,64 m. është e vendosur mbrapa, me një hyrje anësore 82 cm., afër burgut të bagëtive, i cili ka një derë më vete nga jashtë dhe një komunikim me dhomën e zjarrit. Këtu shihet qartë se ky ambient është ai që i është shtuar i pari dhomës së zjarrit. Duket mirë ndarja volumetrike, një dhe dykatëshe, midis këtyre dy ambienteve dhe pjesës tjetër të banesës, e cila në katin e parë ka mullirin e shtypjes së vajit e një depo, kurse në katin e dytë dy dhoma gjumi[5]).

Kjo banesë pa punime të veçanta dekoruese, e ulët, me pak ambiente, ka qenë tipike për familjen e një fshatari të varfër para çlirimit. Janë akoma shenjat e një prapambetjeje dhe të një kujdesi të veçantë për bagëtinë, që mbahej afër ambientit ku banonte njeriu.

Në planimetrinë e banesës në lagjen Treg (tab. II, banesa 4), shihet se rreth dhomës së zjarrit mjeshtri ka zhilluar ambientet e tjera. Në ballë ka hajatin, majtas mullirin e vajit, para dy depo. Një shkallë me gjërësi 85 cm. të çon nga dhoma e zjarrit me anën e një mafili në katin e dytë. Ky mafil nuk është si në gjithë rastet e tjera, por zhvillohet si një ballkon druri i brendshëm i hapur.

Në katin e dytë mund të ngjitesh nga brenda ose nga jashtë. Aty janë një divan dhe tre dhoma gjumi, së bashku me hamamin. Kjo banesë e rrethuar nga gjithë anët me mur ka pasur dhoma për shërbyesit, depo për bereqet, stalla. Oborri i shtruar me gurë ka në mes pusin. Porta e madhe kryesore është me hark. Forma e harkut ndeshet shpesh në portat e jashtme të banesave më të pasura.

Banesa e Jakup Lilës (tab. III banesa 5) na jep një zgjidhje planimetrike me dhomë zjarri të vendosur në mënyrë anësore, por banesa merr një shtrirje më të gjërë. Ky ekzemplar dallohet dhe për një element të ri, daljen e divanit nga vija e murit dhe shndrruarjen në ballkon të mbuluar. Këtu përsëri si ambient kryesor mbetet dhoma e zjarrit. «Shtëpia e madhe» ka hyrje nga brënda (prej hajatit) dhe një portë nga jashtë, në anën perëndimore. Vatra ka qënë në qendër, tani kanë bërë një oxhak në mur (viz. 2). Element që duhet shënuar është mafili me gjerësi 2 m., tek i cili ngjitesh me 10 shkallë druri, që kanë shkeljen 22 cm. e lartësi 20 cm. Në të gjitha rastet shkallët janë prej druri. Dhe në këtë ambient kemi 4 kamare 33-37 cm. të gjëra, dy poshtë dhe dy në nivelin e mafilit.

Nga mafili kalohet në një dhomë gjumi me oxhak e WC më vete. Njera dhomë gjumi (më e madhja $S = 27.6\ m^2$) e destinuar për miqt ka hyrje si nga koridori, ashtu dhe nga jashtë me një palë shkallë guri dhe me një derë me hark në fasadën lindore. Edhe kjo

5) Mulliri i vajit është një ambient mjaft i madh. Lëvizjen e gurëve për shtypje e bënin dy tre burra ose me kafshë, kurse shtrydhjen e vajit e bënin me një mekanizëm të thjeshtë prej druri. Shtylla me viaska quhet burgji, mbi të lëviz torku, i cili shtrëngon budallanë në koshin me ullinj.



Skica 2



Skica 3

dhomë ka WC e saj. Dhoma tjetër e fjetjes me S = = 16.7 m² ka hyrje nga koridori.

Ballkoni i mbuluar është ndërtuar me lëndë druri. Dritaret e mëdha që janë çelur nëpër dhomat janë adaptim i mëvonshëm.

Dera e madhe, e jashtëme, e banesës mbyllet nga brënda me një tra të madh, kurse kapaku i majt i saj ka një detaj, që vlen të citohet, një kllapë druri 80 cm. e punuar që luan rolin e rezes (viz. 3).

Mjeshtri ka shtrytëzuar me aftësi pjerrësinë e terrenit, duke krijuar ambiente me disnivele, të cilat shihen qartë në fasadën anësore.

Banesa e Hasan Lilës (tab. III banesa 6) është e vendosur në kulmin e një kodrine në lagjen Çoçje. Fasadën kryesore e ka të kthyer nga lugina e lumit Erzen, në drejtimin V.L.

Kornizat e dritareve, kamaret, oxhakët etj. janë punuar me mjeshtëri, me gurë e dru, me detaje të kërkuara. Ruhet në gjendje të mirë, megjithëse janë bërë disa adaptime nga banorët e shtëpisë.

»Dhoma e zjarrit» me S = 36.4 m², është e vendosur në qendër të banesës në pjesën e mbrapme të saj. Hajati është i ndarë nga ambienti i shkallës, e cila është e futur brënda si masë sigurimi, pra, shkallë nga jashtë nuk ka. Sikurse shihet nga planimetria kemi tre shkallë të brëndshme. Njera, që do ta quanim kryesoren, e cila na nxjerr në veçanti në dhomën e gjumit të vendosur në ballë. Shkalla e dytë, që komunikon me ambientin e jasntëm me një derë dërrase në faqen lindore, e cila na çon më dy dhoma banimi të katit të dytë, që shohin nga lindja e veriu.

Shkalla e tretë, krejtësisht e brëndshme, është ajo e mafilit të odës së zjarrit. Kjo të çon në kuotën e mafilit, i cili është një ballkon druri i dyanshëm. Vërejmë se krahu lindor zgjerohet nga 157 cm. në 190 cm., kurse krahu verior shkon drejt me gjerësi 120 cm. Ky të çon në një koridor para dhomës së gjumit të miqve. Kjo dhomë me dimensione 3.2 x 3.9 m. ka një oxhak dhe një kamare të punuar në qoshe të murit ka një frëngji, e cila e ka detyruar mjeshtërit të gërryejë murin me një formë të kurbëzuar.

Në qoshen tjetër të shtëpisë, nga ana e mbrapme e saj, në dhomën e gjumit ka po ashtu një frëngji. Gjithsejt në katin e dytë ka tre frengji mbrojtëse për raste lufte. Dritaret kanë gjërësi të ndryshme nga 48-98 cm; ato të katit të poshtëm për sigurim mbyllen nga brënda me kapakë druri, kurse të sipërmet me rrjetë kafaz druri. Fashatura e jashtme e dritareve është po ashtu me dërrasa lisi.

Veranda me S = 22.8 m² është një pikë panoramike, që zotëron nga lart gjithë zonën. Në të varen prodhimet bujqësore, sidomos, duhani për t'u tharë. Një kënd i veçantë i saj që quhet «qoshe» me gjërësi

DO NOT COPY

205 cm. është i ngritur 50 cm. nga niveli i dyshemesë për të vendosur vegjën në të cilen punonin grate.

Një nga shtëpitë më të vjetra në Ndroq, që ruhet, është ajo e Sulejman Branjes (tab. IV banesa 7). Nën një çati të madhe me kater kullime mbulohet një banesë dykatësne me planimetri katërkendesne me S = = 290 m². Kjo planimetri ka në qender «dhomen e zjarrit». Vatra ndodhet afër qendres së ambientit, e spostuar pak nga ana perëndimore. Ka dy gurë të ngjeshur në toke «carunj». Në muret përreth dallojme katër kamare me gjerësi 28,48 e 60 cm.

Kreth «shtëpisë se bukës» zhvillonet planimetrija me ambiente rreth e qark saj. Para ka një hajat me dy dhoma banimi, majtas mullirin e vajit, mbrapa tre ambiente për bagëti. Nga jashtë ka 6 hyrje, kurse për komunikim me katin e dytë ka tre pale shkallë, një nga «shpija e madhe». Përmes mafilit shkohet në dy dhomat e miqve, në dhomën e madhe nga veriu, prej ku dilet në verandë dhe në llozhën që sneh nga jugu në fasadën kryesore.

Më parë një palë shkallë që ishin vendosur në mullirin e vajit dhe komunikonin me ambientin e jashtëm të çonin, gjithashtu, në «dhomën e miqve», këtu që për miqtë komunikimi bëhej direkt nga jashtë.

Një palë shkallë të tjera, «me qepen», të nxirrnin në verandën me S=45 m². Tani vonë këto shkallë i kanë zëvëndësuar me një palë shkallë të jashtme. Në këtë banesë shihet përdorimi i kalimit nga një ambient në tjetrin. Përreth shtëpija ka oborr të madh, pus, ambiente shërbimi dhe një mur rrethues.

Banesa dykatësne e Islam Ahmet Bletës (tab. IV banesa 8), në lagjen e re të Ndroqit është, sipas të dhënave gojore, banesa më e vjetër që ruhet deri sot, rreth 150 vjeçare. Ndërtimin e saj ua atribuojnë mjeshtërve korçarë. Ka planimetri pothuajse katrore me dimensione 17.65 x 19.3 m. me një thyerje të vogël të murit verior. Në dy planimetritë shihet qartë zhvillimi i ambienteve përreth atyre që qëndrojnë në bërthamë. Ajo që e dallon këtë banesë nga të tjerat, është se dhoma e zjarrit ngrihet në katin e dytë. Kjo banesë ka pësuar mjaft ndryshime, megjithatë dallohen lehtë ambientet dhe detajet fillestare. Ndryshimin më të madh e ka shkaktuar lidhja e saj, në fillim të shekullit, me një banesë tjetër dykatëshe, në faqen veriore (fig. 2). Lidhja është bërë me një ballkon urë të mbuluar (fig. 3). Kjo simbiozë është mjaft tërheqëse. Shtëpia e vjetër e madhe pa dekoracione të jashtme, e thjeshtë një «kulm i madh», siç e quajnë këtu, bashkohet me një shtesë të re të lehtë, të gëzuar, me një ballkon në dru në faqen perëndimore, me nga 6 dritare në çdo dhomë, plot dritë, e ndërtuar nga mjeshtra dibranë. Ndërtuesi me shumë mjeshtëri ka zgjidhur kërkesën e pronarit për një shtesë tjetër, që të lidhej me banesën e vjetër. Secila ka zgjidhje të vetën, por rrinë hijshëm një-



Fig. 2



Fig. 3

DO NOT COPY



Skica 4

ra pranë tjetrës. Këto ndërtime nga mjeshtër të ndryshëm në kohë të ndryshme, janë një shembull i qartë që tregon se si në arkitekturën fshatare janë realizuar kërkesa të reja, krahas atyre më të hershmëve.

Pra, sikurse shënuam banesa e vjetër ka një planimetri, pothuaj katrore, me një sipërfaqe naërtimi 329 m². Dallohen qartë 4 muret gjatësorë 75 cm. të gjërë që ndërpriten nga të tjerët. Ka pasur hyrje shërbimi nga veriu, kurse hyrja per banorët është nga perendimi. Shkalla e brëndshme, e gurtë, me një rampë me 15 shkelje, tani nuk përdoret dhe gjendet në qilar. Në këtë kat ka ambiente që përdoreshin për ruajtjen e materialeve, mulli vaji, ahur për bagëti etj. Hyrja veriore është e mbrojtur nga një frengji. Tani vonë janë shtuar dy shkallë, një e jashtme dhe një tjetër e brendshme. Shkalla bëhej e brëndshme për sigurim. Elementë të tjerë mbrojtës janë frëngjitë në katin e parë, dhe ato në katin e dytë, tek dhoma e miqve.

Në katin e dytë, ambienti më i rëndësishëm është dhoma e zjarrit me dimensione 5.4 x 11 m. Një oxhak i thjeshtë, por madhështor 170 x 135 cm., i ngritur 190 cm. nga toka, dominon gjithë ambientin. Dhoma është pa tavan. Duken trarët e lisit të nxirë dhe gjithë çatia. Në mur, anës oxhakut dhe në vënde të tjera, ka kamare e dollape, kurse në murin lindor, një sergjen (viz. 4).

Nga ky ambient qëndror qarkullohej në dhomat e tjera periferike me anën e 6 portave, që të çonin në odat e miqve, odat e fjetjes, ambientet e shërbimit. Para dhomave ka qënë hamami. Dallohen për punimet në dru të dollapëve, sergjeneve, kapakëve të dritareve dy dhoma gjumi, njëra në cepin V.P. e, tjetra, në atë J.L.. Kjo e fundit, e destinuar për miq, është veçanërisht e rehatëshme. Dritaret kanë 3 sërë kornizash: kapaku mbrojtës i tëri në dru, grila me rjetë druri në formë rombi dhe korniza e dritares. Kapakët e dritareve kanë lëvizje vertikale. Në murin jugor një vatër me një kanal të gjatë është e zgavruar në mur. Anash ka dollape e kamare, kur hapet kapaku i një dollapi duket vrima e frëngjisë për mbrojtje. Kjo dhomë ka dy frëngji (fig. 4).

Dera e jashtme me hark mbyllet nga një kllapë hekuri me këlysh (fig. 5, 6).

Banesa e Sulejman Salës në lagjen Treg (tab. V banesa 9), është një tip kulle që dallohet midis banesave të tjera dhe është i vetmi ekzemplar i këtij tipi banese në këtë zonë. Elementin kryesor të banesës së fortifikuar, frëngjinë, e pamë dhe në banesa të tjera, prandaj ky tip banese i fortifikuar është si vazhdim i kërkesave për mbrojtje. Kulla trekatëshe në planimetri ka një zhvillim tipik të kullave të veriut. Në çdo kat ka nga një dhomë. Kati i parë, tani i ndryshuar ka qënë si qi-



Fig. 4

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

lar (bodrum), kurse dy katet e tjera banoheshin. Kati i sipërm, ka një tavan të punuar në dru me një dekor radial. Në pamjen kryesore të bie në sy porta tipike e kullave, e ulët dhe me hark. Kjo portë tani është mbyllur me gurë dhe është çelur një tjetër në faqen lindore. Tri dritare të vogla shërbenin për ndriçim e mbrojtje.

Dritaret e dy kateve të tjera janë 103 x 150 cm. dhe kanë një kornizë druri të dekoruar në pjesën e sipërme me një variacion trekëndëshi. Një dritare e vogël, me kafaz 58 cm., jo në një kuotë me dritaret e mëdha i jep dritë shkallës.

E mbushur me dritë nga 6 dritare që shohin në tre drejtime jug, lindje e veri është dhoma e miqve e katit të tretë. Shkallët janë prej dru lisi. Muratura me gurë ka gjërësi 70 cm. Çatia është me katër kullime.

Kjo banesë është ndërtuar nga mjeshtër dibranë, që kanë plotësuar kërkesat e një banese të fortifikuar, tip kullë në planimetri, me një zbutje stilistike në dritaret e mëdha dhe tavanin të dekoruar.

Mjeshtrit dibranë kanë dekoruar dhe tavane të tjera në këtë zonë. Po përmëndim dy tavane në një banesë afër kësaj kulle, tek banesa e Ramazan Mancakut, po ashtu dhe tek banesa e Hamit Çurrit në fshatin Zbarqe. (tab. VI, banesa 10). Kjo banesë ka po ashtu frëngji 9 x 20 cm. në katin e dytë, pranë portës së hyrjes, dritare me fashaturë të dekoruar dhe një dhomë miqsh të punuar me mjeshtëri. Aty ruhen mirë dollapet, sergjenet dhe tavani. Dhoma ka lartësi 2.28 m. Një dollap qëndror është për plaçkat e fjetjes dhe tre dollapë të tjerë kanë thellësi të paktën 25 cm.

Banesa e Vath Merkoqit në lagjen Treg-Ndroq (tab. VI banesa 11), paraqet vlera, sidomos për zhvillimin planimetrik. Është banesë dykatëshe me një planimetri katërkëndëshe.

DO NOT COPY

Nga planimetria duket që depot, stallat, dhomat e shtuara dhe muret, rrethojnë dy ballë të shtëpisë, atë jugoren, dhe atë perëndimoren, duke krijuar dy oborre të brendshme. Në këto oborre qarkullohet me anën e katër portave, nga të cilat, ajo e ballit lindor është kryesorja me një hark gjysmërrethor dhe një portë të madhe druri që mbyllet nga një kllapë hekuri me këlysh. Kjo banesë dallohet nga të tjerat për faktin se ka dy ambiente zjarri, nga një që kemi parë deri tani, në dy dhoma zjarri të mbështetura shpinë më shpinë në një mur. Kati i parë ka nji hajat me S=21 m² dhe dy dhoma banimi anash tij, nga ky hajat kalohet në të dy dhomat e zjarrit në pjesën e mbrapme të banesës. Janë me dimensione të ndryshme, njera me S=39 m² e tjetra me S=36m². Në lartësi kapin dy katet e banesës 4.2 m. Njera dhomë zjarri, më e madhja, ka hyrje direkt nga jashtë, kurse tjetra nuk ka; ato kanë pasur dhe një komunikim midis tyre, që më vonë është mbyllur. Kamaret në mur të punuara bukur (njëra ka 8 syresh, kurse tjetra 3), shërbejnë për të vendosur filxhanet e kafes, sende përdorimi etj. Mafilet me shkallët e drurit, dritaret dhe vatra me kamostër krijojnë një ambient ku rrihej me kënaqësi.

Njëra dhomë zjarri ka sipër mafilin, që komunikon vetëm me hajatin e katit të dytë e, prej andej, shkohet në dhomën e gjumit, kurse dhoma tjetër e zjarrit ka shkallë të brendshme që të çojnë në mafil. Prej andej delet në koridor, i cili me anën e një dere me hark na nxjerr në një palë shkallë guri të jashtme.

Njëra nga këto dhoma zjarri ka hamam në faqen veriore.

Në faqen perëndimore, tani vonë, është ndërtuar nga banorët e rinj një shkallë që të çon në dhomë.

Kjo banesë, me dy dhoma zjarri, është ndërtuar për dy familje, pra, mund t'a konsiderojmë si bashkimin e dy banesave.

Materialet dhe teknika e ndërtimit. Të gjitha banesat e vjetra kanë si material kryesor ndërtimi, gurin. Është gur i rrumbullakët i grumbulluar në lumin Erzenit dhe në përrenjtë e shumtë, që derdhen në të: si përroi i Jevgut, përroi i Pezës, përroi i Brizës, përroi i Shëmtirës etj. Në fshatrat malore Zbarqe, Kërçukje, Sauqet, Çala-Barzez, Dorz, Damjan, guri nxirrej nga shkëmbinjtë. Gurët e lumit ose të përrenjve grumbulloheshin në kapulica anës, ku nuk i merrte uji. Transportimi i tyre bëhej me kafshë, të cilave u vinin arka në samar.

Mjeshtrit dhe banorët përdorin shprehjen «një përrua gurë» si njësi matëse. Kjo është baraz me 20-30 m³ gurë. Gurët grumbulloheshin paraprakisht, afër vëndit ku do të ngrihej banesa. Si material lidhës përdoret balta e rrahur mirë me këmbë. Brezat e drurit vendosen çdo 65-95 cm. dhe janë prej dru lisi, i cili pritej në pyjet përreth. Gjithashtu përdorej dhe druri i qarrit ose dushkut. Çdo familje kishte një zonë të caktuar në pyll. Sharrëxhinjtë që bënin këtë punë ishin nga zona e Korçës. Trarët përdoreshin për strukturat mbajtëse të shkallëve, dyshemeve ose çative. Në çati trarët vendoseshin horizontalë, pastaj ata lidhës transversalë që quheshin «uku». Viheshin «cungalet» vertikale, që lidheshin midis tyre me «zgjedhën», pastaj vendoseshin «trarët e çatisë», «kulmori», «patavrat» e, në fund, hidheshin tjegullat. Trarët që dalin jashtë muraturës e formojnë strehët quhen «bishta». Mbulesa e çatisë katërujse është me tjegulla vëndi që digjeshin nga vetë fshatarët në kumi. Në disa banesa populore më të reja, gjejmë gurë të gdhëndur e të murosur në cepat e qosheve.

Sipas të dhënave gojore, shtëpitë e vjetra i kanë ndërtuar mjeshtra korçarë e dibranë. Vëndasit nuk dinin të ndërtonin e nuk merreshin me këtë punë. Vetëm mbas çlirimit dolën muratorë vëndas, të cilët sot ndërtojnë pjesën më të madhe të banesave fshatare, megjithatë mjeshtrat korçarë vazhdojnë të vijnë e të ndërtojnë ende edhe sot.

Konkluzione. — Nga materiali që parashtruam del në pah se tipi kryesor i banesës është ai me «shpi zjarri»[6]; Gjetëm banesa njëkthinëshe që ka qenë faza fillestare dhe të tjera me zhvillim planimetrik më të zgjeruar. Në të gjitha rastet «shpija e zjarrit» mbetet ambienti kryesor, bërthama planimetrike rreth së cilës zhvillohen ambientet e tjera që shtohen për të plotësuar nevojat ekonomike e shoqërore (quri, mulliri i vajit, ahuri i kafshëve, dhomat e fjetjes, dhoma e miqve). Këto shtesa sjellin domosdoshmërinë e elementeve dhe ambienteve të tjera lidhëse: hajatit, shkallës, mafilit, çardakut, por megjithatë ambienti kryesor, ai i zjarrit, mbetet në qendër i pandryshueshëm. Dhe kur zhvillimi volumetrik bën që banesa të ngrihet në dy kate, shtëpija e zjarrit kap lartësinë e të dy kateve. Me sa duket lartësija limit e këtij tipi është dykatëshe; rast banese me tre kate nuk kemi hasur dhe kjo është e kuptueshme. «Shpija e zjarrit» nuk do të mund të luante më rolin e një epiqendre shpërndarëse në drejtimin e ambienteve të tjera veçse duke u deformuar.

Ky tip banese nga të gjitha karakteristikat e saj, të lë të kuptosh se është shumë e lashtë, në shekuj

6) Përveç këtyre banesave me «shpi zjarri» janë dhe këto: Në Varosh banesat e Ibrahim Gurit e Rasim Rabetës, në Treg ajo e Sulejman Mancakut, në Cala-Barzez banesa e Osman Gogës dhe Bajram Gogës, në Kërçukje banesa e Hysni Lilës e Dull Lilës, në Zbarqje banesa e Beqir Xhumrit.

DUKOT.COM

duhet të ketë pësuar fare pak ndryshime strukturale e planimetrike[7]).

K. Zheku e gjeti dhe e studjoi këtë tip banese në fshatrat Mullet[8]), Farkë e Lundër[9]), po ashtu E. Riza dhe K. Zheku këtë tip banese e gjetën në qytetin e Tiranës dhe e quajtën banesa tiranase[10]). Banesa e zonës së Ndroqit ka karakteristika planimetrike e funksionale të njëjta me ta, por ndërron në teknikën e ndërtimit, sepse është e ndërtuar kryesisht me gurë; qerpiçi në këtë zonë pothuajse nuk përdoret. Sikurse pamë, në mjaft raste gjejmë si elementë mbrojtës frëngjitë[11]). Po ashtu dhe në trajtimin arkitektonik të fasadës, banesa tiranase dhe ajo e fshatrave përreth saj ka një zbutje stilistike me përdorimin më të madh të kollonave prej druri, çardakëve e strehëve të mbuluara. Ky studim e bën më të plotë kuadrin e shtrirjes territoriale të këtij tip banese. Shënojmë se për fshatrat Shetel, Hardhishtë, Likesh, Pjeshkëz, Rrethje të lokalitetit të Shijakut fqinj me fshatrat e zonës së Ndroqit, fshatarët treguan se banesat e hershme kanë qënë me «shpi zjarri». Banesa ndërtohej me hunj, kallama e bajgë bagëtish. Ishte njëkatëshe, në qendër ishte «shpija e zjarrit», në mes të së cilës ndizej zjarri. Kishte edhe shtëpi me shtylla druri e qerpiçi. Mafili ekzistonte kur banesa ishte dykatëshe.

Sikurse pamë, Ndroqi dhe fshatrat përreth tij, ruajnë ende sot në gjendje të mirë një numër të madh banesash fshatare të vjetra, pjesa më e madhe e të cilave janë me «shpi zjarri». Këtë tip, pra, do ta cilësonim dhe si tipin e banesës që ka prediminuar në këtë zonë.

DO NOT COPY

7) Një fakt tjetër i rëndësishëm për këtë është një zbulim i rastësishëm që fshatarët e fshatit Shesh bënë në vitin 1957. Duke gërmuar në një terren të pjerrët, zbuluan rrënojat e dy banesave me «shpi zjarri» në qendër (dimensionet e përafërta të shtëpisë së zjarrit ishin tek njëra 5 x 4 m. tek tjetra 4 x 4). Të dyja ruanin dy «carunjtë» të ngulur në tokë. Në njerën banesë u gjet tek «shpija e zjarrit» një mokër, kurse tek tjetra një vorbë. Rreth e përqark kishte ambiente të tjera. Kjo gjetje dëshmon se ky tip është përdorur vazhdimisht në këtë zonë.

Të dhënat gojore dhe gjetjet që pamë në fshatin Shesh i dëshmojnë dhe shumë fshatarë. Gurët e këtyre rrënojave u morën dhe u përsosën për ndërtimin e furrës dhe të objekteve të tjera.

8) K. Zheku, **Shtëpia e banimit në fshatin Mullet dhe zhvillimi i saj.** «Etnografia shqiptare» I. Tiranë, 1962.

9) K. Zheku, **Disa shtëpi banimi karakteristike në fshatrat Farkë e Lundër** «Etnografia shqiptare» III, Tiranë, 1972.

10. — E. Riza. K. Zheku, **Banesa Tiranase.,** «Monumentet» 2/1971

11) Frëngji për mbrojtje kanë pasur dhe banesat në Gror, Damjan Pezë etj. Të dhëna gojore nga Ismail Muçalla.

TAB I

BANESA 1



BANESA 2







0 1 2 3 4



PREMJA A-A

DO NOT COPY

TAB II

BANESA 3



BANESA 4





KATI I



KATI I



0 2 4 6м

KATI II



KATI II

GEN - PLAN



DO NOT COPY

BANESA 6



BANESA 5





KATI I



KATI I



KATI II

0 2 4 6м



KATI II

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB IV

BANESA 7



BANESA 8





KATI I



KATI I



KATI II



KATI II

GEN · PLAN





BANESA 9

TAB. V



KATI I



TAVANI - AMBJENTI A



0 05 1M.

KATI II



KATI III



0 2 4 6

DO NOTOPOLY

BANESA 11

TAB. VI



GEN - PLAN





KATI I

BANESA 10





KATI II



DO NOT COPY

DO NOT COPY

Maksi VELO

L'HABITATION TYPE DE LA ZONE DE NDROQ

RESUME

Ndroq se trouve à 17 km au sud-est de Tirana, à moitié route du chemin carrossable Tirana-Durrës. Cette aire, comme le montrent la forteresse Illyrienne de Dorz et celle de Ndroq, les objets découverts fortuitement par les paysans, ainsi que les ruines de 6 églises que nous avons mis à jour, se caractérise par la continuité de la culture matérielle.

Ndroq, vers la fin du XIXe siècle et le commencement du XXe, devint aussi un important centre de commerce. Il avait son marché à lui, avec 20 magasins environ, disposés sur la place près du platane séculaire, et commerçait surtout avec Tirana, Shijak et Kavaje.

Les villages de Ndroq et de Peze se caractérisent par des conditions presque analogues, historiques, économiques et sociales, et par le même type d'habitation. Les villages de Peze, ayant été incendiés pendant l'offensive ennemie de juin 1943, il est difficile de trouver dans cette zone un matériel intéressant. Par la suite ces villages furent entièrement reconstruits à neuf.

Parmi les anciennes habitations paysannes, on relève une nette prédominance du type à «chambre du feu». La caractéristique dominante de cette habitation est le fait que sa pièce principale est représentée par la «chambre du feu», où se développait toute l'activité familiale. L'appellation même de ce type d'habitation montre que la principale fonction de cette pièce consistait dans le fait d'allumer le feu et de le conserver. Le feu était allumé à même le sol légèrement graté. En ce qui concerne la fumée, elle était directement évacuée à travers les poutres du toit et ses tuiles.

Les murs étaient garnis de niches, à une ou deux rayons, où étaient disposés les ustensiles de ménage de petites dimensions. Un autre important élément de cette pièce est le «mafil», auquel on accède par un escalier en bois muni d'une rampe. Le mafil *nous met en communication avec le deuxième étage de l'habitation. Certaines habitations de paysans, datant de la période d'avant libération, se caractérisent par un développement volumétrique plutôt limité, de la sorte le* mafil *n'existe point et le passage au deuxième étage a lieu à travers un escalier simple à trois ou cinq degrés.*

Une des plus anciennes habitations de Ndroq, conservées de nos jours encore, est celle reproduite dans la figure 7. Un toit à quatre pentes couvre une maison à deux étages, de planimétrie rectangulaire et d'une superficie de 290 m^2. Au centre de cette planimétrie se trouve la «chambre du feu». Le foyer est disposé au milieu de la pièce et légèrement déplacé en direction ouest. Il est garni de deux pierres enfoncées dans le sol, que les gens du pays appellent carunj. *Dans les murs ont été aménagées quatre niches, dont la largeur est respectivement de 28, 48 et 60 cm.*

La planimétrie de cette habitation se développe autour de la «chambre du pain» entourée de différentes pièces. Sur son devant se trouve l'atrium avec deux chambres d'habitation, à gauche un moulin à huile et au point arrière trois pièces pour les animaux. L'accès à cette habitation a lieu à travers 6 entrées, tandis que la communication avec le deuxième étage est assuré par trois escaliers, dont l'un provient de «la grande maison». C'est à travers le mafil *que l'on accède aux deux chambres des*

amis et à la grande chambre disposée au nord, d'où l'on sort à la véranda et à la loge qui regarde du côté sud la façade principale.

Quant à la maison située dans le quartier Treg (fig. 9), elle représente une habitation de type kulle se distinguant nettement de ses voisines et constituant un exemplaire unique dans cette contrée. L'élément fondamental de l'habitation fortifiée, la meurtrière, nous l'avons observé dans d'autres habitations aussi, ce qui nous induit à penser que le type d'habitation fortifiée est une prolongation des exigences imposées par la défense. Quant à la planimétrie des kulla à trois étages, elle connaît un développement semblable à celui des kulla construites dans le Nord. Chaque étage est doté d'une pièce. Le premier étage actuellement modifié servait naguère de cave, tandis que les deux autres étages étaient destinés à l'habitation. L'étage supérieur est garni d'un plafond en bois travaillé selon un décor radial. A première vue l'on observe la porte typique des kulla, qui est peu haute et en forme d'arc. Maintenant cette porte est murée et elle a été substituée par une autre porte pratiquée sur la face orientale. Trois petites fenêtres percées dans le mur servaient à la fois à illuminer le milieu et à des fins défensives.

La chambre des amis, située au troisième étage, est bien illuminée par 6 fenêtres regardant en trois différentes directions: sud, est et nord. Les escaliers sont en bois de chêne. Les murs en pierre ont une épaisseur de 70 cm. Quant au toit de cette habitation, elle est à quatre pentes.

Dans toutes les anciennes habitations, la matière base de construction est représenté par la pierre. Celle-ci est liée par de la boue bien pétrie avec les pieds. Les bandes, en bois de chêne, sont disposées à chaque 65-95 cm. sur le parement des murs. Les escaliers, le plancher ou le toit s'appuient sur des structures de soutien en poutres. Les poutres du toit étaient disposées horizontalement, les chevrons transversaux s'appelaient «uku»; puis venaient les poinçons verticaux (= cungale) reliés au «joug» (zgjedhë), les «poutres du toit», le faîtage, les échandoles et, en dernier lieu, les tuiles.

Ce type d'habitation à chambre du «feu», toute considération faite de ses caractéristiques, est sans doute très ancienne. Elle a du subir de très légères modifications, sur le plan structural et planimétrique, au cours des siècles.

L'habitation type de la zone de Ndroq a des caractéristiques planimétriques et fonctionnelles analogues à celles de l'habitation tiranoise, mais elle diffère de cette dernière en ce qu'elle est construite seulement de pierres. La brique crue n'est presque pas employée dans cette contrée. Comme nous venons de le relever, les meurtrières constituent souvent un élément défensif. De même en ce qui concerne le traitement architectonique de la façade, la maison tiranoise comme celle des villages avoisinants reflète une atténuation stylistique qui se manifeste par un plus large emploi de colonnes en bois, du tchardak et d'auvents couverts.

Ndroq et les villages environnants conservent de nos jours encore un grand nombre d'anciennes habitations rurales, dans un bon état et dont l'écrasante majorité est constituée par le type de maison à «chambre du feu». Nous sommes donc en présence du type d'habitation ayant prévalu dans cette contrée.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

RESTAURIMI I KISHËS SË MANASTIRIT TË SHËN-THANASIT NË POLIÇAN

Në këtë shkrim do të trajtojmë arkitekturën dhe punimet restauruese të ndërmarra në vitin 1972, në kishën e manastirit të Shën-Thanasit, në fshatin Poliçan të Gjirokastrës.

Monumenti që po shqyrtojmë është një bazilikë me kupol mbi transept dhe narteks më të vonë (tab. I). Naosi ndahet në tre nefa, nëpërmjet dy arkadave të përbëra prej dy kolonash secila. Të katër kolonat ndodhen në pjesën qëndrore me kupol. Nefi qendror, që është më i gjërë dhe me nivel më të lartë se dy anësorët, mbulohet me qemer cilindrik gjysmërrethor, kurse dy nefat anësore, që janë në nivel më të ulët, mbulohen me qemere me seksion çerek rrethi. Në pjesën qendrore nën kupolën, tërthor nefave, është transepti, i cili mbulohet me qemer cilindrik me seksion gjysmërrethor dhe në një nivel me atë të nefit qendror. Në këtë mënyrë, transepti dhe kupola ndërpresin të tre qemerët e nefave, të cilët shkojnë nga muri perëndimor, deri në atë lindor. Naosi ndahet nga ambienti i altarit, nëpërmjet një ikonostasi prej druri i vendosur më nga lindja prapa kolonave. Në anën perëndimore të kishës është narteksi me çati druri dyujse, mbuluar me rasa guri si në anën perëndimore, ashtu dhe në atë lindore; kjo çati përfundon me kallkan. Tërthor kësaj kemi çatin dyujse të transeptit, që përfundon dhe kjo me frontone, por më të vegjël. Kemi të bëjmë me një kryq me krahë jo të njëllojtë si gjatësi dhe gjërësi. Mbi një bazament rrethor, pikërisht në vendtakimin e tyre, ngrihet tamburi me kupol. Bazamenti është një rreth i plotë koncentrik, që del pak prej tamburit[2]) dhe paksa mbi çatitë e tjera. Kisha është ndërtuar me gurë gëlqerorë me madhësi mesatare, të lidhur me llaç gëlqereje dhe të punuar vetëm në qoshet. Me tulla janë ndërtuar kornizat dhe pjesërisht tamburi i kupolës.

Në kishë hyet nga porta perëndimore e narteksit, e cila në planimetri është drejtkëndëshe me brinjë më të vegjël se ato veriore dhe jugore. Dyshemeja e narteksit është e shtruar me pllaka guri dhe ndodhet në nivel më të ulët se terreni përpara kishës, prandaj në të zbritet me disa këmbëshkallë. Sot narteksi është i mbuluar me çati druri, ndërsa më parë ka qenë me qemer cilindrik me formuese veri-jug, gjurmë të cilat ruhen si në faqet jugore e veriore, ashtu edhe në mbështetjen e tij në murin perëndimor të naosit.

Narteksi është shtruar më vonë, gjë që dallohet nga fugat në kontaktin e mureve të tij me muret e naosit. Për këtë flet edhe një dritare në anën perëndimore të kishës, të cilën e mbyllte qemeri i narteksit.

Me rrëzimin e qemerit ka rënë dhe një pjesë e konsiderueshme e murit perëndimor të narteksit, kështu që është dashur rindërtimi i tij. Të dy muret dallohen qartë edhe nga teknika e ndërtimit të tyre. Mu-

---

1. — Rilevimi është i autorit, S. Dashit dhe L. Sulit, foto. të H. Çollakut. Restaurimi është kryer nga Ateljea e Monumenteve të Kulturës të Tiranës, nën drejtimin e autorit dhe L. Sulit.

2) Rasti tjetër që ne kemi hasur në vendin tonë është ai i kishës së Marmiroit, ku bazamenti del si katër segmente rrethore, ndërmjet krahëve të kryqit. Shih. A. Meksi, **Restaurimi i kishës së Marmiroit,** «Monumentet» 2/1971, 75.



Fig. 1

ri më i vjetër është me gurë gëlqerorë me madhësi mesatare, ndërsa muri i ri është ndërtuar me gurë gëlqerorë mesatarë e të vegjël dhe vende-vende me gurë çmërsi; kjo duket në qemerin e rrëzuar, si dhe në brezat e drurit në sipërfaqen e murit. E tillë është pjesa mbi tokë e murit perëndimor, qoshet e këtij muri, si dhe pjesët mbi qemerin e dikurshëm. Gjatë rindërtimit janë ribërë dhe pjesët e sipërme të mureve të vetë kishës, pranë mureve të reja të narteksit, kështu që aty fuga ndarëse naos-narteks mungon (tab II, 1).

Në murin perëndimor të narteksit, mbi portën kryesore, janë tre nikje me mbulesë të harkuar (fig. 1). Në gurin kyç të nikjes së sipërme është gdhëndur një kokë njeriu. Në këtë faqe muri janë dhe dy dritare mesatare, që mbulohen me hark guri. Në secilin nga muret e reja të faqeve jugore e veriore, gjëndet nga një dritare e vogël. Shpatullat janë ndërtuar nga dy gurë çmërsi dhe, nga një tjetër, të gdhendur në formë harku për mbulesë. Gjithashtu një derë e mbuluar me hark, ndodhet në anën veriore të narteksit.

Nga narteksi, nëpërmjet një dere të mbuluar me arkitrarë guri, hyet në naos. Siç e përmendëm më lart, të tre nefat e tij janë të mbuluar me qemere. Ato të nefave anësore kanë mbështetje më të ulët se arkadat, zgjidhje kjo normale nga pikpamja strukturale, sepse siguron shkarkimin më të mirë të shtytjeve të qemerit qëndror.

Të tre qemeret që mbulojnë nefat ndërpriten nga transepti, i cili del edhe mbi çati. Qemeri që mbulon krahët e transeptit e përshkon arkadën në nivelin e nefit qendror, duke krijuar dy harqe më të mëdhenj në arkadat ndarëse të nefave. Kjo bije në kundërshtim me ritmikën bazilikale dhe duhet të jetë kushtëzuar nga numri i vogël i harqeve në arkadë, si dhe nga vendosja në pjesën qëndrore e naosit dhe transeptit. Nga ndërprerja e qemereve të nefit qëndror dhe transeptit, ndërmjet katër kolonave formohet një drejtkëndësh me brinjë më të gjatë, atë veri-jug, mbi të cilin është ngritur tamburi. Për të krijuar katrorin e nevojshëm për ndërtimin e tamburit janë ndërtuar dy harqe me tulla, që kufizojnë brinjën më të gjatë. Mbi të vijnë trekëndshat sferikë dhe korniza e tamburit me kupolën (tab. II, 1). Ky zvogëlim i pjesës qëndrore bën që vizitorit t'i krijohet përshtypja, sikur kupola qëndron në ajër, përshtypje që theksohet nga lartësia relativisht e madhe e

DO NOT COPY

tamburit dhe nga drita që vjen nga tetë dritaret e tij.

Qemeret që mbulojnë nefat vazhdojnë deri në murin lindor, duke u ndërprerë vetëm nga transepti. Hapësira bazilikale ndërpritet nga ikonostasi, i cili është vendosur përpara kolonave, më nga lindja. Ambienti i altarit, i formuar prapa ikonostasit, është në të njëjtin nivel me naosin. Një absidë gjysmërrethore zë pjesën qëndrore të këtij ambienti, ndërsa protezis dhe diakonikoni janë dy nikje të vogla rrethore, që nuk shkojnë deri në tokë. Si në niket, ashtu dhe në abside kemi nga një dritare të murosur.

Të katër kolonat janë të ndërtuara me gurë të hollë e llaç gëlqereje. Përdorimi në to i disa gurëve brenda një rreshti dhe, jo i rrotullave prej guri, është një gjë jo e zakonshme. Si naosi, ashtu edhe ambienti i altarit janë shtruar me dysheme prej tullash gjashtëkëndëshe (brinjët 20 cm., trashësia 4 cm.) (tab. II, 2).

Në anën e jashtme naosin, si dhe narteksin, e karakterizon thjeshtësia e trajtimit të mureve prej guri.

Në vija të përgjithëshme, pamjet jugore dhe veriore janë të njëllojta. Ato ndryshojnë vetëm nga numri i dritareve, forma e transeptit mbi çati dhe gjurmët e vjetra që ruhen. Në murin jugor, transepti ruhej tërësisht (tab. III, 2). Mbi të ishte një këmbanore e vonë gjysmë e rrënuar (tab. II, 5), që kishte dëmtuar së tepërmi frontonin jugor të transeptit. Nuk ruhej asgjë prej kornizës së transeptit nga ana perëndimore, por duken disa tulla në formë dhëmbësharre e disa të drejta në të njëjtin rresht. Tre rradhë tullash, që janë bazamenti i kornizës, duken në qoshen juglindore dhe vazhdojnë në faqen lindore të transeptit, deri sa takohen me çatinë.

Në murin jugor të naosit ka katër dritare. Nga këto, njëra e ngushtë dhe mbuluar me gurë çmërsi e gdhendur në formë harku është në pjesën e sipërme të transeptit. Dy të tjerat, njëra më poshtë dhe tjetra në pjesën më nga perëndimi, janë të njëkohëshme me kishën, po ta gjykojmë nga rregullshmëria e fugave dhe ngjyrat e llaçit. Dritarja e fundit ndodhet në pjesën që i takon diakonikonit. Nga shpatulla e saj me llaçin e fugave të hedhur në mënyrë të çrregullt, dallojmë qartë se janë mure më të rinj.

Në pjesën e transeptit dallohet e mbuluar një portë e murosur, e cila në anën e jashtme është e mbuluar me hark gurësh dhe në anën e brendshme me arkitrarë druri. Kjo portë duket pjesërisht, pasi dherat janë në nivel mjaft të lartë.

Në murin verior përpara restaurimit pamja ndryshonte. Gjithë pjesa e sipërme kishte formën e një frontoni, me bazë gjatësinë e naosit dhe kulmin në mes të transeptit (tab. III, 1). Megjithatë ishte mjaft e lehtë të dalloheshin shtesat prej pjesëve të tjera. Kështu janë shtuar pjesët me mur guri pa llaç anash transeptit. Dallohen qartë jo vetëm faqet vertikale të transeptit, por edhe mbarimet horizontale e të pjerrta të faqes veriore. Në anën lindore të transeptit kemi disa tulla të drejta dhe, mbi to, tulla të thyera. Po kështu kemi dhe qoshen lindore të frontonit ku ruhet si bazamenti i kornizës, ashtu dhe disa tulla të vendosura pjerrtas (tab. II, 4).

Një dritare e ngushtë e mbuluar me një gur të rrafshtë, ndodhet në mes të transeptit. Ka shumë të ngjarë që, dikur të ketë pasur ndonjë ambient të shtuar ngjitur mureve, pasi ka sipërfaqe pak a shumë të mëdha të suvatuara. Duke vrojtuar muret dallojmë që, ndërmjet gurëve, në disa vende janë vendosur vertikalisht tulla ose dhe gurë të hollë, ashtu siç janë përdorur për rrafshim gurë të vegjël ose rrasa ndërmjet gurëve.

Muri lindor (tab. I), dallohet nga të tjerët për përdorimin e një numri të konsiderueshëm gurësh çmërsi. Ai përfundon në pjesën e sipërme me fronton. Korniza e vjetër ruhet vetëm në anën veriore, ndërsa ana jugore i ka rrasat e gurit të çatisë direkt mbi mur. Ruheshin në mënyrë fragmentare si tullat e drejta, ashtu dhe ato në formë dhëmbësharre.

Absida trefaqshe, që del në këtë anë, është mbështetur mbi një bazament gjysmërrethor, që ngrihet nga terreni rreth 35 cm.

Në vëndkryqëzimin e transeptit me nefin qëndror, mbi një bazament rrethor, ngrihet tamburi me kupolën mbi të (tab. IV, 2). Tamburi është tetëfaqesh me koloneta në qoshet e faqeve dhe me nga një dritare në mes. Të gjithë dritaret ishin të murosura dhe vetëm në disa prej tyre ishte lënë një pjesë e vogël për ndriçim. Pjesa më e madhe e faqeve të tamburit ishte suvatuar me llaç me përmbajtje të madhe gëlqere, që i jepte atij ngjyrë të bardhë. Të pa suvatuara ishin faqet lindore, jugore dhe juglindore. Me vrojtimet tona, gjatë restaurimit, e kemi përfundimisht të qartë formën dhe dekorin e tamburit. Nga bazamenti, mbi të cilin kemi dy rreshta tullash deri në thembrat e harqeve, muratura është një rresht gurë çmërsi dhe tre rreshta tullash që shkojnë rreth e qark tamburit. Vetëm në disa nga faqet, më tepër në atë juglindore, ka dhe ndonjë tullë vertikale, bile dhe dy së bashku, që japin idenë e kluasonazhit. Menjëherë mbas kolonetave vinë tre shkallëzime në secilën anë të dritares, që vazhdojnë në pjesën e sipërme me tre harqe, gjithashtu të shkallëzuar e të ndërtuar po me tulla. Mbi harkun më të madh kalon një shirit tullash, mbi një rresht me tulla të vendosura në formë dhëmbësharre e, pastaj, një shirit tjetër tullash. Mbi këtë kornizë kemi një hark me gurë çmërsi që mbështetet mbi një gur po prej çmërsi, i cili del

POSTSCRIPT

më pak nga koloneta dhe luan rolin e kapitelit. Mbi harkun me gur çmërsi është një shirit tullash. Mbi kulmin e tij ka një rresht horizontal tullash, pastaj vjen korniza me një rresht tullash në formë dhëmbësharre e një rresht horizontal që nuk ruhej i tëri. Trekëndëshat e formuar ndërmjet harqeve dhe rreshtave horizontalë, janë dekoruar me tulla vertikale dhe horizontale dhe me nga një kryq në mes.

Në këtë mënyrë i kemi të qarta format dhe fazat e ndërtimit të kishës së Manastirit të Shën-Thanasit. Kemi të bëjmë, si e përmendëm më lart, me një bazilikë me kupol mbi transept. Në një kohë të dytë, në anën perëndimore, kishës i shtohet një narteks i mbuluar me qemer cilindrik në formuese veri-jugë, që përbën fazën e dytë të ndërtimit. Më vonë, me rrëzimin e qemerit të narteksit, rindërtohet muri perëndimor dhe pjesët e sipërme të mureve veriorë dhe jugorë të tij. Kjo është faza e tretë e ndërtimit. Veç këtyre janë bërë edhe meremetime të tjera në kohë të vështira për përdoruesit e monumentit, si mbyllja e dritareve dhe e dyerve, transformimi i krahut verior të transeptit me ndërtimin e mureve në të thatë, anash tij. Vendosja e këtyre meremetimeve në kohë, na duket e pamundur, dhe kjo është arsyeja që nuk po i quajmë faza të veçanta ndërtimi.

Megjithë ndryshimet e bëra në kohë, monumenti ruante në gjendje të mirë gjithë elementet përbërëse të tij. Ndërhyrja restauruese konsistonte, në riparimin e çative dhe strukturave mbajtëse të saj, në hapjen e murosjeve të dyerve dhe dritareve dhe riparimin në tërësi të një sërë dëmtimeve të vogla. Përsa i përket narteksit, menduam, se ai duhej lënë në gjendjen që ishte, duke ruajtur, pra, të tre fazat e ndërtimit.

Restaurimi filloi me zhveshjen e tamburit nga suvatimet dhe vazhdoi me heqjen e mbushjeve të dritareve të kupolës. Vërejtëm një dallim të vogël, ndërmjet dritareve të vendosura sipas pikave të horizontit dhe të tjerave. Të parat kanë në brinjët e boshllëkut të dritares një dhëmb 2x2 cm., i cili duket se është bërë më vonë me gdhendje të gurëve dhe tullave 25 cm. Nën kulmin e dritareve ka qënë një brez druri i strukturës të kupolave, që sot është i prerë rrafsh me shpatullat e dritareve. Nga mënyra e të prerit kuptohet se ajo është bërë nga brenda.

Gjatë heqjes së rrasave të gurit të kupolës, doli se ato ishin vënë direkt mbi strukturën me tulla radiale të kupolës (tab. II, 5), pa ndonjë mbushje, pra, dhe pa ndonjë gjurmë të llaçit mbushës së çatisë së dikurshme. Llaçi është përdorur vetëm aty ku mungojnë tullat e drejta të kornizave për të fiksuar rrasat e gurit. Heqja e rrasave të pjesës tjetër të çatisë, na ofroi një sërë të dhënash mbi gjendjen e kornizave dhe konstruksionin e çatisë. Rezultoi se mbulesa me rrasa ishte mbështetur direkt mbi qemeret në pjesën e transeptit dhe nefit qëndror, ndërsa në pjesën e nefave anësorë, mbi çati druri, me që ata ishin në nivel më të ulët. Gjendja e kësaj pjese të çatisë ishte e keqe, diku me dërrasa, diku me mbushje materialesh ndërtimi. Me pastrimin e çdo lloj mbeturine dhe mureve të rinj, pranë krahut verior të transeptit, dolën në dukje si pjesët e mbetura të kornizave, ashtu edhe struktura e qemereve me gurë çmërsi.

Frontoni mbi murin kishte tulla të vendosura në formë dhëmbësharre me përmasa 25 x 11 x 4 cm., ndërsa gjithë tullat e tjera 25 x 25 x 4 cm.

Në faqen veriore, pjesa e pjerrët e transeptit kishte tulla kuadratike me të njejtat përmasa, ndërsa korniza horizontale veriore e transeptit kishte një radhë tullash në rresht të drejtë e një radhë tullash në formë dhëmbësharre, të gjitha kuadratike. Pjesa nga lindja e kornizës së naosit ishte me tulla kuadratike, ndërsa pjesa e drejtë dhe drejtkëndëshe kishte tulla në formë dhëmbësharre. Siç dukeshin dhe më parë, këto korniza ruheshin në mënyrë fragmentare, po kështu dhe gjurmët e tullave në llaç.

Në faqen jugore, pjesët e pjerrta të transeptit (tab. IV, 3) ishin me tulla kuadratike të rivendosura në mënyrë të çrregullt, ndërsa korniza e drejtë e transeptit ruhej me tulla në vendin e tyre. Kjo kornizë është e gjatë 1.20 m., aq sa është pjesa në dukje dhe ka tre rreshta. Rreshti i parë është me tulla të vendosura drejtë, i dyti në formë dhëmbësharre, i treti, nga i cili ruhen vetëm gjurmët, është rresht i drejtë (tab. IV, 4). Nga korniza horizontale mbi vetë murin jugor, ruhen vetëm dy rreshta me tulla të vendosura drejtë, mbi të cilat nuk ruhen gjurmë të tullave mbi to. Duhet shtuar se nuk rezultonte qartë, në se këto ishin në vendin e tyre, sepse bimësia kishte dëmtuar së tepërmi llaçin lidhës.

Me mbarimin e punimeve çliruese, kaluam në punimet e mirëfillta të restaurimit. Në fillim ndërtuam çatinë e kupolës dhe restauruam tamburin, më tej kaluam në kompletimin e kornizave si element i domosdoshëm për ndërtesë, sipas formës së vjetër; një rresht dhëmbësharre e një rresht i drejtë mbi to. U lanë pa prekur gjithë elementët e vjetër si dëshmi të vlefshme dokumentare. Përsa i përket kornizës, në zonën e narteksit më të vonë, e rindërtuam sipas kornizës ekzistuese, me rrasa guri të nxjerra konsol ndaj murit, sigurisht në pjesët ku ajo mungonte.

Pas ndërtimit të kornizave filluam ndërtimin e çatisë, në fillim pjesët me strukturë druri, pastaj ndërtuam mbulesën e çatisë me tjegulla. Zgjodhëm variantin me tjegulla, megjithëse nuk gjetëm asnjë gjurmë, pasi menduam, se përderisa janë përdorur tullat në të duhet të jenë përdorur dhe tjegulla. Në se kjo zgjidhje do të gjykohet në të ardhmen jo e

FOTOCOPY

drejtë, çatia mund të zëvendësohet lehtësisht me rrasa guri.

Me përfundimin e çatisë mbetej të mbyllnim me mur dritaret e vona, përderisa murin e çrregullt të tyre do të duhej ta preknim. Për shkak të nivelit të lartë të dherave, jashtë kishës, nuk hapëm derën e murosur të narteksit dhe atë të naosit. Me plotësimin e dritareve, sistemimin e brëndshëm të monumentit dhe sistemimin e ambientit përreth, morën fund punimet për restaurimin e tij.

Me restaurimin vlerat arkitekturale të monumentit, deri diku janë vënë më në dukje, pra, është e mundur të vrojtohet më mirë nga ana shkencore, si dhe është garantuar qendrueshmëria e tij në kohë (tab. IV, 5).

Së fundi, le të trajtojmë vlerat arkitekturale të monumentit dhe datimin e tij. Në anën e jashtme kisha dallohet nga rigoroziteti i faqeve dhe vijave të drejta të kornizave. E vetmja notë e gjallë vjen nga fregmentimi i çative si nga transepti, ashtu dhe nga tamburi me kupol, që me vertikalitetin e vet ndërpret vështrimin mbi sipërfaqet e rrafshta e të gjëra të çatisë. Përsa i përket dekorit ai mungon fare në tërë kishën, me përjashtim të kupolës. Por edhe aty i janë shmangur kluasonazhit, duke përdorur dekorin me rreshta dhe që, vetëm në pjesën e sipërme, mbi harqet, korniza gjallërohet me një dekor tullash, që me ngjyrën e tyre kafe i shmangen së tepërmi përshtypjes së përgjithshme. Me interes monumenti paraqet në interier jo vetëm për shkak të hapësirës brendshme barzilikale, por dhe prej kupolës që shton ndjenjën e vertikalitetit në pjesën qendrore të kishës nëpërmjet ngritjes në lartësi në krahasim me nefin qëndror, e bën atë të duket sikur është në ajër. Mbas restaurimit, me hapjen e gjithë dritareve kjo përshtypje është shtuar së tepërmi.

Vendosja në kohë e kishës së manastirit të Shën-Thanasit paraqet një sërë vështirësish për mungesë të të dhënave epigrafike dhe burimore, ndërsa tradita gojore e konsideron këtë monument si të periudhës para pushtimit turk. Analiza arkitekturale e kishës ofron një diapazon të gjërë që nga arkitektura e vonë bizantine e deri tek arkitektura pasbizantine. Në rastin e parë, duke u nisur nga tipi, ndërtimi vëllimor, forma e qemereve të nefave anësorë dhe dekori (kluasonazh në embrion) do të kishim të bënim me një produkt të një ateljeje vëndase, që nuk arriti të asimilonte tërësisht tipin kryq të brëndashkruar dhe që vazhdoi t'i përmbahet tipit të vjetër e me rrënjë të thella në provinca, pra, bazilikës. Në këtë rast trajtimi rigoroz si në sipërfaqet, ashtu dhe volumet, mungesa e kluasonazhit, tamburi jo shumë i zhvilluar, na shtyjnë për një datim pak a shumë të hershëm, në shek. XII-XIII. Në rastin e dytë kemi të bëjmë me një tip, që, me disa ndryshime, takohet në kisha të tjera të kësaj zone. Kështu bazilika trenefshe me kupol mbi tambur dhe nefat anësore të mbuluar me qemere me seksion çerek rrethi janë, Shën-Thanasi i Mozhanit, po në Poliçan (pikturuar në fundin e shek. XVI fillimi shek. XVII) dhe Shën-Mëria në Vllahogoranxi (ndërtuar në vitin 1622). Bazilika me kupol mbi transept janë, kisha e Manastirit të Shën-Qiriakut dhe Julitës në Dhuvjan (ndërtuar në vitin 1583) dhe kisha e Manastirit të Ungjillëzimit në Vanishtë (ndërtuar në vitin 1582). Këto dy kisha, përveç tipit, kanë të përbashkët, në disa aspekte, edhe dekorin me tulla të kupolës. Dallimet janë në drejtim të formave. Ajo e Poliçanit është elegante. Brezat e tullave, së paku në Dhuvjan ku janë në dukje, përbëhen nga tre rreshta dhe pa tulla vertikale, mungon në to dekori me tulla, ndërmjet kornizës dhe harqeve të tamburit. Në Vanishtë e në Dhuvjan kemi alternativisht një dritare dhe një nikje.

Në një kuadër të tillë të dhënash datimi është i vështirë, sepse për ndërtimin e kishave me tipare të tilla të përafërta, fare mirë mund të shërbente si prototip edhe kisha e Shën-Thanasit e ndërtuar, mbase pak shekuj më parë, gjë që ndodh zakonisht me monumentet pasbizantine. Po kështu mund të shërbente për prototip ndonjë kishë tjetër për të gjithë monumentet e kësaj kategorie. Është për të shënuar se mjaft nga elementet arrijnë të kenë përdorim dhe në kisha të tjera, p.sh. qemeret çerekrrethor i hasim në Shën-Triadhën e Pepelit (pikturuar në vitin 1754).

Për një datim më të saktë mbeten për tu kryer studime të mëtejshme, mbi arkitekturën bizantine dhe pasbizantine të zonave të ndryshme të Gjirokastrës dhe krahinave pranë.

DO NOT COPY

TAB. I



Premje gjatësore



Premje tërthore



Planimetria



Pamje nga Lindja

0 1 2 3 4M

DO NOT COPY













DO NOT COPY

TAB. III

DO NOT COPY



Pamje nga Veriu



Pamje nga Jugu











DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

RESTAURATION DE L'EGLISE DU MONASTERE DE SAINT-ATHANASE DE POLIÇAN

RESUME

L'église de Saint-Athanase est une basilique à trois nefs dotées de colonnes, d'un transept surmonté d'une coupole et d'un narthex de construction plus tardive. La nef centrale, qui est aussi la plus haute par rapport aux deux autres, est recouverte d'une voûte en plein cintre, tandis que les deux nefs latérales sont surmontées par une voûte en quart de cercle. C'est dans la partie centrale de cette coupole qu'a été aménagée un transept recouvert par une voûte en demi-cercle. L'église en question est couverte par un toit à deux pentes, tandis que ses côtés est et ouest se terminent avec un fronton. Transversalement se trouve le toit à deux pentes du transept qui se termine aussi avec des frontons, mais évidemment de dimensions plus petites. A leur point de contact se dresse, sur un soubassement cylindrique, un tambour surmonté de coupole. Le tambour est à 8 faces, dont chacune est dotée de petites colonnes à ses angles ainsi que d'une fenêtre. Les murs du tambour sont en pierres et se caractérisent par une bande de briques à trois rangées. Chacune des faces présente des arcs échelonnés et des corniches de briques disposées en dents de scie. Le tambour se termine par une corniche plate de briques.

En ce qui concerne le narthex disposé sur le côté occidental, il est actuellement couvert par un toit en bois. Naguère, à ce que l'on peut juger des traces visibles sur ses murs, il doit avoir été couvert par une voûte cylindrique. Il s'agit évidemment d'une construction tardive, comme l'atteste les joints de contact visibles sur ses murs.

Par suite de la confrontation de la forme des murs et de leur technique de construction, il n'est pas difficile de distinguer les adjonctions des anciens murs ainsi que les fenêtres percées plus tard. Ainsi l'on arrive à relever les adjonctions faites au fronton septentrional du transept.

Une fois l'étude du monument portée à terme, on a entamé les travaux de restauration qui consistaient à éliminer les adjonctions d'aucune valeur, à réparer les toits et leurs structures de soutien, à libérer les portes et les fenêtres murées et à réparer une série d'autres endommagements de plus petite entité. En ce qui concerne le narthex, il a été décidé de la conserver à son état actuel qui reproduit les trois différentes phases de construction.

Pendant les opérations consistant à éliminer l'enduit du tambour, on a mis au jour le décor en pierres et en briques qui a profondément ravivé l'aspect de cette église. Les travaux pour enlever le toit en dalles de pierre ont montré que celles-ci reposaient directement sur les structures des couvertures à voûts, ce qui ne nous a pas permis de savoir si l'ancien toit était naguère couverte de tuiles. Pendant ces travaux de dégagement il a été possible d'observer la présence partielle d'anciennes corniches de pierres disposées directement et en dents de scie.

Les travaux de restauration ont fait ressortir non seulement la valeur architecturale de ce monument, mais encore de l'observer mieux et d'en garantir la stabilité dans le temps. En ce qui concerne sa valeur architecturale, nous sommes en présence d'un monument modeste. L'église de Saint-Athanase se fait remarquer par la rigueur dans le traitement de ses faces et ses lignes droites. Exception faite de la coupole, le décor y fait absolu-

DO NOT COPY

ment défaut. Quant à l'intérieur du monument, il présente de l'intérêt non seulement pour ce qui concerne l'espace intérieur de la basilique mais aussi pour le sens de la verticalité souligné particulièrement par la coupole étroite qui semble comme suspendue.

La datation de cette église présente maintes difficultés en raison du défaut de données épigraphiques et de sources documentaires. Quant à la tradition, elle l'attribue à la période précédent l'occupation turque. De l'analyse architecturale il ressort un diapason s'étendant de l'architecure byzantine tardive à l'architecture postbyzantine. Dans le premier cas nous sommes en présence de la production d'un atelier local n'ayant pas complètement assimilé le type d'église à croix inscrite et s'en tenant encore à l'ancien type de basilique, qui avait poussé de profondes racines dans les provinces. S'il en est ainsi, le traitement des surfaces comme des volumes, le manque du cloisonnage, le tambour insuffisament développé sont sutant d'éléments qui nous induisent vers une datation plus ou moins tardive, les XIIe-XIIIe siècles. Dans le deuxième cas, nous sommes en présence d'un type, qui, à quelques différences près, se rencontre dans d'autres églises de cette zone. Exemples de basiliques à trois nefs, dotées de tambour à coupole et surmontées de voûtes en quart de cercle, sont l'église de Saint-Athanase de Mazhar à Poliçan (peinte vers la fin du XVIe-le commencement du XVIIe siècle) et celle de Sainte-Marie de Vllahogoranxi éditiée en 1622). Le type de basilique à transept, surmonté de coupole, se retrouve dans l'église du monastère de Saint-Qiriak et de Julite de Dhuvjan (construite en 1583) ainsi que dans l'église du Monastère de l'Evangélisation de Vanishte (construite en 1582). Ces deux églises sont non seulement et celle que nous sommes en train d'examiner appartiennent non seulement au même type, mais ont encore en commun la décoration en briques de la coupole. Les différences qui les caractérisent concernent leurs formes, qui sont plus élégantes dans l'église de Poliçan, ainsi que le manque de briques verticales entre les rangées de briques et la disposition alternative de la fenêtre et de la niche.

Avec de telles données, le problème de la datation n'est point aisé du fait que pour la construction d'églises ayant des traits approximatifs pourrait également servir de prototype l'église en examen, édifiée probablement quelques siècles auparavant, comme cela arrive d'habitude avec les monuments postbyzantins. Bien plus un autre monument pourrait fort bien servir de prototype à tous les monuments mentionnés plus haut, y compris l'église objet de cette étude.

Pour une datation plus exacte de ce monument, il importe d'effectuer des études plus approfondies en ce qui concerne l'architecture byzantine et postbyzantine dans les différentes zones de Gjirokastër et les régions avoisinantes.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

JETA SHKENCORE

Gjatë vitit 1973 u ndërmorën punime restaurimi dhe konservimi në 145 monumente.

Sektori i monumenteve antike vazhdoi punimet në shkallë të gjërë në muret rrethuese të qytetit ilir të Lisit. U krye anastiloza e portës së brendshme të qytetit dhe e ambienteve në krahët e saj. Gjithashtu u pregatitën kushtet për vazhdimin e restaurimit në pjesë të tjera të murit rrethues. Në Zgërdhesh punimet me karakter konservimi u përqëndruan në murin e akropolit, ku u krijuan mundësitë për restaurimin e hyrjes kryesore në këtë pjesë të qytetit. Porta kryesore e qytetit ishte objekt i punimeve konservuese edhe në qytetin ilir të Klosit. Këtu u kryen gjithashtu punime anastiloze në pjesën perëndimore të murit rrethues. Punime me karakter konservimi u kryen edhe në amfiteatrin e Durrësit dhe varret monumentale të Selcës së Poshtme. Qendrat arkeologjike të Apollonisë dhe Butrintit përbënin gjithashtu objekte të rëndësishme të punës konservuese dhe restauruese. Në to u kryen punime në muret rrethuese dhe monumentet me karakter shoqëror apo privat.

Sektori i monumenteve mesjetare pati si objekt kryesor në punimet e veta kalatë e Beratit, Butrintit, Ishmit, Kaninës, Durrësit dhe Shkodrës. U ndërmorën masa konservuese dhe restauruese në muret rrethuese, duke synuar kryesisht në vlerësimin e tyre dhe në sigurimin e strukturave të dëmtuara. Ky sektor kreu punime edhe në një sërë monumentesh kulti si në xhaminë e Allajbegisë, kishën e Mesopotamit, Sopikut, Selçkës dhe xhaminë e Gjin Aleksit. Punime më të kufizuara, kryesisht me karakter konservimi janë kryer në një numër monumentesh kulti në rrethet e Peshkopisë, Gjirokastrës etj.

Sektori i qendrave historike ka kryer punime konservimi dhe restaurimi në një numër të madh banesash popullore, kryesisht në qytetet-muze të Beratit dhe Gjirokastrës. Në të parin puna u krye duke përfshirë ansamble të gjërë arkitektonikë në lagjet Mangalem dhe Kala, ndërsa në Gjirokastër punimet u përqëndruan kryesisht në monumente të kategorisë së dytë që paraqisnin nevoja urgjente konservimi dhe restaurimi. Gjithashtu u kryen punime me stil të gjërë edhe në qytetet Shkodër, Korçë, Tiranë, Krujë dhe Elbasan.

Sektori i arteve ndërmori punime me karakter konservimi në mozaikun e bazilikave paleokristiane në Tiranë, Butrint dhe Lin. Gjithashtu u kryen punime konservuese në mozaikët e Apollonisë dhe afreskat e kishës së Shën Triadhës në Berat.

* *
*

Më 3-10 tetor 1973 zhvilloi punimet në Selanik (Greqi) Kolokiumi II i ICOMOS-it, i organizuar nga Komiteti nacional grek i ICOMOS-it. Në këtë kolokium mori pjesë dhe një delegacion i vendit tonë, i cili u paraqit me dy kumtesa: **«Probleme të mbrojtjes dhe gjallërimit të fshatit historik të Shqipërisë»,** që u mbajt nga G. Strazimiri dhe, **«Arkitektura fshatare shqiptare»,** që u mbajt nga P. Thomo.

Në kumtesën e parë autori vuri në dukje masat që janë marrë në vendin tonë për ruajtjen e monumenteve të arkitekturës popullore, lehtësitë që krijon legjislacioni ynë për mirëmbajtjen dhe restaurimin e tyre, kriteret që ndiqen tek ne për mbrojtjen dhe gjallërimin e ndërtimeve dhe qendrave historike si në qytet, ashtu dhe në fshat.

Kumtesa e dytë trajtonte tipologjinë e arkitekturës fshatare. Theksi kryesor në këtë kumtesë, pa mohuar ndikimet reciproke ndërmjet popujve fqinjë, u vu në zhvillimin e brendshëm të arkitekturës fshatare.

Duke ndjekur rrugët e zhvillimit të tipeve të banesave nga më të thjeshtat deri në ato më të evoluarat, u tregua se sa pa baza janë pohimet e autorëve të huaj, të cilët mbivlerësonin ndikimet dhe huazimet nga jashtë.

Mjaft delegatë në diskutimet në sallë dhe në ato të lirat, shprehën fjalë të ngrohta për punën e mirë që bëhet tek ne për konservimin dhe studimin e arkitekturës popullore dhe, ç'është më kryesore, shumë prej tyre pranuan se pa materialin shqiptar nuk mund të dilet në konkluzione të drejta për arkitekturën ballkanike, prandaj duhet të rishikohen mjaft pikpamje të shfaqura deri më sot.

* * *

Në muajin tetor erdhi në vendin tonë restauratori rumun ing. Ion Istudor, i Drejtorisë së Monumenteve Historike dhe të Arteve të Bukureshtit, i cili dha një ndihmë të mirë në drejtim të restaurimit dhe konservimit të ikonave. Specialisti rumun u muar kryesisht me konservimin dhe restaurimin e ikonave të kishës së Shën-Mëri Vllahernës të Beratit dhe përvoja e tij ishte një ndihmë e madhe për punonjësit e sektorit të artit të Institutit tonë.

Gjithashtu në muajin nëntor, Qendra Ndërkombëtare e Studimeve Restauruese dhe Konservuese në Romë, sipas marrëveshjes përkatëse, dërgoi në vendin tonë restauratorin e saj Raimondo Boenni, i cili studjoi në përgjithësi gjendjen e ikonave tona dhe masat që duhet të merren në të ardhmen për konservimin dhe restaurimin e tyre. Mendimet dhe konkluzionet e tij qenë një kontribut i vlefshëm për mbarëvajtjen e punës konservuese në sektorin tonë të arteve.

* * *

Gjatë vitit 1974 Instituti i Monumenteve të Kulturës kreu punime konservimi dhe restaurimi në 172 monumente.

Sektori i monumenteve antike dhe këtë vit e përqëndroi punën në qytetet ilire. Në Lezhë punimet u kryen gjatë murit të brendshëm dhe në anën jugperëndimore të murit rrethues. Gjithashtu u kryen punime me karakter konservimi në anën veriore të këtij muri dhe në substruksionet e murit mesjetar, ku dolën më mirë në dukje gjurmët e akropolit antik. Në Klos u bë anastiloza e murit të parodosit të teatrit, ku dolën në dritë një numër i madh dekretesh mbi dhënien e të drejtës së qytetarisë. Në Bylis punimet konservuese nxorrën në dukje një pjesë të mirë të sistemit të fortifikimit në anën verilindore të qytetit. U sqarua oborri i fortifikuar nga ana veriore si dhe katër hyrje dhe pesë kulla, të cilat do të jenë objekt i punimeve restauruese në vitet e ardhshme. Në Antigone, Amantia, Mavrovë dhe Dimal u kryen punime me karakter konservimi dhe u pregatitën kushte për ndërhyrje restauruese në vitet e ardhshme. Në Apolloni filluan punimet pregatitore për anastilozën e fasadës së monumentit të Agonotetëve që do të realizohet vitin e ardhshëm. Punime me karakter konservimi u ndërmorrën dhe në Butrint, Selcën e Poshtme, Durrës etj.

Sektori i monumenteve të arkitekturës mesjetare kreu punime restaurimi në kalanë e Beratit, Drishtit dhe në fortifikimet mesjetare të Butrintit. Punime me karakter pastrimi dhe konsolidimi të mureve u kryen gjithashtu në kalanë e Durrësit, Peqinit dhe Petrelës. Punimet e restaurimit në Drisht u përqëndruan në akropolin e qytetit ku u prek muri jugor i tij dhe kulla e hyrjes. Në Berat punimet u kryen në kullën e hyrjes kryesore ku u mënjanua dëmtimi i mëtejshëm i saj. Në Butrint punimet u përqëndruan në restaurimin e kullës jugore të kështjellës mesjetare në bregun jugor të kanalit të Vivarit. Punime konservimi me stil të gjërë u bënë në xhaminë e Ethem Beut në Tiranë, si dhe punime konservimi në një sërë monumentesh kulti në zonat e Myzeqesë, Gjirokastrës, Voskopojës, Vithkuqit, Peshkopisë etj. Gjithashtu u bënë një sërë studimesh për punime konservimi dhe restaurimi si dhe rilevime të monumenteve të kultit në zona të ndryshme të vendit.

Sektori i artit u preokupua kryesisht me restaurimin e ikonave dhe afreskave që u dërguan në ekspozitën e Parisit «Arti shqiptar në Shekuj». Në këtë punë punonjësit e këtij sektori u ndihmuan nga një specialist rumun, i cili ndejti dy muaj në vendin tonë.

Sektori i qendrave historike ka kryer punime konservimi dhe restaurimi në një sërë banesash të kategorisë së parë dhe të dytë, në qytetet-muze të Beratit dhe Gjirokastrës, si dhe në qytetet e Shkodrës, Korçës, Elbasanit, Krujës dhe Tiranës. Në qytetet-muze është punuar kryesisht për restaurimin e një sërë banesash të kategorisë së dytë. Krahas tyre, veçanërisht në Berat, është punuar për restaurimin e një numri monumentesh të kategorisë së parë. Për t'u përmendur janë punimet në një banesë karakteristike me çardak të fundit të shek. XIX, e cila është një ekzemplar tipik që shquhet për kompozimin dhe trajtimin arkitektonik të saj. Në qytetin e Gjirokastrës

DO NOT COPY

përfundoi restaurimi i banesës së Zekatëve, një nga më të shquarat në këtë gjini, e cila u kthye në muze etnografik. Ateljeja e Shkodrës punoi gjatë këtij viti në gjashtë banesa, duke kryer në to kryesisht punime konsolidimi dhe në disa ambiente dhe ndërhyrje të karakterit restaurues. Në Korçë vazhduan punimet për restaurimin e hanit të Elbasanit, një nga ekzemplarët e rrallë të kësaj gjinije në vendin tonë. Krahas këtyre vazhduan punimet e konservimit në Pazarin e Korçës dhe në disa banesa të kategorisë së dytë në zonën-muze të qytetit. Në qytetin e Elbasanit u përfundua restaurimi i plotë i një banese karakteristike të gjysmës së dytë të shek. XIX, ndërsa në Krujë dhe në Tiranë u krye restaurimi i dy banesave tipike për këto dy qendra.

*
* *

Punonjësit shkencor bënë një punë më të gjërë dhe më të kualifikuar shkencore, duke pregatitur dhe dorëzuar për botim 25 artikuj të ndryshëm. Gjithashtu krahas punës propaganduese, dolën nga shtypi dhe u vunë në qarkullim numrat 3 dhe 4 të serisë botimit «Monumentet» si dhe albumi «Monumentet e Arkitekturës në Shqipëri».

DO NOT COPY

NDREQJE GABIMESH

Faqe	Kollona	rreshti	Si është	si duhet të jetë
15	–	–	fig 11	fig. 12
			fig. 12	fig. 11.
16	II	15	shkurtër	sigurt
30	II	3	shek. IV	shek. VI.
74	I	31	kalon te trasea	kalonte si trasea
81	II	16	1	L
82	II	6	të barabartë	të pabarabartë
112	II	12	1913	913
115	II	2	ndaj	ndahet nga
118	–	20	IX-X	X
150	II	28	të frengjisë	si frengji
151	I	6	tab. VIII	tab. VII
168	II	35	fig. 13 A, D	fig. 18 B, C, E, F, fig. 14
169	II	23	fig. 19 C, F	fig. 18 C, F
179	–	15	fig. –	fig. 19
189	II	11	tërthor	rrethor

DO NOT COPY

Tirazhi: 1500 kopje Formati 70 x 100/12 Stash: 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik Shtypshkronja «Mihal Duri», Tiranë –

DO NOT COPY

Çmimi 10 Lekë

IMK